



ISBN 978-9928-210-03-6

ISSN 2413-1334

Konferenca e I-rë Shkencore Ndërkombëtare



Policimi dhe **SIGURIA**

Kontributi në sigurinë publike
nëpërmjet arsimimit

NËNTOR
2016

PROCEEDINGS
Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2016

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

390

POLICIMI DHE SIGURIA

Kontributi në sigurinë
publike nëpërmjet arsimimit

PROCEEDINGS

PROCEEDINGS

Botuar nga Akademia e Sigurisë, Tiranë

KONFERENCA E I-rë
NDËRKOMBËTARE

2016

© - Akademia e Sigurisë, Tiranë.

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet, shpërndalet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të këtij botimi, pa autorizim, përbën shkelje penale të të drejtave të autorit.

Akademia e Sigurisë zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Policinë e Shtetit dhe Arsimin e lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim, janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Akademisë së Sigurisë. Autorët e publikimeve gëzojnë liri të plotë akademike, me kushtin e vetëm që kur shkruajnë, ata të zbatojnë të gjithë legjislacionin përkatës si të komunikimit edhe atë profesional, i cili nuk cenon të drejtat e ndryshme.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

RSH. Akademia e Sigurisë
Policimi dhe siguria : kontributi në sigurinë publike
nëpërmjet arsimimit : konferenca e I-rë ndërkombëtare:
Tiranë, 31 tetor-1 nëntor, 2016 : proceedings / RSH.
Akademia e Sigurisë ;
red. shkenc. Albert Hitoaliaj. – Tiranë : Akademia e Sigurisë,
2016... f. ; 16.5 X24cm.
Bibliogr.

ISBN 978 - 9928 - 210 - 03 - 6

Libri në shqip dhe angl.
1.Policia 2.Arsimi i lartë 3.Siguria kombëtare 4.Konferenca

351.74(496.5)(062)



AKADEMIA E SIGURISË

KONFERENCA E I-rë SHKENCORE NDËRKOMBËTARE, nëntor 2016, Tiranë

*Në bashkëpunim me Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Akademinë e Forcave të Armatosura,
Universitë degli Studi di Roma "Tor Vergata" dhe Universiteti i Tiranës*

Kontributi në sigurinë publike nëpërmjet arsimit
Contribution to public safety through education

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

Bordi Shkencor/ Scientific Committee

Kryetar i Bordit/Chair

Prof. Dr. Ismet **ELEZI**, Kriminolog

Anëtarët/Members

Prof. Dr. Mynyr **KONI** - Rektor i Universitetit të Tiranës
 Prof. Dr. Dhori **KULE** - Dekan i Fakultetit Ekonomik, Universiteti i Tiranës
 Prof. Dr. Irakli **KOCOLLARI** - Rektor i Universitetit "Akademia Profesionale e Biznesit"
 Prof. Dr. Giovanni **ARCUDI** - Profesor, Universiteti i Romës "Tor Vergata"
 Prof. Dr. Emiliano **GIARDINA** - Profesor, Universiteti i Romës "Tor Vergata"
 Prof. Asc. Dr. Rauf **DIMNAJ** - Zv. Ministër i Arsimit dhe Sporteve
 Prof. Asc. Dr. Bejtush **GASHI** - Pedagog, Akademia e Kosovës për Siguri Publike
 Prof. Asc. Dr. Snezana **MOJOSKA** - Zv. Dekane, Universiteti "St. Kliment Ohridski-Manastir", Fakulteti i Sigurisë, Shkup
 Prof. Asc. Dr. Qetsor **ORHAN** - Pedagog, Akademia e Sigurisë, Tiranë
 Dr. Frank **HARRIS** - Këshilltar i Engjilijty për "ICITAP" në Shqipëri
 Dr. Sandër **LLESHI** - Këshilltar për Sigurinë, Këshilli i Ministrave
 Dr. Bilbil **MEMAJ** - Rektor/Drejtor i Përgjithshëm i Akademisë së Sigurisë, Tiranë
 Dr. Xhavit **SHALA** - Drejtor i Qendrës së Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë
 Z. Ismail **SMAKIQLI** - Drejtor i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike
 Dr.(proc.) Albert **HITOALIAJ** - Akademia e Sigurisë, Tiranë

Komiteti organizator/Organizational committee

Drejtuues i Lartë Dr. Bilbil **MEMAJ** - Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë së Sigurisë, Tiranë
 Drejtuues Dr. Xhavit **SHALA** - Drejtori i Qendrës së Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë
 Prof. Dr. Ilirjan **MANDRO** - Dekan i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë, Tiranë
 Prof. Asoc. Dr. Pandeli **TAÇI** - Shef i Sektorit të Botimeve, në Qendrën e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë,
 Drejtuues Mehdi **ÇANGA** - Drejtor i Drejtorisë së Administratës, Akademia e Sigurisë, Tiranë
 Drejtuese Laura **TOTRAKU** - Shefe e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun, Drejtoria e Policisë së Shtetit

Sekretariati dhe koordinimi/secretariat and coordination

Msc. Anisa AGASTRA, (koordinatore e konferencës) Sektori i Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë
 Dr. Irvin FANIKO, Shef i Sektorit të Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë
 Dr. (proc.) Albert HITOALIAJ, Sektori i Botimeve, Akademia e Sigurisë, Tiranë
 Andi OSMANI, Sektori i Botimeve, Akademia e Sigurisë, Tiranë

Redaktor Shkencor

Dr. (proc.) Albert HITOALIAJ - Akademia e Sigurisë, Tiranë

Punimet grafike

Andi Osmani

Realizimi teknik

Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë

© Akademia e Sigurisë, Tiranë 2016

Përmbajtja

Sesioni I / First Section

Ballkani Perëndimor - Kërcënimet dhe rreziqet ndaj sigurisë publike
dhe sfidat e përballjes me to

Dr. Bilbil MEMAJ

Siguria publike arrihet me specialistë të shkolluar dhe inteligjentë.....10

**Assos. prof. Snezana MOJSOSKA
dhe Assist. prof. Nikola DUJOVSKI**

The importance of education of economy as contribution to public safety22

Dr. Frank HARRIS

Trafikimi ndërkombëtar i drogës: nxjerrja e mësimeve nga Afganistani.....32

Dr. Sandër LLESHI

Edukimi modern si antidot i pazëvendësueshëm në përballjen me ekstremizmin e dhunshëm...42

Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI

Konceptet e sigurisë nacionale të Kosovës, sfidat përballë një bote në ndryshim.....52

Dr. Rruzhdi KUÇI

Emigracioni, trafikimi i qenieve njerëzore dhe pasojat në sigurinë kombëtare.....64

Dr. Marenglen KASMI dhe Prof. Dr. Kristaq XHARO

Reflektime mbi arsimimin në Fushën e Sigurisë përvoja, dinamika dhe sfidat e së ardhmes.....78

Prof. Asc. Dr. Pandell TAÇI

Impakti i shkollimit policor në përballjen me kërcënimet ndaj sigurisë(Vështrim studimor mbi shkollën shqiptare të policisë)88

Msc. Qetësor GURRA dhe Msc. Jonida GURRA

Lëvizja e emigrantëve dhe impakti mbi sigurinë.....100

Dr. Xhavit SHALA dhe Msc. Eros SHALA

Arsimimi, faktor i rëndësishëm për neutralizimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm ...112

Dr. (në proces) Riza SHILLOVA

Ndikimi i reformimit të Policisë së Kosovës në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe ekstremizmit të dhunshëm.....126

Msc. Nazmi IBALLI, Dr. (në proces) Kujtim BYTYQI, Dr. Bekim BODRIMQAKU Shtytësit kryesor të radikalizmit dhe shkalla e problemit me ekstremizëm të dhunshëm: Rasti i Kosovës	138
Dr. Rezana BALLA Detyrimi pozitiv i shtetit për mbrojtjen e së drejtës për të mos qenë subjekt i trajtimit çnjerëzor ose degradues, gjatë dhënies së dëshmisë.....	150
Msc. Silena TOLA Riintegrimi i viktimave të trafikimit dhe impakti në siguri (Rasti i vajzave dhe grave të trafikuar në Shqipëri).....	162
Dr. Aurel KOROÇI dhe Prof. Asc. Dr. Stavri SINJARI Eksplorimi i marrëdhënieve të korrupsionit me të ardhurat tatimore.....	174

Sesioni II / Second Section

Roli dhe ndikimi i arsimimit në sigurinë publike

Msc. Nikoll RICA Trajnimi profesional i vazhdueshëm në Policinë e Shtetit.....	182
Dr. (në proces) Artili MANDRO dhe Prof. Dr. Ilirjan MANDRO Përqasja e kurikulave të arsimit policor me misionin e sigurisë publike.....	194
Prof. Asc. Dr. Stavri SINJARI dhe Dr. Aurel KOROÇI Polici i së nesërme arsimiti	206
Dr. (në proces) Ilo KEÇKA Zhvillimi i vazhdueshëm profesional, garanci për një shërbim policor cilësor dhe demokratik....	216
Dr. (në proces) Ferid AZEMI Ethical and social justice issues - the case of correctional institutions	226
Prof. dr sc. Nikola DUJOVSKI dhe Prof. dr sc. Snezhana MOJSOSKA Students attitudes on police ethics and it contribution to public safety.....	236
Msc. Tonin VOCAJ Nevoja për programe deradikalizimi në Shqipëri.....	248
Msc. Ardi VELIU Policimi dhe Shoqëria, një marrëdhënie interaktive afatgjatë bazuar në edukim dhe përgjegjshmëri.....	262

Prof. Asoc. Dr. Qetsor ORHAN

dhe Msc. Qetësor GURRA

Programet e arsimit policor konform kërkesave të ligjit për arsimin e lartë në RSH274

Dr. Xhavit SHALA

Reformimi i sistemit arsimor policor, domosdoshmëri për përballimin e sfidave bashkëkohore të sigurisë.....282

Dr. Irvín FANIKO

Liria e besimit në Kushtetutën e Shqipërisë së vitit 1950 dhe në Kushtetutën e vitit 1976 (Aspektet historiko-juridike).....298

Msc. Anisa AGASTRA

Rëndësia e arsimit dhe pedagogjisë në dimensionin policor dhe të sigurisë publike.....306

Msc. Elerta SHANAJ

Analizimi i veprës penale së përndjekjes(Sanksionimi dhe evoluimi i ligjeve të kësaj vepre penale, me zhvillimin e shoqërisë).....318

Ma.Sc. Agron RUKIË

Ngritja e kapaciteteve trajnuese te Policisë së Kosovës dhe ndikimi i tyre në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar328

Msc. Ajdin MBORJA

dhe Dr. (në proces) Artill MANDRO

Formimi i ekspertëve kriminalistë përballë sfidave të kohës338

MR LI. Nebi HALILI

Zhvillimi i Procedurës Penale ndaj të miturve348

Dr. Myzafer ELEZI

Reformimi i arsimit bazë policor për përballimin e sfidave të së ardhmes të cilat ndeshet punonjësi i policisë.....360

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

KONFERENCA E I-rë NDËRKOMBËTARE
“KONTRIBUTI NË SIGURINË PUBLIKE NËPËRMJET ARSIMIMIT”
Nëntor 2016, Tiranë

Akademia e Sigurisë organizoi konferencën shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare, me titull: “Kontributi në sigurinë publike nëpërmjet arsimit” (“*Contribution to public safety through education*”), në bashkëpunim me Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Akademinë e Forcave të Armatosura, Universitë degli Studi di Roma “Tor Vergata” dhe Universiteti i Tiranës Akademikë, studiues, profesionistë dhe studentë ishin pjesëmarrës me punimet/projektet dhe propozimet e tyre. Konferenca u zhvillua në gjuhën shqip dhe anglisht. Natyra shumëdimensionale dhe e sofistikuar e kërcënimeve imponon trajtimin e çështjes së arsimit në fushën e sigurisë, dhe jo vetëm, si prioritet. Arsimiti i ndërthurur me trajnimet profesionale dhe kërkimi shkencor shtojnë shinat e një zhvillimi profesional të qëndrueshëm, për një policim më dinamik dhe të adoptueshëm me ambientin e pasigurt e të ndryshueshëm të sigurisë. Sipas studimeve, në shumë vende Perëndimore konstatohet siguri më e mirë publike me rritje të investimeve në arsimimin e burimeve njerëzore të agjencive të zbatimit të ligjit, mbështetje më e madhe nga komuniteti e këtyre agjencive kur personel i mirëarsimuar u shërben sigurisë së tyre; adoptueshmëri më të lartë me ambientin dinamik të kërcënimit; përmirësim të kapaciteteve menaxheriale të organizatës dhe për më tepër kriminalitet më i ulët në zona e rajone me popullsi të arsimuar.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

Objekti i konferencës

Objekti kryesor i konferencës ishte trajtimi i rolit dhe impaktit të arsimit në përgjithësi, në zbutjen e kërcënimeve ndaj sigurisë, arsimit dhe trajnimit profesional në fushën e sigurisë në veçanti, në raport me sfidat e sotme dhe të ardhme të sigurisë publike; diskutimi i qasjeve dhe hartimi i rekomandimeve në ndihmë të përmirësimit të programeve akademike në fushën e sigurisë për të përmirësuar cilësinë e policimit dhe përgatitur ekspertë të lartë sigurie për agjencitë e zbatimit të ligjit.

Struktura e konferencës

Konferenca u organizua në dy sesione:

Sesioni I

“Ballkani Perëndimor - Kërcënimet dhe rreziqet ndaj sigurisë publike dhe sfidat e përballjes me to”, me nënçështje si:

- radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm;
- analizë kontekstuale e vektorëve që nxisin radikalizimin;
- krimi i organizuar dhe ekstremizmi i dhunshëm;
- trafiqet e paligjshme, kriza e emigrantëve dhe impakti në sigurinë;
- roli i agjencive të zbatimit të ligjit në menaxhimin e krizës së emigrantëve;
- bashkëpunimi dhe koordinimi si domosdoshmëri në përballje me kërcënimet e përbashkëta etj.

Sesioni II

“Roli dhe ndikimi i arsimit në sigurinë publike”, me nënçështjet si:

- arsimimi dhe siguria publike;
- krijimi i besimit dhe rritja e sigurisë së komunitetit përmes policimit në komunitet;
- sofistikimi i krimit dhe kapacitetet infrastrukture, njerëzore të agjencive të zbatimit të ligjit;
- rëndësia e arsimit në fushën e sigurisë: Akademia e Sigurisë auditori i përgatitjes së gjeneratës së re të specialistëve të sigurisë;
- qasje bashkëpunuese mes arsimit, trajnimeve profesionale dhe kërkimit shkencor për një policim më dinamik dhe të adoptueshëm me ambientin e sigurisë në ndryshim etj.

Pjesëmarrja ishte e hapur për stafin akademik të Akademisë së Sigurisë dhe studiuës nga radhët e strukturave të Policisë së Shtetit e agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, akademikë të institucioneve të tjera të arsimit të lartë publik e privat në vend, studiuës e ekspertë të çështjeve të sigurisë në vend dhe vende partnere, përfaqësues nga organizma ndërkombëtare partner të Policisë së Shtetit etj.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

Siguria publike arrihet me specialistë të shkolluar dhe inteligjentë

Dr. Bilbil MEMAJ

Drejtor i Akademisë së Sigurisë
bilbil.memaj@asp.gov.al

Abstrakt

Arsimimi fillestar, para fillimit të punës së një oficeri policie dhe ai i vazhdueshëm, gjatë shërbimit, duhet të vihet në dispozicion në të gjitha fushat e aktiviteteve të policisë, në intervale të rregullta dhe për të gjitha nivelet e policisë. Bazat e shkollim/trajnimeve duhet të jenë metodat më të mira si dhe modelet e përsosura të arrira deri tani në fushën e policisë, por të gjitha këto duhet të jenë në përputhje me parimet e policimit demokratik. Në një gjuhë më të thjeshtë, policia duhet të shkollohet dhe të trajnohet në një proces të padiskutueshëm normal shkollimi, në kolegji dhe në të gjitha nivelet e arsimit të lartë. Policimi në kohët që po jetojmë, nuk është më një zana që mund të mësohet me njohuri empirike shabllone, por është një profesion i komplikuar dhe shumë i domosdoshëm për shoqërinë. Policimi është profesion me rëndësi jetike dhe përcaktues i nivelit të vlerave në një shoqëri demokratike. Policimi kërkon shkollim, trajnime dhe specializime jo vetëm në zbatimin e ligjeve, etikës policore, kodet e sjelljes dhe standardeve për të drejtat e njeriut, por kërkon shkollim dhe specializim për t'i dhënë zgjidhje dilemave reale të policimit në shoqëri. I gjithë investimi i një shoqërie për të krijuar një polici nuk shkon kot nëse përgatisim oficerë policie, të përkushtuar që njohin mirë ligjet dhe procedurat, që zbatojnë parimet e policimit demokratik dhe që divizë në punën e tyre kanë zbatimin e ligjit dhe lirive e të drejtave themelore të njeriut.

AKADEMIA
E SIGURISË

Fjalëkyçe:

arsimim policor, profesion, kolegji, policim, oficer policie.

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

1. Hyrje

Arsimimi fillestar para fillimit të punës së një oficeri policie dhe ai i vazhdueshëm gjatë shërbimit duhet të vihet në dispozicion në të gjitha fushat e aktiviteteve të policisë në intervale të rregullta dhe për të gjitha nivelet e policisë. Bazat e shkollim/trajnimeve duhet të jenë metodat më të mira si dhe modelet e përsosura të arrira deri tani në fushën e policisë, por të gjitha këto duhet të jenë në përputhje me parimet e policimit demokratik. Në një gjuhë më të thjeshtë policia duhet të shkollohet dhe trajnohet në një proces të padiskutueshëm normal shkollimi në kolegji dhe në të gjitha nivelet e arsimit të lartë. Policimi në ditët e sotme nuk është më një zanat që mund të mësohet me njohuri empirike shabllone, por është një profesion i komplikuar dhe shumë i domosdoshëm për shoqërinë. Policimi është profesion me rëndësi jetike dhe përcaktues i nivelit të vlerave në një shoqëri demokratike. Policimi kërkon shkollim, trajnime dhe specializime jo vetëm në zbatimin e ligjeve, etikës policore, kodet e sjelljes dhe standardeve për të drejtat e njeriut, por kërkon shkollim dhe specializim për t'i dhënë zgjidhje dilemave reale të policimit në shoqëri. I gjithë investimi i një shoqërie, për të krijuar një polici nuk shkon kot nëse përgatisim oficerë policie, të përkushtuar që njohin mirë ligjet dhe procedurat, që zbatojnë parimet e policimit demokratik dhe që divizë në punën e tyre kanë zbatimin e të drejtave të njeriut.

2. Çfarë bën policia?

Vazhdimisht, qytetarë të ndryshëm, por dhe studiues që merren me probleme e çështje të policisë dhe policimit, më së shumti ngjarjeve që lidhen me rendin apo cenonjë sigurinë, shtrojnë pyetjen, se “Çfarë bën policia?”. Duke shprehur në këtë mënyrë, jo vetëm pakënaqësi lidhur me mënyrën se si e kryen ajo detyrën, por dhe faktin që kanë mangësi informacioni dhe njohurish mbi rolin dhe përgjegjësitë e policisë në shtetin demokratik çka do të thotë se, komuniteti kërkon më shumë informacion rreth policisë.

AKADEMIA
E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit »

Me qëllim që të sqarojmë pyetjen, por edhe të ndihmojmë në përgjigjen e saj duhet të biem dakord për nocionet, “polici” dhe “policim”. Në fjalorin e përditshëm këto nocione përdoren sikur të jenë sinonime, por në fakt nuk është kështu.

3. Ç’është Policia e Shtetit?

Nëse do i referohemi fjalorit kryesor shqip-shqip, “Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqip”, botimi i vitit ‘80, – natyrisht duke pasur parasysh edhe ndikimin ideologjik – kuptimi i fjalës “polici” përshkruhet kështu:

“Organ ekzekutiv e i armatosur i pushtetit popullor, që bën pjesë në forcat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe që ka për detyrë të mbrojë rendin juridik socialist, të parandalojë krimet, të mbrojë sigurinë e shtetasve, të zbulojë krimin dhe atë që e ka kryer etj.; tërësia e punonjësve të këtij organi; zyra a ndërtesa ku është vendosur ky organ. Policia popullore. Policia rrugore. Arma e policisë.”¹

Në fjalorin tonë nuk jepet (akoma edhe sot) një kuptim për fjalën “të policosh” ose “policim”, term tashmë i përdorur gjerësisht në organizatën tonë të policisë. Ndërkohë, kjo gjë shpjegohet në gjuhët e tjera dhe po sjell si rast shembulli, anglishtfolësit. Fjalori i Oksfordit, bën këtë shpjegim për “polici” dhe “policim”:

“- polici: emër [shumës] Forcë civile shtetërore, që mban përgjegjësi për parandalimin dhe zbulimin e krimit si dhe për ruajtjen e rendit publik.

- të policosh: folje (e një force policie), të pasurit detyrën e ruajtjes së ligjit dhe rendit në ose mbi (një ngjarje ose hapësirë). Shembull: Një plan me dhjetë pika për përmirësimin e të policuarit/policimin.”²

a) Në kuptimin gjuhësor, e thënë shkurtazi, fjala “polici” (në gr. “polis”, ang. “police”, ger. “polizei”, fr. “police”) e ka kuptimin e saj të lidhur me qeverisjen e qytetit/shtetit. Pikërisht këtë gjë, vuri në dukje edhe studiuesi aq i mirënjohur shqiptar, Moikom Zeqo, gjatë një takimi me studentët e Akademisë së Sigurisë, brezi i parë i studimeve “bachelor”. *“Policia është një organizatë, me një mision fisnik. Qysh nga prejardhja e emrit ajo qëndron mbi të tjerët, pasi ajo e ka prejardhjen që nga greqishtja e lashtë e latinishtja, ku ‘polis’ në greqisht është qyteti dhe ‘politia’ në latinisht është administrimi civil. Pra, efektivet e Policisë mendohen si ruajtës rendi, si ruajtës qytetërimi, ligji. Për këtë arsye ata janë parë gjithnjë si figura ideale të korrektësisë dhe intelektualisht të përgatitur. Për këto e të tjera, Policia është një aset kombëtar, një pasuri publike...”³*

b) Në kuptimin juridik, “policia” është institucion administrativ, person juridik... me objekt dhe mision të përcaktuar. Kjo ka ndodhur që në fillimet e saja, kur u kristalizua misioni.

“Deri në mesin e shek. 19-të, fjala “police” përdorej në Angli për “administrimin civil” ndërsa përdorimi për “administrim të rendit publik dhe i zbatimit të ligjit” (1716) vjen nga Franca. E para forcë, e quajtur me këtë emër në Angli, ishte “Marine Police” (Policia e Marinës) e krijuar në 1798, për të mbrojtur mallrat në portin e Londrës. Domethënia e saj si ‘një trupë oficerësh të besuar me detyrën e forcimit të ligjit, zbulimit

¹ Androkli Kostallari, Jani Thomaj, Xhevat Lloshi, Miço Samara, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (red.). *Fjalori i Gjuhës Së Sotme Shqipe (me rreth 41.000 fjalë)*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1980.

² Oxford Dictionary. “Definition of police in English”. *English Oxford living Dictionary*. Oxford: 2016. Gjendet në: <https://en.oxforddictionaries.com/definition/police>

³ Zeqo, Moikom. “Fjala përshëndetëse”, *Moikom Zeqo dhe Ksenofon Krisafi mes studentëve të Akademisë: Policia e Shtetit, krenaria jonë*. Zhvilluar më datë 24.11.2015. Gjendet në: <https://www.asp.gov.al/akademia/index.php/al/>

të krimit, etj.’, i përket vitit 1810.”⁴

c) Nga ana administrative “policia është një organizatë e strukturuar” dhe, ajo zbaton ose duhet të zbatojë të gjitha ligjet dhe rregullat e funksionimit të një organizate, sidomos ato që kanë të bëjnë me menaxhimin. Këtë gjë e dëshmon edhe konteksti historik i kësaj organizate.

“Fuqia policore është fuqia e një qeverie për të kufizuar liritë civile dhe për të ushtruar shtrëngim dhe detyrim mbi të drejtat private, veçanërisht për të çuar përpara progresin ose për të mbrojtur mirëqenien publike. Policia e shtetit, si “shtet me harmoni të rregulluar me anë të policisë kombëtare”, regjistrohet fillimisht në vitin 1865, duke marrë si referencë për rastin, Austrinë. Veprimi policor, në kuptimin ndërkombëtar të “ndërhyrjes ushtarake në mungesë lufte, me sebeb rregullimin e një situatë të mungesës së ligjit”, i përket vitit 1933; ndërsa “oficeri i policisë” e ka dëshminë si i tillë, që nga viti 1794 në anglishten amerikane dhe “stacioni i policisë” që nga viti 1817”.⁵

d) Në përmbajtje, policia është një shërbim i specializuar për komunitetin, ajo është dhe forcë ligj zbatuese, pjesë e pushtetit ekzekutiv e depolitizuar dhe e departizuar në shërbim të ligjeve të shtetit. Kur ne themi “policia” duhet të nënkuptojmë një trupë oficerë policie të organizuar, strukturuar, shkolluar, trajnuar dhe specializuar me hierarki drejtimi apo komandimi.

Policia e shtetit ka ndryshuar në të gjitha drejtimet si në strukturë dhe në funksionim si në formë ashtu edhe në përmbajtje, këto ndryshime kanë ndodhur në mënyrë të vazhdueshme ashtu si ka ndryshuar edhe shoqëria, pra në një farë mënyre policia i është përgjigjur këtyre ndryshimeve.

“Policia nuk është thjeshtë një aneks i shtetit, nuk është thjeshtë një organizëm me strukturë hierarkike me veprime të përcaktuara në kushtetutë, por policia është një element kulturologjik i vetë popullit, tregon nivelin kulturor, emancipimin dhe zhvillimin e tij”⁶

Në jetën e përditshme pothuajse në shumicën e vendeve të botës në mënyrë të vazhdueshme qytetarët thërrasin Policinë e Shtetit për shërbime të ndryshme, të cilat zënë një spektër të gjerë të problemeve jetësore si: krimi, kundërvajtje të ndryshme, shqetësime për rendin e qetësinë, çrregullime të ndryshme, emergjenca të llojeve të ndryshme, shqetësime nga kërcënime të ndryshme direkt dhe nëpërmjet mjeteve të komunikimit, mesazhe shqetësuese, raportime të çështjeve shqetësuese, etj. Efektivisht pra, Policia e Shtetit është në shërbim të qytetarëve për të zgjidhur problemet që ata kanë. Në përgjigje të nevojave të qytetarëve policia është ajo që duhet t’i japë zgjidhje problemeve; zgjidhja duhet të jetë ligjore dhe në përputhje me procedurat që janë miratuar bazuar në eksperiencën e punës së policisë. Prandaj, ky institucion ka ndryshuar sipas kërkesave që ka pasur shoqëria, duke ngritur në mënyrë të vazhdueshme nivelin e kulturës profesionale por edhe atë të përgjithshme. Oficeri i policisë sa vjen dhe bëhet personi garant ku mbështeten njerëzit për të zgjidhur shumë probleme, shpesh edhe ato probleme që nuk janë atribut ligjor i saj.

Këta oficerë përballen me parandalimin e krimit për të bërë të mundur, që të ketë sa më pak krime, sa më pak vrasje e vjedhje, për të mbajtur dhe vendosur rregull në

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

“ Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit ”

⁴ Harper, Douglas. *Online Etymology Dictionary*. [publikim elektronik]: Dan McCormack. Gjendet në: <http://www.etymonline.com/index.php?term=police>

⁵ Harper, Douglas. *Online Etymology Dictionary*. [publikim elektronik]: Dan McCormack. Gjendet në: <http://www.etymonline.com/index.php?term=police>

⁶ Zeqo, Mojkom. *Fjala përshëndetëse...*

raste kur ka veprimtari të organizuara me shumë qytetarë, për të zbuluar krimet kur ato ndodhin, për të rivendosur rendin kur ai prishet përkohësisht, për të ndërhyrë në të gjitha rastet kur shkelet ligji etj. Kjo është policia dhe në mënyrë të përmbledhur kjo është edhe një pjesë e rëndësishme e punës në shërbim të komunitetit. Me një rëndësi të madhe, por shpeshherë edhe e pakuptuar në misionin e saj; ashtu siç e vë në dukje edhe fituesi i pesë çmimeve në forumin e kërkimit shkencor mbi policimin, “Police Executive Research Forum (PERF)”, Herman Goldstein⁷:

“Cilësia e policimit ka një ndikim të drejtpërdrejtë mbi cilësinë e jetës në një demokraci. Tashmë, publiku amerikan vazhdon të injorojë kompleksitetin e policimit, rëndësinë e policisë dhe kërkesat që ne shtrojmë para tyre.”⁸

Për këtë “policimi” në disa vende është diskutuar dhe vazhdon të diskutohet, nëse ky shërbim, kjo strukturë, kjo lloj veprimtarie është specialitet apo një zanat si gjithë të tjerët?

4. Policimi si profesion

Nëse do të bënim një përmbledhje të punëve që kryen oficeri i policisë, në fusha si, mbajtja e rendit publik, parandalimi i krimeve, si dhe hetimi dhe zbulimi i tyre kërkohet që oficeri i policisë të ketë njohuritë e një specialisti në fushat përkatëse të punës së tij. Kur specialisti i policisë merret me shërbimin e rendit, atij i duhet ta ushtrojë këtë detyrë në të gjithë territorin e caktuar si juridiksion, në rrugë për mbikëqyrjen e qarkullimit apo edhe në kufi për kontrollin e zbatimit të rregullave etj. Ka raste, jo të rralla, që oficeri i policisë duhet të menaxhojë turma njerëzish në aktivitete sportive, politike, apo artistike edhe në këto raste atij i duhet të ketë dije dhe përgatitje të veçantë për të bërë detyrën. Kjo veprimtari e oficerit kërkon një nivel të lartë të kulturës së përgjithshme dhe po kështu një nivel akoma më të lartë të kulturës profesionale. Që të arrihen këto nivele duhet të përvetësohen disiplina të tëra shkencore të fushave të së drejtave apo dhe procedurave që duhen respektuar dhe që shprehin qëndrimin e shtetit ndaj individit, grupit nëse është i organizuar. Duhet të përvetësoj taktikat dhe teknikat e punës, pjesë e procedurave standarde të miratuara etj.

“Modelet e policimit të së ardhmes në shtetet e demokracive Perëndimore, parimet e tyre, kriteret e reja dhe objektivat e ardhshme të policisë, janë në transformim.... Hierarkisë policore i nevojitet të ndryshojë natyrën e vet të ngurtë dhe zbatimin i panevojshëm verbazi të rregullave. Ndarjet tradicionale të strukturave operacionale, të hetimit e të trafikut, duhet të ndryshojnë duke u përshtatur me elementë të rinj, si teknologjia dhe grupet psikologjike.”⁹

Nëse do të merrnim rastin e menaxhimit të tubimeve të mijëra njerëzve, që për arsye të ndryshme protestojnë, është detyra e drejtuesit të policisë që ta menaxhoj situatën. Në këtë moment përgjegjësia është e shumëfishtë. Oficeri që menaxhon, por edhe të tjerët që veprojnë duhet të njohin mirë procedurat, taktikat e ndërhyrjes, teoritë për menaxhimin e tyre, gjithashtu duhet të njohin mirë edhe psikologjinë e turmës¹⁰. Oficeri është përgjegjës për ruajtjen e qytetarëve por edhe për vetë pjesëmarrësit në manifestime.

⁷ 2001, Award for Excellence in Problem-Oriented Policing (POP). Herman Goldstein, Çmim ekselence.

⁸ Goldstein, Herman. *Policing a Free Society*. Cambridge, Mass: Ballinger Pub. Co., 1977, f. 5.

⁹ Alderson, John. *Policing freedom*. Plymouth: Macdonald and Evans, 1979, f. 170.

¹⁰ Zigmund Frojd “Psikologjia e turmave” botimi, shqip.

Në rastin e psikologjisë kolektive, kemi të bëjmë me një disiplinë shkencore (është mirë që të njihet nga çdo qytetar), e cila nuk mund të mësohet pa ditur mirë veçoritë dhe gjendjen psikike të njeriut, që është objekt i psikologjisë së përgjithshme.

Por në rastin e menaxhimit të kriminalitetit do të duhet të bëjnë hetime të cilat kërkojnë përgatitje shumë të lartë, të gjithanshme të oficerit që lidhen me njohuri: filozofike, juridike procedurale, psikologjike, logjike, kriminalistike, historike, demografike, nga e drejta zakonore, etj., etj. Të gjitha këto nuk mund të mësohen në një program trajnimi, por kërkojnë nivele të larta shkollimi, shkollim universitar.

Prej këtej natyrshëm lind pyetja se “ç’është policimi dhe çfarë e përbën thelbin e të policuarit?”.

Policimi është veprimtari, pjesëmarrje, bashkëpunim, bashkëveprim, i të gjithë aktorëve subjekteve të organizuar ose jo, që japin, ose ndikojnë në atë që ne e quajmë produkt të policimit “siguri publike”. Në mënyrë të përsëritur duhet thënë që policimi nuk është vetëm puna që lidhet me krimin dhe natyrisht nuk lidhet vetëm me policinë. Për oficerët e policisë, policimi është profesion i nivelit të lartë dhe kërkon shkollim dhe trajnim të vazhdueshëm gjatë gjithë karrierës policore. Marrja me krimin, me kriminalitetin është një nga pjesët e veprimtarisë kryesore, që bën policia si rutinë të punës së saj. Kjo përbën dhe punën e mirëfilltë të policisë, punën e specializuar të saj, krahas asaj të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike. Pikërisht kjo veprimtari e policisë në vite ka dëshmuar se nuk ka qenë e suksesshme pa bashkëpunuar me subjekte të tjerë të shoqërisë. Ndaj dhe termi “policim” është futur si një përmbledhje kuptimore, logjike e filozofisë apo e metodologjisë të së punuarit. Në rutinën e përditshme qytetarët i raportojnë krimet në polici, detyra e policisë është t’i vlerësojë, dokumentojë, analizojë e të përgjigjet sipas rastit dhe llojit të krimit të ndodhur.

Si përfundim mund të theksojmë se: *Kur ne themi “policimi” duhet të kuptojmë veprim, energji të harxhuar, punë të kryer nga të gjithë subjektet, ku përfshihet dhe policia, për të dhënë siguri publike.*

Në rastin e policisë veprimet e saj janë të kushtëzuara nga zbatimi i përpiktë i procedurave. Procedurat e policisë përbëjnë edhe ngarkesën më të madhe që duhet të dijë dhe zbatojë një oficer policie. Në rastin e një oficeri të nivelit të mesëm menaxherial këto procedura e kalojnë shifrën 2500 të tilla. Oficeri i policisë në çdo gjë që bën, që nga veshja dhe mbajtja e uniformës, armatimit personal apo atë që merr për shërbim dhe shumë veprime të tjera që zbatohen nga ai bëhen në bazë të një procedure të miratuar. Nisur nga të gjitha këto, por edhe të tjera argumente, është tashmë e padiskutueshme që policimi është profesion.

Emërtimi profesion shpesh i referohet një seti të aftësive të specializuara që janë të transferueshme përmes shkollimeve, trajnimit dhe eksperiencës. Duke nënkuptuar gjithashtu zhvillimin e standardeve objektive të punës të artikuluar përmes politikave dhe procedurave që përkufizojnë rezultatet e dëshiruara dhe atyre të detyrave, thekson dr. Bowman, i Departamentit të Policisë së Arlingtonit ¹¹.

Ndërkohë që, në rastin e zanatit kemi të bëjmë me marrjen e njohurive në rrugë empirike dhe praktike pa shpjeguar ligjësitë dhe “pse-në” e gjërave.

Një Oficeri policie i nevojiten t’i ketë të dyja, edhe zanatin edhe profesionin, sipas niveleve dhe detyrave që mbulon. Kur një oficer është i vijës së parë ai duhet të jetë i trajnuar më së miri për të kryer këtë detyrë, ndërsa kur ai fillon të menaxhojë oficerë të

¹¹ Bowman, Theron. “The Chief’s Perspective: Abolishing The Recruiting Myth”. *The Police Chief: The Professional Voice of Law Enforcement*, August 2006.

tjerë ai duhet të pajiset me dije, të cilat duhet të jenë të konsoliduara dhe të përfituara nga ndjekja e studimeve të nivelit “Bachelor”, me një program të miratuar nga MAS.

“Shtytja drejt profesionalizimit të policisë është një diskurs në zgjerim në shoqëritë Perëndimore. Profesionet, në krahasim me zejet, zanatet apo punësimet, kanë karakteristika të veçanta, disa prej të cilave e kanë larguar policimin dhe duhet të merret parasysh, në qoftë se policia mund apo jo t’ia arrijë këtij qëllimi. Karakteristikat e një profesioni përfshijnë një shoqatë profesionale, njohurinë bazë, trajnimin e institucionalizuar, licencimin, autonominë e punës, kontrollin e kolegut, kodin e etikës dhe të standardeve të larta të përsosmërisë profesionale dhe intelektuale. Më tej, profesionalizimi kërkon përjasjen e aspekteve të ndryshme të praktikës profesionale (Schneider, 2009). Arsimi i lartë dhe zhvillimi i një trangu dijesh disiplinare nëpërmjet kërkimit, janë komponentë të rëndësishme të tij. Ky studim shqyrton disa nga çështjet të cilat kanë penguar më parë policinë për adoptimin e një modeli të plotë profesional. Ai gjithashtu shqyrton rritjen e përfshirjes në sektorin universitar nga ana e profesionistëve të policisë, gjë e cila duket se tregon njëfarë ‘drite në fund të tunelit’ dhe lë vend për optimizëm në të ardhmen.”¹²

5. Policimi dhe nevoja për shkollë të lartë

Një shoqëri që të ketë prosperitet duhet të ketë të vendosur rendin, që do të thotë, se shteti me strukturën e policisë dhe me zbatim të ligjit garanton një veprimtari normale të njerëzve në shoqëri. Këtë punë e bën policia me oficerët e vetë në terren apo në zyra, me punë direkte me njerëzit apo me punën administrative zyrtare të caktuar si të tillë. *Veprimet e policisë janë manifestimi më i dallueshëm i autoritetit shtetëror, përmes kryerjes së detyrave më të dukshme, më të menjëhershme dhe më imponuese, për të siguruar mirëqenien si të individit, ashtu edhe të komunitetit.*

Detyrat parësore të policisë janë ruajtja e qetësisë publike, ligjit dhe rendit, mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të individit, veçanërisht të jetës, parandalimi dhe zbulimi i krimit, reduktimi i frikës dhe dhënia e ndihmës dhe shërbimeve për publikun. Oficerët janë ata që në praktikën e përditshme zbatojnë procedurat për ruajtjen e qetësisë.

Ndërtimi i një force pune policore komplekse përfshin mjaft punë dhe planifikim, si edhe nuk duhet kurrë të përfshijë standarde në ulje apo të pres më pak se kandidatet, sesa i kërkon vetë detyra e një oficeri policie. Gjithashtu, shërbimi policor profesional nuk mund t’i sigurohet një komuniteti pa oficerë policie, të cilët kanë njohuri në gjuhët dhe kulturat e tyre. Eksperiencat e klasave të strukturuara, krijojnë një vlerësim për ndryshimet, duke siguruar shanse për studentët që ata të jenë në gjendje të komunikojnë me njerëz nga të gjithë sferat e jetës. Oficerët nisin të kuptojnë konceptet e drejtësisë së komunitetit dhe dinjitetit të individëve, *vulë kjo që e vendos policimi profesional; të besojnë se kjo duhet fituar përmes respektit. Standardi i edukimit katër-vjeçar dërgon një mesazh të forte ndaj personave në komunitete me etni minoritare, shumica e të cilëve janë studentë të kolegjit të brezit të parë, në mënyrë që punonjësit të cilët kërkojnë një diplomë gjithashtu t’ia njohin vlerën kësaj diplome.*¹³

Me këtë argument, por edhe me mendimin e kolegëve me shumë eksperiencë të cituar

¹² Green, Tracey dhe Alison Gates. “Understanding the Process of Professionalisation in the Police Organisation”. *The Police Journal* June 1, 2014, 87: 75-91.

¹³ Bowman, *The Chief’s Perspective...*

në këtë punim shumica e drejtuesve të policisë kanë një qasje afërsisht të njëjtë dhe shkollim e trajnim të vazhdueshëm për arsytet që cituam më lartë. “Vollmer [“babai i policisë amerikane”] kundërshtoi kolegët që ofronin një orientim me shkollim zanati për policinë.”¹⁴

Përgjithësisht oficerët e policisë duhet të rekrutohen në shkollimin fillestar bazikë dhe nëse vlerësohen pozitivisht ata punësohen si oficerë të patrullës së përgjithshme. Në vazhdim, nëse ata kërkojnë të bëhen menaxherë të oficerëve në terren, ata duhet të shkollohen dhe të pajisen me diplomën “bachelor”, ndërsa për tu bërë drejtues i nivelit të lartë të drejtimit oficeri i policisë duhet të këtë përfunduar nivelin “master” në një nga fushat e sigurisë publike. Nisur nga kjo platformë arsimimi, ne i japim përgjigje deri në një nivel të kënaqshëm përgatitjes së oficerëve të policisë si atyre në terren, ashtu edhe për oficerët e të gjitha niveleve të menaxhimit policor. Problemi është te ndryshimi në peshën specifike që kanë disiplina të caktuara në programet e të gjitha niveleve për këtë po i referohemi një studimi të bërë nga kolegët tanë në Slloveni.

Për sa i përket përmbajtjes, programet e edukimit profesional të lartë policor mund të ndahen gjerësisht në tre grupe:

1. Programe që dominohen nga ligjet.

2. Programe që kanë theks mbi lëndët e lidhura me policinë, ligjin, kriminalistikën dhe kriminologjinë, ndërsa në të njëjtën kohë kanë mungesë apo lënë jashtë programit lëndë të administrimit dhe menaxhimit policor.

3. Programe që kanë një përzjerje balancuese të së gjitha lëndëve. Bazuar në studimet e sipërcituara nga kolegët sllovenë, shkollat në shtatë vende evropiane janë bazuar tek ky program. Studentët e diplomuar në këto shkolla, pas diplomimit nisin punën si oficerë policie, pa trajnime shtesë.¹⁵

Kjo ndarje e ngarkesës brenda, përbënë një diskutim tjetër të specialistëve të kurikulave për të bërë edhe këtu një përjasje për ato lëndë apo grup lëndë që mund të jenë të unifikuara. Në eksperiencën tonë, ne do ta rreshtonim veten në pikën e tretë të studimit të kolegëve. Pasi modulet në Kolegjin Policor dhe lëndët në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, janë në balancë. Ne mund të veçojmë grupimin e lëndëve të fakultetit, si: Formimi juridik dhe i përgjithshëm, ku sasia e orëve është afërsisht 50% e programit të Fakultetit Juridik UT dhe gjysma tjetër është formim profesional e i përgjithshëm.

Për të gjitha çfarë theksuam më lartë, në drejtim të ndryshimeve që po bëhen në arsimimin policorë mund të nënvizojmë: a) Arsimimi i lartë po merr përherë e më shumë rëndësi në profesionin e policimit. b) Përballja me natyrën shumëdimensionale dhe të sofistikuar të krimit, kërkon një qasje bashkëpunuese mes arsimimit me trajnimet profesionale dhe kërkimin shkencor për tu gjetur përgjigje inovative problemeve komplekse. c) Në kushtet e sotme, policisë i nevojiten analiza të qëndrueshme dhe metodologji vlerësimi kërcënimesh për të planifikuar përgjigjen e përshtatshme policore.

“Sfida e edukimit policor është përmirësimi i arsimimit akademik me një proces trajnimi profesional të vazhdueshëm të përshtatshëm për përgatitjen e profesionistëve për një shërbim policor dinamik dhe të adoptueshëm me ambientin në ndryshim.” Thekson Cavanagh (1993).¹⁶

¹⁴ Shernock, Stanley K. “The effects of college education on professional attitudes among police.” *Journal of Criminal Justice Education* 3.1, 1992, 71-92.

¹⁵ Pagon, Milan, et al. “European systems of police education and training”. *Policing in Central And Eastern Europe: Comparing Firsthand Knowledge with Experience from the West*. Ljubljana, Slovenia: College of Police and Security Studies, 1996.

¹⁶ Cavanagh, SH. “Connecting education and practice”. L. Curry, J Wergin & Associates (red.), *Educating professionals responding to new expectations for competence and accountability*, Jossey Publishers, San Francisco, pp. 180–212.

Siç edhe dihet arsimimi i lartë në përgjithësi dhe ai policorë në veçanti bazohet në tre parime themelore që e dallojnë atë nga format e trajnimit që janë:

Mendimi kritik (vlerësime analitike, diagnostikuese, opinione, arsytim logjikë e racional) lipset të jetë themeli i zhvillimit të policisë. Ky është shembulli më i mirë, që vjen edhe prej shoqërive më të përparuara demokratike.

“Për më tepër, edukimi dhe trajnimi i oficerëve të policisë, duhet të bazohet në të mësuarin eksperimental, të orientuar drejt zgjidhjeve të problemeve dhe duhet vënë theksi te mendimi kritik dhe vlerat e qëllimet e shoqërisë demokratike.”¹⁷

Natyrisht, që shembujt e marrë nga Perëndimi janë të shumtë dhe mbështeten në dekada¹⁸ të tëra kërkimi për gjetjen e korrelacionit mes edukimit dhe performancës profesionale policore.¹⁹

Analiza (investigim dhe interpretim), është një tjetër benefit që vjen nga përmirësimi i edukimit. Marrja e formateve të duhura nëpërmjet arsimimit për kryerjen e analizës, përmirëson rezultatet e analizës profesionale dhe të performancës në detyrë. Mund të prek shkarazi vetëm çështjen e autoritarizmit. Një profesor psikologjie dhe dy doktorë për shkencat juridike, në vitin 1970 vërtetuan nëpërmjet një studimi të tyre mbi autoritarizmin, se efektivët e policisë së Nju Jorkut, kishin dallim mes tyre: kur ata kishin kryer një kolegji dhe ishin oficerë policie, kundrejt atyre që nuk e kishin kryer një të tillë dhe, thjesht kryenin detyrën e policit. Oficerët e diplomuar ishin më pak autoritarë dhe kishin prirje të mira sociale; gjë që nuk e kishin ata të padiplomuarit.”²⁰

Natyrisht që autoritarizmi e bllokton frymën e lirë të mendimit kritik dhe ky shembull demonstroi dhe një herë rëndësinë e arsimimit.

Kërkimi shkencor (investigimi sistematik për të radhitur fakte apo grumbulluar informacion në lidhje me një subjekt, analizë dhe ekzaminim i tyre) mund të radhitet si një ndër elementët kryesorë për zhvillimin e një force policore me nivele të larta. Nuk është aspak çudi (edhe pse ka raste kur në vendin tonë shihet me dyshim kjo gjë!) që në radhët e policisë të ketë emra të spikatur të kërkimit shkencor, të pajisur këta me grada e tituj shkencorë. Ky duhet të jetë një objektiv i pandryshueshëm nëse do të duam të zhvillohemi. Kjo gjë, është bërë dhe bëhet në mënyrë konstante në vende me demokraci e polici të zhvilluar.²¹

Kombinimi i arsimimit me trajnimet e vazhdueshme profesionale janë dy shtyllat e një zhvillimi profesional të qëndrueshëm. Shpesh ka pasur konfuzion mes programeve të arsimimit dhe atyre të trajnimit në dëm të njëra tjetrës. Padyshim që këto dy elementë janë të lidhur simbiotikisht dhe nuk zëvendësojnë por komplimentojnë njëri tjetrin.

¹⁷ Marenin, Otwin. "Police Training for Democracy 1." *Police practice and Research* 5.2 (2004): 107-123.

¹⁸ Feldman, K. A., dhe T. H. Newcomb. "1969 The Impact of College on Students. Vol. 1: An Analysis of Four Decades of Research."

¹⁹ Higgins, J. M. & Michals, J. (1994). "The effects of education level on performance among campus police officers". *Paper presented at the annual Graduate Conference in I/O Psychology and Organizational Behavior, Chicago, IL.* ("Efektet e nivelit të edukimit mbi performancën e oficerëve të policisë me universitet." Studim i prezantuar në Konferencën vjetore për Psikologjinë dhe Sjelljen Organizative, Çikago.)

²⁰ Smith, A. B., Locke, B., & Fenstger, A. "Authoritarianism in policemen who are college graduates and non-college police". *Journal of Criminal Law Criminology, and Police Science*, 61, 1970, f. 313-315.

²¹ Champion, D. H. (1994). A study of the relationship between critical thinking levels and job performance of police officers in a medium size police department in North Carolina. Unpublished doctoral dissertation, North Carolina State University.

Ky është një studim i cili synon të japë pikërisht këtë objekt diskutimi që po prekim: lidhjen mes mendimit kritik dhe performancës në punë të oficerëve të policisë. Ky kërkim, është një disertacion doktorature i mbrojtur në Universitetin Shtetëror të Karolinës.

6. Përfundime dhe rekomandime

- Policimi është pjesa kryesore e punës së policisë dhe realizohet me oficerë të shkolluar dhe të përkushtuar ku arsimit i lartë është i padiskutueshëm për nivelet e menaxhim-drejtimit të së gjitha niveleve të policisë.

- Oficerët e policisë të diplomuar në Kolegj të shkollohen në nivelet e tjera të arsimit policior për të drejtuar policinë.

- Fakulteti i Sigurisë Publike dhe Hetimit t'i japë zgjidhje problematikës; rritjes së kapaciteteve të oficerëve të hetimit si çelësi për përmirësimin e hetimit në përgjithësi dhe përgatitjes së procedurave për gjykim në veçanti.

- Trajnimi dhe specializimi i policisë duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i pa ndërprerë jo vetëm në Akademinë e Sigurisë, por edhe në terren atje ku policët punojnë.

- Policia e ka detyrim të bashkëpunoj me strukturat e tjera për të bërë të mundur arritjen e qëllimit të policimit kjo është mënyra e vetme për të garantuar suksesin

- Duhet të bëhet më shumë punë për të fituar besimin në komunitet dhe kjo bëhet me oficerë të shkolluar dhe me nivel të lartë kulturor. Policia duhet të ketë nivelin kulturor një shkallë më të lartë se mesatarja e popullsisë.

Referenca

1. Androkli Kostallari, Jani Thomaj, Xhevat Lloshi, Miço Samara, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (red.). *Fjalor i Gjuhës Së Sotme Shqipe (me rreth 41.000 fjalë)*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1980.
2. Oxford Dictionary. "Definition of police in English". *English Oxford living Dictionary*. Oxford: 2016. Gjendet në: <https://en.oxforddictionaries.com/definition/police>
3. Zeqo, Moikom. "Fjala përshëndetëse", *Moikom Zeqo dhe Ksenofon Krisafi mes studentëve të Akademisë: Policia e Shtetit, krenaria jonë*. Zhvilluar më datë 24.11.2015. Gjendet në: <https://www.asp.gov.al/akademia/index.php/al/>
4. Harper, Douglas. *Online Etymology Dictionary*. [publikim elektronik]: Dan McCormack. Gjendet në: <http://www.etymonline.com/index.php?term=polic>
5. 2001, Award for Excellence in Problem-Oriented Policing (POP). Herman Goldstein, Çmim ekselence.
6. Goldstein, Herman. *Policing a Free Society*. Cambridge, Mass: Ballinger Pub. Co., 1977.
7. Alderson, John. *Policing freedom*. Plymouth: Macdonald and Evans, 1979.
8. Frojd, Zigmund. *Psikologjia e turmave*. Tiranë: Fan Noli, 2004.
9. Bowman, Theron. "The Chief's Perspective: Abolishing The Recruiting Myth". *The Police Chief: The Professional Voice of Law Enforcement*, August 2006.
10. Green, Tracey dhe Alison Gates. "Understanding the Process of Professionalisation in the Police Organisation". *The Police Journal June 1, 2014, 87: 75-91*.
11. Shernock, Stanley K. "The effects of college education on professional attitudes among police." *Journal of Criminal Justice Education* 3.1, 1992, 71-92.
12. Pagon, Milan, et al. "European systems of police education and training". *Policing in Central And Eastern Europe: Comparing Firstrand Knowledge with Experience from the West*. Ljubljana, Slovenia: College of Police and Security Studies, 1996.
13. Cavanagh, SH. "Connecting education and practice". L. Curry, J Wergin & Associates (red.), *Educating professionals responding to new expectations for competence and accountability*, Jossey Publishers, San Francisco, pp. 180-212.
14. Marenin, Otwin. "Police Training for Democracy 1." *Police practice and Research* 5.2 (2004): 107-123.
15. Feldman, K. A., dhe T. H. Newcomb. "1969 The Impact of College on Students. Vol. 1: An Analysis of Four Decades of Research."
16. Higgins, J. M. & Michals, J. (1994). "The effects of education level on performance among campus police officers". *Paper presented at the annual Graduate Conference in I/O Psychology and Organizational Behavior, Chicago, IL*. ("Efektet e nivelit të edukimit mbi performancën e oficerëve të policisë me universitet." Studim i prezantuar në Konferencën vjetore për Psikologjinë dhe Sjelljen Organizative, Çikago.)
17. Smith, A. B., Locke, B., & Fenstger, A. "Authoritarianism in policemen who are college graduates and non-college police". *Journal of Criminal Law Criminology, and Police Science*, 61, 1970.
18. Champion, D. H. (1994). A study of the relationship between critical thinking levels and job performance of police officers in a medium size police department in North Carolina. Unpublished doctoral dissertation, North Carolina State University.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

Sesioni I / First Section

~ Ballkani Perëndimor ~

Kërcënimet dhe rreziqet ndaj sigurisë publike
dhe sfidat e përballjes me to

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

The importance of education of economy as contribution to public safety

Assist. Prof. Snezana MOJSOSKA

Faculty of Security, Skopje
smojsoska@gmail.com

Assist. Prof. Nikola DUJOVSKI

Faculty of Security, Skopje
ndujovski@gmail.com

Abstract

Në kundërshtim me përshtypjet e dhëna nga SKKD-ja, tregtia afgane e drogës përbën një pjesë të një fenomeni më të madh dhe më të ndërlikuar, që shtrihet nga një labirint kanalesh trafikimi, i fshehtë në dukje, drejt rrugëve të Londrës dhe vendeve të tjera të BE-së. Në terma monetare, ky rrytë ndërkombëtar i tregtisë së drogës është llogaritur që kap një vlerë më shumë se 26 miliardë \$USD, dhe duke pasur parasysh që fermerët afganë marrin më pak se 10% të tij (Taylor 2006, fq. 2), ekzistojnë arsye për të vënë në pikëpyetje nëse SKKD-ja mund të gjykohej si e mjaftueshme, pa qenë pjesë e një strategjie me të gjerë dhe të integruar plotësisht me BE-në dhe shtetet e tjera (Europol 2007). Për të testuar këtë hipotezë është e rëndësishme që të vlerësohet jo vetëm politika e ndjekur nga qeveria afgane, por edhe ajo e shteteve të BE-së që përbëjnë një element të rëndësishëm të tregtisë, për sa i përket financimit, organizimit dhe kërkesës për drogë. Sikurse e ka vënë shumë hidhur në dukje Starr (2006, fq. 23) problemi i drogës afgane është një problem i BE-së, dhe ai argumenton që shtetet e BE-së kanë dështuar në shkallë të gjerë që të marrin përgjegjësitë e tyre. Është e qartë që Evropa merr 80 – 90% të heroinës nga Afganistani dhe përfitimet prej shumë miliardë eurosh nga rrugët e Evropës, rrisin kërkesën për opium afgan (Taylor 2006, fq. 2). Prandaj shtetet e BE-së, duhet të vendosen në një pozicion më të fuqishëm për

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

të luftuar pikat e dobëta të zinxhirit të furnizimit.

Edhe pse BE-ja në këtë kohë nuk ndoqi të njëjtën strategji “luftë ndaj drogave” si administrata e Bushit (Star 2006), për më shumë se disa vite është orvatur që të gjenerojë një përgjigje të unifikuar ndaj karakteristikave të krimit të organizuar ndërkombëtar, sidomos tregtisë së drogës (EU 2006). Një gjë e tillë përfshin një mori masash të zbatimit të ligjit, ku përfshihet bashkëpunimi policor dhe doganor (Deflem 2006), ndarja e informacionit kriminal të përpunuar me anë të Europolit sipas strategjisë për krimin e organizuar (EU 1999), firmosjen e Konventës së OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (EU 2003) dhe, krijimin e Forumit Evropian mbi Parandalimin e Krimit të Organizuar (EU 2005). Megjithatë, nuk është e qartë nëse këto përpjekje janë përkthyer në pengues efektivë; sidoqoftë ato duken si të pamjaftueshme për të balancuar mundësitë e krijuara për krimin e organizuar nga vizioni i Shengenit për një Evropë pa kufij (Lebor 2004). Qarkullimi i lirë i një automjeti nga kufiri kroat/serb në Kalas pa u ndaluar nga policia ose dogana, ka tendencën që të shumëzojë më zero impaktin e shumë prej marrëveshjeve dhe konventave. Ndoshta, mund t’iu jepet më shumë meritë, përpjekjeve të BE-së në lidhje me pastrimin e parave, një fushë ku duken qartë pikat e dobëta të “zinxhirit të furnizimit” dhe që përbën një nga komponentët e rëndësishëm të tregtisë afgane të heroinës. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve për t’iu kërkuar shteteve anëtare që të integrojnë një sërë masash kundër pastrimit të parave në ligjet e tyre kombëtare, një raport i kohëve të fundit, bën një panoramë të mjerueshme të rritjes në vazhdimësi të krimit ekonomik (EU 2002).

Strategjia e tanishme e Mbretërisë së Bashkuar për luftën kundër drogës, bazohet në modelin e “zinxhirit të furnizimit” dhe ka si qëllim që të ulë furnizimin nga jashtë, duke ndjekur penalisht importuesit dhe tregtarët, si edhe të promovojë një sërë masash parandaluese dhe proaktive, ku përfshihen edukimi, trajtimi, rehabilitimi, përmirësimi i zbatimit të ligjit për ulur kërkesën në vend (Home Office 2007). Megjithatë, një raport i kohëve të fundit në media, vë në dukje një studim të një njësie strategjike të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, mbi rritjen e drogave të paligjshme, që tregon një dështim alarmant të strategjisë së qeverisë (Travis, 2005). Çdo vit 749 persona vdesin si rezultat i abuzimit me heroinën dhe metadonin dhe rreth 280,000 përdorues kokaine dhe heroine krijojnë një barrë financiare prej 24 miliardë £ për sistemin shëndetësor dhe për krimet e kryera për të vazhduar varësinë ndaj këtij vesi. Për më tepër, edhe pse me anë të masave për zbatimin e ligjit kapet rreth 20% e drogës, përpjekjet janë shumë poshtë objektivit 60-80%, që nevojitet për të pasur një ndikim serioz në fluksin e drogave në Mbretërinë e Bashkuar. Masat për liberalizimin e përdorimit të drogave të kategorisë A, si heroina dhe, lejimi i personave që kanë krijuar varësi që të marrin droga të nivelit farmaceutik nën monitorim mjekësor, do të ishin efektive për të reduktuar pushtetin e krimit të organizuar (Osborn, 2002). Masa të tilla për kanabisin zbatohen në Holandë dhe qeveria e Mbretërisë së Bashkuar që nga viti 2003, e ka ulur nivelin (në kategorinë C) e kësaj droge popullore (BBC, 2003). Edhe pse alternativa e liberalizimit të heroinës për të shfrytëzuar tregun e madh e të paligjshëm duket më tërheqëse duke pasur parasysh dështimin dukshëm të thellë të Strategjisë së vjetër të Ministrisë së Brendshme, gjasat për pasoja të rënda shoqërore me përmasa të mëdha përhapjeje i bëjnë politikanët që të hezitojnë.

Si përfundim, teoria e “zinxhirit të furnizimit”, ndihmon për të diagnostikuar forcat

e parezistueshme të tregut, që drejtojnë fenomenin ndërkombëtar tejet fitimprurës të heroinës, e cila furnizohet nga fermerët e varfër afganë. Gjithashtu, ajo ndihmon për të identifikuar pikat e dobëta në këtë tregti globale, ku për momentin, demokracitë liberale të BE-së po hezitojnë ose e kanë të pamundur të veprojnë, pavarësisht politikave të zotuar. Për më tepër, modeli vë në dukje zgjidhje – qofshin ato, për liberalizimin e përdorimit të drogave të paligjshme dhe prodhimin e tyre të ligjshëm në Afganistan ose, metoda më intrusive, për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e këtyre aktiviteteve – që këto demokraci, nuk janë të gatshme ose nuk mund t’i venë në zbatim. Është e diskutueshme nëse këto vështirësi që hasen me politikën e shteteve të industrializuara që krijojnë pjesën më të madhe të kërkesës, trafikantëve dhe financat e nevojshme për tregtinë e drogës, vënë në dukje nevojën për një model më të sofistikuar sesa modeli i “zinxhirit të furnizimit” ose “sipërmarrjes” së Smithit. Ky i fundit merr për të mirëqenë një shoqëri homogjene, koherente dhe të stabilizuar, me një konsensus me bazë të gjerë mbi etikën e abuzimit më drogat dhe me atë çfarë konsiderohet “sipërmarrje e paligjshme”. Megjithatë, fenomeni që lidh sjelljen e fermerëve të varfër afganë, trafikantëve oportunistë dhe britanikëve që kanë fituar varësi, është dinamik dhe përfshin një konflikt vlerash dhe idealesh etike. Ai sugjeron nevojën për një model dialektik, duke vënë në dukje konfliktin midis vlerave të demokracive liberale, pikave të dobëta të shteteve të varfra, brishtësisë së qenieve njerëzore dhe lakmisë së vazhdueshme të tyre.

Referenca

1. ACPO (1985). *ACPO Crime Committee Report of the working party on drugs related crime*. [Electronic version]. Marrë në 23.11.2007 nga: <http://www.the-shipman-inquiry.org.uk/gencat.asp?p=2&ID=408>.
2. Anand, B. (2004). *Replacing Narco-usurers With Micro-lenders, The Agricultural Finance Component of Opium Substitution Programs in Afghanistan* [Electronic Version]. Marrë në 11.12.2007 nga: <http://fletcher.tufts.edu/research/2004/Anand-Bhuvana.pdf>.
3. Applebaum, A. (2007). *How to solve Afghanistan's drug problem*. [Electronic version]. Marrë në 12.11.2017 nga: <http://www.slate.com/id/2157644/>.
4. BBC News (November 13, 2003). *Cannabis changes agreed by Lords*. BBC News Online. [Electronic version]. Marrë në 30.11.2007 nga: http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk_news/politics/3266177.stm.
5. Clemons, S.C. (2007). *The US's Afghan Opium Strategy: Eradicating Any Chance of Stability*. [Electronic version]. Marrë në 11.12.2007 nga: <http://www.thewashingtonnote.com/archives/002304.php>.
6. Chossudovsky, M. (2006). *Who benefits from the Afghan Opium Trade?*, Global Research. [Electronic version]. Marrë në 13.12.2007 nga: <http://www.globalresearch.ca/index.php?context=viewArticle&code=CH020060921&articleId=3294>.
7. Deflem, M. (2006). *Europol and the Policing of International Terrorism: Counter-Terrorism in a Global Perspective*, Justice Quarterly 23(3):336-359. [Electronic version]. Marrë në 18.12. 2007 nga: <http://www.cas.sc.edu/soc/faculty/deflem/zeuroterror.htm>.
8. EU (1999). *The Prevention And Control Of Organised Crime: A European Union Strategy For The Beginning Of The New Millennium*. Official Journal of the European Communities. [Electronic version]. Marrë në 18.12.2007 nga: http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/oj/2000/c_124/c_12420000503en00010033.pdf.
9. EU (2002). *Europe's fight against economic and transnational organized crime progress or retreat?* Parliamentary Assembly Recommendation 1507 (2001). [Electronic version]. Marrë në 18.12.2007 nga: <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=CM/Notes/808/10.6&Language=lanEnglish&Site=COE&BackColorInternet=9999CC&BackColorIntranet=&BackColorLogged=FDC864>.
10. EU (2003). *EC ratification of UN Convention against Transnational Organized Crime*, European Union @ United Nations. [Electronic version]. Marrë në 17.12. 2007 nga: http://www.europa-eu-un.org/articles/en/article_2668_en.htm.
11. EU (2005). *A common EU approach to the fight against organised transnational crime*. Europa.

[Electronic version].

Marrë në 19.12.2007 nga:

http://ec.europa.eu/justice_home/fsj/crime/fsj_crime_intro_en.htm.

12. EU (2006). *The EU's Shared Responsibility In Drugs – Efforts at Home and Abroad*, Presentation by the European Commission - Dialogue on Shared Responsibility and the Global Problem of Illicit Drugs. [Electronic version].
Marrë në 17.12.2007 nga: http://ec.europa.eu/external_relations/drugs/docs/shared_resp_021106.pdf.
13. Home Office (2007). *Drug Strategy*. [Electronic version].
Marrë në 10.12.2007 nga: <http://drugs.homeoffice.gov.uk/drug-strategy/>.
14. Interpol (2007). *Heroin*. Drugs Sub-Directorate. [Electronic version].
Marrë në 3.12.2007 nga: <http://www.interpol.int/public/Drugs/heroin/default.asp>.
15. IRIN (March 5, 2007) *AFGHANISTAN: Fighting a losing battle against opium production*. [Electronic version].
Marrë në 14.12.2007 nga: <http://www.irinnews.org/Report.aspx?ReportId=70511>.
16. Lebor, A. (February 23, 2004). *Road dash highlights leaky Euro borders*. Times Online. [Electronic version].
Marrë në 2.12.2007 nga: <http://www.timesonline.co.uk/tol/news/world/article1027070.ece>.
17. Leithead, A. (August 27, 2007), *Afghanistan opium at record high*. BBC News Online/South Asia. [Electronic version].
Marrë në 13.12.2007 nga: http://news.bbc.co.uk/2/low/south_asia/6965115.stm.
18. Mansfield, D. (2006). *Exploring the 'Shades of Grey': An Assessment of the Factors Influencing Decisions to Cultivate Opium Poppy in 2005/2006*. UK Government, Afghan Drugs Inter Departmental Unit. [Electronic version]. Marrë në 9.12.2007 nga: [www.fco.gov.uk/Files/kfile/FinalFinal2005DriversDocumentdm%20\(2\).pdf](http://www.fco.gov.uk/Files/kfile/FinalFinal2005DriversDocumentdm%20(2).pdf).
19. NDCS (2006), *Five-Year Strategy for Tackling the Illicit Drug Problem*. [Electronic version].
Marrë në 17.12.2007 nga:
<http://www.fco.gov.uk/Files/kfile/NDCSfinal%20Jan%202006,0.pdf>.
20. Osborn, A (March 14, 2002). *Dutch back free heroin for addicts*. Guardian Unlimited. [Electronic version].
Marrë në 22.12.2007 nga:
<http://www.guardian.co.uk/drugs/Story/0,2763,666802,00.html>.
21. Senlis (2006). *Afghanistan Five Years Later – The Return of the Taliban*. The Senlis Council. [Electronic version]. Marrë në 10.12.2007 nga: www.senliscouncil.net/modules/publications/O14_publication.
22. Silverstone, D. (2007). *Transnational Organised Crime and Drugs Control* (Institute of Criminal Justice Studies Distance Learning). Portsmouth: University of Portsmouth.
23. Sinha, S. (2006). *Afghanistan's Anti-Narcotics Strategy*. Global Policy Forum, Institute of Peace and Conflict Studies. [Electronic version].
Marrë në 9.12.2007 nga:
www.globalpolicy.org/security/issues/afghan/2006/0829narcoticsstrategy.htm.
25. Smith, D.C. (1975). *The Mafia Mystique*. New York: Basic Books.
26. Smith, D.C. (1994). "Illicit Enterprise: An Organized Crime Paradigm for the Nineties," In Kelly, R.J., Chin, K., and Schatzberg, R., (Eds.), *Handbook of Organized Crime in the United States* (pp. 121 - 150). Westport, CT: Greenwood Press.
27. Spiegel (March 27, 2007). *NATO to Legalize Afghanistan's Opium?* Spiegel Online International. Marrë në 14.12.2007 nga: <http://www.spiegel.de/international/world/0,1518,473933,00.html>.
28. Starr, F.S. (2004). *US Afghanistan Policy: It's Working*. Central Asia-Caucasus Institute [Electronic version].
Marrë në 23.11.2007 nga: www.sais-jhu.edu/pubaffairs/PDF/Afghan_Starr_2004_Total.pdf.
29. Taylor, L. (2006). *The Nexus of Terrorism and Drug Trafficking in the Golden Crescent: Afghanistan*. Strategy Research Project. [Electronic version]. Marrë në 3.12.2007, nga:
www.strategicstudiesinstitute.army.mil/pdffiles/ksii514.pdf.
30. Transnational Institute (December 2006). *Losing Ground. Drug Control and War in Afghanistan*. [Electronic version]. Marrë në 12.12.2007 nga:
www.tni.org/reports/drugs/debate15.pdf.
31. Travis, A. (July 5, 2005). *Revealed: how drugs war failed*. Guardian Unlimited. [Electronic version].
Marrë në 12.12.2007 nga: <http://www.guardian.co.uk/drugs/Story/0,,1521501,00.html>.
32. UK Parliament (2006). *Memorandum from the Senlis Council*. [Electronic version].
Marrë në 30.11.2007 nga: www.publications.parliament.uk/pa/cm200506/cmselect/cmdfence/558/558e06.htm.
33. UNIS (November 26, 2004). *United Nations Office on Drugs and Crime Assists Afghanistan in Drafting Laws against Crime and Terrorism*. [Electronic version].
Marrë në 17.12.2007 nga: <http://www.unis.unvienna.org/unis/pressrels/2004/unisnar870.html>.
34. UNODC (2005). *Afghanistan Drug Use Survey 2005*. United Nations Office on Drugs and Crime. [Electronic version]. Marrë në 17.10.2007 nga: http://www.unodc.org/afg/drug_use.html.
35. UNODC (2006). *Afghanistan's Drug Industry: Structure, Functioning, Dynamics and Implications for Counter-Narcotics Policy*. [Electronic version].
Marrë në 3.12.2007 nga:
http://www.unodc.org/pdf/afg/publications/afghanistan_drug_industry.pdf.

36. UNODC (2007). *Afghanistan Opium Survey 2007*. United Nations Office on Drugs and Crime. [Electronic version]. Marrë në 12.12. 2007 nga: http://www.unodc.org/pdf/research/AFG07_ExSum_ëeb.pdf.
37. UNODC (2007b). *Fact Sheet on Drugs and Crime*. United Nations Assistance Mission to Afghanistan (UNAMA). [Electronic version]. Marrë në 13.12. 2007 nga: www.unodc.org/afg/en/fact_sheet.html.
38. Von Lampe, K. (2006). *The Interdisciplinary Dimensions of the Study of Organized Crime*. [Electronic version]. Marrë në 13.12.2007 nga: <http://www.organized-crime.de/kvllnterdiscDimStudyOC-TOC-9-3-2006.pdf>.
39. Walsh, D. (August 28, 2007). *UN horrified by surge in opium trade in Helmand*. Guardian Unlimited. [Electronic version]. Marrë në 11.12. 2007 nga: <http://www.guardian.co.uk/afghanistan/story/0,,2157313,00.html>.

Edukimi modern, si antidot i pazëvendësueshëm në përballjen me ekstremizmin e dhunshëm

Dr. Sandër LLESHI

Kryeministria e Republikës së Shqipërisë
Këshilltar i Kryeministrit për Sigurinë
sander.lleshi@kryeministria.al

Abstrakt

Ekstremizmi i dhunshëm, që të arrijë në pikën finale të tij, në atë të veprimit, kalon nëpër një spirale përshkallëzuese të transformimit individual. Shtyllat kryesore të individit, transformohen, duke sjellë edhe një ndryshim rrënjësor të botëkuptimit mbi të mirën e të keqen dhe ç'është më kryesorja, duke transformuar perceptimin mbi identitetin kombëtar e atë personal. Terrorizmi ka si objekt kryesor shndërrimin dhe zëvendësimin me mënyra radikale të gjithçkaje që njerëzimi ka rritur gjatë zhvillimit të tij historik, me një rend të ri të njëtrajtshëm, i cili funksionon vetëm në bazë të një ideje e që duhet të ndiqet nga kushdo pa u diskutuar. Për të arritur këtë gjë, atij i lipset që të zhveshë individin nga tiparet më të rëndësishme të identitetit e t'i heqë atij atributet kombëtare duke e shndërruar atë në një bashkësinë joidentitare, por të përgjithshme. Shpeshherë sulmet ndaj identiteti kombëtar kanë pas tyre shtysa të tilla, që kamuflohen si kërkesa moderne e liberale që evokojnë njëfarë ndarje nga idhujt e së shkuarës, etj. Në qendër të goditjeve qëndron trashëgimia shpirtërore e kulturore e një kombi. Përvoja shqiptare e dekadave të fundit jep shembuj të qartë për këtë gjë. "Rishikimi" i traditave shekullore fetare, minimi i pandalshëm i gjuhës shqipe e shumë dukuri të tjera, janë tipare të qarta të një presioni të ri ekstremist, që synon cenimin dhe zhdukjen e identitetit kombëtar si një ndër parakushtet që mundësojnë lindjen e terroristëve, të cilët, ndër të tjera, janë qenie pa identitet. Në Shqipëri, në kuadër të "Strategjisë kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm", ka filluar procesi i diskutimit për përfshirjen e çështjeve të harmonisë fetare në kurrikulat e shkollave të vendit. Kjo gjë është mbështetur padyshim edhe në përvojën më të mirë të vendeve të zhvilluara, e cila tregon se mjedisi i shkollës është krejt i natyrshëm dhe aleat pozitiv në trajtimin e çështjeve të radikalizmit dhe të ekstremizmit. Projekti i qeverisë shqiptare synon që të plotësojë një vakum të madh të krijuar në hapësirën e edukimit nga hezitimi i gjatë i sistemit tonë arsimor për t'u ballafaquar me shfaqjet e radikalizmit, ekstremizmit apo të intolerancës në kuadër të vetë shkollës. Ky artikull, synon të shtjellojë tiparet kryesore të këtij procesi, duke sjellë argumentin se vetëm arsimimi mund t'i paraprijë këtij erozioni gërryes që shpie drejt ekstremizmit.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

Fjalëkyçe:

harmonia fetare, ekstremizmi i dhunshëm, arsimim, indoktrinim fetar, identitet, terrorizëm.

1. Vlerat themelore dhe identiteti, si argumente me rëndësi në përballjen me ekstremizmin

Arsimi dhe edukimi i shëndoshë i bazuar në vlera të larta, konsiderohet pa asnjë dyshim si rruga më e sigurt për përparimin e përgjithshëm të çdo shoqërie. Dallimi në nivelin e zhvillimit të vendeve e popujve të ndryshëm, është para së gjithash dallimi i sistemeve të tyre arsimore. Në fund të fundit, edukimi dhe arsimimi bëjnë diferencën. Shkolla është institucioni që, ndër shumë detyra të tjera, ka për mision edhe të prodhojë lëndën bazë të kohezionit shoqëror, nëpërmjet edukimit të rinisë me vlerat themelore individuale, shoqërore dhe kombëtare. Shkolla është vendi ku ngjizen tipare të rëndësishme identitare. Në një botë që globalizohet me një ritëm eksponencial shumë të lartë, mendja njerëzore e ka të vështirë që të perceptojë në kohën e duhur dhe të reagojë në mënyrën e përshtatshme ndaj ndryshimit. Ndërlidhja dhe komunikimi i jashtëzakonshëm, lëvizshmëria, fluksi masiv i informacionit dhe shumë dukuri të tjera që lidhen me globalizimin, paraqesin një sfidë serioze edhe për identitetin e individit. Njeriu që lëviz shumë, që shpëputet nga shumë rrjete përkatësie tradicionale si, vendlindja, rrethi familjar apo shoqëror; njeriu që ballafaqohet pa pushim me informacion të ri, me ide të reja, me gjuhë të huaja, me doktrina apo pikëpamje të ndryshme, me mundësi, oferta apo sfida të tjera, përballet edhe me kriza të rëndësishme identitare. Por, nëse globalizimi tenton të rrafshojë shumë aspekte identitare, duke zgjeruar gamën e tipareve të përbashkëta të individëve të ndryshëm (p.sh.: përditë e më tepër shtohet numri i atyre që flasin anglisht), totalitarizmi, diktaturat, rrjetet apo organizatat terroriste, tentojnë të shuajnë çdo individualitet në shërbim të nevojës për të ndërtuar masa kompakte kolektive. Në njëfarë kuptimi,

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit »

identiteti është një lloj përkufizimi që gjithkush i bën vetes. Ndërkohë, dihet se përkufizimi i çdo termi, pra edhe përkufizimi i identitetit, bazohet në dy rregulla. Së pari, përfshirja e termit në një kategori më të gjerë, p.sh., në rastin e një individi, ai identifikohet (përkufizohet), si shqiptar apo amerikan, si mysliman apo si ateist, si artist apo si sportist, etj.. Në një hap të dytë bëhet veçimi individual nga bashkësia e madhe, përmes cilësimeve të tjera si, toskë apo teksanas, bektashi apo sunit, poet apo atlet, etj.. Të gjitha këto veçime, synojnë të vizatojnë tiparet individuale që e dallojnë individin nga bashkësia përkatëse e tij.

Përpjekja për identitet paraqet një dilemë të ndërlikuar njerëzore, e cila bart dy vektorë që shkojnë në kahe të ndryshme. Nga njëra anë shquhet prirja për t'u përfshirë në një bashkësi, por nga ana tjetër edhe nevoja për t'u shquar brenda saj përmes tipareve individuale. Shoqëritë e lira dhe demokratike krijojnë hapësira të mëdha për shpalosjen e identiteteve të ndryshme, duke krijuar kështu kushte që njerëzit, të mund të krijojnë dhe të zhvillojnë profilet e tyre, si nëpërmjet zgjedhjes së lirë të përkatësive kolektive, ashtu edhe nëpërmjet zgjerimit të diapazonit të individualitetit personal. Angazhimi i lirë politik dhe shoqëror, anëtarësimi në grupime të ndryshme politike, kulturore apo të interesit, shkollimi, profilizimi dhe shumë mundësi të tjera i hapin udhë individit të shpalosë veçoritë personale, duke e bashkuar kështu në grupime më të mëdha, por edhe duke e individualizuar njëkohësisht prej tyre.

Nga ana tjetër, shoqëritë totalitare karakterizohen nga një theksim i fortë i identitetit kolektiv në dëm të atij individual, i cili konsiderohet si një shqetësim për të parin. Aparatet totalitare si shkolla, media apo institucione të tjera angazhohen në mënyrë sistematike për të krijuar një identitet të ri të përbashkët, për të krijuar në njëfarë mënyre “njeriun e ri”, i cili mund të jetë komunist, fashist, xhihadist, etj., por jo një individ i mbështetur në trashëgimi tradicionale. Shoqëritë totalitare kanë një konflikt të pashmangshëm me individin e lirë, ose me personin me identitet të qartë. Në shumë aspekte, thirrjet e propagandës së pashembullt të Daesh, i vetëquajtur ndryshe si Shteti Islamik, kanë shumë ngjashmëri me argumentet kryesore të ideologjive të tjera totalitare si fashizmi apo komunizmi. Të gjitha këto ideologji kanë nevojë për një njeri të ri, të ndryshëm nga modelet e mëparshme, të gjitha ato kanë një armik qartësisht të identifikuar (përgjithësisht të personifikuar nga SHBA), të gjitha ato kanë një ofertë ideale të lumturisë, e cila praktikisht është e paarritshme. Ajo mund të arrihet vetëm në kushte hipotetike: një superracë njerëzore tek nazistët, barazia absolute njerëzore tek komunistët apo vdekja tek xhihadistët. Në një numër të vitit 2016, të revistës famëkeqe “Dabiq”, që botohet nga Daesh, krahas lumit monstroz të një propagande antinjerëzore, shprehet shqetësimi i terrorizmit për rolin e edukimit në shkollat Perëndimore, të cilat përçojnë tek fëmijët vlera dhe mesazhe krejt të kundërta nga ato për të cilat kanë nevojë terroristët.

“Fëmijët që shkojnë në shkollat e të pafeve njihen së pari me konceptin e nacionalizmit, ku u kërkohet të ngrihen në këmbë për himnin kombëtar dhe, në vende të tilla si Amerika, të premtojnë besnikëri për disa simbole kombëtare si flamuri, të recitojnë slogane kombëtare apo të premtojnë besnikëri tek udhëheqës të pafe... Pas shkatërrimit fillestar të besimit dhe dedikimit të tyre, shkollat e të pafeve u mësojnë fëmijëve konceptin e pabazë të ‘tolerancës’ në një moshë të re. Ata u mësojnë atyre të tolerojnë dhe të respektojnë fetë e tjetra...”¹.

¹ Dabiq, Issue 12, viti 2016 (1437), f. 34.

Është e qartë nevoja e terrorizmit të sotëm për t'i shkëputur njerëzit nga lidhja me atdheun dhe me vlera të tjera kombëtare. Kjo shkëputje është e ngjashme me shkëputjen nga qendra e gravitetit të një sistemi, që rezulton me endjen pa kah dhe kuptim nëpër hapësirë. Atdheu, familja dhe konstante të tjera indentitare përbëjnë pikërisht qendrat e gravitetit shpirtëror që e bëjnë një funksionale një shoqëri. Në thirrjen kundër identitetit kombëtar duket se ideologjitë e sotme terroriste nuk ndryshojnë shumë nga idetë komuniste të shpallura në shekullin e 19-të janë të shumta.

“Punëtorët nuk kanë atdhe. .² Në vend që t'i riformulojë të vërtetat e përjetshme, komunizmi i zhdok ato, ai e zhdok fenë dhe moralin, ai i kundërshton gjithashtu të gjitha zhvillimet historike të deritanishme”³.

Përputhshmëria e madhe mes komunizmit dhe terrorizmit lidhet më qëllimin e përbashkët për të zëvendësuar, nëpërmjet një përmbyse radikale, gjithçka që njerëzimi ka rritur gjatë zhvillimit të tij historik me një rend të ri të njëtrajtshëm, i cili funksionon vetëm në bazë të një ideje që duhet të ndiqet pa diskutim nga kushdo. Në përpjekje për të zhveshur individin nga tipare të rëndësishme indentitare, terrorizmi kërkon t'i heqë atributet kombëtare për ta shndërruar atë në një zero, në bashkësinë e ëndërruar të Umah. Jo vetëm në pamflete ekstreme politike, si ato që shpërndan Daesh, por edhe në qasje më të stërholluara radikale apo ekstremiste, tiparet themelore të identitetit kombëtar duket se përbëjnë një objektivi të përhershëm sulmi. Shpeshherë këto sulme kamuflohen si kërkesa moderne dhe liberale që evokojnë njëfarë ndarje nga idhujt e së shkuarës, që relativizojnë rëndësinë e ngjarjeve apo personazheve të rëndësishëm historikë, që luajnë me domethënie të trashëgimisë shpirtërore e kulturore, që “ngatërrojnë” përherë e më shumë gjuhën kombëtare etj.. Edhe përvoja shqiptare e dekadave të fundit jep shembuj të qartë të përpjekjeve relativizuese kundër identitetit kombëtar. Rikthimi i Skënderbeut dhe i figurave emblematike të identitetit kombëtar në tryezën e “analizave kritike”, vërshimi i sponsorizuar i ritmeve dhe dallgëve të huaja e të panjohura muzikore, “rishikimi” i traditave shekullore fetare, minimi i pandalshëm i gjuhës shqipe e shumë dukuri të tjera, janë tipare të qarta të një presioni të ri ekstremist, që synon të bëjë në heshtje, pikërisht atë që Daesh e ëndërron hapur edhe në paragrafin e cituar më lart: cenimin dhe zhdukjen e identitetit kombëtar si një ndër parakushtet që mundësojnë lindjen e terroristëve, të cilët, ndër të tjera, janë genie pa identitet.

“S’do të kalonte shumë kohë dhe, pas Kastriotit, do të hidhej hija e keqe për periudhën më të ndritur të historisë shqiptare, rilindjen Kombëtare, atë ishte njohur si bijë e drejtpërdrejtë e iluminizmit evropian. E pas saj, mbi gjithçka të shpallur si vlerë morale e kulturore e kombit: mbi gjuhën shqipe, mbi zanafillën ilire të saj dhe të gjithë shqiptarëve, mbi themeluesin e shtetit shqiptar më 1912, gjer mbi Nënë Terezën, që gjatë ceremonisë së çmimit “Nobel” në Oslo, kishte treguar moselegancën të zinte ngoje zanafillën e vet shqiptare.”⁴

Por aq sa shqetësohet nga identiteti i spikatur kombëtar, terrorizmi i druhet dhe vlerave demokratike dhe humane. Në citimin e mësipërm të Dabiq, duket qartë se për terrorizmin toleranca fetare është një e keqe e madhe dhe, shkolla që e mëkon atë është një problem më vete. Njohja dhe respekti për fenë e tjetrit përbën një tabu, të cilës ekstremistët dhe terroristët i tremben shumë. Ashtu si çdo dituri apo njohje, edhe njohja

² Marx, Karl dhe Friedrich Engels. *Manifest der Kommunistischen Partei*. London: 1848, f. 14.

³ Ibidem, f. 15.

⁴ Kadare, Ismail. *Mosmarrëveshja*. Tiranë: Onufri, 2010, f. 76.

e fesë së tjetrit përbën një urë të rëndësishme për komunikimin dhe reflektimin ndër njerëzor, prej nga rezulton mirëkuptimi dhe harmonia, të cilave u tremben ekstremistët dhe terroristët.

2. Roli i shkollës, në kuadër të Strategjisë Kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm

Paradoksalisht edukimi ka potencialin e dyfishtë: edukimin e shëndoshë kundër ekstremizmit, por edhe indoktrinimin e dëmshëm së të rinjve. Praktika botërore jep mjaft shembuj për rolin pozitiv apo edhe negativ të shkollës në çështjet e ekstremizmit. Për arsye të këtij potenciali të dyfishtë, shkolla është një objektivi i rëndësishëm si për institucionet e shtetit dhe të shoqërisë të cilat synojnë edukimin ashtu dhe për rrjetet dhe organizatat ekstremiste, që synojnë indoktrinimin dhe rekrutimin. Në vitin 2015 u miratua “Strategjia kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm”.⁵ Ky dokument i rëndësishëm, i hartuar për herë të parë në Shqipëri, mëton të japë disa përgjigje për një ndër sfidat më të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria jonë, e cila nuk është e imunizuar prej valëve të ekstremizmit dhe terrorizmit që ka prekur botën prej disa dekadash. Gjatë periudhës 2012-2014, organet e sigurisë kombëtare në Shqipëri, evidentuan raste qytetarësh shqiptarë të cilët u përfshin në konfliktin luftarak në Siri, në përmasa që ishin shqetësuese. Gjatë kësaj periudhe, vlerësohet se kanë udhëtuar drejt Sirisë rreth 140 qytetarë shqiptarë, ku përfshihet edhe një numër i konsiderueshëm familjarësh, grash dhe fëmijësh. Rreth 20 qytetarë të Shqipërisë kanë humbur jetën në konfliktin në Siri. Në të njëjtën kohë, disa qytetarë të tjerë në Shqipëri janë gjykuar për akuzën e “*rekrutimit të personave me qëllim kryerjen e veprimeve terroriste*”, “*nxitjes, thirrjes publike dhe propagandës për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste*”, “*nxitjes së urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve*” të parashikuara nga neni 231, 232/a dhe 265 të Kodit Penal. Në vitin 2016 gjykata shpalli fajtorë nëntë persona dhe i dënoi me nga 7 deri në 18 vjet, që përbëjnë gjithsej 126 vite burg. Sukseset e arritura nga Shqipëria në përballimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe të terrorizmit janë krejt të veçanta. Në fjalën e tij në një konferencë kushtuar ekstremizmit të dhunshëm, terrorizmit dhe migracionit të paligjshëm, Ambasadori i SHBA-së në Tiranë, Donald Lu, u shpreh se:

“Shqipëria ka ulur gjithashtu lëvizjen e luftëtarëve terroristë nga territori i saj, nga mbi 90 persona në vitin 2013 dhe 2014 në zero gjatë dy viteve të fundit, sipas Institutit Shqiptar për Studime Ndërkombëtare. Kjo është një arritje e jashtëzakonshme, e pakrahasueshme me asnjë vend tjetër në Ballkanin Perëndimor.”⁶

Me gjithë masat e suksesshme të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse, përsëri mbeten shumë pyetje të hapura, më e rëndësishmja prej të cilave është: “Cilët ishin faktorët që shtrynë një numër të konsiderueshëm qytetarësh shqiptarë për të ndërmarrë një aventurë shumë të rrezikshme për një kauzë në dukje të pakuptueshme?”. Është fakt se në konfliktin në Siri kanë dhënë jetën një numër më i madh qytetarësh nga

⁵ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 930, date 18.11.2015 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe planit të veprimit”.

⁶ Lu, Donald. *Luftëtarët e huaj terroristë dhe rrugët e migrimit të kundërligjshëm, - fjala e ambasadorit*. Tiranë: Ambasada Amerikane, 14 shtator 2016.

Parë për herë të fundit në dt. 18. 10. 2016, në:

<https://albanian.tirana.usembassy.gov/al/news/fjalimet-e-ambasadorit/fjala-e-ambasadorit-donald-lu-ne-aktivitetin-luftetaret-e-huaj-terroriste-dhe-rruget-e-migrimit-te-kundraligjshem-14-shtator-2016.html>

Shqipëria se sa në luftën për çlirimin e Kosovës. Ky fakt është një befasi e trishtë për të gjithë, për politikën, për institucionet, për studiuesit, për shkollën dhe për shoqërinë në tërësi. Në thelbin e tij, fenomeni është rezultat i një përpjekjeje konstante dhe intensive radikalizuese dhe ekstremizuese, gjatë periudhës që pasoi rënien e komunizmit në Shqipëri, si dhe i dështimit të politikës, institucioneve dhe shoqërisë për ta identifikuar dhe parandaluar në kohë atë. Shoqëria jonë postkomuniste, e përfshirë në euforinë e epokës së re, u hap krejt e papërgatitur ndaj botës, duke rrezikuar rëndë që, përveç përfitimeve të padiskutueshme, të prekej edhe nga efekte të tjera anësore. Duke analizuar Shqipërinë postkomuniste, Tomas L. Friedman shkruan:

“Vendi më i varfër, që unë kam parë ndër kleptokracitë e tregut të lirë, ka qenë Shqipëria e viteve ‘90-të. Shqipëria ka qenë një nga vendet më të izoluar për pesëdhjetë vjet, që kishte adaptuar një qëndrim maoist pro kinez gjatë Luftës së Ftohtë. Duke pasuar rënien e Murit të Berlinit, regjimi komunist në Shqipëri u përmbys në vitin 1991... Më në fund, shqiptarët menduan se po merrnin gjithçka që të tjerët kishin: “hardware” nga tregu i lirë. Fatkeqësisht kjo ishte e gjitha që ata morën. Shqipëria u mbush me “hardware”, por pa “software” dhe pa sistem operimi.”⁷

Dhe këtu duket se mund të kërkohet përgjigjja për befasinë e sotme. Paaftësia për t’u orientuar drejt, në epokën e lirisë solli pasojën e rëndë që shoqëria jonë të përqendrohej vetëm në aspekte të jetës materiale, duke e lënë edukimin e brezit të ri në një proces rënie të lirë, pasojat e të cilit duken sot.

“Epoka e re pasonte periudhën komuniste, gjatë së cilës ishin bërë përpjeke për ta zgjidhur ndryshe problemin. Asokohe, pra gjatë izolimit komunist, ishte besuar se përmes propagandës (një lloj “software”-i i kohës) të mund të zgjidheshin problemet e panumërta të shoqërisë. Koha provoi se të dyja përjasjet ishin joefektive. Ishte dashur si “hardware”-i modern ashtu dhe “software”-i i përshtatshëm. Edhe mungesa e vetëm njëjës prej këtyre dy përbërësve kishte mjaftuar për të sjellë kolapsin. As socializmi i kuptuar si një dehje ideologjike (“software”) dhe as kapitalizmi i kuptuar si një ngopje materiale (“hardware”) duket se nuk kishin qenë zgjidhje të përshtatshme”⁸

Për një periudhë të gjatë shoqëria jonë, e përfshirë në një makth mbijetese për shumicën, apo në ethet e një pasurimi ekstrem për një kategori tjetër, ka neglizhuar rëndë edukimin e brezit të ri. Vakuumin e rrezikshëm të krijuar nga mosveprimi i institucioneve e kanë shfrytëzuar pa hezitim grupe apo rrjete të ndryshme, ndër të cilat rrjetet ekstremiste kanë arritur të korrin sukseset e para. Për shumë vite shkollat u transferuan në periferi të vëmendjes institucionale dhe shoqërore, mësuesit ranë në fund të hierarkive sociale dhe kurrikulat pësuan fatin e pronave publike “të zëna” nga çdokush. Infiltrimi i një morie informacioni të pa verifikuar nëpër kurrikula, vijimi i metodave të vjetra të mësimdhënies dhe, për më tepër, hezitimi dhe paaftësia e shkollës për t’u marrë më tematikat më të rëndësishme të shoqërisë, krijoi një hapësirë ideale për grupet dhe rrjetet e ndryshme, përfshirë ato ekstremiste dhe terroriste, por jo vetëm, për të ndërhyrë dhe manipuluar rrezikshëm mendjet e fëmijëve dhe të rinjve.

Një numër i madh fëmijësh dhe të rinjsh u tërhoqën në programe edukimi në institucione dhe vende të ekspozuara si nxitëse apo përkrahëse të ekstremizmit dhe të terrorizmit. Disa prej tyre u kthyen në Shqipëri krejtësisht të indoktrinuar, të motivuar dhe të mbështetur për të sfiduar traditat më të mira të harmonisë dhe të bashkëjetesës,

⁷ Friedman, Thomas L. *The Lexus and the Olive Tree, Understanding Globalization*. NewYork: Farrar, Strausand Giroux, 2000, f. 150.

⁸ Lleshi, Sandër. *Udhëheqja ushtarake, globalizmi dhe rasti i Shqipërisë*. Tiranë: Onufri, 2015, f. 40.

të cilat janë një ndër karakteristikat historike të shqiptarëve. Rifutja në diskutim e çështjeve të mbyllura të historisë, të kulturës, të trashëgimisë shpirtërore e kulturore dhe, mbi të gjitha, atyre të identitetit, krijuan mundësi për të shpërndarë mjedisin shoqëror valë të rrezikshme “virale”, ndaj të cilave shoqëria ishte dhe ende mbetet “e pavaksinuar”.

3. Të menduarit kritik si parakusht për tu përballur me indoktrinimin

Një ndër masat më të rëndësishme të parashikuara në “Strategjinë kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm” është “*nxitja e mendimit kritik, pjesëmarrjes civile dhe inkurajimi i vlerave të tolerancës përmes arsimit*”. Strategjia ka identifikuar drejt njërin prej problemeve themelore të sistemit tonë arsimor, i cili ende e shfaq tiparin e tij instruktiv dhe udhëzues, të trashëguar nga shkolla e vjetër. Edukimi i qytetarëve të lirë është i lidhur ngushtë me nxitjen dhe zhvillimin e mendimit kritik. Qytetarët mund të bëhen të lirë, kur ata mësojnë të mendojnë dhe veprojnë sipas gjykimit të tyre dhe roli i shkollës në këtë mes është parësor. Inkurajimi i mendimit kritik dhe refuzimi i shablloneve dogmatike mbetet prioritet i rëndësishëm i shkollës sonë, e cila ka shumë për të ndryshuar nga traditat e saj.

“Metoda tradicionale e arsimimit stimulon krijimin e tipave sociale pasivë, të bindur, por jo bashkëpunues, të urtë por jo luajalë, të zellshëm por jo produktivë, ankues por jo kritikë, zbatues por jo krijues etj.. Duke synuar t’u mësojë studentëve jo ‘çfarë të mendojnë, por si të mendojnë’ koncepti⁹ nuk e bazon suksesin tek ngarkesa e madhe, shpesh herë e panevojshme. Lodhja e studentit nuk konsiderohet si qëllim. Suksesi i studentëve matet jo vetëm me aftësinë për të mbajtur mend a për të “përvetësuar”, por me aftësinë për të studiuar në mënyrë të pavarur e kritike si dhe për të gjetur zgjidhje origjinale. Studentët konsiderohen jo si subjekte që thjesht kanë nevojë vetëm të dëgjojnë, të shikojnë dhe më tej të përsërisin. Sistemi kërkon prej tyre, imagjinatë, krijimtari, përfshirje aktive, zgjidhje jashtë skemave dhe shablloneve.”¹⁰

Nevoja që shkolla të edukojë qytetarë të lirë dhe jo shtetas të zellshëm është e lidhur ngushtë me filozofinë bazë që ajo duhet të ndjekë. Në mes traditës së dominuar nga një pedagogjia instruktive dhe imponuese, shkolla jonë duhet të krijojë përherë e më tepër hapësirë për lirinë e mendimit, krijimtarinë dhe frymën kritike. Që në vitin 1784, iluministi i njohur Immanuel Kant shkruante: “Iluminizmi është dalja e njeriut nga gjendja e foshnjërisë, për të cilën ai vetë është fajtor. Foshnjëria është paaftësia e njeriut për të përdorur mendjen e vet pa drejtimin e një tjetri. Vetë njeriu është fajtor për këtë foshnjëri, kur shkak i saj nuk është mungesa e mendjes, por mungesa e vendosmërisë dhe e guximit për ta përdorur atë pa drejtimin e një tjetri. Përtacia dhe frika janë arsyet se përse një pjesë kaq e madhe e njerëzve, edhe pasi natyra prej kohësh i ka çliruar prej komandimit të jashtëm, mbeten megjithatë në një stad fëmijërie për kënaqësinë e tyre; dhe përse disa të tjerë e kanë aq të lehtë që të bëhen tutorë për të parët. Është shumë komode të jesh fëmijë: E kam një libër i cili ka mendje edhe për mua; e kam një klerik i cili ka ndërgjegje edhe për mua, e kam një mjek, i cili gjykon për dietën time, etj., kështu që unë nuk kam nevojë të përpiqem vetë.”¹¹

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

⁸ Friedman, Thomas L. *The Lexus and the Olive Tree, Understanding Globalization*. NewYork: Farrar, Strausand Giroux, 2000, f. 150.

⁹ Lleshi, Sandër. *Udhëheqja ushtarake, globalizmi dhe rasti i Shqipërisë*. Tiranë: Onufri, 2015, f. 40.

¹⁰ Lleshi, *Udhëheqja ushtarake*, f. 250.

¹¹ Kant, Immanuel. “Beantwortung der Frage: Was ist Aufklärung?”. *Berlinische Monatsschrift, Dezember*. Heft 1784, f. 481.

Edhe sot ky konstatim duket plotësisht aktual, madje edhe më i prekshëm. Të nxitur nga oferta e madhe dhe kompleksiteti përherë në rritje, edhe sot, shumë njerëz nuk guxojnë të shkëputen nga niveli i fëmijës. Shumë gjëra mund të gjenden të gatshme, mbijetesa në rutinë është përherë e më e mundur, ndërkohë që dalja prej saj përherë e më me rrezik. Nga ana tjetër, shumë të tjerë mbushin vakuumin dhe nxitojnë të ofrojnë zgjidhje, të luajnë më foshnjërinë e të parëve, të manipulojnë frikën, pra të komandojnë. Mentaliteti i nënshtruar, pafuqia për të gjykuar në mënyrë kritike, mungesa e dijenive apo konsumi pasiv i informacioneve të shpërndara në rrjetet sociale, i bën shumë të rinj prë të lehtë të propagandës ekstremiste. Në një shkallë të konsiderueshme edhe ekstremizmi, radikalizmi apo terrorizmi janë vepër e dështakëve, e përtacëve, e frikacakëve dhe e tutorëve të tyre. Ata që nuk kanë forcën dhe guximin për të drejtuar veten, preferojnë të komandohen nga jashtë për të përfunduar kështu në vegla të verbra të interesave të së tjerëve. Varfëria e aspiratave, banalizimi i kuptimit për lumturinë personale dhe shoqërore apo iluzionet për rrugë të shkurtra drejt mirëqenies i rrisin shumë premiset që të rinj të papërgatitur të pranojnë pa koment oferta të dëmshme. Duke folur për rëndësinë kapitale që ka konceptimi i drejtë i lumturisë njerëzore, Kant shkruante: *“Askush nuk mund të më detyrojë mua që të jem i lumtur sipas mënyrës së tij, dhe kushdo ka të drejtë ta kërkojë lumturinë e tij në mënyrën që ai mendon si më të mirën për vete, me kusht që kjo të mos cenojë të drejtën e të tjerëve për të kërkuar lumturinë sipas të njëjtit parim.”*¹²

Problemi i sotëm është se, bota është e mbushur me “instruktorë të lumturisë”, të cilët janë shtete, organizata, individë, etj., ndërkohë që edhe numri i klientëve dembelë e frikacakë që presin receta të gatshme dhe çudibërëse, gjithashtu po rritet. Ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizmi janë tipikisht receta lumturie për frikacakë e dembelë, të cilët në pamundësi të mposhtin frustrimin e tyre dhe të kërkojnë lumturi në mënyrën e tyre, i nënshtrohen ofertave të gatshme për një lumturi të shpejtë, të cilën si rregull mund ta shijojnë vetëm pas vdekjes së tyre dhe të së tjerëve. Përballimi i ekstremizmit të dhunshëm kërkon mobilizimin e shumë aktorëve të shoqërisë dhe të shtetit. Me gjithë rëndësinë e padiskutueshme të çdonjërit prej tyre, roli i shkollës mbetet i dorës së parë, pasi është ajo që ndeshjen e bën në nivelin e ideve, pikërisht aty ku ekstremizmi e kërkon suksesin afatgjatë. Por, shkollës i duhet të çlirohet vetë nga modeli vjetër i transferimit të diturisë nga mësuesi tek nxënësi, që Freire (1970)¹³ e quan një sistem banke me mësuesin në qendër, në modelin e të mësuarit si një proces i ndërtimit të diturisë nga nxënësi, ku ky i fundit është në qendër. Po ashtu, shpallja e të mësuarit si një proces që zhvillohet gjatë gjithë jetës është një kusht i rëndësishëm për plotësimin e misionit të një shkolle moderne.

4. Nevoja për përfshirjen e çështjeve të harmonisë fetare në kurrikulat shkollore

Në kuadër të “Strategjisë kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm”, ka filluar procesi i diskutimit për përfshirjen e çështjeve të harmonisë fetare në kurrikulat e shkollave të vendit. Përvoja më e mirë botërore, tregon se shkollat janë një aktor i

¹² Kant, Immanuel. *Werke in zwölf Bänden. Her aus gegeben von Wilhelm Weischedel.* Frankfurt am Main: Suhrkamp, 1977, f. 143.

¹³ Freire, P. *Pedagogy of the Oppressed.* NewYork: Herder and Herder, 1970.

natyrshëm për t'u marrë me çështjet e radikalizmit dhe të ekstremizmit. Injorimi i diferencave kulturore, etnike apo fetare nga sistemet arsimore në emër të barazisë shpesh herë mund të krijojë padrejtësi dhe pabarazi, duke larguar dhe izoluar ata që nuk ndihen të adresuar nga sistemi.¹⁴

Janë këto, arsytet që i kanë shtyrë shumë vende drejt rishikimit të koncepteve rreth laicitetit, duke i hapur shkollat edhe për çështje që lidhen me ekstremizmin. Kështu p.sh., me interes është përvoja franceze, e nxitur nga niveli shqetësues i ekstremizmit dhe terrorizmit me të cilin është përballur ky vend, kampion i laicizmit dhe i vlerave liberale. Deri në vitin 2015 sistemi francez nuk njihte diferencat etnike, kulturore apo fetare ndërmjet njerëzve, referuar parimit 'të gjithë të barabartë përpara ligjit'. Ky hezitim për të parë një realitet përtej 'barazisë' solli një situatë të tillë ku institucionet nuk mbanin as të dhëna rreth çështjeve që dallojnë grupime të caktuara të shoqërisë. Pas sulmeve të janarit 2015 kundër redaksisë së Charlie Hebdo, Kryeministri francez, Valls, e shihte më në fund praninë e një "aparteidi territorial, social dhe etnik" në vendin e tij, duke artikuluar kështu qartë dhe fort një realitet që prej shumë kohësh institucionet franceze kishin dështuar ta shihnin.¹⁵

Ishin sulmet e nëntorit 2015, gjatë të cilave u vranë 130 njerëz që e shtynë qeverinë franceze për të vënë në dyshim mënyrën e zbatimit në praktikë të parimit të *laïcité* dhe, për të menduar rreth reformave në sistemin arsimor me synim mësimin e shekullarizimit dhe të vlerave civile për rininë franceze.¹⁶ Në shkurt 2015, Ministria franceze e Arsimit shpalli programin "*Grande Mobilisation de l'École pour les valeurs de la République*" i cili synon përfshirjen thelbësore të shkollës në forcimin e kohezionit social përmes përhapjes së vlerave shekullare dhe republikane.

Programe të mirëfillta për edukimin shekullar dhe të vlerave themelore të tolerancës e të bashkëjetesës etnike, fetare e kulturore, janë zhvilluar në shumë shtete të Europës dhe të mbarë botës. Britania e Madhe, e ka bërë gjithashtu, edukimin kundër ekstremizmit të dhunshëm, pjesë të sistemit formal të arsimit. Strategjia britanike kundër ekstremizmit të dhunshëm synon që shkollat të shndërrohen në hapësira të sigurta, ku fëmijët dhe të rinjtë "*kanë mundësi të kuptojnë e të diskutojnë çështje të ndjeshme, përfshirë terrorizmin dhe idetë ekstremiste që janë pjesë e ideologjisë terroriste si dhe të mësojnë se si t'i sfidojnë këto ide.*"¹⁷

Por, krahas shembujve të shumtë pozitivë, ekzistojnë edhe raste të kundërta. Në disa vende të botës arabe, të Azisë apo të Afrikës ndeshen shembuj shqetësues të radikalizmit të fëmijëve, pikërisht përmes sistemeve zyrtare të arsimit. Tekste me përmbajtje të theksuar radikale dhe frymë urrejtje fetare dhe etnike përdoren në shumë shkolla të këtyre vendeve. Krahas përpjekjeve për modernizimin e thellë të sistemit arsimor me fokus nxitjen e mendimit kritik dhe të metodave bashkëkohore të arsimit, qeveria planifikon të fillojë një përpjekje të dedikuar për fillimin e një programi të

¹⁴ Ghosh, R. "The Liberating Potential of Multicultural Education in Canada: Ideals and Realities". *Canadian Issues*, Spring 2011, f. 3-8.

¹⁵ Ganley, E. dhe Corbet, S. "France tackles inequalities, extremism after attacks". *Huffington Post*, 22 January 2015. Parë për herë të fundit në dt. 7. 8. 2016, në:
http://www.huffingtonpost.com/huffwires/20150122/eu-france-troubled-suburbs/?utm_hp_ref=world&ir=world.

¹⁶ Chrisafis, A. "France to overhaul secularism teaching to help stop radicalisation". *The Guardian*, 21 January 2016. Parë për herë të fundit në dt. 7. 8. 2016, në:
<http://www.theguardian.com/world/2016/jan/21/france-overhaul-secularism-teaching-anti-radicalisation-paris-attacks>.

¹⁷ *HM Government*, 2015. f. 11.

veçantë në fushën e edukimit kundër ekstremizmit në shkolla. Projekti i Qeverisë shqiptare synon që të plotësojë një vakum të madh të krijuar në hapësirën e edukimit nga hezitimi i gjatë i sistemit tonë arsimor për t'u ballafaquar me shfaqjet e radikalizmit, ekstremizmit apo të intolerancës në kuadër të vetë shkollës. Ky hezitim, i bërë në emër të laicitetit të shkollës, në fakt, vetëm sa ka lehtësuar punën e grupeve apo rrjeteve radikale dhe ekstremiste në drejtim të indoktrinimit së të rinjve. Programi i edukimit kundër ekstremizmit në shkolla do të synojë edukimin mbi nevojën e pranimit, të bashkëjetesës dhe të bashkëpunimit me tjetrin, atë të ndryshmin, pa paralelizuar apo konkurruar dhe, duke bashkëpunuar me bashkësitë fetare. Programi do të fillojë të zbatohet gjatë vitit akademik 2016-2017, fillimisht në trajtë pilot në disa shkolla, për t'u shtrirë më tej në të gjithë sistemin.

Literatura

1. *Dabiq*, Issue 12, 2016 (1437).
2. Marx, Karl dhe Friedrich Engels. *Manifest der Kommunistischen Partei*. London: 1848.
3. Kadare, Ismail. *Mosmarrëveshja*. Tiranë: Onufri, 2010.
4. Vendim i Keshillit të Ministrave nr. 930, date 18.11.2015 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe planit të veprimit".
5. Lu, Donald. *Luftëtarët e huaj terroristë dhe rrugët e migrimit të kundërligjshëm, - fjala e ambasadorit*. Tiranë: Ambasada Amerikane, 14 shtator 2016.
6. Friedman, Thomas L. *The Lexus and the Olive Tree, Understanding Globalization*. New York: Farrar, Straus and Giroux, 2000.
7. Lleshi, Sandër. *Udhëheqja ushtarake, globalizmi dhe rasti i Shqipërisë*. Tiranë: Onufri, 2015.
8. Kant, Immanuel. "Beantwortung der Frage: Was ist Aufklärung?". *Berlinische Monatsschrift*, Dezember. Heft 1784.
9. Kant, Immanuel. *Werke in zwölf Bänden. Her aus gegeben von Wilhelm Weischedel*. Frankfurt am Main: Suhrkamp, 1977.
10. Freire, P. *Pedagogy of the Oppressed*. New York: Herder and Herder, 1970.
11. Ghosh, R. "The Liberating Potential of Multicultural Education in Canada: Ideals and Realities". *Canadian Issues*, Spring 2011.
12. Ganley, E. dhe Corbet, S. "France tackles inequalities, extremism after attacks". *Huffington Post*, 22 January 2015.
13. Chrisafis, A. "France to overhaul secularism teaching to help stop radicalisation". *The Guardian*, 21 January 2016.
14. *HM Government*, 2015.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

Konceptet e sigurisë nacionale të Kosovës, sfidat përballë një bote në ndryshim

Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI*
Akademia e Kosoves per Siguri Publike
bejtushg2002@yahoo.com

Abstrakt

Siguria, kjo çështje e shumëpërfolur dhe jetike që me lindjen e njerëzimit, vazhdon të mbetet aktuale dhe objekt i gjerë studimi dhe diskutimi për shumë studiues, analistë dhe sidomos të strategëve ushtarakë. Ajo vazhdon të mbetet gjithnjë e pranishme, me befasi dhe shpërthimet e papritura. Është një vlerë absolute dhe element primar strukturor i sistemit shoqëror, sepse prek të gjithë anëtarët e shoqërisë dhe i ku nënshtrohen të gjitha resurset e tjera shtetërore. Rëndësia dhe dominimi i qasjeve "klasike" të sigurisë, si frikësimi, balanca e forcave, siguria kolektive dhe mbrojtja kolektive po sfidohen/zëvendësohen me konceptet e reja të sigurisë së përbashkët, gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese. Në shekullin XXI, siguria më nuk identifikohet me fuqinë ushtarake, ndërsa përdorimi i forcës më nuk është monopol i shtetit. Sfidat klasike janë zëvendësuar me sfida të ndryshme të cilat para së gjithash nuk janë të lidhura për forcën klasike ushtarake dhe atributet e saj. Siguria kombëtare trajton çështje të mbrojtjes së integritetit, tërësisë territoriale dhe qëndrueshmërisë së institucioneve të shtetit nga tërësia e rreziqeve të jashtme dhe të brendshme, që mund t'i vijë një vendi, si dhe përcakton kundërveprimet që institucionet shtetërore/publike duhet të bëjnë. Ajo ecën paralel me zhvillimin e një vendi, për rrjedhojë, shoqëria dhe kombi garantojnë dhe shtojnë përparimin dhe zhvillimin e mëtejshëm. Siguria është e garantuar kur vendi përmbush interesat kombëtare, qëllimet, objektivat dhe prioritetet e tij. Si rrjedhim, niveli i sigurisë përcaktohet nga shkalla e mbrojtjes dhe realizimit efektiv të interesave të qytetarëve, të shoqërisë dhe të shtetit, të cilat së bashku formojnë interesat kombëtare, interesat e qytetarëve, shoqërisë dhe shtetit.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

Fjalëkyçe:

siguria nacionale, terrorizmi, korrupsioni, aleancat, Kosova, FSK, NATO, OSBE, etj.

* Ligjërues në Fakultetin për Siguri Publike, Vushtrri, në Kolegjin Universitar "AAB" & "Dardania", Prishtinë dhe në Universitetin e EJL, Tetovë, Republika e Maqedonisë.

1. Hyrje

Përkufizimi i nocionit të sigurisë ka ndryshuar thellësisht në përpjekje për të përfshirë të gjithë faktorët të cilët kanë kapacitet në përdorimin e forcës apo ushtrimin e dhunës, përtej faktorëve tradicionalë (forca ushtarake, marrëdhëniet ndërkombëtare, etj., që në masë të madhe përcaktojnë sigurinë shtetërore), duke zgjeruar kuptimin e viktimës për të përfshirë jo vetëm shtetin dhe sigurinë fizike të shtetit e individit, por edhe ambientin në të cilin zhvillohen veprimet e dhunës (nga ai familjar, deri tek arena e veprimeve ushtarake në shkallë të gjerë), si dhe, duke zgjeruar kuptimin e sigurisë për të përfshirë edhe lirinë e lëvizjes, lirinë nga sëmundjet, nga uria, nga represioni, etj¹. Këta faktorë të rinj, nuk mundë të trajtohen përmes konceptit “tradicional” të sigurisë shtetërore, por, përmes konceptit të ri, që sigurinë shoqërore (sociale), nuk e trajton vetëm si element të sigurisë shtetërore, por, edhe si objekt referues më vete, i sigurisë.²

Në nivelin e tashëm të zhvillimit shoqëror, politika e sigurisë është e organizuar përmes sistemit të sigurisë, i cili analizon mundësitë e shkallës së organizimit për të kryer funksionin e sigurisë në shoqërinë bashkëkohore. Ajo është pjesë e politikës së përgjithshme shtetërore dhe realizohet si tërësi e qëllimeve të sigurisë kombëtare. Kjo nënkupton se politika e sigurisë ka për objekt të identifikojë tërësinë e kërcënimeve dhe të rreziqeve që mund t'i vijnë një vendi, sidomos ato që kanë lidhje me mbrojtjen e popullsisë, integritetin e territorit dhe qëndrueshmërinë e institucioneve të shtetit dhe, të përcaktojë

¹ Sachs, Stephen E. *The Changing Definition of Security*. Oxford: International Relations, Merton College, 2003. http://www.stevesachs.com/papers/paper_security.html

Parë për herë të fundit: dt. 25.8.2016.

² Waever et al, (1993).

kundërveprimet që pushtetet publike duhet të bëjnë. Ky përcaktim i konceptit të sigurisë kombëtare zëvendëson konceptin e vjetër të mbrojtjes kombëtare, sepse politika e mbrojtjes ka për objekt të sigurojë integritetin e territorit dhe mbrojtjen e popullsisë kundër agresioneve të armatosura. Ajo kontribuon në luftën kundër kërcënimeve të tjera, që vënë në rrezik sigurinë kombëtare. Pra, mbrojtja nuk është më kuadri i përgjithshëm i veprimit të shtetit në fushën e mbrojtjes së interesave kombëtare, por vetëm një prej funksioneve të shtetit, që merr pjesë, bashkë me politikat e tjera publike, në sigurinë kombëtare.

2. Politika e sigurisë kombëtare

Studimet e ndryshme pohojnë se politikat qeveritare të cilat promovojnë sigurinë “jo-ushtarake”, ndikojnë në zhvillimin e vendit; ndërsa politikat e “pasigurisë” (konfliktet ushtarake), padyshim, sjellin shkatërrime dhe ndalim të zhvillimit ekonomik.³ Kuptimi i kësaj ndërvarësie, ka bërë që sfidat e menaxhimit të konflikteve të jenë më të vështira. Rëndësia dhe dominimi i qasjeve “klasike” të sigurisë, si frikësimi, balanca i forcave, siguria kolektive dhe mbrojtja kolektive, po sfidohen/zëvendësohen me konceptet e reja të sigurisë së përbashkët, gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese. Institucione globale e regjionale po eksperimentojnë me teknika të reja të trajtimit të konflikteve, siç është diplomacia preventive, paqeruajtja, ndërtimi i paqes dhe intervenimi humanitar, shpesh me rezultate të përziera.⁴

Politika e bashkëpunimit dhe integrimi në institucionet ndërkombëtare të sigurisë, me theks të veçantë integrimin në NATO, si mjet për arritjen e stabilitetit në vend dhe rajon, përbën objektivin dhe zgjidhjen strategjike themelore për sigurinë e Kosovës dhe mbrojtjen e interesave kombëtare. Mirëpo, shkalla e suksesit në realizimin e kësaj politike, varet nga arritja e stabilitetit të brendshëm dhe e konsolidimit të shoqërisë demokratike dhe të drejtave të njeriut, zhvillimi ekonomik, ngritja e kapaciteteve njerëzore (shkallës së arsimit “funksional” – të zbatueshëm); konsolidimi i institucioneve dhe instrumenteve të sigurisë, duke e afirmuar Kosovën në vazhdimësi si një faktor progresi e kontribuues në proceset e sigurisë rajonale dhe globale. Kosova, e mbështetur nga NATO-ja dhe EULEX-i, po ndërton një sistem evropian të sigurisë, i cili mbështetet në bashkëpunimin reciprok në nivel rajonal dhe në atë ndërkombëtar. Ky koncept, ka mbështetje të plotë në rrafshin profesional dhe financiar nga bashkësia ndërkombëtare, në veçanti nga NATO-ja, SHBA-ja dhe Bashkimi Evropian. Për të përmbushur këto objektiva, institucionet e Kosovës duhet të përshpejtojnë plotësimin e infrastrukturës ligjore për fushën e sigurisë, e cila duhet të jetë në harmoni të plotë me standardet dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian. Zhvillimi i legjislacionit dhe funksionimi efektiv i organeve të drejtësisë, janë garanci për integrimin e Kosovës në Bashkësinë Evropiane. Nga perspektiva e politikës kosovare, Bashkimi Evropian dhe NATO-ja, janë faktorët kryesorë të arkitekturës evropiane, të cilët kanë përjetuar ndryshime të mëdha pas zhvillimeve të viteve 90-të. Në dokumente bazë të kësaj fushe (të cilat janë në fazën e hartimit) do të reflektohet politika e këtyre dy organizmave, duke ndjekur standardet dhe ndryshimet e tyre me synimin për krijimin e kushteve për integrim të plotë në këto

³ Francis, Stewart. *Development and Security*. Oxford: Queen Elisabeth House, University of Oxford, 2004.

⁴ Rajaratnam, S. *School of International Studies*. Gjendet elektronikisht në:

<http://www.ntu.edu.sg/rsis/teaching/MSc.asp#>.

Parë për herë të fundit: dt. 28.5.2016.

struktura. Prezenca e NATO-s në Kosovë forcon shkallën e sigurisë dhe rrit faktorin mbrojtës, i cili është bazë i stabilitetit të përgjithshëm. Mirëpo, rëndësi dhe rol të veçantë për stabilitetin e rajonit, me theks të veçantë të Kosovës, luan prania e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sepse ato ishin dhe janë promotor i stabilitetit dhe progresit rajonal. Kosova duhet të mbështesë konceptin e ri të politikës së sigurisë, i cili nënkupton bashkëpunimin dhe bashkëveprimin në nivel ndërkombëtar. Mirëpo për të përmbushur këtë synim në këtë fazë, Kosovës i mungon përcaktimi i qartë i mjedisit të sigurisë, ndërsa politika e sigurisë mbështetet në aftësinë/mbështetjen e KFOR-it dhe EULEX-it. Për krijimin e kësaj gjendjeje, ndikim të madh kanë pasur aktivitetet e grupeve kriminale të së gjitha llojeve të sponsorizuara nga Serbia, të cilat kanë penguar dhe po pengojnë institucionet kosovare të sigurisë që të ushtrojnë sovranitetin në tërë territorin e Kosovës. Në shekullin e XXI-të, siguria nuk identifikohet më me fuqinë ushtarake, ndërsa përdorimi i forcës nuk është më monopol i shtetit. Sfidat klasike janë zëvendësuar me sfida të ndryshme, të cilat para së gjithash nuk janë të lidhura për forcën klasike ushtarake dhe atributet e saj. Ato vijnë nga burime nga më të ndryshmet dhe vështirë se mund të parashihet në natyrën e tyre, intensiteti i rrezikut, vendi, koha e shpërthimit të tyre dhe kontinuiteti i zgjatjes. Këto zhvillime, kanë ndryshuar edhe përkufizimin e shtetit nga kuptimi ekonomik i Adam Smith apo kuptimi i sigurisë i Max Weber. Politika e bashkëpunimit dhe integrimi në institucionet ndërkombëtare të sigurisë, me theks të veçantë integrimi në NATO, si mjet për arritjen e stabilitetit në vend dhe në rajon, përbën objektivin dhe zgjidhjen strategjike themelore për sigurinë e Kosovës dhe mbrojtjen e interesave kombëtare. Mirëpo, shkalla e suksesit në realizimin e kësaj politike varet nga arritja e stabilitetit të brendshëm dhe e konsolidimit të shoqërisë demokratike; e të drejtave të njeriut, zhvillimi ekonomik, ngritjen e kapaciteteve njerëzore (shkallës së arsimit “funksional” – të zbatueshëm); konsolidimi i institucioneve dhe instrumenteve të sigurisë, duke e afirmuar Kosovën në vazhdimësi si një faktor progresi e kontribuuese në proceset e sigurisë rajonale dhe globale. Kosova, e mbështetur nga NATO-ja dhe EULEX-i, po ndërton një sistem evropian të sigurisë, i cili mbështetet në bashkëpunimin reciprok në nivel rajonal dhe atë ndërkombëtar. Periudha që po jetojmë, përveç globalizimit ekonomik, paraqitet edhe si globalizim i rreziqeve dhe i kërcënimeve të fushës së sigurisë ndërkombëtare, rajonale, nacionale dhe individuale/njerëzore. Globalizimi, duke favorizuar lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të mallrave, ka krijuar edhe mundësitë e përfitimeve për krimin dhe terrorizmin. Ndërvarësia dhe ndërveprimi i ekonomisë dhe sigurisë është shtuar, por, me gjithë këtë shtim, këto dukuri janë bërë gjithnjë më amorfe dhe më të papërcaktuara. Siguria shoqërore më nuk mund të trajtohet ngushtë si pjesë e sigurisë shtetërore, por, duhet të trajtohet si çështje e veçantë dhe e rëndësishme e interesit nacional. Institucione dhe nisma të shumta ndërkombëtare janë themeluar dhe veprojnë duke shpenzuar shuma të majme financiare, për të “përbashkuar” këto dy sektorë jetikë për çdo shtet dhe/ose komb.

3. Diplomacia dhe ndikimi mbi sigurinë

Në analizën e punës së diplomacisë kosovare për garantimin e objektivave të shprehura në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, vihen re disa aspekte kritike, të cilat në mos kanë ndikuar negativisht, nuk kanë arritur të sjellin rezultate pozitive për vendin. Një ndër fenomenet më sfiduese të institucioneve të sigurisë në Kosovë, është ndjenja e inferioritetit dhe emocionit ndaj shteteve ose interesave të huaja. Një nga arsyt kryesore,

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

që politika e jashtme kosovare shfaq shenja të tilla, është mungesa e brezit të profesionistëve, e strategjive dhe e projekteve të qarta në fushën e diplomacisë, por edhe mungesa e konsensusit politik për këto çështje. Gjatë tetë viteve, ka ndodhur rrallë, shumë rrallë, që politika kosovare të bashkohet në një aksion apo qëndrim diplomatik. Një rast i tillë është mbështetja e procesit të integrimi euro-atlantike, duke e parë efektin diplomatik në një aspekt më të prekshëm rajonal, mund të thuhet se Kosova po përpiqet shumë për të luajtur një rol aktiv në përmbushjen e synimeve për integrim rajonal dhe më pas evropian. Kosova zhvillon marrëdhënieve intensive me vendet e tjera, hyn në aleanca politike, por në çdo rast ajo duhet të marrë në konsideratë interesat reciproke. Pikërisht, njohja e këtyre interesave është mjaft e rëndësishme, në mënyrë që të ketë përputhje me interesat tona kombëtare dhe të mos jenë në dëm të tyre.

Kosova është në proces të ndërtimit të një sistemi funksional modern të sigurisë dhe të mbrojtjes për sigurinë rajonale dhe globale si dhe për stabilitetin të Kosovës. Kosova duhet të sigurojë se ajo ka aftësitë e nevojshme për të adresuar sfidat aktuale dhe të ardhshme. Kosova duhet të ketë aftësi në vend (lokale) për të mbrojtur integritetin territorial të saj dhe të sigurojë mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve të saj. Mirëpo në funksion të mbrojtjes ndaj këtyre kërcënimeve dhe rreziqeve të mundshme, në politikën e jashtme, Kosova e shikon integrimin në strukturat evropiane dhe euroatlantike të sigurisë, si objektivin e saj strategjik, si një ndër shtyllat kryesore të politikës së jashtme. Është me rëndësi të theksohet se të gjithë liderët, si nga pozita ashtu edhe nga opozita, kanë deklaruar se Republika e Kosovës është plotësisht e angazhuar për integrimin euroatlantik dhe për marrëdhënie e fqinjësi të mirë, për të qenë një partner konstruktiv në ndërtimin e paqes rajonale, sigurisë, stabilitetit dhe prosperitetit ekonomik. Këto qëllime të mësipërme pasqyrohen edhe në kushtetutë, si dhe në prioritetet kombëtare të Republikës së Kosovës. Ndërsa, integrimi në NATO konsiderohet jo vetëm si një faktor themelor në funksion të rritjes së sigurisë për momentin, por edhe si një investim i rëndësishëm afatgjatë. Kosova është duke e kërkuar sigurinë, së bashku me vendet fqinje, nën ombrellën e NATO-s dhe është duke krijuar kushtet e duhura të sigurisë për të vendosur stabilitetin afatgjatë, sigurinë dhe paqen për vendin e rajonin. Në prill 2012, Kosova ka filluar Rishikimi Strategjik të Sektorit të Sigurisë për të identifikuar nevojat e sigurisë së vendit dhe të përcaktojë qartë rolet dhe misionet e secilit institucion që merret me çështjet e sigurisë. Qëllimi i rishikimit ishte bërja e një analize të plotë dhe gjithëpërfshirëse “të tërë qeverisë”. Të gjitha institucionet dhe agjencitë përgjegjëse për sigurinë ishin të përfshira dhe janë analizuar të gjitha aspektet e sigurisë së Kosovës. Pas një analize dyvjeçare, e cila është bërë në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, qeveria e Kosovës arriti në përfundimin se Forca e Sigurisë së Kosovës do të transformohet në Forcat e Armatosura të Kosovës. Kalimi/tranzicioni i FSK-së në FAK është në pritje të ndryshimeve të nevojshme kushtetuese.

Misioni i Forcave të Armatosura të Kosovës do të jetë për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës, për të mbrojtur qytetarët si dhe pronat e tyre dhe interesat e kombit. Forcat e Armatosura do të kontribuojë në ndërtimin dhe ruajtjen e stabilitetit rajonal dhe global. Ato do të vazhdojnë të marrin pjesë në operacionet në përgjigje të krizës, të ndihmojnë autoritetet civile si përgjigje ndaj katastrofave dhe emergjencave natyrore si dhe të kryejnë asgjësimin e mjeteve eksplozive. E ardhmja e Forcave të Armatosura të Kosovës do të zhvillohet në përputhje me parimet e mëposhtme:

- do të jenë të fokusuar në mbrojtjen e atdheut;
- do të jenë një forcë për të mirë dhe do të zhvillohet sipas standardeve ndërkombëtare;

- do t'i nënshtrohen kontrollit demokratik civil;
- do të jenë vullnetare, profesionale, dhe multietnike.

Kosova po ndërton një forcë moderne, mobile dhe teknologjike të avancuar, që është në gjendje të jetë fleksibël dhe që mund t'i përgjigjet në mënyrë adekuate sfidave bashkëkohore të sigurisë. E ardhmja e Forcave të Armatosura të Kosovës do të përbëjë themelin e politikës së sigurisë të qeverisë dhe do të përbëhet nga 5.000 veta personel aktiv dhe 3.000 vetë personel rezervë. Struktura ushtarake do të përbëhet nga Komanda e Forcave Tokësore, Komanda Kombëtare e Gardës, Komanda Logjistike dhe Komanda e Trajnimit dhe Doktrinës. Zhvillimi i Forcave të Armatosura të Kosovës do të jetë gradual dhe pritet të zgjasë për 10 vjet.

Kosova është e bindur se vendet e Ballkanit Perëndimor mund të shërbejnë si një shembull se besimi reciprok mund të arrihet përmes dialogut, se mosmarrëveshjet mund të zgjidhen në mënyrë paqësore përmes negociatave dhe se siguria rajonale mund të realizohet nëpërmjet bashkëpunimit. Kemi bashkëpunim shumë të mirë me Republikën e Maqedonisë (kemi dërguar në studime të rregullta në akademinë ushtarake, pjesëtarë të FSK-së, të minoriteteve, kemi marrë pjesë në ushtrime të përbashkëta në Qendrën Stërvitore në Krivollak, janë trajnuar një grup i pjesëtarëve të FSK-së për PIAR, etj.), me Republikën e Kroacisë (këtë vit planifikojmë t'i dërgojmë për arsimim nga lëmi i diplomacisë ushtarake dy oficerë dhe do të kemi mbështetje me ekspertë për Policinë Ushtarake), si dhe Republikën e Shqipërisë (në arsimim të së gjitha niveleve, trajnime, ekspertizë, etj.). Në të ardhmen e afërt besojmë se do të fillojmë bashkëpunimin edhe me Republikën e Bosnje Hercegovinës duke dërguar pjesëtarët e FSK-së për arsimim profesional në Qendrën Trajnuese në Sarajevë. Ne jemi më të efektshëm nëse punojmë së bashku. Kosova është duke bërë thirrje për bashkëpunim më të thellë, për politika dhe doktrina të përbashkëta, vendime dhe veprime të koordinuara, përpjekje të kombinuara dhe aftësim. Ky do të jetë çelësi i suksesit tonë. Ky do të jetë çelësi i ëndrrës sonë: paqe e qëndrueshme dhe stabilitet.

4. Sfidat e sigurisë në Kosovë, në rrethanat aktuale ndërkombëtare dhe vendore

Problemet e sigurisë janë bërë me kohë fusha e përgjegjesisë e institucioneve më të rëndësishme shtetërore, si dhe ekspertëve të tyre. Bota në asnjë rast nuk ka qenë e sigurt për shtete të vogla dhe të mesme. Kjo ishte më e theksuar gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, përmes rivalitetit të superfuqive, konflikteve ideologjike, si dhe përplasjeve ndërmjet tyre për interesa gjeopolitike dhe gjeostrategjike. Historia ka dëshmuar se fuqitë e mëdha e kanë shumë të lehtë të manipulojnë shtetet e vogla dhe të dobëta si nga ana ekonomike, ashtu si dhe nga ana ushtarake. Kronikat dhe ngjarjet historike të shteteve të vogla dhe të mesme, për fat të keq janë gllabëruar nga shtetet e mëdha si gjatë periudhës së sundimit të Prusisë ashtu dhe në kohërat moderne, në shkretëtirat e Saharasë. Shembujt edhe sot e kësaj dite, tregojnë se asimilimi i shteteve të vogla e të mesme nga shtetet e mëdha nuk ka ndodhur gjithmonë, madje ka shtete të vogla dhe të mesme të cilat jo vetëm që kanë mundur të mbijetojnë si shtete të pavarura dhe sovrane, por dhe kanë lulëzuar dhe janë begatuar përkrah shteteve shumë më të mëdha dhe të

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

fuqishëm. Shembulli i qartë dhe kuptimplotë është Zvicra, i cili është ndjekur nga Kosta Rika, Izraeli, Singapori si dhe disa shtete të tjera të vogla nga Paqësori dhe Karaibet.

Pas viteve '90-të, problem strategjik kyç për të gjitha vendet e vogla postkomuniste ishte rirreshtimi në kontekstin e ri, në kuptimin qenësor dhe jo vetëm formal, si kandidatë për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe NATO. Dilema e tyre, objektivisht, ishte më pak e komplikuar në vitet e para të tranzicionit, për arsye se atëherë ende vلente ndarja kulturore, për më tepër politike “Perëndim” dhe “Lindje”.

Ndërkohë, koncepti i “Perëndimit” pësoi ndryshime serioze në esencën e vet, si rezultat i paraqitjes së vijave të reja të ndasisë ndërmjet Evropës dhe Amerikës. Në vitet e para të mijëvjeçarit të ri, tendencat e tilla u bënë aq të qarta sa që diskursi politik që me vite të tëra e përfaqësonin shtetet e vogla për “kthim atje ku e kanë vendin” u bë gati sa irelevant pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit. Disa studiues ironizuan dhe madje konstatuan se, rendi i ri vërtet i minimizonte rreziqet për sigurinë e shteteve të vogla, por bota bipolare, megjithatë, u ofronte shumë opsione që t’i kishin në dispozicion. Ç’është e vërteta, sot për shtetet e vogla ekziston vetëm një zgjedhje strategjike, e ajo është, integrimi euroatlantik. Marrë në përgjithësi, projekti i sigurisë dhe i mbrojtjes së përbashkët ishte ide e shteteve të mëdha evropiane, mirëpo qëllimi për t’u pozicionuar në sistemin ndërkombëtar ishte motivi kryesor që i detyroi gati të gjitha shtetet e vogla t’u bashkoheshin atyre.⁵

Me përjashtim të Qipros, Maltës, Irlandës dhe Danimarkës, të gjitha vendet anëtare të vogla të Bashkimit Evropian, e shprehnin interesimin e tyre për të përkrahur aktivitetet në planin e sigurisë dhe mbrojtjes së përbashkët. Shtetet e vogla duhet të përqendrohen në krijimin e një force profesionale të stërvitur, e cila mund të mobilizohet me lehtësi në rast krize, si dhe të jetë e përballueshme në aspektin ekonomik. Shembujt më të mirë janë Izraeli, Zvicra, Tajvani dhe Singapori, që disponojnë forca të armatosura shumë të mira, të mbështetura financiarisht, forca të cilat konsiderohen vendimtare për parandalimin e rrezikut dhe dekurajimin e kundërshtarit. Cilësia kompeson numrin e vogël të forcave të armatosura, ku me cilësi kuptohet lëvizshmëria, morali, stërvitja dhe pajisja sa më e mirë. Gjithashtu edhe modernizimi në pajisje e armatim është ndjekur vazhdimisht dhe është domosdoshmëri edhe për shtetet e vogla. Sfidat e mjedisit të sigurisë shoqërore, në rrethanat aktuale ndërkombëtare dhe në Kosovë, janë të shumta. Disa prej tyre kanë ndikim të drejtpërdrejt (akut) ndaj sigurisë, kurse të tjerat kanë ndikim të tërthortë (të vonuar).

Në sfidat e grupit të parë hyjnë: korrupsioni, terrorizmi dhe krimi i organizuar (trafikimi me qenie njerëzore, trafikimi ilegal me materie të kontrolluara – narkotikë, armë, teknologji, etj.). Ndërsa në sfidat e grupit të dytë, do të veçojmë: cilësia e ulët e arsimit në të gjitha nivelet, me pasojë “analfabetizmin” funksional; mungesa e politikës agrare dhe strategjisë së urbanizimit; integrimi i pakicës serbe në institucione shtetërore; ndikimi i Beogradit ndaj pakicës serbe, etj. Korrupsioni i lartë po kërcënon funksionimin e standardeve të ekonomisë së tregut në Kosovë dhe po shkakton një efekt deformues në politikat qeveritare për tregtinë dhe taksat si dhe, po frenon investitorët potencialë. Është kërcënim i madh për demokratizimin e shoqërisë kosovare si dhe për konsolidimin e institucioneve demokratike të saj. Ai pengon zbatimin e strategjive dhe politikave të kontrollit të krimit dhe është një pengesë e madhe për zbatimin e suksesshëm

¹ Molis, A. “The Role and Interests of Small States in Developing European Security and Defense”. *Baltic Security and Defense Review*, Vol. 8, 2006, fq. 84

të metodave dhe organizimit që vendosin ligjin. Privatizimi me çdo kusht i ndërmarrjeve shoqërore, në zbatim të luftës kundër korrupsionit, nuk është strategji e drejtë. Privatizimi, në shumë vende të tranzicionit dhe në vende në zhvillim, shpeshherë ka degraduar në shitjen e asetëve publike (apo shoqërore) nën çmimin e tregut, në mënyrë jotransparente dhe korruptive. Përveç kësaj, praktika të tilla i hapin rrugë korrupsionit edhe pas privatizimit.⁶

Stërzgjatja e procesit të privatizimit të PTK-së dhe pjesëve (shërbimeve) të KEK-ut, është indikacion se edhe në këtë mes, “ka diçka të kalbur”. Përveç korrupsionit “eklatant”, një praktikë e hidhur që duhet luftuar, është edhe “mitmarrja detyruese” që nënkupton nevojën e qytetarëve për të dhënë mito, për të arritur diçka që atyre u takon me ligj dhe/ose me normat qytetare. Sipas raportimit të medieve, kjo dukuri është e përhapur në të gjitha sistemet e pushtetit, ashtu si dhe në ndërmarrjet publike e shoqërore. Kërcënimi i korrupsionit mund të luftohet duke përdorur strategjitë preventive që reduktojnë shanset për krim dhe që eliminojnë pikat e dobëta të sistemeve ekonomike e industriale suke shtuar rezistencën e tyre ndaj infiltrimit të grupeve të krimit të organizuar. Lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe trafikeve të paligjshme, varet nga efikasiteti i veprimit të “Agjencisë kundër korrupsionit”, “Agjencisë së inteligjencës, policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit”.

Ruajtja e sigurisë së përgjithshme kërkon, gjithashtu, ndalimin e përdorimit të informacioneve të grumbulluara për qëllime të manipulimit të ndërgjegjes së publikut. Qeveria e Kosovës duhet që të intensifikojë funksionalizimin e plotë të këtij sistemi, duke përfshirë strukturat e grumbullimit dhe përpunimit të informacionit, veçanërisht atyre të fshehta, (në kuptimin e misionit, procedurave dhe infrastrukturës ligjore) duke ndërtuar një sistem informacioni të integrueshëm dhe të ndërveprueshëm në mes vete si dhe me strukturat homologe të rajonit e me agjenci informacioni që kapërcejnë kufijtë tradicionalë si dhe të përfshijë konceptin “coalition of information”. Po ashtu, nga organizmat ndërkombëtarë duhet të kërkohet garantimi me ligje të veçanta i mbrojtjes së informacionit të klasifikuar si shtetëror në fusha të veçanta, si dhe ai ndërshtetëror apo me organizma ndërkombëtarë, që buron nga marrëveshjet midis palëve. Kërcënimi nga terrorizimi, konsiderohet sot njëri ndër kërcënimet më serioze për sigurinë e Kosovës, si dhe një ndër kërcënimet më serioze për sigurinë ndërkombëtare, sidomos duke pasur parasysh edhe prirjet globale të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Këto fenomene mbështeten në anët e forta dhe të dobëta të botës së globalizuar të përhapjes së mesazheve të grupeve terroriste, për të siguruar fonde për grupet përkrahëse dhe veprimtaritë kriminale dhe për më tepër duke bërë rekrutimin e anëtarëve të rinj, për arritjen e qëllimeve të tyre edhe në vende të cilat ndodhen larg konflikteve. Kërcënimi më i madh aktualisht, duket të jetë i ashtuquajturit ISIS, me bazë në Siri dhe Irak, i cili nuk është vetëm global, por përbën edhe kërcënim lokal si dhe konfliktet e ndryshme në rajon dhe në vendet me të cilat një pjesë e popullsisë së Kosovës kanë lidhje tradicionale, kulturore dhe historike. Këto fenomene për fat të keq nuk tregojnë shenja të zbehjes, prandaj adresimi i këtyre sfidave është çështje urgjente për Republikën e Kosovës. Ndër sfidat e grupit të dytë, mund të veçohen, si: cilësia e ulët e arsimit në të gjitha nivelet, me pasojë “analfabetizmin” funksional; mungesa e politikës agrare dhe strategjisë së urbanizimit; integrimi i pakicës serbe në institucione shtetërore; ndikimi i Beogradit ndaj pakicës serbe, etj.

Kosova është e njohur për faktin se ka popullatën më të re në kontinent, mirëpo

sado që është i mirëseardhur ky fakt, në kuptimin pozitiv, për sa i përket kapacitetit zhvillimor, është e domosdoshme që të investohet në ruajtjen e këtij kapaciteti nga degradimi dhe shkatërrimi.⁷ Niveli tepër i ulët i arritjes së suksesit në provimin e maturës, po detyron Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë që të bëjë atë që nuk duhet bërë – të ulë prapun e kalueshmërisë së testit. Sistemi privat i arsimit në Kosovë, ka krijuar një inflacion të kuadrove dhe thirrjeve shkencore në drejtimet e shkencave shoqërore (sociale) - juristë, bankierë, menaxherë, kriminalistë, politologë, diplomatë, etj., të cilët nuk arrijnë të gjejnë zbatim praktik, ndërkohë që drejtimet teknike dhe shkencat natyrore, ndërtimtaria, makinaria, në sektorin privat as që nuk ekzistojnë, kurse në Universitetin e Prishtinës janë thuajse në prag të shuarjes. Integrimi i pakicave në shoqëri dhe në institucione shtetërore është një ndër parakushtet për anëtarësim në BE. Mirëpo, vënia e nevojave të një grupi të çfarëdo përkatësie (qoftë ekonomike/ sociale, apo etnike) përpara nevojave dhe mirëqenies së shoqërisë në përgjithësi, asnjëherë nuk sjell efektet e pritura.

Në fakt, historia njerëzore ka dëshmuar se këto orvatje gjithherë përfundojnë me katastrofa të individëve, apo edhe të tërë shoqërisë. Orvatje të tilla, në Kosovën e viteve '90-të, përfunduan me luftën e hapur të UÇK-së, në fund të shekullit XX-të, kurse aktualisht jemi dëshmitarë të kryengritjeve dhe luftërave civile në thuajse mbarë vendet arabe. Prandaj, institucionet Kosovare duhet të mësojnë nga përvojat e hidhura të së kaluarës dhe të ndryshojnë qasjen e gabuar ndaj sigurisë së pjesëtarëve të pakicave, të cilën UNMIK-u e ka "trashëguar" nga gjendja e paraluftës dhe është munduar që t'ia lërë "trashëgim" edhe institucioneve vendore.⁸ Ndikimi i Beogradit ndaj serbëve në Kosovë, ka rënë në shkallë të konsiderueshme gjatë viteve të fundit e sidomos, pas "Marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës e Serbisë", e cila u nënshkrua më 19 prill 2013, pas 10 rundeve të dialogut politik nën drejtimin e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian (BE) për Politikë të Jashtme dhe Siguri, znj. Catherine Ashton.

Kjo është dëshmuar edhe me rastin e zgjedhjeve lokale, si dhe në zgjedhjet e fundit në nivel qendror. Megjithatë, ky ndikim mbetet ende problematik, sidomos në veri të vendit, pasi marrëveshja shkon përtej "Propozimit gjithëpërfshirës për statusin" nga Ahtisaari (PGJS) dhe krijon një ndarje institucionale etnike mes serbëve të Kosovës dhe të tjerëve si dhe, paraqet goditje të përpjekjeve shtatëmbëdhjetëvjeçare të bashkësisë ndërkombëtare për të ndërtuar Kosovën si shoqëri dhe shtet shumetnik. Serbët lokalë në Zveçan, tashmë disa herë, po bllokojnë magjistralen, duke kundërshtuar jo vetëm Policinë e Kosovës, por edhe KFOR-in dhe EULEX-in, për shkaqë nga më të ndryshmet, duke dëshmuar se në çdo kohë, mundë të shkaktojnë trazira të sigurisë.

5. Armët e shkatërrimit në masë mbesin prioritet për terroristët

Edhe pse sulmet e 11 shtatorit tregojnë se al-Kaida dhe terroristët të tjerë do të vazhdojnë të përdorin armë konvencionale, një nga shqetësimet më të larta është

⁷ Gashi, Bejtush dhe Agron Jusufi. "Ekonomia e Sigurisë" (Ekonomija Sigurnosti, sluëaj za analizu: Kosovo poslije rata). *International Studies, A Review of International Relations, Foreign Policy and Diplomacy*. Zagreb: The Center for International Studies, 2009.

⁸ *Siguria personale në Kosovë, domosdoshmëri për rishqyrtim gjithëpërfshirës*, (grup autorësh). Prishtinë: Instituti për Studime të Sigurisë dhe Integrimi, "Katana", 2007.

gatisshmëria e tyre në përpjekje për sulme të pazakonta kundër SHBA-së dhe aleatëve të saj. Në fillim të vitit 1998, Bin Laden deklaroi publikisht se armët e pazakonta ishin “një detyrë fetare”. Grupet terroriste në mbarë botën kanë qasje të drejtpërdrejtë në informacione kimike, biologjike dhe madje edhe te armët bërthamore, nëpërmjet internetit, ndërsa al-Kaida ka bërë përpjekje për të siguruar armë të shkatërrimit në masë, përkatësisht agjentë kimikë dhe toksina. Këtë e dëshmojnë dokumentet e al-Kaidës të gjetura në një objekt në Afganistan, të cilat faktojnë se Bin Laden ishte duke ndjekur hulumtimin e armëve të sofistikuara biologjike. Përndryshe, al-Kaida ose grupe të tjera terroriste mund të përpiqen që të kryejnë sulme konvencionale, kundër qendrave industriale, kimike apo infrastrukturave bërthamore të Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të saj.

Gjithashtu, ka një alarm për mundësinë e ndonjë lufte të sulmit kibernetik, që pas sulmeve të 11 shtatorit 2001, në atë kohë rrjeti elektronik ka qenë në një shkallë jo aq shumë të mbrojtur, të mbrojtjes së paparashikuar nga sulmet e terroristëve, krahasuar me atë sot. Sulmet e kësaj natyre, do të bëhen një opsion gjithnjë i zbatueshëm për terroristët. Si ata edhe kundërshtarë të tjerë, bëhen më të njohur me këto objektiva dhe teknologjitë e nevojshme për të sulmuar qarqet e caktuara. Përdorimi i ndonjë prej armëve të shkatërrimit në masë (WMD) nga një grup terrorist do të ishte një ngjarje me përmasa shkatërruese, sepse përmasa e dëmeve nga armët bërthamore, kimike e biologjike është shumë më e madhe se sa nga ajo e sulmeve terroriste. Një armë bërthamore do të shkaktoje dëme të menjëhershme në një zonë të kufizuar, por shpërthimi dhe presioni i tepërt, ngrohja ekstreme dhe rrezatimi nuk mund të ndalen. Nëse një armë shpërthen në një metropol të madh, numri i viktimave mund të shkojë më tepër se 100.000 të vdekur dhe të plagosurit dhe so t'i nënshtroheshin dozave vdekjeprurëse të rrezatimit.

Kulti Shinrikyo Aum përdori armë kimike në sulmin e vitit 1995 në metron e Tokios, - helmin vdekjeprurës nervor “sarin”, nga i cili, nëse bie qoftë edhe një pikë e vetme në lëkurë mund të jetë fatal për njeriun. Mirëpo, sulmi nuk pati një sukses të plotë për shkak të shpërndarjes së paefektshme, por 12 njerëz vdiqën dhe gati 3.800 të tjerë u plagosën. Shinrikyo Aum në katër sulme të tjera përdori VX (10 deri 1000 herë më i fortë se gazi sarin). Këto sulme kishin në shënjestër individë ose grupe të veçanta njerëzish dhe nuk kishin qëllim të shkaktonin viktima masive. Në një rast, nuk kishte pasoja fatale dhe në një tjetër rast pati 20 vdekje, por sulmet e tjera dështuan për shkak se lirimi i agjentit VX ishte joefektiv. Është vlerësuar se, në kushte ideale, nëse shpërndahet siç duhet, një kuart (0.9 litra) i agjentit VX, në një zonë të madhe metropolitane, mund të vriten rreth 12 milionë njerëz në 60 minuta. Pasojat e një sulmi biologjik janë potencialisht katastrofike, sepse armët biologjike kërcënojnë sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare. Veronique de Ruyg dhe Charles V. Peña⁹, argumentojnë se armët biologjike paraqesin një kërcënim të madh ndaj sigurisë së Amerikës dhe ndaj aleatëve ndërkombëtarë, në qoftë se terroristët posedojnë armët bërthamore apo ato kimike. Autorët thonë se ndryshe nga sulmet bërthamore dhe kimike, një sulm duke përdorur armë biologjike, nuk do të mund të zbulohet menjëherë, duke i dhënë kohë virusit që të përhapet në të gjithë popullsinë, para se të mund të administrohet antidoti. Sipas, de Ruyg dhe Pena, virusi biologjik është një kërcënim veçanërisht serioz për shkak të kësaj dhe të normave fatale e lehtësisë së transmetimit.

⁹ Ruyg, Veronique de, dhe Charles V. Peña. *Responding to the threat of smallpox bioterrorism: an ounce of prevention is best approach*. Washington, D.C.: Cato Institute, 2002.

6. Terrorizmi kibernetik përmban një grup kërcënimesh

Ndër sfidat e grupit të parë hyjnë edhe sulmet kibernetike, përkatësisht “terrorizmi kibernetik”. Siç thekson Bruce Brekowitz: “Gjatë viteve të fundit, zyrtarët ushtarakë, janë shqetësuar për mundësinë që një kundërshtar i huaj mund të godasë në kompjuterët e SHBA-së dhe të aleatëve të saj, rrjetet e komunikimit dhe bazat e të dhënave. Edhe pse si i tillë, si një “luftë informacioni” (IW), sulmi mund të jetë pjesë e një operacioni të madh konvencional ushtarak; kundërshtarët mund ta përdorin gjithashtu edhe si një paralajmërim për të futur në mendje idenë e goditjes në pjesë tjera të botës, ku Shtetet e Bashkuara ndihmojnë një aleat jashtë vendit apo si pjesë e një fushate antiterroriste¹⁰.

Lufta e informacionit paraqet probleme të veçanta për planifikuesit e mbrojtjes. Shumë, nëse jo shumica objektivave të një sulmi të tillë, ndoshta do të ishin kompjuterët komercialë dhe sistemet e komunikimit, të cilat janë më të prekshme se sa nga ato që përdor ushtria. Operatorët komercialë, akoma janë në dukje në dijeni, se ata janë objektivat e mundshme dhe disa kanë marrë të gjitha masat parandaluese¹¹

7. Përfundim

Siguria e shtetit si koncept është mjaft komplekse, ndërsa në terma të përgjithshme, ajo mund të përcaktohet si një “mbrojtje identiteti”, ndërsa në terma të veçanta, siguria shikohet si një strukturë shumëdimensionale. Në mjedisin e ri të sigurisë, konceptet tradicionale nuk mund të rekomandojnë zgjidhje të problemeve të sotme. Dihet se, situata e përgjithshme e sigurisë në botë gjatë dhjetëvjeçarit të fundit ka ndryshuar në mënyrë dramatike¹². Ndërsa janë fashitur kërcënimet e vjetra, vendin e tyre e kanë zënë sfida të tjera, të reja dhe shumë më të frikshme. Disa segmente të krimit të organizuar si, terrorizimi, trafiket e paligjshme, shfrytëzimi i qenieve njerëzore, korrupsioni i zyrtarëve të lartë, etj., kanë sjellë pasoja të rënda jo vetëm në jetët njerëzore, por edhe në pastabilitetin ekonomik e politik si dhe në sigurinë e vendeve me demokraci të brishtë.

Përveç progresit, në Ballkanin Perëndimor, ka pasur edhe regrese e sfida të vështira si p.sh. : tronditje sociale, anarki, dhunë, cenime kushtetuese deri në rrezikim të sigurisë e integritetit të vendit dhe rajonit. Pra, siguria e trazuar, është produkt i një bote të trazuar. Shtetet e vogla, për të siguruar paqen duhet të përdorin strategjitë e balancimit të pushteteve, gjë që është thelbësore dhe kërkon që të gjitha shtetet e mëdha, si të Lindjes ashtu edhe të Perëndimit, të ndikojnë ekonomikisht në ekzistencën e shteteve të vogla dhe të mesme. Ndërsa diplomacia si arti i miqësisë është mjeti më i sigurt për një shtet të vogël, për të përballuar kërcënimet e jashtme. Përderisa një shtet i vogël nuk është në gjendje të përballojë një konflikt me forcat e veta, rruga e vetme mbetet lufta diplomatike për të shmangur ose ulur rrezikun e konfliktit. Kosova, pas shpalljes së pavarësisë, më 17 shkurt 2008, ka qenë në masë të madhe paqësore dhe e stabilizuar,

¹⁰ Berkowitz, Bruce. "Information Warfare: Time to Prepare". *Issues in Science and Technology*. *Issues in Science and Technology*, Vol. 17, No. 2, Winter 2000, f.35.

Online, (Winter 2000), <http://www.nap.edu/issues/17.2/berkowitz.htm>.

Parë për herë të fundit: dt. 11.2.2016.

¹¹ Berkowitz, *Information Warfare*... , f.37.

¹² Viano, Emilio C, (red.). *Global Organized Crime and International Security*. Farnham (Surrey, United Kingdom): Ashgate Publishing, 1999, f. 230.

por bashkësia ndërkombëtare, nuk ka ofruar mbështetje adekuatë për të garantuar sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës dhe për të siguruar shmangien e çdo përpjekjeje që synon ndarjen e vendit. Misioni i EULEX-it është përballur edhe me më shumë sfida, ku më kryesoret konsiderohen: përgjithësimi, përkatësisht paqartësia e funksioneve ekzekutive të EULEX-it, ekzistenca e një gjendje jo të qëndrueshme të sigurisë në vend, funksionimi i sistemit trepalësh të pushtetit (UNMIK- EULEX- Institucione të Kosovës), çështja e personave të zhdukur, përbërja heterogjene e Misionit të EULEX-it etj. Ndërsa, dështimet kryesore i referohen çështjes së mbetjes së disa zonave të Kosovës jashtë juridiksionit të autoriteteve të ligjshme të vendit, vazhdimësisë së funksionimit të strukturave ilegale serbe, funksionimit të shërbimit sekret serb, mosdemilitarizimit të vendit nga armët e paligjshme, mosfunksionimit të punës së gjyqësorit në pjesën veriore të Mitrovicës, defekteve në funksionimin e pikave doganore 1 dhe 31 në pjesën veriore të Kosovës, etj..

Literatura

1. Sachs, Stephen E. *The Changing Definition of Security*. Oxford: International Relations, Merton College, 2003. http://www.stevesachs.com/papers/paper_security.html
Parë për herë të fundit: dt. 25.8.2016.
2. Francis, Stewart. *Development and Security*. Oxford: Queen Elisabeth House, University of Oxford, 2004.
3. Rajaratnam, S. *School of International Studies. Gjendet elektronikisht në:*
<http://www.ntu.edu.sg/rsis/teaching/MSc.asp#>.
Parë për herë të fundit: dt. 28.5.2016.
4. Molis, A. "The Role and Interests of Small States in Developing European Security and Defense". *Baltic Security and Defense Review*, Vol. 8, 2006.
5. Akram, Tanweer. *Ineffective Privatization of Public Enterprises: The Case of Bangladesh*. UN Public Administration Network, 1999.
<http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/APCITY/UNPAN024962.pdf>
Parë për herë të fundit: dt. 8.3.2016.
6. Gashi, Bejtush dhe Agron Jusufi. "Ekonomia e Sigurisë" (Ekonomia e Sigurnosti, sluëaj za analizu: Kosovo poslije rata). *International Studies, A Review of International Relations, Foreign Policy and Diplomacy*. Zagreb: The Center for International Studies, 2009.
7. *Siguria personale në Kosovë, domosdoshmëri për rishqyrtim gjithëpërfshirës*, (grup autorësh). Prishtinë: Instituti për Studime të Sigurisë dhe Integriteteve, "Katana", 2007.
8. Rugy, Veronique de, dhe Charles V. Peña. *Responding to the threat of smallpox bioterrorism: an ounce of prevention is best approach*. Washington, D.C. : Cato Institute, 2002.
9. Berkowitz, Bruce. "Information Warfare: Time to Prepare". *Issues in Science and Technology*. *Issues in Science and Technology*, Vol. 17, No. 2, Winter 2000.
Online, (Winter 2000), <http://www.nap.edu/issues/17.2/berkowitz.htm>.
Parë për herë të fundit: dt. 11.2.2016.
10. Viano, Emilio C. (red.). *Global Organized Crime and International Security*. Farnham (Surrey, United Kingdom): Ashgate Publishing, 1999.
11. Harden, B. Sheila (red). *Neutral States and the European Community*. London: Brassey's, UK, 2001.
12. Henk, Dan. "Human Security: Relevance and Implications". *Parameters*, Summer 2005.
13. Wolfers, Arnold. "National Security as an Ambiguous Symbol". *Political Science Quarterly*, Vol. 67, No. 4 (Dec.), 1952.
14. Talavs J. "Baltic States: Cooperation on Security and Integration into the European Security System". *NATO Research Fellowships*, 1996.
15. Wivel A. "Small EU Member States after Enlargement: A New Context of Foreign Policy Making". *ISA, 46th Annual Convention*, 2005.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit »

Emigracioni, trafikimi i qenieve njerëzore dhe pasojat në sigurinë kombëtare

Dr. Rruzhdil KUÇI

Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura
rruzhdil.kuci@aaf.mil.al

Abstrakt

Kjo trajtesë, që lidhet me tendencat më të rëndësishme globale sot, të cilat janë “globalizimi” dhe “revolucionit i informacionit”, kushte ku shoqëritë dhe kulturat ndërveprojnë me një ritëm të paparë deri më sot, nuk ka për qëllim vetëm njohjen me kërcënimet dhe rreziqet kryesore të kohëve të sotme, por të kuptuarit e shkaqeve, problemeve e rrethanave që çojnë në lindjen e këtyre kërcënimeve dhe rreziqeve. Mjedisi i sotëm i sigurisë është bërë më kompleks dhe më i pasigurt dhe përmban shumë kërcënime e rreziqe, të tilla si: emigracioni, trafiket e paligjshme, terrorizmi, përhapja e armëve të dëmtimit në masë, konfliktet rajonale, dështimi i shteteve, krimi i organizuar, kërcënimet dhe rreziqet natyrore. Ndarja e kërcënimeve, krijon një njohje më të gjerë e më të thellë për punën që duhet bërë nga strukturat kombëtare dhe ndërkombëtare për të përballuar emigracionin dhe trafiket e paligjshme si sfida të kohës, për të marrë masa, për të ruajtur vlerat kombëtare, sovranitetin kombëtar nëpërmjet forcimit të së gjitha institucioneve, si dhe për të reduktuar ndikimin e tyre te siguria. Zhvillimet strukturore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe pajisja me legjislacionin e nevojshëm për të luftuar emigracionin dhe trafiket e paligjshme është bërë në përputhje me zhvillimet kombëtare, rajonale e ndërkombëtare. Forcimi i masave të sigurisë ndaj problemeve të emigracionit dhe trafikeve të paligjshme është konsideruar si detyrë shumë e rëndësishme, në kushtet e realiteteve të përditësuar. Ashtu siç ndryshon mjedisi i sigurisë ashtu duhet bërë gjithë përgatitja, organizimi dhe pajisja me mundësi dhe aftësi për tu organizuar në ruajtjen e sigurisë. Anëtarësimi në organizatat e sigurisë kolektive (OKB, NATO, BE, OSBE) rrit aftësitë dhe mundësitë për të përballuar situatat e vështira që krijojnë kërcënimet dhe rreziqet e mësipërme. Sot, thuhet që mjedisi i sotëm i sigurisë është i rrezikuar, kërcënuar dhe favorizues për emigracionin dhe trafiket e paligjshme, por nuk duhet të harrojmë kurrë që marrja e masave që çon në forcimin e legjislacionit dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare çon në uljen e ndikimit të këtyre rreziqeve dhe kërcënimeve në siguri. Në këtë material, jam munduar të paraqes në mënyrë sa më të kuptueshme ecurinë e zhvillimit të emigracionit dhe trafiket e paligjshme, si dhe masat që duhen marrë, për rrugën që duhet ndjekur.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

Fjalëkyçe:

trafikim, emigracion, siguri kombëtare, globalizimi, trafiket e paligjshme.

1. Ç'është emigracioni dhe trafikimi i qenieve njerëzore?

Njerëzit emigrojnë, kur në vendin e tyre mungojnë burimet dhe mundësitë për të përmbushur nevojat dhe aspiratat e tyre. Migrimi ka qenë pjesë e zhvillimit të historisë njerëzore dhe në thelb ka qenë dhe mbetet, shprehja e dëshirës dhe vendosmërisë së individit, për të dalë mbi vështirësitë, me vështirimin e projektuar drejt një jete më të mirë për vete dhe familjen e tij. Në kohë dhe në etapa të ndryshme historike, kanë ndryshuar përbërja e flukseve migratore, qëllimet dhe motivet e kësaj lëvizje ndërkombëtare, drejtimet dhe senset e lëvizjes, për të ardhur në epokën tonë, të globalizimit. Kjo epokë, së bashku me lehtësirat në transport dhe komunikim ka sjellë edhe një rritje të numrit të njerëzve, që kanë jo vetëm dëshirën, por edhe aftësitë për të jetuar edhe punuar në vende të ndryshëm nga ai i origjinës. Lëvizjet e njerëzve nga një territor sovran në një tjetër kanë luajtur një rol thelbësor në historinë e njerëzimit. Kështu, popullsi të vogla morën përmasa madhore, ndërkohë që shtete të fuqishme janë dobësuar, apo forcuar, falë lëvizjeve ndërkombëtare të njerëzve. Bota do të kishte qenë krejt ndryshe pa modelet historike të emigrimit. Në kushtet e një vendi të varfër kur krijohen marrëdhënie me botën e zhvilluar, vihen re dy tendenca: së *pari*¹, punëtorët nga vendi i prapambetur, kanë prirje të punësohen në vendet e zhvilluara, pasi pagat në vendet e zhvilluara janë më të larta, së *dyti*, investitorët nga vendet e zhvilluara kanë prirje të investojnë në vendin e prapambetur, pasi në këto vende fitimet e tyre janë më të mëdha. Emigracioni ka luajtur dhe luan një rol shumë të rëndësishëm në sigurimin e

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit »

¹ Civici, Ardian. *Dilemat e zhvillimit: modelet e zhvillimit ekonomik dhe social përballë globalizimit*. Tiranë: Geer, 2007.

një pjesë të ardhurave për popullsitë dhe në përgjithësi ndikon në zhvillimin e vendit. Presioni për emigrim tek vendet e varfra është i lartë, sepse shpërblimi i punës është disa herë më i vogël se në vendet e tjera. Njohja e realitetit të migrimit eventualisht është një element i rëndësishëm, për të formuluar politikat dhe për të realizuar një zhvillim social dhe ekonomik të balancuar të vendeve të varfra dhe në zhvillim.

Flukset e emigracionit janë bërë më masive në shekullin XXI,² pasojë e konflikteve të ndryshme, e sidomos e atyre që shpërthyen në Lindjen e Mesme dhe kaosit politik që shoqëroi këto konflikte. Lëvizjet migratore kanë shkaqe të shumta,³ ato janë ekonomike, politike, demografike, ndryshime klimaterike etj. Ambicjet dhe motivet individuale për emigrim, janë përzier me faktorë dhe presion të jashtëm. Vetë terminologjia migratore është në zhvillim të vazhdueshëm. Për shembull, termi “trafikim i qenieve njerëzore” deri vonë, përdorej shumë rrallë në debatet për politikat migratore. Ndërkohë që sot, trafikimi i qenieve njerëzore është në krye të prioriteteve politike të shteteve, kur bëhet fjalë për menaxhimin e migracionit. Nevoja për një kuadër të plotë legjislativ dhe studime në këtë fushë lindi kryesisht pas viteve ‘90-të, si rezultat i përmasave që njohu emigrimi në këtë periudhë.

Edhe pse numri i emigrantëve në vendet të ndryshme vazhdon të mbetet i lartë, ajo që vihet re kohët e fundit, është rritja e emigracionit sezonal si edhe ndryshimi i raportit midis emigracionit të rregullt dhe atij të parregullt, në favor të emigracionit të rregullt. Së pari, kjo ndodh si pasojë e lehtësimit të marrjes së dokumentave në vendet pritëse. Së dyti, rritja e përshtatjes me kërkesat e tregut të punës në vendet pritëse i jep kësaj prirjeje një ndihmë të madhe. Krijimi i kontakteve si edhe mësimi i gjuhëve të vendeve, fqinje ka ndihmuar në mënyrë të konsiderueshme këtë proces. Së treti, zhvillimi i komunikimit me vendet pritëse ka luajtur një rol të rëndësishëm. Kjo është shoqëruar edhe me shtimin e pikave të kalimit kufitar, linjave të traqeteve, rritjen e numrit të fluturimeve, si dhe me përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Komunikimi me mediet e huaja është shtuar dhe është i vazhdueshëm, në ato vende, në të cilët shtetasit kanë qenë emigrantë. Një mënyrë për të parë ndikimin e migracionit në treguesit demografikë⁴ të një vendi, është shqyrtimi i ndryshimeve të popullsisë gjatë viteve. Ka shumë burime që japin informacione të ndryshme për ndryshimet e popullsisë. Regjistrat e popullsisë janë një nga metodat që përdoren për identifikimin e flukseve migratore. Kufizimi kryesor që vjen nga përdorimi i këtij burimi informacioni ka të bëjë me besueshmërinë e këtyre llojeve të dhënash sepse sistemi nuk është i kompjuterizuar dhe nuk pasqyron ndryshimet e shpejta të popullsisë.

Burime të tjera informacioni janë edhe vrojtimet. Vrojtimi i “matjes së standardeve të jetesës” përdoret shpesh për të vlerësuar përhapjen e kësaj dukurie⁵. Pasoja më negative e emigracionit është se shumë emigrantë detyrohen të rrinë me vite të tëra pa parë familjet e tyre, derisa të marrin dokumentet në shtetet e huaja ku jetojnë. Familjet janë copëtuar dhe gjymtuar fizikisht e shpirtërisht. Pasoja e dytë më negative, është se rriten në vende të huaja para kohe. Mundësitë për të krijuar familjen me një bashkëkombëse janë shumë të pakta. Vetmia dhe, në disa raste depresioni, i bren emigrantët. Një fenomen

² Po aty.

³ Annan, Kofi. *Raporti i OKB-së, viti 2005*. UN: 2005.

Gjendet elektronik në: www.un.org

⁴ INSTAT (Instituti i Statistikave, Republika e Shqipërisë). *Migracioni në Shqipëri*. Tiranë: INSTAT, 2014.

Gjendet elektronik në: www.instat.gov.al/media/241762/migracioni_ne_shqiperi.pdf

⁵ Po aty.

që ndodh shpesh është se komunitetet e emigrantëve nuk janë solidare dhe disa herë me të drejtë, njohja me emigrantë të tjerë nuk të lë të ecësh përpara sipas kërkesave të vendit në të cilin ndodhesh dhe ka raste që më shume të krijon probleme, sesa të përmbush nevoja shpirtërore që një shoqëri e pastër të plotëson. Në emigracion kanë dalë shumë nivele njerëzish dhe kjo e bën akoma edhe më të vështirë krijimin e miqësive me bashkëkombësit jashtë. Nëse do të lidhim si duhet migrimin me zhvillimin atëherë do ta bëjmë këtë dukuri të vyer. Emigrimi mund t'i privojë vendet e origjinës nga aftësitë më të mira dhe talentet e mendjet e shkëlqyera, siç mund të ndikojë në copëtimet, shpërbërjet e familjes, jo rrallë emigrimi shfrytëzohet për qëllime kontrabandimi dhe trafikimi të qenieve njerëzore, për të shkuar deri tek shfrytëzimi i flukseve migratore nga organizata kriminale dhe terroriste. Asnjëherë nuk është e tepërt të pohohet dhe ripohohet, se shumë prej problemeve mund të zgjidhen, përmes angazhimit, debatit, si brenda vendit duke përfshirë të gjithë aktorët kyç, ashtu edhe përmes një bashkëpunimi ndërkombëtar. Kjo do të shpinte në një njohje dhe të kuptuar më të mirë të përfitimeve të pamata që ofron emigrimi. Ish-Sekretari i Përgjithshëm i Asamblesë së Kombeve të Bashkuara, Kofi Anan, shprehej: “Asnjë prej nesh nuk i zgjidh i vetëm problemet e migrimit, por ama secili prej nesh mban në dorë një copëz të zgjidhjes së problemit; ka ardhur koha që t'i bashkojmë këto.”⁶ Jo gjithmonë përvojat migratore kanë qenë pozitive: migrantët e të dy gjinive, gjithnjë e më shumë po i ekspozohen shfrytëzimit dhe abuzimit nga ana e kontrabandistëve të qenieve njerëzore, si rezultat i rritjes së tensioneve sociale, fetare dhe kulturore në disa shoqëri, e shohin veten të përfshirë dhe përballë mureve të diskriminimit, ksenofobisë dhe racizmit. Fundi i shekullit të XX

-të dhe fillimi i shekullit të XXI-të prezanton një formë të re të skllavërisë njerëzore atë të trafikimit të tyre⁷. Trafikimi i qenieve njerëzore, si pjese e trafiqeve te paligjshme mund të cilësohet si skllavëria e kohëve moderne. Ky fenomen është i pranishëm si në vendet e zhvilluara ashtu dhe në vendet e varfra e ato në tranzicion. Trafikimi është një formë e kulluar skllavërie dhe pune të detyruar, abuzim i pushtetit të më të fortit ndaj më të dobët, gjendje ku një person a një grup personash kontrollojnë veprimtarinë e një personi tjetër me qëllime përfitimi dhe që funksionon duke përdorur mashtrimin, forcën ose rrëmbimin e personit. Trafikantët dhe viktimat e tyre kanë shpërndarje gjeografike në të gjithë botën⁸. Shkaqet e trafikut lidhen me faktorët ekonomikë (ekonomia e dobët), socialë (divorcet, dhuna në familje, lëvizja e lirë), politikë (destabilitet).

2. Faktorët dhe shkaqet që nxisin emigracionin dhe trafikimin e qenieve njerëzore

Faktorët nxitës të këtij trafiku janë: statusi i nënshtuar i grave, fitimet e mëdha që sjell ky trafik, politikat e dobëta, ligjet e dobëta dhe jo të plota. Ky shqetësim u bë objekt i konferencës së 12-15 dhjetorit 2000 në Palermo të Italisë ku u nënshkrua Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar. Politikat e emigrimit ndërkombëtar nuk ekzistojnë si të izoluar, të gjitha kanë pasoja globale. Tanimë, ne

⁶ Raporti i OKB-së, viti 2005. UN: 2005.

⁷ Barjaba, Kosta, Zyhdi Dervishi dhe Luigi Perrone. “L'emigracione albanese: spazi, tempi e cause”. *Studi Emigrazione*, XXIX, 1992, n° 107.

⁸ Perrone, Luigi, Kosta Barjaba dhe Georges Lapassade. *Naufraqi albanesi: studi, ricerche e riflessioni sull'Albania*. Roma: Sensibili alle Foglie, 1996.

kemi përqaftuar filozofinë se, politikat migratore nuk duhet të konsiderojnë vetëm aspekte ekonomike, por duke iu mbajtur shkollës së mendimit se emigrimi prodhon pasoja sociale, kulturore, madje edhe politike nuk është më, vetëm diçka mes të qenët i pasur, apo i varfër, por modelon vetë shoqëritë ku duam të jetojmë. Faktorët⁹ që ndikojnë (iniciojnë) në lëvizjet emigratore. Objekt studimi sot është bërë identifikimi i arsyeve për largimin nga vendi te emigrantëve. Faktori më i rëndësishëm që ka shtyrë emigracionin ka qenë faktori ekonomik, ku 67% e të pyeturve (anketuarve) përgjigjen se vështirësitë ekonomike, varfëria, kushtet e vështira të jetesës, ribashkimi me prestatët e tjerë të familjes dhe mundësia për jetesë më të mirë veçanërisht në disa zona ku mungojnë kushtet elementare si energjia elektrike, uji dhe strehimi, ishin arsyeja e parë për largimin e tyre.

Faktorët shtytës për largimin nga vendi janë, pamundësia e punësimit, e gërshtuar me kërkesat e tregut të punës në vendet pritëse për krah të lirë pune në fusha si ndërtimi, bujqësia, turizmi, etj., është një faktor i madh shtytës për emigracionin e personave të pakualifikuar, nga ana tjetër, shumë emigrantë të kualifikuar, me diplomë universitare, kanë emigruar si rezultat i mungesës së punësimit në pozicione larg kualifikimit të tyre, niveli i ulët i sigurisë publike apo trazirave në vend. Ndër faktorët nxitës që përmenden gjerësisht në studime të ndryshme janë: rritja e ulët ekonomike e kombinuar me një pabarazi të dukshme në shpërndarjen e të ardhurave, mbipopullimi, presioni lidhur me pronësinë mbi tokën, kushtet e ambientit urban, konfliktet e armatosura, spastrimet etnike, abuzimet me të drejtat e njeriut, diskriminimi, trajtimi çnjerëzor dhe degradues, persekutimi apo frika nga persekutimi për shkak të racës, shtetësisë, bindjes politike, fesë apo përkatësisë në një grup social, katastrofat natyrore, degradimi ekologjik dhe keqqueverisja.

Lëvizjet migratore ndikojnë e në demografi, duke ulur numrin e përgjithshëm të popullsisë, i cili ka bërë që për vite me radhë popullsia të ketë pësuar rënie.¹⁰ Ulja e vazhdueshme e lindshmërisë ka qenë faktori i dytë që ka ndikuar në ritmet e ulëta të rritjes së popullsisë. Ndryshimet në përbërjen e grupmoshave të popullsisë pasqyrojnë ndikimin e emigracionit. Grupmoshat 20-40 vjeç përbëjnë numrin më të madh të emigrantëve, gjë që ka ndikuar si në ndryshimet në strukturën e grupmoshave të popullsisë ashtu edhe në nivelin e lindshmërisë. Ndikimi i emigracionit në ekonominë e vendit, është parësor. Emigracioni si dukuri ndikon në stabilitetin ekonomik të vendit duke tentuar të mbajë në nivele të ulëta papunësinë në vend dhe të zbusë pakënaqësinë që vjen si rezultat i kushteve të vështira social ekonomike. Kufizimi i mundësive për të emigruar, mund të çojë në rritjen e presionit nga shtetasit të cilët dëshirojnë të emigrojnë. Dërgesat e emigrantëve përbëjnë një nga shtyllat kryesore të ekonomive të vendeve të varfra, duke siguruar një hyrje të vazhdueshme të valutave të huaja në vend si edhe duke konsoliduar bazën për kursime dhe investime.

Orientimi i dërgesave¹¹ të emigrantëve përbën mekanizmin kryesor të uljes së varfërisë dhe rritjen e të ardhurave te familjet në veçanti. Ato jo vetëm që sigurojnë një mbështetje të rëndësishme ekonomike për familjet e emigrantëve, por edhe për stabilitetin shoqëror dhe ekonomik të vendit. Modeli i përdorur i dërgesave të emigrantëve, tregon se ato janë përdorur kryesisht për të plotësuar nevojat ditore si ushqim, veshje, etj.; së dyti, për të përmirësuar cilësinë e jetesës si pajisje elektronike,

⁹ Raporti i BE-së viti 2000.

¹⁰ Dervishi, Zyhdi, *L'emigracione albanese ...*

¹¹ Raporti i BSH-se viti 2009.

mobilitet shtëpish etj.; së treti, për zgjerimin dhe ndërtimin e shtëpive të reja. Po ashtu, një pjesë e vogël e dërgesave të emigrantëve përdoren për të ruajtur traditën, martesat etj., dhe mbahen në banka apo në shtëpi. Vetëm në disa raste, dërgesat e emigrantëve përdoren për të blerë prona të patundshme në sektorët e shërbimeve, bujqësisë, etj. Interesi i kohëve të fundit mbi dërgesat nga jashtë, është gjithashtu një reflektim i faktit se ato i fusin monedhë të huaj në vendet në zhvillim, aq shumë të nevojshme në këto vende, për të forcuar kursimet në valutë, importet e financës, si dhe për të rritur mundësitë e bankave për të financuar kreditë. Është shumë e vështirë që të bësh një llogaritje realiste dhe të saktë të flukseve të dërgesave, sepse bëhen jashtë mënyrave formale dhe në këtë mënyrë i shpëtojnë statistikave të së dhënave zyrtare të transferimit të kapitalit. Emigracioni ndikon në tregun e punës¹². Emigracioni ka një ndikim të madh në zhvillimin profesional të emigrantëve. Nga njëra anë, punësimi i emigrantëve në ekonominë e zhvilluar të vendeve pritëse i ka pajisur ata me një kulturë të përgjithshme të menaxhimit të punës, të etikës në punë, njohuri për sektorë të rinj të ekonomisë, me njohuri mbi teknikën dhe teknologjinë e fundit. E parë në këtë këndvështrim, kthimi i tyre do të shoqërohej me transferimin e aftësive të sipërpërmendura. Emigracioni ndikon në formimin e kulturës politike. Dukuria e emigracionit mund të ndikojë në nivelin e pjesëmarrjes së emigrantëve në zhvillimet politike në vend.¹³

Ata nuk mund të marrin pjesë në votime edhe pse përbëjnë një numër të madh të zgjedhësve, pasi nuk mund të votojnë në konsullatat jashtë vendit dhe duhet të udhëtojnë për në vendet e tyre, posaçërisht për këtë qëllim. Kjo ndikon në rezultatin e zgjedhjeve dhe mosangazhimin e tyre politik në tërësi. Jetesa jashtë vendit ndikon në formimin politik të emigrantëve dhe të afërmeve të tyre dhe në mendimin e tyre se sa kujdeset qeveria për emigrantët. Pjesa më e madhe e emigrantëve, jetojnë dhe punojnë në vende me sisteme të demokracisë liberale, duke i dhënë mundësi atyre të familjarizohen dhe të shprehen në atë sistem. Formimi i ndryshëm politik i emigrantëve që kthehen në vend do të ndikojë pozitivisht ndaj dukurive të tilla si klientelizmi, interesat vetjake dhe korrupsioni, duke përshpejtuar dhe duke siguruar qëndrueshmëri për vazhdimin e procesit të demokratizimit në vend. Emigracioni ndikon edhe në mundësinë dhe dëshirën e shtetasve për të udhëtuar lirisht jashtë vendit. Liberalizimi i regjimit të vizave konsiderohet si nivel më i ulët izolimi, si detyrë e qeverisë për të lejuar apo lehtësuar mundësitë për të udhëtuar jashtë vendit.

3. Pasojat e emigracionit, në ekonominë e vendit në politikën e brendshme, në sigurinë kombëtare

Emigracioni, rrezik për sigurinë kombëtare? Strategjitet e menaxhimit të flukseve migratore, përcaktojnë se largimi i paligjshëm i njerëzve nga vendi i tyre cenon sigurinë kombëtare. Pasojat negative të emigracionit klandestin janë: humbje jetësh, rrjedhja e pakontrolluar e inteligjencës, plakja artificiale e popullsisë, mungesa e dëshirës për të punuar si dhe forcimi i ndjenjës së largimit nga vendlindja. Fenomeni i emigracionit drejt vendeve të tjera të botës, me të cilin po përballet gjithnjë e më shumë shoqëria e

¹² Po aty.

¹³ *Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë*, Tiranë: 2014.

Versioni elektronik në:

http://www.mod.gov.al/images/PDF/strategjia_sigurise_kombetare_republikes_se_shqiperise.pdf

sotme, është klasifikuar si një rrezik kombëtar, për zhvillimin ekonomik-social të shoqërisë, si dhe për sigurinë e saj në të ardhmen, mbi të gjitha, emigrimet klandestine drejt vendeve Perëndimore, cilësohen se paraqesin një rrezik real për të sotmen dhe të ardhmen. Të gjithë ne që jetojmë në këtë shoqëri, jemi dëshmitarë të flukseve migratore. Çdo ditë shihen lëvizje masive të popullsisë drejt qendrave të mëdha urbane¹⁴. Kjo zhvendosje ka një kosto të madhe për shoqëritë dhe shoqërohet nga probleme, konflikte dhe ngjarje të pandodhura dhe të paparashikuara më parë. Siguria kombëtare dhe të drejtat e migrantit përbëjnë shqetësimin primar të shteteve, në politikën e tyre për pranimin e të huajve. Shpesh, siguria kombëtare interpretohet në mënyrë të zgjeruar, duke përfshirë edhe sigurinë ekonomike, identitetin kulturor e fetar, sigurinë e mjedisit, krahas rendit publik, social e politik, apo mbrojtjes kundër krimit të organizuar dhe terrorizimit. Në këto kushte, respektimi i të drejtave të migrantit kundrejt sigurisë kombëtare, mund të jetë i suksesshëm vetëm në rast se standardet dhe garancitë ndërkombëtare trupëzohen në legjislacionin e brendshëm. Ky është një parakusht, për zbatimin efektiv të politikave migratore dhe administrimin e migracionit. Çdo kufizim i të drejtave të migrantëve duhet të parashikohet nga legjislacioni i brendshëm. Çështjet e sigurisë, shpesh janë përdorur si alibi për të kufizuar apo pezulluar të drejtat e migrantëve.

Me zgjerimin e veprimtarisë së krimit të organizuar dhe terrorizmit, është shtuar doza e dyshimit ndaj migrantëve, të cilët shpesh konsiderohen si "armi" potencialë. Këto dhe shumë çështje të tjera, e kanë koklavitur realitetin aq sa, shumë njerëz e shohin si të pashpresë daljen nga kaosi dhe ndërtimin e një jete ku forca e ligjit do të mbizotërojë mbi çdo gjë tjetër dhe ku veprimi i çastit do t'ia lërë vendin zgjidhjeve të studiuara në bazë të strategjive të qarta të zhvillimit. Për më tepër, mungon vullneti i politikës për t'i nxjerrë vendet nga bataku i kor-rupsionit, informalitetit dhe çdo gjëje tjetër të paligjshme. Më duhej ta theksoja këtë, për të dalë te fakti se sa shumë punë ju duhet institucioneve të shteteve, shoqërisë civile, shoqërisë në tërësi dhe çdo individi për t'i sjellë vendet në parametrat e një shoqërie të civilizuar që synon t'i bashkohet familjes së madhe globale. Për fat të keq, sa më thellë zhytesh të hulumtosh në realitetin e sotëm të shoqërisë, aq më shumë takon polarizimin e jetës, varfëri-në, nganjëherë të skajshme, takon injorancën dhe mentalitetin e prapambetur. Sfidat kyçe për përparimin e vendeve përfshijnë, konsolidimin fiskal, përmirësimin e menaxhimit të shpenzimeve publike, reforma rregullatore dhe institucionale, zvogëlimin e mangësive infrastrukturore dhe përmirësimin e efikasitetit të sistemeve të mbrojtjes sociale dhe shërbimeve kyçe shëndetësore. Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, vijnë të ndihmojnë në zvogëlimin e mangësive infrastrukturore në mënyrë të qëndrueshme fiskale, më specifikisht duke rritur investimet private dhe nxitur partneritetin privat publik. Përmirësimi i efikasitetit të sistemeve të mbrojtjes sociale dhe shërbimeve shëndetësore, në mënyrë që rritja ekonomike të bëhet përfshirëse për të gjithë, vijnë të jetë prioritet, në një periudhë kur perspektiva ekonomike është më e dobët.

4. Politikën dhe programet në kuadër të lëvizjeve migratore

E drejta për të lëvizur, është një e drejtë themelore e individit, e njohur dhe e

¹⁴ INSTAT (Instituti i Statistikave, Republika e Shqipërisë). *Shqipëria në Shifra 2010*. Tiranë: INSTAT, 2010.

pranuar në shumë instrumente ndërkombëtarë si dhe nga legjislacioni i brendshëm i shumë shteteve. Megjithatë, e drejta për të lëvizur lirisht, gjendet përballë autoritetit të shteteve për të pranuar apo lejuar lëvizjen. Kjo, e thënë në kuptimin që, shtetet kanë si detyrimin për të menaxhuar apo lehtësuar lëvizjen, ashtu edhe autoritetin për të rregulluar çështjet migratore brenda territorit. Në fakt, tradicionalisht pushteti i shteteve për çështjet migratore është gati absolut, me kufizime modeste në kuadrin e së drejtës ndërkombëtare. Për shkak të zhvillimeve galopante të fenomenit migrator, shtetet kanë filluar ta zgjerojnë gamën e të drejtave të migrantëve duke kapërcyer shpesh edhe standardet e parashikuara në të drejtën ndërkombëtare. Dy janë parimet themelore që gjithmonë e më shumë po kufizojnë autoritetin e shtetit në trajtimin e çështjeve migratore: parimi i “mosdiskriminimit” dhe ai i “moskthimit”, të cilët janë tashmë pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare. Shtetet kanë përgjegjësinë për sigurimin e shëndetit, sigurisë dhe mirëqenies ekonomike të popullsisë së tyre.

Për pasojë, politikat e tyre migratore marrin në konsideratë interesat publike me qëllim sigurimin e të mirave për qytetarët e tyre si, shëndetin, sigurinë, mirëqenien ekonomike. Në këtë kuadër, shtetet kanë autoritetin final për të vendosur kriteret mbi personat që lejohen të hyjnë dhe ata që mund të qëndrojnë, në përputhje me interesat kombëtare si edhe në përmbushje të kërkesave të traktateve për të drejtat e njeriut. Tradicionalisht, shtetet kanë tentuar të reduktojnë pranimin hyrjen e të huajve duke forcuar kriteret për dhënien e vizës apo lejimin e hyrjes, në përputhje me interesat kombëtare dhe presionin e brendshëm ndaj fuqisë punëtore të huaj. Kjo tendencë, vihet re sidomos në periudha të rënies së ekonomisë, tregut të punës, etj. Shtetet, kanë përgjegjësi jo vetëm ndaj individit, por edhe ndaj shteteve të tjera, për të pranuar shtetasit e tyre. Askush nuk mund të pengohet të dalë lirisht jashtë shtetit, - kjo është më e hershme sesa detyrimi i shteteve për të respektuar lirinë e lëvizjes, parashikuar nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.

Përgjegjësia për të pranuar kthimin e shtetasve, qëndron edhe në rastin kur personi reziston dhe nuk pranon të kthehet në atdhe, përveç rasteve kur ekziston frika nga përndjekja ose persekutimi në vendin e shtetësisë, gjë që do ta detyronte shtetin pritës të respektonte parimin e moskthimit. Shtetet e tranzitit, tradicionalisht nuk kanë qenë të detyruar të pranojnë të huajt që kanë kaluar tranzit. Autoriteti shtetëror, gjendet përballë normave ndërkombëtare, edhe për sa i përket aspekteve procedurale që shoqërojnë procesin e largimit, të cilat janë më rigorozë sesa ato mbi pranimin. Sidoqoftë, edhe këto kufizime janë modeste, pasi i lënë hapësirë të gjerë shteteve në këtë drejtim. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike në nenin 13-të të saj parashikon se: “Një i huaj që jeton në mënyrë të rregullt në një territor, mund të dëbohet prej aty vetëm në përputhje me ligjin dhe përveç rasteve kur interesat e larta të sigurisë publike e kërkojnë ndryshe, do t’i jepet mundësia të parashtrijë argumentet kundër dëbimit si edhe akses për ta çuar çështjen përpara një autoriteti, një personi apo grupi personash të caktuar posaçërisht për këtë punë nga autoriteti kompetent.

Garancia procedurale aplikohet vetëm në rastet kur personat janë me qëndrim të ligjshëm në territor dhe nuk mbulon hyrjet klandestine apo personat që janë në kufi dhe aplikojnë për pranim”.¹⁵

Një numër gjithmonë e më i madh shtetesh, duke përfshirë dhe ata që kanë qenë oponentë të fuqishëm të dyshtetësisë, tashmë po shkojnë drejt pranimin dhe, në shumë

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

¹⁵ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Publike. Versioni elektronik në: <http://www.punetejashme.gov.al/al/dokumenta/konventa-dhe-raporte-per-te-drejtat-e-njeriut>

raste, të inkurajimit të dyshtetësisë për shtetasit e tyre që kanë jetuar gjatë në shtete të tjera. Me miratimin dhe adoptimin e instrumenteve të së drejtave të njeriut¹⁶, në çdo vend duhet të ngrihet një strukturë e pavarur për të monitoruar zbatimin e ligjeve dhe të kërkojë dëmshpërblim apo rivendosje në vend të së drejtës së dhunuar. Strukturat monitoruese të pavarura janë shumë të rëndësishme, pasi sigurojnë që qeveritë do të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre dhe, se çdo shkelje e së drejtës, do të shpallet publikisht. Në këtë mënyrë, krijohet një mundësi më shumë për të detyruar strukturat shtetërore që të respektojnë normat e nxjerra prej atyre vete, në të kundërt do të mbajnë përgjegjësi. Përveç strukturave monitoruese, në çdo shtet duhet të ekzistojë e drejta e informimit dhe transparenca.

Një qeveri e hapur, objekt i investigimit do të jetë e përgjegjshme për veprimet e veta dhe përgjegjëse për shkeljet. Nga ana tjetër, informimi dhe transparenca krijojnë mundësi për trajnimin e publikut me të drejtat dhe detyrimet e tyre, gjë që potencialisht ndihmon në respektimin e legjislacionit dhe në rast shkeljeje nuk e vendos subjektin përballë procedurave arbitrare, por i paralajmëruar me kohë për pasojat e veprimeve të tij, ai do të mbajë përgjegjësinë përkatëse. Në rast shkeljeje, reagimi nga organet shtetërore duhet të jetë proporcional, në përputhje dhe në raport të drejtë me shkeljen. Në bazë të parimit të proporcionalitetit, kur ndaj qytetarit merren masa të cilat mund të dhunojnë të drejtat e njeriut, këto masa duhet të rishikohen në baza të rregullta nga struktura të pavarura shtetërore. Masat përjashtuese duhet të ngelen përjashtuese vetëm në rast se janë të domosdoshme për shkak të situatës, në periudha emergjencash apo në kohë lufte. Nga ana tjetër, në bazë të parimit të proporcionalitetit, masat duhet të jenë specifike dhe të mirëpërcaktuara dhe jo të përgjithshme dhe arbitrare.

Çështjet migratore historikisht janë trajtuar në nivelin kombëtar, duke bërë që legjislacioni migrator të jetë kryesisht i brendshëm. Me zgjerimin e lëvizjeve migratore, u pa se ishte i pamundur rregullimi i këtij fenomeni vetëm me kuadrin legjislativ kombëtar në një kohë kur nevoja për bashkëpunim dhe veprime të përbashkëta¹⁷ bëhej më emergjente. Kjo çoi në hartimin dhe miratimin e akteve ndërkombëtare migratore. E drejta migratore ndërkombëtare, në themel të saj ka përgjegjësinë ndërkombëtare të shteteve, gjë që kufizon autoritetin tradicional të tyre për sa i përket çështjeve migratore, në bazë të një parimi themelor dhe të pranuar gjerësisht se, e drejta ndërkombëtare qëndron mbi të drejtën kombëtare. Shtetet duhet të japin një justifikim të pranueshëm për dallimet e parashikuara në aktet ligjore apo në praktikë.

Pavarësisht nga klauzola antidiskriminim, dallimet midis shtetasve, migrantëve afatshkurtër, migrantëve afatgjatë, migrantëve të rregullt dhe të parregullt, të cilat pranohen gjerësisht nga komuniteti i shteteve, për sa kohë që nuk prekin thelbin e të drejtave të njeriut dhe kanë një bazë racionale si justifikim për çështjen, janë të pranueshme. Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, në kuadër të projektit “Mbështetje për zbatimin e Strategjisë për Migracionin”, financuar nga Komisioni Evropian, ka parashikuar mbështetjen për krijimin dhe vënien në funksionim të një sistemi koordinimi dhe monitorimi. Sistemi do të përmbajë një sërë instrumentesh monitorimi dhe mekanizmash raportimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse për zbatimin e masave të parashikuara në strategji dhe në planet kombëtare të veprimit për migracionin, në këtë fushë përfshihet kontrolli kufitar, masat kundër trafikëve të

¹⁶ Konventa Ndërkombëtare e Mbrojtjes të së Drejtave të Njeriut. Versioni elektronik në:
<http://www.puneteshashtme.gov.al/al/dokumenta/konventa-dhe-raporte-per-te-drejtat-e-njeriut>.

paligjshme, çështjet që kanë të bëjnë me hyrjen, qëndrimin dhe largimin e të huajve, etj. Zhvillimi i politikave të Bashkimit Evropian¹⁸ është angazhuar në mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve në përgjithësi. Ajo synon *së pari* t'u sigurojë shtetasve të vendeve të treta *qëndrim* të ligjshëm në vendet e Bashkimit Evropian të *drejta* të barabarta me ato të shtetasve të BE-së, siç është pranuar nga përfundimet e takimit të Tamperes, në tetor 1999. Mbi këtë bazë janë miratuar disa direktiva që rregullojnë njëkohësisht edhe pranimin në BE dhe të drejtat e njerëzve të pranuar. *Synimi i dytë* i politikës, është që të *mbrojë* të drejtat e shtetasve të vendeve të treta nëpërmjet parimit të trajtimit të barabartë. Janë miratuar edhe dy instrumente ligjorë, direktiva e 29 qershorit të vitit 2000 në zbatim të parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave, pavarësisht nga origjina racore dhe etnike dhe direktiva e nëntorit të vitit 2000, që përcakton një kuadër të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion. *Së treti*, zhvillimet e kohëve të fundit në mënyrë të veçantë nevoja për të luftuar episodet shqetësuese të intolerancës, ksenofobisë dhe shfrytëzimit, synojnë përfshirjen e integritit të shtetasve të vendeve të treta në politikën e imigracionit¹⁹.

Një komunikatë për imigracionin, integrimin dhe punësimin është miratuar nga Komisioni Evropian në 3 qershor 2003 dhe është pasuar nga raporti i parë vjetor për migracionin dhe integrimin në 16 korrik 2004. Ndërmjet shteteve anëtare është krijuar një rrjet pikash kontakti për integrimin. Një nga faktorët, ndoshta më i rëndësishmi, që ka ndikuar pozitivisht në pozicionin e emigrantëve, ka qenë pajisja me dokumente të rregullta, e kryer nga vendet pritëse. E drejta migratore e Bashkimit Evropian është relativisht e re, por ka ecur me hapa galopante për t'ju përgjigjur zhvillimeve të migracionit në Evropë. Politikat e Bashkimit Evropian në tërësinë e tyre synojnë forcimin e Bashkimit Evropian si një zonë e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Integrimi evropian i ka themelet tek vlerat e përbashkëta.

Që nga origjina, Bashkimi Evropian ka vënë theksin në promovimin e lirisë, të drejtave të njeriut, institucioneve demokratike dhe sundimin e së drejtës. Këto vlera janë të domosdoshme për të siguruar paqen dhe prosperitetin e Bashkimit Evropian dhe trajtohen si parakusht për të gjitha përpjekjet që do të ndërmerren në kuadër të zgjerimit të Bashkimit Evropian. Integrimi i shtetasve të vendeve të treta, konsiderohet si një nga faktorët kryesorë për përfitime maksimale nga migracioni. Bashkimi Evropian po e trajton me rëndësi prioritare integrimin e shtetasve të vendeve të treta, duke synuar krijimin e një kuadri të përbashkët për integrimin. Pranimi i shtetasve nga vendet e treta për qëllime studimi apo trajnimi është parë tradicionalisht në mënyrë të favorshme, veçanërisht për sa u përket studimit në arsimin e lartë.

4.1 Ndhma sociale²⁰

Në përpjekje për t'i ofruar refugjatëve një trajtim njerëzor dhe dinjitoz, konventa parashikon një sërë masash që duhet të marrin shtetet lidhur me mirëqenien e tyre. Në mënyrë të veçantë, Konventa kërkon nga shtetet të miratojnë në legjislativet e tyre dispozita që i trajtojnë të huajt njësoj me shtetasit në lidhje me kufizimet ushqimore, ne rast se në një shtet gjendet në situatë të vështirë për produkte të caktuara, arsimin fillor,

¹⁷ Raporti i OKB-së për çështjet migratore, viti 2009.

¹⁸ Raporti i BE-së për çështjet migratore, viti 2003

¹⁹ Raporti i BE-së viti 2000, Komunikate e Tamperes.

²⁰ Banka e Shqipërisë, raport i vitit 2008

ndihmën publike, legjislacionin e punës dhe sigurimet shoqërore. Ndërkohë, për çështjet e strehimit dhe arsimit të mesëm dhe të lartë, refugjatët, në bazë të Konventës kanë të drejtë për trajtim.

Angazhimi i qeverive të vendeve që kanë të zhvilluar procesin e emigracionit, për t'i dhënë fund krimit ndërkufitar, migracionit të paligjshëm, kontrabandës, trafikimit në përgjithësi dhe trafikimit të qenieve njerëzore në veçanti, nëpërmjet forcimit të kontrollit kufitar, është parë domosdoshmëri jetike. Qeveritë duhet ta konsiderojnë menaxhimin e kufirit jo vetëm si një detyrim ndaj shtetasve të saj, por gjithashtu si një çështje që ka ndikim të drejtpërdrejtë në marrëdhëniet me vendet e tjera. Plani i masave për përmirësimin e lëvizjes së lirë të njerëzve është një tjetër dokument i rëndësishëm. Kuptimi i "lëvizjes së lirë"²¹ ka nevojë për t'u shpjeguar, ajo nuk mund të merret në kuptimin që ka në të drejtën Evropiane pasi një e drejtë e tillë në parim mund t'i garantohet shtetasit të një vendi pas pranimit të tij në Bashkimin Evropian.

E drejta komunitare mbi qëndrimin, përbëhet si nga akte që rregullojnë dokumentacionin dhe çështjet procedurale të cilat përfshijnë lejet e qëndrimit dhe informacionin që ato duhet të përmbajnë, edhe nga aktet që rregullojnë çështjet substanciale si p.sh., statusin, të drejtat dhe detyrimet e rezidentëve dhe në veçanti rezidentët afatgjatë. Nisur nga nevoja për harmonizimin e formatit të lejeve të qëndrimit dhe elementëve të sigurisë së tyre, me qëllim që të jenë të përshtatshme për përdorim nga të gjithë shtetet anëtare në kuadrin e një politike të harmonizuar të migracionit, është prezantuar një format uniform dhe janë adoptuar standarde të përbashkëta për plotësimin e tij. Nga ana tjetër, BE konsideron në interes të së gjithë aktorëve të përfshirë, integrimin e shtetasve të vendeve të treta në shtetet anëtare. Në këtë aspekt, janë marrë masa legjislative për lehtësimin e procesit të integritit.

Së fundmi, Bashkimi Evropian është orientuar drejt masave që e luftojnë migracionin e paligjshëm që në burim, nëpërmjet zhvillimit të metodës së "aktorëve në zinxhir"²² në të cilin vendet e origjinës, tranzitit dhe të destinacionit janë përfshirë në faza të ndryshme të procesit. Në çdo rast, hartimi i politikave për luftën ndaj imigracionit të parregullt, merr në konsideratë detyrimet e shteteve anëtare përballë të drejtës ndërkombëtare dhe konventave për të drejtat e njeriut. Komuniteti Evropian i jep përparësi mbrojtjes së të drejtave themelore, mosdiskriminimit dhe mundësive të barabarta për të gjithë. Ky angazhim është shprehur qartë edhe në Strategjinë kundër diskriminimit dhe krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë.

Të drejta të tilla si, barazia përpara ligjit dhe mosdiskriminimi janë të drejta universale dhe të njohura nga shumë instrumente ndërkombëtare si, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe ajo mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore si edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, të cilat janë nënshkruar nga të gjithë shtetet anëtare. Lëvizja e lirë e njerëzve dhe krijimi i një zone lirie, drejtësie dhe sigurie kërkojnë natyrshëm një lëvizje të lirë të informacionit dhe të dhënave personale ndërmjet shteteve anëtare. Ky proces, do të jetë efektiv dhe i suksesshëm vetëm në rast se do të garantohet mbrojtja e këtyre të dhënave në mënyrë të unifikuar në të gjithë shtetet anëtare të BE-së.

²¹ Raport, Dokumenti i BE-së.

²² Po aty.

4.2 Ndikimi i krizës globale financiare mbi migracionin

Kriza aktuale financiare në botë nga pikëpamja e kohëzgjatjes dhe intensitetit është e vështirë të parashikohet, por ndikimi i saj pritet të variojë në varësi të vendit, rajonit gjeografik dhe sektorit të punësimit. Gjatë rënies ekonomike, punëtorët migrantë janë të parët të cilët humbasin vendet e tyre të punës. Ndërsa një pjesë prirën të largohen drejt vendeve të tyre të origjinës, politikat të cilat synojnë dërgimin e migrantëve në vendlindje nuk përbëjnë një zgjidhje të situatës dhe mund të kenë efekte rrënuese për zhvillimin, duke pasur parasysh nivelin e dërgesave në para, të cilat pritej të arrinin në 283 miliardë dollarë për vendet në zhvillim gjatë vitit 2015 si dhe të niveleve tashmë të larta të papunësisë në këto vende. Kërkesat për të reduktuar flukset migratore në vendet e destinacionit bazohen në perceptimin e gabuar se “migrantët zënë vendet e punës” ose se “ata konkurrojnë për përfitime sociale”, kur në fakt shumica e migrantëve krijojnë vende të reja pune dhe aktivitete ekonomike. Lëvizja e njerëzve, siç edhe nënvizohet në Raportin Botëror mbi emigracionin për vitin 2014, i bën ekonominë më dinamike dhe efektive. Emigracioni mund të jetë gjithashtu një forcë pozitive për lehtësimin e aspekteve të ndryshme të krizës financiare dhe potencialisht, përbën një kontribut të rëndësishëm për kapërcimin e rënies ekonomike. Përpjekja për ta luftuar krizën financiare nëpërmjet reduktimit të migracionit do ta përkeqësonte situatën. Pavarësisht nga kjo, vendet e origjinës pritet të përjetojnë një rikthim të migrantëve, gjë e cila mund të shkaktojë destabilizim ekonomik dhe social në vendet e varfra. Kjo do të rezultojë në fluks në rënie të emigracionit të punës dhe në fuqizimin e migracionit të paligjshëm dhe të trafikimit të qenieve njerëzore. Për këtë arsye, nevojiten politika fleksibile, koherente dhe gjithëpërfshirëse të administrimit të emigracionit, për të rritur përfitimet nga migracioni, për të mbrojtur migrantët dhe për të marrë në konsideratë nevojat e tyre gjatë zgjidhjes së krizës.

5. Masat për menaxhimin e flukseve të emigracionit

Nga masat më të domosdoshme për menaxhimin e flukseve të emigracionit mund të jenë:

a. Stabilizimi i plotë i jetës politike në vend, bazuar në vlerat e demokracisë; konsolidimi i institucioneve të shtetit²³ si dhe rritja e besimit të publikut ndaj tyre.

b. Përdorimi i të gjitha potencialeve kombëtare për arritjen e kohezionit kombëtar në të mirë të zhvillimit e të përparimit të vendit. Intensifikimi i politikës së jashtme në të mirë të zhvillimit e të përparimit të vendit dhe në mbrojtje të interesave kombëtare.

c. Parandalimi i krijimit të situatave potenciale të rrezikshme, që çojnë në konflikte të armatosura. Në rast të krijimit të këtyre situatave, të eliminohet përdorimi i forcës për zgjidhjen e tyre dhe të përdoren të gjitha rrugët diplomatike në aspektin dypalësh e shumëpalësh.

d. Të synohet vazhdimisht në mbajtjen e situatave në nivel sa më të ulët, deri në zgjidhjen përfundimtare të tyre.

e. Është e domosdoshme që të krijohen kushtet për një zhvillim ekonomik me ritme të larta nëpërmjet eliminimit të pasojave negative të ekonomisë informale.

²³ Raport i Qeverisë Shqiptare për masat e marra për forcimin e sigurisë institucionale, viti 2014.

f. Për sigurimin e një mbështetjeje financiare ndërkombëtare kërkohet vazhdimi i reformave ekonomike e veçanërisht në fushën legjislative.

g. Për të rritur besueshmërinë dhe prosperitetin në fushën ekonomike është kusht i domosdoshëm, për parandalimin e çdo veprimtarie të krimit financiar.

h. Bazuar në masat e sigurimi e të mirëbesimit, si rrjedhojë e integritit në strukturat euroatlantike, kërkohet mbajtja e kapaciteteve të mjaftueshme cilësore mbrojtëse. Ecuria në procesin e integritit euroatlantik do të ndikojë ndjeshëm në minimizimin dhe parandalimin e rreziqeve e të kërcënimeve serioze, për shkak të disnivelit ekonomiko-shoqëror brenda dhe jashtë vendeve.

Referenca

1. Civici, Ardian. *Dilemat e zhvillimit : modelet e zhvillimit ekonomik dhe social përballë globalizimit*. Tiranë: Geer, 2007.
2. Annan, Kofi. *Raporti i OKB-së, viti 2005*. UN: 2005.
Gjendet elektronik në: www.un.org.
3. INSTAT (Instituti i Statistikave, Republika e Shqipërisë). *Migracioni në Shqipëri*. Tiranë: INSTAT, 2014.
Gjendet elektronik në: www.instat.gov.al/media/241762/migracioni_ne_shqiperi.pdf
4. *Raporti i OKB-së, viti 2005*. UN: 2005.
5. Barjaba, Kosta, Zyhdri Dervishi dhe Luigi Perrone. "L'emigrazione albanese: spazi, tempi e cause". *Studi Emigrazione*, XXIX, 1992, n° 107.
6. Perrone, Luigi, Kosta Barjaba dhe Georges Lapassade. *Naufraqi albanesi: studi, ricerche e riflessioni sull'Albania*. Roma: Sensibili alle Foglie, 1996.
7. Raporti i BE-së, viti 2000.
8. Raporti i BSH-se, viti 2009.
9. *Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë*, Tiranë: 2014.
Versioni elektronike në:
http://www.mod.gov.al/images/PDF/strategjia_sigurise_kombetare_republikes_se_shqiperise.pdf.
10. INSTAT (Instituti i Statistikave, Republika e Shqipërisë). *Shqipëria në Shifra 2010*. Tiranë: INSTAT, 2010.
11. *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Publike*. Versioni elektronik në: <http://www.puneteshatme.gov.al/al/dokumenta/konventa-dhe-raporte-per-te-drejtat-e-njeriut>.
12. *Konventa Ndërkombëtare e Mbrojtjes të së Drejtave të Njeriut*. Versioni elektronik në: <http://www.puneteshatme.gov.al/al/dokumenta/konventa-dhe-raporte-per-te-drejtat-e-njeriut>.
13. *Raporti i OKB-së për çështjet migratore*, viti 2009.
14. *Raporti i BE-së për çështjet migratore*, viti 2003.
15. Raporti i BE-së viti 2000, Komunikata e Tampere.
16. Banka e Shqipërisë, *Raport i vitit 2008*.
17. Raport-dokumenti i BE-së.
18. Qendra e Botimeve Zyrtare. *Raport i Qeverisë Shqiptare për masat e marra për forcimin e sigurisë institucionale*, viti 2014.

Reflektime mbi arsimimin në fushën e sigurisë – përvoja, dinamika dhe sfidat e së ardhmes

Dr. Marenglen KASMI
marinkasmi@gmx.de

Prof. Asc. Kristaq XHARO
Universiteti Europian i Tiranës
kristaq.xharo@uet.edu.al

Abstrakt

Koncepti dhe mjedisi i sigurisë janë në evolucion të vazhdueshëm, të vullshëm e të pandërprerë. Skenarët ndryshojnë vazhdimisht dhe procesi i sigurisë bëhet gjithmonë e më kompleks. Mënyra më efektive për të parashikuar këto skenarë është të përgatitesh për ndryshimin. Në perëndim, institucione si universitete, akademi, kolegje, institute etj. angazhohen të studiojnë, shpjegojnë dhe të paraprijnë zhvillimet në fushën e sigurisë. Ato ju afrojnë institucioneve vendimarrëse analiza dhe rekomandime shkencore për dinamikat e zhvillimeve në këtë fushë. Në vendin tonë, aktualisht studimet e sigurisë nuk janë në periudhën e tyre më të mirë. Mungon mjedisi i zhvillimit të këtyre studimeve dhe vihet re një përgjumje e institucioneve përgjegjëse për sigurinë. Gjendja e arsimimit dhe studimeve në pikëpamje institucionale nuk i përgjigjet kënaqshëm statusit të përgjithshëm, në të cilën ndodhet dhe kërkohet të angazhohet vendi ynë, si në nivel rajonal e më gjerë, në aleanca apo në forume. Studimet e punimet akademike të sigurisë, janë e po bëhen gjithmonë e më të rralla. Në vend të thellimit dhe zgjerimit të kurrikulave bashkëkohore, ato pak institucione që angazhoheshin në arsimimin e kësaj fushe u paragjykan duke i orientuar ato drejt një koncepti të vjetruar të sigurisë, ku siguria shihej si një fenomen që zhvillohej vetëm brenda oborrit të kazermave ushtarake. Për të operuar me të njëjtin standard me partnerët, por edhe për të harmonizuar mënyrën e veprimit në nivel kombëtar, e vetmja rrugë për të përballuar sfidat shumëdimensionale në fushën e sigurisë mbetet arsimimi, kualifikimi dhe trajnimi me programe bashkëkohore. Institucionet akademike kanë rol parësor jo vetëm në kryerjen e këtyre studimeve, por edhe në krijimin e një mjedisi dhe klime të ngrohtë, bashkëpunuese dhe intelektuale për këto çështje.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit»

Fjalëkyçe:

arsimim, fusha e sigurisë, dinamika e sigurisë, sfidat e sigurisë.

1. Hyrje

Kohë më parë, Thomas Hobbes shkruante se “...pa siguri nuk ka vend për industri... për art, për letërsi, për shoqëri dhe çfarë është më e tmerrshme ... pa siguri reflektohet një ankth i pandërprerë, dhe rreziku i dhunshëm për jetën, vetmi, varfëri, mizerje, brutalitet dhe pamjaftueshmëri...”. Siguria është substance e jetës njerëzore. Të jesh i sigurt është të jesh i pashqetësuar nga rreziqet apo frika. Ndonëse autori i këtyre fjalëve i përket një periudhe tjetër, fjalët e tij janë aktuale edhe sot, madje në një formë tepër të spikatur. Kësisoj lind natyrshëm pyetja, nëse gjithë rreziqet aktuale që kërcënojnë sigurinë në ditët e sotme janë pjesë e studimit dhe vlerësimit me qëllimin final njohjen dhe mënjanimin në kohë reale të rrezikut që ato paraqesin ndaj sigurisë kombëtare dhe, në një koncept më të gjerë, edhe ndaj asaj ndërkombëtare. Parë në këtë këndvështrim, disa reflektime mbi arsimimin në fushën e Sigurisë si edhe përvoja, dinamika dhe sfidat e së ardhmes marrin një rëndësi të veçantë. Sigurisht, që trajtimi i kësaj tematike i kalon caqet e një kumtese modeste, por ajo çka do të trajtohet më poshtë synon të qartësojë së pari se, cilat janë dimensionet e sigurisë dhe koncepti i termit dhe si ka evoluuar ky koncept dhe pse është e rëndësishme të reflektohet ndaj këtij procesi. Ky trajtim paraprak çon në hapin tjetër të studimit, njëkohësisht dhe ai më i rëndësishmi, se si paraqiten studimet në Fushën e Sigurisë në vendin tonë, ku përkrah një prezantimi të gjendjes aktuale dhe së shkuarës, tentohet t’i jepet përgjigje pyetjes, nëse ka nevojë për një axhendë dinamike të studimeve në këtë fushë. Së fundmi jepen edhe disa përfundime. Si pasojë e rëndësisë që ka kjo temë, trajtimet janë të shumta, por në këtë kumtesë më së shumti janë përdorur burime të dorës së parë, siç janë Koncepti Strategjik i NATO-s, botimi i vitit 2010, Strategjia e Sigurisë Kombëtare, botimi i vitit 2014, si edhe autorë të tjerë të huaj si Colin Gray¹, Lidell

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit »

2. Dimensionet e Sigurisë dhe konceptimi i termit

Ekonomia dhe siguria vazhdojnë të dominojnë zhvillimin e shoqërisë në çdo kohë dhe në çdo sistem. Nga ky ndikim nuk ka “shpëtuar” as epoka jonë. Siguria vazhdon të mbetet një nga dilemat më të mëdha të shoqërisë. Globi nuk fitoi më shumë siguri edhe pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Që nga viti 1989, sipas UCDDP (një nga forumet më prestigjioze në çështjet e sigurisë) janë regjistruar 144 konflikte të armatosura në mbi 80 rajone, 47 prej tyre vlerësohen në përmasat e luftërave. Vetëm në 10 vitet e fundit numri i konflikteve aktive është rritur nga 31 në 37, ndërsa janë realizuar vetëm 6 marrëveshje për ndërprerje konflikti. Numri i viktimave të konflikteve të armatosura, që nga viti 1989 i kaluar të 6 milionë persona, prej nga, mbi 90% janë civil dhe 3 në 4 të vrarë janë fëmijë dhe gra. Më shumë se 50 milionë vlerësohet nga UNDP numri i refugjatëve që janë zhvendosur nga zonat e konfliktit.

Me fundin e Luftës së Ftohtë dhe zhvillimet drastike që e pasuan atë në lëmin politik, ekonomik dhe kulturor, u kuptua se përqafimi i një këndvështrimi të ngushtë mbi sigurinë, i parë kryesisht si një rrezik ushtarak që vinte nga jashtë, nuk ishte më i përshtatshëm. Përqendrimi tek aspekti ushtarak kishte lënë mënjanë studimin e çështjeve që kishin të bënin me ekonominë, politikat identitare, nacionalizmin, shtetet e dobëta apo të dështuara, konfliktet etnike, etj. Ndërkohë që konfliktet dhe krizat të cilat dominuan ambientin ndërkombëtar pas Luftës së Ftohtë, buronin nga problemet në fushat e theksuara më sipër. Për më tepër, siç thekson Kalevi Holsti, lufta brenda shtetit është kthyer sot në normën e re, ndërsa ajo ndërshtetërore në përjashtim. Ndryshimet në natyrën e luftës dhe ambientin politik ndërkombëtar, i nxiti studiuesit të zgjeronin gamën e rrezeve ndaj sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Situata e sigurisë, në ditët tona vazhdon të mbetet sfiduese dhe, e shoqëruar edhe me krizën ekonomike është kthyer në dilemë. Edhe pse janë të “ngrirë” momentalisht konfliktet ndërshtetërore, kjo pak e ka përmirësuar nivelin e sigurisë.

Konflikte me frymëzues aktorë joshtetëror, që nisen nga nivele periferike e nacionale po mbartin kapacitete për të vënë në rrezik sigurinë rajonale dhe më gjerë. Në mjedisin aktual të sigurisë, mjafton të veçojmë qoftë edhe tre zhvillime, në përmbajtje dhe në shtrirje në përmasat e krizave, që kanë pështjelluar thellësisht komunitetin ndërkombëtar. Ato, në përmasat e krizave rajonale, nuk lenë në periferi as vendin tonë. Konflikti në Lindjen e Mesme (Irak-Siri), zhvillohet jo më larg se 1000 km nga vendi ynë; ngjarjet në Ukrainë ndodhin jo më larg se 1300 km dhe kriza e refugjatëve pranë dhe brenda kufijve. Në përmasa gjeografike, këto zhvillime “mbërthejnë” vendin tonë në zonat e krizave. Në *vlerësim gjeopolitik, mjedisi ynë i sigurisë ndikohet direkt nga këto zhvillime në nivel të mjaftueshëm për të reflektuar. Nga të gjithë elementët vlerësues, vetëm media duket se ka ndier më shpejtë efektet e rrezikut dhe është sensibilizuar më shpejtë dhe më me shqetësim për efektet direkte*

¹ Gray, Colin. *War, Peace and International Relations: An Introduction to Strategic History*. Abingdon and New York: Routledge 2007.

² Hart, Liddell B. H. *Strategy*, (2nd rev. Ed). London: Faber & Faber 1967.

³ Clausewitz, Carl von. *On War, Oxford World's Classics*. New York: Oxford University Press, 2006.

⁴ Luttwak, Edward. *The Grand Strategy of the Byzantine Empire*. Cambridge, Mass.: Belknap Press of Harvard University Press, 2009.

të rreziqeve të sigurisë edhe në hapësirat shqiptare.

Shkencat politike nuk kanë mundur ende të japin një përkufizim përfundimtar dhe gjithëpërfshirës të termit siguri, ndonëse ky term, i përmendur gjithmonë e më shumë qysh prej viteve 1960, nënkuptonte më së shumti karakterin e një sigurie të brendshme. Vështirësia qëndron në faktin që siguria është shndërruar në një “term catch-all” i botës moderne.⁵ Kësisoj mund të thuhet se, ky term tashmë ka hyrë në çdo fushë dhe si pasojë është e vështirë të jepet një përkufizim gjithëpërfshirës. Po ashtu edhe në aspektin e politikës ndërkombëtare, termi siguri është i diskutueshëm. Me të nënkuptohet vendosja e prioritetëve në synimet politike dhe zgjedhja e mjeteve, me të cilat duhet të arrihen këto synime.⁶

3. Evoluimi i konceptit në mjedisin e sigurisë, nevojë për të reflektuar

Studimet akademike për çështjet e sigurisë kombëtare duket se i kanë fillimet e tyre në vitet ‘40 dhe sigurisht që Lufta e Dytë Botërore pati një ndikim katalitik në këtë drejtim. Siç ka shkruar studiuesi William Fox, në punimin e tij të hershëm, në këtë fushë, gjatë mesit të viteve 1950, “...pritej se pesëmbëdhjetë vjet të Luftës Botërore, por edhe të tensionit të pasluftës, me probleme të sigurisë kombëtare në qendër të interesit publik dhe qeveritar, do të kishin ndikim dhe do të linin gjurmë dominante në aktivitetet kërkimore e shkencore”⁷. David Baldwin, një tjetër studiues i njohur, madje shkon aq larg, sa i përshkruan këto vite të hershme si “...periudhën më emocionuese dhe krijuese në tërë historinë e studimeve të sigurisë.”, periudhë e cila shënoi edhe krijimin e shkollave të reja me fokus në sigurinë kombëtare. Për shkak se studimet e sigurisë nuk u konceptuan si një disiplinë e veçantë akademike në atë kohë, reflektoi në aludimin edhe nga një numër studiuesish, se ajo nuk arriti të shfaqej direkt si një disiplinë me kufij të përcaktuar qartë. Dhe kështu, ndoshta ajo për një kohë relativisht të gjatë, u ndesh më shumë se çdo disiplinë tjetër me “ndërthurje”, por edhe “ndërhurje” në disiplinat e tjera të shkencave politike, diplomatike, ushtarake e sociale.

Në të njëjtën kohë, një axhendë akute e dilemës së sigurisë, e cila më parë kishte dërguar spiralen e botës në dy konflikte katastrofike, motivoi një dëshirë për të njohur e zhvilluar kërkimet në aspektet e sigurisë kombëtare dhe globale. Si pjesë e kësaj përpjekjeje, integritet të ushtrisë me teknika jo vetëm ushtarake, por të ndërthurur me ato që përmendëm më lartë, ju dha një vëmendje e veçantë. Paralel, me këto zhvillime, ndoshta dhe në mënyrë të ngjashme, u bënë përpjeke intelektuale për të shqyrtuar çështjet e sigurisë edhe më thellë se ato ushtarake, por edhe në objektiva të tjera kombëtare, të tilla si mirëqenia ekonomike dhe liria individuale⁸.

Në ditët tona, koncepti i sigurisë evoluon dhe pasurohet aq shpejt, sa ndryshon dhe

⁵ Daase, Christopher. “Sicherheitskultur – Ein Konzept zur interdisziplinären Erforschung politischen und sozialen Wandels”. *Sicherheit und Frieden (S+F)*, 2/2011, 29. Jahrgang, S. 59 – 65.

Këtu, Christian Endreß, Nils Petersen, Die *Dimensionen des Sicherheitsbegriffes*, në: <http://www.bpb.de/politik/innenpolitik/innere-sicherheit/76634/dimensionen-des-sicherheitsbegriffs?p=all>, 14.09.2016.

⁶ Daase, Christopher, et al. “Internationale Risikopolitik”. *Der Umgang mit neuen Gefahren in den internationalen Beziehungen*. Baden-Baden 2002. Këtu: Christian Endreß, Nils Petersen: Die Dimensionen des Sicherheitsbegriffes.

⁷ Fox, William T. R. “Civil-Military Relations Research”. *The SSRC Committee and Its Research Survey*, vol.6, no.2, January 1954, f. 279.

⁸ Fox, *Civil-Military*, f. 278–288.

shkurton ciklet e hartimit të vetë strategjive apo dokumenteve strategjike, të cilat afrohen për të menaxhuar e parashikuar zhvillimet në procesin e sigurisë. Dihet që vendi ynë, nuk ka parametra të fuqisë për të ndikuar e për të qenë faktor i rëndësishëm në çështje të sigurisë rajonale dhe globale, duke filluar që nga parametrat ushtarakë, ekonomikë, social, etj. Në të kundërt, duke mos mundur të jetë aktivë i angazhuar në zonat e krizave, ai ka qenë e mund të vazhdojë të jetë tërësisht vulnerabël ndaj efekteve direkt apo të mëvonshme të këtyre zhvillimeve.

Pa hyrë në analizë dhe vlerësim, por thjeshtë me një vështrim të konfliktit në Lindjen e Mesme (ISIS), në vazhdim të idesë për konceptin dhe mjedisin e sigurisë, përsëri është e qartë, se konflikti ka ndikime direkt të afërta ose më tej, mbi vendin tonë. Vendi ynë, vërtetë, nuk ka kapacitete të fuqisë ushtarake (dhe vlerësohet që edhe për një të ardhme nuk do ti ketë), ndihmat tona në krah të koalicionit ushtarak kundër ISIS kanë qenë dhe do të mbeten modeste, kjo për aq sa varet nga ne. Edhe vlerësimet që na janë dhënë nga aleatët janë kryesisht në nivel inkurajues. Ndërkohë, ajo që mund dhe duhej të ishte kontributi ynë më i madh, që varej nga ne është fakti që në këtë situatë nuk kemi qenë të aftë për të kufizuar apo ndalur (edhe fizikisht) ata dhjetëra e qindra vullnetarë “foreign fighters”, që nga Shqipëria, trojet apo emigrimi t’i bashkohen ekstremistëve të ISIS. Për fat të keq nuk ka analiza të plota apo prognoza përse “vullnetarët” shqiptarë i bashkohen ISIS, apo nëse të tjerë do të vazhdojnë të shtohen. Masat e ndërmarra ligjore janë pozitive, por ato janë “muri” i fundit të llojit reflektiv dhe jo proaktiv. Si të tilla ato janë e do të mbesin detyrimisht të pamjaftueshme. Në këtë situatë, edhe nëse formacionet e ISIS mund të shpartallohen shpejt, kjo nuk do të mbyllë efektin e pasojave të fenomenit ISIS-it në vendin tonë. Edhe nëse në numër më të vogël “vullnetarët” shqiptarë një ditë mund të kthehen, mjedisi ynë i sigurisë, për shumë arsye, nuk do të jetë më tepër i shëndetshëm. Problematika do të vazhdojë të jetë duke ndikuar direkt në mjedisin e sigurisë së brendshme. Ndaj edhe koncepti i sigurisë dhe studimet që lidhen me të, do të duhet të evoluojnë në gjërësi dhe në thellësi.

Kriza e refugjatëve nga trojet shqiptare duket se trokiti në dyert e Europës pak më parë se kriza që sot konsiderohet tronditëse. Mbi 30 mijë shqiptarë morën rrugën e emigrimit brenda një periudhë të shkurtër duke ju shtuar gati mbi 30% të gjithë popullsisë, që është larguar më parë. Janë alarmante faktet, që konfirmojnë uljen e numrit të popullsisë: në 2011 ky numër është 7.7% më e vogël se në 2001, ose me 230 mijë persona më pak. Nëse vazhdon ky trend do të jemi në nivelin e kërcënimit të sigurisë kombëtare, kur popullsia e vendit tonë pas 10-15 vjetësh do të jetë sa 50% e asaj të viti 1990. Në situata të tilla, çdo vend në Perëndim e Lindje do të vlerësonte si një nga rreziqet më potenciale të sigurisë kombëtare dhe në mënyrë urgjente do të harton strategji për të shmangur rrezikun ndaj këtij elementi të fuqisë së kombit. Pati një debat pas dhe për regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, por ai çuditërisht u fokusua vetëm si shqetësim i disa komuniteteve fetare dhe disa të vetëquajtura pakica minoritare për reduktimin e numrit të tyre. Faktet që u përmendën më sipër janë kambana për fuqinë detyrimisht edhe sigurinë kombëtare dhe rishikimin e konceptit të sigurisë në një mjedis të ri.

Duket sikur konflikti në Ukrainë, për shqiptarët po ndodh larg, në një botë tjetër dhe mendohet se janë mjaftueshëm disa deklarata politike. Por, asnjë prej tyre nuk mund të plotësojë nivelin e analizave, studimeve dhe vlerësime për efektet e mundshme edhe procesin tonë të sigurisë. Skenari ukrainas sot vlerësohet nga shumica e studiuesve të huaj, si një skenar nga më të mundshmit, që do të mund të jetë rrezik potencial për

sigurinë, veçanërisht në shtetet e vogla dhe të brishta. Nuk paraqet habi fakti që, në shumicën e analizave perëndimore, veçanërisht atyre të shërbimeve inteligjente, vendet e Ballkanit, për më tepër të Ballkanit Perëndimor, klasifikohen si shtete të brishta. Vendi ynë nuk shmanget nga ky klasifikim. Skenari ukrainas, në çdo kohë mund të lulëzojë në vendet të cilat kanë pakica, minoritet, ndasi religjioze, diferenca sociale e kulturore, etj. Ky skenar, në Ukrainë, nuk mundi të zgjidhej për një kohë të shkurtër, ai vazhdon të jetë e sfiduar në kërkim të një zgjidhje, por që nuk duket të jetë e shpejtë. Ukraina, tashmë, po përdoret si një “case study”, ku angazhohen jo vetëm organizatat më të fuqishme ndërkombëtare, politika botërore por edhe mendjet më të shquara në çështjet e sigurisë si dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare (Kisinger). Ka ardhur koha që koncepti i sigurisë të evoluojë edhe mbi këtë skenar duke reflektuar jo vetëm thjesht për shkak të afërsisë gjeografike, sesa për arsye të përmbajtjes. Në një ambient politik anarkik ndërkombëtar raporti midis mjedisit të jashtëm e të brendshëm ishte paracaktuar në thelb nga njëra anë për të balancuar pushtete të fuqishme në sistemin ndërkombëtar dhe nga ana tjetër për të alokuar burime shtesë për sigurinë kombëtare⁹.

4. Përvoja studimore për Fushën e Sigurisë në vendin tonë

Deri pak kohë më parë, i vetmi institucion akademik që kish për objekt studimet në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes ishte Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”. Ky institucion përfaqësonte në të njëjtën kohë institucionin më të lartë arsimor në strukturat e sigurisë. Që prej fundviteve 1970, në bazë të një vendimi të Këshillit të Ministrave¹⁰, në këtë Akademi filluan kualifikimet pasuniversitare, të cilat fokusoheshin kryesisht në studime kërkimore në fushën e mbrojtjes. Kujtojmë gjithashtu se kandidatë nga struktura të tjera, si nga Policia e shtetit, Garda, Shërbimi Informativ deri edhe nga Ministria e jashtë me ndiqnin kurse kualifikimi në këtë institucion. Kjo periudhë korrespondon me kohën kur edhe në vende të tjera (Perëndim apo Lindje) studimet e mbrojtjes identifikoheshin me studimet e sigurisë. Akademia e Mbrojtjes kishte njëkohësisht edhe atributin në dhënien e titujve dhe gradave shkencore.

Pas viteve '90 u zhvillua prirja për të futur në objektin e studimeve një spektër më të gjerë se fusha e mbrojtjes. Bëhej fjalë për studimet e sigurisë. Bashkëpunimi me institucione homologe në perëndim kryesisht ato gjermane dhe amerikane, synuan t'i jepnin institucioneve akademike natyrën dhe përmbajtjen e këtyre vendeve që ishin në pararojë të mendimit teorik. Në vitet 2000, u poqën kushtet për programe dhe kurrikula të vendeve perëndimore, ndikuar edhe nga objektivat e integritimit të vendit në Aleancën veriatlantike. Kjo çoi në sanksionimin edhe ligjërisht të zgjerimit të fushës së studimit nga fusha e mbrojtjes në atë të sigurisë dhe mbrojtjes. Ky ishte njëkohësisht hopi cilësor në vend që, jo vetëm aplikoheshin studimet në këtë fushë, por edhe afroheshin në një cikël akademik me gjithë kontekstin e vet. Deri në vitin 2011, në këtë institucion u mbrojtën 14 punime nga fusha e sigurisë, që zinin 12.03% në vlerën totale të temave të doktoraturave të mbrojtura në këtë Akademi qysh në vitin 1982 (131 doktoratura), kohë kur u mbrojt edhe doktoratura e parë në këtë institucion.¹¹ Vala tjetër e evoluimit

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

⁹ Waltz, Kenneth. *Theory of International Politics*. New York: Random House, 1979.

¹⁰ Agolli, Agron. *Kualifikimi shkencor në Forcat e Armatosura 1974-2012*, Tiranë: Qendra e Botimeve Ushtarake, 2012, f. 10.

¹¹ *Ibid*, f. 14.

në fushën e studimeve të sigurisë dhe mbrojtjes vlerësohet rreth vitit 2010. E ripërfshirë, përsëri, në Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, në këtë Akademi rifilloi procesi i arsimit në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Sipas programit, të diplomuarit e këtij programi u pajisën me një paketë konceptesh teorike mbi marrëdhëniet ndërkombëtare dhe dimensionet e sigurisë kombëtare, rajonale, europiane dhe globale, mbi gjeopolitikën, mbi marrëdhëniet me publikun, me institucionet ndërkombëtare etj. Këto koncepte synojnë që të ndikojnë drejtpërdrejt në krijimin e specialistëve të aftë në institucionet e sigurisë kombëtare apo si ekspertë pranë autoriteteve publike, që operojnë në sferën e sigurisë kombëtare, sikurse në organizmat ndërkombëtare të profilit (OKB, NATO, BE, etj). Më tej, një pjesë e të diplomuarve, supozohej se duhej të formonte edhe elitën e studiuesve, pedagogëve dhe analistëve të ardhshëm për problemet e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Eksperienca e mëparshme 40 vjeçare dhe bashkëpunimi me institucione homologe perëndimore shërbeu si garant për suksesin e objektivave në këtë fushë. Por, pavarësisht nga sa më sipër, procesi u ndërpre duke krijuar kështu një vakum në këto studime.

Ndërprerja e studimeve në Akademi e këtij programi, bëri që një numër i konsiderueshëm i stafit pedagogjik të kualifikuar të orientohej drejt ofertës, çka mund të llogaritet në një investim të humbur të strukturave të sigurisë, si në pikëpamje financiare ashtu edhe në atë profesionale. Një përpjekje e lavdërueshme për të plotësuar këtë boshllëk të krijuar në institucionet arsimore shtetërore të studimit të Fushës së Sigurisë, po bëhet nga Akademia e Sigurisë, e krijuar rishtas me programe të avancuara e sipas një koncepti të ri bashkëkohor. Ndoshta një bashkërendim i këtij institucioni me institucionet e tjera arsimore universitare (publike apo jo publike), që lëvrojnë fushën e studimeve të sigurisë mund të krijoj më tepër mundësi për të siguruar koherencën dhe vijueshmërinë e studimeve në këtë fushë dhe krijimin e një axhende dinamike të studimeve të sigurisë. Sigurisht që, në kuadër të liberalizimit të procesit arsimor, u afruan një numër institucioneve të tjera arsimore jopublike, të cilat tentojnë të mbulojnë studimet në këtë fushë. Megjithatë, në periudhën aktuale janë të limituara këto institucione për shkak të specifikave, stafit dhe interesit.

5. Nevoja për një axhendë dinamike të studimeve të sigurisë

Aktualisht, interesi i studimeve në çështje të sigurisë ka filluar të rigjallërohet. Është koha kur “globalizimi” po zëvendëson “ndërvarësinë si një kuizi i ri midis studiuesve të marrëdhënieve ndërkombëtare.¹² Në harmoni me këtë, studiuesit e sigurisë ndodhen në mes të debatit për përballjen ndaj kërcënimeve të shumëllojshme mjaft të larmishme dhe që ndryshojnë vazhdimisht. Robert Kaplan, në esenë e famshme “Coming Anarchy”, parashikon se me shfaqjen e kësaj larmie po vihet në dilemë autoriteti formal.¹³ Koncepti dhe mjedisi i sigurisë janë në evolucion të vazhdueshëm, të vullshëm e të pandërprerë. Skenarët ndryshojnë vazhdimisht dhe procesi i sigurisë shfaqet përherë e më i vështirë. Mënyra më efektive për të parashikuar të mundshmen është të përgatitesh për

¹² Keohane, Robert O. dhe Joseph S. Nye Jr. “Globalization: What’s New? What’s Not? (And So What?)”. *Foreign Policy*, Issue 118, Spring 2000, f. 104–119.

¹³ Kaplan, Robert D. “The Coming Anarchy”. *The Atlantic Monthly*, vol. 273, issue 2, February 1994, f. 44–76.

ndryshimin. Forumet akademike, janë në frontin e analizave, vlerësimeve dhe mundësive të zgjidhjes. Në perëndim, institucione të shquara intelektuale: universitete, akademi, kolegje, institute angazhohen t'i studiojnë, shpjegojnë dhe paraprijnë zhvillimeve në fushën e sigurisë. Ato ju afrojnë institucioneve vendimmarrëse (me porosi ose dhe në mënyrë të pavarur) analiza dhe rekomandime shkencore për dinamikat e zhvillimeve.

Ashtu si koncepti edhe studimet e sigurisë kanë ardhur duke u zgjeruar e thelluar dhe sot ato mbulojnë territore të çështjeve të pleksura, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me impakte në mbijetesën e komunitetit. Ato variojnë nga konceptet tradicionale, që lidheshin kryesisht me sovranitetin dhe elementë të fuqisë ushtarake, dhe zhvillohen më tej në shkaqet dhe konsekuencat e konflikteve në dhe midis shteteve, kapacitetet ekonomike, konfliktet etnike, religjioze dhe ideologjike, burimet energjetike, shkencore dhe teknologjike, e vazhdojnë në kërcënimet e sigurisë njerëzore dhe stabilitetin e shteteve nga degradimi politik e mjedisor, sëmundjet infektive, ndryshimet klimaterike e deri në aktivitetin e aktorëve joshitetërorë. Demonstrimi më tipik i evoluimit të konceptit të sigurisë është Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s, miratuar në Samitin e Lisbonës në 2010, ku vizioni bazë i Aleancës lidhet me "human security"¹⁴.

Studimet e sigurisë në vendin tonë, siç e përmendëm edhe më lart, nuk janë në periudhën e tyre më të mirë. Krahas mungesës së mjedisit, mungon edhe afrimi institucional. Gjendja e studimeve, në përgjithësi nuk i përgjigjet statusit të përgjithshëm, në të cilën ndodhet dhe kërkohet të angazhohet vendi ynë, në nivel rajonal e më gjerë, në aleanca apo në forume. Studimet e punimet akademike të sigurisë, janë e po bëhen gjithmonë e më të rralla. Aktualisht, institucionet akademike po ndeshen me vështirësi subjektive që të përgatisin specialistët e sigurisë. Në vend të thellimit dhe zgjerimit të kurrikulave bashkëkohore, ato pak institucione që angazhoheshin nuk u inkurajuan dhe motivuan, indiferentizmi dhe "mosdija" i pozicionuan ato, atje në konceptin e vjetër, në fushën e kazermave, ku ishin para vitit 1970.

Në të kundërt me mungesën e ndonjë strategjie apo vizioni perspektivë mbi bazë interesi kombëtar për përgatitjen e specialistëve në fushën e sigurisë, është kontribut i veçantë, ndihma që dhanë aleatët Perëndimorë, për përgatitjen e një numri ekspertësh në fushën e sigurisë. Qendra Marshall dhe disa nga kolegjet e famshme në SHBA dhe vendet e NATO-s, janë kontribuuesit kryesorë përgjatë më shumë se 20 vjet, për përgatitjen e ekspertëve në fushën e sigurisë. Nëpërmjet programeve trajnuese dhe kualifikuese në institucionet Perëndimore u investua në burime intelektuale, të cilat mund të shërbenin në një të ardhme për të krijuar bazamentin për analiza, studime e vlerësime të mirëfillta në fushën e sigurisë. Është gjithashtu fakt që mungesa ideo, vizionit, vëmendjes apo interesit për këto investime nuk arritën të vlerësoheshin, por u tjetërsuan dhe humbën plotësisht në amullinë e përgjithshme.

6. Përfundime

Në kohën e sotme vendi ynë angazhohet në operacione ndërkombëtare të sigurisë, ruajtjes së paqes, menaxhimit të krizave, ruajtjes së mjedisit, fatkeqësive natyrore etj. Vendi ynë angazhohet në shtabe e organizata ndërkombëtare të cilët në objektin e vet kanë edhe studime, vlerësime hartime dhe implementime planesh e strategjish. Specialistë për çështje të sigurisë janë të kërkuar pothuaj në gjithë dikasteret e linjës deri në qeveri,

¹⁴ "Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s", *Revista Mbrojtja*. Tiranë: QSHBPU, 2010.

parlament, presidencë dhe jo vetëm në Forcat e Armatosura, Forcat e Rendit, Shërbimet Inteligjente etj. Në vlerësim statistikor është një numër i konsiderueshëm (disa mijë) i atyre që angazhohen në çështjet e sigurisë.

Për të operuar me të njëjtin standard me partnerët, por edhe për të harmonizuar mënyrën e veprimit në nivel kombëtar e vetmja rrugë për ata që angazhohen në çështjet e sigurisë mbetet arsimimi, kualifikimi dhe trajnimi me kurrikula bashkëkohore. Institucionet akademike kanë rol parësor jo vetëm me atë që theksoam që në krye të radhës, studime të sigurisë, por edhe në afrimin e një mjedisi dhe klime intelektuale për këto çështje. Është mjaft kuptimplotë ajo çka Freedman artikulon: *“padyshim që, nëse studimet e sigurisë të ekzistojnë dhe të evoluojnë, ato detyrimisht duhet të jenë të ngulitura në sistemin universitar. Edhe pse studimet e sigurisë, vazhdon ai, - bëjnë pjesë në politika relevante dhe teori veprimi, ato para së gjithash duhet të jenë fusha dhe disiplina intelektuale, që të duhet dhe do të mund të reflektojnë në performanca shtetërore”*¹⁵. Më e vështirë se njohja e rreziqeve dhe sfidave të sigurisë është të përgatitesh për tu përballur. Dhe përballja nuk mund të realizohet me slogane apo me konferenca pompoze por me programe që zhvillohen në dimension horizontal dhe vertikal. Ky është kontribut direkt në mjedisin e sigurisë, mjedis që duhet të na interesoj të gjithëve. Nuk mund të jemi të sigurt kur nuk kuptojmë si të sigurohemi. Skenarët e sfidat e sigurisë nuk mund t’i përballojmë në mënyrë diletante dhe delirante. Parë në këtë këndvështrim, ajo çka paraqitet si sfida e studimeve të Sigurisë për të ardhmen, konsiston më së shumti në pyetjet se, cilat zhvillime relevante në fushën e sigurisë, siç janë pasiguria, rreziqet, kërcënimet etj. do të dominojnë studimet në këtë fushë për të paktën 20 vitet e ardhshme. Së dyti, cilat tema dhe fusha studimore do të mbizotërojnë në fushën e sigurisë për dhjetëvjeçarët e ardhshëm dhe së treti, cilat perspektiva disiplinore dhe ide identifikohen përballë studimeve në fushën e sigurisë dhe cilat janë sfidat për të ardhmen e studimeve në këtë fushë. Megjithatë ekziston optimizmi se fusha e studimeve të sigurisë do të zgjerohet me tej për të shqyrtuar shumë çështje emergjente. *“...Kërcënimet e bazuara tek emergjencat dhe fatkeqësitë me potencialin për të shkaktuar një shkallë të lartë dëmsh në hapësirë të shkurtër kohe i janë shtuar menysë të zgjidhjeve të mundshme për studiuesit e sigurisë.*¹⁶ Studimi i çështjeve të sigurisë do të përshtatet me këto rrethana, për t’u përballur me sfidat e reja. Në rastin e ndryshimit të mjedisit, qasja më e mirë mendohet se do të jetë analiza dhe studimi rast pas rasti i kërcënimeve dhe afrimi ndaj tyre sipas tipologjisë dhe gjeografisë së kërcënimit.

Bibliografia

1. Gray, Colin. *War, Peace and International Relations: An Introduction to Strategic History*. Abingdon and New York: Routledge 2007.
2. Hart, Liddell B. H. *Strategy*, (2nd rev. Ed). London: Faber & Faber 1967.
3. Clausewitz, Carl von. *On War, Oxford World's Classics*. New York: Oxford University Press, 2006.
4. Luttwak, Edward. *The Grand Strategy of the Byzantine Empire*. Cambridge, Mass.: Belknap Press of Harvard University Press, 2009.
5. Daase, Christopher. "Sicherheitskultur – Ein Konzept zur interdisziplinären Erforschung politischen und sozialen Wandels". *Sicherheit und Frieden (S+F)*, 2/2011, 29. Jahrgang, S. 59 – 65.
Këtu, Christian Endreß, Nils Petersen, Die *Dimensionen des Sicherheitsbegriffes*, në: <http://www.bpb.de/politik/innenpolitik/innere-sicherheit/76634/dimensionen-des-sicherheitsbegriffs?p=all>, 14.09.2016.
6. Daase, Christopher, et al. "Internationale Risikopolitik". *Der Umgang mit neuen Gefahren in den internationalen Beziehungen*.
7. Fox, William T. R. "Civil-Military Relations Research". *The SSRC Committee and Its Research Survey*, vol.6, no.2, January 1954.
8. Waltz, Kenneth. *Theory of International Politics*. New York: Random House, 1979.
9. Agolli, Agron. *Kualifikimi shkencor në Forcat e Armatosura 1974-2012*, Tiranë: Qendra e Botimeve Ushtarake, 2012.
10. Keohane, Robert O. dhe Joseph S. Nye Jr. "Globalization: What's New? What's Not? (And So What?)". *Foreign Policy*, Issue 118, Spring 2000, f. 104–119.
11. Kaplan, Robert D. "The Coming Anarchy". *The Atlantic Monthly*, vol. 273, issue 2, February 1994.
12. "Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s", *Revista Mbrojtja*. Tiranë: QSHBPU, 2010.
13. Friedman, George. *100 vitet e ardhshme*. Tiranë: Plejad 2010.
14. Enemark, Christian. *Disease and Security: Natural Plagues and Biological Weapons in East Asia*. London: Routledge, 2007.

Impakti i shkollimit policor në përballjen me kërcënimet ndaj sigurisë

Vështrim studimor mbi shkollën shqiptare të Policisë

Prof. Asc. Dr. Pandell TAÇI¹

Akademia e Sigurisë

pandeli.taçi@asp.gov.al

Abstrakt

Përqendrimi në zhvillimet e brendshme të dy dekadave të fundit, evidenton se gjendja e rendit, niveli i sigurisë dhe zhvillimet kriminale e kanë sfiduar seriozisht sistemin e sigurisë, veçanërisht Policinë Shqiptare. Sfida është e tillë, sa e kanë bërë dhe vazhdojnë ta bëjnë luftën për parandalimin dhe mënjanimin e kërcënimeve ndaj sigurisë në tërësi dhe zbulimin, parandalimin e goditjen e terrorizmit, krimeve të dhunshme e të rënda, krimin të organizuar, drogës, trafiqeve, korrupsionit, etj., provë të aftësive të saj (policisë), të përkushtimit atdhetar dhe të seriozitetit të reformave të ndërmarra. Madje, në rrafsh më të gjerë edhe të aftësive e të qëndrueshmërisë së vetë shtetit demokratik. Në analizë të faktorëve që kanë ndikuar në rënien e nivelit të sigurisë së komunitetit dhe uljen e besimit ndaj agjencive të zbatimit të ligjit, në gjendjen e rendit, sigurisë e luftës ndaj krimin dhe të situatës së paligjshmërisë në tërësi, evidentohet moseficienta e institucioneve të shkollimit dhe kualifikimit policor, aq më tepër reduktimi e deri mbyllja e institucioneve të arsimit të lartë të Policisë. Ndaj dhe, veç nevojës për një trupë policore të arsimuar e kualifikuar, kjo gjendje sjell edhe një herë në vëmendje kërkesën që veprimtaria e institucioneve akademike e shkencore të policisë, përveç sa efiçente, të jetë e integruar e të zgjidhë nevojat konkrete të vendit. Është kjo një ndër arsytet që, në punën që bëhet për reformimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, vlerësohet kujdesi i qeverisë që, këtij procesi zhvillimi e modernizimi, t'i bashkohen të gjitha institucionet e arsimit të burimeve njerëzore të agjencive të zbatimit të ligjit e strukturave të sigurisë, më konkretisht të gjitha nivelet e personelit të policisë shqiptare, si strukturë me rol e pritshmëri të veçanta në përballje me krimin dhe kërcënimet ndaj sigurisë, për të sotmen dhe integrimin e vendit në institucionet evropiane. Duke e njohur gjendjen dhe problematikën në arsimin e lartë policor, përshëndeta përfshirjen në programin qeverisës të reformimit rrënjësisht të sistemit të arsimit e kualifikimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, për shtimin dhe diversifikimin e kapaciteteve profesionale dhe përshtatjen me ritmin dhe hapat e zhvillimit të vendit. Ndaj dhe me anë të një vështrimi studimor mbi shkollën shqiptare të Policisë, po shfaq disa arsytetime, përfundime dhe vlerësime mbi rolin e arsimit, me shpresë të kontribuoj në gjetjen e qasjeve adekuate, të vlefshme për përgatitjen e specialistëve dhe ekspertëve të sigurisë, për rritjen e cilësisë së policimit dhe përtimin e një mjedisi të sigurtë publik.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

Fjalëkyçe:

Arsimi policor, program studimi, siguria publike, rendi publik, krimi i organizuar, trajnimi, kualifikimi.

1. Hyrje

Përqendrimi në zhvillimet e brendshme të dy dekadave të fundit, evidenton se gjendja e rendit, niveli i sigurisë dhe zhvillimet kriminale e kanë sfiduar seriozisht sistemin e sigurisë, veçanërisht policinë shqiptare. Sfida është e tillë, sa që e kanë bërë dhe vazhdojnë ta bëjnë luftën për parandalimin dhe mënjanimin e kërcënimeve ndaj sigurisë në tërësi dhe zbulimin, parandalimin e goditjen e terrorizmit, krimeve të dhunshme e të rënda, krimet të organizuar, drogës, trafikeve, korrupsionit, etj., provë të aftësive të saj (policisë), të përkushtimit atdhetar dhe të seriozitetit të reformave të ndërmarra. Madje, në rrafsh më të gjerë edhe të aftësive e të qëndrueshmërisë së vetë shtetit demokratik. Të kondicionuara e diktuar prej shndërrimeve të thella politike, sociale e ekonomike që ndodhen në vendin tonë, në dy dekadat e fundit, konceptet e sigurisë në tërësi, e veçanërisht ato të sigurisë publike e kombëtare, kanë ndryshuar rrënjësisht. Tashmë ajo nuk gjykohet më si koncept politik, social, ushtarak, ekonomik apo policor dhe, që u përket vetëm organeve apo institucioneve të caktuara të shtetit. Përkundrazi. Siguria, sot perceptohet shumë më gjerë dhe, përmasat e saj (të sigurisë së brendshme, sigurisë së jashtme, sigurisë rajonale, etj.), sipas qasjeve bashkëkohore, përfshijnë gjithanshmërinë e aktivitetit dhe veprimtarisë së shoqërisë apo shtetit demokratik, në funksion të zhvillimit ekonomik e social dhe uljen në minimum të efekteve negative të faktorëve dhe veprimeve që cenojnë liritë e të drejtat e njeriut, rrjedhimisht edhe të sigurisë në gjithanshmërinë e vet. Është realitet që dekadat e fundit kemi përjetuar një gjendje pamjaftueshmërie të punës dhe efektivitetit të instrumenteve të sigurisë, gjë që ka vënë në rrezik jo vetëm mbrojtjen e jetës, pronës dhe pasurisë së shqiptareve, por herë-herë edhe sovranitetin, pavarësinë dhe integritetin e vendit. “Mungesa e strukturave të

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

¹ Shef i Sektorit të Botimeve, Qendra e Kërkimeve Shkencore në Akademinë e Sigurisë.

specializuara dhe e eksperiencës, mungesa e legjislacionit për të luftuar format e reja të kriminalitetit në vendin tonë, ka favorizuar përhapjen dhe konsolidimin e krimit të organizuar.”²

Nga analiza më e detajuar e faktorëve që kanë ndikuar në gjendjen e rendit, sigurisë publike, luftës kundër krimit dhe të situatës së paligjshmërisë në tërësi, evidentohet edhe mosefienca e institucioneve të shkollimit dhe kualifikimit policor, aq më tepër mbyllja e institucionit të arsimit të lartë të Policisë, të cilat edhe pse në mënyrë tërthore kanë impakt afatgjatë në nivelin e sigurisë. Ndaj dhe veç nevojës për një trupë policore të arsimuar e kualifikuar, kjo gjendje sjell dhe një herë në vëmendje kërkesën që veprimtaria e institucioneve akademike e shkencore të policisë, të jetë e integruar dhe në pajtim me nevojat konkrete të vendit. Është kjo një nga arsyet që, në punën që bëhet për reformën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, vlerësohet kujdesi i qeverisë që, këtij procesi zhvillimi e modernizimi, t’i bashkohen të gjitha institucionet e arsimit të strukturave të sigurisë, më konkretisht të gjitha nivelet e personelit të Policisë shqiptare, si strukturë me rol e pritshmëri të veçanta për të ardhmen dhe integrimin e vendit në institucionet evropiane. Synimi është që me anë të kësaj trajtese, të evidentojmë e nxjerrim në pah faktin se i kemi të gjitha potencialet e nevojshme njerëzore, ekonomike e materiale për t’i mbajtur të eficient instrumentet e sigurisë, për të mbrojtur dhe zhvilluar interesat kombëtarë.

Ajo që lypset, e që natyrisht bën pjesë në rekomandimet e trajtesës, është që nëpërmjet një vështrimi studimor mbi shkollën shqiptare të Policisë, të evidentojmë rrugët, mjetet dhe mënyrat e rritjes së efikasitetit të institucioneve akademike për realizimin e misionit dhe përgjegjësisë në fushën e rendit, të luftës ndaj krimit dhe sigurisë në tërësi. Me preokupacion të veçantë që, këtij procesi zhvillimi e modernizimi, t’i bashkohen të gjitha institucionet e arsimit të burimeve njerëzore të agjencive të zbatimit të ligjit dhe strukturave të sigurisë, më konkretisht të gjitha nivelet e personelit të policisë shqiptare.

2. Policia dhe çështjet e sigurisë³

Edhe pse është e vështirë të veçohen organe apo organizma si të palidhura me çështjet e sigurisë, sepse në një mënyrë apo tjetrën, ato lidhen me të, Policia është ndër institucionet apo strukturat e sigurisë me mision, me rol dhe pritshmëri të veçanta në përballje me krimin dhe kërcënimet e tjera ndaj sigurisë, si për të sotmen ashtu dhe për integrimin e vendit në institucionet evropiane. Legjislacioni policor, tërësisht i rinovuar dhe misioni i strukturave të saj, të cilat ushtrojnë veprimtarinë dhe atributet ligjore në gjithë territorin e vendit, kanë nxjerrë në evidencë detyra të rëndësishme, në këtë fushë. Sipas ligjit⁴, Policia e Shtetit është institucioni i administratës shtetërore, përgjegjëse për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike dhe mbrojtjen e jetës, shëndetit, pronës publike e private, etj. Problemet e sigurisë, në veprimtarinë e përditshme të policisë, zënë një vend të rëndësishëm e të posaçëm për shkak se pasojat dhe fusha e indikacionit të tyre është e konsiderueshme. Drejtimet më të rëndësishme të punës së policisë - dhe për argument sjell në vëmendje, luftën ndaj krimit të organizuar, punën për parandalimin

² Gjonça, Luan dhe Genci Gjonça. *Kriminologjia (tekst mësimor)*. Tiranë: Adel Print, 2009, fq. 359.

³ Në trajtimin e çështjeve është shfrytëzuar përmbajtja e “Dokumentit të Strategjisë së Sigurimit të RSH-së”, miratuar me ligjin nr. 8572, datë 27.1.2000.

⁴ Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, neni 4/1 dhe neni 17/1.b.

e aksidenteve me humbje jete dhe pasoja të rënda në autotransport, zbulimin dhe goditjen e akteve terroriste, menaxhimin e prishjes apo cenimeve të rënda të rendit publik, zgjidhjen e konflikteve ndërkrahinore, ndërpolitike apo ndërftare, goditjen e trafikimit të lëndëve narkotike dhe parandalimin e kultivimit të bimëve të drogës, e të tjera, - përbëjnë rreziqe faktike dhe kërcënime reale për sigurinë e brendshme, publike apo të individit. Ndoshta sot, një pjesë e këtyre fenomeneve, janë minimizuar si rrjedhojë e investimeve të konsiderueshme, veçanërisht në burimet njerëzore, në teknologji policore, në trajnime e kualifikime, në aspektin juridik, e të tjera. Por në fund të viteve '90 dhe në fillimin e dekadës së parë të viteve 2000, këto përbënin kërcënim real për destabilitetin politik.

Është pikërisht kjo situatë pasigurie, një ndër shtysat që, shteti shqiptar, me ligj të veçantë (ligjin nr. 8572, datë 27.1.2000), miratoi "Dokumentin e Strategjisë së Sigurimit të RSh-së" dhe, në harkun e pesë viteve 2000-2005, miratoi mbi 30 ligje për ratifikimin e konventave dhe protokolleve të OKB-së, shumë ligje e akte të tjera nënligjore, si dhe disa strategji e plane veprimi kombëtare për goditjen, ndërprerjen dhe parandalimin e veprimtarive apo aktiviteteve të rrezikshme kriminale, të tilla si: "Strategjia kombëtare e luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore" VKM, nr. 361, datë 18.7.2002; "Strategjia kombëtare kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimë të trafikimit" VKM, nr. 171, datë 11.2.2005; "Strategjia kombëtare antidrogë 2004-2010" VKM, nr. 292, datë 7.5.2004; "Strategjia e Policimit në Komunitet" tetor 2005; "Strategjia për kontrollin e kufirit dhe menaxhimin e integruar të tij", dhjetor 2002; dhe mori aktesh nënligjore në funksion e zbatim te tyre.

Pothuajse në të gjitha aktet ligjore, nënligjore e normative, por dhe në trajtimet teorike bashkëkohore për policinë, detyrat për sigurinë gjenden të shprehura në tri përcaktime; në rendin e sigurinë publike, në sigurinë e individit dhe herë-herë edhe në sigurinë shtetërore.

a. Rendi dhe siguria publike konceptohet si tërësi masash që merren nga shteti dhe institucionet përkatëse (institucionet e sigurisë) për respektimin e ligjeve e rregullave dhe për realizimin e mbrojtjes nga faktorët e rreziqet që pengojnë zhvillimin dhe kanosin bashkëjetesën në komunitet. Më konkretisht, mbrojtja e rendit dhe sigurisë publike presupozon mbikëqyrjen e zbatimit nga shtetasit të kërkesave të përcaktuara në ligje të veçanta për rregullin, rendin e qetësinë publike, normat dhe moralin e bashkëjetesës në komunitet, etj. Çka do të thotë që Policia e Shtetit, me anë të shërbimeve të veta, duhet të garantojë zbatimin e ligjit, për të mbrojtur qytetarët, institucionet, mjedisin dhe rendin publik, nga çdo dhunim apo shkelje.

b. Ndërkohë, siguria e individit, presupozon masat që merren për të mbrojtur individin nga rreziqet që kanosin integritetin e jetës, të pronës e të dinjitetit njerëzor. Përveç institucioneve të tjera të sigurisë, Policia ka me shumicë përgjegjësinë për t'u garantuar shtetasve ushtrimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara nga Kushtetuta e RSH. Ajo zbaton masa të gjithanshme për të mbrojtur jetën, pronën, të drejtat politike të pjesëmarrjes në votime si zgjedhës apo i zgjedhur, në tubime paqësore, realizimin e qarkullimit dhe lëvizjes së lirë, etj., të cilat mund të cenohen nga veprime të kundërligjshme. Sipas koncepteve bashkëkohore, arritja e sigurisë së individit gjykohet e realizuar përmes garantimit të sigurisë sociale apo publike dhe veprimit e konsolidimit të shtetit të së drejtës.

c. Siguria shtetërore, mund të perceptohet si tërësi masash të institucioneve të sigurisë, përfshirë Policinë e Shtetit, të cilat garantojnë integritetin e institucioneve shtetërore, jetën dhe veprimtarinë normale të personaliteteve të larta dhe autoriteteve shtetërore e publike, mbrojnë rregullin e rendin publik nga turbullirat sociale, nga revoltat e armatosura dhe rebelimet masive që kërcënojnë seriozisht rendin kushtetues, ose rrezikojnë ta përmbysin atë me dhunë. Pra, të mbrosh e realizosh sigurinë shtetërore, do të thotë të garantosh integritetin dhe normalitetin e veprimtarisë politike, ekonomike e shoqërore.

Siguria shtetërore, publike dhe e individit, sot kërcënohet nga rreziqe globale, nga rreziqe rajonale dhe nga rreziqe të brendshme, ku veçohet terrorizmi dhe krimi i organizuar ndërkombëtar e rajonal. Ndërkohë rreziqet e brendshme të sigurisë janë më të shumta, janë një bashkim i faktorëve politikë, ekonomike, sociale, kriminogjenë, etj.

d. “Terrorizmi është kërcënimi më i rëndësishëm për sigurinë tonë kombëtare - thuhet në dokumentin “Plani Strategjik i FBI-së, 2004-2009”, hartuar mbi bazën e analizave dhe refleksioneve, pas ngjarjeve tragjike të 11 shtatorit. “Në arenën e terrorizmit ndërkombëtar, mbi 5 vitet e ardhshme, ne besojmë se numri i organizatave terroriste të sponsorizuara nga shteti do të vazhdojë të ulet, por grupet terroriste të sponsorizuara në mënyrë private do të rritet në numër. Sidoqoftë, grupet terroriste do të bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme me njëri-tjetrin, që të arrijnë përfundimet e dëshiruara kundër armiqve të përbashkët. Këto aleanca do të jenë të një vazhdimësie të limituar, por të tilla “shoqëri” të humbura do të kërkojnë aftësinë tonë për të identifikuar kërcënimet specifike. Al-Kaeda dhe bashkimet e saj do të mbeten kërcënimi më i rëndësishëm për më shumë se në 5 vitet e ardhshme.... Ne parashikojmë që terroristët të shfrytëzojnë organizimet kriminale për të zhvilluar dhe gjetur aftësitë e armëve të shkatërrimit në masë. Globalizimi do ta bëjë atë më të lehtë për të transferuar përvojat dhe materialet në të gjithë botën.”⁵ Dhe koha provoi plotësisht vërtetësinë e analizës dhe parashikimeve të bëra nga FBI.

e. Edhe pse në vendin tonë, nuk janë evidentuar vepra mirëfilli terroriste, ngjarjet e 11 shtatorit në SHBA, apo ato në Spanjë, Angli, Gjermani, Francë, Belgjikë e gjetkë dhe rreshtimi ynë përkrah vendeve që e luftojnë terrorizmin, nuk lenë vend të besohet se nuk do të ndodhin. Krimi i organizuar, i cili në vendin tonë është i pranishëm, pothuaj me të gjitha format e tij, për nga pasojat tepër të rënda sociale që shkakton, përbën rrezik potencial për sigurinë e brendshme e të jashtme. Rrjetet e trafikantëve të drogës, të armëve, prostitucionit, vrasjet, rrëmbimi i pengjeve, gjobvënia ndaj biznesmenëve, kontrabanda, pastrimi i parave të krimit, etj., përfitojnë nga korrupsioni në administratë, brishtësia e institucioneve dhe bashkë me to, edhe nga inefiçenca e veprimit të ligjit. “Krimi i organizuar dhe korrupsioni përbëjnë një pengesë reale të stabilitetit demokratik, shtetit ligjor, zhvillimit ekonomik dhe zhvillimit të shoqërisë civile në rajon, si dhe një burim shqetësimesh të rënda për BE-në. Luftimi i tyre përbën një prioritet madhor. Krimi i organizuar është përçudnimi i drejtësisë, një pengesë për progresin dhe rrezik për sigurinë e brendshme të së gjitha vendeve ballkanike” - u theksua në Deklaratën e

⁵ US Federal Bureau of Investigation (FBI). *Federal Bureau of Investigation Strategic Plan 2004-2009*. Washington, DC: Office for Victim Assistance, 2004, fq.15.

Samitit të Selanikut të vitit 2002.

f. Krimet kundër jetës me motive hakmarrjen e pronësinë, rrëmbimet e personave me motive përfitimet materiale, veprat penale me objekt shkatërrimin e tjetërsimin e pronës, krimet në fushën e ekonomisë dhe financave, etj., me përmasat dhe shtrirjen e tyre, identifikohen si shkaqe me ndikime direkt në nivelin e sigurisë së qytetarit. Efektivisht, këto përbëjnë frontin ku veprimtaria e strukturave policore pritet të kontribuojë jo vetëm për zbulimin dhe dërgimin para drejtësisë të autorëve, por në bashkëpunim me organet e tjera ligjzbatuese dhe shoqërinë civile të synojë parandalimin e tyre.

Përfundimisht, tërësia e çështjeve dhe problematikës që shfaqin sot problemet e sigurisë së përgjithshme evidentojnë lidhjet e tyre me institucionet e sigurisë, konkretisht me policinë dhe veprimtarinë e saj. Kjo edhe për faktin se terrorizmi, krimi i organizuar dhe trafiket, krimet kundër personit me motiv hakmarrjen dhe pronësinë, e të tjera fenomene e dukuri kriminale, si dhe lufta e përpjekjet për zbulimin, parandalimin dhe goditjen e tyre, janë detyrë e atribut i veprimtarisë së policisë.

3. Përvoja dhe eksperiencat tona në arsimimin dhe kualifikimin policor

Njohja dhe rivlerësimi i përvojës dhe eksperiencave tona, afërsisht njëqindvjeçare, në arsimin e kualifikimin policor, përbëjnë një rezervë të konsiderueshme në ndihmë të reformave që janë ndërmarrë për rindërtimin dhe modernizimin e sistemit arsimor, eksperiencat e cilat grupet e interesit brenda e jashtë policisë, duhet t'i njohin dhe konsiderojnë në hartimin e planeve dhe programeve. Nëpërmjet një vështrimi studimor mbi shkollën shqiptare të Policisë kemi për qellim që të evidentojmë rrugët, mjetet dhe mënyrat e rritjes së efikasitetit të institucioneve akademike për realizimin e misionit dhe përgjegjësi në fushën e rendit, të luftës ndaj krimit dhe sigurisë në tërësi. Fillimet e kësaj veprimtarie datojnë me formimin e policisë, menjëherë pas krijimit të shtetit të parë shqiptar dhe, ndër format kryesore të arsimimit janë trajnimet e kualifikimet, fillimisht me kurse një e disa javore, me kurse mujore e më vonë deri në shkolla një e dyvjeçare formimi për policinë. Këto forma kualifikimi vazhduan disi gjatë, deri në fillimvitet '70 dhe vlerësohen relativisht pozitive, edhe pse, për shkak të gjendjes së vendit dhe niveleve të zhvillimit, eksperiencat që përcjellin janë disi modeste.

3.1. Lidhur me arsimin e lartë të policisë

Vlera disi të referueshme shënohen me krijimin e Shkollës së Lartë të Policisë, si institucioni i parë i këtij lloji në vendin tonë - kohë në të cilën proceset e formimit bazë dhe kualifikimit policor u vunë në rrugën e zhvillimit dhe modernizimit. Nëse mbajmë në konsideratë kushtet politike, nivelin ekonomik, ritmet e zhvillimit, por edhe shndërrimet e mëdha social-ekonomike e politike të këtyre viteve, del se arsimimi policor është zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme e cilësore. Ndër momentet më të rëndësishme të zhvillimit institucional e akademik, të cilave mund e duhet t'u referohemi, përmendim:

- Hapja e studimeve të larta për Policinë (Shkolla e Lartë e MPB) dhe fillimi i

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit »

studimeve në shtator të vitit 1971, përbëjnë një ngjarje të rëndësishme për zhvillimin institucional dhe rritjen e nivelit profesional të trupës së oficerëve dhe drejtuesve të policisë shqiptare. Ndër faktorët kryesorë që diktuan hapjen e saj përmendim:

a) prapambetja relative institucionale dhe administrative e strukturave që merreshin me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit; b) diferencat që vëreheshin në nivelin kulturor të tyre në raport me punonjësit e tjerë të administratës shtetërore, dhe c) shtimi në sasi e në lloje i kriminalitetit në vend. Si bazë për hartimin e kurikulave, planit dhe programeve mësimore shërbyen programet e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Politike të Universitetit Tiranës, ndërkohë që trupa pedagogjike për lëndët profesionale vinte nga radhët e specialistëve që kishin mbaruar studimet e larta në BS apo vende të tjera të Lindjes evropiane.

- Reforma e parë përmbajtjesore në kurikulën dhe programet lëndore universitare të kësaj shkolle, shënohet se u krye në vitin 1984 dhe mund të cilësohet si reforma për forcimin më tej të karakterit juridik e profesional të shkollës policore shqiptare. Vlerësohen të tilla, sepse kjo u mor konkretisht me aspektet me kruciale e të rëndësishme të edukimit profesional, të tilla që sollën në pak vjet përmbysjen e praktikave policore të tejkaluara nga koha dhe adaptimin e metodologjive të inteligjencës në luftën ndaj kriminalitetit dhe në shërbimet e policisë. Ndryshimet më thelbësore të planit mësimor ishin: shtimi i numrit të lëndëve profesionale, i numrit të lëndëve juridike, i disa lëndëve të sociologjisë, hartimi i një programi të integruar të përgatitjes fizike, si dhe zgjatja e kohës së studimeve nga 3 në 4 vjet. Veçoj se, në lëndët profesionale të shtuara, spikatin ato për teknikat informative, për metodat e përgjimit e investigimit kriminal dhe njohuritë për përgatitjen tekniko-speciale. Natyrisht që këto ndryshime nuk u bënë për dëshirat subjektive të drejtuesve të kohës, por ishin të diktuar nga rritja në sasi e në lloj e kriminalitetit dhe shtimi veçanërisht i krimeve të rënda (vrasje, vjedhje, grabitje te pronës, përdhunime, etj.).

- Ndryshimi i sistemit politik në fillim të viteve '90, hapja me botën, format e reja të kriminalitetit, etj., diktuan nevojën e rikonceptimit të programeve, ripunimit të teksteve, etj., pra të një reforme tërësore për ringritjen dhe riorganizimin e strukturave arsimore të formimit dhe kualifikimit policor. Kështu, në zbatim të planit të veprimit për strategjinë e zhvillimit të arsimit policor, në vitin 2000 u formua Akademia e Policisë, me statusin e shkollës së lartë policore, me kohëzgjatje të studimeve tre vite akademike, me shkëputje nga puna. Në prill të vitit 2001, për herë të parë në historinë e Policisë Shqiptare, u organizua Konferenca "Për Strategjinë e zhvillimit të arsimit dhe kualifikimit Policor", çka shënon një fazë të re më të lartë zhvillimi institucional, akademik e shkencor të Policisë.

- Kërkimi shkencor ka qenë pjesë integrale e punës së institucioneve të arsimit policor, edhe pse matjet tregojnë për produkt të pakët. Universitetet në mbarë botën konsiderohen si institucionet më të përshtatshme për zhvillimin e kërkimit shkencor. Dhe kjo, për dy arsye kryesore: e para, lidhja e drejtpërdrejtë e kërkimit shkencor me procesin e mësimin; e dyta, integrimi i kërkimit me një institucion që është më afër tregut të punës se cilido tjetër. Është për këtë arsye që, në vitin 1984, me hapjen e sistemit të studimeve pasuniversitare, në shkallë vendi) u regjistruan disa specialistë, në kërkim të gradave e titujve shkencorë dhe në vitet '88, '89 e '90, u mbrojtën doktoraturat e para për policinë.

- Në kuadër të reformimit të Akademisë dhe si pjesë e rëndësishme e saj, në vitin 2000, u krijua Qendra e Studim-Kualifikimeve, me detyrë zhvillimin e kërkimeve,

studimeve dhe përgjithësimi shkencore e profesional, integrimin e kërkimeve në procesin mësimor dhe realizimin e kualifikimeve me personelin e rolit madhor e drejtues. Ndërkohë, që në vitin 2004, me vendim të posaçëm të KM, u çel Shkolla Pasuniversitare me drejtim “Për Rend e Siguri Publike”, por që, për fat të keq, nuk funksionoi.

3.2. Formimi profesional i trupës policore

Rreth 2/3 e tërësisë së personelit policor i përket ndihmës specialistëve, apo punonjësve të nivelit të parë operues e ekzekutivë. Përgjegjësitë dhe detyrat që kryejnë këta janë nga më të rëndësishmet për kontrollin e rendit, sigurisë dhe goditjen e parandalimin e krimeve dhe shërbimet e tyre nga më të dukshmet e më përfaqësueset në publik. Natyra e detyrave që kryejnë, vendi që zënë dhe niveli arsimor e kulturor i tyre, dikton kujdes e vëmendje të veçantë për formimin dhe kualifikimin profesional e juridik. Vazhdimisht, në të gjithë vendet, edukimit profesional të kësaj kategorie personeli i kushtohet kujdes i veçantë. Kështu p.sh., jo rastësisht, në mesin e viteve '80, ndërkohë që studimet e larta për oficerët u bënë 4 vjet, ato për policë e nënoficerëve u bënë 2 vjet, duke krijuar edhe një institut të posaçëm policie për formimin e kësaj kategorie personeli. Nisur nga roli i rëndësishëm i tyre për realizimin e misionit e të përgjegjësive të policisë, çështjet e formimit profesional dhe kualifikimit të punonjësve të nivelit bazë apo ekzekutiv-operues, janë trajtuar si pjesë integrale e reformave në institucionet e arsimit të lartë policor. Duke sugjeruar se kështu duhet të vazhdojnë të konsiderohen edhe në të ardhmen, sjellim në vëmendje të auditorit disa nga hapat me vlera të referueshme për arsimimin e kësaj kategorie personeli.

- Eksperiencat e fushës së formimit profesional të policisë gjatë monarkisë deri në fillimvitet '70, vlerësohen relativisht pozitive, edhe pse sjellin pak material specifik për t'u përgjithësuar. Edhe pse kanë qenë të pakta, për kohën dhe krahasimisht me të tjerët ato vlerësohen normale. Këtu është për t'u shënuar fakti që, për trajnimin e policisë, me gjithë varfërinë dhe nivelin e ulët ekonomik, shteti ka treguar kujdes, pavarësisht nga forma apo ngjyrimet politike. Edukimi profesional, trajnimi, kualifikimet për personat e ngarkuar me ruajtjen e rendit e të sigurisë, si njëra nga strukturat me detyra specifike për shtetin, është zhvilluar, si dhe për punonjësit e tjerë të administratës, në pajtim me nivelin e zhvillimit të vendit dhe mjeteve të kufizuara ekonomike e financiare. Veç kurseve afatshkurtra me ritme e kohëzgjatje të ndryshme, gjatë këtyre viteve funksionuan edhe shkollat profesionale një e dyvjeçare, duke sjellë hera-herës edhe specialistë të huaj.

- Kurset një e disa mujore e deri njëvjeçare, vijuan edhe pas Çlirimit, me krijimin e Policisë Popullore kur pushteti i ri, i dalë nga lufta, shtoi në sasi, në lloje e në forma mjetet dhe mënyrat e edukimit të trupës policore. Në vitin 1954 deri në 1968, për oficerët, nënoficerët e policët, u hap Shkolla e Bashkuar e M. P. Brendshme, me statusin e shkollës së mesme profesionale, ku një nga tri degët ishte kursi i punonjësve të Policisë.

- Ndër zhvillimet e rëndësishme dhe me ndikim në rritjen dhe performancën kulturore të trupës policore shqiptare, në fillim të viteve '70, ishte vendosja e arsimit të mesëm në kriteret bazë të rekrutimit, si dhe fakti, krahas çeljes së shkollës së lartë për oficerët e Policisë, u hap kursi njëvjeçar për policë e nënoficerë, që funksionoi deri në mesin e viteve '80.

- Në vitin 1985 u çel Shkolla dyvjeçare e Policisë, me bazë arsimin e mesëm, e cila funksionoi për rreth një dekadë. Pa statusin e arsimit të lartë, por me plan e programe

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

mësimore nga më të avancuarat e kohës dhe me një trupë pedagogësh të përgatitur, ajo kish për mision formimin bazë dhe kualifikimin e policëve dhe nënoficerëve. Kjo shënon një hap cilësor të konsiderueshëm në formimin profesional dhe performancën e shërbimeve të policisë në tërësi. Ndërkohë që, në vitin 2000, njëherazi me formimin e Akademisë së Policisë⁶ dhe në vartësi të saj u krijua Instituti i Policisë, me detyrë formimin profesional të punonjësve të policisë të rolit bazë, me afat kohor studimesh një vit akademik.

- Por, jo gjithçka, në të kaluarën tonë, me arsimimin dhe kualifikimin e trupës ka ecur drejtë, sepse krahas përvojave pozitive janë vërejtur edhe dukuri e fenomene që kanë dëmtuar procesin e zhvillimit dhe kanë frenuar ritmet e rritjes. Në disa raste janë dëmtuar projekte të rëndësishme në fushën e kërkimit dhe kualifikimit shkencor, siç është rasti i mbylljes arbitrare e të pamotivuar të Shkollës Pasuniversitare “Për rend e siguri publike”, në vitin 2003⁷. Apo, rasti flagrant i vitit 2005, kur u ndërpreu studimet e larta në Akademinë e Policisë, në këtë institucion prestigjioz akademik, produkti dhe specialistët e të cilit, vazhdimisht, por sidomos dekadat e fundit, janë shquar për formim të lartë profesional e patriotik.

4. Sistemi i shkollimit përballë sfidave të sigurisë, të rendit publik dhe të kriminalitetit

Rezultatet dhe impakti pozitiv i përballjes me rreziqet dhe kërcënimet ndaj sigurisë, por dhe i sfidave e zhvillimeve në fushën e rendit e të luftës ndaj krimit, kondicionohet në masë të konsiderueshme nga veprimtaria e institucioneve të arsimit të policisë shqiptare. Varet nga to sepse, në përmbushje të misionit dhe përgjegjësive të tyre, duhet të ofrojnë programe studimesh të krahasueshme me sistemet arsimore të vendeve të tjera, duke siguruar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e këtyre programeve në kontekstin e hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë.

4.a. Lidhur me sistemin apo modelin e arsimit të lartë policor, dëshiroj të shprehem se është gjetja e duhur aplikimi i sistemit të Bolonjës, i përbërë nga cikle të njëpasnjëshme programesh studimi, (sipas niveleve: Bachelor, Master dhe Doktoratë - BMD), i organizuar në module dhe vlerësuar në kredite, bazuar në sistemin evropian ECTS⁸. Këto programe studimi duhet të përfshijnë përgatitjen dhe paraqitjen edhe të projekteve kërkimore të studentëve, sipas rregulloreve të studimeve (temë diplome, tezë dhe disertacion). Më konkretisht, ringritja e Institucionit të Arsimit të Lartë të Policisë (themeluar qysh në fillimvitet ‘70 dhe mbyllur padrejtësisht në vitin 2005), me organizim e strukturë sipas llojeve të programeve e cikleve të studimeve që do të ofrojnë, duhet të jetë i njëjtë me atë të universiteteve apo fakulteteve të tjera. Si institucion i arsimit të lartë, të ketë të drejtën e ofrimit të programeve për tri cikle të studimit: cikli i parë, diploma “Bachelor” (me kohëzgjatje të paktën tre vjet dhe 180 kredite), cikli i dytë, ai i studimeve “Master” (Master Profesional një e dy vjeçar me 60 e 120 kredite dhe “Master Shkencor” dyvjeçar me 120 kredite) dhe cikli i tretë - studimet e Doktoratës, (3-5 vjeçare, specializime me kohëzgjatje minimalisht dyvjeçare dhe të paktën 120

⁶ VKM nr. 281, datë 2.6.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Akademisë së Policisë”.

⁷ VKM nr. 524, datë 1.8.2003, “Për hapjen e Shkollës Pasuniversitare pranë Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari”.

⁸ ECTS-Sistemi Evropian i Grumbullimit e Transferimit të Krediteve.

kredite). Zgjedhja dhe zbatimi tashmë praktikisht i këtij sistemi studimesh, i provuar si i suksesshëm në disa vende të rajonit (pa harruar se për të ka edhe vërejtje e rezerva nga shumë studiues e specialistë), kërkon një organizim efikas institucional, të pavarur dhe efektiv, me ndarje të qartë midis profilit apo anës akademike e kërkimore dhe anës administrative, si dhe zvogëlimin e barrierave burokratike të funksionimit institucional, për të rritur efciçnsën në përmbushje të misionit të arsimit policor. Vetëm në këtë mënyrë garantohet cilësia dhe standardi në mësimdhënie dhe veprimtarinë kërkimore shkencore, konkurruese me ato të vendeve evropiane.

Për të qenë koherentë në përcaktimin e programeve të studimit dhe sa më afër me natyrën e punëve të policisë, mendoj se është pikërisht momenti kur duhet të hidhen bazat për harmonizimin e sistemit të programeve, të diplomave dhe cikleve të studimit me sistemin e gradave e të karrierës në Policinë e Shtetit. Në këtë mënyrë, duke e bërë sistemin e karrierës pjesë integrale të sistemit arsimor e kualifikues zgjidhen dy çështje tepër të rëndësishme: *e para*, në themel të ecurisë në gradë, për rrjedhojë dhe në marrjen e posteve drejtuese e të përgjegjësiive, vihet merita dhe niveli i përgatitjes individuale; *e dyta*, vetëm në këtë mënyrë i pritret rruga subjektivizmit, militantizmit, korrupsionit dhe gjithçkaje që prodhon ecuri të pamerituar në karrierë, duke kompromentuar e deformuar krejt procesin.

Duke bërë integrimin e niveleve dhe programeve të studimit me nivelet, gradat dhe sistemin e karrierës në polici, programit “Bachelor” i korespondon përgatitja e nivelit të komisarëve, programeve “Master”, i përgjigjet niveli i menaxherëve dhe drejtuesve të strukturave, ndërsa studimet doktorale, të nominuara rigorozisht, i përkojnë nivelit të drejtuesve të lartë të policisë. Efektivisht, ashtu si homologët italianë, francezë, etj., edhe ne do të mund të shprehemi për “Shkollën e Inspektorëve”, “Shkollën e Komisarëve”, etj.

4.b. Për shkak të vendit që zënë në tërësinë e personelit policor, por edhe për shtimin e diversifikimin e kapaciteteve njerëzore që ka policia, sugjerohet ristrukturimi i kurikulës dhe programeve mësimore të shkollimit policor për punonjësit e nivelit të parë zbatues e ekzekutiv. I organizuar tashmë në formën e një kolegji të lartë profesional, ai do të ofrojë shkollim cilësor për rendin e sigurinë publike, bazuar në një program komplementar e të menduar studimi, me njohuri profesionale, juridike, sociologjike, taktiko-fizike, etj., i organizuar në module dhe vlerësuar në kredite ECTS, të transferueshme, me të drejtën e lëshimit të një diplome profesionale. Në këtë mënyrë, rikthehet në praktikën tonë të shkollimit policor, formimi solid profesional, me programe të rinovuara, tashmë në formën e “Shkollës së Inspektorëve”. Lidhur me të duhen gjetur mekanizmat ligjore që, pas një periudhe pune trevjeçare në shërbimet dhe strukturat e bazës, studentët cilësorë gjatë shkollimit bazë dhe me rezultate të spikatura në punë, të mund të pranohen në shkollën e lartë të policisë. Ndërkohë që, studentët e ekselencës duhet të fitojnë një të drejtë direkte studimi për programin “Bachelor”.

4.c. Sistemi i kualifikimit vazhdues⁹. Mbështetur në përvojën tonë dhe në eksperiencën e shkollave të vendeve të tjera, për të siguruar vazhdimësinë e procesit të formimit profesional, lypset ndërtimi i një sistemi efikas kualifikimi e specializimi vazhdues apo në vijimësi, i cili çmohet e duhet vlerësuar si pjesë integrale e programeve të studimit dhe aspekt i rëndësishëm i reformës së sistemit arsimor. Në praktikë, me programe të formimit të vazhduar nënkuptohen specializime afatshkurtra, plotësime dhe freskim i

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

njohurive me synim azhurnimin e njohurive të personelit me aktet e reja normative dhe ndryshimet në legjislacion. Por, në arsyetimin tim, "formimi vazhdues, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës", ballafaquar me misionin e policisë, me nivele të larta e të mprehta kriminaliteti dhe në një mjedis social e ekonomik gjithnjë në ndryshim, merr përmbajtje e përmasa të tjera. Roli dhe detyrat e procesit kualifikimeve, trajnimeve, specializimeve, etj., që duhet të realizojë ai, veçanërisht në luftën ndaj krimit të organizuar, terrorizmit e trafiqeve kriminale, i tejkalojnë përmasat normale të specializimeve e kualifikimeve afatshkurtra.

Në konceptin tonë, "formimi vazhdues", duhet përfytyruar si sistem programesh me synime e objektiva të gjera, të thella, specifike dhe të integruara me nivele të tjera arsimimi. Ai duhet të konsiderojë nivelin e arritur nga zhvillimi i programeve të mëparshme, t'i ripërtërijë ato dhe të ndihmojë në realizimin si duhet te detyrave e përgjegjësiave për njohjen dhe zbatimin në kohë të ligjeve e akteve nënligjore e normative të fushës së kontrollit të krimit dhe sigurisë publike. Qasja jonë është që për realizimin e tyre të përdoren forma të reja të mësimdhënies, ndjekja e leksioneve dhe seminareve në distancë "online", ashtu sikurse vlerësimet për realizimin e programeve, mënyrën e zhvillimit të tyre, shkallën e frekuentimit dhe përvetësimit etj., të jenë të matshme dhe të materializuara në kredite. Këto kredite të fituara nga kualifikimet e specializimet e zhvilluara, duhet të bëhen pjesë e vlerësimit të performancës vjetore të personelit. Përdorimi i këtyre formave besojmë se do ta nxjerrë procesin e sotëm, nga formalizmi, nga mbivendosja e kurseve, nga mospjesëmarrja e shmangiet e shefave, me motivin "kemi punë", etj. Synimi është që nëpërmjet kualifikimit, sipas shërbimeve apo sektorëve specifikë, të bëhet azhurnimi në vijimësi, me metodologjitë dhe teknikat e reja të operimit, gjurmimit dhe intervenimit policor, me aktet ligjore e nënligjore të dala dhe praktikat pozitive, thellimit të njohurive në fushat specifike, për të ruajtur e përtërirë nivelet e kualifikimit dhe shtuar njohuritë në fushën e operimit policor.

5. Përfundime

Vështrimi analitik dhe çështjet e argumentet që sollëm lidhur me korrelacionin dhe impaktin e sistemit të shkollimit e të kualifikimit në përballjen me rreziqet dhe kërcënimet ndaj sigurisë, por edhe me sfidat dhe zhvillimet në fushën e rendit e të luftës ndaj krimit, vërteton edhe një herë faktin që nivele normale sigurie dhe parametra optimale të rendit kushtëzohen në mase të konsiderueshme edhe nga veprimtaria e institucioneve të arsimit të policisë shqiptare. Në kushtet aktuale të zhvillimit, ne i kemi potencialet e nevojshme njerëzore, ekonomike e materiale për t'i mbajtur eficientë instrumentet e sigurisë, për të mbrojtur dhe zhvilluar interesat kombëtarë. Arsimi dhe kualifikimi policor është vlerësuar si pjesë integrale e arsimit të lartë në vendin tonë dhe, si i tillë, ka qenë në një proces të paprerë reformimi, për të nxjerrë profesionistë të aftë për nevoja të rendit, sigurisë e luftës ndaj krimit.

Nëse mbajmë në konsideratë kushtet dhe nivelin ekonomik, ritmet e zhvillimit, por dhe shndërrimet e mëdha social-ekonomike e politike të këtyre viteve, del se arsimimi policor është zhvilluar në mënyrë cilësore. Nëse marrim në konsideratë kohën relativisht të vogël (rreth 45 vjet), nga hapja e Shkollës së Lartë të Policisë e deri sot, kur po përgatitemi të çelim studimet doktorale (në shtete të tjera evropiane këto shkolla janë themeluar 150-200 vjet më parë); ndryshimin e sistemit politik dhe zhvillimet sociale e ekonomike, në vend e në rajon, prapambetjen relative që trashëguam nga e kaluara

jonë, etj., si dhe hapat e hedhur për kualifikimin e trupës policore qysh nga krijimi i Shtetit Shqiptar, konkludohet se është ecur relativisht drejtë dhe kemi eksperiencë të vlefshme të cilave mund të duhet t'u referohemi. Institucionet e arsimit dhe kualifikimit të krijuara pas formimit të policisë, morën trajtë më të plotë gjatë kohës së monarkisë, u ringritën në një stad më të lartë gjatë viteve '70-80 dhe u modernizuan në dekadat e fundit 2000-2010.

Rihapja e Akademisë së Sigurisë në 2015 dhe çelja e programeve “Bachelor” e “Master” për Rendin e Sigurisë zgjidh përfundimisht përgatitjen e personelit nivelit të komisarëve dhe menaxherëve e drejtuesve të strukturave, ashtu sikurse themelimi i Kolegji Profesional të Lartë, si pjesë integrale e arsimit të lartë policor, do të ofrojë shkollim cilësor për rendin e sigurinë publike, për nivelin e inspektorëve të policisë në rolet e specialistëve të kontrollit të territorit. Kjo do të arrihet duke mbajtur parasysh natyrën e procesit akademik ku, formimi profesional i studentit të mbështetet sa në mësimet teorike aq edhe në praktikën në terren, organizimi i mësimdhënies me grupe të vogla studentësh dhe disponimi i një baze materiale e teknike në ndihmë të formimit. Sipas August Uollmerit, një ndër themeluesit e policisë moderne amerikane “...çdo gjë që ndodh në situatat reale, duhet të gjendet diku e trajtuar në librat mësimore. Ky është kriter i rëndësishëm i metodave të mësimdhënies dhe praktikave të studentëve në shkollat e policisë, pandashmëria e teorisë me praktikën e gjallë në terren”.¹⁰

Ajo që synuam të arrijmë me anë të kësaj trajtese, është që nëpërmjet një vështrimi studimor mbi shkollën shqiptare të Policisë të evidentojmë rrugët, mjetet dhe mënyrat e rritjes së efikasitetit të institucioneve akademike për realizimin e misionit dhe përgjegjësisë, në fushën e rendit, të luftës ndaj krimit dhe sigurisë në tërësi. Me theks të veçantë që, këtij procesi zhvillimi e modernizimi, t'i bashkohen të gjitha institucionet e arsimit të burimeve njerëzore të agjencive të zbatimit të ligjit e strukturave të sigurisë, më konkretisht të gjitha nivelet e personelit të policisë shqiptare.

Referenca

1. Gjonça, Luan dhe Genci Gjonça. *Kriminologjia (tekst mësimor)*. Tiranë: Adel Print, 2009.
2. Kerri, N. dhe Pandeli Taçi. *Kriminaliteti, rendi dhe policimi, nr.1*. Tiranë: Akademia e Policisë, 2001.
3. Sinjari, Stavri dhe Sofokli Duka. “August Uollmer - babai i policisë moderne amerikane”. *Policimi dhe Siguria, nr 2*. Tiranë: Akademia e Sigurisë, 2016.
4. US Federal Bureau of Investigation (FBI). *Federal Bureau of Investigation Strategic Plan 2004-2009*. Washington, DC: FBI, Office for Victim Assistance, 2004.
5. Ligji nr. 8572, datë 27.1.2000 “Dokumenti i Strategjisë së Sigurimit të RSh”.
6. Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, neni 4/1 dhe neni 17/1.b.
7. VKM nr. 281, datë 2.6.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Akademisë së Policisë”.
8. VKM nr. 405, datë 15.9.1992 “Për krijimin e Akademisë së Rendit Publik”.
9. VKM nr. 437, datë 12.9.1994 “Për disa ndryshime e shtesa në VKM nr. 405, datë 15.9.1992 “Për krijimin e Akademisë së Rendit Publik”.
10. VKM nr. 524, datë 1.8.2003, “Për hapjen e Shkollës Pasuniversitare pranë Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari”.
11. VKM, nr. 361, datë 18.7.2002 “Strategjia kombëtare e luftës kundër TQNJ”.
12. VKM, nr. 171, datë 11.2.2005 “Strategjia Kombëtare kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimë të trafikimit”.
13. “Strategjia e Policimit në Komunitet”, tetor 2005.
14. “Strategjia për Kontrollin e Kufirit dhe Menaxhimin e Integruar të tij”, dhjetor 2002.
15. VKM nr. 292, datë 7.5.2004, “Strategjia Kombëtare Antidrogë, 2004-2010”.
16. Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.
17. Ligji nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSh”.
18. VKM nr. 185, datë 25/02/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

Lëvizja e emigrantëve dhe impakti mbi sigurinë

Msc. Qetësor GURRA
Akademia e Sigurisë
qetesor.gurra@asp.gov.al

Msc. Jonida GURRA
Mnistria e Drejtësisë
gurrajonida7@gmail.com

Abstrakt

Ky punim mbart përpjekjen për të paraqitur tablonë e lëvizjes masive të emigrantëve dhe refugjatëve, duke u ndalur në impaktin që tërheq pas vetes ky fenomen gjithnjë e më shumë shqetësues dhe vështirësisht i kontrollueshëm kundrejt sigurisë dhe ruajtjes së rendit publik. Fillimisht do të ketë një trajtesë mbi të dhënat e fundit, lidhur me gjendjen aktuale të ekspansionit të lëvizjes së emigrantëve në drejtim të shteteve të ndryshme. Do të trajtohen emigrantët shqiptarë, por edhe të vendeve të tjera të cilat mbartin vështirësi e arsye të ngjashme për t'u larguar dhe për të marrë përsipër rrezikun e riskun zhgënjes të mundshëm - ashtu sikurse shpresën dhe realizimin e objektivave të tyre, edhe pse të realizueshme në kuadrin kohor afatgjatë. Në vijim, do të përmenden tërësia e organizmave dhe organeve institucionale ose jo, të cilat kanë detyrimin ligjor ose kanë marrë përsipër misionin, detyrën të monitorojnë, kontrollojnë, lehtësojnë, ndihmojnë, japin zgjidhje tërësisë së problematikave që paraqesin nevojë zgjidhjeje dhe parandalimi përballë efekteve negative që shpalojnë emigrimi gjithnjë e më shumë i gjerë. Më tej kryefjala e kësaj teme konference, cenimi i sigurisë së popullatës do të trajtohet lidhur me zhvillimet e dhimbshme të realitetit duke vendosur theksin ulëritës në rëndësinë që ka menaxhimi i krizës së emigrantëve, përballja me kërcënimet që kjo e fundit paraqet, policimi në të tilla situata të përkeqësuar dhe qasjet efektive të cilat këshillojnë bashkëpunim, koordinim me tërësinë e aktorëve përbërës ndihmues për të përmirësuar problematikën e shumta që konstatohen. Në përfundim të këtij punimi pasi të jenë analizuar tërësia e komponentëve të trajtuara do të ofrohen rekomandime e zgjidhje alternative.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

Fjalëkyçe:

krizë emigrantësh, siguri, rend publik, policim, zgjidhje.

1. Hyrje

Tre çështjet e trajtuara në vazhdimësi të temës përpiqen të sjellin vërtetësinë e gjendjes aktuale dhe ndër vite të lëvizjes së emigrantëve dhe refugjatëve. Fillimisht trajtesa përpiket të sjellë të rejat më të fundit në arenën evropiane, duke shpalosur në të njëjtën kohë dhe mekanizmat mbrojtjes parandaluese dhe operacionale që mbart Bashkimi Evropian. Aty do të flitet me fakte konkrete, duke u përpjekur që të nënvizohet jo vetëm masiviteti si vlerë numerike, por gjithashtu edhe tërësia e veprimtarive të kryera dhe instrumenteve të mobilizuara që përpjekin të servirin efektivitet dhe kontribut maksimal në aspiratat afatgjata vendimmarrëse. Në vijim, trajtimi i problematikave në Republikën e Shqipërisë, tregon rrugëtimin e vuajtur që ndjek një shqiptar, i cili në momentin që nuk mundet të gjejë një mundësi legale të largohet nga kufijtë, mjaftohet me migrimin e brendshëm pavarësisht se ky i fundit nuk paraqet ndryshueshmëri standardi jetese aspak domethënëse, ose nuk ka alternativë tjetër përveçse të largohet në forme ilegale. Të dhënat ndalen gjerësisht në vendet si Greqi, Itali, Shtete të Bashkuara të Amerikës, Gjermani, Britani, duke u renditur jo më kot në të tillë rend kronologjik pasi shpalosin dhe preferencën e zgjedhjes ose vërtitjen e fatit për emigrantët shqiptarë. Cenimi i sigurisë, lidhur dhe me ngjarjet tragjike terroriste në shtetet evropiane përveç mekanizmave mbrojtës që kërkon nevojshmërisht, trajtuar dhe në pjesën e parë të temës nga instancat evropiane është parë dhe në spektrin e fajësimit të tërthortë të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian pasi realisht mikpritën pafund të popullatës, por izolimi ekonomik dhe mundësitë e limituara, koordinimi dhe mungesa e informacionit pason në krijimin e një mjedisi delikuent dhe të rrezikshëm qoftë për ta qoftë për këdo që i rrethon.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit »

2. Gjendja aktuale e krizës së emigrantëve në Evropë

Gjatë dy viteve të fundit Evropa ka përjetuar një ndër lëvizjet më masive të popullatës që nga Lufta e Dytë Botërore¹. Më shumë se një milionë refugjatë dhe emigrantë kanë shkuar në vendet e Unionit Evropian, pjesa më e madhe e tyre nga Siria, vendet pranë saj dhe vende të tjera problematike e konfliktuale². Bashkimi Evropian ka konstatuar dhe ndërmarrë përpjekje emergjente, për ndihmesë dhe dhënie zgjidhjesh alternative, a qoftë adekuate, për situatat konkrete që janë krijuar. Mobilizimi nënkupton analizimin dhe studimin e shkaqeve të krizës që shkakton lëvizje masive dhe, krijim ndihmese gjithnjë e më masive ndaj emigrantëve dhe refugjatëve, duke pasur mbi të gjitha nën fokus asistencën humanitare. Hapa të lëvdueshme janë bërë në lidhje me zhvendosjen dhe sistemimin e azilkërkuesve, gjithashtu reformimi e kthimi pas i pseudoazilantëve që nuk përmbushin kriteret. Bashkimi Evropian po përmirëson sigurinë në kufijtë e shteteve duke shumëfishuar kontrollin e kufijve detarë dhe tokësorë për të eliminuar vakuumet përpjekëse për hyrje jo të ligjshme dhe të rrezikshme kundrejt ruajtjes së rendit publik. Lëvizje të shumta njerëzish kërkojnë azil në Bashkimin Evropian. Kjo është një formë e përshtatshme për të dhuruar mbrojtje kundrejt individëve, të cilët largohen nga vendi i tyre të dëshpëruar nga frika, pasiguria e keqtrajtimit dhe përndjekjes. Mbi të gjitha obligimi ligjor dhe moral i Unionit Evropian është të ndihmojë në rast nevojë emergjente dhe problematikash të agravuara. Shtetet anëtare të BE kanë detyrimin të analizojnë çdo aplikim dhe të vendosin shpërndarjen e duhur të mbrojtjes.

Duhet përmendur gjithashtu fakti, se jo çdokush ka nevojë për mbrojtje. Familje të shumta largohen nga vendlindja, duke tentuar arritjen e një jete më të mirë dhe standardesh të mira mirëqenieje. Këta të fundit quhen emigrantë ekonomike dhe nëse përpjekja e tyre për azil dështon ose nuk aprovohet, atëherë instancat kombëtare shtetërore kanë detyrimin t'i zhvendosin nga vendi i largimit drejt një shteti tjetër qoftë fqinj ose jo. Mijëra njerëz kanë humbur jetën gjatë përpjekjeve për të kaluar nëpërmjet detit në BE. Rreth 90% e emigrantëve dhe refugjatëve kanë paguar grupe të mirëorganizuar kriminale dhe kontrabandiste për të kaluar kufirin³. Të tillë individë quhen emigrantë ilegalë, të cilët nuk përqafojnë ligjërisht futjen në Unionin Evropian dhe nuk futen me tagra dashamirëse dhe mikpritëse ashtu sikurse kanë realisht nevojë në territorin e dëshiruar. Sigurimi i ushqimit, ujit dhe një strehë përbën një sforcim të madh burimesh për shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Vlen të përmendet rasti i Greqisë dhe Italisë, ku emigrantë të panumërt u drejtuan fillimisht në vendet e tyre të dëshiruara. Vijon të jetë ende e madhe nevoja për të hyrë definitivisht në shtetet si: Gjermania, Suedia. Kjo lëvizje masive ka shkaktuar probleme të shumta në vendet tek të cilat emigrantët duhet të kalonin, për të arritur destinacionin e tyre final si për shembull: Kroacia, Hungaria, Austria dhe Sllovenia⁴. Në një pjesë të madhe të BE, konkretisht zona Shengen, njerëzit mund të lëvizin lirshëm, pa kontroll të brendshëm kufitar, por lëvizja masive e emigrantëve ka bërë që disa vende anëtare të Unionit të komplikojnë

¹Uebi i publikimeve të Bashkimit Evropian, korrik 2016, fq. 1. <http://publications.europa.eu/webpub/com/factsheets/refugee-crisis/en/>

² Ibid.

³ Ibid, fq 2.

⁴ Uebi i publikimeve të Bashkimit Evropian, korrik 2016, fq. 2. <http://publications.europa.eu/ëebpub/com/factsheets/refugee-crisis/en/>

mënyrën e kontrollit çka mbart një kosto pakënaqësie në shumë aspekte. Masiviteti i emigrantëve nuk është shpërndarë në mënyrë të barabartë çka vështirëson tej mase efektivitetin e masave që ndërmerren. Në 2015 , 75% e aplikimeve për azil ishin të regjistruara vetëm në 5 vendet anëtare të BE si: Gjermania, Hungaria, Suedia, Austria dhe Italia⁵.

BE së fundmi ka mundur të arrijë një marrëveshje me Turqinë, e cila mbart si qëllim në vetvete ndalimin dhe filtrimin e masës së gjerë që vjen nga deti Egje. Marrëveshja gjithashtu ofron mënyra legale për t'ju drejtuar ligjërisht Evropës. Rrjedha lëvizëse e emigrantëve dhe refugjatëve është reduktuar si rezultat i kësaj vendimmarrjeje. Ndryshimi ndihet ndjeshëm në shifrat e ofruara ku nëse në një ditë tetori të vitit 2015 prurja ishte 7000 për 24 orë sot ajo konkludon të jetë mesatarisht 47 për 24 orë në maj të vitit 2016⁶.

Në total, Bashkimi Evropian ka arsyetuar dhe dedikuar 10 bilion dollarë të buxhetit për ti bërë ballë sfidave dhe problematikave që ka shkaktuar dhe po shkakton lëvizja masive e emigrantëve. Është për të ardhur keq që pjesa më e madhe e këtyre të fundit i drejtohen Unionit vetëm për nevojat bazike jetësore çka paraqet një tablo të dhimbshme të realitetit megjithatë duhet përmendur fakti që projekte të shumta humanitare po financohen nga BE duke pasur nën fokus rreth 50'000 emigrantë dhe refugjatë të mikpritur në Greqi, Itali të cilët kanë një nevojë urgjente dhënieje ndihmëse⁷. Përpjekje ndihmëse të mëdha humanitare janë bërë dhe për vende të cilat nuk bëjnë pjesë në BE, siç janë: Turqi, Libi, Jordani, Irak. Turqia mbart numrin rekord të vendit mikpritës të emigrantëve prej 3 milion nga të cilët vetëm 2.5 janë nga Siria⁸. Mbatja në fokus e vështirësisë së akomodimit të Turqisë ka bërë që vendet anëtare të BE të dhurojnë 6 bilion dollarë për lehtësimin e gjendjes aktuale nga viti 2016 deri në vitin 2018⁹.

3. Kufijtë e Bashkimit Evropian

BE ka rritur kapacitetin e kërkimit dhe shpëtimit operacional në Mesdhe, duke u fokusuar tej mase në trajtimin dhe gjurmimin e rrjeteve kriminale. Duke trefishuar burimet paraardhëse strategjike, është shpëtuar më shumë se 25% e një milion njerëzish në vitin 2015¹⁰. Vendet anëtare të BE-së kanë arritur në sinkron të marrëveshjes në qershor të vitit 2016, duke vendosur dhe përforcuar kufijtë evropiane dhe ruajtjen bregdetare ndërkohë që paralelisht, Zyra e Policisë Evropiane ka hapur një qendër të re emigrantësh evropianë për të mbështetur shtetet anëtare të BE-në në çmontimin e rrjeteve kriminale të përfshira në kontrabandën e emigrantëve të organizuar¹¹.

3.1 Zhvendosja, risistemimi dhe kthimi

Bazuar në propozimin e Komisionit Evropian, shtetet anëtare të BE kanë rënë dakord për herë të parë, për të risistemuar 160.000 azilantë nga Greqia dhe Italia në

⁵ Ibid, fq 2.

⁶ Ibid.

⁷ Ibid, fq 3.

⁸ Ibid, fq 3

⁹ Uebi i publikimeve të Bashkimit Evropian, korrik 2016, fq. 3. <http://publications.europa.eu/ëebpub/com/factsheets/refugee-crisis/en/>

¹⁰ Ibid.

¹¹ Ibid.

vende të tjera të Unionit, deri në shtator të vitit 2017¹². Gjithsesi deri në korrik të vitit 2016 vetëm 3.000 azilantë kanë mundur të sistemohen sërish. Institucionet shtetërore kanë nevojë gjithnjë e më shumë të rrisin tempin e planifikimit dhe veprimtarive të koordinuara konkrete për të ndihmuar dhe përmirësuar nevojën për mbrojtje¹³. Ajo çka përbën problematikë të theksuar është dhe përsosja e mënyrave të sigurta dhe ligjore të hyrjes së emigrantëve në BE në mënyrë të atillë që të mos rrezikohen jetët e tyre, kursimet e vetme që ata mund të mbartin prej shumë vitesh por mbi të gjitha të mos jene gurë frymorë fitimprurës në duart e kontrabandistëve dhe trafikantëve të cilët jo vetëm nuk kanë mëshirë për ta por gjithnjë e më shumë tentojnë të sofistikojnë bashkëpunimet e rrezikshme të cilat cenojnë, dëmtojnë sigurinë e rendin e popullatës së përgjithshme. Një program vullnetar i BE ka vendosur në sajë të rënies dakord me të gjitha shtetet anëtare të Unionit për transferimin e 22.500 njerëzve nga vendet jashtë Bashkimit Evropian në një shtet anëtar të tij¹⁴. Gjithashtu ashpërsia e analizimit të pseudo aplikimeve për azil është ashpërsuar tej mase pasi është e vetmja mënyrë për t'i bërë ballë masave të stërmëdha të emigrantëve në lëvizje e sipër. BE ka rritur normën e kthimit të emigrantëve të parregullt duke rënë dakord të zbatojë, rregulla aktive kthimi konkretisht agjencia kufitare e Bashkimit Evropian ndihmon në koordinimin e fluturimeve të kthimit.

3.2 Marrëveshja me Turqinë

Bashkimi Evropian dhe Turqia kanë rënë dakord në mars të vitit 2016 që emigrantët e paligjshëm që shkojnë në ishujt grekë nëpërmjet Turqisë të kthehen në Turqi. Skema mbart detyrimin që për çdo sirian të rikthyer në Turqi nga Greqia në formë ilegale, Bashkimi Evropian do të marrë një sirian në Turqi i cili nuk ka zgjedhur formën ilegale të udhëtimit. Shkëmbimet operacionale kanë nisur nga ishujt greke për në Turqi ndërkohë që paralelisht organizohen fluturime direkt nga Turqia në shtetet anëtare të BE.

Autoritetet përgjegjëse për kontrollin e lëvizjes ilegale të emigrantëve kanë implementuar qendra këshillimi dhe ndihmëse në Greqi dhe Itali të cilat do të bashkëpunojnë me autoritetet e shteteve përkatëse në menaxhimin e rrjedhjeve të emigrantëve. Janë dërguar gjithashtu ekspertë të cilët do të regjistrojnë dhe koordinojnë kthimin e masave të gjera të popullatës në vendin e origjinës. Gjithashtu Unioni Evropian do të jetë në kërkim të partneriteteve me vende të tjera, të cilat do të mundën të përmirësojnë dhe mbrojnë jetën e emigrantëve duke pasur si qëllim në vetvete lokalizimin e arsyeve që çojnë emigrantët ilegale në marrjen e iniciativave të atilla duke i dhënë zgjidhje problematikave në planin afatgjatë e parë perspektivën në formën e duhur parandaluese. Nga raportet e BE flitet që fondi i dhuruar të jetë 8 bilion dollarë deri në vitin 2021¹⁵.

Në parim, BE duhet të fillojë të përsosë politikën e përbashkët të azilantëve, edhe pse janë bërë përpjekje që nga viti 1999, por duhet nënvizuar fakti që rregullat ekzistuese nuk janë dizajnuar në atë lloj shkalle sa të mund të përballojnë denjësisht një numër masiv individësh në hapësira kohe të shkurtra¹⁶. Propozimet e reja, janë duke u diskutuar

¹² Ibid.

¹³ Ibid.

¹⁴ Ibid.

¹⁵ Uebi i publikimeve të Bashkimit Evropian, korrik 2016, fq. 4 <http://publications.europa.eu/ëebpub/com/factsheets/refugee-crisis/en/>

¹⁶ Ibid.

nga Komisioni Evropian për të rishikuar ligjet ekzistuese në përputhje me nevojat aktuale dhe të ardhshme. Qëllimet bazë do të jenë të atilla, që njerëzit të aplikojnë për azil në shtetin e parë anëtar të BE-së, që të hyjnë brenda Unionit nëse nuk kanë familje në vende të tjera. Duhet domosdoshmërisht një solidaritet dhe ndarje e drejtë përgjegjësish brenda Bashkimit Evropian, pasi vetëm në këtë lloj forme, efçensa mund të bërtasë fort për punën dhe sforcon e madhe që po bëhet.

4. Lëvizja masive e emigrantëve shqiptarë

Emigracioni është një ndër arsyet kryesore të uljes së numrit të popullsisë në Shqipëri. Natyrisht që nuk duhet të lihet jashtë vëmendjes, fakti që një pjesë dërrmuese e qytetarëve nuk regjistrohen sistematikisht kur largohen, qoftë për periudha relativisht të gjata ose të shkurtra. Duke qenë se stimuli kundrejt respektimit të dispozitave ligjore lidhur me të tilla procedura, nuk ekziston tek autoritetet vendore, të tilla situata provokojnë atë çka me pak fjalë do të mund ta quanim, kolaps të dhënash aspak të besueshme - qoftë për ne si individë, në kuadër të informacionit, qoftë për institucionet shtetërore dhe akoma më shumë e rëndë për organizmat ndërkombëtare, që shpeshherë kanë nevojë për statistika koherente dhe të sakta. Duke lënë mënjanë vështirësinë e matjes së lëvizjes së emigrantëve në Republikën e Shqipërisë përdoren metoda të tërthorta të cilat konsistojnë në llogaritjen e një popullsie bazë në një vit të caktuar i cili shërben si pikë referimi dhe marrja e të dhënave të vazhdueshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Bëhen me dije normat specifike të vdekshmërisë të cilat në tërësinë e komponentëve të lartpërmendura japin një peizazh të turbullt të numrit të emigrantëve që largohen ndonëse me imazh jo shumë të qartë. Emigracioni është një dukuri e zakonshme në Shqipëri. Zakonisht janë meshkujt ata të cilët largohen por të dhënat e fundit tregojnë se diferenca me gratë ka filluar të jetë jo dhe aq e dukshme pas vitit 1997¹⁷. Në të kaluarën meshkujt ishin më të prirë të merrnin iniciativa largimi, lidhur edhe me mentalitetin që frymëzohej; gjithsesi ajo çka vlen të theksohet, është se të rinjtë madhorë, janë ata që tentojnë vazhdimisht të largohen përfundimisht nga vendi ynë. Ka nga ata individë që i përmbushin aspiratat e tyre individuale duke kryer migracion të brendshëm e ndofta, për plot fatkeqë që nuk kanë as luksin të provojnë të rrezikojnë jashtë kufijve, pasi nuk kanë burime të mjaftueshme monetare dhe u mungon një mbështetje ndofta dhe fillestare. Duke lënë mënjanë, qoftë për pak, analizat e gjendjes aktuale, duhet shprehur se numri i emigrantëve për periudhën 2001–2011 llogaritet të jetë mbi 480.000 persona ndërkohë që nga viti 2012–2016 llogaritet të jetë afërsisht 3/4 e periudhës paraardhëse¹⁸. Të dhënat e paraqitura në INSTAT dhe organizma të tjerë deri diku të besueshëm, tregojnë që jo të gjitha grupmoshat janë aktive kundrejt largimit, më e prekur është popullsia e cila mundet të jetë në moshë pune. Më shumë se 34 % e meshkujve kanë emigruar, duke qenë grupmoshë nga 23 në 38 vjeç¹⁹. Meshkujt më të vegjël në moshë llogariten të jenë 23%. Gjatë viteve 1989–1998 kishte një raport aspak të ekuilibruar në këndvështrimin gjinor, por tashmë gjendja është në raporte të ngjashme edhe pse jo të barabartë²⁰.

Sipas të dhënave, shprehur nga OECD, destinacioni më i preferuar për emigrim nga

¹⁷ INSTAT, *Migracioni në Shqipëri*, maj 2014, fq. 34.

¹⁸ *Ibid*, fq. 34

¹⁹ *Ibid*, fq. 35

²⁰ INSTAT, *Migracioni në Shqipëri*, maj 2014, fq. 35

shqiptarët, është Italia dhe Greqia. Fill pas tyre Gjermania, ShBA-ja dhe Britania e Madhe. Çka rezulton se 47% e emigrantëve jetojnë në Itali, 43 % në Greqi dhe me një përqindje goxha më të ulët në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e më tej²¹.

Në vitin 2011 rreth 450.000 shtetas shqiptarë kishin vendbanim në Greqi ndërkohë që vetëm 346.000 kishin lindur në Shqipëri. Nga të dhënat e Bankës Botërore rezultojnë të numërohen 677.000 shqiptarë në total bashkë me shqiptarët etnikë të cilët kanë lindur në Greqi²². Gjatë viteve 2005–2012 u konstatua një rënie e lëvizjes, por në dallim nga të gjitha shtetet e preferuara të rrugëtimit në 2008 u shënua një rritje emigrimi në Itali dhe një ulje në Greqi. Analiza e faktorëve ekonomikë sociale shpalos ekzistencën e krizës në vendet konsekuente. Nga vitet 2010–2011 dhe më tej, emigrimi është zbutur rreth 40% për Greqinë dhe 25% për Italinë²³. Deri në fund të vitit 2015 në Itali jetojnë 5.014.437 emigrantë të rregullt e emigrantët shqiptarë renditen në vend të dytë për nga numri duke përbërë 12.7% të tyre²⁴. Ndër 129.887 nënshtetësi italiane dhënë emigrantëve të cilët kanë përbushur kërkesat kohore e administrative për marrjen e saj, 16,4% janë emigrantë shqiptarë.

Një milion e 120 mijë shqiptarë jetojnë sot jashtë Shqipërisë. Ky është përfundimi i Raportit të Origjinës dhe Destinacioneve të Emigrantëve nëpër botë prej vitit 1990 deri në 2015. Raporti i bërë nga Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe Qendra e Kërkimeve, tregon se destinacioni i preferuar i emigrantëve shqiptarë gjatë viteve, ka qenë Italia, me 450 mijë emigrantë shqiptarë. Pas Italisë, Greqia me 440 mijë emigrantë e në vend të tretë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me 80 mijë. Në lotarinë amerikane, në vitin 2015 aplikuan rreth 200 mijë shqiptarë. Ndërsa Britania e Madhe pavarësisht lajmeve të shumta për emigrantët shqiptarë, ende nuk ka nxjerrë një shifër zyrtare. Ajo çka konstatohet me keqardhje është që Shqipëria renditet një ndër vendet më të varfra të Europës me një varfëri në rritje 18 % dhe nivel papunësie 33% në vitin 2014²⁵. Deri në vitin 2015 mendohet që emigracioni total ka qenë 1.25 milion shqiptarë në disa shtete ku prezumohet se një pjesë e tyre kanë arritur të gjejnë deri diku një standard jete më të lëndueshëm se sa në vendlindje. Nuk mund të lihet pa përmendur që në gjysmën e parë të vitit 2015 mijëra shqiptarë u drejtuan të dëshpëruar në Gjermani me shpresën se do të mund të fitonin të drejtën ligjore për të qenë azilantë aty²⁶. Duke lënë mënjanë problemet serioze që vendi ynë numëron të ketë në planin politik dhe korrupsionin e rrënjëzuar thellë në shoqërinë shqiptare e aparatin shtetëror, duhet pranuar që përpjekje serioze janë kryer, në përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë evropian, në kuadrin e mbikëqyrjes së emigracionit dhe standardeve operacionale në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian.

5. Rrezikshmëria që mbart për sigurinë dhe rendin emigrimi masiv

Pasi analizojmë deri diku gjendjen e emigracionit në rajon dhe në vendin tonë do të ishte e rëndësishme të kuptonim dhe impaktin e pasojat që ka emigrimi në cenimin e

²¹ Ibid, fq. 35.

²² Banka Botërore, *Urban Development, Migration and Poverty Reduction*, 2010, fq. 21

²³ INSTAT, *Migracioni në Shqipëri*, maj 2014, fq. 36.

²⁴ Uebi, *StranierItalia.com*, 2014 fq. 2.

²⁵ Resneck, Jacob. *Germany's media blitz to discourage Balkan migrants*. 2015. Fq. 5.

²⁶ Ibid, fq. 3.

sigurisë së rendit publik. Është e vërtetë, që fluksi i popullatës ndikon në grumbullimin e detyrave të panumërta të instancave shtetërore dhe organizmave ndërkombëtarë, në planin organizativ e operacional të numrit të madh të emigrantëve lidhur me sistemimin e tyre, vëzhgimit të detajuar të kërkesave për azil, etj., por në të tilla situata të mëdha fluksi, kontrolli vështirësohet. Vakuumi iurvejimit krijon rrezikshmëri lidhur me sulme terroriste, probabilitet më të lartë për konflikte në ambiente ku varfëria dhe përpjekja për qëndrim legal është tejet e madhe dhe numri i masës së popullatës gjithashtu. Konstatohet se terroristët zakonisht kanë hyrë në territoret e shteteve si emigrantë ose turistë. Këta të fundit në Evropë ka qenë përgjegjës për 64 % ose 3'025 vrasje deri në fund të vitit 2015.

Teksa ndjenjat humanitare në Evropë janë pa dyshim të sinqerta, fluksi i refugjatëve sirianë bart me vete kërcënime të mëdha. Problemi janë më pak refugjatët në vetvete, sesa ardhja e tyre në kontinentin e vjetër, që po shton edhe më shumë tensionet e emigrantëve ekzistues, të cilët tashmë nuk janë më të imunizuar ndaj akteve të dhunës²⁷.

Kjo dukuri ngre perspektivën e një dhune më të madhe, jo vetëm nga që do të mund të bëhen xhihadistë, por edhe ndaj elementëve të tjerë në komunitetin e imigrantëve, si dhe një numër në rritje të vendasve të irrituar evropianë, një model që do ta rrënojë strukturën sociale të Evropës, dhe do të zbehë më tej perspektivën tashmë të kufizuar ekonomike²⁸.

Shumë kohë para se sirianët të fillonin të vinin në Evropë, komuniteti i emigrantëve myslimanë u rrit ndjeshëm, dhe ishte tejet i pakënaqur në atë masë sa të shkaktonte tensione sociale të konsiderueshme ndaj duke lënë mënjanë xhihadistët e rastit, ndjenja e izolimit dhe e mungesës kryesisht të mundësive ekonomike, i pati shtyrë njerëzit tek sjelljet antisociale²⁹.

Te dhimbshme janë trazirat që ndodhën në periferinë e Parisit në vitin 2005 dhe të tjerat që pasuan me tej, por pavarësisht se faji fillimisht u hodh direkt në subjektet myslimane arsyet e mirëfillta ishin me komplekse dhe mbartin prapaska pakënaqësi ekonomike dhe sociale. Emigrantët e lokalizuar në Gjermani janë pak më të dhunshëm, por vazhdimisht ankohen për diskriminim, çka shton akoma më shumë mundësinë e konflikteve të mundshme. Sado që racizmi ekziston, shqetësimet e këtyre njerëzve meritojnë vëmendje. Tek e fundit, janë fshatrat dhe jo rrethinat e qyteteve të mëdha dhe të zhvilluara, ato që kanë ndryshuar rrënjësisht me shtimin e komuniteteve të emigrantëve³⁰. Do të ishte mohim i natyrës njerëzore, të mendohet se këta njerëz nuk kanë arsye të ndihen të tjetërsuar e të frikësuar, përballë një ndryshimi të tillë. Shkalla e lartë e papunësisë, veçanërisht në mesin e të rinjve evropianë, vetëm sa e ka ndërlikuar më tej problemin. Është e vështirë të jesh i mirëpritur sot në Francë, kur rreth 25 për qind e të rinjve janë pa punë, 45 për qind në Itali dhe pothuajse 50 për qind në Spanjë³¹. Përkundrazi, ky lloj presioni i tundon njerëzit të fajësojnë të ardhurit për gjendjen e tyre. Sado të padrejta që mund të jenë ndjesi të tilla, ato gjithsesi mbeten një fakt i kuptueshëm i jetës, që ka gjetur shprehje në veprimet politike dhe antisociale. Aty ku ankesat e emigrantëve janë shqetësuese, ajo ka bërë shumë pak për t'i integruar ata në ekonominë, dhe aq më pak në kulturën vendase. Përkundrazi, strukturat ekzistuese

²⁷ Milton Ezrati, *Tridhjetë të nesërmet*, 2015, fq. 7.

²⁸ *Ibid*, fq 7.

²⁹ *Ibid*, fq 8.

³⁰ *Ibid*, fq 8.

³¹ *Ibid*, fq 10.

duken të projektuara për t'i mbajtur emigrantët të izoluar, në një kohë që kufizojnë mundësitë e tyre ekonomike. Të kufizosh mundësitë ekonomike do të thotë të krijosh hapësira për mungesë stabiliteti dhe rrezikshmëri çka mund të jetë me pasoja fatale për të ardhmen. Jo të gjithë do të kenë një botëkuptim qytetar dhe të ndërjegjshëm për të jetuar dhe u adaptuar me shtetet mikpritëse në momentin që ata sado galopante do të dhurojnë mundësi integrimi, pasi duhet kuptuar dhe pozicioni i tyre. Fluksi emigrantëve ka bërë mbipërdorim të burimeve dhe potencialeve që ata mund të japin. Pra nëse burimi do të ishte efektivisht i përthithur drejtë për 10 persona ai tashmë nisur dhe nga masiviteti trokitës i njerëzve duhet të shërbejë për 50 persona.

Duhet vlerësuar angazhimi i Bashkimit Evropian dhe shteteve anëtare, lidhur me mënyrën si po përpiqen t'i bëjnë ballë krizës së emigrantëve dhe refugjatëve, por mos harrojmë që, pavarësisht tërësisë së objektivave që përpiqen të jetësohen sa më mirë të jetë e mundur, e keqja nuk mund të asimilohet, pasi ajo vazhdon të jetë po aq e papritur dhe jonjerëzore në vendet më të zhvilluara botërore, aq më tepër, në të tilla territore të mbipopulluara. Prapaskena delikate janë shtruar në diskutim, lidhur dhe me origjinën e vatrën ideore furnizuese të emigrantëve që zgjedhin të prishin rendin e të shtojnë viktimat, por kryefjala e kësaj teme nuk duhet të thellohet në zymtësinë e informacioneve të shumëpërfolura, por fatkeqësisht jo zyrtare.

6. Përfundime

Rastësia bëri që mbajtja e kësaj konference, do të bëhet pikërisht pas mbledhjes plenare të Asamblesë së Bashkimit Evropian, e cila është mbajtur në 19 shtator 2016 për krizën masive që ka shkaktuar lëvizja e emigrantëve dhe refugjatëve³². Paneli i mirëstrukturuar nga ekspertë të sferave të ndryshme dhe funksionarë të lartë, do të mundë që rekomandimet e tyre t'i finalizojë me praktikitet veprimi, në pesë fusha operacionale të rëndësishme. Atje është dhënë një bazë të dhënash të besueshme ku shprehet se në vitin 2015, numri i emigrantëve në Evropë, ka arritur 244 milion, një rritje prej 71 milionësh çka konsiston në 41% më shumë nga viti 2000³³. Ndërkohë, 150 milion emigrantë të cilët përbëjnë 72.7 % të emigrantëve në total janë në moshë aktive pune³⁴. Kjo përqindje bërtet fuqishëm si një ndër faktorët kryesorë që ka kontribuar në përkeqësimin dhe ashpërsimin e lëvizjes masive si e vetmja mënyrë për t'i bërë ballë pamundësisë dhe varfërisë.

Kryefjala e kësaj teme, cenimi i sigurisë dhe rendit publik nga fenomeni i emigrimit, është përpjekur të analizohet dhe shpaloset nëpërmjet të dhënave të shumta megjithatë natyrshëm lind pyetja. Vallë mekanizmat, instrumentet, instancat shtetërore, organizmat ndërkombëtare janë duke bërë vendimmarrjen e duhur në rrugën që kanë zgjedhur ti japin zgjidhje situatës? Mos vallë në krye të veprimtarive mbrojtëse duhen ezauruar dhe ndërmarrë nisma të tjera? Tërësia e rekomandimeve vazhduese synon të paraqesë zgjidhje të mundshme:

- Përpara se shtetet me të fuqishme evropiane të hapin dyert e mikpritjes, të maten mirë, duke u kujdesur për shtetet në nevojë. Tërësia e projekteve dhe ndihmave qofshin nën tutelën vëzhguese dhe shtrënguese, të jepen në vendin mëmë duke punuar fort për

³² Report of the General Secretary of European Union. *In safety and dignity about addressing large movements of refugees and migrants*, 2016, fq 1.

³³ *Ibid*, fq 4.

³⁴ *Ibid*, fq 4.

parandalimin dhe luftimin e faktorëve të brendshëm, në ato vende pasi nuk mund të përballohen dyndje të stërmëdha popullate, sado fort të punohet dhe angazhohet nga Bashkimi Evropian.

- Nëse vendet anëtare zgjedhin të pranojnë qytetarë të kombësive të ndryshme ti lejojnë këta të fundit me tagra mesatare të integrohen në shoqëri pasi tentacionet aspak të hijshme u sigurojnë atyre veçse kushtet minimale dhe një bllokadë bashkëveprimi me shtetin mikpritës. Diskriminimi ndihet ndjeshëm çka revolton dhe krijon hapësira për konflikte dhe jo vetëm. Nëse individët nuk mundin të gjejnë veten dhe të ndihen deri diku të barabartë në mundësitë e ofruara për të krijuar një stabilitet ekonomik natyrisht që ata do të përpiqen të gjejnë mënyra ilegale ta bëjnë të atillë gjë.

- Të bëhet një ndarje propocionale e emigrantëve dhe refugjatëve në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian. Të japë një ndihmese të jashtëzakonshme media nëpërmjet informimit, duke ndihmuar vetëdijen e popullatës, në mënyrë që ajo mos të udhëtojë qorrazi, pa u orientuar siç duhet, sepse vetëm në këtë lloj forme mundet të luftohet forma ilegale e lëvizjes dhe tërësia e grupeve kriminale, kontrabandiste që mezi presin dezinformim dhe dyndje masive njerëzish për të shtuar gjithnjë e më shumë format e veprave penale të kryera.

- Shtetet problematike dhe ato të cilat aspirojnë të futen në Bashkimin Evropian duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht me Inteligjencën Policore vendore dhe ndërkombëtare, pasi është e vetmja mënyrë të jesh koherente me lëvizjet dhe veprimet e dyshimta, për të pikasur dhe ndaluar sulmet terroriste, aktet kriminale, shfrytëzim i vulnerabilitetit të emigrantëve dhe refugjatëve etj

- Të shikohet me prioritet trajnimi dhe vendosja e profesionistëve në pikat kufitare tokësore dhe vijë bregdetare duke qenë efektive ndoshta dhe me dyfishin e stafit dhe ekspertizës së përdorur, pasi ngjarjet kanë treguar se po aq viktima sa sulmet terroriste kanë pësuar dhe ato vende që përfaqësojnë formën ilegale të transportimit.

- Të ketë një bashkëpunim, solidaritet dhe tentacion pune të palodhur nga tërësia e institucioneve shtetërore të shteteve dhe organizmave ndërkombëtare në kuadrin afatgjatë pasi pritet që deri në vitin 2050 popullsia do të arrije shifrat 9.7 bilion çka do të dhurojë problematika shtesë që nevojshëmrisht do të kenë nevojë për zgjidhje³⁵.

- Të respektohen të drejtat e njeriut dhe gjithnjë e më tepër të bëhet përpilimi i dispozitave ligjore në përshtatje me situatën e agravuar të emigrimit, pasi ende përdoren ligje, të cilat i referohen një situatë normale lëvizjeje popullate. Kur kjo daton të jetë në vendet të cilat mbartin standard të lëvdueshëm, çfarë mund të prezumohet nga vendet e tjera që nuk bëjnë pjesë në atë bashkësi?

- Duke konkluduar me rekomandime për Republikën e Shqipërisë, t'i jepet prioritet problemeve më emergjente në lidhje me lëvizjen masive të njerëzve. Po largohet nga vendi pjesa më e madhe e intelektualëve, të cilët nëse do të lejoheshin të jepnin kontributin e tyre në vendin e lindjes, ndoshta do të ndikonin dhe në kthimin e emigrantëve të cilët prej shumë vitesh janë sistemuar në vende të tjera. Do të rikthehej syri investues dhe kontribuues me kapital nga shqiptarë, çka do të ndikonte pozitivisht në ekonominë dhe mirëqenien sociale gjithashtu do të tërhiqte dhe partnerë ndërkombëtarë.

- Të reformohet arsimit dhe media duke qene dy ndër gurët më sensibilizues të njerëzve çka do ti bënte ata të kuptojnë që nuk është rrugë e zgjidhjes arratisja por

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

³⁵ Report of the General Secretary of European Union, *In safety and dignity about addressing large movements of refugees and migrants*, 2016, fq 7.

dhënia e kontributit duke filluar ndryshimin në planin personal pikë së pari dhe më pas me tej.

Rekomandimet mund të jenë të pafundme, por çka do të mbyllte denjësisht këtë temë është pikërisht bindja se duhet të gjendet bashkëpunimi efektiv midis shteteve, për të bërë koordinim të duhur ndaj krizës së lëvizjes së emigrantëve dhe refugjatëve, pasi vendimmarrja operationale dhe ligjore, duhet jo vetëm që të ndihmojë të tashmen, por të kontribuojë përplot vizion parandalues për të ardhmen.

Bibliografia

1. Albanian Centre for Competitiveness and International Trade, *Study on the Greek Crisis Impact in Albania*, 2012.
2. Barjaba Kosta, *Contemporary Patterns in Albanian Migration*, 2008.
3. Rando Devole Franco Pittau, Antonio Ricci, Giuliana Urso, *Gli Albanesi in Italia, conseguenze economiche e sociali dell'immigrazione*, 2010.
4. European University of Tirana (EUT) Press, *Kurthet e Papunësisë*, 2013.
5. European University of Tirana (EUT) Press, *Rithemelimi i Mireqenies*, 2012.
6. Barjaba, Kosta and Russell King, *The New Albanian Migration*, 2014.
7. Eurostat. 2015, *Azilantët në Bashkimin Evropian*, 2015.
8. German Federal Ministry of the Interior, *Asylanträge im ersten Halbjahr*, 2015.
9. Kapllani, Gazmend dhe Nicola Mai, *Greece Belongs to Greeks*, 2005.
10. World Bank, *Shqipëria Zhvillimi Urban, Migrimi dhe Ulja e Varfërisë*, 2007.
11. United Nations High Commissioner for Refugees (UNHCR), *Country Operation Albania*, 2009.
12. Tirta Mark, *Migrime të shqiptarëve, të brendshme dhe jashtë atdheut*, 1999.

Arsimimi, faktor i rëndësishëm, për neutralizimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm

Dr. Xhavit SHALA

Akademia e Sigurisë
xhavit.shala@asp.gov.al

Msc. Eros SHALA

Autoriteti i Mediave Audiovizive
eros.shala@gmail.com

Abstrakt

Objekti i studimit dhe i hulumtimit në këtë punim është trajtimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm si rrezik e kërcënim për sigurinë dhe i rolit të arsimimit dhe shkollës si faktorë të rëndësishëm për neutralizimin e tyre. Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm nuk janë dukuri të panjohura më parë nga shoqëria njerëzore. Dhuna dhe shkatërrimi të motivuara politikisht për të frikësuar dhe dobësuar elitat, shtetet dhe popujt janë përdorur shpesh gjatë historisë. Por, forma moderne e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, duke shfrytëzuar mundësitë që ofron globalizimi si dhe përparësitë e teknologjisë bashkëkohore të informimit, përbëjnë sot një fenomen të ri. Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm janë klasifikuar në rrethin e kërcënimeve më serioze bashkëkohore për paqen dhe sigurinë kombëtarë, rajonale e ndërkombëtare. Këto kërcënime mund të jenë me sfond etnik, nacionalist, fetar, etj. Prandaj dhe lufta për neutralizimin e këtyre kërcënimeve kërkon një ndërveprim të të gjithë aktorëve qeveritarë dhe jo vetëm, në nivel kombëtar, rajonal dhe më gjerë. Në këtë kumtesë do të fokusohemi kryesisht tek radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm me sfond fetar dhe roli i arsimimit për neutralizimin e tyre. Shqipëria, në Strategjinë e saj të re të Sigurisë Kombëtare ka përcaktuar se "...ritja e radikalizmit fetar, që rrezikon vlerat e harmonisë fetare në Shqipëri dhe që mund të shkaktojë tension shoqëror" ndonëse është klasifikuar në rreziqet e nivelit të dytë, nëse shfaqet "vlerësohet si me pasoja të larta për sigurinë kombëtare". Qeveritë e Shqipërisë, të Kosovës, por dhe të vendeve të tjera të rajonit e më gjerë, i kanë sigurizuar këto kërcënime për sigurinë e tyre, duke e konsideruar luftën kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm si një prej përparësive themelore të programit të tyre politik. Gjatë këtij punimi janë aplikuar metodat dhe instrumentet bazë kërkimore shkencore, sasiore dhe cilësore, si metoda e analizës dhe sintezës, analizës krahasuese, ajo historike, juridike, e krahasimit dhe konfrontimit si dhe e studimit të rastit. Në përfundim të punimit konkludohet ndërmjet të tjerave se, krahas veprimtarisë së institucioneve të sigurisë, arsimimi dhe shkolla janë faktorë të rëndësishëm e të pazëvendësueshëm, për neutralizimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit»

Fjalëkyçe:

arsimimi, shkolla, radikalizmi i dhunshëm, ekstremizmi i dhunshëm, siguri kombëtare, kërcënim, terrorizëm

1. Hyrje

Kërcënimi nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm nuk përbën një fenomen të ri për shoqërinë njerëzore. Dhuna dhe shkatërrimi, të motivuara politikisht për të frikësuar dhe dobësuar elitat, shtetet dhe popujt janë përdorur shpesh gjatë historisë. Por, forma moderne e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, duke shfrytëzuar mundësitë që ofron globalizmi si dhe përparësitë e teknologjisë bashkëkohore të informimit, përbëjnë sot një fenomen i ri. Në Strategjinë e re të Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë, është përcaktuar se “...rritja e radikalizmit fetar, që rrezikon vlerat e harmonisë fetare në Shqipëri dhe që mund të shkaktojë tension shoqëror”¹ ndonëse është klasifikuar në rreziqet e nivelit të dytë, shfaqja e tij “vlerësohet si me pasoja të larta për sigurinë kombëtare.”²

Shqipëria, si pjesë e koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit, është e angazhuar seriozisht dhe i është bashkuar përpjekjeve ndërkombëtare kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Pjesë e këtij angazhimi për koordinimin e përpjekjeve në nivel rajonal është dhe mbajtja në Tiranë e një takimi rajonal në vitin 2015³.

Zhvillimet ndërkombëtare jo shumë larg kufijve tanë etnikë, obligojnë Shqipërinë, Kosovën, por dhe faktorin politik shqiptar në rajon që të koordinojnë masat në forcimin e qëndrueshmërisë së shtetit dhe shoqërisë ndaj kërcënimeve që vijnë nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm. Duke qenë se radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm janë dukuri bashkëkohore globale dhe, aktualisht, përbëjnë një kërcënim serioz ndaj

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit »

¹ *Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë 2014*. Shtojca C: Klasifikimi i rreziqeve, faqe 25. Miratuar me Ligjin Nr.103/2014, Date: 31.07.2014, Flet. Zyrtare Nr.137, Faqe:137.

² Po aty.

³ Më 19 maj të vitit 2015 në Tiranë u mbajt *Samiti Rajonal Ballkanik kundër Ekstremizmit të Dhunshëm*.

paqes e sigurisë kombëtare e ndërkombëtare, qeveritë e Shqipërisë⁴ dhe të Kosovës,⁵ por dhe të vendeve të tjera të rajonit e më gjerë, i kanë sigurizuar⁶ këto kërcënime, duke e konsideruar luftën kundër tyre si një prej përparësive themelore të programit të tyre politik. Krahas veprimtarisë së institucioneve të sigurisë, arsimimi dhe shkolla janë faktorë të rëndësishëm e të pazëvendësueshëm për neutralizimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

2. Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm, rrezik⁷ dhe kërcënim⁸ për sigurinë

Radikalizmi në vetvete nuk përbën kërcënim për shoqërinë. Ai mund të jetë nxitje e një ndryshimi pozitiv. Në disa raste, idetë radikale, ndonëse binin ndesh me opinionet e përgjithshme mbizotëruese të shoqërisë së kohës, kanë luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin e shoqërisë njerëzore⁹. Por, nëse radikalizmi shoqërohet me dhunën apo veprime të tjera të paligjshme si dhe nxitjen e urrejtjes, atëherë ai kthehet në një rrezik, por edhe kërcënim për sigurinë dhe vetë shoqërinë¹⁰. “Radikalizimi në dhunë” është një vendim për të anashkaluar proceset politike apo metodat jo të dhunshme të nxitjes së ndryshimit, duke favorizuar përdorimin e metodave të dhunshme për të sjellë ndryshimin.¹¹ Ai është procesi i përqafimit të opinionëve, pikëpamjeve dhe ideve që mund të çojnë në akte terrorizmi.¹² Vetë radikalizmi që çon në terrorizëm është procesi dinamik, sipas të cilit,

⁴ *Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm*, miratuar me VKM nr. 930, datë 18.11.2015. Fletore Zyrtare Nr. 203 /2015. Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, faqe 13248.

⁵ *Strategjia e Kosovës për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm 2015 – 2020*. Prishtinë 2015,

⁶ “Sigurizimi” si term, i referohet klasifikimit të disa fenomeneve, personave ose entiteteve etj., si kërcënime ekzistenciale që kërkojnë masa të jashtëzakonshme. Kur një çështje klasifikohet në kategorinë e çështjeve të sigurisë bëhet sigurizimi i saj. Një çështje sigurizohet kur kërkon veprime urgjente për të procedurave politike standarde të shtetit. Kjo i referohet një procesi në të cilin një komunitet politik vendos për të trajtuar diçka si një kërcënim ekzistencial dhe për të mundësuar një thirrje për masa urgjente dhe të jashtëzakonshme për t’u marrë me këtë kërcënim”. Ndërsa de-sigurizimi i referohet një procesi që ri paraqet një çështje të sigurizuar në arenën politike standarde dhe që fillon të menaxhohet brenda sistemit politik standard. Është procesi sipas të cilit një komunitet politik ul apo pushon për të trajtuar diçka si një kërcënim. Këto koncepte janë futur nga Shkolla e Kopenhagës. Për më tepër shih përfaqësuesit e kësaj shkolle Buzan, Waever, de Wilde, 1998: 23.

⁷ Termi “rrezik” përfshin në vetvete një gjendje të përgjithshme jo të zakonshme, jo normale, e cila sjell destabilitet apo mënjanim nga zhvillimi normal i ngjarjeve dhe që rrezikon interesat kombëtare në përgjithësi. Ai duhet të merret në shqyrtim për t’u menaxhuar me masa e veprime përkatëse në një kohë të caktuar, me përkushtim të caktuar, për t’u mbajtur në gjendjen ekzistuese duke parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të tij.

⁸ Termi “kërcënim” nënkupton një zhvillim të shpejtë ose të përshkallëzuar të një rreziku konkret, të pa menaxhuar më parë ose të keqmenaxhuar. Ai konkretizohet deri në përdorimin e mjeteve të ndryshme, duke përfshirë mjetet e dhunës, duke vështirësuar dhe vënë në diskutim gjendjen ekzistuese. Kështu kërcënim mund të përkufizohet si rrezik konkret, i shkallëzuar dhe me objektivitet të përcaktuar qartë. Në përgjithësi, në varësi me zhvillimin e ngjarjeve, zakonisht kalohet nga gjendja e rrezikut në atë të kërcënimit. Përvoja e deritanishme ka treguar se në përgjithësi vetëm burimet e rreziqeve mund të shndërrohen në kërcënime.

⁹ Kështu p.sh., idetë e Martin Luther King-ut për përparimin e të drejtave civile të popullsisë me ngjyrë në SHBA, mund të konsiderohen radikale për kohën, por sollën një revolucion në SHBA, për të drejtat e njeriut.

¹⁰ Mundësia e krijimit të një dëmi luan një rol të veçantë në ndarjen midis kërcënimit dhe rrezikut. Për një shtet të caktuar ekziston një kërcënim kur janë përmbyshur tri kushte: Duhet të ekzistojë një kundërshtar (aktori); aktori kundërshtar duhet të ketë një qëllim armiqësor (qëllimi) dhe kundërshtari duhet të ketë një potencial të caktuar ushtarak (potenciali). Mund të flitet për një kërcënim vetëm nëse ekzistojnë njohuri të qarta mbi aktorin, qëllimin dhe potencialin e tij. E thënë më thjeshtë, kemi të bëjmë me një rrezik në qoftë se njëri nga elementet që karakterizojnë kërcënimin është e panjohur.

¹¹ *Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm*, miratuar me VKM nr. 930, datë 18.11.2015. Fletore Zyrtare Nr. 203 /2015. Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, faqe 13249.

¹² *Violent Extremism and Religious Radicalization in Albania*. Publishing IDM 2015, p.9.

¹³ *Parandalimi i terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që favorizojnë terrorizmin: gasja e policimit në komunitet*. Botim i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Vjenë, mars 2014, faqe 16.

një individ nis ta pranojë dhunën terroriste si një mënyrë të mundshme, ndoshta edhe legjitime, veprimi. Eventualisht, por jo domosdoshmërisht, kjo mund ta bëjë personin të flasë në favor, të veprojë në mbështetje apo edhe të përfshihet në akte terrorizmi¹³.

Ndërsa “ekstremizëm i dhunshëm” është përdorimi i dhunës për arritjen e objektivave politikë.¹⁴ Në një farë mënyre radikalizmi i dhunshëm është procesi dhe ekstremizmi i dhunshëm është rezultati.¹⁵ Përshkallëzimi nga “radikalizimi i dhunshëm” në “ekstremizëm të dhunshëm” është në një farë mënyre përshkallëzimi nga rrezik në kërcënim për sigurinë kombëtare¹⁶. Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm mund të jetë me sfond etnik, nacionalist, fetar, etj.

Në përgjithësi, radikalizmit fetar që të çon në terrorizëm, i paraprin ekskluzivizmi fetar, i cili si rrymë përmban moskomunikimin dhe përjashtimin e besimeve të tjera fetare. Njerëzit që i përkasin rrymës së ekskluzivizmit fetar, pra të përjashtimit të besimeve tjera fetare, e shohin besimin e tyre fetar si të vetmen fe të vërtetë. Sipas tyre, fetë e tjera nuk janë të vërteta. Ato janë rivale të fesë së tyre dhe janë forma të satanizmit¹⁷.

Ekskluzivistët fillojnë të ndjejnë veten me identitet tjetër në raport me besimet e tjera fetare. Këtu fillon dhe përcaktimi i kufijve ndërmjet “bashkësisë së vetes” dhe “bashkësisë të tjerëve” dhe se “kush është kundër nesh”, por dhe “kush jemi ne”, duke i përjetuar të tjerët si armiq të rrezikshëm e duke ndjerë veten të pasigurt prej tyre. Në këtë mënyrë, ndërlidhja midis identitetit, frikës dhe sigurisë bëhet e pandashme. Keqpërceptimi i sigurisë, frika, ankthi dhe ndjenjën e pasigurisë së tyre, i nxit ata drejt ppërjashtimit të të tjerëve, intolerancës dhe dhunës. Mbështetësit e ekskluzivizmit fetar, shpesh e gjejnë frymëzimin në interpretimin e gabuar që u bëjnë pasazheve të marra nga librat e shenjtë, si në bibël, ashtu dhe në kuran. Fryma e ekskluzivizmit ekziston, shpesh edhe brenda një feje, duke pretenduar gjoja vërtetësinë e një varianti, krahasuar me një variant tjetër të së njëjtës fe¹⁸. Ekskluzivizmi (përjashtuesit) dhe pluralizmi fetar janë dy rryma kundërshtuese në mënyrën se si e shohin botën fetare në raport me fenë e tyre. Përkrahësve të ekskluzivizmit fetar, nëse u lihet fushë veprimi, jo vetëm që frenojnë komunikimin e dialogun ndërfeetar, por mund të nxisin urrejtjen dhe dhunën ndaj besimeve dhe anëtarëve të komuniteteve të tjera fetare, duke cenuar sigurinë e një vendi.¹⁹ Mungesa e komunikimit dhe dialogut ndërfeetar në dekadat e fundit është shoqëruar me një radikalizim të besimeve fetare i cili nga ana e tij ka çuar shpesh në urrejtje ndërfeetare e ndërtnike, në krime kundër njerëzimit, gjenocide e akte terroriste, duke u bërë në këtë mënyrë një kërcënim serioz për sigurinë kombëtare, rajonale e atë globale. Masakra ndaj popullsisë myslimane në Srebrenicë, në korrik 1995²⁰, Afganistani

¹³ Parandalimi i terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që favorizojnë terrorizmin: qasja e policimit në komunitet. Botim i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Vjenë, mars 2014, faqe 16.

¹⁴ Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, miratuar me VKM nr. 930, datë 18.11.2015. Fletore Zyrtare Nr. 203 /2015. Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, faqe 13249. Burim i cituar

¹⁵ *Violent Extremism and Religious Radicalization in Albania*. Publishing IDM 2015, p.10. Burim i cituar.

¹⁶ Kërcënim i ndaj sigurisë kombëtare konsiderohet kur një ose disa nga interesat dhe vlerat më të rëndësishme kombëtare të një shteti ose kombi, denigrohen në ekstrem, nga veprime të jashtme, të brendshme ose të kombinuara.

¹⁷ Xhavit Shala (2016), “*State, Religious Faith and Security Issues*”, Lambert Academic Publishing, p.124.

¹⁸ Irani, megjithëse edhe vetë ishte një shtet islamik, krijoi rezerva dhe i ndiqte me vëmendje veprimet e talebanëve, për shkak të ekskluzivizmit të besimit Sunni Pashtun të talebanëve.

¹⁹ Për më tepër shih: Xhavit Shala, «*Shqiptarët në udhëkryq*», 42-56, Tiranë, maj 2004. Botim i Qendrës Shqiptare të Studimeve për Sigurinë Kombëtare.

²⁰ VOA 25.03.2016: Drejtuesi i kësaj masakre Radovan Karaxhiç, u dënua për përndjekje, shfarosje, deportim, zhvendosje të dhunshme dhe vrasje – por, u lirua nga akuzat për gjenocid lidhur me një fushatë për të përzënë myslimanët boshnjakë dhe kroatët nga fshatrat e pushtuara nga forcat serbe gjatë luftës së viteve 1992-1995.

i mëparshëm nën regjimin taleban dhe sulmi i 11 shtatorit të vitit 2001 ndaj SHBA-së, akti terrorist i Brejvikut²¹ në Norvegji²², gjenocidi në ditët e sotme i ISIS-it ndaj popullsisë jazide²³ si dhe tendencat e sotme për radikalizmin e islamit ballkanik²⁴ e provojmë më së miri këtë.

Akoma më e rrezikshme është kur ekskluzivizmi fetar kthehet në ideologji sunduese dhe në politikë shtetërore. Në këtë rast kemi të bëjmë me shtete teokratike, të njohura kryesisht në Mesjetë, por që në dekadat e fundit po rishfaqën përsëri. Ekskluzivizmi fetar taleban u bë kërcënim dhe për sigurinë globale²⁵. Në Afganistan u ideua dhe u përgatit sulmi i terrorist më 11 shtator 2001 në SHBA.²⁶ Ekskluzivizmi fetar sot është politikë “shtetërore” edhe në të ashtuquajturin Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë, përndryshe ISIS-i, ISIL-i apo dhe DAESH-it. Ai “është përgjegjës për gjenocid ndaj popullsisë në zonat që kontrollon, ndër ta jazidët, të krishterët dhe myslimanët shiitë. Misioni i tyre i vetëshpallur është gjenocidi, si nga ideologjia, ashtu edhe veprimet e tyre, nga ato çfarë thonë, çfarë besojnë dhe çfarë bëjnë.”²⁷ Ai është bërë qendër botërore për radikalizimin, rekrutimin, trajnimin e qytetarëve të dëshpëruar nga vende të ndryshme të botës, pavarësisht besimit të tyre fetare, si dhe përdorimin e tyre për akte terroriste. ISIS-i, brenda një periudhe më pak se dyvjeçare u bë kërcënim kryesor për sigurinë në Evropë dhe për gjithë sistemin aktual të sigurisë ndërkombëtare. Më 22 mars, ky shtet, me një akt të shpallur lufte, goditi Brukselin, kryeqendrën e vlerave të qytetërimit Perëndimor, kryeqendrën e fuqisë ekonomike të Bashkimit Evropian dhe kryeqendrën e NATO-s, duke sfiduar kështu dhe organizatën më të fuqishme e më të madhe të mbrojtjes ushtarake në botë.

3. Radikalizmi dhe ekstremizmi fetar si rrezik e kërcënim edhe në gjeohapësirën shqiptare

Radikalizimi i besimeve fetare kthehet në një kërcënim serioz edhe në vende me traditë të fuqishme të tolerancës fetare, siç është vendi ynë. Qenia në themel të identitetit kombëtar të shqiptarëve jo i fesë, por i gjuhës, traditës e kulturës²⁸ dhe, më tej, prania e një feje islame, përgjithësisht popullore dhe e zbutur nga bektashizmi²⁹; trajtimi në mënyrë të barabartë i besimeve tradicionale fetare të shqiptarëve pavarësisht raporteve të shtrirjes së tyre në mesin e popullsisë shqiptare; apatia e hershme ndaj rrymave

²¹ BBC 23 qershor 2011, *Anders Behring Breivik, fundamentalist kristian, vret 85 veta kryesisht të rinj e të reja në ishullin Utøya në Norvegji*. Në dorëshkrimin prej 1518 faqesh, të quajtur “*Deklarata Evropiane e Pavarësisë: 2083*”, të publikuar në internet, Anders Breivik shpreh hapur urrejtjen ndaj myslimanëve. Ai parashtron dhe idenë e shfarosjes së tyre si dhe të ndarjes apo shpërbërjes së shteteve islamike.

²² Ardian Vehbiu, ResPublika 30 Korrik 2011: *Breivik-u e shihte veten si kryqtar, misioni i të cilit ishte të luftonte, qoftë edhe duke u sakrifikuar, për të mbrojtur Evropën e Krishterë nga rreziku mysliman*.

²³ VOA 30.10.2014: *Viktimizimi i grave nga ISIS*.

²⁴ Xhavit Shala (2016), *State, Religious Faith and Security Issues*, Lambert Academic Publishing, p.40.

²⁵ Kthimi i ekskluzivizmit fetar në politikë shtetërore shoqërohet me pasoja në politikën e brendshme të këtyre shteteve. Këto shtete bëhen strehë, radikalizues dhe trajnues të e militantëve të së njëjtës fe apo të konvertuar nga vende të tjera. Në politikën e jashtme, këto shtete bëhen shqetësim për vendet e rajonit, nxitëse dhe eksportuese të terrorizmit me kopeturë fetare, duke cenuar, në këtë mënyrë, sigurinë rajonale dhe më gjerë. Në Afganistan, Bin Ladeni gjeti terren dhe në mars 1998 bëri unifikimin, nën komandën e tij, të grupeve terroriste që vepronin në atë kohë dhe krijoi Frontin e Çlirimit të Vendeve të Shenjta, i cili më vonë u njoh si Al Qaeda.

²⁶ Nga «shkolla afgane» kanë dalë një pjesë e madhe e figurave, që u bënë drejtues të rrjeteve terroriste, duke filluar nga Osama bin Laden, Ajman Zavahiri-udhëheqësi aktual i Al Qaeda; Al Zarkavi, drejtues i akteve terroriste në Irak etj.

²⁷ VOA, 17.3.2016, *Deklaratë e Sekretarit të Shtetit të SHBA-së Xhon Kerri*.

²⁸ Veton Surroi, “Fetë dhe civilizimet”, *Gazeta “Korrieri”* 14 nëntor 2003.

²⁹ Mehdi Frashëri, *The ancient History of Albania and Albanians*, p. 44 -45

intolerante në islam, siç është vahabizmi³⁰; ftohja e detyruar e brezit të ri të shqiptarëve ndaj fesë gjatë regjimit komunist; moskthimi i konflikteve ekonomike e shoqërore në konflikte fetare, si dhe tradita e forcave politike shqiptare, që historikisht nuk kanë synuar të krijojnë një elektorat mbi baza fetare³¹, janë disa nga faktorët që i kanë ruajtur besimet tradicionale fetare të shqiptarëve nga radikalizmi dhe ekstremizmi si dhe e shndërruan tolerancën fetare të shqiptarëve në një thesar të vyer të kulturës sonë kombëtare. Por, thesaret e kulturës së një kombi janë gjithmonë të rrezikuara, nëse nuk kujdesesh për to, nëse nuk identifikon faktorët që i rrezikojnë dhe nëse nuk investon për të neutralizuar efektin e këtyre faktorëve. Prandaj dhe toleranca fetare, si thesari i kulturës sonë kombëtare, ndonëse është krijuar dhe ka rezistuar në shekuj, duhet sigurizuar, pra duhen trajtuar si pasuri e rrezikuar³² dhe e kërcënuar nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm. Sipas sondazhit të zhvilluar nga IDM në vitin 2015, prania në komunitet e individëve apo grupeve që nxisin radikalizmin e krishterë dhe islamik pranohet përkatesisht nga 9% e 12% e të intervistuarve³³, ndërkohë që në total 16% e tyre pranojnë se në zonën ku ata jetojnë ka individë që mbështesin ekstremizmin e dhunshëm.³⁴

Ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e rrezikut dhe kërcënimit nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm në vendin tonë janë: Varfëria, papunësia³⁵ dhe tranzicioni i tejzgjatur poskomunist i shoqërisë shqiptare i shoqëruar nga kriza të pakuruara sociale, emocionale, shpirtërore, financiare e politike, bashkëshoqëruar shpesh dhe me mungesën e shtetit ligjor dhe me cënime të rënda të rendit dhe sigurisë³⁶; pamundësia për të ndikuar vendimmarrjen dhe perceptimet për qeverisje të korruptuar apo të padrejtë³⁷; importimi që në vitet e para të demokracisë në mënyrë të pakontrolluar nëpërmjet OJQ-ve të spektrit fetar të një sërë sektesh e rrymash fetare³⁸, të cilat cënojnë të drejtën e shqiptarëve për të ushtruar besimet e tyre tradicionale fetare³⁹; varfëria e komuniteteve fetare, mangësitë në financimin e tyre nga shteti dhe mbështja vetëm në ndihmat që vinin nga jashtë; lejimi i ndërtimeve pa leje të objekteve të kultit dhe jashtë strukturave zyrtare të komuniteteve fetare⁴⁰; vonesa dhe moskthimi i plotë i pronave

³⁰ Arbër Xhaferri te «Religjioni, Politika, Shqiptarët», botuar në *Fetë dhe qytetërimet në mijëvjeçarin e ri - Rasti i Shqipërisë*, faqe 68.

³¹ Artan Fuga - "Sjellja e shqiptarëve të sotëm ndaj fesë". 20 prill 2004 / TN / QSHDNJ.

³² Për më tepër, shih Xhavit Shala, "Çështjet fetare në hapësirat shqiptare dhe siguria jonë kombëtare". Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore me temë "Rruajtja e vlerave kombëtare e fetare të shqiptarëve", mbajtur në Shkup më 3 Shtator 2010.

³³ "Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri". Publikuar IDM 2015, faqe 97.

³⁴ Po aty, faqe 85. Nga ana tjetër, në intervistat e zhvilluara sipas zonave rezultojnë se 30% e të intervistuarve të Komunitetit Qendër-Librashd janë dakord se ka individë që cilët mbështesin ekstremizmin e dhunshëm fetar në zonën e tyre. Ndërsa të anketuarit në Çërrik vijnë të dytët, ku 27% e tyre raportojnë ekzistencën e individëve të tillë.

³⁵ Po aty, faqe 10-11, 61. Sipas sondazhit të realizuar nga IDM në vitin 2015 "Mundësitë e ulëta për punësim pavarësisht arsimimit mund të shërbejnë si një faktor potencial për radikalizim. Kjo ndjesi e përgjithshme privimi dhe pritshmërisht të dështuara përjetohet afërsisht nga gjysma e të anketuarve (49%).

³⁶ Zhvillimet politike në vitet 1991-1992 si dhe ngjarjet e vitin 1997, 1998, etj.

³⁷ "Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri". Publikuar IDM 2015, faqe 11: Pamundësia për të ndikuar vendimmarrjen, qeverisja e korruptuar apo e padrejtë përbëjnë nxitës të fortë të radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm. 26% e të anketuarve besojnë se sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar edhe me dhunë po qe nevoja.

³⁸ Xhavit Shala, *State, Religious Faith and Security Issues*, Lambert Academic Publishing, p.38,122.

³⁹ Po aty, faqe 93:

Rreth 32% e të intervistuarve kanë ndjesinë se besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit të tyre fetar janë nën kërcënim të vazhdueshëm.

⁴⁰ Po aty, faqe 12, 101:

Rreth 28% e të anketuarve shprehen tolerantë ndaj objekteve fetare pa leje (kisha, xhami). Një qëndrim i tillë paraqitet shqetësues duke pasur parasysh se këto mjedise shpesh janë raportuar si propaganduese të ekstremizmit.

të komuniteteve fetare; mungesa e një pakete të plotë ligjore për komunitetet fetare; pozicioni i përshtatshëm gjeografik i Shqipërisë midis Lindjes dhe Perëndimit; mungesa për një kohë të gjatë e strukturave efçente shtetërore⁴¹ që të merreshin me menaxhimin e raporteve ligjore dhe të detyrimeve të ndërsjella të shtetit me komunitetet fetare⁴²; përceptimi i të qenit pjestar i një komuniteti fetar i diskriminuar, i përjashtuar dhe i papërfaqësuar mjaftueshëm në politikë dhe institucione shtetërore⁴³; rritja edhe në vendin tonë e perceptimit se Perëndimi po sulmon islamin dhe myslimanët⁴⁴; pjesëmarrja e dhjetra shtetasve shqiptarë në konfliktin në Siri⁴⁵; lehtësia e radikalizimit dhe rekrutimit të besimtarëve nëpërmjet rrjeteve sociale; trysnia në rritje e rrymave intolerante në islam si vehabi-selefizmi, etj.

Elitat politike dhe qeverisëse të çdo brezi, janë të obliguar të investojë jo vetëm për sigurinë e atij brezi, por edhe për brezat që vijnë. Shtetarët shqiptarë, që pas shpalljes së Pavarësisë investuan shumë për të parandaluar dhe neutralizuar çdo mundësi radikalizimi të besimeve fetare. Çështjet fetare ata i trajtuan gjithmonë si çështje të sigurisë kombëtare.⁴⁶ Që në vitin 1923, Visarion Xhuvani, i cili më vonë bëhet kryepeshkop i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, shprehet: “Të gjithë e dimë që çështjet fetare kanë qenë dhe janë gjithnjë të ngatërruara këtu. Të gjithë e dinë se sa i kanë kushtuar shtetit. Mos e dhëntë Zoti të bëhen vegla dhe për të ardhmen”⁴⁷. Nisur nga këto rrethana specifike, patrioti e shtetari tjetër Mehdi Frashëri, porosiste që “Qeveria duhet të jetë pak më brenda në fetë...”⁴⁸. Për këtë ata në procesin e shtetformimit shqiptar synuan ndërtimin e një shteti “laik veprues” dhe jo “neutral pasiv”. Është për të ardhur keq që në vitet e para të pluralizmit, u hoq çdo mbështetje shtetërore e materiale ndaj fesë dhe u preferua “neutraliteti pasiv” në vend të traditës shtetërore shqiptare të “laicitetit veprues”. Ligjvënësit shqiptarë, nuk u angazhuan si paraardhësit e tyre patriotë, në rikrijimin e asaj infrastrukture të domosdoshme ligjore për të mbrojtur besimet fetare shqiptare nga rrezikët dhe kërcënimet.

Kjo i hapi rrugë depërtimit në vend të vehabi-selefizmit, të cilat përfaqësojnë jo vetëm rryma intolerante e radikalizuese në islam, por përbëjnë rrezik për demokracinë shqiptare, shtetin e të drejtës, të drejtat e njeriut dhe për vetë sigurinë tonë kombëtare. Sot nuk është antiligjore të jesh vehabit, ajo është zgjidhje personale. Por që nga momenti që ata organizohen dhe përpiqen të radikalizojnë dhe me dhunë t’u imponohen të

⁴¹ Në Shqipëri, nga viti 1992, ekziston vetëm Komiteti Shtetëror i Kulteve. Me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 459, datë 23.9.1999, “Për Krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet”, për herë të parë përcaktohen detyrat e kësaj strukture. Kjo strukturë ka ardhur në vazhdimësi duke u reduktuar më personel. Në shumë shtete të tjera, sidomos të Lindjes ish-komuniste, struktura të tilla janë në nivel ministrie.

⁴² Më datë 24 Tetor 2008, pas 18 vitesh demokracie dhe pas dhjetë vitesh të detyrimit kushtetues, u nënshkruan marrëveshjet midis qeverisë shqiptare dhe komuniteteve tradicionale fetare në vend.

⁴³ 51% e të anketuarve besojnë se komuniteti fetar, të cilat ai i përket, nuk është i përfaqësuar mjaftueshëm në politikë dhe institucione shtetërore. (Sondazh i realizuar nga IDM në vitin 2015. faqe 11, 55. Burim i cituar)

⁴⁴ “Radikalizimi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri”. Publikuar IDM 2015, faqe 91: 34% ose një në tre të anketuar beson se “Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën Islame”. Në një total prej 792 personash të cilët kanë pranuar të përgjigjen në lidhje me këtë pyetje, 269 prej tyre besojnë se vendet dhe kultura Islame po sulmohen nga Perëndimi.

⁴⁵ Po aty, faqe 11,76: 47% e të anketuarve besojnë se mbrojtja me çdo mjet, brenda apo jashtë kufijve, e vlerave dhe dinjitetit fetar është detyrë e çdo besimtar.

⁴⁶ Sanksionimi që me krijimin e shtetit të pavarur shqiptar të parimeve të tilla, si laiciteti i shtetit, liria e besimit fetar dhe e ndërrimit të tij, trajtimi i barabartë i besimeve fetare, përcaktimi në detaje i mënyrës së emërimit të primatëve të besimeve fetare, i financimit të këtyre komuniteteve, kanë qenë masa që kanë inkurajuar dialogun e komunikimin ndërfaqet. Ato kanë ndikuar në konsolidimin e tolerancës fetare të popullit tonë dhe, për rrjedhojë, edhe në forcimin dhe sigurinë e vetë shtetit shqiptar.

⁴⁷ AQSH, Fondi. 246, D-68, Fl. 471, viti 1923.

⁴⁸ AQSH, Fondi. 246, D-68, Fl. 637, viti 1923.

tjerëve, përbëjnë një rrezik që duhet sigurizuar. Ato përbëjnë një rrezik për demokracinë në përgjithësi, pasi duan që të imponojnë rregullat e tyre, duke mos i pranuar rregullat e lojës në një rend demokratik. Ata nuk njohin dhe nuk respektojnë institucionet. Ato janë rryma në Islam që nuk e pranojnë një rend demokratik. Për ta shteti duhet të jetë i bazuar mbi ligjet e shenjta. Por Shqipëria, Kosova dhe shqiptarët në Maqedoni e Malin e Zi, por edhe të gjithë popujt e rajonit ballkanik, janë të deklaruar për demokraci Perëndimore, euroatlantike, ku respektohen liritë dhe të drejtat e njeriut. Në këtë mënyrë vehabi-selefitët bien ndesh dhe nuk kanë asgjë të përbashkët as me besimtarët myslimanë shqiptarë dhe as me shqiptarët si komb⁴⁹. Bashkësitë Islame në hapësirat shqiptare janë përcaktuar dhe në "kushtetutat" e tyre se janë besnikë të islamit tradicional shqiptar, pra të shkollës juridike Hanefi. Përkundrazi, vehabitë sot kanë bërë target myslimanizmin tradicional shqiptar. Ata janë radikalë dhe përjashtues dhe, jo vetëm për besimet e tjera fetare, si krishtërimi, por edhe për variantin e besimit islam që praktikojnë shqiptarët. Për ta janë të papranueshme simbolet dhe festat kombëtare që nuk përputhen me ato fetare. Prioritare, sipas tyre, është feja e pastaj kombi. Por, për shqiptarët feja nuk është tipi përcaktues i identitetit të tyre kombëtar. Duke përcaktuar fenë si prioritare para kombit, vehabitët godasin identitetin tonë kombëtar. Ngushtimi i hapësirave të veprimt të vahabi-selefizmit do të ishte një kontribut i vyer, jo vetëm për myslimanizmin tradicional shqiptar, por dhe për gjeopolitikën dhe gjeohapësirën shqiptare në rajon, për integrimin e tyre euro-atlantik dhe për sigurinë tonë kombëtare. Bashkësitë islame në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Malin e Zi, sot ndodhen para një sfide dhe duhet të marrin përgjegjësitë për mbrojtjen e besimit të tyre fetar nga radikalizmi. Trajtimi dhe menaxhimi me përgjegjësi i kësaj sfide është një çështje që prek gjithë shoqërinë shqiptare dhe pozitën e tyre gjeopolitike në rajon.

Nga ana tjetër shteti e ka për detyrë të garantojë që liria e besimit të mos mbetet deklarative. Politikat e shtetit ndaj fesë tashmë duhen vlerësuar si politika të rëndësishme publike. Shteti duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar gëzimin efektiv të lirisë së besimit fetar⁵⁰. Për këtë ai duhet t'i mbrojë besimet fetare nga ndërhyrjet të cilat synojnë të nxisin radikalizmin e tyre, apo të çdo shfaqjeje tjetër ashpërsie në mjediset e besimtarëve. Ky është kuptimi i laicitetit veprues. Siç përcaktohet dhe në Strategjinë tonë të Sigurisë Kombëtare brezi ynë ka përgjegjësinë historike për të realizuar vizionin e përbashkët, për një atdhe që garanton siguri, drejtësi, barazi dhe mirëqenie për të sotmen dhe brezat e ardhshëm⁵¹.

Politikat për një neutralizim afatgjatë të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm janë ato politika që mbështeten në një pjesëmarrje sa më të gjerë të komunitetit në këtë proces. Kjo qasje komunitare do të mbështetet përmes një bashkërendimi në rritje të institucioneve të sigurisë, aktorëve të komunitetit lokal si dhe institucioneve të tjera shtetërore. Kjo do të bëhet e mundur nëpërmjet shfrytëzimit maksimal të kompetencave të punonjësve që janë në vijën e parë: mësuesit, personeli policor, punonjësit socialë, udhëheqësit fetarë dhe individë të tjerë, të cilët kanë një pozicionim strategjik për parandalimin e radikalizimit.⁵² Për të përballuar radikalizmin dhe

⁴⁹ [Ne nuk na lidh asgjë me vehabitët dhe nëse do t'i referohemi historisë do të gjejmë se shqiptarët kanë zhvilluar një luftë të ashpër ndaj tyre. Mjaft të përmendim Ibrahim Pashën e Egjiptit, i cili para rreth 185 vitesh, luftoi e fitoi mbi ekstremistët vehabitë që po rrezikonin besimin islam.

⁵⁰ Heqja e të gjithë mbështetjes shtetërore ndaj fesë, në të vërtetë, nuk mund të jetë pjesë e programit të një qeverisjeje demokratike.

⁵¹ *Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë 2014*, faqe 3.

⁵² *Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm*, miratuar me VKM nr. 930, datë 18.11.2015. Fletore Zyrtare Nr. 203 /2015. Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, faqe 13250.

ekstremizmin e dhunshëm që të çojnë në terrorizëm, qoftë ai i një natyre fetare apo tjetër, një rol të veçantë merr arsimimi dhe shkolla, policia dhe policimi në komunitet, institucionet fetare, media sociale si dhe aktorë të tjerë shtetëror dhe jo shtetëror.

4. Arsimimi dhe shkolla si faktorë të rëndësishëm e të pazëvendësueshëm për neutralizimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm

Neutralizimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm nuk mund të jetë i suksesshëm vetëm me institucionet e sigurisë⁵³, por dhe me adresimin e këtyre problemeve e sidomos me përmirësimin e nivelit të arsimit⁵⁴. Trajtimi i shkollës si një qendër komunitare do të bëjë të mundur që ajo të mos jetë thjesht një ofruese e arsimit, por edhe si hallkë qendrore në konceptimin e punës parandaluese ndaj ekstremizmit të dhunshëm, duke ofruar dhe shërbime këshillimi për këtë problem. Mësuesit e janë punonjës të rëndësishëm të vijës së parë, të cilët shërbejnë si ndërlihdës brenda komuniteteve. Për rrjedhojë, duhet forcuar aftësia e tyre për të shquar dhe për t'iu kundërpërgjigjur radikalizimit e, përfundimisht, për ta parandaluar atë.⁵⁵

Në këtë kuadër është e domosdoshme nxitja e mendimit kritik, pjesëmarrjes civile dhe përhapja e vlerave të tolerancës përmes edukimit nëpërmjet zgjerimit e rrjetit "Shkolla si qendër komunitare" dhe shtrirjen e tyre në zonat problematike; fuqizimin dhe trajnimin e mësuesve me qëllim aftësimin e tyre për të dalluar e për të reaguar ndaj shenjave të radikalizimit si dhe rritja e mbështetjes për përpjekjet shkollore e jashtëshkollore në shkollat e synuara, për të parandaluar radikalizmin, përfshi edukimin civil e fetar, nismat artistike dhe sportive, klubet e debatit dhe veprimtari të ngjashme që rrisin qëndrueshmërinë⁵⁶. Përmirësimi i cilësisë në arsim, zhvillimi i mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve në kuadër të kurrikulave shkollore, janë faktorë dominues për luftimin dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm⁵⁷. Për këtë është e domosdoshme që, në institucionet arsimore të rishikohen programet shkollore duke filluar nga arsimi fillor dhe nivelet e tjera⁵⁸, me synimin për të përmirësuar kurrikulat me qëllim të promovimit të tolerancës, të rritjes së mendimit kritik, të ofrimit të njohurive globale mbi religionin, të ngritjes së kapaciteteve dhe funksionalizimin e mekanizmave brenda shkollave me objektiv për parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm.⁵⁹

Këtu bëhet fjalë në njëfarë mënyrë për përfshirjen të edukimit fetar nëpër shkolla. Në fakt që në fillim duam të bëjmë një dallim mes edukimit fetar dhe arsimit fetar.

⁵³ 30% e të anketuarve e justifikojnë hakmarrjen kundër institucioneve shtetërore nëse ato shkelin të drejtat dhe liritë e njeriut. (Sondazh i IDM, 2015, faqe 11.72). Prandaj, veprimtaria e institucioneve të sigurisë duhet të jetë mjaft e kujdesshme në raport me institucionet fetare pasi veprimet arbitrare mund të provokojnë ndjenja hakmarrjeje dhe mbështetje për grupet ekstremiste të dhunshme.

⁵⁴ David Phillips, Universiteti i Kolumbias, New York. Cilësia e arsimit "parandalon" radikalizmin. Cituar nga *Radio "Evropa e Lirë"*, 22 Qershor 2016.

⁵⁵ *Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm*, miratuar me VKM nr. 930, datë 18.11.2015. Fletore Zyrtare Nr. 203/2015. Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, faqe 13250. Burim i cituar.

⁵⁶ Po aty.

⁵⁷ Këto janë konkluzione dhe të takimit të organizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë me temën "Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm përmes edukimit". *Radio "Evropa e Lirë"*, 22 qershor 2016.

⁵⁸ Mjaft shqetësues është fakti se kryesisht moshat e reja nga 18 deri 30 vjeç (jo praktikantë të fesë) me arsim të ulët dhe të papunë shfaqen më të prirur për të mbështetur përdorimin e dhunës. "Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri". Publikuar IDM 2015, faqe. 11. Burim i cituar.

⁵⁹ *Strategjia e Kosovës për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm 2015 - 2020*. Prishtinë 2015, faqe 23

Edukimi fetar ka të bëjë me dhënien e një informacioni “neutral” apo “të baraslarguar” për besimet fetare, si përmbajtja e tyre, ritualet dhe ceremonitë fetare, institucionet religjioze etj. Ndërsa arsimimi fetar nënkupton diferencimin e një besimi, thellimin e bindjeve për një besim të caktuar dhe për të jetuarit sipas atij besimi, si dhe përgatitjen e kuadrit fetar për një besim të caktuar. Edukimi fetar, për kushtet e vendit tonë, që ka një popullsi relativisht të vogël, me katër besime fetare tradicionale, nuk mund të jetë thjesht një problem pedagogjik dhe arsimor, por është një çështje me ndikime në sigurinë tonë kombëtare. Ndonëse shteti shqiptar ka hezituuar në vite të merret me zgjidhjen e këtij problemi, pas viteve ‘90, me dhjetëra OJQ-të dhe shoqatat me misionarë arabë, italianë, grekë apo nga vende të tjera, instaluan në Shqipëri një sistem të tërë arsimor fetar ilegal e gjysmë ilegal, duke praktikuar një arsimim fetar të fëmijëve dhe adoleshentëve jo në përputhje me besimet tradicionale të vendit tonë dhe, në disa raste, duke bërë diversion kundër tyre.⁶⁰

Marrja nga fëmijët dhe adoleshentët e njohurive të shtrembëruara për një besim fetar, shumë herë përjashtuese për besimet e tjera fetare, të kushtëzuara, në disa raste, me ndihma ekonomike, të ofruara nga organizata me origjinë dhe financime të dyshimta, e bën këtë kontingjent fëmijësh lehtësisht të manipulueshëm dhe të radikalizueshëm për t’u përdorur për veprime antiligjore si dhe një rrezik potencial serioz për tolerancën fetare të vendit tonë. Edhe praktika Perëndimore për edukimin fetar, së cilës shpesh i referohemi, është e larmishme. Në Evropë shtetet financojnë edukimin fetar nëpër shkolla në mënyra të ndryshme. Në Gjermani edukimi fetar tashmë është një traditë.⁶¹ Edhe Franca po e rishikon pozicionin e saj ndaj edukimit fetar nëpër shkolla.⁶² Edukim fetar i fëmijëve në Perëndim synon t’i aftësojë fëmijët të zhvillojnë aftësinë e të menduarit, të dëshmojnë vlerat dhe të kenë njohuri sa më të plota rreth botës moderne, të kenë sensin kritik për vlerat e shoqërisë, në mënyrë që të zhvillojnë sensin e qytetarisë brenda një shoqërie multikulturore.

Për kushtet e Shqipërisë, do të ishte e rekomandueshme përfshirja e edukimit legal fetar në sistemin arsimor publik, duke respektuar laicitetin e shtetit dhe shekullaritetin e shkollës. Për këtë është e nevojshme të hartohen kurrikula si pjesë e një lëndë mësimore apo një lëndë mësimore më vete, nga e cila fëmijët të marrin informacionin e duhur për besimet kryesore fetare, veçoritë shqiptare dhe shtyllat kryesore mbi të cilën mbështetet bashkëjetesa fetare e shqiptarëve, me synim që të arrijnë të kenë njohuri sa më të plota rreth botës moderne e të zhvillojnë sensin kritik për vlerat e shoqërisë. Edukimi legal fetar, duke dhënë një informacion “neutral” dhe “të baraslarguar” nga dhe për besimet fetare, jo vetëm që nuk e cenon laicitetin e shtetit dhe shekullarizmin e sistemit arsimor, por do të minimizojë mundësinë e manipulimit dhe të radikalizimit të tyre të mëvonshëm, duke ndikuar kështu në parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit. Kjo do të përbente një investim serioz për sigurinë tonë kombëtare. Për kushtet e

⁶⁰ Rreth 1/3 e të anketuarve besojnë se traditat dhe dinjiteti i komunitetit të tyre fetar është nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm. Sondazh i IDM. Faqe 11. Burim i cituar.

⁶¹ Feja në shkolla, Hoffman: Iniciativë e mirë, edukimi fetar nuk dëmton. Nisur nga diskutimet e fundit rreth implementimit të fesë në shkolla, Ambasadori Hoffman tha se çdo vend duhet ta shohë si një mundësi të mirë, pasi në Gjermani edukimi fetar është traditë. Intervistë në Oranews.tv, 14.4.2016.

⁶² Edhe Franca e cila, për shkak të ndarjes historike midis shtetit dhe kishës romane katolike, nuk praktikonte sponsorizimin e shtetit për edukimin fetar e ka braktisur këtë pozicion. Kohët e fundit, në opinionin francez po diskutohet pozitivisht futja e edukimit fetar nëpër shkolla. Prania e një komuniteti të madh mysliman, kryesisht afrikano-verior, nevoja që ata të marrin një edukim korrekt për islamin dhe për besimet e tjera fetare, do të ndihmojnë në integrimin më të lehtë të tyre në shoqërinë franceze, si dhe në ndihmë në parandalimin e radikalizimit të tyre, duke ndikuar kështu pozitivisht në çështjet e sigurisë në Francë.]

Shqipërisë një trajtim të veçantë kërkon dhe arsimimi fetar pra edhe në rastet kur persona të caktuar kërkojnë të thellojnë bindjet për një besim të caktuar e për të jetuar sipas atij besimi, dhe sidomos përgatitja e teologëve sipas besimeve fetare. Një profil sa më i kompletuar i klerikëve lokalë, nga pikëpamja e formimit fetar, por edhe e aftësive për të krijuar lidhje të ngushta me xhematin është thelbësore për të minimizuar manipulimin fetar⁶³. Ata duhet të luajnë një rol të rëndësishëm për parandalimin e përhapjes së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm ndër besimtarët e tyre.

Që në vitin 1922, Gjyqi i Naltë i Sheriatit, si struktura më e lartë përgjegjëse menaxhuese e myslimanëve shqiptar, me program të veçantë dhe në bashkëpunim me ministrinë e brendshme, urdhëronte klerikët e saj (myderrizët) "... që janë më të zotët në dituni ..." që të shkonin nëpër katunde për "...t'i dhanë këshilla popullsisë myslimane ...me i ba me kuptue së Atdheu si dhe besimi mund të mbrohen vetëm me shkue mirë dhe me u dashtë si vllazën me shoqi shojin...me u ruajt nga të gjithë ato sjellje të këqija që shkaktojnë mënina në mes të vllaznëve fetar e kombëtar..."⁶⁴ Ndërsa ministri i Brendshëm në atë kohë, Ahmet Zogu jo vetëm që mbështeti këtë nisëm, por porosiste Gjyqin e Naltë të Sheriatit që "në rast të kundërshtimit të ndonjanit ini të lutur me na lajmëruë që t'u presim rrogat..."⁶⁵.

Por, nga anketimet e fundit në vendin tonë rezultoi se 45% e të intervistuarve nuk besojnë se klerikët në komunitetin e tyre kanë nivelin e duhur të formimit teologjik,⁶⁶ e për pasojë është e pamundur që këta klerik të jenë të përgatitur për të kundërshtuar bindshëm dhe me argumente radikale fetare dhe të trajtojnë shqetësimet e besimtarëve. Ata duhet të jenë të arsimuar, të përgjegjshëm dhe të ndërgjegjshëm për rolin që duhet të luajnë. Fatkeqësisht, për vite të tëra kjo punë iu la në dorë organizatave te ndryshme joqeveritare. Përgatitja e kuadrit fetar të komuniteteve fetare për shumë kohë iu la në dorë OJQ-ve. Për vetë specifikën e besimeve fetare në Shqipëri, pothuajse për më shumë se një dekadë më parë, jam përpjekur që të sensibilizoj strukturat përkatëse shtetërore se hapjen dhe financimin e një fakulteti teologjie në nivel nacional⁶⁷ i cili do të mundësonte arsimimin dhe trajnimin e duhur të klerit si dhe do të mbronte komunitetet tona fetare nga ndikimet ekstremiste. Pas rrezikut dhe kërcënimit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në dekadën e fundit të radikalizmit në Evropë, nacionalizimi i shkollimit të teologëve islam është bërë realitet në Gjermani⁶⁸ dhe po vlerësohet si domosdoshmëri në Zvicër, Francë, etj. Edhe pas më shumë se një dekade, vazhdoj të këmbëngul për domosdoshmërinë e hapjes dhe financimin e një fakulteti teologjie në nivel nacional i cili do të mundësonte arsimimin dhe trajnimin e duhur të klerit shqiptar. Gjithsesi, pavarësisht problematikave që ngritëm në këtë kumtesë, gjendja duhet parë me optimizëm. Si Shqipëria ashtu dhe Kosova, i kanë

⁶³ "Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri". Publikuar *IDM 2015*, faqe 109.

⁶⁴ Qarkore e Gjyqit të Naltë të Sheriatit Nr. 371/II, datë 11.7.1922, dërguar Gjyqit të Sheriatit Tiranë. *AQSH, Fondi Komuniteti Mysliman, Dosja 61, Viti 1922, Faqe 7-8*.

⁶⁵ Shkresë e Ministrisë Punëve të Brendshme nr. 10911(1033 sek I), datë 8.7.1922 me lende "Mbi predikimin e myderrizëve", dërguar Gjyqit të Naltë të Sheriatit, Tiranë. *AQSH, Fondi: Komuniteti Mysliman, Dosja 61, Viti 1922, Faqe 6*.

⁶⁶ Po aty: Shumica e të anketuarve besojnë se klerikët në komunitetin e tyre nuk kanë arsimin/formimin e duhur fetar (45%). Ndërsa 34% e të anketuarve deklarojnë që nuk kanë dijeni rreth nivelit të arsimit dhe formimit fetar të klerikëve në zonën e tyre. Vetëm 21% e të pyeturve besojnë se klerikët në komunitetin e tyre fetar kanë arsimin dhe formimin fetar të mjaftueshëm.

⁶⁷ Xhavit Shala, "Mjaft pasivitetit në çështjet fetare". Editorial në gazetën "Korrieri", 15 Mars 2005.

⁶⁸ Profesor Muhamed Sven Kalish, drejtues i "Qendrës për Studime Fetare" në Universitetin e Munsterit, Gjermani: "... ne shpresojmë se, duke arsimuar këtu në mënyrë shkencore mësuesit e fesë myslimane si teologë, do të mund t'i luftojmë më mirë tendencat ekstremiste" (Marrë nga "Kosova Sot", 31 korrik 2004, Prishtinë).

sigurizuar këto rreziqe e kërcënime dhe kanë miratuar strategjitë e tyre kombëtare kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm si dhe planet përkatëse të veprimit. Në të gjithë gjeohapësirën shqiptare, ka një ndërgjegjësim më të madh, jo vetëm të strukturave shtetërore, por dhe të vetë komuniteteve fetare, të intelektualëve dhe, në përgjithësi, të shoqërisë civile ndaj rasteve të raportuara të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Gjithashtu, krahas kësaj shqiptarët, në të gjithë gjeohapësirën e tyre, zotërojnë kapacitetet e nevojshme intelektuale për t'u përballur edhe me propagandën e qarqeve të caktuara antishqiptare e islamofobe.

5. Përfundime

Pas studimit dhe hulumtimit në këtë punim, të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm si rrezik e kërcënim për sigurinë kombëtare dhe, të rolit të arsimit si faktor i vijës së parë për neutralizimin e tyre, arrijmë në këto përfundime:

- Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm vlerësohen si rreziqe dhe kërcënime me pasoja të larta për sigurinë kombëtare dhe në të gjithë gjeohapësirën shqiptare.

- Shteti e ka për detyrë t'i mbrojë besimet fetare, nga ndërhyrjet të cilat synojnë të nxisin radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Për këtë ai duhet të jetë më shumë "laik veprues" se sa "neutral pasiv".

- Laiciteti veprues i shtetit nuk cenon laicizmin dhe shekullarizimin, të cilat janë të shenjta për një shtet demokratik. Përkundrazi, duke qenë laik por aktiv, shteti merr përsipër garantimin dhe realizimin faktit të lirisë së besimeve fetare.

- Politikat për një neutralizim afatgjatë të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, janë ato politika publike, që mbështeten në një pjesëmarrje sa më të gjerë të komunitetit në këtë proces. Kjo qasje komunitare do të mbështetet përmes një bashkërendimi në rritje të institucioneve të sigurisë, aktorëve të komunitetit lokal si dhe institucioneve të tjera shtetërore.

- Arsimimi dhe shkolla janë faktorë të rëndësishëm, të pazëvendësueshëm dhe të vijës së parë, për neutralizimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, krahas veprimtarisë së institucioneve të sigurisë dhe aktorëve të tjerë.

6. Rekomandime

Sa më sipër do të ishte e rekomandueshme:

- Ndjekja dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, miratuar me VKM nr. 930, datë 18.11.2015 dhe planit të saj të veprimit si konkretizim i sigurizimit të rrezikut dhe kërcënimit nga radikalizmit dhe ekstremizmi i dhunshëm. Përcaktimi i strukturës përgjegjëse koordinuese për zbatimin e saj.

- Ristrukturimi dhe rritja e efikasitetit të strukturës shtetërore (Komitetit Shtetëror të Kulturave) që merret me menaxhimin e raporteve ligjore dhe të detyrimeve të ndërsjella të shtetit, me komunitetet fetare dhe, studimi i fizibilitetit për ta rikompozuar atë, në rangun e një ministrie.

- Studimi i mundësisë për hapjen dhe financimin e një fakulteti teologjie në nivel kombëtar, i cili do të mundësonte arsimimin dhe trajnimin e duhur të klerit shqiptar, si domosdoshmëri për forcimin e kapaciteteve të tyre për tu përballur me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

- Forcimi i kapaciteteve dhe ekspertizës së zyrtarëve të zbatimit të ligjit, për të

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

parandaluar ekstremizmin e dhunshëm.

- Nxitjen e institucioneve shtetërore për t'u angazhuar me bashkësitë vendore, përfaqësuesit fetarë dhe aktorë të tjerë, me qëllim identifikimin e grupeve në nevojë, që janë a mund të bëhen shënjestër e ekstremizmit të dhunshëm.

- Angazhimi për të filluar një proces deradikalizimi, proces i cili të përfshijë një paketë të gjerë programesh sociale, politike, ligjore, arsimore dhe ekonomike të hartuara posaçërisht për t'i frenuar individët e pakënaqur dhe të radikalizuar për t'u përfshirë në veprimtari terroriste

- Nxitja e bashkëpunimit të gjithë faktorit shqiptarë në gjeohapësirën shqiptare dhe hartimi i politikave të përbashkëta për të neutralizuar rrezikun e depërtimit të ekstremizmit dhe radikalizimit në komunitetet tona fetare, por edhe për të kordinuar përpjekjet dhe bashkuar kapacitetet për të neutralizuar dhe propagandën e qarqeve të caktuara antishqiptare e islamofobe.

Referenca

1. AQSH, Fondi Komuniteti Mysliman, Dosja 61, Viti 1922, Fl. 6-8.
2. AQSH, Fondi. 246, D-68, viti 1923, Fl. 471.
3. AQSH, Fondi. 246, D-68, viti 1923, Fl. 637.
4. Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë 2014. Miratuar me Ligjin Nr.103/2014, Date: 31.07.2014, Flet.Zyrtare Nr.137, Faqe:137.
5. Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, miratuar me VKM nr. 930, datë 18.11.2015. Fletore Zyrtare Nr. 203 /2015. Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, faqe 13248.
6. Strategjia e Kosovës për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm 2015 – 2020. Prishtinë 2015,
7. Violent Extremism and Religious Radicalization in Albania. Publishing IDM 2015
8. Arbër Xhaferri te «Religjioni, Politika, Shqiptarët», botuar në “Fetë dhe qytetërimet në mijëvjeçarin e ri - Rasti i Shqipërisë”.
9. Ismail Kadare, Fjala në Konferencën Ndërkombëtare «Fetë dhe qytetërimet në mijëvjeçarin e ri - Rasti i Shqipërisë, mbajtur në Tiranë, 13-14 nëntor 2003
10. Artan Fuga - “Sjellja e shqiptarëve të sotëm ndaj fesë”. 20 prill 2004 / TN / QSHDNJ
11. Michael Sheehan, “Evolucioni i luftës moderne” në “Strategy in the Contemporary World”, Oxford University Press, 2007.
12. Veton Surroi, “Fetë dhe civilizimet”, Gazeta “Korrieri” 14 nëntor 2003.
13. Mehdi Frashëri- The ancient History of Albania and Albanians.
14. Barry Buzan, Ole Waever, and Jaap de Wilde, Security: A New Framework for Analysis, Boulder, CO: Lynne Rienner Publishers, 1998.
15. Alexander del Valle, Genesis and the actuality of pro-Islamic strategy of USA.
16. Ardian Vehbiu, ResPublika 30 Korrik 2011.
17. Helmut Hoffman: Interviste në Oranews.tv, 14.4.2016
18. Xhavit Shala (2016), State, Religious Faith and Security Issues, Lambert Akademik Publishing.
19. Xhavit Shala (2004), Shqiptarët në udhëkryq. Botim i Qendrës Shqiptare të Studimeve për Sigurinë Kombëtare.
20. Xhavit Shala (2003), Siguria Kombëtare dhe sfidat e integritit, Botim i Qendrës Shqiptare të Studimeve për Sigurinë Kombëtare.
21. Vendim i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr 459, datë 23.9.1999, “Për Krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet”.
22. Vendim i Këshillit të Ministrave të RSH nr. 930, datë 18.11.2015 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe planit të veprimit”.
23. VOA,17.3.2016-Deklaratë e Sekretarit të Shtetit të SHBA-së Xhon Kerri.
24. VOA 30.10.2014: Viktimizimi i grave nga ISIS.
25. VOA 25.03.2016: Për dënimin e Radovan Karaxhiç.
26. BBC 23 Qershor 2011: Anders Behring Breivik, fundamentalist kristian, vret 85 veta.
27. Radio “Evropa e Lirë”, 22 Qershor 2016. Citim i Prof. David Philips, Universiteti i Kolumbias, New York.
28. ATSH/Prishtinë, 16 Shtator: Qeveria e Kosovës miratoi sot strategjinë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm për periudhën 2015-2020.
29. “Kosova Sot”, 31 korrik 2004, Prishtinë.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

Ndikimi i reformimit të policisë së Kosovës në parandalimin e luftimit e krimit të organizuar dhe ekstremizmit të dhunshëm

Dr. (në proces) Riza SHILLOVA

Policia e Kosovës

riza.shillova@kosovopolice.com

Abstrakt

Kosova në aspektin ndërtimit strukturave policore është një shembull unik, duke pasur parasysh historikun e ndërtimit të këtij sektori, sidomos roli dhe rëndësia që kanë pasur në këtë proces misionet ndërkombëtare qoftë në aspektin pozitiv apo, edhe negativ. E veçanta e procesit të reformave të Policisë në Kosovë, qëndron në mostrashëgimin respektivisht të vazhdimësisë të institucioneve të sigurisë nga e kaluara. Koncepti i përshtatjes së policisë, nevojave të kohës, në këtë fushë, është mjaft kompleks, prandaj ajo përfshin një mori çështjesh, dukurish, të cilat e përbëjnë sigurinë në përgjithësi. Ky kompleksitet, është akoma më i madh në rastin e Kosovës, për shkak se krahas ndërtimit të policisë, kemi reformim në harmoni me standardet e BE-së, ku kemi edhe një prezencë ndërkombëtare të sigurisë siç është KFOR-i, UNMIK dhe misioni EULEX. Në rrugën e integritit, Kosova ka themeluar bazën ligjore, por edhe mekanizmin institucional me qëllim që të realizojë hetime proaktive të pasurisë së pazakonshme/të dyshimtë, të vendosë një sistem të mirë kundër pastrimit të parave si dhe ka zhvilluar e zbatuar një sistem solid për konfiskimin dhe menaxhimin e aseteve, si parakusht për të parandaluar dhe luftuar me sukses krimin e organizuar, ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin. Në veçanti, në Kosovë, janë fuqizuar kapacitetet e policisë dhe njësisë përgjegjëse për inteligjencë financiare, për të kryer në mënyrë efektive dhe të pavarur hetime komplekse të krimit të organizuar dhe pastrimit të parave. Edhe pse është bërë shumë në përmirësimin e koordinimit, bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave dhe inteligjencës kriminale ndërmjet autoriteteve për zbatim të ligjit, posaçërisht policisë dhe prokurorisë, për të përmirësuar arritjet në hetimin dhe ndjekjen e rasteve të krimit të organizuar dhe terrorizmit konsiderojmë se ka akoma ka hapësirë për përmirësim.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

Fjalëkyçe:

policia, siguri, reforma, krimi, integrim evropian.

1. Hyrje

Policia paraqet njërin ndër institucionet më të rëndësishëm shtetërorë në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit në përgjithësi, krimit të organizuar dhe krimeve të rënda në veçanti. Specifike për Kosovën është se, përpos Policisë së Kosovës në çështjet e parandalimit dhe luftimit të krimit, rol të rëndësishëm ka pasur në të kaluarën edhe Policia e Kombeve të Bashkuara si dhe aktualisht, rol të theksuar ka edhe policia e Misionit të Bashkimit Evropian, EULEX. Prandaj, vështrimi dhe trajtimi i aktiviteteve policore të tri komponentëve policore, pasur parasysh veprimin ekzekutiv të këtyre, koordinimin mes tyre, kompetencat, detyrat dhe rolin që kanë pasur dhe kanë në përgjithësi në këtë fushë, është e një rëndësie të veçantë dhe specifike për Kosovën, e cila e bën shembull unik në botë. Në një botë të ndërvarur, Kosova si dhe shumë vende të tjera në mënyrë direkt ose indirekte përballen me rreziqe të ngjashme.¹

Në kushtet e globalizmit, krimi i organizuar dhe ekstremizmit konsiderohet si kërcënim ndaj sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare dhe kjo vlen edhe për Kosovën. Ky kërcënim mund të manifestohet në forma të ndryshme, në varësi me zhvillimin e jetës ekonomike dhe shoqërore. Pozita gjeostrategjike e Republikës së Kosovës në Ballkan si dhe kushtet e krijuar pas luftës u mundësojnë grupeve të ndryshme kriminale për të zhvilluar aktivitete të krimit të organizuar dhe ekstremizmit. Shkalla e lartë e papunësisë dhe varfëria gjithashtu kontribuojnë në krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar dhe ekstremizmit në veçanti. Ndikim ka pasur edhe mungesa e institucioneve efikase për parandalim dhe luftim të kësaj forme të krimit si dhe, ndërtimi i institucioneve të reja dhe pa përvojë. Kosova, në kuadër të politikave nacionale, ka synim integrimin në Bashkimin Evropian prandaj në këtë rrugëtim ajo duhet të luftojë me efikasitet krimin e organizuar dhe ekstremizmin. Këtë duhet ta bëjë duke ndërtuar kapacitetet e saja, në harmoni me standardet evropiane. Prandaj, rol të rëndësishëm në këtë fushë, ka organizata policore. Rëndësia e kësaj teme qëndron në faktin se kjo është një temë e pahulumtuar sa dhe si duhet, më parë, në

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

¹ Analiza e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës, Prishtinë: 2014, fq. 16

veçanti në Kosovë; është një temë e re dhe e një rëndësie të posaçme jo vetëm për studiuesit e kësaj fushe, për politikë-bërësit, ekspertët si dhe zbatuesit e politikave të sigurisë në vend. Kosova është në fazën e tranzicionit dhe të procesit të integrimi evropiane. Ajo duhet të adaptojë reforma të thella në të gjitha sferat përfshirë edhe reforma në sektorin e policisë. Trajtimi i kësaj teme ka për qëllim të sqarojë nevojën e reformave në polici, procesin, nevojën për reforma, standardet e BE-së në këtë fushë si dhe përputhshmërinë e këtyre reformave me këto standarde, të cilat do ta bëjnë më të lehtë procesin e integrit të Kosovës në BE. Reforma e policisë është një koncept relativisht i ri në aspektin kohor, sidomos në shtetet të cilat janë në fazat e tranzicionit dhe transformimit, zhvillimit të shtetit dhe ndërtimin e paqes dhe sigurisë në shoqëritë pas konflikt. Shqyrtimet teorike të kësaj teme synojnë edhe pasurimin e debatit teorik dhe koncepteve të reformave të sigurisë kombëtare, ndërlidhjen e tyre me procesin e integrit evropian si dhe rreth koncepteve të krijimit, ruajtjes dhe ndërtimit të paqes në vendet në tranzicion, sigurisë së BE-së dhe më gjerë. Gjatë punimit të kësaj teme janë përdorur një sërë e metodave të ndryshme, për të arritur deri tek rezultatet e dëshiruara, siç janë, metoda historike, normative dhe ajo e krahasimit. Në kuadër të procesit të ngritjes së kapaciteteve në fushën kundër krimit të organizuar, ekstremizmit, rëndësi të veçantë kanë edhe standardet e përcaktuara nga BE-ja, të përcaktuara në akte formale siç janë: Programi i Stokholmit dhe plani i veprimit mbi Programin e Stokholmit; Programi i Hagës: dhjetë prioritetet për pesë vitet e ardhshme; materiale të prodhuara nga Zyra e Policisë Evropiane – Europol; Protokollin kundër kontrabandimit të migrantëve nga toka, ajri dhe deti; Korniza e zakonshme për oficerët ndërlidhës lidhur me Krimin i organizuar, etj. Gjithashtu janë trajtuar materialet që kanë të bëjnë me raportet Kosovë-BE sa i përket procesit të reformave në polici siç janë: Raporti i Progresit për Kosovën, Marrëveshja e Stabilizim Asocimit, Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave, dokumentet Strategjike, siç është Strategjia për Integrim Evropian, Strategjia për Asistencë në Sektorin e Sundimit të Ligjit, Analiza e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë, Strategjia e Komisionit Evropian e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2014-15, etj. Gjatë hulumtimit, janë shqyrtuar edhe materiale, si: politikat nacionale në këtë fushë, legjislacioni vendor dhe ai ndërkombëtar, etj.

2. Aspekti historik i themelimit dhe zhvillimit të Policisë së Kosovës

Policia e Republikës së Kosovës është themeluar si shërbim publik, në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si person juridik, e cila vepron nëpërmjet zinxhirit të unifikuar komandues në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Policia ka uniformën, flamurin dhe emblemën e vet.² Në fillim, ajo është themeluar më 6 shtator 1999 si Shërbim Policor i Kosovës, në kuadër të kuadër të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Ministria e Punëve të Brendshme është themeluar më vonë, sipas Rregullores së UNMIK-ut 2005/54. Themelimi i saj është miratuar më 20 dhjetor 2005 (de facto e themeluar në mars 2006).³

Mënyra e themelimit të Policisë së Kosovës dhe integrimi i asaj në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, paraqet gjithashtu një rast unik në botë, të themelimit dhe

² Ligji i Policisë, Nr. 04/L-076, 2012, neni 4.

³ FREEDOM, *Rishikimi funksional i Policisë së Kosovës*, 2009, fq. 7.

zhvillimit të një organizate policore. Kjo, për faktin se aktivitetet policore, në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit dhe ekstremizmit, nuk janë mbështetur në politika nacionale vendore, për shkak se nuk ka pasur autoritete vendore të cilat i kanë zhvilluar ato politika. Misionit të OSBE-së në Kosovë, shtyllës së tretë të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara (UNMIK-ut), i ishte dhënë mandati për ndërtimin e institucioneve dhe demokracisë dhe promovimin e të drejtave të njeriut e sundimit të ligjit. Departamenti i saj, për zhvillim dhe edukim policor, ishte i ngarkuar me punë mbi zhvillimin dhe trajnimin demokratik të Shërbimit të ri Policor të Kosovës, i cili do të mbështeste sundimin e ligjit dhe respektimin e mëtejshëm për të drejtat e njeriut.⁴ Në fillimin e themelimit të Policisë së Kosovës, në Kosovë ishte një ambient i vështirë në aspektin e sigurisë. Ishte trashëguar një ambient i dalë nga lufta. Forca e organizuar dhe trajnuar ishte në numër mjaft të vogël dhe deri në kohën kur arriti t'i plotësojë radhët me numër më të madh të personeli, sidomos deri në vitin 2006, nuk ishte një organizatë e rëndësishme e sigurisë publike siç është sot. Në fillim të krijimit të saj nuk ka pasur as rregulla dhe procedura të brendshme të punës, – kjo vazhdoi deri në vitin 2000 dhe 2001, kur u hartua “Rregullorja e brendshme” e punës e cila parasheh parimet, respektivisht politikat dhe procedurat e punës për personelin policor. Vvitin 2003, ishte fillimi i tranzicionit të përgjegjësive e detyrave nga policia e UNMIK-ut në Policinë e Kosovës. Fillimisht u fillua me tranzicionin e njësive respektivisht, stacioneve policore në zonat e vogla – stacione më të vogla dhe pastaj u zgjerua në gjithë Kosovën, duke përfshirë edhe tranzicionin e drejtorive rajonale dhe disa njësive në nivel qendror të policisë. Ky proces, vazhdoi deri në vitin 2008 kur edhe u shpall Pavarësia e vendit dhe mëvetësimi i plotë i Policisë së Kosovës. Viti 2008 është edhe viti i tranzicionit të plotë të detyrave dhe përgjegjësive, përfshirë edhe kompetencat në hetimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe ekstremizmit. Ky mëvetësim dhe kompetencë iu mundësua me miratimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Policinë.

3. Manifestimi i krimit të organizuar dhe ekstremizmit në Kosovë në raport me nevojën për reformë policore

Krimi i organizuar dhe ekstremizmi, janë një dukuri negative e rrezikshme, të cilat kanë depërtuar pothuajse në të gjitha segmentet e shoqërisë njerëzore. Kjo formë e kriminalitetit, manifeston disa veçori dalluese nga format e tjera të kriminalitetit. Kështu p.sh., disa kategori (forma) të sjelljeve të krimit të organizuar nuk janë karakteristike për format e tjera të grupeve kriminale. Këto kategori të sjelljeve të krimit të organizuar, janë tipike për këtë formë të kriminalitetit siç është: furnizimi me shërbime të paligjshme, furnizimi i paligjshëm i mallrave, konspiracioni, depërtimi në afarizëm legjitim, detyrimi dhe korrupsioni, etj. Ofrimi i shërbimeve të paligjshme konsiderohet si një ndër aktivitetet kryesore të organizatave të krimit të organizuar. Këto shërbime përfshijnë: aktivitetet e bixhozit, të cilat janë veprime të jashtëligjshme; reketin, si një formë e detyrimit përmes së cilës anëtarët e grupeve të krimit të organizuar u ofrojnë kinse “mbrojtje” pronarëve të bizneseve për afarizmin e tyre; huadhënia (fajde), si huazim joligjor i parave me kamata të larta dhe të dyshimta dhe prostitucioni, si një formë e gjerë e organizuar.

Terrorizmi është një kërcënim për të gjitha vendet dhe të gjithë popujt. Paraqet

⁴ Edukimi dhe Zhvillimi i Policisë, revistë e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian. Prishtinë: 2005, fq. 1.

kërcënim serioz për sigurinë tonë, për vlerat e shoqërive demokratike për liritë dhe të drejtat e qytetarit, në veçanti përmes targetimit/shënjjimit të njerëzve të pafajshëm.⁵

Kuptohet se, në rastet më të shpeshta, parat e fituara nga aktivitete kriminale të cilat merren me krim të organizuar dhe terrorizëm, janë në funksion të arritjes së qëllimeve të organizatave të krimit të organizuar dhe të atyre terroriste. Të gjitha këto forma të manifestimit, janë prezent edhe në Kosovë, me gjithë kompleksitetin e saj. Situata e rëndë e popullsisë, nga pasojat e luftës, pamundësia për të ardhur deri tek mjetet financiare përmes rrugëve tjera i konsiderohet si faktor që i ka shtyrë njerëzit, që të merren me akte kriminale. Si rezultat, grupet kriminale filluan të shfrytëzojnë mjaft mirë avantazhet e situatës, të cilët fillimisht filluan të merren me kontrabandimin e mallrave, pasi kjo ishte një nevojë emergjente, por duke marrë parasysh se nuk kishte kontrollin e duhur kufitar, grupet kriminale vazhduan edhe me trafikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike, armëve, qenieve njerëzore dhe formave të tjera të kriminalitetit.⁶

Me qëllim të përbaljes me këto dukuri pas luftime, Kosova në aspektin ndërtimit të Policisë ku paralelisht me parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit, është punuar në themelimin dhe ndërtimin institucional, është një shembull unik pasur parasysh historikun e ndërtimit të këtij sektori, sidomos roli dhe rëndësia që kanë pasur në këtë proces misionet ndërkombëtare. E veçanta e procesit të reformave të Policisë në Kosovë, qëndron në trashëgiminë respektivisht mosvazhdimësinë e institucioneve të sigurisë nga e kaluara e sidomos, përvoja e Kosovës në themelimin e institucioneve të reja, si shembull dhe përvojë e rëndësishme që mund të aplikohet në nivel ndërkombëtar. Për tu përballur me efikasitet me këto manifestime të krimit të organizuar dhe të terrorizmit, është dashur reformim i Policisë në aspekte shumëdimensionale, duke filluar nga ai ligjor, institucional, politikave publike, si atij kadrovik.

5. Kriteret evropiane për reforma në polici, për procesin e integritetit evropian

Policia e Kosovës vazhdon të shihet si institucioni më i besueshëm për sundim e ligjit në Kosovë. Ajo ka zhvilluar strategjinë e saj të parë të trajnimeve (2014-18) duke u përqendruar në fusha si, përmirësimi i kapacitetit dhe zhvillimi i ekspertizave të reja e avancimi i bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat e jashtme ndërkombëtare.⁷ Si pjesë e procesit të reformave në sektorin e sigurisë në Kosovë, sidomos tranzicioni, respektivisht marrja graduale e më shumë përgjegjësive për sigurinë nga misionet ndërkombëtare në Kosovë në vitin 2012, qeveria e Republikës së Kosovës ka filluar procesin e rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë. Rishikimi i sektorit të sigurisë, si proces i reformave të këtij sektori ka pasur për qëllim, që të përcaktoheshin qartë rolet dhe misionet e secilit institucion në sektorin e sigurisë, për t'ju shmangur dyfishimit dhe për t'i maksimalizuar kapacitetet institucionale për qëllime të përbashkëta, pastaj identifikimin e kapaciteteve të nevojshme, të cilat kërkohet të ndërtohen me qëllim ofrimin e sigurisë, qytetarëve të Kosovës. Nënshkrimi i MSA-së në mes të BE-së dhe Kosovës, në muajin korrik të vitit 2014 është një arritje e madhe në marrëdhëniet BE-Kosovë. Tani Kosova në bazë të Strategjisë për Zgjerim të BE-së, ka nevojë të arrij

⁵ *Strategjia Kundër Terrorizmit e Bashkimit Evropian*, 2005, fq. 6.

⁶ *Raporti Vlerësimeve të Kërcënimeve nga Krimi i Organizuar dhe Krimet e Rënda* (SOCTA), Policia e Kosovës, 2013, fq. 11.

⁷ *Raporti i Progresit për Kosovën*, 2014, fq. 59-60.

reformat kyçe, në veçanti në sundimin e ligjit. Sipas BE-së, Kosova duhet të bëjë më shumë për të trajtuar mangësitë e dala në pah gjatë dialogut të vizave, përfshirë zbutjen e rreziqeve të sigurisë dhe migrimit. Kosova duhet të bëjë reformë gjithëpërfshirëse dhe përafrim të legjislacionit me *acquis*-in e BE-së, përfshirë sektorë si, sundimi i ligjit. Mbi bazën e kësaj, janë bërë dhe ka akoma për t'u bërë në procesin e reformimit të policisë. Në kuadër të reformave në sektorin e sigurisë, me theks të veçantë në polici, në shumicën e kritereve për Kosovën, kërkohet që të zhvillohen hetime proaktive apo parandaluese. Në këtë kontekst, theksohet në kuadër të raportit të progresit se policimi, i udhëhequr nga inteligjenca, mbetet i dobët. Sistemi informativ i tanishëm i Policisë së Kosovës, nuk përfshinë informatat e dorëzuara nga zyrtarët e PK-së dhe nuk kontribuon në analiza efektive, që janë thelbësore për policimin e bazuar në inteligjencë, për të ekspozuar dhe hetuar krimin. Nuk ka kapacitet për të ndërtuar një pamje të përgjithshme strategjike, të gjendjes së krimit të organizuar në Kosovë. Një model funksional i inteligjencës (grumbullim efektiv, analizim dhe shpërndarje informatash) do të ndihmonte në krijimin e një pasqyre gjithëpërfshirëse të krimit të organizuar, me hollësi për kërcënimet dhe trendët në rrjetet dhe grupet kriminale.⁸

Në procesin e liberalizimit të vizave, në fushën e rendit dhe sigurisë, Kosova duhet të miratojë dhe zbatojë legjislacionin për parandalimin, hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e krimit të organizuar dhe korrupsionin, duke përfshirë pastrimin e parave dhe krimit financiar, konfiskimin dhe kthimin e aseteve, si dhe financimin e terrorizmit, në pajtim me *acquis* të BE-së. Kosova, ashtu siç kërkohet, duhet të miratojë dhe të zbatojë legjislacionin për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e trafikimit të qenieve njerëzore, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve, në pajtim me *acquis* të BE-së, të sigurojë hetimin dhe ndjekjen proaktive e trafikimit me qenie njerëzore, duke përfshirë dënimet bindëse për individët që janë shpallur fajtorë në këtë krim serioz, të shtojë efikasitetin e identifikimit të viktimave. Gjithashtu kritere të cilat duhet të arrihen për Kosovën, është se ajo duhet të miratojë dhe zbatojë legjislacionin për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e trafikimit më narkotikë dhe prekursorë, në pajtueshmëri me *acquis* të BE-së; të sigurojë hetimin dhe ndjekjen proaktive të këtyre krimeve, pastaj të zbatojë strategjitë dhe planet e veprimt për luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit, trafikimit me qenie njerëzore, trafikimit me drogë dhe prekursorë, kundër terrorizmit, parandalimit të krimit dhe trafikimit me armë, të rishikojë këto dokumente, nëse është e nevojshme të përcaktojë veprime efektive dhe të vendosë tregues të qartë për matjen e performancës në këto fusha. Dokumentet të cilat përmbajnë politika në këtë fushë duhet të jenë në harmoni me politikat-strategjitë e BE-së. Për të arritur këtë, Kosova duhet të bëjë reforma në sektorin e sigurisë dhe jo vetëm në të.⁹

Në kuadër të reformave në këtë fushë, Kosova ka fuqizuar kapacitetet e policisë, ka përmirësuar koordinimin, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informatave ndërmjet autoriteteve për zbatim të ligjit. Edhe në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve, duhet të kryhen reforma me qëllim të arritjes së standardeve, sidomos në aspektin legjislativ, sidomos fuqizimi i kapaciteteve të policisë për krijimin dhe funksionalizimin e programit për mbrojtje të dëshmitarëve.¹⁰ Në fushën e bashkëpunimit policor ndërkombëtar, Kosova duhet t'i zbatojë marrëveshjet ekzistuese për bashkëpunim dhe, ku është e mundshme, të nënshkruajë marrëveshje të reja, të krijojë linja të komunikimit dhe

⁸ Po aty.

⁹ Udhërrëfyesi për Liberalizim të Vizave për Kosovën, fq. 11-12.

¹⁰ Po aty. Fq. 12.

bashkëpunimit me shtetet anëtare të BE-së dhe jo vetëm me to, përmes vendosjes së zyrtarëve ndërlidhës, të shtojë bashkëpunimi operacional me autoritetet e sundimit të ligjit të shteteve anëtare dhe vendeve të treta, me theks të veçantë realizimin e operacioneve të përbashkëta, të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme lidhur me shkëmbimin e informatave. Kosova për të arritur standardet në këtë fushë, duhet të shtojë bashkëpunimin me organizatat e ndryshme të sigurisë, në radhë të parë me EUROPOL e me EMCDDA dhe, të shtojë mënyrat e bashkëpunimit me iniciativat rajonale për bashkëpunim në fushën e zbatimit të ligjit, etj.¹¹

Sundimi i ligjit është një vlerë themelore, mbi të cilën BE-ja është themeluar. Ruajtja e vlerave, siç është sundimi i ligjit, është ajo për çfarë është krijuar Bashkimi Evropian, që nga fillimi i tij e deri tek kapitujt e tij të fundit të zgjerimit. Sundimi i ligjit mbetet prioritet për BE-në dhe është në zemër të procesit të anëtarësimit, një shtyllë kyçe e kriterëve politike të Kopenhagës. Vendet që aspirojnë t'i bashkohen Bashkimit Evropian, duhet të krijojnë dhe të promovojnë që nga faza e hershme funksionimin e institucioneve kyçe që janë të nevojshme për sigurimin e sundimit të ligjit. Luftimi i krimit të organizuar është thelbësor për t'iu kundërvënë infiltrimit kriminal në sistemet politike, ligjore dhe ekonomike. Në shumicën e vendeve në zgjerim, ka nevojë për reforma gjithëpërfshirëse, transparente dhe ambicioze me synim të sigurimit të një sistemi gjyqësor të pavarur, paanshëm, efikas dhe të përgjegjshëm.¹²

6. Politikat publike për plotësimin e standardeve evropiane në parandalim dhe luftim të krimit të organizuar dhe ekstremizmit

Republika e Kosovës është një shtet që ka vizion të promovojë stabilitet dhe siguri, jo vetëm brenda territorit të saj, por edhe në rajon e më gjerë. Republika e Kosovës synon anëtarësimin në organizata të sigurisë rajonale dhe globale, sidomos në BE, NATO, OSBE dhe OKB. Republika e Kosovës, ndjek rrugën e anëtarësimit dhe integritimit në strukturat euroatlantike të cilat mbesin emërtuesi më i fuqishëm për Kosovën, si dhe një tregues i gatishmërisë dhe konfirmojnë dëshirën e vendit për t'u bërë eksportues i sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare. Ne të vërtetë, siguria kombëtare e Kosovës është e lidhur ngushtë me sigurinë rajonale dhe sigurinë më të gjerë euroatlantike.¹³

Policia e Kosovës si agjenci e ri e zbatimit të ligjit, ka pasur mangësi në fillim, për t'u përballur me sukses me këto forma të krimit e në veçanti krimit të organizuar dhe ekstremizmit. Siç dihet, parandalimi i krimit, ashtu si dhe në shtetet tjera edhe në Republikën e Kosovës paraqet sfidë të veçantë për institucionet e zbatimit të ligjit. Republika e Kosovës ne vazhden e parandalimit dhe luftimit të krimit, ka adaptuar një mori masash si:

- miratimin e ligjeve dhe akteve tjera nënligjore;
- miratimi i strategjive siç janë:
 - Strategjia 2013-2017 për parandalimin e krimit,
 - Strategjia dhe PV 2012-2017 kundër krimit të organizuar,
 - Strategjia dhe PV 2012-2017 luftimin trafikimit me narkotik,

¹¹ Po aty, fq. 13- 14.

¹² Udhërrëfyesi për Liberalizim të Vizave për Kosovën, fq. 13

¹³ Analiza e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës, fq. 4.

- Strategjia dhe PV 2011-2014 kundër trafikimit të qenieve njerëzore,
- Strategjia 2012-2015 kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit,
- Strategjia 2013-2018, për menaxhimin e integruar të kufirit,
- Strategjia për Policinë e udhëhequr nga Inteligjenca 2013-2017,
- Strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015 – 2020.

- Ndërtimi i strukturave operacionale siç janë:

- Struktura Organizative e PK-së e cila është kompatible me nevojat e Policisë së Kosovës;

- Themelimi i Drejtorisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar;
- Themelimi i Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve;
- Themelimi i Njësisë Speciale për Luftën ndaj Krimit Kibernetik;
- Themelimi i njësisë rajonale të Drejtorisë Kundër Terrorizmit.
- Është punuar në ngritjen e kapaciteteve institucionale (të burimeve njerëzore dhe pajisjet).

- Trajnime të specializuara për zyrtarët që merren me luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit.

- Është hartuar raportin e vlerësimeve të kërcënime dhe rreziqeve SOCTA 2013 dhe SOCTA i hartuar në vitin 2016.

- Në vazhdimësi janë hartuar raportet vjetore të vlerësimit strategjik të kërcënimeve në vitin 2013, 2014 dhe 2015.

Për të plotësuar këto standarde ndihmë të veçantë kanë dhënë projekte e ndryshme mbështetëse të BE-së, siç janë projektet e binjakëzimit. Me ndihmën e projektit të binjakëzimit për ngritje të kapacitete në fushën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, është hartuar edhe udhëzuesi i përbashkët Polici-Prokurori dhe Inspektorati Policor lidhur me unifikimin e procedurave hetimore. Ky udhëzues është i përbërë nga 5 kapituj sipas përmbajtjes në vijim: rritja e bashkëpunimit të përbashkët në mes të Prokurorisë dhe Policisë së Republikës së Kosovës; menaxhimi i dosjeve hetimore dhe format e standardizuara; udhëzues mbi masat e fshehta ose teknike të vëzhgimit dhe hetimit; hetimi i krimit të organizuar lidhur me veprat penale të narkotikëve; standardizimi i hetimeve, korrupsioni në fushën e prokurimit publik; si dhe, një aneks shtesë ku përfshihen format e standardizuara.

7. Aspekti praktik i implementimit të standardeve evropiane

Në nivelin e politikave operative, Policia e Kosovës me qëllim të arritjes së standardeve ka miratuar disa dokumente me rëndësi si: projektin implementues për bashkëpunim vendor dhe ndërkombëtar, manualin për komunikim në situatat e krizave; hartimi udhëzimeve administrative të cilat dalin nga Ligji i Policisë, politikat e Raportimit për përdorimin e forcës, standardizimi i formave policore në fushën e hetimit të krimit, politikat e reagimit ndaj alarmit në banka, obligimet e personelit policor pas kryerjes së trajnimeve të specializuara, politikat Njësia Speciale Ndërhyrëse, etj.¹⁴

Në aspektin organizativ, janë miratuar strukturat organizative të policisë si dhe janë themeluar sektorët e caktuar, që kanë rol në parandalimin dhe luftimin e krimit siç janë

¹⁴ Raporti Vjetor i Policisë së Kosovës, 2008, fq. 5.

Drejtoritë: kundër krimit të organizuar, kundër narkotikëve, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm, trafikimit me qenie njerëzore, bashkëpunim ndërkombëtar, inteligjencës, mbrojtje të dëshmitarëve, pastaj njësia kundër krimeve kibernetike, hetimeve financiare, njësia për parandalim dhe hulumtim të trafikimit me narkotik, njësia për asistim dhe mbrojtje të viktimave, etj. Në vitin 2009, në kuadër të strategjisë kundër krimit, janë paraparë centralizimi i njësive kundër krimit të organizuar, Drejtorisë për Analizë të Krimit, krijimi e Njësitit për Përkrahjen e Operacioneve të Fshehta, krijimi i Njësive për Hetimin e Krimit Kibernetikë në kuadër të PK-së etj.¹⁵

Në aspektin e implemmentimit të projekteve kryesore të teknologjisë informative dhe komunikimit janë arritur reforma në ndërtim të Sistemit të Integruar Informativ të Policisë së Kosovës, ndërtimi i qendrës së të dhënave të PK-së, projektit për ngritjen e kapaciteteve të rrjetës së PK-së, zhvillimi i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Resurseve të Policisë, krijimi i Sistemit për Menaxhimin e Dëshmimeve Policore, krijimi i bazës së të dhënave për menaxhimin e mjeteve themelore të Policisë, instalimi i sistemit të vëzhgimit përmes kamerave në objektet policore, shtrirja e rrjetit përmes fibrave optike, etj. Bashkëpunimi ndërkombëtar policor, për herë të parë, është i përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në bazë të Kushtetutës, me qëllim të ruajtjes së paqes dhe mbrojtjes së interesave shtetërore, Kosova mund të marrë pjesë në sisteme të sigurisë ndërkombëtare.¹⁶ Gjithashtu baza ligjore e bashkëpunimit policor ndërkombëtar, është paraparë në ligjin e ri të Policisë, i miratuar në vitin 2012.¹⁷

Sipas ligjit, policia bashkëpunon me organizata policore ndërkombëtare dhe institucione të tjera të huaja në bazë të legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare. Në bazë të kësaj dispozite, policia si organizatë, ka mundësinë e bashkëpunimit me çfarëdo organizate e cila mund të jetë rajonale apo edhe globale. Gjithashtu, ofrohet mundësia edhe e bashkëpunimit ndërkombëtar me organizata tjera policore të shteteve tjera. Policia mund të dërgojë zyrtarë ndërlidhës, me shërbim të përkohshëm në një organizatë policore ndërkombëtare, me qëllim të kryerjes së detyrave policore jashtë vendit, në përputhje me ligjin dhe marrëveshjet ndërkombëtare.¹⁸ Në zbatim të kësaj dispozite, policia ka dërguar pesë zyrtarë ndërlidhës në: Gjermani, Francë, Austri, Belgjikë dhe Turqi. Në vitin 2011, bëhet themelimi i Drejtorisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtarë e njohur me emërtim "ILECU".¹⁹ Themelimi i saj është një progres i theksuar në fushën e bashkëpunimit praktik operacional. Kjo drejtori është përgjegjëse për koordinimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe ndërkombëtar për të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit.²⁰

Pas themelimit të Drejtorisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar, në fushën e zbatimit të ligjit, ka pasur rritje të shkëmbimit të informacioneve në nivel ndërkombëtar. Kështu, Policia e Kosovës, gjatë vitit 2015 ka trajtuar 3428 informacion që ndërlidhen me raste ndërkombëtare, prej të cilëve ka asistuar në 18 raste të ekstradimit dhe një rast transferimi.²¹ Në prill të vitit 2015, është bërë aplikimi për praninë në organizatën e INTERPOL-it, ndërkohë që bashkëpunimi me EUROPOL-in ka vazhduar përmes diskut të Suedisë, i cili është në kuadër të EULEX-it.²²

¹⁵ *Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës Kundër Krimit të Organizuar dhe Plani i Veprimit, 2009-2012*

¹⁶ *Kushtetuta e Kosovës*, neni 2.

¹⁷ *Ligji i Policisë*, Nr. 04/L-076, 2012, neni 9.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ *Vendimi i Qeverisë së Kosovës*, Nr. 04/2, 2011.

²⁰ *Memorandum bashkëpunimi për koordinim dhe mbështetje për Njësinë për Bashkëpunimin Ndërkombëtar, në zbatim të Ligjit, 2011.*

²¹ *Raporti Vjetor i Policisë së Kosovës, 2015, f.13.*

²² Po aty.

Në bashkëpunimin me INTERPOL, Policia e Kosovës komunikimin e bën përmes INTERPOL-UNMIK, duke pasur status vëzhguesi në Asambleenë e Përgjithshme të INTERPOL-it. Me EUROPOL - Komunikimi bëhet përmes të ashtuquajturës “tavolina e Suedisë” e cila është e vendosur në kuadër të EULEX-it.

Në fushën e bashkëpunimit me FRONTEX, kemi marrëveshje të përbashkët të nënshkruar dhe bashkëpunimi është i vendosur edhe formalisht, por edhe praktikisht. Deri tani, Policia e Kosovës ka arritur të nënshkruajë 69 marrëveshje të bashkëpunimit policor ndërkombëtar, me 18 shtete të ndryshme si dhe me disa organizata ndërkombëtare. Kjo i mundëson asaj që të jetë një partner i rëndësishëm në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe ekstremizmit.

8. Përfundime

Vështirimi i përgjithshëm në rolin e policisë në demokraci, nxjerr në pah rëndësinë që ka ajo në shoqëri. Njerëzit në demokraci, kanë organizuar shtetin në një mënyrë të tillë, që të kenë liri maksimale për veten e tyre, brenda kuadrit të shtetit ligjor. Po kështu, janë hartuar sisteme të drejtësisë penale me qëllim që të garantohet liria dhe siguria e individit krahas përdorimit të mjeteve dhe metodave të veçanta në luftën kundër krimit.

Problemit të krimit të organizuar dhe ekstremizmit në shoqërinë kosovare, i duhet kushtuar kujdes i veçantë, sidomos nga mekanizmat shtetërorë, institucionalë dhe shoqërorë, duke u angazhuar aktivisht në parandalim dhe zbulim. Republika e Kosovës duhet të bëjë përpjekje për të implementuar një politikë të besueshme dhe reale në përmirësimin e situatës aktuale në fushën e sundimit të ligjit dhe, të merret në mënyrë efikase me parandalimin dhe luftimin e krimit, me qëllim progresin drejt rrugës së integritetit evropian.

Zbatimi i ligjit në Kosovë, në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit, kërkon akoma më shumë koordinim dhe bashkëpunim efikas ndërinstitucional si dhe bashkëpunimi rajonal e ndërkombëtar që janë parakushte themelore për sukses. Reformat e policisë janë bërë të zakonshme në shoqëritë bashkëkohore e sidomos në ato të tranzicionit. Ky standard është i aplikueshëm edhe në Kosovë, ku parashihen kriteret për reforma në sektorin e sigurisë në mënyrë specifike dhe të drejtpërdrejtë, por gjithashtu parashihen edhe arritjet e disa standardeve të cilat në mënyrë indirekte imponojnë nevojën reformave në sektorin e sigurisë. Anëtarësimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar me organizatat ndërkombëtare, është shumë me rëndësi. Në këtë fazë, Policia e Kosovës në aspektin e bashkëpunimit ndërkombëtar me organizatat ndërkombëtare, është sfidë dhe objektiv strategjik.

Me interes të veçan për fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit është anëtarësimi në disa organizata ndërkombëtare, ne veçanti: Interpol, Europol, Frontex, PCC, etj. Në rrugën e integritetit, Kosova duhet të themelojë bazën ligjore, por edhe mekanizmin institucional, me qëllim që të realizojë hetime proaktive të pasurisë së pazakonshme/të dyshimtë, të vendos një sistem të mirë kundër pastrimit të parave si dhe të zhvillojë e zbatojë, një sistem solid për konfiskimin dhe menaxhimin e aseteve, ashtu siç është në shtetet anëtare të BE-së.

Policia e Kosovës duhet të zhvillojë kapacitetet operacionale për hetime proaktive dhe në këtë kontekst zbatim më efikas të strategjisë, Policia e Udhëhequr nga Inteligenca. Për të plotësuar këto kritere, Kosova ka nevojë për përkrahje nga vet Bashkimi Evropian. Prandaj, për këtë arsye, në kuadër të këtij punimi, u trajtuan edhe aspektet e bashkëveprimit mes Kosovës dhe BE-së dhe mundësitë të cilat ofron procesi i integrimi për reformat në sektorin e policisë.

Bibliografi

1. Qeveria e Republikës së Kosovës. *Analiza e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës*. Prishtinë: 2014.
2. *Edukimi dhe Zhvillimi i Policisë*, revistë e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian. Prishtinë: 2005.
3. *Ligji i Policisë*, Nr. 04/L-076, 2012.
4. *Memorandum bashkëpunimi për koordinim dhe mbështetje për Njësinë për Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Zbatim të Ligjit*. Prishtinë: 2011.
5. Raporti Vjetor i Policisë së Kosovës, 2008.
6. Raporti Vjetor i Policisë së Kosovës, 2015.
7. *Raporti i Progresit për Kosovën*. Bruksel: 2014.
8. Raporti i Vlerësimeve të Kërcënimeve nga Krimi i Organizuar dhe Krimet e Rënda (SOCTA) i Policisë së Kosovës. Prishtinë: 2013.
9. FREEDOM, *Rishikimi Funksional i Policisë së Kosovës*. Prishtinë: 2009.
10. *Strategjia Kundër Terrorizmit e Bashkimit Evropian*. Bruksel: 2005.
11. *Udhërrëfytesë për Liberalizim të Vizave për Kosovën*. Bruksel: 2012.
12. *Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës Kundër Krimit të Organizuar dhe Plani i Veprimit 2009-2012*. Prishtinë: 2009.
13. *Vendimi i Qeverisë së Kosovës*, Nr. 04/2. Prishtinë: 2011.

Shtytësit kryesor të radikalizmit dhe shkalla e problemit me ekstremizëm të dhunshëm Rasti i Kosovës

Msc Nazmi Iballi

Akademia e Kosovës për Siguri Publike
nazmi.iballi@rks-gov.net

Dr. (në proces) Kujtim Bytyqi

Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës
kujtim.bytyqi@rks-gov.net

Dr. Bekim Podrimçaku

Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës
bekim.podrimçaku@rks-gov.net

Abstrakt

Lufta në Siri dhe pjesëmarrja e shumë qytetarëve të rinj të Kosovës të cilët janë rekrutuar si “luftëtarë të huaj”, duke luftuar për Shtetin Islamik të Irakut dhe Sirisë (ISIS) ka ngritur debate të vazhdueshme në shoqërinë kosovare. Faktorët e varfër politik dhe socioekonomik në Kosovë kanë ofruar një terren të përshtatshëm për depërtimin e ekstremizmit islamik. Kjo nxjerr në pah paaftësinë e treguar nga shteti dhe shoqëria, për të trajtuar rrënjët e një fenomeni të tillë të rrezikshëm, si dhe aftësinë e këtij fenomeni për të depërtuar edhe në vendet me traditë historike të harmonisë fetare, siç është edhe rasti i Kosovës. Shtytësit kryesorë që kontribuojnë në radikalizëm islamik të shoqërisë kosovare, mund të ndahen në tri kategori: problemet strukturore të shoqërisë, që përfshijnë dobësitë afatgjate socioekonomike e që për pasojë shkaktojnë edhe një varg problemesh tjera. E dyta, besimet personale, që përshkruajnë se si njerëzit e shohin botën dhe vendin e tyre në të, dhe përfshijnë idetë rreth të drejtës dhe të gabuarës, të drejtësisë dhe ndëshkimit. Kategoria e fundit, janë rrethanat personale, që përfshijnë faktorë shumë të rëndësishëm si, marrëdhëniet personale, familja dhe miqtë, shoqërimi me ekstremistë të tjerë si dhe çështjet e tjera si, lakmia, personaliteti sociopatik ose e kaluara penale. Prandaj, qëllimi i këtij punimi, është analiza i shtytësve kryesor të radikalizmit islamik në Kosovë si dhe vlerësimi i nivelit të kërcënimit që këta shtytës paraqesin për sigurinë e brendshme kombëtare.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit»

Fjalëkyçe:

shtytësit kryesor, radikalizmi, ekstremizmi i dhunshëm, terrorizmi, luftëtari i huaj

1. Hyrje

Kohët e fundit, një problem i theksuar për Kosovën është bërë radikalizimi i myslimanëve të rinj që janë rekrutuar si “luftëtarët e huaj”, për të luftuar në konfliktin në Siri duke luftuar për të ashtuquajturin Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë (ISIS). Që nga fillimi i konfliktit në Siri, luftëtarët e huaj nga vende të ndryshme të botës janë bashkuar në luftë kundër regjimit të Asadit. Fenomeni i luftëtarëve të huaj u shfaq në vitin 2011, kur nga protestat jo të dhunshme gjendja përshkallëzoi në një luftë të hapur civile. Në fillimet e veta, ky konflikt tërhoqi luftëtarë nga e gjithë bota, ku as Kosova nuk mbeti imune ndaj këtij mobilizimi.¹ Si rezultat, sipas departamentit të kundër-terrorizmit në kuadër të Kosovës, të paktën 17 qytetarë të saj iu bashkuan konfliktit në mes të janar-qershorit të vitit 2012. Gjatë vitit 2013, i ashtuquajturi Shteti Islamik (ISIS), vinte duke i konsoliduar dhe duke i forcuar radhët e tij nga fraksionet e ndryshme të Al Kaedës, si në strukturë e aftësi edhe në rekrutim.² Në të njëjtin vit, për herë të parë, shtetasi kosovar, Lavdrim Muhaxheri³, nëpërmjet një videoje të quajtur “të gjithë muslimanët shqiptarë të bashkohen në luftën kundër regjimit të Bashar al-Asad dhe të tjerëve ‘të pafeve’”⁴ u bëri thirrje publike në gjuhën shqipe të gjithë shqiptarëve, që të shkonin e të

¹ Louis Charbonneau, “Kosovo voices strong support for Syria opposition” Reuters 2012. Më shumë informacione në: <http://www.reuters.com/article/2012/05/14/us-syria-kosovo-idUSBRE84D1EI20120514> (qasur me 20 Korrik 2016).

² Peter Beaumont, *How effective is ISIS compared with the Iraqi army and Kurdish Peshmerga?* June 12, 2014. The Guardian. E qasshme ne: <http://www.theguardian.com/world/2014/jun/12/how-battle-ready-isis-iraqi-army-peshmerga> (qasur me 17 Gusht 2016).

³ Lavdrim Muhaxheri, është lider i formacionit paramilitar ushtarak shqiptar të Shtetit Islamik në Siri dhe Irak (ISIS). Me heret ka qene anetar i Al-Nusra por me vone iu bashkua ISIS-it. Me shume informacione ne: <http://www.gazetaexpress.com/en/news/who-is-lavdrim-muhaxheri-69-37296/?archive=1> (qasur me 17 Gusht 2016).

⁴ Indeksonline.net (2014) “Lufta ne Siri - Indeksonline” Youtube. E qasshme në: <https://www.youtube.com/watch?v=zhbWhgS6vc> (qasur me 17 gusht 2016).

luftonin në Siri. Në fakt, kjo erdhi si një sinjal i dhimbshëm për Kosovën, pasi kjo ia solli luftën civile të Sirisë më afër shtëpisë.⁵

Procesi i radikalizmit dhe shkaqet e përfshirjes së luftëtarëve të huaj kosovar në Siri dhe Irak është i nxitur nga shumë faktorë duke filluar nga problemet socioekonomike si, varfëria, papunësia dhe korrupsioni; ndjenja e së drejtës dhe padrejtësisë, ideologjive dhe besimeve, veçanërisht në lidhje me jetën e përtëjme dhe fundin e botës dhe, jo më pak të rëndësishme, edhe nga lidhjet e rrethanat personale.⁶

Qëllimi i këtij punimi, është analiza e shtytësve kryesor të radikalizmit islamik në Kosovë si dhe vlerësimi i nivelit të kërcënimit që këta shtytës paraqesin për sigurinë e brendshme kombëtare. Edhe pse ka përpjekje të vazhdueshme, shumë pak argumente informuese janë siguruar nga ekspertët, politikëbërësit, media, figura fetare dhe studiues në Kosovë në lidhje me faktorët shtytës të radikalizmit në Kosovë.

Sa i përket metodologjisë së kërkimit, në aspektin e burimeve primare, janë mbledhur gjetje të rëndësishme, duke përdorur intervista gjysmë të strukturuar me dy ish-luftëtarë të huaj kosovarë. Kjo, siç pritej, nuk ishte detyrë e lehtë, sepse të anketuarit nuk dëshironin të intervistoheshin. Nga nëntë që kemi kontaktuar për të bërë intervistë, vetëm dy prej tyre pranuan të përgjigjen. Arsytet ishin të ndryshme, por më kryesorja, frika nga hakmarrja e anëtarëve të tjerë xhihadist kosovar, apo edhe mosbesimi në institucionet shtetërore. Këta dy “luftëtarë të huaj” kanë qenë të përfshirë drejtpërdrejt në luftën kundër regjimit të Asadit, në mesin e verës të 2012-s dhe dimrit të 2013-s. Për shkak të ndjeshmërisë dhe besimit që ata ofruan ndaj nesh, identiteti i tyre mbetet anonim.

2. Shtytësit kryesor të radikalizmit

Shumë akademikë apo studiues, pajtohen se nuk ka një model definitiv të procesit të radikalizimit⁷ edhe se për një proces të tillë (në një masë të caktuar të kuptimit të tij specifik⁸) nuk ekziston një rrugë tipike e radikalizimit⁹. Megjithatë, ky koncept, veçanërisht në dekadën e fundit, është studiuar mirë dhe janë vënë në pah faktorë të ndryshëm si shtytës të mundshëm të radikalizmit. Veldhuis dhe Staun, e karakterizojnë procesin e radikalizmit, “si një proces që kalon nëpër faza të ndryshme, i ndikuar nga dinamika e grupit, ku trajektorët individuale që çojnë në përfshirje mund të ndryshojnë”¹⁰. Në nivelin makro, mund të jetë i karakterit politik, ekonomik dhe kulturor, ndërsa në nivelin mikro, ai mund të përfshijë ndërveprimin, proceset grupore, karakteristikat psikologjike apo përvojat personale.¹¹

⁵ Laura Aggio Caldon, (2015). “ISIS recruitment in Kosovo” 2 March 2015. Memo Middle East Monitor. E qasshme ne: <https://www.middleeastmonitor.com/articles/europe/17263-isis-recruitment-in-kosovo> (qasur me 18 Gusht 2016).

⁶ Scott Atran, *Talking to the Enemy: Faith, Brotherhood and the (Un)Making of Terrorists*, New York, 2010 (Kindle edition).

⁷ McCauley, C. & Moskalenko, S. (2008). *Mechanisms of Political Radicalization: Pathways Toward Terrorism, Terrorism and Political Violence*, 20 (3), 415-433.

⁸ Neumann, P. (2011). *Preventing Violent Radicalization in America*. Bipartisan Policy Center. Marrë nga: <http://bipartisanpolicy.org/wp-content/uploads/sites/default/files/NSPG.pdf> (qasur më 20 gusht 2016).

⁹ Weggemans, D., Bakker, E. & Grol, P. (2014). *Who Are They and Why Do They Go? The Radicalization and Preparatory Processes of Dutch Jihadist Foreign Fighters*. *Perspectives on Terrorism*, Vol. 8 (4), 100-110 Marrë nga: <http://www.terrorismanalysts.com/pt/index.php/pot/article/view/365/718>. (qasur më 20 gusht 2016).

¹⁰ Veldhuis, T. & Staun, J. (2009). *Islamist Radicalisation: A Root Cause Model*. Netherlands Institute of International Relations Clingendael. Marrë nga: http://www.dcisim.dk/graphics/_iO_indsatsomraader/Religion_og_social_konflikt_og_Mellemosten/Islamist%20Radicalisation.Veldhuis%20and%20Staun.pdf (qasur me 21 Gusht 2016).

¹¹ Po aty, 23.

McCauley dhe Moskalenko, me vëmendjen e tyre mbi dallimet sociale të proceseve të tilla, theksojnë se, “ka shumë kuptime të mundshme të radikalizmit, por shumica e dallimeve relevante mund të përfaqësohen me dallimet e zakonshme sociale psikologjike mes besimit, ndjenjës dhe sjelljes”¹². Prandaj, shumica e këtyre studiuesve vijnë kryesisht në një pikë të përbashkët, se procesi i radikalizmit është një proces i cili është i shtyrë kryesisht nga besimi personal, ndjenja dhe sjellja e një individi. Sipas John Horgan, ekziston literaturë e bollshme shkencore mbi radikalizimin, e cila ka treguar se ka shumë rrugë, të cilat çojnë drejt ekstremizmit të dhunshëm dhe ka shumë pak shenja të besueshme kërcënimi. Sipas tij, në katër dekadat e hulumtimit psikologjik, ende nuk është nxjerr një profil, i cili do të përcaktonte potencialet e një individi si terrorist të ardhshëm.¹³ Të tjerë, gjykojnë se “përpjekjet për të përgjithësuar problemin kanë dështuar”.¹⁴ Bazuar në këtë, mund të themi se shtytësit janë asimetric.

Scott Atran, një ekspert i rëndësishëm ndërkombëtar i fushës së sigurisë vëren se “në procesin e radikalizimit ka aq shumë rastësi, sa ka edhe qëllim: Dikush jepet pas xhihadit për çfarëdo arsye, dhe miqtë e ndjekin, duke marrë forcë nga të qëndruarit së bashku”.¹⁵ Një studim tjetër pajtohet me atë, se: “Nëse kemi mësuar ndonjë gjë në dekadën e fundit në lidhje me procesin e radikalizimit, është se, njerëz të ndryshëm angazhohen me ideologji të dhunshme ekstremiste apo aktorë në vende të ndryshme, për arsye të ndryshme dhe në momente të caktuara kohore. Për më tepër, rrugët e tyre përmes kësaj përvoje, shpeshherë nuk janë pothuajse as lineare e as të vazhdueshme.”¹⁶ Në këtë kuptim, dikujt që është i përfshirë në tri faza kryesore domethënë: të radikalizimit, të ekstremizmit dhe (në raste të rralla) të terrorizmit¹⁷, nuk i nevojitet domosdoshmërisht të kalojë në mënyrë lineare nëpër të gjithë hapat dhe ky mendim përputhet edhe me analizën e Horgan, kur ai thekson se “ka prova se jo të gjithë ata që përfshihen në sjellje të dhunshme patjetër duhet të posedojnë besimin radikal”.¹⁸

Një studim i metodave shumë të ndryshme ndaj strategjive për parandalim të ekstremizmit të dhunshëm, miratuar nga Franca, Indonezia, Irlanda e Veriut, Singapori dhe Britania e Madhe, ka gjetur se “nuk mund të ketë asnjë përgjigje të vetme e ‘të saktë’ për ta kuptuar ekstremizmin e dhunshëm, por dy sugjerime janë të qarta: njohuritë e nivelit lokal janë shpesh një pikë e mirë startuese për t’i përcaktuar shenjat e radikalizimit tek individët, por rrugët motivuese të njerëzve që i çojnë drejtë terrorizmit janë shpesh të komplikuar”.¹⁹ Megjithatë, nuk do të thotë se procesi i radikalizimit është krejtësisht i errët. Nga kjo rezulton se çdo ekstremist i dhunshëm arrin në pikën e tij/saj në fund, nëpërmjet një sërë vendimesh, emocioneve dhe ngjarjesh që mund të analizohen dhe të

¹² McCauley, C. & Moskalenko, S. (2008). *Mechanisms of Political Radicalization: Pathways Toward Terrorism, Terrorism and Political Violence*, 20 (3), 416.

¹³ John Horgan, *Director of Centre for Security Studies, University of Massachusetts at Lowell*, cituar te Stern dhe Berger, op. cit., 81.

¹⁴ Stern and Berger, op. cit., 81.

¹⁵ Atran, Scott, (2015) *Talking to the Enemy: Religion, Brotherhood, and the (Un) Making of Terrorists*, Harper Collins Publisher New York. 58.

¹⁶ Qatar International Academy for Security Studies, “Risk reduction for countering violent extremism,” 2010, 4. Marrë nga: <http://soufangroup.com/wp-content/uploads/2013/12/QIASS-CVE-FINAL-Report-112410-copy.pdf> (qasur më 16 gusht 2016).

¹⁷ Noppe, J., Verhage, A. & Easton, M. (2012). *The process of radicalization: an exploratory empirical study*. Governance of Security Research Papers Series, Volume 6, 3.

¹⁸ Horgan, J. (2012). *Discussion Point: The End of Radicalization? START*. Marrë nga: <http://www.start.umd.edu/news/discussion-point-end-radicalization>. (qasur më 18 gusht 2016).

¹⁹ Qatar International Academy for Security Studies, “Risk reduction for countering violent extremism,” 2010, 2. available online at: <http://soufangroup.com/wp-content/uploads/2013/12/QIASS-CVE-FINAL-Report-112410-copy.pdf> (qasur më 17 gusht 2016).

kuptohen. Çdo rrugë e radikalizmit e ka kuptimin dhe motivin e vet specifik, por secila nga ato është e veçantë dhe mund të ndryshojë në mënyrë dramatike nga të tjerat. Të rinjtë, veçanërisht djemtë e rinj, janë grupi më i rrezikuar se të gjithë të tjerët, nga ekstremizmi dhe dhuna. Këtë, më së miri e thekson Scott Atran, në fjalimin e tij në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, ku sipas tij, luftëtarët e huaj janë njerëz kryesisht të rinj, në fazat e tranzicionit të jetës së tyre: studentë, emigrantë dhe ata që gjatë kohës kur fillojnë të praktikojnë fenë dëbohen nga xhamia sepse shprehin bindje radikale politike.²⁰

Në rastin e Kosovës, faktorët (shtytësit) që i kontribuojnë radikalizmit mund të ndahen në tri kategori themelore:

- probleme strukturore të shoqërisë;
- besimet personale dhe ideologjitë;
- rrethanat personale.

Faktori i parë përfshin dobësitë afatgjata të shoqërisë kosovare, që janë shkaktuar nga një gamë e gjerë problemesh, të cilat nuk janë të kufizuara vetëm në ekstremizmin e dhunshëm. Përpjekjet për t'i kapërcyer këto dobësi janë në progres mirëpo do t'i duhej kohë. Faktori i dytë, përshkruan se si njerëzit e perceptojnë botën dhe vendin ku jetojnë dhe përfshin ide në lidhje me të drejtën dhe të gabuarën, drejtësinë dhe ndëshkimin. Kategoria e fundit e elaboruar, është ajo e rrethanave personale që mbulon faktorë shumë të rëndësishëm, siç janë marrëdhëniet personale. Rrjedhimisht, parashikuesi i vetëm më i mirë i ekstremizmit të dhunshëm në këtë rast është miqësia me ekstremistë të tjerë – dhe, çështje si lakmia apo e kaluara kriminale. Pra, ndër shtytësit e rëndësishëm të radikalizmit në Kosovë, është edhe faktori socioekonomik. Edhe pse nuk është vërtetuar në mënyrë të vazhdueshme, se ky faktor është çdo herë shtytës i radikalizmit që shpie në terrorizëm, një studim nga Caruso dhe Schneider ka gjetur një lidhje të rëndësishme pozitive në mes të normave të papunësisë së të rinjve dhe terrorizmit në Evropë, nga 1994-2007.²¹ Edhe autoritetet gjermane të sigurisë, kohëve të fundit kanë realizuar një studim lidhur me xhihadistët nga Gjermania, të cilët kanë udhëtuar për t'iu bashkangjitur ISIS-it. Nga ky studim del se ndër të gjithë xhihadistët, vetëm 12 për qind kishin një vend pune para se të radikalizoheshin. Edhe në rastin, kur ata kishin një vend pune, për këtë kërkohej një kualifikim minimal. Në mesin e xhihadistëve kishte edhe nga ata që kanë ndërprerë shkollën apo studimet.²²

Në rastin e Kosovës, niveli i papunësisë është më i larti në Evropë. Prej popullsisë së saj prej 1.8 milionë banorëve, vetëm 338.364 janë të punësuar, një normë punësimi prej 28.4 për qind.²³ Në këtë llogaritje, të rinjtë mes moshës 16 dhe 25 vjeç, shpesh kanë mjaft kohë të lirë.²⁴ Nga kjo, rezulton se punësimi i të rinjve është gjithashtu shumë i ulët, por ende më shqetësues është fakti se pjesa më e madhe e të rinjve (35.3 për qind) nuk janë aktiv në edukim, trajnim apo vende pune.²⁵

²⁰ Scott Atran, *remarks at UN Security Council session 7432 (on the role of youth in countering violent extremism and promoting peace)*, S/PV.7432 (23 April 2015), 6.

²¹ Caruso R., Schneider F., (2011), *The Socio-Economic determinants of terrorism and political violence in Western Europe (1994-2007)*. European Journal of Political Economy. Vol.27, S1, 37-49.

²² Issio Ehrich, *Was treibt Frauen zum IS?*, mund të gjendet online në: <http://www.n-tv.de/politik/Auf-der-Such-nach-den-besseren-Maennern-article13831891.html>, (qasar më 30 gusht 2016).

²³ Agjencioni i Statistikave të Kosovës, "Rezultatet e forcës punëtore në Kosovë për vitin 2013," nëntor 2014, 9.


²⁴ Intervistë me xhihadistin kosovar "Mani" - ai thoshte se në Siri ka shkuar në moshën 24 vjeçare. Nga mosha punës ai thoshte se ishte i papunë për 6 vite, prandaj kishte kohë të bollshme dhe kështu vendosi të shkonte, në Siri për të luftuar regjimin e Asadit.

²⁵ Caruso R., Schneider F. *The Socio-Economic determinants of terrorism and political violence in Western Europe (1994-2007)*, 37.

Sektori publik në Kosovë është punëdhënësi më i madh. Një pjesë e madhe e kosovarëve, besojnë se disa vende pune në dispozicion, janë shpërndarë në bazë të “lidhjeve familjare, ryshfetit, aleancave partiake dhe faktorëve të tjerë jo të meritës”, gjë që bën që shumica e të rinjve të jenë të dekurajuar nga ky fenomen, për të konkurruar në vende pune në këtë sektor. Sipas publikimit të UNDP-së, vetëm rreth 15 për qind e të intervistuarve, mendonin se kombinimi i lidhjeve familjare, partiake dhe ryshfetit i ka ndihmuar në gjetjen një vendi pune.²⁶

Kosova, përveç problemeve ekonomike, përballet edhe me nivelin e lartë të korrupsionit dhe të krimit të organizuar që ndikon, qoftë direkt apo edhe indirekt si shtytës, në nxitjen e individit drejt radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Kjo lloj sëmundjeje, mund të ndihet në të gjithë Kosovën. Prandaj, udhëtimi i disa qytetarëve të Kosovës drejt Sirisë dhe Irakut mund të jetë ndikuar nga (së paku nën nivelin e ndërdisjes së tyre) faktori socioekonomik. Për më tepër, sipas të dhënave të ofruara nga departamenti i kundër-terrorizmit në kuadër të Policisë së Kosovës, 80 për qind e të gjithë luftëtarëve të huaj të Kosovës vijnë nga familje të varfra (shih Fig. 1 më poshtë).

Figura 1: Gjendja ekonomike e “luftëtarëve të huaj” kosovarë



Burimi: baza e të dhënave e Policisë së Kosovës, 07 dhjetor 2015

Kjo situatë ka bërë që një komentator të konkludojë se: “...mjedisi ekonomik dhe social në Kosovë, këto ditë është “kohë e vjeljeve” për ekstremizmin që të përhapë mësimet e tij toksike dhe të indoktrinojnë një numër gjithnjë e më të madh të rinjsh”.²⁷ Prandaj, një numër i konsiderueshëm i qytetarëve të Kosovës, të cilët patën shkuar në ato vatra lufte, vijnë nga margjinat gjeografike, sociale dhe ekonomike.²⁸

Edhe mazoritë e kryera nga regjimi i Asadit, kanë qenë një shtytës për disa luftëtarë nga Kosova, për të udhëtuar për në Siri, në vitin 2011.²⁹ Krimet dhe padrejtësitë e bëra ndaj popullatës civile gjatë luftës së Kosovës (1998-1999), kanë ngjallur ndërgjegjen e disa të rinjve, të cilët e kanë përjetuar këtë luftë, që t’i bashkohen luftës në Siri për ta

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

²⁶ UNDP, “Public Pulse Report “ 9, Prepared by UNDP Kosovo - Public Pulse Project team. Marrë nga: http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/PublicPulse/pp9/PPR9_Anglisht.pdf Prishtina, April 2015. (qasur më 13 gusht 2016).

²⁷ Krasniqi Mirka, “Kosovo is Sleepwalking into the Islamists’s Arms”, Prishtina Insight, 29 gusht - 11 shtator 2014, 23.

²⁸ Intervistë me zyrtarin nga departamenti i kundërterrorizmit (DKT), Policia e Kosovës, Prishtinë, 18 gusht 2016.

²⁹ Intervistë me majorin Luan Keka, shef i hetimeve, DKT, Policia e Kosovës, 4 shtator 2016.

luftuar regjimin e Asadit, të cilin e kanë krahasuar atë me regjimin e Milosheviçit.³⁰ Krimet e kryera nga regjimi i Asadit janë dënuar nga vendet Perëndimore, ku edhe ministri i MPJ-së, Enver Hoxhaj, pat shprehur mbështetjen e hershme, për opozitën siriane dhe më pas bëri thirrje për një ndërhyrje ushtarake ndërkombëtare, duke cituar “përgjegjësinë për të mbrojtur” popullsinë civile.³¹ Si pasojë, në fillim të konfliktit, vullnetarët kosovarë, shkuan në Siri kryesisht për mbrojtjen e viktimave civile, duke iu bashkuar Ushtrisë së Lirë Siriane (ULS-së/FSA), por ata, fillimisht nuk konsideroheshin si kërcenim për sigurinë nga ana e autoriteteve shtetërore, megjithatë policia njoftoi se shumë prej atyre ishin ekstremistë fetarë.³² Nga ana tjetër, propaganda e ISIS-it ka përdor raportet dhe imazhet e krimeve të tmerrshme të qeverisë si mjet rekrutimi. Videot e dhunshme duke treguar imazhe grafike të mizorive qeveritare siriane qarkullonin vazhdimisht online.³³

Përveç faktorit humanitar, disa luftëtarë janë motivuar për të shkuar në Siri edhe nga dëshira për t’u bërë të rëndësishëm; “për t’u bërë aktorë”, duke i promovuar aktivitetet e tyre nëpërmjet rrjeteve sociale, sidomos veprime kriminale dhe kështu duke u munduar që të bëhen pjesë e historisë. Dëshira për t’u bërë i rëndësishëm, është shfrytëzuar kryesisht nga ata individë të cilët nuk kishin alternativë tjetër për një jetë kuptimplotë. Një sistem i arsimit publik dhe privat jo i dizajnuar në përputhje me kërkesat e tregut dhe numrin e të rinjve që hyjnë në tregun e punës, çdo vit ka bërë që shumë të rinjve t’u minimizohen alternativat. Veç kësaj, edhe “zbrazëtia ideologjike” e jetës publike, mostrajtimi i çështjeve të rëndësishme shtetërore të cilat do të duhet të kishin për synim zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, i shtyn disa të rinj, për të kërkuar alternativa në lëvizjet radikale në mënyrë që të bëhen të rëndësishëm. Problemi i varfërisë nuk mund të jetë çdo herë shtytës për t’u bërë “luftëtar i huaj” sepse dëshira për një vend pune, që paguhet mirë, mund t’i nxisë të rinjtë për të emigruar në shtetet e Bashkimit Evropian, por jo për t’u bërë pjesë e ISIS-it. Nga kjo rezulton se përfitimet materiale nuk janë faktori kryesor shtytës, sepse ata me dëshirën që të bëhen të rëndësishëm po flijojnë edhe jetën e tyre.

Atran, argumenton se lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm do të thotë “t’iu ofrosh diçka të rinjve; që i bën ata të ëndërrojnë për një jetë të rëndësishme, përmes luftës dhe sakrificës me shokë. Kjo është ajo që ofron ISIS (. . .) Të rinjtë nuk do të zgjedhin të sakrifikojnë çdo gjë, duke përfshirë edhe jetën e tyre, - tërësinë e interesave të tyre - vetëm për shpërblime materiale... për vlerat e shenjta, duhet të luftohet me vlerat të tjera të shenjta”.³⁴ Ekstremistët apelojnë për këtë lloj frustrimi duke treguar se sa shumë të rinj mund të arrijnë në radhët e tyre. Lavdrim Muhaxheri, xhihadisti kosovar nga Kaçaniku, ka luajtur një rol kryesor në serinë kryesore të propagandës së ISIS-it, Saleel el-Sawarim (Përlëshja e Shtpatave)³⁵. Filmi në të cilin ai u shfaq duke tundur një shpatë të shkurtër dhe duke i folur në mënyrë elokuate një turme në arabisht, ishte “egërsisht e suksesshme ... [dhe] grumbulloi miliona shikime në platforma të përhapjes

³⁰ Intervistë me dy luftëtarë të huaj kosovarë, “Mani dhe Gani”, të dy u përgjigjen që njërin nga motivet kryesore për të luftuar në Siri e kanë pasur edhe aspektin humanitar për t’i mbrojtur civilët sirianë kundër regjimit të Bashar Al-Asad-it, 26 dhe 29 gusht 2016.

³¹ Louis Charbonneau, “Kosovo voices strong support for Syrian opposition”, Reuters 14 May 2012. Marrë nga: <http://www.reuters.com/article/us-syria-kosovo-idUSBRE84D1E120120514>, (qasur më 20 gusht 2016).

³² Intervistë me zyrtarin nga departamenti i kundërterrorizmit, Policia e Kosovës, Prishtinë, 18 gusht 2016.

³³ Uri Friedman (2012) “The five worst atrocities of the Syrian Uprising” *Foreign Policy*. Marrë nga: <http://foreignpolicy.com/2012/05/29/the-five-worst-atrocities-of-the-syrian-uprising/> (qasur më 12 gusht 2016).

³⁴ Scott Atran, *remarks at UN Security Council meeting, 23 April 2015, S/PV 7432, 7*.

³⁵ Marrë nga: https://www.youtube.com/watch?v=m4yd1k_mIYA (qasur më 15 gusht 2016).

së videove”, duke shkaktuar “ngazëllim të madh në mesin e atyre që e ndoqën ISIS-in online dhe shumë nga ata që ishin të ndikuar nga mesazhi i tij”.³⁶

Përveç dëshirës për t’u bërë i rëndësishëm, nuk ka asnjë dyshim që edhe lidhjet personale kanë luajtur një rol të rëndësishëm në procesin e radikalizmit dhe shkuarjes së qytetarëve të Kosovës në konfliktin në Siri. Rreth tre në çdo katër njerëz që i bashkohen Al-Kaidës ose ISIS-it e bëjnë këtë nëpërmjet miqve; ndërsa shumica e pjesës tjetër e bëjnë këtë nëpërmjet bashkudhëtarëve apo familjes në kërkim të një rruge domethënëse në jetë. Rrallëherë, prindërit janë të vetëdijshëm se fëmijët e tyre dëshirojnë t’u bashkohen lëvizjes xhihadiste.³⁷ Këtë faktor, e dëshmon më së miri edhe intervista e realizuar me xhihadistin “Mani” (nuk është emri i tij i vërtetë), ku ai thotë se: “Ndihma për të shkuar në Siri është siguruar nga një mik i tij, i cili tashmë është duke luftuar në Siri dhe që do ta merrte atë nga Turqia dhe do ta dërgonte në Siri”.³⁸ Kjo dëshmon se lidhjet personale kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e radikalizmit të individëve. Rëndësinë e lidhjeve personale në procesin e radikalizmit e dëshmojnë edhe raste të tjera, ku shtetas të tjerë kosovarë, i janë bashkuar ISIS-it e që ishin miq të ngushtë dhe fqinjë me liderin kosovar të ISIS-it, Lavdrim Muhaxherin.³⁹

Argumentet të tilla, dëshmojnë se fqinjësia është shpesh “çelësi” në lidhjet xhihadiste. Për këtë arsye, Atran sugjeron se “në qoftë se ju doni ta gjeni grupin, shikoni se ku një nga anëtarët i këtij grupi ha, pi apo me kë shoqërohet, në fqinjësi apo në internet, ku si rezultat i kësaj, ju mund t’i gjeni bashkëideologët tuaj”.⁴⁰ Shumë luftëtarë të huaj kanë udhëtuar për në Siri dhe Irak, me qëllim që të jetojnë në të ashtuquajturin dhe të vetëshpallurin Kalifat, sipas ligjit të Sheriatit. Krijimi i një “shteti islamik”⁴¹, në të cilin zbatohet ligji i Sheriatit, të paktën sipas interpretimit të devijuar të Islamit nga ISIS-i, obligon të gjithë besimtarët myslimanë, të cilët nuk mund të ushtrojnë plotësisht Islamin në shoqëritë sekulare dhe demokratike, që të emigrojnë, gjoja për të ndjekur gjurmët e Profetit, kur ai ndërmoi hixhretin (migrimin), për në Medinë. Në disa komunitete, ky është njëri nga faktorët kyç, si motivim për të udhëtuar në Siri apo Irak, gjë që shpjegon largimin e një numri relativisht të madh edhe të grave dhe fëmijëve të tyre. Prandaj, largimi vullnetar tek i ashtuquajturi Shtet Islamik, nuk mund të jetë domosdoshmërisht me qëllim të luftimit, por për shkak se disa myslimanë ndihen të detyruar të largohen nga shoqëritë dhe vendet e tyre, ku sipas interpretimit të ISIS-it kanë pengesë në praktikimin e religjionit të tyre. Ky arsyetim për të jetuar në një shtet të tillë, duket të ketë nxitur edhe disa nga Kosovarët që të emigrojnë me familjet e tyre në Siri.⁴² Disa prej tyre besojnë se Sheriati është “e vetmja shpresë për njerëzimin”.⁴³ Këtu vërehet se ideologjia mund të jetë një faktor shumë tërheqës edhe për njerëzit që janë të frustruar

³⁶ Stern dhe Berger, op. cit. 110-12. conservative religious believers report. s nothing extremist about wearing a headscarf, the issue arose in many of the stakehold

³⁷ Scott Atran, *remarks at UN Security Council meeting, 23 prill 2015*, S/PV 7432, 4-5.

³⁸ Intervistë me dy luftëtarë të huaj kosovarë, 26 dhe 29 gusht 2016.

³⁹ “Ilir Berisha, Sadat Topojani and Jetmir Kycyku arrested today in counter-terrorism operacion”, *Gazeta Express* 26 qershor 2014. Marrë nga: <http://www.gazetaexpress.com/lajme/ilir-berisha-sadat-topojani-e-jetmir-kycyku-jane-te-arrestuarit-e-sotem-n-operacionin-kunder-terrorizmit-24693/?archive=1> (qasur më 17 gusht 2016).

⁴⁰ Scott Atran, *Talking to the Enemy: Faith, Brotherhood and the (Un)Making of Terrorists*, New York, 2010 (Kindle edition).

⁴¹ Graeme Wood, “What ISIS really wants”? Gjendet në:

<http://www.theatlantic.com/magazine/archive/2015/03/what-isis-really-wants/384980/>. “The caliph, Abu Bakr Al-Baghdadi, was appointed secretly in late June 2014”, *The Atlantic*, March 2015.

⁴² Shiko për më shumë: *Kosovo Centre for Security Studies Report*, “The overwhelming majority of fighters joined the conflict on religious grounds”.

⁴³ Shiko për më shumë: *Kosovo Centre for Security Studies Report*, 26.

nga paraqitjet grafike të ISIS-it, të cilat kanë për qëllim që të paraqesin abuzimet e të drejtave të njeriut nga shtetet Perëndimore.⁴⁴

Bazuar në këtë që u tha më sipër, vihet në pah se edhe ideologjia konsiderohet si njëri prej motiveve shumë të rëndësishme, që shtyn qytetarët kosovarë për t'iu bashkuar konfliktit në Siri. Ata që shkojnë duke u bazuar në këtë motiv, mendojnë se janë duke luftuar për allahun dhe për forcimin e shtetit islamik, dhe se ata ndiejnë obligim ideologjik për t'i mbrojtur myslimanët nga të tjerët. Vlen të shtohet se disa kosovarë udhëtojnë në Siri, jo domosdoshmërisht për të marrë pjesë në mënyrë aktive në luftime, por për të jetuar në "Shtetit Islamik" sipas "parimeve islame".⁴⁵

Duke u ndërlidhur me faktorin ideologjik, frika nga xhehenemi (ferri) është një motiv i fortë për disa ekstremistë të dhunshëm. Sipas Policisë së Kosovës, disa nga xhihadistët e përgjuar paraqitën shumë njohuri në lidhje me Kur'anin, duke folur për frikën nga ferri.⁴⁶ Njerëzit që kanë jetuar jetën mëkatore, ose që ndjehen të ngarkuar psikologjikisht nga faji dhe frika, mund të jenë pre e manipulimit nga rekrutuesit, të cilët e zënë prenë e tyre duke i frikuar ata nga gjykimi hyjnor. Shumë kulte kanë abuzuar me rrëfimin e mëkatit dhe me informacione të tjera të turpshme personale si një teknikë të "shpëlarjes së trurit".⁴⁷

Ka debate të vazhdueshme në lidhje me rolin e internetit dhe medie sociale në radikalizim dhe mbi politikën më të mira të kundër ekstremizmit online.⁴⁸ Kohët e fundit, zhvillimi i Teknologjisë së Informacionit ka kontribuar shumë në përhapjen e ideologjive ekstremiste.⁴⁹ Disa studiues besojnë se "për ata që tashme janë në rrugën drejt radikalizimit", media sociale krijon grupe të errëta të lidhjeve sociale, që janë krijuar nga rekrutuesit terrorist dhe influencuesit. Qindra luftëtarë përdorin llogaritë personale në media sociale për të dokumentuar përvojat, për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për t'i këshilluar ata që janë të interesuar t'iu bashkëngjiten atyre.⁵⁰ Në "Twitter" ose "Facebook", është shumë lehtë të gjejmë llogari radikale apo ekstremiste, që përdoren nga rekrutuesit terrorist që kërkojnë prenë e tyre brenda shoqërisë.⁵¹ "Ky është gjithashtu edhe mendimi i zbatuesve të ligjit në Kosovë, që kanë vënë re rekrutues tërheqës duke joshur caqet e tyre në faqe publike si "Facebook"-u, ndërsa më pas ata i drejtonin ata në forume private online dhe në fund duke kontaktuar ata personalisht përmes "Skype"-it.⁵² Nuk ka asnjë dyshim se në kuptim të komunikimit dhe për shkak të teknologjisë moderne, pjesëmarrësit në luftërat e Sirisë dhe Irakut janë vazhdimisht në kontakt të drejtpërdrejtë me luftëtar të rinj potencialë. Ky "trafik virtual" i dyanshëm, është praktikisht i pafund dhe i pamundur, për t'u monitoruar.

Faktori i fundit, por jo nga rëndësia, është e kaluara e mëparshme kriminale ose ikja

⁴⁴ Atran, Scott, *Remarks at UN Security Council meeting*, 23 April 2015, S/PV 7432, 6. "A young Frenchwoman told Scott Atran that "she would choose the caliphate to help create a homeland where Muslims could pool their resources, be strong again and live in dignity."

⁴⁵ Intervistë me majorin Luan Keka, shef i hetimeve, DKT, Policia e Kosovës, 4 shtator 2016.

⁴⁶ *Comment at OSCE roundtable*, "United Against Terrorism: Protecting youth against radicalisations", Prishtinë, 28 prill, 2015.

⁴⁷ "Confession is one of the eight main tools used by cults for what Robert Jay Lifton called "thought reform". Gjetet në: http://changingminds.org/techniques/conversion/lifton_thought_reform.htm (qasur më 15 gusht 2016).

⁴⁸ Intervista me dy ish-luftëtar të huaj kosovarë, të dy kanë thënë se janë ndikuar edhe nga interneti dhe mediet (26 dhe 29 gusht 2016).

⁴⁹ *Intervista me majorin Luan Keka*, 2016.

⁵⁰ Mullins Sam, "Foreign Fighters in Syria - Tracking the trend and assessing the threat", *Concordiam Journal of European Security and Defense Issues*, Volume 5, Issue 3, 2014, f. 37.

⁵¹ Stern dhe Berger, *ISIS*, op. cit., 137-8.

⁵² Interviste me zyrtarin e lartë nga departamenti i kundërterrorizmit, Policia e Kosovës, Prishtinë, 18 gusht 2016.

nga ndjekja penale e që ka qenë dhe është një motiv shumë i rëndësishëm për t'iu bashkuar konfliktit në Siri. Sipas një studimi gjerman, më shumë se 60 për qind e xhihadistëve nga Gjermania, që kanë udhëtuar në Siri dhe Irak, kishin kryer tashmë një vepër penale - kryesisht përmes dhunës, vjedhjes apo drogës.⁵³ Edhe në rastin e Kosovës, sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, afër 40 për qind e atyre, që kanë qenë tashmë në Siri kanë pasur një numër të veprave kriminale para se të niseshin atje. Gjysma e tyre kanë më shumë se një vepër kriminale.⁵⁴ Për shembull, Lavdrim Muhaxheri, nga Kaçaniku, i cili ka gradën komandant në ISIS, kishte 7 vepra kriminale para se të nisej për në Siri.⁵⁵

Krimet për të cilat këta njerëz janë hetuar, dënuar apo burgosur përfshijnë: sulme të dhunshme, vjedhje, armëmbajtje pa leje, frikësim dhe mashtrim, posedim të narkotikëve, vrasje dhe tentim vrasje.⁵⁶ Arsyeya se përse këta njerëz i bashkohen konfliktit në Siri, lidhet shumë me ideologjinë, pasi ata besojnë se zoti do t'ua falë veprat e tyre të mëparshme kriminale dhe se ata do të gjejnë faljen e Allahut në "Ditën e Gjykimit".

3. Përfundimet

Bazuar në këtë hulumtim, nxjerrim përfundimin se faktorët të cilët kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë në procesin e radikalizmit, janë të natyrës asimetrike. Këta faktorë ndryshojnë nga shteti në shtet. Shembujt e ilustruar, tregojnë më së miri se motivet janë të ndryshme, por në rastin e Kosovës faktorët që më së shumti kanë nxitur kosovarët që t'i bashkohen luftërave në Siri dhe Irak janë: faktori socioekonomik, i cili del të jetë njëri nga faktorët më shtytës, si rezultat i shkallës së lartë së papunësisë si dhe, mundësive e perspektivës tejet të kufizuar, për të rinjtë kosovarë. Dihet që, Kosova ka popullsinë me moshën më të re në Evropë dhe se nuk ka kapacitete shtetërore për t'u mundësuar të gjithë atyre një vend pune. Ky faktor, mund të vazhdojë të mbetet problematik edhe për një kohë të gjatë, pasi zhvillimi ekonomik është proces afatgjatë dhe me një ritëm tejet të ngadaltë në rastin e Kosovës. Faktori tjetër që pason nga rëndësia, është motivi humanitar. Të intervistuarit që ishin objekt i hulumtimit, thanë se përveçse ishin të varfër dhe të papunë, motiv i tyre ishte gjithashtu edhe ai humanitari. Krimet dhe padrejtësitë e bëra ndaj popullatës civile gjatë luftës së Kosovës (1998-1999), kanë ngjallur ndërjegjien e disa të rinjve, të cilët e kanë përjetuar këtë luftë që t'i bashkohen luftës në Siri për ta luftuar regjimin e Asadit, të cilin e kanë krahasuar atë me regjimin e Milosheviçit.

Përveç dëshirës për t'u bërë të rëndësishëm, nuk ka asnjë dyshim që edhe familja dhe miqtë, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në procesin e radikalizmit dhe shkuarjes së qytetarëve të Kosovës në konfliktin në Siri. Gjithashtu, në këtë hulumtim është parë se largimi vullnetar tek ashtuquajturit "Shtet Islamik", nuk mund të jetë domosdoshmërisht me qëllim të luftimit, por për shkak se disa myslimanë ndihen të detyruar të largohen nga shoqëritë dhe vendet e tyre, ku sipas interpretimit të ISIS-it kanë pengesë në praktikimin e religjionit të tyre. Prandaj, një numër qytetarësh kanë udhëtuar në Siri me familjet e tyre, me qëllim që të jetojnë në "Shtetin Islamik" ku sipas tyre, ata do t'i

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

⁵³ Issio Ehrich, *Was treibt Frauen zum IS?*. Gjetendet online në: <http://www.n-tv.de/politik/Auf-der-Suche-nach-den-besseren-Maennern-article13831891.html>, (qasur më 30 gusht 2016).

⁵⁴ Të dhënat e ofruara nga departamenti i kundërterrorizmit, Policia e Kosovës, 7 dhjetor 2015.

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ Po aty.

vendosnin lirshëm bazat e jetës së tyre, sipas rregullave të ligjit të Sheriatit. Po ashtu, edhe interneti e media sociale, kanë ndikuar që një pjesë e të rinjve në Kosovë, të lidhen me rekrutues të ISIS-it. E kaluara e mëparshme kriminale, ose ikja nga ndjekja penale, është gjithashtu një motiv që i ka shtyrë disa të rinj për t'iu bashkuar konfliktit në Siri. Si përfundim, mund të vlerësojmë se përfshirja e qytetarëve nga Kosova në luftën në Siri dhe Irak, paraqet një kërcënim për sigurinë e brendshme dhe të jashtme, sepse pas kthimit të tyre, ata vijnë me përvojën e theksuar ushtarake, të aftë në përdorimin e eksplozivëve si dhe të radikalizuar ideologjikisht. Kjo mund të ketë pasojë afatgjatë kërcënuese në shoqërinë kosovare duke e bartur kështu, modelin e tyre edhe për të rinjtë e tjerë. Veç kësaj, këta të kthyer paraqesin një sfidë të madhe për shtetin e Kosovës, në procesin e rehabilitimit dhe riintegrit të tyre në jetën normale.

Bibliografia

1. Atran, Scott, (2015) *Talking to the Enemy: Religion, Brotherhood, and the (Un) Making of Terrorists*, Harper Collins Publisher, New York.
2. Caruso R., Schneider F., (2011), *The Socio-Economic determinants of terrorism and political violence in Western Europe (1994-2007)*. European Journal of Political Economy. Vol.27, S1, 37-49.
3. Graeme Wood, "What ISIS really wants"? Marrë nga: <http://www.theatlantic.com/magazine/archive/2015/03/what-isis-really-wants/384980/>. The caliph, Abu Bakr Al-Baghdadi, was appointed secretly in late June 2014. The Atlantic, March 2015.
4. Horgan, J. (2012). *Discussion Point: The End of Radicalization? START*. Marrë nga: <http://www.start.umd.edu/news/discussion-point-end-radicalization>. (qasur me 18 gusht 2016).
5. Issio Ehrich, *Was treibt Frauen zum IS?*, mund të gjendet online në: <http://www.n-tv.de/politik/Auf-der-Suche-nach-den-besseren-Maennern-article13831891.html>, (qasur më 30 gusht 2016).
6. John Horgan, *Director of Centre for Security Studies, University of Massachusetts at Lowell*, cituar te Stern dhe Berger, op. cit., 81.
7. Krasniqi Mirka, "Kosovo is Sleepwalking into the Islamists's Arms", Prishtina Insight, 29 gusht – 11 shtator 2014, 23.
8. Kursani Shpend, "The overwhelming majority of fighters joined the conflict on religious grounds" Kosovo Centre for Security Studies Report 26.
9. Laura Aggio Caldon, (2015). "ISIS recruitment in Kosovo" 2 March 2015. Memo Middle East Monitor. Gjendet në: <https://www.middleeastmonitor.com/articles/europe/17263-isis-recruitment-in-kosovo> (qasur më 18 gusht 2016).
10. Louis Charbonneau, "Kosovo voices strong support for Syria opposition" Reuters 2012. Më shumë informacione në: <http://www.reuters.com/article/2012/05/14/us-syria-kosovo-idUSBRE84D1EI20120514> (qasur më 20 korrik 2016).
11. McCauley, C. & Moskalenko, S. (2008). *Mechanisms of Political Radicalization: Pathways Toward Terrorism. Terrorism and Political Violence*, 20 (3), 415-433.
12. Mullins Sam, *Foreign Fighters in Syria – Tracking the trend and assessing the threat*, per Concordiam Journal of European Security and Defense Issues. Volume 5, Issue 3, 2014, 37.
13. Neumann, P. (2011). *Preventing Violent Radicalization in America. Bipartisan Policy Center*. Marrë nga: <http://bipartisanpolicy.org/wp-content/uploads/sites/default/files/NSPG.pdf> (qasur më 20 gusht 2016).
14. Noppe, J., Verhage, A. & Easton, M. (2012). *The process of radicalization: an exploratory empirical study*. Governance of Security Research Papers Series, Volume 6, 3.
15. Peter Beaumont, *How effective is ISIS compared with the Iraqi army and Kurdish Peshmerga?* June 12, 2014. The Guardian. Gjendet në: <http://www.theguardian.com/world/2014/jun/12/how-battle-ready-isis-iraqi-army-peshmerga> (qasur me 17 Gusht 2016).
16. Scott Atran, *remarks at UN Security Council session 7432 (on the role of youth in countering violent extremism and promoting peace)*, S/PV.7432 (23 April 2015), 6.
17. Scott Atran, *Talking to the Enemy: Faith, Brotherhood and the (Un)Making of Terrorists*, New York, 2010

- (Kindle edition).
18. Uri Friedman (2012) "The five worst atrocities of the Syrian Uprising" *Foreign Policy*. Marrë nga: <http://foreignpolicy.com/2012/05/29/the-five-worst-atrocities-of-the-syrian-uprising/> (qasur më 12 gusht 2016).
 19. Veldhuis, T. & Staun, J. (2009). *Islamist Radicalisation: A Root Cause Model*. Netherlands Institute of International Relations Clingendael. Marrë nga: http://www.dicm.dk/graphics/_JO_indsatsomraader/Religion_og_social_konflikt_og_Mellemsten/Islamist%20Radicalisation.Veldhuis%20and%20Staun.pdf (qasur më 21 gusht 2016).
 20. Weggemans, D., Bakker, E. & Grol, P. (2014). *Who Are They and Why Do They Go? The Radicalization and Preparatory Processes of Dutch Jihadist Foreign Fighters. Perspectives on Terrorism*, Vol. 8 (4), 100-110 Marrë nga: <http://www.terrorismanalysts.com/pt/index.php/pot/article/view/365/718>. (qasur më 20 Gusht 2016).
 21. Agjencioni i Statistikave të Kosovës, "Rezultatet e forcës punëtore në Kosovë për vitin 2013," nëntor 2014, 9.
 22. Indeksonline.net (2014) "Lufta ne Siri – Indeksonline" Youtube. Gjendet në: <https://www.youtube.com/watch?v=zhbWhgS6svc> (qasur më 17 gusht 2016).
 23. Qatar International Academy for Security Studies, "Risk reduction for countering violent extremism," 2010, 4. Marrë nga: <http://soufangroup.com/wp-content/uploads/2013/12/QIASS-CVE-FINAL-Report-112410-copy.pdf> (qasur më 16 gusht 2016).
 24. UNDP, "Public Pulse Report " 9, Prepared by UNDP Kosovo - Public Pulse Project team. Marrë nga: http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/PublicPulse/pp9/PPR9_Anglisht.pdf Prishtina, prill 2015 (qasur më 13 gusht 2016).

Detyrimi pozitiv i shtetit për mbrojtjen e së drejtës për të mos qenë subjekt i trajtimit çnjerëzor ose degradues, gjatë dhënies së dëshmisë

Dr. Rezana BALLA

Akademia e Sigurisë

ballarezana@gmail.com

Abstrakt

Të drejtat dhe liritë e individit nuk mund të kuptohen ose të zbatohen, nëse nuk përkthehen në detyrime pozitive të shtetit për të garantuar mbrojtjen e këtyre të drejtave. Nëpërmjet këtij punimi, synohet që të realizohet një trajtim i sistemit juridiko-penal, të garancive kushtetuese të dëshmitarëve të drejtësisë. Ky trajtim synohet të bëhet sipas një vështrimi të hollësishëm historik, të etapave të evoluimit të këtij instituti të rëndësishëm të së drejtës penale materiale dhe procedurale. Artikulli synon që të trajtojë reagimin e institucioneve ndërkombëtare ndaj shkeljeve të vlerave themelore, të lirive dhe të drejtave individuale të bashkësisë njerëzore, si dhe faktorëve që kanë qenë kyç në përforcimin dhe evoluimin e sistemit juridiko-penal. Artikulli nuk synon jo vetëm një pasqyrë të reagimit juridiko-penal në rrafshin kombëtar, por edhe një reagim institucional mbi praktikën institucionale ndërkombëtare, me qëllim përfitimin e praktikës më të mirë institucionale për mbrojtjen e dëshmitarëve të drejtësisë. Sipas përfundimeve të arritura në këtë përpunim, rekomandohet të zbatohet në Shqipëri detyrimi pozitiv i shtetit për të siguruar të drejtën e jetës; detyrimi pozitiv i shtetit për mbrojtjen e të drejtës, për të mos qenë subjekt i trajtimit çnjerëzor ose degradues, gjatë dhënies së dëshmisë.

Fjalëkyçe:

detyrim pozitiv; trajtim juridik; mbrojtje dëshmitari; prezumim i pafajësisë.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

1. Hyrje

E drejta penale dhe e drejta e procedurës penale, përshkohen në mënyrë të pashmangshme nga e drejta e humanizmit. Pothuajse të gjitha aktet ndërkombëtare detyruese në fushën e së drejtës penale, parashikohet parimi i humanizmit i trajtimit me dinjitet të qenieve njerëzore, etj. Kjo është një prej të drejtave themelore të individit dhe është e pandashëm nga e drejta për t'u trajtuar me dinjitet njerëzor, e drejta e jetës, e drejta për mbrojtjen e integritetit fizik, lirinë personale, etj. Të gjitha shtetet në bazë të akteve të shumta ndërkombëtare, angazhohen se jo vetëm do t'i njohin këto të drejta, si të drejta themelore me ligj, por edhe do të përcaktojnë garancinë juridike, për mbrojtjen ndaj pushtetit represiv të punonjësve të zbatimit të ligjit dhe ndaj kërcënimeve të tjera. Në këtë mënyrë, shtetet marrin në mbrojtje grupet shoqërore më të rrezikuara ose më të dobëta ndaj keqtrajtimeve, siç janë gratë, fëmijët ose personat me aftësi të kufizuara fizike e mendore. Nisur edhe nga këto përvoja negative, Kushtetuta aktuale shqiptare, e frymëzuar edhe nga parime demokratike përparimtare dhe e përshkuar veçanërisht nga fryma e humanizmit¹ të spikatur, ka parashikuar një mbrojtje të veçantë për kategori të caktuara shoqërore. Sipas nenit 54 të Kushtetutës, fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja, kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti. Fëmijët mbrohen jo vetëm nga dhuna dhe keqtrajtimi, por edhe nga shfrytëzimi dhe përdorimi për punë të ndaluara nga Kodi i Punës për moshën e tyre. Për të realizuar këtë detyrë të shtetit, Kodi Penal, në nenet e kreut II, seksioni VI-IX, parashikon disa vepra të posaçme për mbrojtjen e grave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave të pazotë për t'u mbrojtur, si, marrëdhëniet seksuale, rrëmbimi ose mbajtja peng e të miturit,

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit »

¹ Anastasi, A., Omari, L., *E drejta Kushteuëse*, Tiranë, 2010, fq. 154.

shfrytëzimi i prostitucionit, trafikimi i femrave ose i fëmijëve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit si, shfrytëzimit seksual, punës ose shërbimeve të detyruara², skllavërimet, etj.

Në përputhje me nenin 49-të të Kushtetutës, çdo njeri ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij, me punë të ligjshme që e ka zgjedhur dhe pranuar vetë. Një formë shtrëngimi ose kërcënimi, është përdorimi i një detyrimi ose borxhi. Shpesh e referuar si “punë detyruese” ose “detyrim borxhi”, praktika ka qenë për një kohë të gjatë e ndaluar sipas ligjit amerikan, me termin e huazuar nga spanjishtja – “peonage” – që do të thotë “zgjedhë” ose “nënshtrim” dhe nga Protokoli i Palermos, i cili kërkon kriminalizimin e kësaj praktike, si një formë e trafikimit të personave. Punëtorët mundet gjithashtu, të trashëgojnë borxhe sipas sistemeve tradicionale të punës detyruese³. Thelbi i parimit kushtetues të humanizmit, në të drejtën penale qëndron së pari, në mbrojtjen e veçantë që u bëhet kategorive të brishta të shoqërisë, fëmijëve, grave dhe personave me aftësi të kufizuara, si dhe në caktimin e dënimeve të drejta për të gjitha autorët e veprave penale⁴. Kodi Penal në një varg dispozitash të tij, qoftë të pjesës së përgjithshme që kanë të bëjnë me përcaktimin e moshës për përgjegjësi penale, duke përjashtuar të miturit nga përgjegjësia penale, në caktimin e dënimit, etj., si edhe në dispozita të pjesës së posaçme të tij si: gjenocidet, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës e deri tek ato që mbrojnë jetën dhe shëndetin e posaçërisht lirinë e paprekshmërinë seksuale të së miturve dhe grave, etj., shpreh qartë aplikimin e parimit të humanizmit⁵. Por, edhe pse dispozitat e Kodit Penal, të cilat shprehin qartë standardet e pranuar në shkallë ndërkombëtare, në luftën kundër trafikimit, janë një element shumë i domosdoshëm, ato nuk janë të mjaftueshme – për këtë, le të shohim se si është mundësuar zbatimi i tyre.

Parimi i humanizmit ndalon shkaktimin e vuajtjeve dhe dëmtimeve të panevojshme. Ky parim është parimi bazë për mbrojtjen e popullsisë civile, në rastet e konflikteve të armatosura ose sulmeve terroriste. E drejta ndërkombëtare humanitare vendos kufizime të përgjithshme mbi operacionet ushtarake, duke kërkuar që gjatë përfshirjes në një konflikt të armatosur, të zbatohen parimet e domosdoshmërisë së humanizmit dhe proporcionalitetit. Parimi i legjitimitetit, nuk kufizohet vetëm me zbatimin e së drejtës penale, por edhe në zbatimin e masave represive, siç janë sanksionet e parashikuara nga Kodet Penale. Por, zbatimi i sanksioneve të parashikuara nga ligji, karakterizohet nga parimi i humanizmit dhe socializimit të autorit të veprës penale. Parimi i humanizmit reflektohet edhe tek përcaktimi i moshës së përgjegjësive penale, uljes së dënimeve e dënimeve me kusht.

Teoricienë të së drejtës, shprehen se, nga niveli i zbatimit të këtij parimi kaq të rëndësishëm të së drejtës ndërkombëtare penale, përcaktohet në një masë të konsiderueshme edhe niveli i demokracisë së një vendi. Por, nisur nga zhvillimet e

² Studimet më të fundit bashkëkohore tregojnë se pjesa më e madhe e trafikimit të qenieve njerëzore kanë formën e punës së detyruar. ILO (Organizata Ndërkombëtare e Punës) vlerëson se për çdo viktimit trafikimi subjekt të prostitucionit të detyruar, nëntë persona janë detyruar të punojnë forcërisht. Gjithashtu, e njohur si shërbim i pavullnetshëm, puna e detyrueshme mund të rezultojë kur punëmarrës të paskrupujt shfrytëzojnë punëtorët që janë më vulnerabël duke pasur parasysh shkallën e lartë të papunësisë, varfërinë, krimin, diskriminimin, korrupsionin, konfliktet politike ose kulturën e përgjithshme. Emigrantët janë veçanërisht vulnerabël, por individët mund të detyrohen të punojnë edhe në shtetet, shtetas të të cilëve ata janë. Viktimat femra të punës së detyruar veçanërisht gratë dhe vajzat e reja në shërbime në shtëpi shpesh shfrytëzohen, përveç punës së detyrueshme edhe seksualisht.

³ Në Azinë Jugore, për shembull, është vlerësuar se ndodhen miliona viktima të trafikimit që punojnë për të paguar ose shlyer borxhe të së parëve të tyre.

⁴ Muçi, Sh., *E drejta Penale Pjesa e Përgjithshme*, Tiranë 2007, fq. 31.

⁵ Elezi, I., Kaçupi, S., Haxhia, M., *Komentari i Kodit Penal*, Tiranë, 2009, fq. 40.

sotme, që konsiderohen me demokratiket e të gjitha kohërave, reagimi ndaj akteve terroriste nuk ka qenë vetëm ligjor, pra nëpërmjet zbatimit të ligjit, por ka ardhur edhe nëpërmjet reagimit ushtarak. Burgu i Gatanamos, në Kubë, është themeluar në vitin 2002 nga ana e administratës Bush, për të mbajtur të burgosurit që besohet të jenë të lidhur me luftën në Afganistan e më vonë në Irak, ose me sulmet terroriste. Edhe dëshmitarët edhe bashkëpunëtorët e drejtësisë, por njëkohësisht, dhe veçanërisht, edhe viktimat e krimit, meritojnë të trajtohen me humanizëm nga institucionet e zbatimit të ligjit.

2. Ndalimi i torturës dhe trajtimit ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose degraduese

Parimi ndalimit të torturës dhe trajtimit ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose degraduese është një parim universal, i parashikuar në mënyrë eksplicite ndaluese dhe urdhëruese nga të gjitha aktet ndërkombëtare që kanë në fokus të drejtat dhe liritë themelore të njeriut: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (neni 5), Pakti mbi të Drejtat Civile dhe Politike (neni 7), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁶ (neni 3). Një nga problematikat më të rëndësishme në këtë fushë, me të cilat janë shkelur aktet ndërkombëtare⁷ që parashikojnë këto të drejta, është mbajtja e të burgosurve⁸ në burgjet e “Guantanamo Bay”. Anëtarët e Bashkimit Evropian dhe Organizata e Shteteve Amerikane, si dhe organizata joqeveritare, si “Amnesty International” dhe “Human Rights Watch”, kanë protestuar statusin ligjor dhe gjendjen fizike të ts burgosurve në Guantanamo. Organizata për Të Drejtat e Njeriut (“Human Rights Watch”) ka kritikuar administratën e Bushit mbi këtë përcaktim, në vitin 2003, në raportin e saj botëror, duke deklaruar: “Uashingtoni ka injoruar standardet e të drejtave të njeriut në trajtimin prej tij të së dyshuarve të terrorizmit⁹”.

Ai ka refuzuar që të zbatojë konventat e Gjenevës për të burgosurit e luftës nga Afganistani dhe, ka keqpërdorur termin ‘luftëtar ilegal’, i aplikuar ndaj të dyshuarve për vepra penale në tokën amerikane”. Në maj 2007, Martin Scheinin, një raportues i Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat në luftën kundër terrorizmit, publikoi një raport paraprak të Kombeve të Bashkuara të Këshillit Për të Drejtat e Njeriut. Raporti theksoi se Shtetet e Bashkuara kanë shkelur ligjin ndërkombëtar, Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike në veçanti, se administrata e Bushit nuk mund t’i provonte për të burgosurit si luftëtarë të armikut, në një gjykatë ushtarake dhe, mundi t’u mohojë

⁶ Neni 3 i KEDNJ përcakton: “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore e poshtëruese”.

⁷ Një raport i publikuar në prill 2011 në revistën PLoS Medicine kishte vëzhguar në rastet e nëntë individëve për dëshmi të trajtimit të torturës dhe të sëmurë dhe të dokumentacionit nga ana e personelit mjekësor në bazë, duke shqyrtuar të dhënat mjekësore dhe dosjet përkatëse ligjore (avokat-klient shënime dhe përmbledhjet, dhe opinione ligjore të ekspertëve mjekësor). Përfundimet në këto nëntë raste nga baza tregojnë se mjekët dhe personeli i shëndetit mendor të caktuar në DoD kishin neglizhuar të dëshmonin dhe/ose kishin fshehur të dhënat mjekësore të dëmtimit në mënyrë të qëllimshme dhe të paraburgosurit u ankuar për “metodat e marrjes në pyetje abuzive që janë në përputhje me tortura, siç përcaktohet nga Konventa e OKB-së Kundër Torturës si kohë dhe si përkufizim më restriktiv amerikan të torturës që ishte operacionale në atë kohë”.

⁸ Grupi mjekësor për të Drejtat e Njeriut ka deklaruar se profesionistët shëndetësorë ishin pjesëmarrës aktivë në zhvillimin dhe zbatimin e seancave të pyetjeve dhe kishin monitoruar të burgosurit në efektivitetin e metodave të përdorura, një shkelje e mundshme e Kodit të Nurembergut, i cili ndalon eksperimentimin njerëzor ndaj të burgosurve.

⁹ Zoti Steyn, e quajti atë “një dështim monstruoze të drejtësisë”, sepse “...Ushtria do të veprojë si hetuesit, prokurorët dhe gjykatësit, mbrojtësi dhe, kur dënimet me vdekje janë imponuar, si ekzekutorë, pa gjyqet, pa asnjë garanci, pa asnjë të drejtë private e pa nevojën e respektimit të një gjykimi të drejtë”.

atyre qasje, në provat e përdorura kundër tyre. Të burgosurit kanë qenë të emërtuar “ilegalë” ose “luftëtarët armiq të paligjshëm”, por vëzhguesi si ata të Qendrës për të Drejtat Kushtetuese dhe të “Human Rights Watch”, thonë se Shtetet e Bashkuara nuk e kanë mbajtur parasysh nenin 5, kërkuar gjykatave nga konventat e Gjenevës.

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq ka deklaruar se: “Çdo person në duart e armikut, duhet të ketë një status sipas të drejtës ndërkombëtare: ai është ose një i burgosur i luftës dhe si i tillë, i mbuluar nga Konventa e Tretë, një civil i mbuluar nga Konventa e Katërt, ose një anëtar i personelit mjekësor të forcave të armatosura, që mbulohen nga Konventa e Parë nuk ka asnjë status të ndërmjetëm, ... askush nuk mund të bjerë në duart e armikut jashtë ligjit.” Henry King, një prokuror për gjyqet e Nurembergut, ka argumentuar se lloji i gjykatave në Guantanamo Bay “shkel parimet Nurembergut” dhe se ata janë kundër “frymës së Konventave të Gjenevës të vitit 1949”. Është e patolerueshme që të shkelen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në ditët e sotme, kur pretendohet se demokracia civile ka arritur kulmin e zhvillimit të saj. Për më tepër, kur këto dhunime të së drejtave, kanë ndodhur nga djepi i demokracisë botërore, demokracisë amerikane. Nëpërmjet ngjarjeve që kanë ndodhur dhe vazhdojnë të ndodhin, pasi akoma nuk është mbyllur burgu i Guatanamos, ne u përpoqëm të japim edhe panoramën e kuadrit ligjor ndërkombëtar, që me Konventat e Gjenevës 1949 e deri më sot, me vendimet aktuale të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila shprehet në kundërshtim me vendimet e gjykatave britanike, të cilat, informacionet e nxjerra nëpërmjet torturës, i pranojnë në gjykatat kombëtare. Dëshmitë e tërhequra në këtë mënyrë, ashtu siç përcaktuam edhe më lart, janë kategorikisht të ndaluara nga të gjitha aktet ndërkombëtare.

Përkufizimi i plotë i termit “torturë” jepet nga Konventa¹⁰ Kundër Torturës dhe Dënimeve ose Trajtimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese, sipas nenit 1 të saj: *“Çdo veprim me anë të së cilit një personi i shkaktohen me dashje, dhimbje ose vuajtje të rënda fizike, ose mendore, me synimin për të marrë prej tij ose prej një tjetri, informata ose pohime, për ta ndëshkuar për një veprim që ka kryer ose dyshohet se e ka kryer, për ta frikësuar atë ose për t’i bërë presion mbi një person tjetër ose, për çdo motiv tjetër; kur një dhimbje ose vuajtje e tillë, është shkaktuar nga një person zyrtar ose nga një person tjetër, që vepron me titull zyrtar, me nxitjen e tij ose, me miratimin e tij të shprehur ose të heshtur.”*

Sipas këtij përkufizimi, nuk përfshihen dhimbjet ose vuajtjet që janë pasojë e sanksioneve të ligjshme dhe që janë pjesë e pandarë e këtyre sanksioneve ose që janë shkaktuar prej tyre. Konventa ka përcaktuar një ndalim absolut të torturës, duke parashikuar dhe duke mos përjashtuar asnjë lloj rrethane, madje edhe në rrethana të jashtëzakonshme përdorimin e saj. Ky është standardi ndërkombëtar për ndalimin e torturës dhe akteve të tjera çnjerëzore, por ajo që konstatohet nga “Komiteti Kundër Torturës” që mbikëqyr zbatimin e konventës nga shtetet anëtare, për monitorimin e torturës kudo në botë është e kundërta. Veçanërisht, për Shqipërinë, nga ana e këtij komiteti janë bërë vlerësimet më negative. Raportet e këtij komiteti shprehin shqetësimin e tyre se në institucionet e zbatimit të ligjit dhe kryesisht, në institucionin e paraburgimit dhe atë të vuajtjes së dënimit, nga punonjësit e policisë ushtrohet jashtëzakonisht dhunë

¹⁰ Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me Rezolutën 39/46 të 10 Dhjetorit 1984. Kjo Konventë është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 7727, date 30.06.1993 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën Kundër Torturës dhe Vuajtjeve të Tjera ose Trajtimeve Mizore, Jonjerëzore a Degraduese”.

dhe tortura çnjerëzore. Megjithëse, Shqipëria e ka ratifikuar këtë konventë që prej vitit 1993, duke e bërë atë pjesë të legjislacionit të brendshëm, tortura dhe dhuna është e pranishme në institucionet tona të zbatimit të ligjit. Torturën nuk mund ta justifikojë asnjë situatë tjetër lehtësuese; atë nuk mund ta justifikojë, as një urdhër, i një autoriteti publik. Kështu, mund të përmendim vendimin e GJEDNJ,¹¹ në çështjen “Dybeku kundër Shqipërisë”, e cila vlerësoi se: “*Natyra, kohëzgjatja e vuajtja e dënimit sa i takon keqtrajtimit të së cilit ankuesi i ishte nënshtruar, si dhe efektet që ka pasur në tërësi mbi gjendjen e tij shëndetësore, janë të mjaftueshme për t’u kualifikuar si çnjerëzore dhe degraduese*”.

Gjithashtu, një ndalim absolut ndaj torturës dhe akteve të tjera çnjerëzore dhe degraduese është parashikuar edhe nga Konventa Evropiane¹² sipas nenit 2 të saj. Por, pavarësisht edhe këtyre parashikimeve të cilat janë bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm kombëtar, në Shqipëri, institucionet shtetërore vazhdojnë të dështojnë në zbatimin e kësaj dispozite, e cila sanksionon një ndalim absolut. Me vendimin¹³ e GJEDNJ “Groni kundër Shqipërisë”, Gjykata ka përcaktuar se me veprimet e tyre institucionet shqiptare i kanë shkaktuar vuajtje fizike, që kanë çuar në trajtimin degradues të parashikuar nga neni 3 i KEDNJ. Kështu, mund të sjellim në vëmendjen tuaj, ngjarjet e 21 janarit të vitit 2011¹⁴, në të cilën jo vetëm u keqtrajtuat një numër i madh individësh, por në këtë paqëndrueshmëri politike iu mor jeta edhe katër personave pjesëmarrës në ngjarje.

Njëkohësisht, sipas këtyre akteve ndërkombëtare, përcaktohet si detyrim për shtetet anëtare që të marrin masat ligjore dhe institucionale, për të garantuar në mënyrë efektive, ruajtjen e dinjitetit njerëzor dhe integritetin fizik të njeriut. Lidhur ngushtë me ndalimin e torturës, është edhe e drejta për rehabilitimin e viktimave. Konventa, në nenin 39 të saj, u garanton viktimave të drejtën e rehabilitimit nga tortura dhe keqtrajtimet, ose aktet e tjera çnjerëzore dhe keqtrajtuese. Konventa ka përcaktuar si detyrim ligjor për shtetet anëtare, që të garantojnë në mënyrë efektive rehabilitimin e viktimave madje, të ndëshkojnë edhe përdoruesit e torturës. Kështu, shtetet duhet të marrin masat ligjore dhe masa të tjera të nevojshme për të siguruar rehabilitimin e viktimave. Konventa përcakton që “riaftësimi dhe riintegrimi, të bëhen në kushtet e një mjedisi që ndihmon shëndetin, personalitetin dhe dinjitetin e viktimave”.

3. Parimi i ligjshmërisë

Parimi kryesor i së drejtës penale, është parimi i ligjshmërisë. Parimi i ligjshmërisë është parim universal i së drejtës së brendshme kombëtare dhe i së drejtës ndërkombëtare penale. Parimi i ligjshmërisë duke qenë universal, aplikohet në të gjitha fushat e së drejtës, duke filluar me të drejtën kushtetuese. Veçanërisht, zbatimi i këtij parimi, merr një rëndësi të jashtëzakonshme në të drejtën penale, pasi abuzimet dhe arbitrariteti i institucioneve të zbatimit të ligjit, mund të shkaktojnë cenimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit. Parimi i ligjshmërisë: “*Nullum crimen nulla poena sine lege*” nuk

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

¹¹ Aplikimi nr. 41153/06, datë 18 dhjetor 2007, çështja “Dybeku kundër Shqipërisë”.

¹² Neni 2: “1. Çdo shtet merr masa administrative, legjislative, gjyqësore dhe masa të tjera të efektshme për të ndaluar që në çdo territor që është në juridiksionin e tij të kryhen veprime torture”.

2. Asnjë rrethanë e jashtëzakonshme e çfarëdolloji, si gjendja e luftës apo rreziku i luftës, paqëndrueshmëria politike e brendshme ose çdo gjendje tjetër e jashtëzakonshme, nuk mund të shërbejë si justifikim për torturën”

¹³ Aplikimi nr. 25336/04, datë 7 korrik 2009.

¹⁴ Referuar medias së shkruar dhe audiovizive në këtë kohë.

ka vepër penale, nuk ka dënim; pa ligj, është postulati që ka udhëhequr drejtësinë penale që në kohën e romakëve të lashtë. Ky proklamim, është një përcaktim kushtetues sipas të cilit askush nuk mund të dënohet për një vepër e cila para se të kryhej nuk ka qenë e parashikuar me ligj si vepër penale dhe për të cilën, nuk është përcaktuar një dënim. Të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit, gjykatat, prokuroria, etj., duhet të zbatojnë kushtetutën dhe ligjet që përbëjnë korpusin e së drejtës, në një shtet ligjor. Parimi i ligjshmërisë, ka rëndësi që të bëjë përcaktimin themelor të së drejtës penale si e drejtë e bazuar në ligj. Ligji është njëkohësisht garant për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe mbrojtjes nga çdo autokraci apo keqpërdorim i pushtetit. E drejta penale, është një e drejtë ligjore, pasi ajo përfshin kufizimet më të mëdha të së drejtave dhe lirive themelore të njeriut, madje edhe të drejtën më sublime, atë të jetës. Pra, ligji është burimi themelor i së drejtës penale.

Parimi i ligjshmërisë, parashikohet në të gjitha aktet ndërkombëtare që parashikojnë të drejtat civile dhe liritë themelore të njeriut. Ky parim sanksionohet nga dokumenti *Magna Charta Libertatum*, e vitit 1215, “Bill of Rights” e vitit 1689, deri në pranimin e rëndësisë së tij si garanci për sigurinë juridike, barazinë e të gjithë qytetarëve dhe kufizimin e së drejtës shtetërore për ndëshkim me Deklaratën e të Drejtave të Njeriut në Amerikë, në vitin 1787 e Deklaratën Franceze për të Drejtat e Njeriut në vitin 1789. Parimi i ligjshmërisë, përbën një standard ndërkombëtar, i cili parashikohet edhe në shumë dokumente për të drejtat e njeriut, si: Karta e OKB-së, e vitit 1945; Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, e vitit 1948 (neni 11); Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat e Civile dhe Politike, e vitit 1966 (neni 15); Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut, e vitit 1969 (neni 9); Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e vitit 1950 (neni 7). Evolucioni i konceptit universal i të drejtave të njeriut dhe zhvillimi i së drejtës ndërkombëtare penale, kontribuuan që përmbajtja e këtij parimi të inkadrojë edhe një dimension supranacional.

Sipas të drejtës ndërkombëtare penale, si vepër penale mund të konsiderohet edhe vepra që është parashikuar nga parimet e përgjithshme juridike të së drejtës penale ndërkombëtare. Përmbajtja e parimit të ligjshmërisë, përmban në radhë të parë dy kërkesa themelore: përcaktimin e figurës së veprës penale pra, vendosjen e përshkrimeve të qarta të veprave penale sipas parimit *nullum crimen sine lege certa* dhe ndalimin e veprimit prapaveprues të ligjit, sipas parimit *nulum crimen sine lege praevia*.

Organet shtetërore që ushtrojnë zbulimin, ndjekjen, gjykimin dhe ekzekutimin e sanksioneve penale si policia, prokuroria, gjykatat dhe institucionet për vuajtjen e dënimit, kanë detyrim ligjor zbatimin e ligjit. Kështu, ndalohet zbatimi i ligjit me analogji, përjashtohet zbatimi i praktikës gjyqësore, etj. Moszbatimi i ligjit për shtete të ndryshme është ndëshkuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. Kështu, i tillë është rasti i Serbisë, shtet në të cilin pati dhunime të thella të moszbatimit të ligjit dhe konsumimit të disa prej figurave më të rënda të krimit të njohura nga e drejta ndërkombëtare penale. Pra, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka miratuar aplikimin e sanksionve ndaj shtetit të Serbisë si vendosjen e embargove në fusha të ndryshme të zhvillimit ekonomik. Padyshim që përveç ligjvënësit, organeve shtetërore, parimi i ligjshmërisë i drejtohet edhe vetë qytetarit. Detyra për respektimin e lirive dhe të drejtave, është pjesë përbërëse e të drejtave dhe lirive të njeriut. Çdo qytetar është i detyruar të respektojë të drejtat dhe liritë e barabarta të qytetarëve të tjerë.

4. Prezumimi i pafajësisë

Prezumimi i pafajësisë, është i lidhur ngushtë me lirinë dhe sigurinë personale të individit. Ky parim është parashikuar nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Natyrisht që parimi i prezumimit të pafajësisë, i ka fillesat e tij që prej Mesjetës, me dokumentin *Magna Charta Libertatum*, si pjesë e së drejtës *common law* - e deri në ditët e sotme, ky parim rregullohet nga të gjitha aktet e së drejtës ndërkombëtare penale. Prezumimi i pafajësisë, i referohet shprehjes latine *Ei incumbit probatio qui dicit, non qui negat*, e cila do të thotë: “Barra e provës bie mbi atë që akuzon, jo mbi atë që e mohon”. Parimi i prezumimit të pafajësisë konsiston në faktin se personi konsiderohet i pafajshëm derisa të provohet fajtor. Aplikimi i këtij parimi është një e drejtë ligjore e të akuzuarit në një gjykim penal, i njohur në shumë vende. Barra e provës është kështu mbi prokurorin që ushtron ndjekjen penale, i cili ka për të mbledhur dhe paraqitur përpara gjykatës prova të mjaftueshme bindëse, të vërteta. Prokurori i kërkon gjykatës, se i është përmbajtur ligjit dhe, i kërkon të marrin në konsideratë vetëm dëshmi aktuale dhe dëshminë që është marrë në mënyrë të ligjshme, e pranueshme nga gjykata dhe në shumicën e rasteve, mbi bazën e provave të marra në mënyrë të ligjshme, provon se i akuzuari, është fajtor përtej dyshimit të arsyeshëm. Nëse dyshimi mbetet, i akuzuari duhet të lirohet ose të deklarohet i pafajshëm.

Postulati i këtij parimi, shprehet shpesh në fraza të tilla: “të pafajshëm derisa të shpallet fajtor”, e përdorur më së shumti dhe e shpikur nga Garrow.¹⁵ Ai këmbënguli se akuzuesit, duhet të testohen fuqishëm në gjykatë. Një vëzhgues objektiv, në pozitën e arsyeshme të një anëtari jurie, duhet të arrijë në përfundimin, se i pandehuri pothuajse me siguri, e ka kryer krimin. Për të siguruar këtë mbrojtje ligjore, duhet mbajtur parasysh një grup prej tre rregullave të lidhura me njëra-tjetrën, që do të udhëheqin procedurën e gjykimeve penale. Prezumim i pafajësisë do të thotë:

1. Për sa i përket fakteve kritike të çështjes gjyqësore - nëse krimi për të cilin është paraqitur akuza, është kryer dhe nëse i pandehuri ishte personi që ka kryer krimin, prokuroria ka gjithë barrën e provës.

2. Për sa i përket fakteve kritike të çështjes, i pandehuri nuk ka ndonjë barrë prove. I pandehuri nuk duhet të dëshmojë, të thërrasë dëshmitarë ose të paraqesë ose ndonjë provë tjetër dhe në qoftë se i pandehuri nuk zgjedh të dëshmojë ose të paraqesë prova, ky vendim nuk mund të përdoret kundër tij.

3. Juria ose gjykatësi, nuk duhet të nxjerrin ndonjë përfundim negativ nga fakti se pandehuri ka qenë i akuzuar për një krim dhe se është i pranishëm në gjykatë e se është i përfaqësuar nga një avokat. Ata duhet të vendosin për çështjen, vetëm mbi provat e paraqitura gjatë gjykimit.

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Njeriut të Këshillit të Evropës, thotë (neni 6.2): “Çdo person i akuzuar për një veprë penale, prezumohet i pafajshëm deri sa të vërtetohet fajësia në bazë të ligjit”. Kjo konventë është miratuar nga traktati dhe është e detyrueshme për të gjithë anëtarët e Këshillit të Evropës. Aktualisht (dhe në çdo zgjerim të parashikueshëm të BE-së), çdo vend anëtar i Bashkimit Evropian është edhe anëtar i Këshillit të Evropës, kështu që kjo qëndron për

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

¹⁵ Moore, Christopher (1997). *The Law Society of Upper Canada and Ontario's lawyers, 1797-1997*, University of Toronto Press. Sir William Garrow avokat anglez (1760-1840).

anëtarët e BE-së, si një gjë e natyrshme. Megjithatë, ky pohim është përsëritur tekstualisht në nenin 48 të Kartës¹⁶ së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Në Francë, neni 9 i Deklaratës së të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit 1789, e cila ka fuqi si ligj kushtetues, fillon kështu: “Çdo njeri konsiderohet i pafajshëm derisa ai nuk ka qenë i shpallur fajtor ...”. Kodi i Procedurës Penale, Francez¹⁷ përcakton në nenin paraprak (13), se: “çdo person i dyshuar ose që ndiqet, është i pafajshëm për aq kohë sa fajësia e tyre nuk ka qenë shpallur” dhe, në betimin e anëtarëve të jurisë, e përsërit këtë pohim (neni 304). Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, neni 11, thotë se: “Çdo person i akuzuar për një vepër penale, ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm deri sa të vërtetohet fajësia, në bazë të ligjit dhe në një proces publik, në të cilin ai ka pasur të gjitha garancitë e duhura për mbrojtjen e tij.”

Aktivistë të së drejtave civile,¹⁸ theksojnë se praktikat e miratuara dhe të mirëkuptuara, mund të kenë një efekt të dëmshëm në drejtësi. Një shembull, vjen nga përdorimi i një ekrani në raste të sulmeve seksuale, i cili është ngritur për të parandaluar ankuesin, nga të qenit të shqetësuar në sytë e të akuzuarit. Në këtë rast, viktimja ishte në fakt viktimizuar nga i akuzuari, kjo mund të argumentohet për t’i shërbyer parimeve të drejtësisë terapeutike. Pasi, viktimja është e traumatizuar dhe përballja me të akuzuarin mund t’i shkaktojë një traumë më të rëndë. Megjithatë, kur një i akuzuar është i pafajshëm, ky mund pa dashje t’i tregojë jurisë që, gjykata pranon se një krim është kryer. Kjo mund të ndërrojë barrën e provës tradicionalisht nga akuza tek mbrojtja, dhe rrezikon të vërë gjykatën në rolin jurisë duke e gjykuar fajtor.

Edhe më e rëndësishmja, një mburojë gjithashtu mund të dërgojë një mesazh se ankuesi është i mërziur nga sytë e të akuzuarit edhe një herë, sepse faji është parë të ketë qenë marrë nga gjykata, si një mënyrë për të mbrojtur ankuesin. Efektet psikologjike të një ekrani të tillë ende nuk janë hulumtuar mirë, por tensioni mes dy pikëpamjeve është një problem për drejtësinë, të cilat duhet të peshojnë mbrojtjen e viktimave nga shkelësit e vërtetë kundër potencialit për një bindje të padrejtë që një mbrojtje e tillë mund të krijojë. Jo rastësisht e sollëm këtë pikëpamje të aktivistëve të së drejtave civile, pasi mbrojtja e dëshmitarëve dhe sidomos e bashkëpunëtorëve të drejtësisë është kundërshtuar nga këta aktivistë. Në të gjitha këto akte sanksionohet standardi ndërkombëtar i prezumimit të pafajësisë, sipas të cilit kushdo konsiderohet i pafajshëm përderisa nuk është provuar fajësia e tij me vendim të formës së prerë. Pra, vetëm gjykata është institucioni që mund të vendosë mbi fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit. Është gjykata, që vendos për masat paraprake të sigurimit, që kanë të bëjnë me vendosjen e kufizimeve të lirisë personale. Pra, derisa i pandehuri nuk është shpallur i fajshëm nga një vendim gjykate i formës së prerë, ai konsiderohet i pafajshëm.

5. Konkluzione dhe rekomandime

Dispozitat e Kodit Penal janë të pamjaftueshme për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë. Kanosja është parashikuar nga KP, por, një vepër e tillë, ka karakter të përgjithshëm dhe personi i dëmtuar mund të jetë kushdo. Nëse përcaktohet si rrethanë rënduese, kanosja ndaj dëshmitarit ose bashkëpunëtorit të drejtësisë,

¹⁶ Neni 48, *Prezumimi i pafajësisë dhe e drejta e mbrojtjes*: “1. Çdo njeri që është akuzuar për një krim është i pafajshëm derisa të provohet fajësia e tij sipas ligjit”.

¹⁷ *Code de procédure pénale*, article 304. Kodi i Procedurës Penale Francez.

¹⁸ *Innocenceproject.org*, publikuar, 13.10.2010.

mendojmë se do të sigurohet një mbrojtje akoma më e madhe për dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë. Pra, mendojmë që Kodi Penal duhet të përmirësohet në këtë drejtim, duke parashikuar si rrethanë rënduese, kanosjen ndaj dëshmitarit të drejtësisë. Një përcaktim i tillë, është bërë nga Kodi Penal i Kosovës.

- Detyrimi pozitiv i shtetit për mbrojtjen e së drejtës, për të mos qenë subjekt i trajtimit çnjerëzor ose degradues, gjatë dhënies së dëshmisë.¹⁹

Sipas nenit 86, të Kodit Penal, ndalimi i torturës është absolut. Një problem tjetër që lidhet me këtë dispozitë është edhe përcaktimi që i është bërë kësaj dispozite me ndryshimet e vitit 2007, me të cilin, ngushtohet rrethi i personave që kryejnë këtë veprë penale, në krahasim me dispozitën e mëparshme, duke parashikuar vetëm personat që ushtrojnë funksione publike.

Kjo dispozitë, e formuluar në këtë mënyrë, përjashton personat që mund të kryejnë veprën e torturës ndaj dëshmitarit të drejtësisë dhe jo vetëm, por ndaj çdo personi tjetër – pra, personat që nuk ushtrojnë funksione publike. Zakonisht, në rastin e studimit tonë, personat që ushtrojnë torturën ndaj dëshmitarëve, mund të jenë edhe kriminelë të një organizate kriminale.

Ky formulim, i përjashton këta persona nga kryerja e veprës penale. Për më tepër, Konventa e OKB-së kundër Torturës, Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës, madje edhe Kushtetuta jonë, nuk e kufizojnë subjektin e kësaj vepre penale vetëm në një subjekt të posaçëm, pra siç është parashikuar nga neni 86 i KP, por edhe nga një subjekt i përgjithshëm, që do të thotë se rrethi i subjekteve të kësaj vepre penale, është i përgjithshëm - asnjëri nuk përjashtohet prej saj. Në këtë mënyrë, mendojmë se formulimi i nenit 86 është në kundërshtim me aktet ndërkombëtare dhe me Kushtetutën e për këtë arsye, duhet të riformulohet.

Në Kodin Penal, vërtet janë bërë ndryshime në kuadrin e mbrojtjes së dëshmitarëve, por mendojmë që dispozitat janë të përgjithshme dhe duhet të detajohen e të përmirësohen, jo vetëm në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve, por edhe me sigurimin e interesave të shtetit në dhënien e drejtësisë.

Kështu, KP përcakton uljen e dënimit në përgjithësi për bashkëpunëtorët e drejtësisë, duke parashikuar për dënimin me burg të përjetshëm, dënim me 30 vjet dhe 1/3 e 1/2 e dënimit të parashikuar për vepra të ndryshme. Madje KP, shkon edhe më tej, duke parashikuar edhe përjashtim nga dënimi për raste të veçanta.

Një dispozitë e tillë në KP, është e interpretueshme dhe lë shteg për keqinterpretime nga ana e gjyqtarëve. Nisur nga kuadri ligjor, veçanërisht Kodi Penal Italian - parashikon ulje të përcaktuara qartë për çdo veprë penale, për bashkëpunëtorin e drejtësisë. Edhe KP i Kosovës parashikon dispozita të veçanta për uljen e dënimit në masa të caktuara për bashkëpunëtorët e drejtësisë. Por, duhet të theksojmë faktin se, sipas legjislacioneve të shteteve të huaja, asnjë prej tyre nuk parashikon përjashtim nga dënimi penal. Në çdo

¹ Sipas nenit 2 të, Konventës Evropiane të së Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

rast, ata parashikojnë sipas veprave penale, ulje të caktuar të dënimit, për bashkëpunëtorët e drejtësisë.

Rekomandim

Përmirësimi i nenit 86 të Kodit Penal, për kanosjen, duke përfshirë edhe kanosjen ndaj dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë ose viktimave të veprave penale si rrethanë rënduese të dënimit. Ndryshimi i nenit, duke parashikuar subjekt të kryerjes së kësaj vepre penale jo vetëm funksionarët publikë, por një subjekt të përgjithshëm, pra çdo individ mund të kryejë veprën penale të torturës. Në mënyrë që kjo dispozitë të jetë në përputhje me vetë Kushtetutën e më pas me aktet ndërkombëtare të ratifikuara.

Bibliografia

1. Kontrata Evropiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.
2. *Konventa e Gjenevës*, "Për mbrojtjen e të plagosurve dhe të sëmurëve gjatë kohës së luftës", 1864; *Konventat e Hagës*, në 1899 dhe 1907.
3. Abour, Louise. "Crime against Women under International Law", *Berkeley Journal of International Law*, 21, (2003).
4. Schneider, Peter dhe Jane Schneider. "Giovanni Falcone, Paolo Borsellino the Procura of Palermo", 2002. Schneider, Jane dhe Peter Schneider. "Chapter Six", *Reversible Destiny: Mafia, Antimafia and the Struggle for Palermo*. Berkeley: University of California Press.
5. "Italy Slicing Up the Beast", *Time Magazine*, February 24, 1986.
6. "Raport i zyrës së Kombeve të Bashkuara mbi drogat dhe krimin" në, *Konferenca: Reagimi ndaj trafikimit të qenieve njerëzore*. Hagë, Hollandë: 2009.
7. "Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar".
8. Guidë Legjislative për Konventën.
9. "Praktikat më të mira për mbrojtjen e dëshmitarëve në procedimin penal të krimit të organizuar".
10. "Mbi Mbrojtjen e Dëshmitarëve në Luftë kundër Krimit të Organizuar". *Rezoluta e Këshillit Evropian*, 23 nëntor 1995.
11. "Mbi individët që bashkëpunojnë në procesin gjyqësor në luftën kundër krimit të organizuar". *Rezoluta e Këshillit Evropian*, 20 dhjetori 1996.
12. Ligjit i vitit 1970, "Për kontrollin kundër krimit të organizuar", Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
13. Robinson, Mike, "Deputy US marshal guilty of leaking secrets to mob", (29 prill, 2009).
14. Glaberson, William. "Lie or Die" - Aftermath of a Murder; Justice, Safety and the System: A Witness Is Slain in Brooklyn". *The New York Times*, July 13, 2011;
15. "California Witness Relocation and Protection Program".
16. Rekomandimi (97) 13, në lidhje me "Kërcënimin e dëshmitarëve dhe të drejtat e mbrojtjes".
17. Rekomandimi (2001) 11, lidhur me "Parimet udhëzuese në luftën kundër krimit të organizuar".
18. Rekomandimi (2005) 9, i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare mbi Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë;
19. Wiviano, F. *The empire of Crime Bruksel*, 1995.

Riintegrimi i viktimave të trafikimit dhe impakti në siguri

Rasti i vajzave dhe grave të trafikuar në Shqipëri

Msc Silena TOLA

Ministria e Punëve të Brendshme

silenatola@gmail.com

Abstrakt

Ky punim synon të trajtojë një aspekt të rëndësishëm të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, atë të riintegrit të vajzave dhe grave, viktimave të trafikimit. Riintegrimi është një proces kompleks dhe afatgjatë me efekt riparues dhe parandalues gjithashtu. Efekt riparues pasi qëllimi kryesor i tij është që viktimave të trafikimit të arrijë të riintegrohet në shoqëri, të jetojë një jetë të sigurt dhe ta pavarur duke hedhur pas të shkuarën. Ka efekt parandalues pasi riintegrimi i viktimave të trafikimit është një kontribut i drejtpërdrejtë në shmangien e mundësisë së rritjes së trafikimit por edhe të kriminalizimit të tyre duke ndikuar kështu jo vetëm në sigurinë e tyre por dhe më gjerë. Në këtë drejtim i rëndësishëm është edukimi i viktimës si një e drejtë që i është mohuar dhe njëkohësisht si një investim që mund të ndikojë në një qasje më të mirë të saj ndaj procesit të riintegrit. Qëllimi i studimit është evidentimi i mekanizmave ligjore dhe institucional ekzistues, që bëjnë të mundur ofrimin e shërbimeve të riintegrit për viktimave të trafikimit në Shqipëri dhe analizimi i tyre për të kuptuar nëse janë efektive sa duhet për të arritur rezultate të suksesshme. Përmes përdorimit të metodologjisë cilësore si metodat përshkruese, analizuese, krahasuese dhe intervistuese synohet të identifikohen procedurat ekzistuese dhe të analizohet efektiviteti i tyre. Duke analizuar si kuadrin ligjor ashtu dhe atë institucional në fushën e trafikimit të personave, shihet rëndësia e përafrimit të legjislativimit të brendshëm me të drejtën ndërkombëtare si një hap i rëndësishëm që çon në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, forcimin e luftës ndaj tij dhe në të njëjtën kohë ndikon edhe në përmirësimin e sistemit të identifikimit, mbrojtjes dhe riintegrit të viktimave të trafikimit. Por nga ana tjetër vihet re një mangësi në zbatimin praktik të dispozitave ligjore që parashikojnë mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të viktimave në disa drejtime. Në përfundim të punimit tim, konkludoj se është punuar dhe me rezultate konkrete për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, por ende ka punë për t'u bërë dhe progres për tu arritur.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit»

Fjalëkyçe:

trafikimi i qenieve njerëzore, mbrojtja e viktimave, riintegrim, siguria e viktimave të trafikuar.

1. Hyrje

Shqipëria është një vend që me hapat pozitivë të hedhur për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me të drejtën ndërkombëtare dhe zbatimin praktik të tij, është bërë palë në luftën kundër krimit të organizuar transnacional e veçanërisht, ndaj trafikimit të personave. Me ratifikimin e Konventës kundër Krimit të Organizuar Transnacional institucionet e zbatimit të ligjit morën masat për pasqyrimin e saj në legjislacionin e brendshëm dhe ngritjen e strukturave të nevojshme për zbatimin e saj. Në zbatim të kësaj konvente u prezantuan për herë të parë veprat penale në fushën e krimit të organizuar e specifikisht edhe për trafikimin e personave të rritur e atyre të mitur. Përtej përafrimit të legjislacionit penal dhe atij procedural penal me të drejtën ndërkombëtare, u ndje domosdoshmëria për ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve sociale në ndihmë të personave të dëmtuar nga veprat penale, e veçanërisht viktimave të trafikimit që ishin ende një kategori e panjohur dhe paidentifikuar më parë. Trafikimi i personave si vepër penale kërkon një përgjigje të mirëkoordinuar, qoftë nga ana penale, ashtu edhe nga ana sociale, qysh prej identifikimit të viktimave të trafikimit e deri në riintegrimin e tyre. Në këtë drejtim, e drejta e tyre për arsim, si pjesë e shërbimeve të riintegrit, është një aspekt i rëndësishëm që ndikon në shkëputjen përfundimtare të viktimës nga bota e krimit. Orientimi drejt politikave edukuese, ndikon që viktimat e trafikimit të pranojnë më lehtë problemet e tyre, të binden ndaj nevojës për ndihmë dhe ndërhyrje dhe më tej në riintegrim dhe krijimin e pavarësisë. Kjo temë është fokusuar në një prej përgjigjeve ndaj fenomenit, që është riintegrimi i viktimave, një proces ky shpesh i vështirë për një sërë arsyesh që lidhen si me mangësi në parashikimet ligjore ashtu edhe në vështirësi në zbatimin praktik të tyre. Nëpërmjet analizimit të legjislacionit vendas mbi trafikimin e qenieve njerëzore, akteve që lidhen drejtpërdrejt me riintegrimin e viktimave të trafikimit në Shqipëri, funksionimit dhe bashkëveprimit të

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

institucioneve shtetërore e atyre joshtetërore, ky punim përpiqet të nxjerrë në pah mangësitë dhe të rekomandojë zgjidhje për adresimin e tyre. Mendoj se të gjithë aktorët në vend, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e luftës kundër trafikimit të personave duhet të konsiderojnë si pjesë integrale të punës së tyre, identifikimin e viktimave të trafikimit, mbrojtjen dhe riintegrimin e tyre. Këto parime janë të lidhura drejtpërdrejt si me përmirësimin e procesit të ndjekjes penale ashtu edhe të gjykimit të veprave penale të trafikimit të personave e atyre që lidhen me të.

2. Vështrim i shkurtër historik dhe ligjor mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe konceptin e mbrojtjes së viktimave

Përkufizimi i trafikimit të qenieve njerëzore ka evoluar me kohën. Sipas Breilu,¹ në vitin 1880 pati një shqetësim publik për vajzat europiane, kryesisht nga Belgjika, Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar, që trafikoheshin brenda Evropës perëndimore për t'u shfrytëzuar në shtëpi publike, një shqetësim ky i shprehur në konceptin e "skllavërisë së bardhë". Shumë studime nga autorë të ndryshëm, si Kempadoo², Segrave dhe Milivojevic³, i referohen mungesës së vullnetit të vajzave për ushtrimin e prostitucionit. Termit "skllavëri e bardhë" i janë dhënë shumë kuptime, por përkufizimin më të përdorur e ka si element kryesor që identifikon mënyrat e shfrytëzimit nëpërmjet përdorimit të substancave narkotike, për të detyruar një femër të bardhë të ushtrojë prostitucion kundër vullnetit të saj.⁴ Lëvizja kundër skllavërimit të bardhë i kombinoi aspiratat e lëvizjes kombëtare kundër prostitucionit me lëvizjen kundër skllavërimit. Emigrimi i shtuar i femrave nga Europa, që kërkonin punë jashtë kufijve të saj ishte një arsye për të vënë në lëvizje shtetet në mbarë botën. Tregtia e femrave, ishte një fenomen i njohur në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX. Një investigim mbi "Importimin dhe shfrytëzimin e femrës për qëllime imorale" në SHBA në vitet 1908-1909 tregoi se një numër i madh vajzash dhe grash silleshin në vend për të shfrytëzuar për qëllime prostitucioni.⁵

Deri në shpërthimin e Luftës së Parë Botërore pati një përpjekje mbarëkombëtare dhe një sërë konferencash u organizuan në Europë dhe SHBA, me fokus luftën kundër skllavërimit të bardhë, trafikimit të femrave dhe emigrimit si një fenomen që ushqente trafikimin⁶. Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore ndodh një kthesë e madhe në terminologjinë e përdorur, duke u shkëputur nga termi i skllavërimit të bardhë, si një term jo gjithëpërfshirës dhe duke e zëvendësuar atë me trafikimin e femrës. Ky ndryshim tregon dhe për një shtrirje ndërkombëtare të problemit, tashmë jo vetëm i Evropës.⁷

¹ Breuil, B.C.O., Siegel, D., van Reenen, P. et al. Trends Organ Crim (2011).

² Kempadoo K (2005), *Trafficking and prostitution reconsidered: new perspectives on migration, sex work and human rights*. Paradigm Publishers, Boulder.

³ Segrave M, Milivojevic S, Pickering S, *Sex trafficking. International context and response*. Willan Publishing, Devon, 2009.

⁴ Victor Malarek, *The Natashas: Inside the New Global Sex Trade* (Paperback), 1905

⁵ Benjamin Skinner, *A Crime So Monstrous: Face-to-Face with Modern-Day Slavery* (Hardcover), 2008.

⁶ Në 1904 një marrëveshje Ndërkombëtare për Luftën kundër Trafikut të Skllavërimit të Bardhë u nënshkrua në Paris me qëllim mbrojtjen e grave dhe vajzave nga krimi i trafikimit dhe në vitin 1910, 13 shtete nënshkruan Konventën Ndërkombëtare Kundër Tregtisë së Skllavërimit të Bardhë.

Pas nënshkrimit të këtyre dy Konventave shumë vende të Evropës nisën të shkëmbenin informacion ndërmjet tyre duke u përfshirë në një punë parandaluese dhe mbrojtëse. U krijua një bazë për diskutim ndërkombëtar të trafikimit të bardhë që u ndërpre me fillimit e Luftës së Parë Botërore.

⁷ Victor Malarek, *The Natashas: Inside the New Global Sex Trade* (Paperback), 1905

Këto përpjekje, sollën hartimin e Konventës Kundër Trafikimit të Femrave dhe Fëmijëve të nënshkruar nga 33 shtete në vitin 1921 në Gjenevë. Për herë të parë në fokus të një instrumenti ligjor vendoset nevoja për asistencë të viktimave dhe kërkohet nga shtetet pjesëmarrëse marrje e masave për realizimin e saj. Ndër të tjera kjo Konventë kërkon nga shtetet pjesëmarrëse të marrin masa konkrete për të ndjekur penalisht dhe hetuar personat e përfshirë në trafik.⁸

Një nga dokumentet e radhës, por me një rëndësi ligjore më të madhe për shkak të karakterit detyrues ishte Konventa e OKB për Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Shfrytëzimit të Prostitucionit të së Tjerëve, e cila hyri në fuqi në 1951. Ishte një kthesë me rëndësi ligjore duke qenë se ishte instrumenti i parë ligjor i detyrueshëm.⁹

Pas hyrjes në fuqi të Konventës, janë adoptuar dhe një sërë instrumentesh të tjera jodetyruese me fokus trafikimin e femrave. Sidoqoftë, në zhvillimet e instrumenteve ligjore detyruese, kishte një hendek 51 vjeçar, përpara se të kishim një zhvillim që sjell vëmendjen plotësisht në trafikimin e qenieve njerëzore. Në vitin 2000 u miratua Protokollin i Kombeve të Bashkuara kundër Trafikimit të Personave, i cili hyri në fuqi në vitin 2003.¹⁰ Protokollin përkufizon trafikimin e personave për herë të parë. Është dokumenti i parë ndërkombëtar që adreson trafikimin e qenieve njerëzore si një krim duke përfshirë të gjitha format e shfrytëzimit. Një risi e tij ishte koncepti i tre P-ve: "Prevention, Protection dhe Prosecution", një koncept që "Parandalimin, Mbrojtjen dhe Ndjekjen Penale", i sheh si tre komponentë të domosdoshëm për të luftuar krimin e trafikimit dhe riintegrimi është një proces i lidhur me mbrojtjen dhe parandalimin e trafikimit të personave dhe gjatë punimit të kësaj teze, unë do të mbështes mendimin se viktimat e trafikimit janë potencialisht të rrezikuara për tu ritrafikuar dhe nga ana tjetër, një viktimë e riintegruar ka më pak gjasa të bjerë sërish pre e trafikantëve.

Shqipëria është bërë palë e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, duke dhënë kontributin e saj në përballjen me këtë problem që i kalon kufijtë e një shteti. Në vendin tonë, fenomeni i trafikimit u shfaq pas viteve '90 dhe vëmendja ndaj procesit të riintegritimit të viktimave të trafikimit, nis me ratifikimin e protokollit shtesë të konventës së OKB, për të vazhduar më tej me Konventën e Këshillit të Evropës dhe dokumentove të tjera ndërkombëtare apo të së drejtës së brendshme. Në këto vite është bërë progres i vazhdueshëm në këtë drejtim dhe shpesh, raportet vlerësuese të masave të marra nga

⁸ Konventa gjithashtu sjell në vëmendje nevojën për mbrojtjen gjatë procesit të migrimit si dhe nevojën që femrat dhe fëmijët të informohen për trafikimin. Nevoja për informimin mbi fenomenin tregon për vlerësimin si të domosdoshme të një strategjie që ka të bëjë me parandalimin. Gjithashtu në këtë Konventë inkurajohen shtetet pjesëmarrëse të menaxhojnë njoftimet në stacione hyrëse dhe dalje, kufij dhe porte duke paralajmëruar për rrezikun nga trafikimi dhe njoftuar mbi vendet ku mund të sigurohet akomodim dhe asistencë nga viktimat <http://hankeringforhistory.com/the-history-of-human-trafficking/>.

⁹ *Convention for the Suppression of the Traffic in Persons and of the Exploitation of the Prostitution of Others*, Neni 16 dhe 17: Kjo Konventë, në nenin 16 të saj parashikon për herë të parë detyrimin e shteteve palë të organizojnë aktivitete ndërgjegjësuese dhe të ndërmarrin hapat e nevojshëm për parandalimin e trafikimit me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit si dhe për rehabilitimin e viktimave të prostitucionit dhe veprave të tjera të parashikuara në Konventë. Duke parashikuar përfshirjen e institucioneve publike dhe jopublike të arsimit, shëndetësisë, institucione sociale, ekonomike dhe ato të lidhura me to, kjo Konventë sjell në vëmendje domosdoshmërinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për adresimin e problematikave që hasen në trajtimin e viktimave, nevojën për mbështetjen sociale të tyre si dhe parandalimin e trafikimit. Gjithashtu në nenin 17 kjo Konventë i referohet edhe domosdoshmërisë së rritjes së kapacitetit të strukturave për identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit midis migrantëve që hyjnë në territorin e shtetit palë si dhe bashkëpunimit në funksion të realizimit të këtyre detyrimeve.

¹⁰ *Protokollin Shtesë i Konventës së OKB "Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve"*, 15 nëntor 2000. Gjetend në: https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/antitrafficking/files/undated_nations_protocol_on_thb_en_4.pdf

shtetet, megjithëse evidentojnë problematika dhe caktojnë detyrime të mëtejshme, flasin mirë për punën e bërë në vendin tonë. Megjithatë, mungesa e një ligji organik që do të përmbledhë në një dokument të vetëm luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, përfshi dhe procesin e riintegritit si pjesë të vetën, është një aspekt që ka ardhur koha të ndreqet. Përmbledhja e të gjitha akteve që parashikojnë shërbimet e riintegritit, procedurat në lidhje me të, detyra dhe përgjegjësi për institucione shtetërore dhe funksionimin e strehëzave, në një dokument të vetëm me fuqi detyruese dhe funksionim të qartë të procesit do të sillte rezultate më të mira në këtë drejtim. Dokumentet politike si strategjitë apo parashikime të shpërndara në legjislacionin tonë nuk janë të mjaftueshme për ta bërë këtë luftë efektive sa duhet.

3. Riintegrimi, një proces dimensional dhe afatgjatë

Koncepti i riintegritit nuk është parashikuar në ndonjë marrëveshje ndërkombëtare, por pranohet gjerësisht dhe rrjedh edhe nga studimi i legjislacionit mbi antitrafikimin se ai është një proces afatgjatë i cili në një nga përkufizimet më të përhapura parashikohet si “*procesi i rikuperimit dhe përfshirjes sociale dhe ekonomike pas një përvoje trafikim*”¹¹. Ky është një nga përkufizimet që tashmë i referohen profesionistët në studimet dhe hartimin e planeve për riintegrimin. Sipas Surtees, ky proces është mjaft sfidues dhe përfshin vendosjen në një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm, akses në standard jetese të arsyeshëm, mirëqenie fizike dhe mendore dhe mundësi për zhvillim personal, social dhe ekonomik dhe akses në mbështetje sociale dhe emocionale. Një aspekt qendror i riintegritit të suksesshëm është ai i fuqizimit, mbështetjes së viktimave për të zhvilluar aftësi drejt pavarësisë dhe vetëmjaftueshmërisë dhe për t’u përfshirë në mënyrë aktive në rikuperimin dhe riintegrimin e tyre.¹²

Riintegrimi është një proces shumëdimensional. Nuk është thjeshtë një proces drejt realizimit të së drejtave socio-ekonomike, por është një proces që nuk mund të shihet si pjesë e ndarë e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Në fakt, kjo luftë nuk mund të kuptohet e plotë nëse femrat e trafikuar nuk arrijnë, që në bazë të një sërë masash të marra nga autoritetet shtetërore dhe jo vetëm, të riintegrohen në shoqëri. Riintegrimi është një koncept i lidhur drejtpërdrejtë me luftën kundër trafikimit edhe për shkak të mundësisë së madhe që ekziston që një femër e trafikuar të bjerë pre sërish e krimit të organizuar dhe të ritrafikohet duke u bërë sërish viktimë por njëkohësisht është potencialisht një person që mund të kthehet në një shkelëse të ligjit duke rekrutuar gra dhe vajza për trafikim. Marrja e masave për të arritur riintegrimin do të thotë përpjekje për të shpërbërë rrethin e trafikimit, shfrytëzimit dhe skllavërisë së qenieve njerëzore. Është një proces i sigurimit dhe garantimit të së drejtës për mbrojtje të grave dhe vajzave nga nënshtrimi dhe puna me forcë ose e detyruar. Mbrojtja e këtyre të drejtave themelore të njeriut është përgjegjësi e shtetit, ato janë absolute dhe nuk lejojnë shmangie. Realizimi i riintegritit është i lidhur ngushtësisht me trajtimin e fakteve që kanë çuar në trafikim, përndryshe ekziston rrezik i madh për ritrafikim¹³. Ndiham që i

¹¹ Surtees (2010) *Monitoring Anti trafficking reintegration programs*, fq. 24.

¹² Surtees, R. (2006) *Re/integration programmes in SE Europe*.

¹³ Kështu p.sh. *Konventa Europiane për masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore*, ratifikuar edhe nga Shqipëria, i kërkon shteteve palë marrjen e masave për të ndihmuar viktimat në rikuperimin e tyre fizik, psikologjik dhe social, duke pasur parasysh nevojat e viktimës për siguri dhe mbrojtje. (*Konventa "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore"*, 2005, Seria e traktateve evropiane ETS nr. 197)

jepet viktimës në këto dimensione gjithëpërfshirëse të problematikave që mund të kenë qenë faktor në rrugën e përfshirjes në trafikim, mund të bëjnë të mundur shkëputjen e tyre përfundimisht nga trafikimi.

Riintegrimi i viktimave të trafikuar është një proces i lidhur ngushtësisht me marrjen e masave institucionale nga organe shtetërore. Për këtë arsye është pjesë përbërëse dhe shumë e rëndësishme e programit të punës që çdo qeveri ndërmerr në kuadër të luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore. Të ndihmohet viktimat për ti kthyer ato në jetën normale të shoqërisë është një proces sa i gjatë aq edhe i vështirë; i gjatë sepse duhen vite pune direkt me viktimën që të mund të arrihet përshtatjen e saj në ambientin rrethues ku ajo do të jetojë, i vështirë sepse pasojat që kanë lënë dhuna dhe abuzimi për një kohë të gjatë tek ajo nuk mund të rikuperohen lehtë. Për realizimin e qëllimit të riintegritit punohet mbi një program antitrafik, suksesi i të cilit kërkon që të gjithë aktorët e përfshirë në këtë program të marrin përgjegjësitë e tyre dhe të bëjnë objekt të punës, të gjitha detyrat e përcaktuara në të. Procesi i riintegritit është një proces kompleks dhe gjatë kohëzgjatjes së tij duhet që personat përgjegjës të mbajnë parasysht disa parime të lidhura me të drejtat e njeriut dhe Protokollin e Palermos të Kombeve të Bashkuara. Këto parime duhet të mbahen parasysht gjatë gjithë kohës së dhënies së shërbimeve nga strehëzat dhe nga organet shtetërore përgjegjëse për riintegrimin gjatë hartimit dhe implementimit të planeve të veprimit dhe caktimit të detyrave për gjithsecilin dhe punonjësit e organeve shtetërore gjatë ushtrimit të detyrave të tyre të lidhura me riintegrimin.¹⁴

Një analizë e shkurtër e këtyre parimeve, do nënkuptonte riintegrimin si një proces që në thelb të tij, ka dhënien e ndihmës që viktimat e trafikimit të mund të ushtrojnë të drejtat e njeriut si çdo shtetas tjetër, i lirë dhe i pavarur. Trafikimi i qenieve njerëzore lidhet drejtpërdrejtë me shkeljen e të drejtave të njeriut. Viktimave të trafikimit i mohohen të drejtat themelore të tyre. Riintegrimi synon rivendosjen e të drejtave të viktimës së trafikimit dhe parandalimin e dhunimit të mëtejshëm të tyre.

4. Roli i institucioneve shtetërore në riintegrimin e viktimave të trafikimit

Institucionet shtetërore luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve të riintegritit, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulojnë. Qendrat që ndjekin rastet e viktimave të trafikimit nuk kanë kapacitetet e duhura për të plotësuar të gjitha nevojat e tyre. Kështu, shërbime si asistencë mjekësore, punësimi, arsimimi, ofrimi i kurseve profesionale, strehimit, etj., realizohen në bashkëpunim me institucionet shtetërore që i ofrojnë këto shërbime. Sidoqoftë, në këtë drejtim ka mangësi, që lidhen edhe me kapacitetet e këtyre institucioneve për të bërë të mundur realizimin e sa më sipër. Roli i shtetit përveç sa përmenda më sipër, është edhe koordinues. Kështu, Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik, bën koordinimin e punës së të gjitha institucioneve

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

¹⁴ *Manuali i IOM për Ndihmën e Drejtpërdrejtë për Viktimat e Trafikimit*, 2007: Në vlerësimin tim, edhe pse shumë studime orientojnë dhe rekomandojnë respektimin e tyre, është *Manuali i Ndihmës së Drejtpërdrejtë* që i përcakton ato në mënyrë të përmblodhur dhe gjithëpërfshirëse duke kërkuar nga ofruesit e shërbimeve respektimin e këtyre parimeve: Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut; Pëlqimi i informuar; Mosdiskriminimi; Konfidencialiteti dhe e drejta për intimitet; Trajtimi dhe kujdesi i individualizuar; Vetëvendosja dhe pjesëmarrja; Gama gjithëpërfshirëse e shërbimeve; Interesi më i lartë i fëmijës; Shpërndarja e drejtë e burimeve.

shtetërore me një rol specifik në riintegrimin e viktimave të trafikimit me njëri-tjetrin dhe, qendrave të ofrimit të shërbimeve; adreson problematikat dhe ndërhyrjet për zgjidhjen e tyre dhe nxit marrjen e masave të nevojshme për ta çuar më tutje punën e bërë në këtë aspekt.

4.1 Nga identifikimi të riintegrimi i viktimave të trafikimit; procedurat dhe shërbimet

Riintegrimi është një proces që fillon me identifikimin e viktimës, referimin e rastit në strehëza, vlerësimin paraprak të rastit për të kuptuar historikun e trafikimit dhe nevojat e viktimës, dhënien e asistencës në kuadër të rehabilitimit fillimisht dhe më pas edhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme të riintegrit. Më poshtë janë të analizuara element të këtij procesi të para në një këndvështrim kronologjik me qëllim nxjerrjen në pah të funksionimit të tij.

4.2 Identifikimi i viktimave të trafikimit

Riintegrimi i viktimave të trafikimit është një proces të cilit i paraprin identifikimi dhe referimi i viktimës. Në Shqipëri identifikimi i viktimave të trafikimit parashikohet nga Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të mundshme të trafikimit”. Këto procedura përcaktojnë hapat që institucionet shtetërore dhe joshtetërore ndjekin për të identifikuar, referuar, asistuar dhe riintegruar viktimat e trafikimit.¹⁵

4.3 Vlerësimi i rastit

Vlerësimi i riintegrit është i rëndësishëm për hartimin e planit të riintegrit për secilën viktimë. Ky vlerësim duhet të kryhet nga persona që e njohin më mirë rastin e viktimës, punonjës të organizatës që ofron shërbime. Këta persona duhet të vlerësojnë opsionet e riintegrit, me synimin e riintegrit të suksesshëm dhe rifutjen në shoqëri të çdo viktime bazuar në kritere të përcaktuara.¹⁶ Shpesh Qendrat hasin vështirësi për shkak të mungesës së personelit të nevojshëm. Kohët e fundit përmes një marrëveshjeje me MMRS atyre ju vihen në dispozicion ekspertë në fusha të ndryshme duke ju mbuluar shpenzimet e pagës. Me qëllim që procesi i riintegrit të jetë efektiv dhe të japë rezultatet

¹⁵ VKM nr. 582, datë 27.7.2011 “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të mundshme të trafikimit”.

Konkretisht procedurat përcaktojnë dy forma të identifikimit të viktimave të trafikimit, identifikimin fillestar dhe atë formal. Identifikimi fillestar mund të kryhet nga cilido që dyshon se një person mund të jetë apo ka qenë pre e shfrytëzimit dhe trafikimit dhe identifikimi formal përcaktohet si kompetencë vetëm e Shërbimit Social Shtetëror dhe Policisë së Shtetit. Këto dy institucione janë përgjegjëse për dhënien e statusit Viktimë Trafikimi, pra për kryerjen e identifikimit formal të një viktime të mundshme trafikimi. Përfaqësuesit e këtyre dy institucioneve në çdo Qark kanë detyrimin të marrin vendimin e përbashkët për dhënien e statusit bazuar mbi indikatorët parësor dhe dy dytësor që këto procedurave përmbajnë.

¹⁶ *Manuali i IOM për Ndhimën e Drejtpërdrejtë për Viktimat e Trafikimit*, 2007.

(Në radhë të parë, nevojat e viktimës, të cilat mund të përfshijnë nevoja fizike, psikologjike, psikiatrike, ligjore, sociale dhe ekonomike; Dëshirat e veçanta të viktimës, dëshirat e tij/saj individuale për opsione ose shërbime të veçanta riintegrit, të cilat mund të jenë të mundshme ose jo; Mundësitë që duhet të shfrytëzohen një viktimë kur gjendet në rrethana të veçanta që lidhen, për shembull, me moshën, gjininë, nivelin e arsimit ose përvojën në punë; Niveli i perceptuar i motivimit të viktimës, për shembull nëpërmjet angazhimit dhe rezultateve që lidhen me ndihmën për riintegrim që po i ofrohet dhe/ose rrethanat vetjake.)

e dëshiruara, trajtimi i viktimës duhet të jetë i veçantë dhe i përshtatshëm sipas karakteristikave të saj. Për këtë arsye, personat që merren me trajtimin e rastit duhet të bëjnë një analizë që quhet vlerësimi i rastit, i cili konsiston në dy momente kryesore. Së pari në vlerësimin paraprak para fillimit të procesit të riintegritimit që konsiston në analizën e karakteristikave individuale të viktimës me qëllim përcaktimin e nevojave. Së dyti në vlerësimin pas procesit të riintegritimit për të parë nivelin e riintegritimit të viktimës, aftësisë që ajo t'i kthehet jetës normale në shoqëri.¹⁷

4.4. Vlerësimi paraprak

Për të bërë të mundur realizimin e kësaj faze, menjëherë pasi paraqitet një rast në një Strehëz, viktimës i caktohet një menaxher që kryesisht është një punonjës social. Ai është përgjegjës për të bërë analizën e rastit duke trajtuar situatën e vetë personit, të familjes, gjendjen ekonomike, shëndetësore dhe psikologjike, nevojat bazike, etj. Pasi bën analizën e situatës Menaxheri i rastit harton një plan veprimi për personit që do të asistohet dhe vendos nëse do akomodohet në Qendër apo pranë familjes. Viktima mund edhe të akomodohet në një apartament të marrë me qira, por zakonisht kjo ndodh pas njëfarë kohe gjatë së cilës ajo mund të ketë marrë edhe një trajtim profesional dhe të ketë fituar një pavarësi të caktuar ekonomike. Edhe në këtë rast ajo vazhdon të jetë nën vëzhgim dhe në proces riintegritimi deri në vlerësimin përfundimtar, nëse viktima e ka kaluar traumën, ka fituar pavarësinë e nevojshme, a është riintegruar?¹⁸

Riintegritimi është një proces afatgjatë i cili zgjat deri në tre vjet, kjo në varësi të karakteristikave të viktimës dhe ecurisë së procesit, dhe është specifik dhe individual për çdo viktimë. Gjatë gjithë procesit të ndihmës, punonjësit duhet të mundohen të ofrojnë masat e mbrojtjes, të ndihmës dhe të mbështetjes që i përshtaten më mirë nevojave dhe rrethanave individuale të viktimave.¹⁹

5. Vlerësimi i rezultateve, pas procesit të riintegritimit

Riintegritimi i suksesshëm i viktimave të trafikimit varet nga një sërë faktorësh dhe situatash përfshirë profilin individual të personit, mjedisin ku ajo do të riintegrohet, mekanizmat e ndryshëm mbështetës për rriintegrim, rolin e shtetit, shoqërisë civile dhe komuniteteve vendore. Rikthimi i të drejtave të mohuara gjatë historisë së trafikimit, është një aspekt që mund të analizohet, me qëllim për të kuptuar rezultatet e procesit të riintegritimit duke qenë se, ky proces i referohet pikërisht krijimit të mundësive të barabarta për viktimën e trafikimit për t'i ushtruar ato si çdo person i lirë dhe i pavarur. Disa kriteret për vlerësimin dhe përcaktimin se nëse një individ është riintegruar me sukses në shoqëri dhe ekonomikisht, lidhen me: strehimin dhe akomodimin, nëse është i sigurt dhe i përballeshëm, statusin ligjor të fituar, mundësitë profesionale dhe të punësimit, mundësi arsimimi dhe trajnimit të krijuara, siguri, krijimi i një mjedisi të shëndetshëm social përfshirë antidiskriminimin dhe antimarxhinalizimin, mirëqenia

¹⁷ Manuali i Ndhmës së Drejtpërdrejtë për Viktimat e Trafikimit, IOM, 2007. Megjithatë viktimat e trafikimit mund të vinë nga përvoja dhe rrethanat të përbashkëta, punonjësit e organizatave duhet të kenë parasysh individualitetin e viktimave, duke përfshirë ndryshimet individuale, gjinore dhe të moshës, si dhe përvojat e ndryshme të këtyre personave para, gjatë dhe pas trafikimit dhe, aq sa munden, të ofrojnë ndihmë dhe kujdes të personalizuar.

¹⁸ Intervistë me Mariana Meshi, Drejtor Ekzekutiv, Qendra "Të Ndryshëm dhe të Barabartë", datë 25.07.2016, intervistuar nga Silena Tola

¹⁹ Po aty.

sociale dhe marrëdhënie pozitive ndërpersonale, mirëqenie dhe qëndrueshmëri ekonomike, akses në shërbime dhe mundësi të tjera.²⁰

5.1 Shërbimet e riintegrit

Shërbimet e riintegrit, janë shërbime që merren me vullnetin e shprehur të viktimës dhe fillojnë që nga shërbimet rehabilituese deri në riintegrim, proces i cili sikurse kjo temë evidenton është shpesh i vështirë në disa raste i pasuksesshëm, për shkak të kohëzgjatjes si dhe të traumës që personi ka pësuar nga veprimtaria kriminale.²¹ Ato ofrohen nga strehëzat në bashkëpunim me institucionet shtetërore, sipas elementëve specifikë dhe fushave të përgjegjesisë së institucioneve dhe janë të shumta dhe specifike, sipas nevojave individuale të viktimave të trafikimit, nisur nga moshja, historiku i trafikimit, kushtet ekonomike dhe familjare, gjendja psikologjike dhe arsimore. Viktimave u sigurohet strehim. Akomodimi duhet të jetë i sigurt dhe i përballueshëm. Në praktikë, e drejta për strehim e viktimave të trafikimit, është shpesh e vështirë të realizohet. Ka raste, kur grupi i punës që vlerëson rastin, sugjeron se për shkak të karakteristikave të saj duhet të mos strehohet në strehëza, por në një apartament privat, por nuk janë mundësitë e realizimit të kësaj nevojë²². Gjithashtu viktimës i sigurohet asistencë mjekësore dhe suport psikologjik, nisur nga fakti se trafikimi është një fenomen që dhunon shëndetin e viktimës përfshi dhe atë mendor, pavarësisht nga pëlqimi ose jo, i dhënë nga ajo për trafikimin. Njëkohësisht eksperiencia e riintegrit është një eksperiencë jo e lehtë. Viktimës i ofrohet asistencë ligjore e nevojshme për të kuptuar dhe zgjidhur situatën e saj me organet e drejtësisë. Kjo ndihmë mund t'i nevojitet për shkak të denoncimit të trafikantit, dhënien e dëshmisë kundra tij, problemeve me martesën, kërkesën për divorc, kujdestarinë e fëmijëve, etj. Viktimave, gjithashtu ju ofrohen shërbime që kanë lidhje me edukimin e tyre arsimor dhe profesional. Ato nxiten të vazhdojnë arsimin e mbetur papërfunduar dhe në varësi të moshës apo aftësive, ju nënshtrohen kurseve dhe trajnimeve profesionale. Fuqizimi ekonomik i viktimave të trafikimit ka një rëndësi të veçantë. Nga një intervistë e realizuar me një nga viktimat e trafikuar e strehuar prej 6 muajsh në një nga strehëzat në vendin tonë, ndihet qartë pasiguria për jetën që e pret pas largimit nga strehëza. Konkretisht, ato ndjenjë se jeta prej të trafikuarë minimalisht i siguronte “*ujë për tu larë dhe bukë për të ngrënë*”.²³ Kështu, në bashkëpunim ndërmjet tyre, organizatat joqeveritare vendase apo të huaja dhe organet shtetërore ju ofrojnë viktimave të trafikimit asistencë materiale dhe asistencë për zhvillim ekonomik. Viktimat e trafikimit janë në monitorim dhe ndjekje të vazhdueshme dhe suport, ju sigurohet edhe përfituesve dytësor që janë familjarët e viktimave, kryesisht fëmijët, por edhe prindërit apo familjarë të tjerë.

Dy janë problemet kryesore në vendin tonë, në drejtim të ofrimit të shërbimeve. Problemi i parë, lidhet me kostot e larta që duhet të përballojnë qendrat që ofrojnë

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

²⁰ Manuali i Ndihmës së Drejtpërdrejtë për Viktimat e Trafikimit, IOM, 2007

²¹ Intervistë me Elona Gjebreja, datë 5.07.2016, intervistuar nga Silena Tola.

²² Intervistë me Mariana Meshi, Drejtor Ekzekutiv, Qendra “Të Ndryshëm dhe të Barabartë”, datë 25.07.2016, intervistuar nga Silena Tola. Gjatë një interviste u vendos theksi në këtë pikë që shpesh bëhet pengesë për suksesin e procesit të riintegrit, veçanërisht për nënat me fëmijë apo viktimat e mitura të trafikimit. Sidoqoftë vazhdojnë përpjekjet për t'i dhënë zgjidhjen e këtij problemi. Aktualisht është duke u konsultuar me grupet e interesit një projektligj që i trajton viktimat e trafikimit si një kategori e veçantë e cila ka nevoja emergjente të trajtohet me strehim

²³ Intervistë me një viktimë trafikimi, datë 10.07.2016, intervistuar nga Silena Tola.

shërbime në vendin tonë, duke pasur parasysh se vetëm njëra prej tyre është me financim shtetëror. Ndihma financiare e dhënë nga shteti nuk është e mjaftueshme dhe duhet të konsiderohet seriozisht në vendin tonë për të bërë të mundur financim më të lartë nga shteti. Vende të tilla si Australia, Austria, Islanda, Franca, Gjermania etj., njihen për shumat e mëdha të vëna në dispozicion të riintegritimit të viktimave të trafikimit dhe ato klasifikohen në radhët e vendeve, që kanë marrë masa të mjaftueshme për të arritur standardet minimale, të vendosura nga Konventa e OKB-së në luftën kundër trafikimit. Problemi i dytë, lidhet me krijimin e mekanizmave të nevojshme, që detyrimi për mundësimin e ofrimit të shërbimeve të zbatohet në praktikë. Kështu për ofrimin e asistencës mjekësore, duhet të bëhet e mundur edhe ofrimi i asistencës psikologjike nga trauma e pësuar, por edhe shërbime të rehabilitimit nga droga duke ruajtur konfidencialitetin e viktimave të trafikimit.

Për ofrimin e strehimit, duhet t'ju vihen në dispozicion apartamente të financuara nga shteti dhe, në këtë drejtim, duhet të përfundojë sa më shpejtë projektligji “Për strehimin” që është duke u punuar dhe konsultuar. Për të drejtën e punësimit, duhet që shteti të bëhet ndërmjetës dhe ta bëjë të mundur përmes politikave lehtësuese për bizneset që punësojnë viktimat trafikimi. Për të drejtën e arsimit, duhet të krijohen lehtësitë e nevojshme që viktimat e trafikimit përveç arsimit profesional në rastet kur kanë aftësi dhe moshën e duhur, të ndjekin arsimin e lartë duke ju ofruar atyre bursa qoftë në universitetet shtetërore ashtu edhe ato joshetërore, etj.

5.2. Mbrojtja dhe siguria e viktimave të trafikimit

Pjesë e procesit të riintegritimit është mbrojtja dhe siguria e viktimave të trafikimit që sjell nevojën e vlerësimit të rrezikut që mund t'i kanoset viktimave të trafikimit në përgjithësi dhe rast pas rasti në veçanti, në varësi të historikut të trafikimit të saj. Të gjitha viktimat që kanë arritur të shpëtojnë nga kthetrat e trafikantëve rrezikojnë të bien sërish në duart e tyre. Bashkëpunimi i tyre me organet e zbatimit të ligjit dhe forcat e rendit, rrit probabilitetin e riskut pasi informacioni që zotërojnë ato mund të rrezikojë lirinë e trafikantëve dhe zbulimin e rrjetit kriminal. Në rastet kur trafikantët e zotërojnë informacionin e nevojshëm se një viktimitë bashkëpunon me forcat e rendit, niveli i rrezikut bëhet tepër i lartë dhe marrja e masave mbrojtëse është imediate.²⁴ Vlerësimi i riskut, duhet bërë në mënyrë të vazhdueshme, periodike dhe duhet shtrirë në një plan të gjerë, referuar kushteve të organizatës ku strehohen viktimat, dhe në një plan të ngushtë individual, referuar historikut të trafikimit dhe pas trafikimit të çdo viktime në veçanti.

6. Përfundime

Riintegrimi i viktimave të trafikimit është një proces që ka marrë vëmendjen e

²⁴ Sipas *Manualit të Ndihmës së Drejtpërdrejtë* për viktimat e trafikimit disa nga treguesit që duhet të merren parasysh në vlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut që i kanoset çdo viktime janë shtrirja dhe ndikimi i trafikimit në vend, a është vendi në fjalë vend burimi, tranziti apo destinacioni, apo ndonjë kombinimi i tyre, sa viktimat trafiku mund të kërkojnë ndihmën e organizatës që ofron shërbime, në çfarë mase kontrollohet trafikimi nga grupet e organizuara kriminale, kapaciteti i njohur ose i pritshëm i tyre për të planifikuar dhe vënë në jetë ndëshkime për viktimat dhe/ose personelin e organizatave që ofrojnë shërbime, kapaciteti i strukturave vendase të zbatimit të ligjit, përhapja e korrupsionit dhe ndikimi i tij në nivelin e rrezikut, niveli i angazhimit dhe i mbështetjes së qeverisë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore (*Manuali i IOM-it Për ndihmën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit*, 2007)

duhur në vendin tonë dhe përpjekje për të realizuar një kuadër ligjor dhe institucional që të mund t'i përgjigjet qëllimit të riintegritimit të viktimave të trafikimit në shoqëri. Ngritja e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar Antitrafik është një hap institucional me rëndësi që rrit efektivitetin në luftën kundër trafikimit, bashkëpunimin ndërmjet institucioneve në kuadër të procesit të riintegritimit, forcimin e partneritetit me organizatat jofitimprurëse që ofrojnë shërbimet e riintegritimit duke e vendosur atë në rolin e një koordinatori që ndjek zhvillimet mbi trafikimin në vend, qofshin ato të karakterit ligjor apo institucional, teorik apo praktik. Ky institucion bën të mundur adresimin e problematikave nga një aktor te tjetri dukë arritur zgjidhjen e tyre. Janë bërë hapa të rëndësishëm para, si në parashikimet ligjore si për procesin e riintegritimit, ashtu edhe në parashikimin e së drejtës së dëmshpërblimit të viktimave të trafikimit. Konkretisht ratifikimi i Konventave që parashikojnë kompensimin, miratimi i ligjit Antimafia dhe ekzistenca e konceptit të dëmshpërblimit dhe në Kodin Civil, krijojnë tabanin e nevojshëm për ngritjen e pretendimeve për dëmshpërblim, nga viktimat e trafikimit, por nga ana tjetër ekzistenca e vetëm një vendimi gjykate që dëmshpërblen një viktimë trafikimi, për më tepër një vendim që nuk është vënë kurrë në zbatim, tregon se nuk ekzistojnë mekanizmat e nevojshëm për vënien në jetë të këtij detyrimi nga njëra anë, dhe të drejte të viktimës nga ana tjetër. Ngërçi kryesor në këtë aspekt lidhet me burimin e parave nga do mundet viktimat të vejë në jetë të drejtën e saj.

Për sa çështje kam analizuar në këtë temë, që lidhet me procesin e riintegritimit, dëmshpërblimi, mendoj se është një hendek i madh që lidhet me zbatimin e ligjit. Kjo sigurisht është e lidhur ngushtësisht me krijimin e mekanizmave të nevojshëm për krijimin e një fondi të veçantë të dëmshpërblimit të viktimave të trafikimit. Përfundimisht, mendoj se në Shqipëri veçanërisht këto dhjetë vitet e fundit, i është dhënë një vëmendje e veçantë institucionale dhe ligjore procesit të riintegritimit, por ka ende shumë punë për t'u bërë, masa konkrete për t'u marrë dhe progres për t'u arritur. Fenomeni i trafikimi të qenieve njerëzore është i ashpër dhe viktimat e trafikuar janë gjithmonë më shumë se ato të riintegruara, kjo për shkaqe të shumta që nisin nga mosidentifikimi i të gjithë femrave të trafikuar e deri te dështimi i procesit të riintegritimit. Shqipëria në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe shoqërinë civile në vend, duhet të vazhdojë fort përpjekjet për realizimin e riintegritimit të viktimave të trafikimit.

7. Rekomandime

Për sa kam paraqitur dhe jam përpjekur të analizoj në këtë punim, do doja që të jepja disa rekomandime, që mendoj se do të ndikonin pozitivisht në zgjidhjen e problemeve të mbetura pezull në kuadër të procesit të riintegritimit dhe, konkretisht:

- Hartimin e një ligji kuadër për trafikimin e personave në Shqipëri, i cili do të përmblihdhte në një ligj organik të posaçëm çdo aspekt të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, përfshirë dhe procesin e riintegritimit, duke bërë të mundur kuptimin më mirë të fenomenit në tërësi, në mënyrë që nevojat konkrete të adresohen si dhe ku duhet. Ngritja e procesit të riintegritimit në nivelin e një ligji, duke pasur parasysh dhe hierarkinë e normave në Nenin 116 të Kushtetutës, mendoj që do ishte një instrument që do të ndikonte në seriozitetin e punës së gjithë aktorëve në vend, që kanë për detyrë të realizojnë riintegritimin e viktimave të trafikimit në shoqëri.

- Përmirësimi i procedurave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe OJF-ve që ofrojnë shërbimet e riintegritimit. Kjo lidhet me ndarjen konkrete të

detyrave për çdo organ shtetëror dhe krijimin e mekanizmave që ato që parashikohen në akte ligjore në vendin tonë të zbatohen në praktik.

- Rritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve me qëllim rritjen e numrit të viktimave të trafikimit, që ju drejtohen këtyre institucioneve dhe rritjen e numrit të atyre që dalin të riintegruara nga procesi afatgjatë, të cilit i nënshtrohen aty. Për realizimin e kësaj, është e domosdoshme rritja e bashkëpunimit me organet shtetërore dhe rritja e fondeve të cilat i destinohen posaçërisht këtij qëllimi, rritjes së cilësisë së shërbimeve.

- Rritja e kapaciteteve të strukturave shtetërore dhe joshetërore për njohjen dhe respektimin e të drejtave të viktimave të krimit dhe atyre të trafikimit në veçanti. Duke qenë se procesi i riintegritimit lidhet në thelb me rivendosjen e disa të drejtave, të cilat viktimës së trafikimit i janë refuzuar gjatë kohës së shfrytëzimit, duhet që këto të drejta të njihen si të rëndësishme dhe thelbësore për t'u realizuar. Por, ekzistenca e një të drejte si e tillë, pa bërë të mundur realizimin e saj, apo më keq, mbrojtjen e saj në raste të cënimit, është njësoj si të mos ekzistonte fare. Për këtë arsye, mendoj se është i nevojshëm parashikimi i mekanizmave konkret për realizimin e të drejtave që lidhen me procesin e riintegritimit dhe mbrojtjen e tyre.

Bibliografi

1. *Ligji nr. 8920, datë 11.7.2002, "Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkufitar dhe dy protokolleve shtesë të tij".*
2. *Ligji nr. 9642 datë 20.11.2006 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për masat kundër trafikimit të personave".*
3. *Direktiva 2011/36/BE "Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij dhe që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA.*
4. *Direktiva 2004/80/EC "Në lidhje me kompensimin e viktimave të krimit".*
5. *Strategjia e luftës kundër trafikimit të personave dhe Plani i Veprimit 2014-2017.*
6. *Plan veprimi "Për riintegrimin socio-ekonomik të grave dhe vajzave viktime të trafikimit të personave".*
7. *MPB (2013) Raporti vjetor i zbatimit të strategjisë kombëtare të luftës kundër trafikimit të personave.*
8. *MPB (2014) Raporti vjetor i zbatimit të strategjisë kombëtare të luftës kundër trafikimit të personave.*
9. *MPB (2015) Raporti vjetor i zbatimit të strategjisë kombëtare të luftës kundër trafikimit të personave.*
10. *Trafikim i Qenieve Njerëzore në Ballkanin Perëndimor, publikim i IOM.*
11. *Përmirësimi i sigurisë dhe qëndrueshmërisë së rikthimit dhe riintegritimit të viktimave të trafikimit.*
12. *"Vajzat dhe Trafikimi", Studim mbi Zhvillimin e trafikut të qenieve njerëzore në Shqipëri (2005).*
13. *Manuali i ndihmës së drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit, publikim i IOM.*
14. *"Jeta përtej trafikimit" Riintegrimi i personave të trafikuar në Ballkan 2007-2014.*
15. *Kompensimi i personave të trafikuar dhe shfrytëzuar në Rajonin e OSCE, 2008.*
16. *Surtees, R. (2010). Monitoring anti-trafficking re/integration programmes (a manual). Belgjikë: Fondacioni King Baudoin.*
17. *Breuil et al (2011) Human trafficking revisited: legal, enforcement and ethnographic narratives on sex trafficking to Western Europe.*
18. *Haveman R (1998) Voorëaarden voor de strafbaarstelling van vrouwenhandel (Conditions for the criminalization of trafficking in women). Gouda Quint, Deventer*
19. *Kempadoo K (2005) Trafficking and prostitution reconsidered: new perspectives on migration, sex work and human rights. Paradigm Publishers, Boulder*
20. *Segrave M, Milivojevic S, Pickering S (2009) Sex trafficking. International context and response. Willan Publishing, Devon.*
21. *Lenja (2015) Profili i situatave të viktimave të trafikimit dhe përpjekjet për përfshirje sociale.*
22. *Lenja (2015) Mekanizmat kundër dhunës dhe trafikimit, Sinergjitë dhe zhvillimet e Sinergjive.*

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »**

Eksplorimi i marrëdhënieve të korrupsionit me të ardhurat tatimore

— Dr. Aurel KOROCI
Albanian University
aurelkoroci@hotmail.com

Prof. Asc. Dr. Stavri SINJARI
Akademia e Sigurisë
stavri.sinjari@asp.gov.al

Abstrakt

Në këtë temë, merret në studim dhe bëhet një sintezë se korrupsioni ka një ndikim të rëndësishëm negativ në nivelet e të ardhurave tatimore të mbledhura në një vend. Korrupsioni jo vetëm që ul raportin midis taksave dhe PBB-së, por shkakton edhe dëme afatgjata për ekonominë, duke penguar investimet, duke rritur sasinë e ekonomisë informale, duke shtrembëruar strukturat tatimore dhe duke gërryer moralin tatimor të tatimpaguesve. Korrupsioni ndikon në uljen e rritjes ekonomike, ndikon në shpërndarjen e të ardhurave kombëtare dhe në pengimin e zhvillimit të demokracisë.

Fjalëkyçe:

korrupsion tatimor, evazion fiskal, informalitet, të ardhura tatimore, PBB.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

1. Efektet e korrupsionit te të ardhurat tatimore

Ka një marrëveshje të gjerë mes studiuesve, se korrupsioni ka një ndikim të rëndësishëm negativ mbi të ardhurat nga taksat. Studime në vendet në zhvillim, tregojnë se gjithnjë e më shpesh, gjysma e taksave që duhet të jenë të mbledhura, nuk mund të gjurmohen nga qeveritë, për shkak të korrupsionit dhe evazionit fiskal. Ndërsa disa studiues të korrupsionit, kanë propozuar se korrupsioni mund të jetë një forcë e efikasitetit në përmirësimin dhe mbledhjen e të hyrave tatimore, duke i motivuar zyrtarët e taksave që të punojnë më shumë dhe duke kryer mosnxitje të evazionit fiskal. Ekspertë të tjerë, kanë vënë në dukje se prania e korrupsionit ul të ardhurat nga taksat në periudha afatgjata (Fjeldstad dhe Tungodden, 2001).

1.1 Korrupsioni si një fuqi nxjerrëse nga ekonomia

Një studim i vitit 1998, i bërë në 39 vendet nënsahariane të Afrikës, nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka gjetur prova të forta statistikore se një rritje në nivelin e korrupsionit, ul raportin tatimor të të ardhurave të PBB-së. Ky zbulim, çoi FMN-në në përfundimin, se përpjekjet për të ulur korrupsionin, do të rrisin të ardhurat tatimore në mënyrë të konsiderueshme (Ghura, 1998).

Këto rezultate, më pas u përforcuan nga Tanzi dhe Davoodi, që hetuan marrëdhëniet në mes të niveleve të korrupsionit (matura nga indekset e perceptimit të korrupsionit) dhe PBB-së, në një mostër prej 97 vende. Ata gjetën se një rritje e një pike në indeksin e perceptimit të korrupsionit shoqërohet me 1.5% rënie në raportin taksë-PBB; 2.7% rënie në raportin ndërmjet të ardhurave tatimore dhe PBB-së dhe

1.3%, rritje e përqindjes në raportin e të ardhurave jo nga taksat e PBB. Kjo tregon se korrupsioni më i lartë, është në përputhje me të ardhurat më të ulëta të së gjitha llojeve, me përjashtim të së ardhurave jotatimore. Zbulimi i fundit, është në përputhje me faktin se, të paktën për vendet në zhvillim, të ardhurat jotatimore janë dominuar nga të ardhurat prej burimeve natyrore. Nga ana tjetër, studimet kanë treguar që edhe rezervat e burimeve natyrore janë një përcaktues i rëndësishëm i korrupsionit (Tanzi dhe Davoodi, 2000).

Tanzi dhe Davoodi, gjithashtu shqyrtuan lidhjen mes korrupsionit dhe kategorive të ndryshme të taksave, kryesisht tatimit mbi të ardhurat, tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe tatimit të tregtisë. Ata gjetën se, korrupsioni ka një korrelacion statistikor të rëndësishëm negativ, me taksat mbi të ardhurat individuale - një rritje me një pikë në korrupsion, është gjetur të jetë e lidhur me një rënie të PBB-së me 0.63 % në taksat e të ardhurave të marra. Korrupsioni i lartë, është i lidhur edhe me taksat më të ulëta, të mbledhura nga TVSH; taksa e shitjes dhe taksa e qarkullimit.

Humbjet në TVSH, janë llogaritur duke përdorur një raport të efikasitetit të TVSH-së: raporti i të ardhurave nga TVSH-ja ndaj PBB, krahasuar me normën standarde të TVSH-së. Ky raport është i lidhur mes të 1-shit dhe 0-s. Sa më i lartë raporti, aq më produktiv sistemi i TVSH-së; sa më i ulët raporti, aq më i përhapur evazoni fiskal, ose administrimi i dobët i taksave. Duke përdorur këtë lidhje të thjeshtë ndërmjet korrupsionit dhe raportit të efikasitetit të TVSH-së, për një kampion prej 83 vendesh, Tanzi dhe Davoodi, gjetën se vendet me perceptimin e lartë të korrupsionit, kanë tendencë që të kenë raport të ulët të efikasitetit TVSH-së. Koeficienti i korrelacionit është -0,34, shifër e cila është statistikisht e rëndësishme në nivelin 1%.

Me gjithë praninë e niveleve të larta të korrupsionit në sistemet doganore, nuk ka korrelacion statistikisht të rëndësishëm të gjetur, mes korrupsionit dhe taksave të tregtisë. Këto rezultate të Tanzi dhe Davoodi, nxjerrin përfundimin se, duke pasur parasysh nivelin e lartë të korrupsionit në vendet në zhvillim, korrupsioni ka një ndikim më të madh mbi taksat direkte, në vendet në zhvillim. Kjo është gjithashtu në përputhje me nivelin e lartë të evazionit fiskal në vendet në zhvillim. Ata hedhin hipotezën se një reduktim me 4 pikë në korrupsion, mund të rrisë taksat direkt në vendet në zhvillim, si një grup, me 7.2 për qind të PBB-së (Tanzi dhe Davoodi, 2000).

Korrupsioni gërryen të ardhurat e tatimit në periudhë afatgjatë. Korrupsioni zvogëlon jo vetëm mbledhjen e të ardhurave tatimore nga ekonomia aktuale, por gjithashtu pengon edhe rritjen ekonomike, duke ndikuar në të ardhmen, në mbledhjen e të ardhurave tatimore.

1.2. Korrupsioni gërryen moralin tatimor të tatimpaguesve

Siç u përmend më parë, korrupsioni ndikon në moralin tatimor të tatimpaguesve dhe shtrembëron strukturën tatimore. Proceset e mbledhjes së të ardhurave të taksave, përfshin lojtarë të mëdhenj të ekonomisë në shoqëri, që i bën mundësinë dhe motivet për t'u angazhuar në korrupsion të shumta dhe të përhapura. Këta aktorë, përfshijnë zyrtarë, politikanë të tatimeve dhe rrjeteve të trashëgimisë si dhe vetë tatimpaguesit. Vazhdimësia e korrupsionit në procesin e mbledhjes së taksave, ndihmon për të nxitur një kulturë korrupsioni mes një game të gjerë të aktorëve, e cila sjell dëme dhe prish mundësinë e krijimit të qeverisjes së mirë dhe llogaridhënies demokratike, në periudhë afatgjatë.

1.3. Korrupsioni shtrembëron strukturat tatimore

Duke përkeqësuar shtrembërimet në nivelin e tatimeve dhe strukturës së saj, korrupsioni zvogëlon rritjen ekonomike. Korrupsioni politik dhe/ose kapja e shtetit, çon në politikanët që abuzojnë me pushtetin e tyre duke futur rregulla tatimore të favorshme për industrinë me fuqi të mëdha. Korrupsioni në këtë nivel, mund të çojë në modelimin joefikas të strukturës tatimore, e cilat mund të krijojë barriera artificiale për aktivitete private ekonomike, të cilat jo vetëm që e shkatërrojnë bazën e të ardhurave të ekonomisë (edhe nga zgjerimi i kapacitetit të saj taksagjeneruese), por gjithashtu krijojnë mundësi më të mëdha për korrupsion në nivel burokratik (Attila, 2008).

1.4. Korrupsioni rrit madhësinë e ekonomisë informale

Vendet me nivele të larta të korrupsioni, priren gjithashtu që të kenë ekonomi informale më të mëdha. Meqenëse korrupsioni dëmton cilësinë e burokracisë dhe besimit të administratës, kjo gjë mund të dekurajojë ndërmarrësit për fillimin e bizneseve të ekonomisë zyrtare. Kur sasia e ekonomisë informale rritet në kurriz të ekonomisë zyrtare, baza e të ardhurave tatimore të qeverisë gërryhet edhe më tej (Dreher dhe Herzfeld, 2005).

1.5. Korrupsioni pengon rritjen e përgjithshme të ekonomisë

Korrupsioni ndikon në potencialin e rritjes së ekonomisë dhe në këtë mënyrë redukton sasinë e taksave të ardhshme. Duke ulur burimet në dispozicion për publikun dhe autoritetet, korrupsioni gjithashtu redukton investimet produktive publike në fusha të tilla si, rrugët, shëndetësia dhe arsimit. Axel Dreher dhe Thomas Herzfeld, kanë gjetur se një rritje në korrupsion me rreth një pikë indeksi, redukton rritjen e PBB-së me 0.13 pikë përqindjeje dhe PBB-në për frymë me 425 dollarë. Korrupsioni dekurajon investitorët, ul produktivitetin e shpenzimeve publike, deformon shpërndarjen e burimeve publike dhe kështu ul rritjen ekonomike. Duke përdorur të dhëna nga 71 vende, Dreher dhe Herzfeld gjetën se korrupsioni ka një efekt negativ në variabëlën e zhvillimit të njeriut të tilla si, jetëgjatësia, shkallën e frekuentimit të shkollës, etj. (Dreher dhe Herzfeld, 2005).

Paolo Mauro, në një studim të vitit 1995 për korrupsionin dhe rritjen e tij, gjeti se vendet më të korruptuara përjetojnë norma, ndjeshëm më të ulëta të investimeve. Ai vlerëson ndikimin në uljen e investimeve me 2.5 pikë përqindjeje për një rritje të devijimit standard në korrupsion. Këto rezultate, u konfirmuan nga Pelligrini dhe Gerlach-u, në vitin 2004, të cilët zbuluan se një rritje devijimi standard, në korrupsion, ul investimet me rreth 2.5 pikë përqindje (Mauro, 1995) e (Pellegrini dhe Gerlach, 2004).

2. Efektet e tatimeve ndaj korrupsionit

Në kontrast me korrupsionin, tatimet janë një metodë legjitime e nxjerrjes së burimeve nga ekonomia. Megjithatë, ekonomistët kanë argumentuar se tatimi i tepruar mund të

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

çojë në efekte negative në aktivitetet ekonomike. Ndërsa rritja e burimeve publike përmes tatimeve mund të ndihmojë qeveritë të sigurojë më shumë të mira publike, si sasiore edhe cilësore, këto përfitime mund të kompensohen nga efektet negative mbi rritjen për shkak të taksave të larta. Shkalla më e lartë e taksave, mund të sjell potencialisht më shumë korrupsionin në një ekonomi, duke nxitur evazionin fiskal - individët do të kenë stimuj të fortë për të pranuar dhe për të paguar më shumë ryshfet, në mënyrë që të zvogëlojnë barrën e taksave. Gbewopo Attila, ngrë hipotezën se, varësisht nga struktura dhe ekonomia, efektet e kësaj, mund të jenë pozitive ose negative për ekonominë në tërësi. Për shembull, në qoftë se për shkak të korrupsionit, barra tatimore e tatimpaguesit (duke përfshirë shumën e ryshfetit) pakësohet, atëherë kjo do të krijojë burime për ta investuar atë në ekonomi ose për të rritur kursimet/akumulimin e kapitalit.

Duke pranuar praninë e korrupsionit, Attila propozon si në vijim:

“Le të supozojmë se ekziston një normë optimale tatimore e rritjes për një ekonomi (duke mos marrë korrupsionin në konsideratë) dhe një ‘shkallë optimale tatimore e korrupsionit’ - një shkallë tatimore, në të cilën ndikimi e korrupsionit në rritjen optimale ekonomike është zero”. Nëpërmjet analizës ekonometrike Attila tregon se, në qoftë se shkalla tatimore e rritjes optimale është më e ulët se norma optimale e taksave të korrupsionit, si rrjedhim korrupsioni shkakton një rritje ekonomike nën normën optimale. Prandaj, çdo rritje në normën e taksave, do të ketë një efekt të drejtpërdrejtë negativ në rritjen në vetvete. Megjithatë, efekti i korrupsionit në këtë rast, do të zbuste ndikimin në rritje. Në anën tjetër, asnjë ulje në tatime s’do të jetë e dobishme për rritjen; këtë herë duke lënë të kuptohet një efekt negativ të korrupsionit.

Nëse, megjithatë, shkalla tatimore e rritjes optimale është më e lartë se sa norma optimale e taksave të korrupsionit, ndikimi i tatimit është më shumë negative në rritje se sa ai që në mënyrë të konsiderueshme ul normën e rritjes. Ndikimi pozitiv i drejtpërdrejtë ose efekti indirekt nëpërmjet korrupsionit që taksat mund të kenë në rritje, pengohet nga efektet negative të tepërta. Attila arrin në përfundimin se, në qoftë se të gjitha gjërat e tjera janë njësoj, rritja ekonomike në ekonomitë pa korrupsion është më e lartë se sa në ekonomitë e korruptuara. Megjithatë çdo ndryshim pozitiv në normën marginale të taksimit, nga më e mundshme optimale, shkakton një efekt negativ në rritjen e cila mund të zbutet nga korrupsioni (Attila, 2008).

Megjithatë, këto rezultate, janë të bazuara në supozimin problematik se zyrtarët e korruptuar nuk do ta rregullojnë shumën e ryshfetit për të maksimizuar efikasitetin në shpërndarjen e burimeve në ekonomi. Një problem tjetër i rëndësishëm, është se burimet e vërteta, shpesh përdoren në mënyrë që t’i mbanë marrëveshjet korruptive sekrete. Aktualisht, ekziston një mungesë e madhe e të dhënave empirike dhe e analizave, në shqyrtimin e ndikimit të tatimit mbi korrupsionin. Duhet të bëhen më shumë hulumtime, për të kuptuar më mirë këtë marrëdhënie dhe për të përcaktuar nëse mjetet juridike për korrupsionin mund të gjenden nëpërmjet skemave tatimore.

3. Përfundime

Një përmbledhje e literaturës tregon se korrupsioni ka një ndikim të rëndësishëm negativ në nivelet e të ardhurave tatimore të mbledhura në një vend. Kuptimi aktual i korrelacionit midis korrupsionit dhe të ardhurave tatimore, megjithatë, nuk është i plotë, pasi nuk ka informata të mjaftueshme në dispozicion në ndikimin e tatimit mbi korrupsionin. Korrupsioni jo vetëm që ul raportin midis taksave dhe PBB-së, por

shkakton edhe dëme afatgjata për ekonominë duke penguar investimet, rrit madhësinë e ekonomisë informale duke shtrembëruar strukturat tatimore dhe duke gërryer moralin tatimor të tatimpaguesve. Të gjitha këto, nga ana tjetër ulin më tej potencialin afatgjatë të gjenerimit të së ardhurave të ekonomisë. Ndikimi i tatimit mbi korrupsionin është më pak i eksploruar në literaturën ekzistuese kërkimore. Informacioni i pakët që u gjet, tregon se normat e larta tatimore mund të sjellin më shumë korrupsion në një ekonomi, duke nxitur evazionin fiskal. Disa studiues argumentojnë se korrupsioni mund të zbutë barrën e taksimit të tepruar në ekonomi, duke mundësuar shpërndarje më të mirë të burimeve dhe duke mundësuar investimet. Megjithatë, supozimet themelore të këtyre gjetjeve janë sfiduar nga studiues të tjerë.

Bibliografi

1. Dreher, A. Herzfeld, T. (2005). "The Economic Costs of Corruption: A Survey and New Evidence". Gjetet në: <http://econpapers.repec.org/paper/wpawuwpe/0506001.htm>
2. Mauro, P. (1996). "The Effects of Corruption on Growth, Investment, and Government Expenditure". *IMF Working Paper 96/98, International Monetary Fund*. Gjetet në: <http://ideas.repec.org/p/imf/imfwpa/96-98.html>
3. Li, H.; Xu, L. C.; Zou, H. (2000). "Corruption, Income Distribution, and Growth. Economics and Politics". *Blackwell Publishing, vol. 12(2): 155-182*. Gjetet në: <http://ideas.repec.org/a/bla/ecopol/v12y2000i2p155-182.html>
4. Attila, G. (2008). "Corruption, Taxation and Economic Growth: Theory and Evidence". *CERDI-CNRS Working Paper, 2008*.
5. Mauro, P. (1995). "Corruption and Growth". *Quarterly Journal of Economics 110 (1995) 3, 681 – 712*. Gjetet në: <http://ideas.repec.org/a/tpj/qjecon/v110y1995i3p681-712.html>
6. Pellegrini, L. Gerlagh, R. (2004). "Corruption's Effect on Growth and its Transmission Channels". *Kyklos, 57 (3), August 2004, fq. 429 – 456*. Gjetet në: http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=591558
7. Brockington, D. (2008). "Corruption, Taxation and Natural Resource Management in Tanzania". *Journal of Development Studies, Vol. 44, No. 1, 103–126, January 2008*.
8. Fisman, R.; Svensson, J. (2002). "Are Corruption and Taxation Really Harmful to Growth?". *Firm Level Evidence*. Gjetet në: <http://people.su.se/~jsven/corrgrowth.pdf>
9. Richardson, G. (2006). "Taxation determinants of fiscal corruption: evidence across countries". *Journal of Financial Crime, Vol. 13 No. 3, 2006, fq. 323-338*.
10. Van der Hoek, M. P. "Enlarging the European Union: Taxation and Corruption in the New Member States". *MPRA Paper No. 11546, November 2008*.
11. Fjeldstad, O-H.; Tungodden, B. "Fiscal Corruption: A vice or a virtue?". *CMI Working Paper, 2001*.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit »

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

180

Sesioni II / Second Section

~ Roli dhe ndikimi i arsimimit në sigurinë publike ~

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit »

Trajnimi profesional i vazhdueshëm në Policinë e Shtetit

Msc Nikoll RICA

Drejtoria e Policisë së Shtetit
nikoll.rica@asp.gov.al

Abstrakt

Nëpërmjet këtij shkrimi, synoj të përcillet tek lexuesi informacion i zgjeruar mbi trajnimin profesional të vazhdueshëm që duhet të realizohet me punonjësit e Policisë së Shtetit, pas përfundimit të shkollës së policisë. Ky detyrim ishte shmangur përvite me radhë ndaj punonjësve të policisë, duke ndikuar negativisht në uljen e nivelit profesional të tyre. Ligji i ri i Policisë së Shtetit, krahas rregullimit juridik të marrëdhënieve për rekrutimin, ecurinë në karrierë, bashkëveprimin e koordinimin ndërinstytucional me institucionet e tjera, trajtimin ekonomik-financiar, etj., rregulloi edhe marrëdhëniet në fushën e trajnimeve, si parakusht për një shërbim të qëndrueshëm e profesional. Nëpërmjet realizimit të programit të trajnimit profesional të vazhdueshëm synohet mbajtja dhe thellimi i mëtejshëm i dijeve profesionale, aftësive fizike, aplikimi i eksperiencave më të mira bashkëkohore, me qëllim zhvillimin e një organizate policore më të aftë, më të disiplinuar, më të informuar dhe më profesionale në përputhje me përgjegjësitë që ajo ushtron, duke garantuar rend dhe siguri publike për të gjithë. Në këtë kuptim, trajnimi profesional i vazhdueshëm është kthyer në një nevojë, si për çdo punonjës policie në veçanti, ashtu edhe për profesionalizimin e organizatës së Policisë në tërësi. Me organizimin e ri strukturor të Policisë janë parashikuar struktura të veçanta, të cilat kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për ndjekjen e trajnimit profesional të vazhdueshëm. Roli i drejtuesit/liderit të strukturës policore në këtë proces është prioritar, si autoriteti përgjegjës për evidentimin dhe planifikimin e nevojave në funksion të trajnimeve profesionale. Në hartimin e politikave të zhvillimit të sistemit të ri të trajnimit policor, duhet të merren parasysh shumë faktorë, si: mjedisi i jashtëm dhe ai i brendshëm, e kaluara dhe e tashmja e këtij procesi si dhe, të hidhet vështrimi mbi nevojat që parashikon e ardhmja. Procesi i reformimit të sistemit të trajnimit vazhdueshëm duhet t'i nënshtrohet konsultimeve, mbikëqyrjes dhe asistencës së partnerëve ndërkombëtare, nëpërmjet misioneve: PAMECA, OSBE dhe ICITAP.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

Fjalëkyçe:

Trajnim i detyruar në shërbim, modul, kurrikul, karrierë, hierarki, trajnim i specializuar, proces konkurrimi, testim, ricertifikim, verifikim të dhënash.

I. Hyrja

Policia e Shtetit në Shqipëri është në një proces reformimi të vazhdueshëm. Pjesë e rëndësishme e këtij procesi është edhe reforma që po kryhet në sistemin e rekrutimit, ecurisë në karrierë, përmirësimit të sistemit të trajnimeve dhe kualifikimeve të punonjësve të Policisë së Shtetit. Ky proces reformimi përfshin një ndër aspektet më të rëndësishme të punës së gjithanshme që po bëhet për rritjen e profesionalizmit të punonjësve të policisë. Aktualisht janë hedhur bazat e nevojshme legjislative dhe organizative për reformimin tërësor të sistemit të trajnim-shkollimit, duke synuar ngritjen e një modeli të ri të trajnimit profesional të vazhdueshëm, i cili duhet të realizohet gjatë gjithë vitit kalendarik. Korniza ligjore e akteve, që aktualisht rregullon veprimtarinë e shkollim-trajnimit në Policinë e Shtetit është:

- “Kodi i sjelljes për punonjësit e zbatimit të ligjit”, (i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në vitin 1979);
- Deklarata e Këshillit të Europës për Policinë; (një instrument i krahasueshëm me “Kodin e sjelljes për punonjësit e zbatimit të ligjit”, shtuar rezolutës 690 (1979) dhe miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, viti 1979);
- “Kodi evropian i etikës së Policisë”;
- Konventa e Europolit;
- Ligji nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”;
- Rregullorja e Policisë së Shtetit, (miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 750 datë 16.09.2015).

Në funksion të zbatimit të këtyre akteve, Drejtori i Policisë së Shtetit miraton

procedurat standarde të punës “Për trajnimin e detyruar në shërbim”, nëpërmjet të cilave, përcaktohen dhe unifikohen rregullat dhe përgjegjësitë e strukturave trajnuese për zbatimin e programit të trajnimit të detyruar në shërbim. Procesi i ri, që ka filluar të implementohet në sistemin e trajnimit, ka për qëllim thellimin e njohurive profesionale dhe të aftësive fizike të punonjësve të policisë, për t’i bërë ata sa më të aftë në zbulimin dhe parandalimin e veprimtarisë kriminale. Trajnimi profesional i vazhdueshëm duhet të kthehet në një proces detyrues për çdo punonjës policie, pavarësisht nga funksioni apo grada që mban. Për të përmbushur këtë detyrim është e domosdoshme respektimi i kriterëve dhe procedurave trajnuese nga çdo strukturë apo individ i veçantë i Policisë së Shtetit. Sistemi i trajnimit profesional të vazhdueshëm, duhet të përputhet me strategjitë, planet perspektive të zhvillimit si dhe nevojat që ka organizata e policisë në kuadër të aftësimit profesional të saj.

1. Prioritetet në reformimin e trajnimit profesional të vazhdueshëm

Trajnimi profesional i vazhdueshëm duhet të zërë peshën kryesore të së gjithë procesit të trajnimit që realizohet me punonjësit e Policisë së Shtetit në tërësi. Ky trajnim duhet të ketë si prioritet aftësimin e punonjësve të policisë përkundrejt vlerave më të mira, thellimin e dijeve profesionale dhe aftësive fizike, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në forcimin e rendit dhe të sigurisë publike. Sigurisht që, përmbajtja dhe metodat e realizimit të trajnimit policor, kanë ngjashmëri ndërmjet vendeve të ndryshme, për sa i përket elementëve mësimdhënës dhe prioritetëve që synohen të realizohen; ndërkohë, ato bëjnë dallime në përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrës së vlerësimit të këtij trajnimi. Këto dallime varen nga legjislacioni dhe statusi që gëzojnë policitë e çdo vendi.

Detyrimi i trajnimit profesional të vazhdueshëm është përcaktuar qartë në nenin 85 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë së Shtetit”, ku thuhet se: “Punonjësi i Policisë së Shtetit ka detyrimin të përmirësojë aftësitë profesionale dhe fizike, nëpërmjet formimit profesional dhe trajtimeve”. Kriteret e vlerësimit vjetor për aftësitë profesionale, performancën dhe aftësitë fizike, përcaktohen në Rregulloren e Policisë së Shtetit¹. Disa prioritate që synohet të realizohen në procesin e reformimit të trajnimit profesional të vazhdueshëm janë:

- Ndërtimi i një sistemi të efektshëm trajnimi, bazuar në standardet e vendeve euroatlantike, parimet e të mësuarit gjatë gjithë jetës; dhënies së shanseve të barabarta për të gjithë punonjësit e policisë si dhe ecurisë në karrierë vetëm nëpërmjet shkollimit dhe trajnimit.

- Hartimi i programeve dhe kurrikulave bashkëkohore, sipas kushteve dhe nevojave të policisë, nga realizimi i të cilave të fitohen njohuri dhe aftësi të specializuara që lidhen me secilin pozicion pune, gradë apo funksion.

- Përshtatja e strukturave trajnuese pranë çdo njësie vendore e qendrore të policisë në funksion të ndjekjes dhe realizimit sa më efektiv të planeve të trajnimit vazhdueshëm të policisë.

- Përcaktimi i përgjegjësive dhe detyrave funksionale për çdo pozicion pune e person që merret me realizimin e programeve të trajnimit profesional të vazhdueshëm.

¹ Policia e Shtetit. “Kreu IV”. Rregullore e Policisë së Shtetit, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 750 datë 16.09.2015.

- Përzgjedhja e stafit që merret me trajnimet duke garantuar integritet, nivel të lartë kulturor e profesional.

- Krijimi i infrastrukturës së nevojshme materiale e didaktike, terreneve sportive, pajisjeve teknike, ndërtimi i skenarëve sa më real, duke i vënë në rol punonjësit e policisë në raport me situatat konkrete që ato kalojnë në shërbim.

Lidershipi në Policinë e Shtetit, ka detyrim të veçantë për të ndjekur trajnimin profesional të vazhdueshëm, i cili duhet të realizohet gjatë gjithë vitit kalendarik. Me organizimin e ri strukturor të Policisë janë parashikuar struktura të veçanta, të cilat kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për ndjekjen e trajnimit profesional të vazhdueshëm. Roli i drejtuesit/liderit të strukturës policore në këtë proces është prioritar, si autoriteti përgjegjës për evidentimin dhe planifikimin e nevojave në funksion të trajnimeve profesionale. Programet që kanë filluar të realizohen, synojnë trajnimin e të gjithë punonjësve të policisë në detyrë me njohuritë e nevojshme që lidhen me zhvillimet, ndryshimet brenda organizatës së Policisë, njohjen me legjislacionin, ruajtjen e njohurive dhe shkathtësive specifike në lidhje me funksionin që ato kryejnë. Programi i trajnimit të detyruar në shërbim, përfshin këto module trajnimi:

a) moduli “Për njohjen edhe përditësimin e akteve ligjore dhe ruajtjen e nivelit të dijeve”;

b) moduli “Për përdorimin e armëve të zjarrit”;

c) moduli “Për ndihmën e parë”;

d) moduli “Për aftësitë policore operacionale”;

e) moduli “Për përgatitjen fizike”.

Koha e zbatimit të programit të trajnimit të detyruar në shërbim, përcaktohet në fillim të çdo viti kalendarik, me kohëzgjatje jo më pak se 6 orë mësimore në muaj. Drejtuesi/lideri i strukturës policore, kur e shikon të nevojshme, ka të drejtë të planifikojë zhvillimin e orëve shtesë të këtij programi. Gjithashtu, ata duhet të planifikojnë dhe realizojnë trajnime për tema të veçanta, në rastet kur identifikohen mangësi gjatë kryerjes së detyrave, kohëzgjatja e të cilave nuk mund të jetë më pak se 24 orë në vit.

2. Programet e trajnimeve që zhvillohen me punonjësit e Policisë së Shtetit

Pas përfundimit të Shkollës Bazë të Policisë dhe emërimit në detyrë, me punonjësit e Policisë së Shtetit duhet të zhvillohen programet e trajnimit si më poshtë:

- programet për ecurinë në karrierë;
- programet për trajnimin e specializuar/avancuar;
- programet për trajnimin e detyruar në shërbim.

2.1. Programet për ecurinë në karrierë

Karriera në Policinë e Shtetit është e lidhur ngushtë me sistemin e gradave, pasi ato përcaktojnë hierarkinë dhe nivelin e menaxhimit për çdo punonjësi policie. Për rrjedhojë, programet e ecurisë në karrierë lidhen me hierarkinë e punonjësit të policisë si dhe me emërtimin në detyrë në çdo strukturë policore. Nëpërmjet këtij procesi, evidentohen cilësitë individuale të punonjësit të policisë, eksperiencia e punës si dhe përgjegjësitë në ushtrimin e funksioneve nëpërmjet një procesi konkurrues. Aktualisht, në Policinë e Shtetit, sipas rendit hierarkik rritës kemi këto funksione për gradë:

- 7200 funksione për gradën *inspektor*;

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

- 1505 funksione për gradën *nënkomisar*;
- 537 funksione për gradën *komisar*;
- 452 funksione për gradën *kryekomisar*;
- 139 funksione për gradën *drejtues*;
- 54 funksione për gradën *drejtues i parë*;
- 6 funksione për gradën *drejtues i lartë*;
- 1 funksion për gradën *drejtues madhor*.

Krahasuar me rendin hierarkik të mëparshëm, ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”², parashikon tre grada policore më pak, për sa i përket funksioneve që kryejnë detyra të nivelit ekzekutiv e zbatues. Duke e krahasuar këtë rend hierarkik me atë të policive të vendeve të tjera të Ballkanit, rezulton se tek ne, ky rend hierarkik është më i vogël në numër; për shembull, ligji i Policisë së Kosovës parashikon që, për punonjësit e policisë që kryejnë detyra të nivelit ekzekutiv e zbatues, të ketë katër grada policore e konkretisht: “polic i ri”, “polic”, “polic i lartë” dhe “rreshter”. Secila prej këtyre gradave ka afatet e caktuara kohore të marrjes ose fitimit të saj. Pavarësisht emërtimit që kanë, rendi hierarkik i tyre, për punonjësit e policisë që kryejnë detyra të nivelit ekzekutiv e zbatues, është më i plotë dhe më fleksibël se sa ai që parashikohet në ligjin tonë të Policisë. Të njëjtin rend hierarkik, me tre ose katër grada parashikojnë edhe legjislacionet e policisë në Turqi, Maqedoni e Mal të Zi, për punonjësit e nivelit zbatues.

Ndërsa legjislacioni jonë parashikon vetëm një rend hierarkik (gradën inspektor) për këtë kategori punonjësish. Kjo do të thotë që, për 7200 funksione, nga 9894 funksione policore që ka sot e gjithë Policia e Shtetit, të aplikohet vetëm një rend hierarkik (grada inspektor), gjë që është e pamjaftueshme dhe jonxitëse për punonjësit e policisë, së kësaj kategorie. Prandaj, është e nevojshme që të ndryshohet dispozita e nenit 51 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit, duke parashikuar një rend hierarkik rritës sëpaku prej tre gradave për punonjësit e policisë që kryejnë detyra të nivelit ekzekutiv e zbatues. Megjithatë, duke qenë se objekti i këtij shkrimi është trajnimi vazhdues në Policinë e Shtetit, po sqarojmë politikat trajnuese dhe parimet që duhet të ndiqen gjatë ecurisë në karrierë të punonjësve të policisë.

Gjatë zhvillimit të tyre ato duhet të synojnë:

a) transparencë, përgjegjshmëri e profesionalizëm të lartë, për të promovuar në Policinë e Shtetit, punonjës me cilësi të larta morale, integritet e kurajë qytetare – për t’i vënë ato në shërbim të komunitetit;

b) promovim të punonjësve me rezultate të larta, garanci morale e profesionale – duke u ofruar atyre shanse për ngritje në detyrë dhe gradë, brenda fushës së shërbimit;

c) zhvillim të karrierës brenda e jashtë fushës së shërbimit – duke përfituar aftësitë e duhura në përmbushjen me sukses të detyrave.

Në procesin e konkurrimit për fitimin e gradës, domosdoshmërisht duhet të respektohen parimet e mëposhtme:

- shanse të barabarta, meritë, mosdiskriminim dhe një proces përzgjedhës i drejtë, i paanshëm dhe transparent;

- vlerësim i aftësive të së shkruarit, të së shprehurit, të punës në grup, të aftësive komunikuese, psikologjike, fizike e shëndetësore, të garancive dhe sigurisë së kandidatit;

- konkurrimi për fitimin e gradës bëhet vetëm për gradën pasardhëse.

Kriteret për fitimin e gradës, fazat e procesit të konkurrimit, llojet e testimëve, si dhe

² Sipas nenit 51 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, gradat sipas rendit hierarkik rritës emërtohen: Inspektor, Nënkomisar, Komisar, Kryekomisar, Drejtues, Drejtues i Parë, Drejtues i Lartë, Drejtues Madhor.

procesi i ankimit, janë të përcaktuara qartë në kreun e VIII-të, nenet 50-62 të ligjit nr. 108/2014 “Policinë e Shtetit”, si dhe në kreun e V-të, nenet 161-173 të Rregullores së Policisë së Shtetit.

Në raport me legjislacionin e mëparshëm, legjislacioni i ri i policisë parashikon veçori për fitimin e gradës “nënkomisar” dhe “drejtues”. Kjo, për faktin se, për fitimin e këtyre dy gradave, kandidatët e shpallur fitues nga procesi i konkurrimit duhet të përfundojnë programin e arsimimit, respektivisht ciklin të parë dhe të dytë të studimeve³; ndërsa, për fitimin e gradave të tjera: “komisar”, “kryekomisar” dhe “drejtues i parë”, kandidatët duhet të përfundojnë programet e trajnimit përkatës me afat javor ose mujor, sipas përcaktimit të bërë në urdhrin e Drejtorit të Policisë së Shtetit. Përderisa gradat përcaktojnë hierarkinë dhe nivelin e menaxhimit, për çdo punonjës policie, do të ishte mirë që kurse trajnimi të parashikoheshin edhe për gradën drejtues i lartë, pavarësisht se ajo jepet nga ministri, e nuk fitohet me proces konkurrimi.

2.2. Programet për trajnimin e specializuar/avancuar

Zhvillimi i këtyre programeve bëhet për të aftësuar punonjësit e policisë në drejtime specifike, ku kërkohen njohuri të posaçme për fusha të veçanta të shërbimit policor. Këto programe nuk ofrohen domosdoshmërisht për të gjithë punonjësit e policisë, por vetëm për ata që janë në pozicione të tilla që kërkojnë njohuri specifike për fushën ku shërbejnë. Trajnimit e specializuara/avancuara, janë të lidhura ngushtë me ndarjet dhe nënndarjet sipas pozicioneve të punës në Policinë e Shtetit. Disa nga trajnimet më kryesore që duhet të zhvillohen me punonjësit e policisë në këtë fushë janë:

2.2.1. Analiza e informacionit kriminal

Trajnimet në fushën e analizës së informacionit kriminal, fokusohen kryesisht në këto drejtime:

- përpunimi, vlerësimi dhe analiza e informacioneve në funksion të operacioneve të policisë;
- përdorimi i sistemit të menaxhimit të informacionit kriminal “MEMEX”, hedhje në sistem të formularëve “Model SK-2mxm” dhe “Model SK- 1-mxm”;
- njohje dhe përdorim të sistemit të menaxhimit policor të çështjes;
- hetim i veprave penale kundër lëndëve narkotike;
- aplikim të metodave speciale të hetimit të veprave penale të krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit, pastrimit të parave, etj.

2.2.2. Formimi i përgjithshëm profesional

Trajnimet në fushën e formimit të përgjithshëm e profesional, fokusohen kryesisht në:

- thellimin e njohurive praktike operacionale të policisë, dhënien e ndihmës së parë, përdorimin e armëve të zjarrit etj.;
- përvetësimin e njohurive dhe aftësive praktike mbi detyrat që kryhen në funksione të policisë kufitare e rrugore;
- analizën e riskut ndaj veprimtarisë së grupeve aktive kriminale;
- përgatitjen e ekspertëve kriminalistë mbi teknikat e ekzaminimit tekniko-grafik të dokumenteve, fiksimit, skicimit dhe fotografimit e provave materiale në vendngjarje, ruajtjen dhe dorëzimin e provave biologjike;
- njohjen dhe zbatimin e Kodi Etik të Policisë së Shtetit, duke synuar përmirësimin

³ Neni 70 i ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

e komunikimit, ruajtjen e figurës së punonjësit të policisë gjatë kryerjes së detyrës e jashtë saj.

2.2.3. *Krimet financiar*

Trajnimet në fushën e krimit financiar, fokusohen kryesisht në:

- hetimin e pasurive që rrjedhin nga pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtari kriminale që lidhen me to;
- përdorimin e metodave proaktive të investigimit të veprave penale të pastrimit të parave, mashtrimit, falsifikimit të kartëmonedhave, dokumenteve, pronësisë industriale etj.;
- njohjen e procedurave për identifikim, lokalizim dhe konfiskim të pasurive kriminale;
- shkëmbimin e praktikave më të mira të punës së analistit në hartimin e produkteve analitike, konform standardeve të miratuara.

2.2.4. *Krimi kompjuterik*

Trajnimet në fushën e krimit kompjuterik, fokusohen kryesisht në:

- kërkimin, dokumentimin, paketimin dhe transportimin e provave kompjuterike;
- fitimin e njohurive mbi programin për ekzaminimin shkencor të internetit;
- njohjen e mënyrave të hetimit për mbrojtjen e fondeve të BE-së;
- forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar, duke përfshirë edhe bashkëpunimin me OLAF.

2.2.5. *Lufta kundër krimit të organizuar*

Trajnimet në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, fokusohen kryesisht në:

- marrjen, përpunimin dhe menaxhimin e informacionit kriminal ndaj veprave penale të krimit të organizuar;
- njohjen me konventat, marrëveshjet dhe protokollet ndërkombëtare që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar;
- aplikimin e formave dhe metodave speciale të hetimit të krimit të organizuar, rekrutimin e informatorëve, trajtimin, drejtimin dhe kontrollin e tyre;
- përpilimin dhe administrimin e dokumentacionit të procedimit policor.

2.2.6. *Kufiri dhe migracioni*

Trajnimet në fushën e kufirit dhe migracionit, fokusohen kryesisht në:

- Forcimin e regjimit të hyrje-daljeve nga territori i Republikës së Shqipërisë;
- respektimin e të drejtave të emigrantëve gjatë kapjes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- kryerjen e hetimeve proaktive ndaj migracionit të paligjshëm;
- kryerjen e veprimeve procedurale për veprat penale të kalimit të paligjshëm të kufirit, kontrabandimit dhe trafikimit të personave, mjeteve, veprave të artit e të kulturës;
- respektimin e rregullave ndaj azilkërkuesve, etj.

2.2.7. *Komunikimi me mediet dhe publikun*

Trajnimet në fushën e komunikimit me mediet e publikun, fokusohen kryesisht në:

- kuptimin mbi rolin e medieve në veprimtarinë policore;
- përmirësimin e aftësive në komunikimin me medien;
- forcimin e policimit në komunitet;
- bashkëpunimin me organet e pushtetit vendor.

2.2.8. *Rendi dhe siguria*

Trajnimet në fushën e rendit dhe sigurisë, fokusohen kryesisht në:

- forcimin e masave për kontrollin e territorit;
- aplikimin e teknikave të sigurisë gjatë menaxhimit të shërbimeve policore;
- mënyrën e sjelljes gjatë policimit në komunitet;
- respektimin e standardeve evropiane të së drejtave të njeriut gjatë shoqërimit, arrestimit apo ndalimit të personave;
- perfeksionimin e teknikave bashkëkohore të vetëmbrojtjes policore;
- trajtimin dhe hetimin e aksidenteve rrugore me pasoja;
- realizimin e qitjes me armë.

2.2.9. Lufta kundër terrorizmit

Trajnimet në fushën e luftës kundër terrorizmit, fokusohen kryesisht në:

- kuptimin mbi aktet terroriste dhe elementët përbërës të këtyre veprave;
- njohjen me konventat, marrëveshjet dhe protokollet ndërkombëtare që lidhen me luftën kundër akteve terroriste;
- format e shfaqjes dhe teknikat e investigimit të veprave penale të akteve terroriste;
- dallimet ndërmjet akteve terroriste me veprat e tjera të krimit të organizuar;
- përpilimin dhe administrimin e dokumentacionit të procedimit policor për veprat penale të akteve terroriste.

2.2.10. Trafiqet e paligjshme

Trajnimet në fushën e trafiqeve të paligjshme, fokusohen kryesisht në:

- kuptimin mbi kontrabandimin dhe trafikimin;
- njohjen me konventat, marrëveshjet dhe protokollet ndërkombëtare që lidhen me luftën kundër trafikimit;
- teknikat e hetimit të veprave penale të trafikimit të veprave të artit dhe mjeteve motorike;
- mbrojtjen e viktimave nga trafikimi;
- realizimin e hetimeve proaktive ndaj veprave penale të trafikimit të paligjshëm, armëve të zjarrit, municioneve, materiale bërthamore, radioaktive si dhe materiale të tjera të rrezikshme.

3. Programet për trajnimin e detyruar në shërbim

Nëpërmjet realizimit të këtyre programe synohet që të gjithë punonjësit e policisë në detyrë, të përfitojnë njohuritë e nevojshme në lidhje me zhvillimet apo ndryshimet brenda organizatës së policisë, azhurnimin me legjislacionin e ri, ruajtjen e dijeve dhe shkathtësive specifike për detyrën që kryejnë. Koha e zbatimit të programeve të trajnimit të detyruar në shërbim, përcaktohet në fillim të çdo viti kalendarik, në aktin administrativ të miratuar nga Drejtori i Policisë së Shtetit, me kohëzgjatje jo më pak se gjashtë orë mësimore në muaj. Kur shikohet e nevojshme, strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit, sipas identifikimit të mangësive gjatë kryerjes së detyrave, planifikojnë dhe zhvillojnë orë shtesë të këtyre programeve, kohëzgjatja e të cilave nuk mund të jetë më pak se 24 orë në vit. Programet e trajnimit të detyruar në shërbim, përgatiten sipas gradave dhe fushave të shërbimit në dhjetëditëshin e parë të muajit dhjetor të çdo viti kalendarik. Ato hartohen nga Akademia e Sigurisë, mbi bazën e analizës dhe identifikimit të nevojave që kanë strukturat qendrore dhe vendore të policisë. Në përfundim, miratimi i këtyre programeve si dhe i afateve të realizimit, bëhet nga Drejtori i Policisë së Shtetit. Zbatimi i tyre bëhet nga strukturat qendrore dhe vendore të policisë, pas detajimit në

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

plane mujore trajnimi. Planet mujore të trajnimit përgatiten nga strukturat e burimeve njerëzore dhe miratohen nga titullari i strukturës.

Në planin vjetor të trajnimit përcaktohen: temat e trajnimit, kriteret e përzgjedhjes, numri i punonjësve të policisë që do të përfshihen në trajnim, personat përgjegjës për zhvillimin e temave (instruktorë/lektorë) si dhe muaji kur mund të zhvillohet trajnimi. Ndërsa, në planin mujor të trajnimit, përcaktohen: temat e trajnimit, objektivat, punonjësit e policisë që do të përfshihen në trajnim sipas gradave dhe fushës së shërbimit, personat përgjegjës për zhvillimin e temave (instruktorë/lektorë), data, vendi dhe koha kur do të zhvillohet trajnimi. Dukeqenëse trajnimi i detyruar në shërbim, është një proces i ri, rëndësi të veçantë në zbatimin e këtyre programeve merr përgatitja dhe puna parapërgatitore e lektorëve/instruktorëve.

Ata duhet të jenë të certifikuar për mësimdhënie sipas drejtimeve të caktuara dhe nuk mund të propozohen për transferim, pa siguruar më parë trajnimin dhe certifikimin e punonjësve të tjerë të asaj strukture. Herëpashere, si lektorë/instruktorë mund të jenë edhe shefat e sektorëve, seksioneve, stacioneve apo njësisve, sipas drejtimeve të shërbimit policor, të cilët duhet të përcjellin tek të trajnuarit shembull personal, cilësi dhe nivel të lartë profesional. Pjesëmarrja në trajnimin e detyruar në shërbim, është detyrues për çdo punonjës policie. Në rastet kur, për arsye shërbimi, leje vjetore, leje shëndetësore, etj., punonjësi i policisë nuk mund të marrë pjesë në datën e përcaktuar për trajnim, atëherë caktohet një datë tjetër për zhvillimin e trajnimit, duke i grupuar të trajnuarit. Në procesin e trajnimit, detyruar në shërbim, rëndësi të veçantë merr edhe dokumentimi i realizimit të programit si dhe i pjesëmarrësve, duke hapur regjistra përkatës dhe plotësuar çdo temë trajnimi. Ky regjistër duhet të administrohet nga shefi/specialisti i seksionit të trajnimeve të strukturës përkatëse dhe në përfundim dhe të dorëzohet në sekretarinë e strukturës ku është zhvilluar trajnimi. Monitorimi i trajnimit të detyruar në shërbim bëhet nga titullarët e strukturave policore, Akademia e Sigurisë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Rezultatet individuale të arritura në trajnimin e detyruar në shërbim, janë pjesë e vlerësimit të punës të çdo punonjësi policie që i nënshtrohet këtij trajnimi.

3.1. Përbërja e programeve të trajnimit të detyruar në shërbim

Programet e trajnimit të detyruar në shërbim përbëhen nga disa module të ndryshme trajnimi, si në vijim.

3.1.1. Moduli i trajnimit "Për njohjen dhe përditësimin e akteve ligjore si dhe ruajtjen e dijeve të punonjësit të policisë"

Në këtë modul përfshihen tema mësimore që kanë lidhje me: legjislacionin e Policisë së Shtetit dhe aktet e tjera normative të nxjerra në zbatim të tij; aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë për sigurinë publike, hetimin e krimeve; legjislacionin penal dhe procedural penal; të drejtën kushtetuese; të drejtat e njeriut, etj. Ky modul zhvillohet në jo më pak se 12 orë në vit dhe është i detyrueshëm për të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit.

3.1.2. Moduli i trajnimit "Për përdorimin e armëve të zjarrit"

Ky modul hartohet së bashku me manualin përkatës dhe aplikohet për të aftësuar punonjësit e policisë për sigurinë dhe përdorimin e armëve të zjarrit, për realizimin e qitjeve reale taktike dhe për arritjen e rezultatit të përcaktuar me armën personale ose të dhënë në përdorim. Për zhvillimin normal të këtij moduli, ndiqen rregullat e

përcaktuara për sigurimin teknik, që parashikohen në manualin përkatës. Pjesa teorike e modulit të trajnimit “Për përdorimin e armëve të zjarrit”, zhvillohet në ambientet e brendshme të strukturave qendrore e vendore të Policisë së Shtetit, nga instruktorët të certifikuar të armëve të zjarrit. Ndërsa, pjesa praktike, (realizimi i qitjeve), kryhet në poligone të mbyllura ose të hapura, pasi ato të jenë të jenë të miratuara. Ky modul zhvillohet në jo më pak se 12 orë në vit dhe është i detyrueshëm për të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit. Forcat Speciale dhe Ndërhyrja e Shpejtë kanë program të veçantë për trajnimin me armët e zjarrit, sipas natyrës së shërbimit.

3.1.3. Moduli i trajnimit “Për ndihmën e parë”

Ky modul hartohet nga Akademia e Sigurisë në bashkëpunim me strukturat e mjekësisë dhe profilaksisë në Policinë e Shtetit, sipas fushës së shërbimit dhe nevojave që ato kanë për trajnim. Synimi i këtij moduli është vlerësimi i njohurive dhe aftësive të punonjësve të policisë mbi përcaktimin fillestar të dëmtimeve, ringjalljen kardiopulmonare, zhbllokimin e rrugëve të frymëmarrjes nga objektet e huaja, ndihmën e parë në rastet e hemorragjisë, në rastet e djegieve dhe gjendjes së shokut. Moduli i trajnimit “Për ndihmën e parë”, është i detyrueshëm për punonjësit e Policisë së Shtetit, nga grada “inspektor” deri në gradën “komisar” dhe zhvillohet në jo më pak se 12 orë në vit. Ai zhvillohet nga punonjës policie të certifikuar, instruktor/trajner, të cilët janë të certifikuar për ndihmën e parë. Kur është e mundur, ky modul zhvillohet edhe nga mjekët e ndihmësmjekët e strukturës policore ose mjekët e ndihmësmjekët e strukturave vendore të shëndetësisë, sipas marrëveshjes së bërë ndërmjet përfaqësuesve të policisë dhe atyre të shëndetësisë.

3.1.4. Moduli i trajnimit “Për aftësitë policore operacionale”

Ky modul përgatitet nga Akademia e Sigurisë në bashkëpunim me strukturat operacionale të Policisë së Shtetit, sipas fushës së shërbimit dhe nevojave që ato kanë për trajnim. Synimi i këtij moduli është që të vlerësojë njohuritë dhe aftësitë e punonjësve të policisë në kryerjen e veprimeve praktike si: reagimi i shpejtë për mbrojtje ndaj vetes dhe qytetarëve, marrje e masave ndaj shkelësve të ligjit në përputhje me domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e veprimeve, kontrolli efikas i territorit, etj. Ky modul zhvillohet në jo më pak se 12 orë në vit dhe është i detyrueshëm për punonjësit e Policisë së Shtetit, nga grada “inspektor” deri në gradën “komisar”.

3.1.5. Moduli “Për përgatitjen fizike”

Ky modul zhvillohet individualisht dhe në mënyrë të pavarur nga punonjësi i policisë, në bazë të manualit përkatës mbi kriteret fizike. Synimi i këtij programi është të përmirësojë aftësitë e punonjësve të Policisë së Shtetit për të kryer detyrat e zakonshme dhe ato në raste kritike. Në rast se punonjësi i policisë bie nën nivelet minimale fizike të parashikuara, atëherë komprometohet performanca e tij në kryerjen e detyrave policore. Programi i trajnimit “Për përgatitjen fizike” është i detyrueshëm për të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit.

4. Testimi i punonjësve të policisë

E gjithë puna që bëhet për realizimin e programeve të trajnimit të detyrueshëm në

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

shërbim, në përfundim, duhet të sjellë si produkt përfitimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme që i duhen çdo punonjësi policie për kryerjen me efikasitet të detyrave, sipas funksionit që kryen. Mekanizmi më i mirë për kontrollin e këtyre njohurive dhe aftësive është zhvillimi i procesit të testimit. Për këtë arsye legjislacioni i ri i Policisë së Shtetit⁴ parashikon që, të gjithë punonjësit e policisë, nga grada “inspektor” deri në gradën “komisar”, çdo vit i nënshtrohen testimit fizik dhe profesional, në varësi të funksionit që ata mbajnë. Nëpërmjet realizimit të këtij testimi synohet:

- verifikimi i aftësive dhe zhvillimit profesional të punonjësve të policisë;
- përcaktimi i nevojave për trajnime shtesë;
- plotësimi i të gjitha kërkesave për burime njerëzore të kualifikuara dhe të specializuara;
- përshtatja e punonjësve të policisë me kërkesa të reja të policimit, që prekin të gjithë organizatën e Policisë.

Testimi përbëhet nga *testimi fizik* dhe *testimi profesional*.

a) *Testimi fizik*, bëhet për të vlerësuar aftësitë fizike e psikomotorike të punonjësve të policisë, me qëllim ruajtjen e nivelit të përgatitjes fizike dhe kapacitetit profesional në veprimet policore. b) *Testimi profesional*, bëhet për të kontrolluar njohuritë profesionale sipas drejtimeve dhe profilizimit të shërbimeve policore, aftësitë në njohjen e akteve normative, kryerjen e veprimeve operacionale, përdorimin e armëve të zjarrit, etj.

Mënyra dhe koha e zhvillimit të testeve, ngritja e komisioneve përkatëse, përbërja e tyre, administrimi i dokumentacionit, procesi apelues etj, përcaktohen në procedurën standarde të miratuar nga Drejtori i Policisë së Shtetit për këtë qëllim. Rezultatet e testimit janë pjesë e vlerësimit të punës për çdo punonjës police. Nëse punonjësi vlerësohet negativisht, atij i humbet e drejta të konkurrojë për ngritjen në gradë. Strukturat e burimeve njerëzore, qendrore dhe vendore që organizojnë testimin, kanë për detyrë të administrojnë të gjithë dokumentacionin e testimit dhe rezultatet e arritura nga punonjësit e policisë të testuar, në një dosje të veçantë. Në përfundim, i dërgohet një informacion i detajuar Drejtorit të Policisë së Shtetit mbi zhvillimin e këtij testimi dhe rezultatet e arritura.

5. Përfundime

Marrëdhëniet e reja juridike të vendosura në fushën e trajnimit profesional të vazhdueshëm përbëjnë një risi për rritjen e nivelit profesional të punonjësve të Policisë së Shtetit. Ndërkohë, ndryshimi cilësor që pësoi institucioni i arsimimit të lartë policor si dhe e gjithë veprimtaria për përgatitjen dhe kualifikimin e punonjësve të policisë, do të reflektojë pozitivitet në rritjen e standardeve të shërbimit ndaj qytetarëve. Programet e trajnimit profesional të vazhdueshëm, që do të realizohen çdo vit nga strukturat qendrore dhe vendore të policisë, do të shërbejnë për thellimin e mëtejshëm të dijeve profesionale, aftësive fizike dhe për zbatimin e eksperiencave më të mira bashkëkohore nga punonjësit e Policisë së Shtetit. Në këtë kuptim, trajnimi profesional i vazhdueshëm do të kthehet në një sfidë për të cilin do të ketë nevojë çdo punonjës policie, pavarësisht nga grada apo funksioni që kryen, duke i bërë ata më të aftë profesionalisht, më të disiplinuar, më të informuar mbi përgjegjësitë që ata ushtrojnë, duke garantuar rend dhe siguri publike për të gjithë. Në funksion të këtij qëllimi, mendoj se në të ardhmen

⁴ Neni 85 i ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. Neni 157 i Rregullores së Policisë.

vëmendja duhet të përqendrohet në këto drejtime:

- Në kryerjen e një studimi të brendshëm në Policinë e Shtetit për njohjen reale të gjendjes së përgatitjes profesionale të punonjësve të policisë dhe hartimin e programeve të veçanta, në funksion të nevojave aktuale dhe atyre të perspektivës, që ka policia për trajnimin profesional të vazhdueshëm.

- Në vënien në efikasitet të plotë të veprimtarisë së Akademisë së Sigurisë, si institucion i arsimit të lartë, me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për përgatitjen dhe kualifikimin e punonjësve të policisë, për të gjitha nivelet e shërbimit dhe në mënyrë të vazhdueshme.

- Në rivlerësimin e programeve mësimore ekzistuese dhe hartimin e kurrikulave të reja për patrullën e përgjithshme, si dhe të gjitha shërbimet e tjera të veçanta të policisë. Këto programe duhet t'i përshtaten niveleve hierarkike të gradave dhe llojeve të shërbimeve policore.

- Në dhënien prioritet, formimit profesional të punonjësve të rinj dhe rekrutimit të shtetasve me arsim të lartë; përforcimit të kriterëve dhe procedurave transparente të konkurrimit. Në këtë proces të synohet rinovimi i shërbimit të patrullës së përgjithshme me punonjës të moshës së re dhe të synohet rritja e pjesëmarrjes së femrave dhe atyre nga minoritetet, në polici.

- Në forcimin e kontrollit ndaj strukturave të veçanta që e kanë për detyrë funksionale ndjekjen e trajnimit profesional të vazhdueshëm. Roli i drejtuesit/liderit të strukturës policore në këtë proces duhet të jetë prioritar, si autoriteti përgjegjës për evidentimin e nevojave, planifikimin dhe zhvillimin e trajnimeve profesionale.

- Procesi i reformimit të sistemit të trajnimit vazhdues duhet t'i nënshtrohet konsultimeve, mbikëqyrjes dhe asistencës së partnerëve ndërkombëtare, nëpërmjet misionëve: PAMECA, OSBE dhe ICITAP.

Bibliografi

1. Ligji nr. 108, datë 31.07.2014, "Për Policinë e Shtetit".
2. Ligji Nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
3. Ligji nr. 8677 datë 02.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", i ndryshuar me ligjin nr. 10301 datë 15. 07. 2010.
4. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 25.02.2015, "Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë".
5. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.09.2015 "Për miratimin e rregullores së Policë së Shtetit".
6. Banfield, Paul dhe Rebecca Kay. *Hyrje në menaxhimin e burimeve njerëzore*. Tiranë: UET Press, 2013.
7. "Kodi i sjelljes për punonjësit e zbatimit të Ligjit", botim i viti 1979.
8. "Deklarata e Këshillit të Europës për Policinë", viti 1979.
9. "Kodi evropian i etikës së Policisë".
10. "Konventa e Europolit".

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

Përqasja e kurikulave të arsimit policor me misionin e sigurisë publike

Dr. (në proces) Artill MANDRO
Fakulteti i Drejtësisë, UT
artilimandro@yahoo.com

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO
Dekan, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit
ilirjan.mandro@asp.gov.al

Abstrakt

Përmes këtij kontributi autori sjell dimensionin e ri dhe të rëndësishëm që sistemi arsimor policor merr për përgatitjen e specialistëve të lartë të policisë nëpërmjet zhvillimit të programit mësimor "Bachelor", për siguri dhe hetim duke u ndalur në përgjegjësitë e veçanta, vështirësitë dhe objektivat që ka Fakulteti për përgatitjen e studentëve jo vetëm në auditor por dhe jashtë tyre në zbatim të politikave të trajnimit vazhdues dhe ecurisë në gradë. Sjellë përmes planeve dhe programeve, shkurtimisht, është paraqitur ndikimi i tyre në përgatitjen profesionale të studentëve me njohuri juridike, sociale dhe policore. Strukturat policore me mendimet e dhëna për këto programe, kanë bindjen se me një punë këmbëngulse impenjative profesionale, fakulteti i sapongritur do të plotësojë boshllëqet profesionale që evidenton në radhët e personelit të saj. Prej indikatorëve që do të përdoren do evidentohen rezultatet e arritura, rezultate lidhur me realitetin e respektimit të të drejtave të qytetarit ose diskriminimit të tij, nivelit të stabilitetit në shoqëri dhe rendit publik ose e kundërta, luftën ndaj terrorizmit e korrupsionit, etj. Duke qenë se formimi profesional në kuptimin fillestar "bachelor" dhe trajnimeve vazhduese dhe jo vetëm por dhe hapja e niveleve të dyta të shkollimit, "Master profesional për siguri dhe hetim", kanë një rëndësi të veçantë, dhe barra më e madhe për këtë në strukturën arsimore policore i bie Fakultetit të Hetimit dhe Sigurisë. Nëse ky institucion nuk do të luajë në lartësinë e duhur rolin e vet, progresi i këtij sistemi arsimimi do të jetë i dyshimtë. Por vetëm një institucion që ndërton filtrat e duhur dhe përzgjedh më të mirët në testimet e zhvilluara, përzgjedh një staf të kualifikuar dhe me parametra shkencor, një institucion që harton për studentët e tij programin e duhur dhe e sjell këtë përmes jo vetëm stafit pedagogjik, por dhe ekspertëve elitare që janë të tillë për shkak të formimit profesional dhe integritet të lartë moral, ka vendosur bazën e sigurt dhe solide të një shkolle të konsoliduar. E njëjta vlen edhe për trajnimet vazhdues si një domosdoshmëri që çdo punonjës policie ti bëjë ballë sfidave të reja, legjislacionit në ndryshim, provave të vështira e pse jo edhe përpjekjeve për përbaltje. Në këtë, diskutim, autori sjell frymën e zhvillimit dhe të punës që po bëhet në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit për të afruar programe dhe plane mësimore të nivelit të lartë universitar profesional, të përgatisë punonjës policie apo struktura të tjera ligjzbatuese, në të tre ciklet universitare të shkollimit të aftë për të ofruar një shërbim profesional, cilësor dhe demokratik me besim tek publiku.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

Fjalëkyçe:

trajnim, program mësimor, fakulteti i sigurisë dhe hetimit, kurikula, student.

1. Hyrje

Vetë titulli i këtij materiali është në vetvete atraktiv, jo pa qëllim, për të tërhequr vëmendjen e asaj pjese studentësh të cilët janë diplomuar në auditorët e kësaj shkolle, brezit të ri të cilët me dëshirë dhe pasion duan të ecin përpara në karrierën e tyre policore, asaj pjese intelektualësh të cilët me dëshirën e mirë duan të çojnë më lart këtë arsimit, ku me të gjitha mundësitë e tyre, administrative dhe vendimmarrëse të kontribuojnë në zhvillimin e arsimit policor shqiptar si pjesë e zhvillimit dhe ndryshimeve në Policinë e Shtetit. Çështjet e rendit dhe të sigurisë publike janë delikate. Prej tyre varet cilësia e qetësisë në jetën qytetare. Standardi i tyre është tregues i ekzistencës ose jo i shtetit të së drejtës. Në realitetin e sotëm kur lufta me kriminalitetin është bërë më e ashpër dhe më e sofistikuar, roli sistemit arsimor policor në përgjithësi dhe kontributi që ky gjeneron përmes studentëve që arsimon në veçanti, mbetet ende një sfidë, në sfidat e mëdha që ka përfshirë zhvillimet e vendit. Cilësia e zhvillimit të planeve, kurikulave mësimore e progresiste në arsimimin policor, kontribuojnë në garantimin e rendit dhe sigurisë publike në luftën kundër krimit në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut. Sigurimi i cilësive arsimore, në përshtatje me kërkesat e standardet e shkollave policore evropiane e më gjerë, është një nga drejtimet kryesore të reformës institucionale të arsimit policor shqiptar dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave¹ riorganizohet dhe ngrihet Akademia e Sigurisë, dhe në prill të vitit 2016 institucionalizohet Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit si pjesë e strukturës arsimore në Akademinë e Sigurisë. Vizioni i fakultetit në këtë proces zhvillimi tashmë do të jetë:

“Të përgatisë punonjës policie apo struktura të tjera ligj zbatuese, në të tre ciklet universitare të shkollimit² të aftë për të ofruar një shërbim profesional, cilësor dhe demokratik me besim tek publiku”. Misioni i këtij fakulteti është formimi, specializimi dhe kualifikimi punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit në përgjithësi dhe ato të

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

¹ VKM Nr.185 datë 25.02.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”, Veprimtaria e Akademisë së Sigurisë mbështetet në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe kërkimit Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH Nr 80/2015; Ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” (kreu VII, neni 37 e 38);

² Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit të Krimit, do të afrojo programe studimi për tri nivelet e shkollimit, atë Bechelior, Master Profesional si dhe programe të ecurisë në gradë.

Sigurisë dhe Hetimit të Krimin në veçanti, si dhe kualifikimin e specializimin e punonjësve të agjencive të tjera ligj zbatuese nëpërmjet këtyre “shtyllave” kryesore:

- Edukimi, trajnimi i punonjësve të policisë të aftë për të ofruar një shërbim profesional e cilësor, të përshtatshëm ndaj nevojave të shoqërisë shqiptare.

- Zhvillimi i drejtuesve të policisë për të qenë të aftë të menaxhojnë me profesionalizëm, efikasitet dhe efektivitet burimet njerëzore materiale apo teknike të shërbimit të policisë shqiptare në përputhje me standardet ndërkombëtare.

- Të afrojmë trajnimin profesional e cilësor për të gjitha shërbimet dhe specialitetet nëpërmjet profilizimit të njohurive.

- Të bëhet një qendër perfeksionimi që afrojmë motivim për të mësuarit gjatë gjithë jetës me anë të një personeli të përkushtuar e të angazhuar, në rritjen e cilësisë së programore.

Bazuar në kërkesat e kohës,³ problematikën e shtruarë ish-in sa delikate dhe të vështira. A mund t'i referoheshim një sistemi të caktuar siç është ai “7S”. Konkretisht u shfrytëzuan:

- Strategjitë e strukturave të larta drejtuese, Policisë së Shtetit dhe ajo e Akademisë së Sigurisë.

- U ngrit një strukturë efiçente duke ju përshtatur kërkesave të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe profilizimeve në strukturën e Policisë së Shtetit, duke mirë funksionuar në hierarkinë e saj.

- U përfshin punonjësit për të përmbushur detyrat e tyre (sistemet) janë element tjetër i vëzhguar i domosdoshëm për hartimin e planit mësimor dhe programeve.

- Vlerat e Përbashkëta: të quajtura edhe “qëllimet super” janë një vlerë e shtuar e organizatës përgjithësimi i të cilës do të përkthehej në tema leksionesh dhe kazuse profesionale për tu zgjidhur nga studentët.

- Të gjitha këto së bashku për finalizim kërkojnë një **Stil** drejtimi që do drejtoj stafin e angazhuar.

- **Stafi**, është çelësi i realizimit të misionit të strukturës së sapongritur. Kualifikimi, eksperiencia e tij ngre nivelin e fakultetit, përjas pjesët teorike me ato të praktikës policore.

- Aftësitë: aftësitë dhe kompetencat e punonjësve që angazhohen në fakultet japin shtysë në realizimin me nivel dhe sukses të programeve mësimore.

Vendosja e vlerave të përbashkëta në mes të modelit thekson se këto vlera janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e të gjithë elementeve të tjerë kritikë. Struktura, strategjia, sistemet, stili, stafi dhe aftësitë, që të gjitha rrjedhin nga origjina e krijimit të organizatës dhe nga ajo çka organizata përfaqëson. Vizioni fillestar për sistemin arsimor, formohet nga vlerat e krijuarve të saj. Me ndryshimin e këtyre vlerave, ndryshojnë edhe të gjithë elementët e tjerë. Por për t'ju përgjigjur kërkesave të organizatës rritur nivelin profesional të punonjësve të saj sa më shpejt duhej bërë një:

- rikonceptim i procesit të mësimdhënies në një proces zinxhir nga formimi i rolit bazë policor, që sot është konceptuar si Kolegj Profesional, deri te drejtuesit e lartë të policisë së shtetit të cilët do të trajnohen për rolin dhe detyrat menaxheriale të cilët ata do të kenë gjatë ushtrimit të detyrës.

- Rikonceptim i të gjitha planeve mësimore për të arritur nivelin e praktikave më të mira të BE e standardet e saj.

- Zhvillimi i një programi vazhduar të detyruar në shërbim nga grada n/komisar deri k/komisar, për të garantuar që njohuritë e fituara në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit zbatohen në nivel të lartë profesional dhe procedural. Të gjitha këto objektiva

nuk mund të arrihen pa futjen në procesin mësimor një fryme të re jo vetëm konceptuale në hartimin e materialit programor por dhe në metodologjinë e dhënies, shpjegimit, trajtimit të temave mësimore me studentët.

2. Planet dhe kurikulat e reja mësimore

Të ndërmarrësh një iniciative për hartimin e planeve dhe kurikulave të reja mësimore nuk është e lehtë. Duhet të bëhet një analizë dhe jepen argumente që çfarë të shtyn në një rikonceptim të gjithë sistemit arsimor policor. Specialistët që u morën me hartimin e tyre ishin të bindur dhe të qartë për atë çdo të bënin dhe çfarë do të synonin të arrinin në përfundimin e tyre. E rëndësishme në këtë progres është se programet e hartuara kanë një stad të lartë jo vetëm profesional por edhe didaktik. Ato synojnë arritjen e: standardeve të Bashkimit Evropian; ruajtjes dhe zbatimit të drejtave të njeriut; orientimit të një policie në shërbim të komunitetit; zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore; aplikimit të metodave më të mira të trajnimit të policive në vendet e rajonit; njohuri të domosdoshme juridike të formimit të përgjithshëm dhe procedurale.⁴ Synimi i hartimit të kurikulave të reja mësimore është: përgatitja e programeve dhe moduleve të plota për formimin e punonjësve të policisë, hartimi i një politike të drejtë trajnimi, përgatitjen e programeve dhe moduleve të plota për kualifikimin dhe specializimin e roleve të ndryshme të policisë.⁵ Përgatitja e kurikulave mësimore u bazua:

a) Në grumbullimin e materialeve didaktike, programe mësimore të shkollave homologe policore në vendet e rajonit dhe më gjerë si dhe model programe të afzuara nga misionet policore që janë pranë Policisë së Shtetit si ato ICITAP; PAMECA.

b) Në zbrërthimin e programeve të ndryshme të shkollave policore të cilat u studiuan dhe u bënë objekt diskutimi në grupe, jo vetëm brenda institucionit arsimor por dhe me specialistë të policisë, departamentet në Fakultetin e Drejtësisë⁶ në Universitetin e Tiranës dhe atë të Drejtësisë në Universitetin “Ismail Qemali”; Agjencinë e Akreditimit pranë Ministrisë së Arsimit; pedagogë të shkencave sociale, etj.

c) U morën në konsideratë përgjigjet e pyetësorëve të hartuar për këtë qëllim, për ristrukturimin e procesit arsimor policor, të shpërndarë punonjësve të policisë të roleve dhe niveleve të ndryshme në strukturat e Policisë së Shtetit.

3. Struktura e planit mësimor

Planet mësimore në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, i përgjigjen studimeve në ciklin e parë “Bachelor” për “Sigurinë dhe Hetimin” i cili do të shtrihet në tri vite⁷ akademike me kohë të plotë duke plotësuar numrin e 180 krediteve (ECTS)⁸. Në

⁴ Mandro. I. *Histori dhe Progres*. Tiranë: 2005, faqe 40.

⁵ Po aty.

⁶ Universiteti i Tiranës ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi, pjesë e së cilës është dhe bashkëpunimi ndërmjet fakulteteve.

⁷ Viti akademik ka një shtrirje 30-32 javë mësimore, i ndarë në dy semestra; semestri akademik zgjat 15-16 javë mësimore; java mësimore është pesë ditë (e hënë - e premte); çdo ditë mund të zhvillohen deri në 5 orë mësimi; studenti zhvillon jo më shumë se 25 orë mësimore/javë, në auditor; koha e fillimit, koha e mbarimit, sesionet e provimeve, pushimet e dimrit dhe të festave zyrtare, etj, përcaktohen në kalendarin akademik, i cili miratohet çdo vit nga Ministria e Linjës (Ministria e Arsimit).

⁸ Ndarja e 180 krediteve ECTS, sipas kategorizimit të lëndëve përafërsisht është: formimi i përgjithshëm (bazë), 37 kredite; formimi karakterizues (profes.), 87 kredite; disiplina formuese, të përafërta, 31 kredite; disiplina formuese me zgjedhje 10 kredite; lëndë si, gjuhë e huaj, informatikë, 13 kredite; veprimtari praktike/profesionale 6 kredite; punimi/tema e diplomës, 6 kredite.

përfundim të programit mësimor dhe dhënies në nivelin kalues të 22 provimeve të përcaktuara në planin mësimor, studentët do të diplomohen për nivelin e parë të studimeve “Specialist për Sigurinë dhe Hetimin”. Ky plan /program mësimor në kompleksivitetin e tij plotëson këto objektiva:

- Përvetësimin e koncepteve të policimit demokratik për respektimin e të drejtave të njeriut me etikë profesionale për t'i shërbyer komunitetit sipas standardeve bashkëkohore.

- Njohjen dhe zbatimin e akteve normative që rregullojnë aktivitetin e Policisë së Shtetit e që përcaktojnë procedurat e veprimit policor në role menaxheriale dhe operuese.

- Pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme profesionale shkathtësitë e shprehitë aplikative për realizimin e detyrave policore.

- Studentët marrin njohuritë e nevojshme juridike dhe procedurale për të mbështetur të gjitha veprimet e tyre gjatë punës mbi baza ligjore.

- Studentët të zotërojnë dhe zbatojnë taktikat e metodikat policore në interes të sigurisë e rendit publik si dhe luftën kundër kriminalitetit.⁹

- Nëpërmjet këtij programi synohet të zgjidhen nevojat e edukimit dhe trajnimit të vazhdueshëm të strukturave policore¹⁰, për këtë, kërkohet më shumë profesionalizëm në stafin mësimdhënës.

Ky zhvillim bën të mundur përmbushjen e detyrimeve për dhënie njohurish në kuadrin e një bashkëpunimi policor ndërkombëtar, dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafiqeve kriminale.

4. Parimet dhe kërkesat e programit

Është e rëndësishme të theksohet se i gjithë procesi i hartimit të plan-programit të studimit, akteve që e shoqërojnë atë, kanë në vëmendjen e tyre parimet universale të zhvillimit të arsimit dhe kërkimit shkencor në institucionet akademike publike. Si pjesë e arsimit të lartë publik, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit: afron mundësi të barabarta jo vetëm konkurrimi, por edhe arsimimi, për të gjithë punonjësit e organizatës së Policisë të cilët plotësojnë kriteret¹¹; afron programe të detyrueshme apo fakultative ku mundësojnë marrjen e njohurive në të gjitha nivelet e studimit duke krijuar kushte për integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor; afrohen mundësi që studentët të mësohen nga staf akademik me tituj e grada shkencore, me eksperiencë dhe performancë të lartë në mësimdhënie; afrohen kushte e mundësi që stafi dhe studentët të gëzojnë liri të plotë akademike dhe pavarësi organizative në aktivitetin mësimdhënës, në kërkimin shkencor dhe në zgjedhjen dhe promovimin akademik.

5. Struktura dhe karakteristikat e programit të studimeve¹²

Programi i studimeve “Bachelor” për “Sigurinë dhe Hetimin”, është program studimesh universitare i ciklit të parë, i organizuar dhe vlerësuar në kreditë, sipas “Sistemit

⁹ Mandro, I. *Histori dhe Progres*. Tiranë: 2005, faqe 41.


¹⁰ Programet në këtë fakultet afrohen për struktura të nivelit nënkomsar, komisar, drejtues, drejtues i parë.

¹¹ Kriteret për tu pranuar në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit të ketë përfunduar arsimin e mesëm; të jetë certifikuar për përfundimin e kursit për “Formimin Bazë Policor” apo “Kolegjin e Lartë Profesional në Akademinë e Sigurisë”; të ketë jo më pak se dy vjet në strukturat apo institucionet e Policisë së Shtetit; të ketë marrë pjesë dhe të jetë shpallur fitues në procesin e konkurrimit për pranim në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit.

¹² Programi i Studimeve “Bachelor” për “Sigurinë dhe Hetimin” hartuar nga grupi punës në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit” Tiranë, tetor 2016.

Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve” (ECTS). Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese janë të organizuara në 6 kategori lëndësh, ku kategoritë A, B, C, E, F janë lëndë të detyrueshme, ndërsa lëndët e kategorisë D janë lëndë me zgjedhje. Veprimtaritë formuese, që karakterizojnë plan/programin e studimit “Bachelor” përmendim: mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë); studimi individual (hulumtimi, kërkimi, studimi, punim relacionesh); përgatitje dosjesh hetimore për referim, dosje për vendim e ngjarjes, fillim hetimi paraprak, detyra të ndryshme, përgatitjet e provimeve, përgatitja e tezës së diplomës, etj); veprimtari të tjera, si praktika profesionale dhe vendosja në rol pranë strukturave vendore të policisë.

Ndarja e krediteve sipas kategorisë së lëndëve që zhvillohen¹³ në mënyrë grafike është shprehur më poshtë:



Ndarja e krediteve sipas kategorisë së lëndëve

5.1 Ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese

1. “Formimi i përgjithshëm”, kategoria A.

Nr	Lëndët mësimore	ECT S	Orët mësimore				St. Indiv	Total
			Leks	Sem.	P/Pr	Ng. mes		
1.	Histori e shtetit të së drejtës	4	30	15	0	45	55	100
2.	Shkrim akademik	3	30	15	0	45	30	75
3.	Psikologji komunikimi	4	30	15	0	45	55	100
4.	Hyrje në ekonomi	4	30	15	0	45	55	100
5.	Psikologji ligjore (e krimit)	3	30	15	0	45	30	75
6.	Informatikë	3	15	15	0	30	45	75
7.	E drejta kushtetuese	6	30	10	5	45	105	150
8.	Kriminalistikë 1+2	6	60	30	15	100	45	150
	Total	33	255	130	20	405	415	825

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

2. Disiplinat e "Formimit profesional", kategoria B.

Nr	Lëndët mësimore	ECT S	Orët mësimore				St. Indiv	Total
			Leks	Sem.	P/Pr	Ng. mes		
1.	Njohuri për armët dhe qitje	4	30	15	15	60	40	100
2.	Përgatitje fizike- Vetëmbrojtje 1+2+3+ 4	9	0	0	120	120	105	225
3.	Legjislacioni policor	6	45	15	10	70	80	150
4.	Veprimtaria gjurmuese hetimore	4	30	15	0	45	55	100
5.	Rrjeti informative 1+2	7	45	15	30	90	85	175
6.	Menaxhimi i shërbimeve të Policisë 1+2	7	45	30	30	105	70	175
7.	Informacioni dhe analiza	4	30	15	10	55	45	100
8.	Krimi i organizuar dhe terrorizmi	6	30	30	30	90	60	150
9.	Procedimi Policor	5	30	15	15	60	65	125
10.	Teknikat dhe taktikat e pyetjes	4	30	15	30	75	25	100
11.	Metodat speciale të hetimit	6	45	15	30	90	60	150
12.	Menaxhimi dhe kontrolli i kufirit 1+ 2	6	60	30	30	120	30	150
13.	Menaxhim trafikut sigurisë rrugore 1+2	6	60	30	0	90	60	150
14.	Ruajtja e PLSH-ve	3	15	15	15	45	30	75
15.	Hetimi i krimit ekonomik dhe korrupsionit.	5	30	15	30	75	50	125
16.	Hetimi i krimeve kundër personit e pronës	5	30	15	30	75	50	125
	Total	87	555	285	425	1265	910	2175

3. Disiplina formuese të përafërta, kategoria C.

Nr	Lëndët mësimore	ECTS	Orët mësimore				St. Indiv	Total
			Leks	Sem.	P/Pr	Ng. mes		
1.	E drejta penale (pjesa e përgj.)	6	30	15	15	60	90	150
2.	E drejta penale (pjesa e posaçme)	6	45	30	0	75	75	150
3.	E drejta civile	5	30	15	5	50	75	125
4.	E drejta administrative	4	30	15	0	45	55	100
5.	E drejta procedurale penale	6	30	15	30	75	75	150
6.	Mjekësi ligjore	4	15	15	15	45	55	100
	Total	31	180	105	65	350	415	775

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

4. Disiplina me zgjedhje të studentit, kategoria D.

Nr	Lëndët mësimore	ECT S	Orët mësimore				St.	Total
			Leks .	Sem.	P/Pr .	Ng. mes	Indiv .	
1.	1. Logjikë, 2. Të drejtat e njeriut	4	30	15	0	45	55	100
2.	1. Soc. Konflikti 2. Krimet kompjuterike	3	15	15	0	30	45	75
3.	1. Barazia gjinore dhe ligji; 2. Elementë të së drejtës publike	3	15	15	0	30	45	75
	Total	10	60	45	0	105	145	250

5. Disiplina të komunikimit, kategoria E.

Nr	Lëndët mësimore	ECT S	Orët mësimore				St.	Total
			Leks .	Sem.	P/Pr .	Ng. mes	Indiv .	
1.	Gjuhë angleze 1-2	4	30	30	0	60	40	100
2.	Sistemet informatike policore (SIP)	3	15	15	5	35	40	75
3.	Praktikë profesionale	6	0	0	15	15	135	150
	Total	13	45	45	15	105	220	325

6. Diploma: mikrotezë, kategoria F.

Nr	Lëndët mësimore	ECT S	Orët mësimore				St.	Total
			Leks .	Sem.	P/Pr .	Ng. mes	Indiv .	
1.	Diploma	6	0	0	0	0	150	150
	Total	6	0	0	0	0	150	150
Shuma e përgjithshme e lëndëve sipas kategorive								
	Lëndët mësimore: gjithsej 34	180	1110	605	530	2245	2255	4500

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

201

5.2 Modulet për “Formimin e përgjithshëm dhe juridik”

• “Formimi psikologjik dhe sociologjik”

Psikologji dhe Komunikim, Psikologji ligjore (e krimi), Sociologji konflikti.

• “Formimi i përgjithshëm juridik”

E drejta kushtetuese, Histori e shtetit dhe e së drejtës, E drejta publike Kriminalistikë.

• “Disiplina të formimit penal”

E drejta penale pjesa e përgjithshme, E drejta penale pjesa e posaçme, E drejta procedurale penale.

• “Disiplina komunikimi”

Gjuha angleze, Sistemet informatike, Praktikë mësimore.

• “Formim i përgjithshëm”

Hyrje në ekonomi, Shkrimi akademik.

5.3 Modulet për lëndët e “Formimit profesional”

• “Formim institucional”

Legjislacion policor, Administrimi i informacionit policor

• “Menaxhimi i Sigurisë Publike”

Menaxhimi i shërbimeve policore, Krimi i Organizuar.

• “Hetim krimi”

Rrjeti informativ, Hetim i krimi ekonomik dhe korrupsioni, Teknikat dhe taktikat e pyetjes, Veprimtari gjurmuese hetimore.

• “Shërbimi Policisë Rrugore”

Legjislacioni rrugor, Menaxhimi i trafikut.

• “Kufiri dhe migracioni”

Menaxhimi dhe Kontrolli i Kufirit, Menaxhimi i rreziqeve

• “Aftësi tekniko-taktik, AZ dhe qitje”

Përgatitje fizike dhe teknika vetëmbrojtje, Njohuri për armët e zjarrit dhe qitje, Ruajtja e Personaliteteve të Larta Shtetërore (PLSH).

5.4 Programi i formimit të përgjithshëm (universitar)

Lëndët që trajtohen në këtë program, kanë qëllim, pajisjen e studentëve me njohuri të nevojshme teorike, juridike, sociale dhe ato të komunikimit. Vihet theksi në njohjen e detyrave institucionale, organizimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës, legjislacionin penal e procedural. Në tërësinë e planit mësimor, lëndët e formimit të përgjithshëm ose të formimit universitar, përbëjnë 17 disiplina mësimore me rreth 48,5 % të totalit të orëve mësimore (ECTS) të “Programit të studimeve “Bachelor” për “Sigurinë dhe Hetimin”. Të gjitha këto disiplina zhvillohen që studentët të bëhen të aftë për të mbikëqyrur e zbatuar më korrektesë ligjin, për sigurimin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë ushtrimit të kompetencave për rendin e sigurinë publike dhe në veçanti zbatimin e detyrave procedurale me atributet e funksionit që ka grada policore që ata do të fitojnë.

Lëndët e “Formimit të përgjithshëm”

1. E drejtë kushtetuese
2. Psikologji dhe komunikim
3. Hyrje në ekonomi
4. Sociologji e konfliktit

5. Psikologji ligjore (e krimit)
6. Shkrim akademik
7. Histori e shtetit të së drejtës
8. E drejta civile
9. E drejta administrative,
10. E drejta penale (pjesa e përgjithshme)
11. E drejta penale (pjesa e posaçme)
12. E drejta procedurale penale
13. Kriminalistikë
14. Informatikë
15. Sistemet informimit policor (SIP)
16. Gjuhë e huaj (anglisht/gjermanisht)
17. Të drejtat e njeriut

5.5 Programi i “Formimit profesional”

Lëndët e formimit karakterizues ose profesional, në “Plani/Programin mësimor”, përbëhen nga 16 disiplina mësimore ose 48.3% të numrit të përgjithshëm të lëndëve që përmban ai dhe rreth 50% të krediteve të tërësisë së kreditove që ka programi studimeve “Bachelor”. Lëndët që zhvillohen janë si më poshtë:

Lëndët e “Formimit profesional”

- 1 Legjislacion policor
- 2 Njohuri për armët e zjarrit dhe qitje
- 3 Përgatitje fizike-vetëmbrojtje
- 4 Veprimtaria gjurmuese hetimore
- 5 Rrjeti informative
- 6 Menaxhim trafiku
- 7 Ruajtja e personaliteteve të larta shtetërore
- 8 Procedimi policor
- 9 Menaxhimi i shërbimeve të Policisë
- 10 Informacioni dhe analiza
- 11 Menaxhimi dhe kontrolli i kufirit
- 12 Teknikat dhe taktikat e pyetjes
- 13 Metodatat speciale të hetimit
- 14 Hetimi i krimeve k/personit e pronës.
- 15 Hetimi i krimit ekonomik/korrupsionit.
- 16 Krimi i organizuar dhe terrorizmi.

Qëllimi kryesor i këtij grupi lëndësh është që të përgatisë studentin me njohuri profesionale bashkëkohore, aftësi vepruese, për të gjitha shërbimet e policisë, të fushës parandaluese dhe të mbikëqyrjes policore; për mënyrat e marrjes, administrimit dhe trajtimit të informacionit; për inteligjencën, investigimin sigurinë dhe hetimin e krimeve; për zotërimin e teknikave dhe shprehive vetëmbrojtëse, e deri te aftësitë organizative e menaxheriale në atributet që do t’i përcaktoj roli i tij.

5.6 Praktika profesionale

Është element tjetër i detyrueshëm mësimor i vlerësuar në përgatitjen e studentit. Është menduar që në shtrirjen programore ky element të përkohet me kohën e përgatitjes dhe paraqitjes së punimit të diplomës pra do të jetë fund të semestrit të gjashtë mësimor.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

Programi i praktikës profesionale, është ndërtuar kryesisht për të vënë studentët në rol në të gjitha shërbimet që kryejnë strukturat policore vendore, me qëllim aftësimin e tyre në veprimtarinë praktike duke gërshetuar njohuritë profesionale teorike me ato praktike. Praktikata zhvillohen në strukturat vendore të policisë, në komisaritet dhe sektorët e drejtorive vendore, nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti përkatës. Si komponent mësimor dhe praktika ka vlerësim me notë dhe kreditë.

5.7 Trajnimi vazhdues

Pa hyrë në hollësi të vazhdimësisë së trajnimeve policore, për të gjithë ata që duan të dinë se si do eci në karrierë një punonjës policie në mënyrë skematike po jap një informacion. Trajnimi i strukturave të policisë është një sistem i të mësuarit gjatë gjithë jetës. Trajnimet zhvillohen me programe të detyruara për gradë dhe nivel. Këto programe përgatiten nga struktura në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit dhe shpërndahen në policitë vendore për zbatim. Zhvillimi i tyre ndiqet dhe monitorohet nga specialistët e trajnimeve që ndodhet në çdo drejtori. Trajnimet bëhen dhe për dhënë njohuri të thelluara në një fushë të caktuar si atë të terrorizmit, këqyrjen e vendit të ngjarjes, dhunës në familje trafikimit etj., por strukturat përfituese, paraqesin kërkesat e tyre çdo fund viti për të zhvilluar trajnime me punonjësit e tyre. Për vitin që po diskutojmë janë kryer 113 trajnime dhe janë trajnuar 2477 specialistë nga struktura të ndryshme të policisë së shtetit. Lidhur me metodologjinë e trajnimit, ekspertët/moderatorët e trajnimit vazhdues:

- zhvillohet një metodë interaktive trajnimi ku auditori do të trajtohet si partner.
- bëhet përpjekje për të ruajtur një ekuilibër mes trajtimit teorik dhe praktik të çështjeve objekt diskutimi.
- bëhet kujdes për ndërhyrje konstruktive, të shpërndara dhe jo dominuese, duke i lënë hapësirë të bollshme diskutimeve nga pjesëmarrësit.

5.8 Aftësimi mësimdhënies dhe procedurat e përzgjedhjes së stafit pedagogjik

Të gjitha këto procese nuk mund të realizohen pa një trajnim e zhvillim profesional të vetë stafit pedagogjik. Reforma institucionale arsimore policore kërkon që çdo pedagog të zotërojë aftësi bashkëkohore të mësimdhënies. Këto aftësi do t'i perfeksionojë duke ju nënshtruar kurseve trajnuese për mësimdhënien. Pasi Dekanati vlerëson nevojat e tija për pedagogë në bashkëpunim me strukturat e Akademisë së Sigurisë, fillon procedurat e përzgjedhjes. Çdo kandidat për pedagog duhet të plotësojë një procedurë të parashikuar në Rregulloren me Kriteret e dhe Procedurat e Përzgjedhjes së Pedagogëve. Procedura kalon në disa faza si ajo e pranimit të dokumentacioni, vlerësimi i tyre, intervistimi. Gjithashtu në kapituj të veçantë janë identifikuar kriteret e çdo pedagogu për departamentet konkret. Përmendim këtu notën mesatare jo më pak se 9 për dy vitet e studimit të njëpasnjëshme dhe mesatarja e lëndës që do të aktivizohet 10. Por synimi i këtij fakulteti shkon edhe më tej në atë të zhvillimit të sistemi arsimor në nivelin e dytë të studimit atë të "Masterit Profesional" në fushën e Hetimit dhe atë të Sigurisë. Këto programe synojnë të plotësojnë formimin e kandidatëve për t'u përfshirë në sektorë ku kërkohen njohuri të posaçme në drejtim të zbulimit dhe hetimit të krimeve apo ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike. Aftësimi dhe specializimi i mëtejshëm i studentëve në fushën e studimit të këtij MP synon në veçanti:

- Fitimin e njohurive të thelluara në fushën e hetimit dhe zbulimit të krimeve apo ato të ruajtjes dhe sigurisë publike.

- Aftësimin e studentëve në këtë nivel për të vlerësuar dhe trajtuar çështje me karakter juridik dhe profesional në kuadrin e veprimtarisë dhe funksionimit të organeve të hetimit dhe procedimit.

- Aftësimin e studentëve në analizimin, interpretimin dhe dhënien e zgjidhjeve të përshtatshme të çështjeve juridike të përgjithshme dhe të veçanta.

- Thellimin e aftësisë për të punuar në grup duke shfaqur një shkallë të lartë autonomie dhe përgjegjësie, personale dhe profesionale, në koordinim edhe me operatorët e tjerë profesionalë ndërveprues.

Çfarë duam të arrijmë me këtë sistem arsimor policor? Përfundimi me sukses i programit mësimor, krijon një brez specialistësh me nivel i lartë kulturor njohuri të plota shoqërore, juridike, për ushtrimin e kompetencave dhe attributeve që i jep ligji; formim profesional për kryerjen e detyrave në fushën e rendit dhe të sigurisë publike dhe për ushtrimin e kompetencave procedurale në fushën e hetimit të krimit; një sistem të qëndrueshëm vlerash morale, cilësish të personalitetit e karakterit të tij të krijuara; aftësi për të menaxhuar stresin në situata kritike; njohuri të plota për legjislacionin që rregullon veprimtarinë e tyre, për të drejtat dhe përgjegjësitë, për teknikat e ndërhyrjes, kontrollit, vetëmbrojtjes etj.; aftësitë e shprehitë aplikative për realizimin e misionit dhe detyrave të shërbimit policor; njohuri të plota për aplikimin e metodave e teknikave bashkëkohore në luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve të ndryshme, terrorizmit etj; aftësitë menaxhuese e drejtuese për shërbimet ekzekutive ndaj kontrollit të territorit, kufirit, qarkullimin rrugor, shërbimeve të emergjencës, etj.; shprehitë për veprimtari studimore e kërkimore të pavarur në fushat e policisë etj.

6. Përfundime

- Krijimin e një shkolle të fortë me nivel universitare të mirëpritur dhe në shërbim të komunitetit.

- Krijen e nivelit profesional policor, juridik të studentëve si rrugë e vetme e ngritjes profesionale të punonjësve në organizatën e Policisë.

- Shkëputjen nga metodat arkaike “mësuesi flet dhe studenti dëgjon”.

- Format kryesore të punës mësimore të jenë interaksioni, ushtrimet, treguesit në terren, praktikat profesionale, detyrat, testimet.

- Formimi i shprehive aplikative të vetëmbrojtjes, armëve e qitjeve për studentët të jetë në nivelet maksimale të mundshme.

- Krijimin e një baze të fortë mbështetëse logjistike për procesin mësimor-garanci kjo për një proces pa kthim.

Literatura

1. Kasimati, M. dhe Manxhari, M. *Sjellje organizative*. Tiranë: 2002
2. “Udhëzues për vlerësimet e brendshme të cilësisë në Arsimin e Lartë”, Tiranë 2002.
3. Musaraj A. *Sjellje organizative*. Tiranë: 2003.
4. Policia e Shtetit Shqiptar, sistemi i menaxhimit total të trajnimeve. Plan veprimi 2005-2006 (Mision Policor ICITAP).
5. Myers, David G. *Socialpsikologjia*. Tiranë: EUGEN 2003.
6. Mandro, I. *Histori dhe Progres*. Tiranë: 2005.
7. Aspekte të vetëvlerësimit të cilësisë në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari” Tiranë: 2005.
8. Mandro I. *Kurikulat për formimin e punonjësit të policisë Shqiptare*. Tiranë: 2006.
9. Programet e studimit “Bachelor” për “Fakultetin e Hetimit të Krimit”, Tiranë, shtator 2015
10. Programet e studimit “Bachelor” për “Fakultetin e Sigurisë”, Tiranë, shtator 2015
11. Programet e studimit “Bachelor” për “Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit”, Tiranë, tetor 2016.

Polici i së nesërmes – arsimimi

Prof. Asc. Dr. Stavri SINJARI

Akademia e Sigurisë
stavri.sinjari@asp.gov.al

Dr. Aurel KOROCI

Albanian University
aurelkoroci@hotmail.com

Abstrakt

“Personi i paarsimuar e percepton veten vetëm si fenomen individual, personi pjesërisht i arsimuar e percepton veten si shembull, dhe personi i arsimuar si përjashtim”

~ Franz Grillparzer¹

Polici duhet të jetë njeri i shkëlqyer, i qytetëruar, i kulturuar dhe mbi të gjitha i arsimuar. Në të gjitha profesionet, pranohet si një aksiomë që s'ka nevojë për vërtetim, arsimimi si një kusht bazë i aftësisë, i rritjes së cilësisë dhe qëndrueshmërisë profesionale. Ky postulat është konfirmuar gjatë gjithë historisë së policimit dhe është në raport të drejtë me përgatitjen e punonjësve të rinj të shërbimit policor, të luftës ndaj krimit, forcimit të rendit e sigurisë publike. Ndryshimet e arritura në shërbimin policor, kanë sjellë një stad të ri, pragun e një hopi cilësor që ve para drejtuesve, specialistëve, studiuesve dhe ligjvënësve një sfidë, sfidën e të nesërmes. Kjo sfidë kërkon përgjigje të sakta për një sërë pyetjesh, e deri tashmë retorikash, të cilat duhen shtruar me kujdes, duhen hulumtuar e venë në jetë shpejt, sigurt e pa hezitim: “Ku jemi, çfarë e deri ku kemi arritur, ç’duhet të bëjmë për të ardhmen?!”. Problemet shtrohen për të gjithë, në të gjitha fushat e formimit dhe shërbimit policor, sidomos në lëmin e arsimimit e trajnimit profesional, si një kusht i padiskutueshëm ose “çelësi i artë” i zgjidhjes së të gjitha problemeve, që hap për policinë portën e së ardhmes.

AKADEMIA
E SIGURISË

Fjalëkyçe:

arsimi policor, sistemi i Bolonjës, program “bachelor”, cikle studimesh, kredite.

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit»

1. Hyrje

*“Ndryshimi midis shkollës dhe jetës:
në shkollë mëson dhe pastaj testohesh, në jetë testohesh dhe pastaj mëson”²*

Në hyrjen e statutit të Akademisë së Sigurisë (AS), në rregulloren e dokumente të tjerë të saj, qartësohet AS-ja si një Institucion i Arsimit të Lartë Publik (IAL), që synon arsimimin e punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të institucioneve të tjera ligjzbatuese. Misioni i AS-së është: “Të zhvillojë e transmetojë dijet me anën e mësimdhënies e të kërkimit shkencor, në fushën e rendit dhe sigurisë, për përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera ligjzbatuese.”³

Ky mision përmban qëllimin kryesor të një institucioni të lartë arsimor, përgatitjen, arsimimin e kualifikimin e policëve dhe drejtuesve policor në të gjithë rangjet e piramidës së gradave, formën e mjetet e realizimit nëpërmjet përcimit të dijeve sa më të thella e bashkëkohore dhe konkretizimit të punës së pavarur kërkimore shkencore në fushën e sigurisë. Përbushjes së këtij misioni kaq të lartë, i shërben struktura e Akademisë, stafi e sistemi arsimor i përzgjedhur dhe programet e hartuara. Aktualisht ky mision përmbledh dy ciklet, “Bachelor” e “Master”, pa përjashtuar mundësinë, që në një të ardhme sa më të afërt, të promovohet edhe cikli i tretë, ai i doktoraturës në polici ose, e thënë ndryshe, doktoratura në sigurinë publike. Mbyllja e vitit të parë për dy programet, i “Sigurisë Publike” dhe “Hetimit të Krimit”, provoi në praktikë efikasitetin e AS-së,

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

¹ Franz Seraphicus Grillparzer (1791 -1872) shkrimtar dramaturg Austriak . Marrë nga: http://www.brainyquote.com/quotes/authors/f/franz_grillparzer.htm

² Ramiz Karaeski. Marrë nga: <http://www.thenie.net/thenie-nga-ramiz-karaeski>.

³ Statuti i Akademisë së Sigurisë, në, Neni 1. Misioni, (2015), 5.

veçanërisht të planeve mësimore. Vlen të theksohet se kurrikula e ciklit të parë “Bachelor” është produkt origjinal, një punë e vërtetë shkencore, që mban vulën “Made in AS”, e hartuar dhe e realizuar prej stafit të brendshëm të saj. Por jo vetëm kaq. Aktualisht janë në proces miratimi dy programe të ciklit të dytë – “master profesional” po në të njëjtat fusha, të sigurisë dhe hetimit të krimit. Po hartohen edhe programe të tjerë të ciklit të dytë, MSC e MSP, mbi bazën e kërkesave dhe kapaciteteve të Policisë së Shtetit. Në to gjen shprehje e sintetizim jo vetëm përvoja e kaluar nga ish-Shkolla e Lartë apo Akademia e Policisë, por edhe modelet e akademive simotra rajonale e padyshim gjejnë reflektim, synimet e objektivat tona për të ardhmen.

Viti i parë, i cili sapo u mbyll⁴, na jep mundësinë të analizojmë, të krahasojmë, të perfeksionojmë, çfarë kemi arritur në raport me atë që kemi si pikësynim të arrijmë prej AS, prej nga, shkurt, synimet e detyrat tona mund t’i përmbledhim në këto drejtime:

- a. një arsimim sa më të plotë të studentëve, aftësi teorike dhe shprehje praktike;
- b. të përçojmë tek ata, mendimet, idetë e arritjet më të larta të kohës, në fushën e sigurisë publike dhe të luftës ndaj krimit;
- c. formim të specialistëve të ardhshëm të policisë, me një kulturë të denjë, me cilësi e qytetari evropiane.

Realizimi i objektivit të madh, një produkt pjesë te programet reformuese institucionale të vendit, për të arritur një polici elitare, model në rajon e më gjerë, një objektiv i vështirë, ambicioz e largpamës që kërkon mbështetje të gjithanshme institucionale, morale, ekonomike, është një program i madh më vete, përmbushja e të cilit përmirëson jo thjesht performancën e Policisë së Shtetit, por vetë shtetin, administratën publike, konceptin e rendit, ligjit, luftës kundër krimit e korrupsionit e më tej të sigurisë publike. Objektivi i policisë elitare do të ketë suport të fuqishëm efikasitetin e reformave në drejtësi, se drejtësia e fortë kërkon një polici të standardeve të larta, dhe policia e fortë bëhet me policë të aftë, të kulturuar e të arsimuar profesionalisht. Pikërisht arsimimi i policisë, është pjesa e detyrës sonë, për formimin e një policie elitare në dije, me njohuri profesionale të thella e të shumanshme, me kulturë e qytetari evropiane. Le të shohim rrugën e disa nga hapat që duhen hedhur në të për të arritur në objektiv.

2. Sistem arsimor policor i gjithanshëm e bashkëkohor

“Një nga problemet më të mëdha të kohës sonë është se shumë janë të shkolluar, por pak janë të arsimuar”⁵

Akademia e Sigurisë, për nga sistemi arsimor, shënon stadin më të lartë (sigurisht, jo të fundit!) të një shkollë të lartë policore në vendin tonë. Kemi përzgjedhur Sistemin e Bolonjës⁶, tashmë i përqaftuar nga shumica e IAL-ve në Shqipëri si dhe nga shumica e vendeve të BE-së. Pavarësisht ndonjë zëri të veçantë korrektues për disa dobësi të këtij sistemi, - kam parasysh autoritete në plan evropian, - mendoj se kjo zgjedhje ishte zgjidhja më e mirë dhe më e përshtatshme e AS-së, për krijimin e një sistemi arsimor

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

“Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit”

⁴ Nga “Analizat vjetore të AS-së dhe Departamenteve”, 2016.

⁵ More, Thomas. Marrë nga: <https://www.goodreads.com/author/quotes/3063220>.

⁶ “Sistemi Bolonjës”-sistemi i unifikuar arsimor Eu, në Bolonjë, me rastin e 1000 vjetorit të këtij Universiteti. Për më tepër shih adresat: https://aab-edu.net/downloads/02_2009_08_kle_Jt01.pdf, <http://www.aal.edu.al/dokumente/legislacioni/Ligji%20i%20Arsimit%20te%20larte%20i%20azhornuar.pdf>

bashkëkohor në fushën specifike të sigurisë dhe hetimit të krimit. Mendojmë se e kemi të nevojshëm dhe më efikas këtë sistem arsimor:

Së pari, sistemi është mjaft i adoptueshëm dhe fleksibël, për t'iu përshtatur nevojave aktuale të formimit policor. Kemi një profil ndryshe nga universitetet e shkollat e tjera të larta; kemi përvojë akademike të trashëguar nga shkollat e mëparshme⁷, janë bërë ndryshime në format e metodat e punës në terren, në teknikë e teknologji e mbi të gjitha në mentalitet - të cilat duhet që të përfaqesin me ndryshimet e evoluimit që shoqërojnë e pasurojnë procesin e policimit.⁸

Ky sistem formues akademik, mund të përshtatë më mirë atë çka është arritur nga ne si shkollim policor, me synimet që na imponon e ardhmja, zhvillimi e integrimi evropian, që shprehet më së miri në Kartën e Bolonjës⁹ ku shprehimisht garantohet që... *“arsimi i lartë dhe sistemet e kërkimit duhet që në mënyrë të vazhdueshme të adaptohen në përputhje me ndryshimet e nevojave dhe kërkesave të shoqërisë si dhe me ndryshimet e ardhura si pasojë e zhvillimit të shkencës në tërësi”*. Prandaj, këtyre ndryshimeve relativisht të thella që janë bërë në shoqërinë tonë, që sidomos kanë përfshirë policinë, në momentet e tanishme pritet të hedhin disa hapa njëherësh, hapin e parë në diplomën “bachelor” si edhe hapin e dytë, me ciklin e masterave në siguri dhe hetim krimi, si “master profesional” dhe “shkencor”, për të cilat më mirë e më me efikasitet, mund t'i përgjigjet modeli aktual, i Bolonjës.

Së dyti, është i nevojshëm një sistem akademik që lidhet më mirë me natyrën e formimit policor, me misionin e detyrat profesionale që ngarkohet të kryejë ky shërbim. Edhe nëse kemi arritur apo do arrijmë në atë pikë që polici të jetë një punëtor social, ashtu siç duhet të jetë në një shoqëri moderne e demokratike, përsëri ky shërbim do i ruajë veçantitë e specifikën e vet. Në punën e përditshme të policisë do të mbeten disa gjëra të disiplinuar apo të themi në thonjëza -“ushtarake”, të huazuara që në origjinën e lindjes së saj, por edhe të domosdoshme për natyrën e këtij shërbimi publik. Këto duhen njohur e pasur parasysh në procesin e hartimit të programeve mësimore dhe në mësimdhënie. Shërbimi policor dallohet ndjeshëm nga shërbimet e forcave të armatosura, prej përmbajtjes së këtyre shërbimeve, detyrave kushtetuese, etj. Por edhe në sistemin e shërbimit policor mbetet e domosdoshme hierarkia e sistemit të gradave, për rrjedhojë edhe uniforma. Piramida policore, sikurse ushtarake, domosdoshmërisht kanë të përbashkët një disiplinë specifike, ndryshe nga disiplina rutinore e administratës civile¹⁰. Policët në raste të caktuara i nevojitet përdorimi i armatimit për kryerjen e detyrës, i duhet ligjërisht urdhri i eprorit për të vepruar në situata të veçanta, njohja e mirë e ligjit dhe procedurave në kornizën e të cilave duhet të vetëveprojë¹¹. Për rrjedhojë pra, disa disiplina mësimore ndonëse me volum jo të madh, duhet të kenë peshë e zgjatje në vite, siç janë lëndët e “bachelor”-it: përgatitja fizike, vetëmbrojtja e përdorimi i armëve të zjarrit, dhënia a ndihmës së parë, legjislacioni policor e administrimi i

⁷ Për më tepër shih, *ShLMB* (1971-1992); *ARP* (1992-2000); *AP* (2000-2009); *AS* (2015).

⁸ Policimi ~ shih: *Fjalor Terminologjik*, Tiranë: 2005, f. 95.

⁹ *Deklaratë e Përbashkët e Ministrave të Arsimit të Evropës*, 18-19 qershor 1999.

Marrë nga: http://reformanedrejtjesi.dmcs-online.com/sites/default/files/deklarata_e_bolonjes_0.pdf

¹⁰ Bilbil Memaj, *Lidershipi në Policinë e Shtetit* (Tiranë: KRISTALINA - KH, 2016), 25-34.

¹¹ *Ngjarjet e fundit terroriste në Francë, Belgjikë*, etj., kanë detyruar disa vende të EU të armatosin policinë.

Për më tepër shih:

<https://www.thesun.co.uk/news/1502957/armed-french-police-in-trunks-protect-holidaymakers-over-fears-of-isis-beach-attack>,

<http://www.telegraph.co.uk/news/2016/06/28/armed-police-lifeguards-to-guard-french-beaches-amid-terror-fear>.

dokumentacionit; lëndët me njohuri specifike në fusha të ndryshme: si informatikë, juridik, logjikë, komunikim e deri lëndë të formimit të përgjithshëm, si, sociologji komunitare, policimi, mbi të drejtën, psikologji, etj.

Së treti, policia si mjaft shërbime të tjera publike, është aktivitet me profil shumëprofesionësh, ka natyrë shumëdimensionale, sikurse politika, mjekësia, administrimi publik, punonjësi social, - në të cilat disa shkenca e disiplina të veçanta ndërthuren, shkrihen e marrin pjesë në formimin e plotë të profesionit të politikanit, mjekut, administratorit, e deri diku të vetë juristit, etj. Prandaj, më tepër i mëshoj idesë se, më i përshtatshëm është ai sistem shkollor që skajshëm një e respekton hierarkinë e cikleve formuese arsimore. Këtë e mishëron më mirë sistemi i Bolonjës me “3+2”-shin që shprehet me njohjen e shumë niveleve e programeve, sasinë e fituar e të transferueshme të ECTS-ve për çdo individ e hierarkinë e diplomave, - siç është diploma e thjeshtë e ciklit të parë “bachelor”, e ciklit të dytë “master”, shkencor ose profesional, e në nivelin më të lartë, deri “doktoraturë” në polici ose cikli i tretë, ai përmbyllësi. Kështu, Akademia do të mundë të shkollojë e arsimojë më mirë policë me grada të llojeve të ndryshme, nga inspektor, nën/komisar, e deri oficerë e drejtues të lartë të Policisë, nëpërmjet përfundimit në kohë e me kredite të këtyre cikleve, të cilët janë përmbyllës të një stadi e jo, asnjëherë përfundimtarë. Parimi kryesor i këtij sistemi është aksioma “*mësimi vazhdon gjithë jetën*”.¹² Prandaj sistemi akademik i Bolonjës, i implementuar në AS, lejon, koordinon e stimulon njohjen e vazhdimësinë e kurseve, trajnimeve, diplomave e lëndëve, nëpërmjet njohjes e transferimit të diplomave e njohurive, duke i lenë gjithmonë hapur dyert e kualifikimit e specializimit të mëtejshëm për çdo individ që ka fituar ose nëse dëshiron të fitojë profilin e policisë¹³.

Së fundi, synimi më i lartë i AS-së është jo thjesht shkollimi, por arsimimi policor. Ndryshimi midis këtyre koncepteve është i njohur e duhet pasur parasysh. Shkolla është pjesë e jetës, edukim që të aftëson në drejtime të caktuara me shprehje e profesion. Nga ana tjetër vet jeta është një shkollë, që të jep përvojën, praktikitetin po kaq të nevojshëm. Pra, shkolla të jep dije që të drejtojnë në veprimet praktike, por që të jesh i arsimuar do të thotë diçka më tepër. I arsimuari ka dije të thella, të qëndrueshme, që di t'i shndërroj këto dije në vegla e mjete individuale, që mund t'i përdorë ato më mjeshtëri në zgjidhjen e çdo problemi e daljen nga çdo situatë. Shkurt, njeriu i arsimuar është më i lirë sesa njeriu i zakonshëm. Pra si kudo, edhe në polici, të jesh i shkolluar nuk do të thotë gjithmonë se je i arsimuar.

I shkolluar do të thotë se ke bërë një shkollë, ke marrë një diplomë, mbase më shumë se një dhe, asgjë që të veçon në detyrë e aftësi; të jesh i arsimuar, do të thotë shumë më shumë, do të thotë - të dish, pra të jesh i ditur në profesion, të menaxhosh e të zgjidhësh problemet në rend e siguri; të dish të ambientohesh në çfarëdo shtate, të krijosh, - edhe pse situatën që po ndeshesh nuk e ke hasur në përvojën e programet që ke bërë në shkollë. Nëse ke venë në provë dijet e tua e ke krijuar bindjen se Akademia e Sigurisë të ka dhënë më shumë se një diplomë, ke fituar një dhunti, aftësinë e të kuptuarit thellë dhe të zotërimit të çdo shtate, atëherë mund të thuash se AS-ja të ka dhënë arsimim, atëherë, ti je i arsimuar! Të jesh i arsimuar, do të thotë se di më tepër se

¹³ Sigurisht që nuk është proces kaq i thjeshtë sa duket, dalin mjaft probleme. Për shembull, problem që duhet zgjidhur, sipas metodës “step by step”, mendojmë se do të jetë problemi i harmonizimit të raportit shkollim / ngritje në grada, hierarki e në detyrë. Për më tepër shih:
http://study.com/how_to_become_a_police_officer.html,
<http://www.camdencc.edu/policeacademy/inservicereg.cfm>

mësimet e mara nga programi shkollor, di të shtosh pareshtur dijet e fituara në shkollë, ke fituar aftësinë e të kuptuarit thellë të gjërave, je kritik ndaj formave të vjetruara që pengojnë ecjen, kupton që nuk qëndrohet në vendnumëro, por kërkon e provon vet të ndryshosh gjërat në sensin e zhvillimit e progresit. Mbetet plot kuptim përcaktimi: *“Person i arsimuar është vetëm ai i cili ka mësuar se si të ndryshojë.”*¹⁴

Këtë duhet të synojmë e duhet të arrijmë, në profilin e policit të ardhshëm, të dalë nga AS-ja. Këto parime duhet të na udhëheqin në misionin tonë mësimdhënës në Akademinë e Sigurisë. Po të njëjtat parime, vlejnë për cilindo nga studentët e studiuesit e akademisë. Synimet ambicioze kanë në themel parime të larta, të njohura e të provuara nga përvoja e gjithë njerëzimit, sidomos nga historia europiane e shkollimit dhe arsimit të elitave edhe në fushën e policisë, e cila për ne është një udhërrëfyes në rrugën e integritit.

3. Arsimimi – pjesë e sigurisë dhe e jetës

*“Po të mos ishte padrejtësia, drejtësisë as që do t’ia dinim emrin”*¹⁵

Si më sipër theksuam, prej shumë kohësh është e njohur thënia e urtë se shkolla është pjesë e jetës dhe vetë jeta një shkollë e madhe. Asnjë, as profesioni më i thjeshtë sot, nuk mund të mësohet e të ushtrohet pa shkollë. Testimi, trajnimi, formimi e kualifikimi profesional, janë e do të mbeten format kryesore të pazëvendësueshme të AS-së e kolegjit të saj për përgatitjen e policisë në çdo hap të hedhur pas hapit të parë. E nëse vetëm testi mbetet hapi i parë që të hap portat e policisë vallë, sa efikase është një provë e tillë për të bërë polic të përzgjedhurin nëpërmjet testeve e konkurseve, e po kështu të përzgjedhurit nga lartësia e stekës për pranimin në “Bachelor”? I gjithë ky proces, nuk është matur ende dhe s’mund të themi se është më i mirë apo efikas, sepse pranohet si çdo aksiomë, - pa vërtetim. Si gjithë IAL-të edhe AS-ja udhëhiqet nga ligji i AL dhe rregulloret e udhëzimet e MAS-it e Policisë së Shtetit. Si të thuash, kandidatët e policisë, renditin në rastin më të mirë, kërkesat e tyre krahas të tjerave për shkollë të lartë, por në rastin më të keq, në një stad më të vonshëm, kur u janë djegur shpresat për degë tjetër e shkollë të lartë. Po këta do të jenë pas një ose dy vjetësh studentët e Akademisë. Rrjedhimisht, i mbetet AS-së ajo çka ka mbetur, madje me stekë të ulur në minimumin e mundshëm. Prandaj, kriteret e pranimit apo prurjet duhet të sinkronizohen me kohën, me kërkesat, me mundësitë. Duhet gjetur mënyra për tërheqjen e kandidatëve nga pjesa elitare e nxënësve të shkollave të mesme apo të larta. Ekziston mundësia, sikurse edhe përvoja.¹⁶ Ky tregues, është njëra anë e binomit prurje-dhënie, pra niveli i kandidatëve, studentëve, “lënda e parë” që përcakton njërin anë të cilësisë. Duhet vlerësuar edhe faktori tjetër, - jo prurës, por dhënës - pra, “çfarë mund t’u japim studentëve të rinj?”, ku si tregues janë niveli pedagogjik e shkencor i mësimdhënësve, niveli i lëndëve e programeve, shtrirja në kohë, semestra e vite mësimore. Këto dy anë të produktit “punonjës i sigurisë dhe hetimit” me diplomë “bachelor”, janë kryesorët që

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

¹⁴ Carl Ransom Rogers, psikolog amerikan (1902-1987). Marrë nga: <http://www.brainyquote.com/quotes/quotes/c/carlrogers130364.html>

¹⁵ Herakliti, filozof grek. (576-480 BC). Marrë nga: <http://www.brainyquote.com/quotes/quotes/h/heraclitus162902.html>

¹⁶ Stavri Sinjari dhe Sofokli Duka, “August Uollmer – “babai” i policisë moderne amerikane,” *Revista periodike shkencore Policimi dhe Siguria*, (2016): 8-15.

duhen analizuar për të siguruar një arsimim të mirë, të sigurt e të vlefshëm në praktikë nga radhët e policisë. Kolegji është një zgjidhje që e amortizon disi edhe këtë problem por mendojmë se duhet shoqëruar me masa të tjera shoqëruese, të cilat i kemi parasysh dhe i ndjekim me kujdes.¹⁷

Po të analizojmë hapin e parë, prurjen nga jeta civile e më pas nga kolegji profesional i policisë, pavarësisht nga programet apo metodat, diversiteti e shkallëzimi në formim e vlerësim do të jetë i pashmangshëm. Asnjëherë nuk mund t'i presim studentët në të njëjtën masë, do të ketë studentë të dobët, të nivelit të mesëm e fare pak të shkëlqyer. Po këta, me ndryshime të vogla nga rezultatet në shkollë, përgjithësisht të tillë "rankim" do të kenë edhe kur të jenë me uniformë.

Pra, studentët më të mirë në Akademi kanë më tepër gjasa të jenë punonjës më të mirë policie.

Diversiteti i tillë është i natyrshëm dhe vlerësojmë si drejtime më përcaktuese:

a. Dëshira, dashuria për profesionin e policit.

Kontingjentet që do vinë të mos jenë "të mbetur" që më tepër i shtyn nevoja ekonomike e detyrohen t'i futen konkurrimit e kalimit të testeve sa për një shkollë që s'i lë pa punë. Duhet të ekzistojë në thellësi të konkurrimit dëshira, nxitja për profesionin e policit. Duhet gjetur forma të reja testimi, më të shtrira në kohë për njohjen e dëshirave e aftësive të kandidatëve. Mund të ndihmonin rekomandimet, kurset verore me të rinj-kandidatë të ardhshëm të radhëve të policisë. Njerëzit e mëdhenj që themeluan e modernizuan policinë e kanë konsideruar si themelore thirrjen në polici, e shihnin si gjënë më të shenjtë, ku duhet "të thirren të shërbejnë njerëzit më të shkëlqyer të atij vendi"¹⁸. Këto risi ende nuk mund të aplikohen e kultivohen te kandidatët e sotëm, të cilët janë lënda jonë e parë në akademi, por duhet të diskutojmë e të hedhim disa ide e disa piketa të së ardhmes.

Aktualisht, tërheqja në programet e ciklit të parë, në pjesën më të madhe ose krejtësisht¹⁹, është më tepër si një detyrim, që lind mbi bazën e interesave për një gradë më të lartë, rrjedhimisht një rrogë e detyrë më e lartë se sa një ambicie mbi bazën e dëshirës së mirë, për të mësuar e shërbyer për Policinë e Shtetit Shqiptar. Nga ana tjetër vet përzgjedhja nga prurjet, duhet të bazohet në filozofinë e zgjedhjes së njeriut të aftë, të vullnetshëm, të drejtë, ku të përfshihen në të parimet etike²⁰ krahas njeriut të mençur e të zgjuar. Kjo kërkon perfeksionim të pandërprerë të metodave të testimit, me efikasitet, duke i dhënë rëndësi testeve psikologjike²¹ e atyre të kapacitetit intelektual.

b. Aftësitë e të nxënit, vullneti për të studiuar.

Edhe ky mbetet të merret në konsideratë si një tjetër faktor i diversitetit në cilësi. Si problem është në radhë të parë individual, por ka lidhje me brezat, traditën, gjendjen arsimore, familjen, me një sërë kushtesh të tjera psikologjike e shoqërore. Është detyrë e çdo shkolle, vlerësimi e përshkallëzimi i nivelit të përvetësimit të dijeve. Përgjithësisht këtë e kryen çdo lloj sistemi arsimor i përzgjedhur. Meqenëse në sistemin e Bolonjës, nivelet e diplomave, shkallëzohen në ciklet e studimit, nga diploma e thjeshtë Bachelor

¹⁷ Kolegji do të diferencojë më saktë e më shpejtë pjesën cilësore-kandidatë për AS.

¹⁸ August Uollmer, konsiderohet "babai" i Policisë Moderne Amerikane. Për më tepër, shih: Stavri Sinjari dhe Sofokli Duka, "August Uollmer - "babai" i policisë moderne amerikane," *Revista periodike shkencore Policimi dhe Siguria*, (2016): 8-15.

¹⁹ Kriteret e pranimit në "bachelor" në Polici, kërkojnë përvojë pune në polici.

²⁰ *Albert Peel*, politikan anglez dhe hartuesi i 9 parimeve etike të policisë. Për më tepër shih adresën: http://www.nytimes.com/2014/04/16/nyregion/sir-robert-peels-nine-principles-of-policing.html?_r=0,

²¹ Mbase edhe makina e së vërtetës do të luante rol të veçantë gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatëve.

te MSC, e krahas tyre MSP, në dy nivele, me 60 dhe 120 ECTS, e më pas doktorimi me 180 kredite, ky shkallëzim ka mundësinë e njohjes më të detajuar²² të dallimeve në njohuri, bën më mirë një stratifikim të nivelit të dijeve të secilit individ gjë që duhet të reflektohet në emërimet në polici, ku zëri i AS-së të jetë deri përcaktues në llojin e shërbimit që mund ti ofrohet çdo studenti²³.

Në ç'kuptim duhet ta themi këtë? Jo në kuptimin e mënjanimin të strukturave të tjera, por në një ndryshim pozitiv të rolit të akademisë në këtë proces, një rol më aktiv e vendimmarrës. Mos harrojmë, "3+2" vjet në akademi janë kaq shumë sa, studentin e akademisë, nuk mund ta njohin më mirë as familjarët e as t' afërmit, se sa pedagogët e shokët e vet në këtë shkollë. Si pjesë e vlerësimit përfundimtar të studentit, deri në propozime e vendimmarrje në emërimet e tyre, AS-ja jo vetëm që do të luante një rol aktiv e pozitiv, por do të injektonte tek çdo subjekt i saj, staf apo student, autoritet dhe përgjegjësi më të madhe.

Sidoqoftë, analiza e faktorëve të tjerë të cilësisë siç është faktori aktiv mësimdhënës do e bënte më të plotë tezën e arsimimit të policit të ardhshëm.

4. Polic me intelekt, apo intelektualë të fuqishëm

*"Kur litarët të ngatërrohen, i padituri i këput, ndërsa i mençuri i zgjidh"*²⁴

Pranojmë se aftësitë individuale janë të ndryshme. Ndikojnë në të shumë parametra, disa janë të trashëguar e lindin me njeriun si shtatlartësia, forca, sikurse edhe zgjuarsia. Këto s' mund të jepen në shkollë, përgjithësisht janë të trashëguara ose ndryshe të lindura, gjë që pranohet e vërtetohet shkencërisht, por gjithashtu pranohet se aftësitë mund të krijohen, apo edhe të shtohen, të ruhen e të shfrytëzohen. Pa e parë të nevojshme të sjellim argumente në këtë ide, duke pasur në qendër të debatit tonë formimin policor ose arsimimin policor, mendoj se kjo do të thotë, që disa lëndë akademike duhet të kenë në vëmendje edhe ato aftësi që lindin me vet njeriun. Është e nevojshme të konsolidojmë shkathhtësinë, forcën, lartësinë, aftësitë vetëmbrojtëse, etj. Pa e tepruar këto duhet të jenë të pranishme e të vlerësuara, në situata apo operationale të thjeshta të rendit apo kriminimit, pra edhe kur polici është në rrugë, në publik, ai duhet të promovojë një figurë, një pamje, një fizik, të vetëprezantojë një njeri sa më adekuat me profesionin më të nderuar të një shteti. Ka ndodhur jo rrallë, që polici ka shpëtuar jetë në sajë të aftësive të tilla, me ndërhyrjet efikase ndaj një kriminel në tentativë, ka dhënë ndihmën e parë ndaj një të mbyturit në plazh, ka shpëtuar një fëmijë apo të moshuar nga fatkeqësi natyrore, etj.

Përfundimisht, mund të ideojmë e konfigurojmë policin tonë ideal, të tipizuar me të gjitha cilësitë e mundshme, fizike e intelektuale. Kjo mund të na ndihmojë si një pikënisje për të arritur drejt përsosjes së kontingjenteve të së ardhmes dhe njëkohësisht për përmirësimin e imazhit të policit e profesionit të tij. Ka një dukuri jo thjesht shqiptare por e përbotshme²⁵ ku polici e policia bëhen objekt viktimizimi, në media, në art, në bisedat e përditshme bëhen objekt humori apo frikësimi²⁶. Do ishte interesant objekti

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit »

²² Në krahasim me diplomën e integruar sistemi i arsimimit me cikle i ndan dhe i shpërblen më mire aftësitë.

²³ Kjo mund të kodifikohet në "Rregulloren e Policisë së Shtetit".

²⁴ Brainquotes, Zëri: "Dijetarë nga orienti".

²⁵ Bilbil Memaj, *Lidershipi në Policinë e Shtetit* (Tiranë: KRISTALINA - KH, 2016), 237-239.

²⁶ Stavri Sinjari dhe Sofokli Duka, "August Uollmer - "babai" i policisë moderne amerikane," *Revista periodike shkencore Policimi dhe Siguria*, (2016): 15.

këtij studimi por shkurt mund të pranojmë se ky konstatim është i njohur e mbahet gjallë si nga tradita e mentalitetet, nga stadi e deficitet intelektuale të vet shoqërisë, por dhe nga vet ata punonjës policie që e deformatojnë figurën e këtij profesioni sa të vështirë aq edhe human. Prandaj, shkollimi i pandërprerë, rritja e kapacitetit intelektual nëpërmjet arsimimit në shkollë e profesion, integrimi i vendeve dhe i vlerave pozitive që ato mbartin, gradualisht e me plot siguri do t'i anashkalojë këto dukuri e do e vendosin policin e policinë në vendin e nderuar që i takon. Janë kuptimplote fjalët e urta se njeriu ka nevojë për një filxhan shkencë, një shishe kujdes dhe një oqean durim.²⁷

5. Përfundime

“Gishtrinjte duhet të arsimohen, gishti i madh është lindur i ditur”²⁸

1. Nga arsimimi i policisë fiton gjithë shoqëria prandaj, policia e policimi duhet të jetë në konsideratë të shoqërisë, institucioneve, e shtetit në çdo qeverisje. Ato kërkojnë kujdesin shtetëror, trajtimin ekonomik e investime nga qeveritë dhe largpamësinë e AS dhe IAL.

2. Arsimiti është një proces që ka vetëm fillim. Vazhdimin e bën Akademia e Sigurisë si IAL e specializuar në këtë fushë. Mbarimin se përcaktojmë dot, e vendos individi.

3. Koha ka rolin e vet dhe mund të jetë përcaktuese nëse nuk menaxhohet mirë, nëse vonohemi e nuk kapërcehen etapat ose ecim trokthi e ato digjen.

4. Pa koment: *“Ne jemi bërë të mençur jo duke e kujtuar të kaluarën tonë, por duke qenë përgjegjës për të ardhmen tonë”²⁹.*

²⁷ Ismail Kadare. Marrë nga: <http://thenie.org/nga/ismail-kadare/page/10>.

²⁸ Marc Chagall-(1887-1985) piktor kubist, ekspresionist, ruso-francez Marrë nga <http://filolet.com/citate/arsimimi.htm>.

²⁹ George Bernard Shaw, (1856-1950), shkrimtar dhe dramaturg.

Biografia: http://www.nobelprize.org/nobel_prizes/literature/laureates/1925/shaw-bio.html

Citime, marrë nga: http://www.brainyquote.com/quotes/authors/g/george_bernard_shaw.html.

Bibliografia

1. Zanaj, Fatmir. *Sociologjia e së Drejtës*. Tiranë: Naimi, 2010.
2. Memaj, Bilbil. *Lidershipi në Policinë e Shtetit*. Tiranë: KRISTALINA – KH, 2016.
3. Sinjari, Stavri dhe Duka, Sofokli. "August Uollmer – "babai" i policisë moderne amerikane." Revista periodike shkencore *Policimi dhe Siguria*, (2016): 8-19.
4. *Fjalor Terminologjik*. Tiranë, 2005.
5. *Manual për Policimin në Komunitet*. Tiranë, 2015
6. ICITAP. *Kodi Etik i Policisë së Shtetit*. Tiranë, 2015.
7. *Rregullore e Policisë së Shtetit*. Tiranë, 2015.
8. *Statuti i Akademisë së Sigurisë*. Tiranë, 2015.
9. Sinjari, Stavri. *Përmbledhje leksionesh të ndryshme*.
10. A Brief Guide To Police History, 20.07.05.
11. Akademia e Sigurisë. *Analizat vjetore e Akademisë së Sigurisë dhe të Departamenteve*.
12. http://www.brainyquote.com/quotes/authors/f/franz_grillparzer.html/ 16.07.2016
13. <http://www.thenie.net/thenie-nga-ramiz-karaeski/09.06.2016>
14. https://www.goodreads.com/author/quotes/3063220.Thomas_More/22.08.2016
15. https://aab-edu.net/downloads/02_2009_08__kle_JtOI.pdf/01.09.2016
16. <http://www.aal.edu.al/dokumente/legjislacioni/Ligji%20i%20Arsimit%20te%20larte%20i%20azhornuar.pdf/22.08.2016>
17. http://reformanedrejtesi.dmcsonline.com/sites/default/files/deklarata_e_bolonjes_0.pdf/04.06.2016.
18. <https://www.thesun.co.uk/news/1502957/armed-french-police-in-trunks-protect-holidaymakers-over-fears-of-isis-beach-attack/22.07.2016>.
19. <http://www.telegraph.co.uk/news/2016/06/28/armed-police-lifeguards-to-guard-french-beaches-amid-terror-fear/22.07.2016>.
20. <http://www.walk-together.com/new/informim-mbi-karten-e-bolonjes/15.06.2016>.
21. http://study.com/how_to_become_a_police_officer.html/23.08.2016.
22. <http://www.camdencc.edu/policeacademy/inservicereg.cfm/23.08.2016>.
23. <http://www.brainyquote.com/quotes/quotes/c/carlrogers130364.html/03.09.2016>.
24. <http://www.brainyquote.com/quotes/quotes/h/heraclitus162902.html/13.07.2016>.
25. http://www.nytimes.com/2014/04/16/nyregion/sir-robert-peels-nine-principles-of-policing.html?_r=0/25.07.2016.
26. <https://sq-al.facebook.com/shkollaislame/posts/990104351012697>.
27. <http://thenie.org/nga/ismail-kadare/page/10/23.06.2016>.
28. <http://filolet.com/citate/arsimimi.htm/18.07.2016>.
29. http://www.brainyquote.com/quotes/authors/g/george_bernard_shaw.htm/19.07.2016.
30. <http://www.walk-together.com/new/informim-mbi-karten-e-bolonjes/20.06.2016>.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional, garanci për një shërbim policor cilësor dhe demokratik

— Dr. (në proces) Ilo Keçka

Drejtoria e Policisë së Shtetit

ilo.kecka@asp.gov.al

Abstrakt

Misioni i Policisë së Shtetit për forcimin e rendit dhe sigurisë publike dhe luftës ndaj krimit, nuk mund të arrihet, nëse nuk ka një personel policor të aftë profesionalisht dhe, nëse nuk i kushtohet një vëmendje e veçantë trajnimeve të vazhdueshme të personelit policor, si trajnimeve specifike të lidhura me detyrat funksionale ashtu dhe për rolin ku do të emërohen apo janë të emëruar. Sistemi aktual i trajnimit/shkollimit në Policinë e Shtetit, ka për qëllim që të përgatisë punonjës policie të aftë profesionalisht, për t'i ofruar publikut një shërbim cilësor dhe demokratik. Për të plotësuar këto nevoja është e domosdoshme që të interpretohen dhe të përcaktohen aspektet e një sistemi trajnimi të vazhdueshëm profesional për policinë, i cili të bëjë të mundur të plotësojë nevojat e policisë, për trajnim në përmbushje të misionit të saj. Krijimi i një sistemi të plotë e bashkëkohor lindi edhe si detyrim i Ligjit Nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", 1 dhe Rregullores së Policisë së Shtetit² ku është përcaktuar, që çdo punonjës policie duhet t'i nënshtrohet trajnimit profesional të vazhdueshëm dhe, për disa punonjës policie (grada inspektor deri komisar) është parashikuar dhe testimi fizik e profesional pas trajnimit. Me ndryshime kaq të konsiderueshme në organizimin, funksionimin dhe karrierën e punonjësve të policisë, çdo kush prej tyre duhet të dijë se ku do të jetë vendi i tij në hierarkinë e policisë si dhe çfarë trajnimi duhet të kryejë. Në një situatë të tillë, trajnimi kthehet në një nevojë si për çdo punonjës policie, ashtu edhe për profesionalizimin e të gjithë Policisë së Shtetit (PSH).

AKADEMIA
E SIGURISË

Fjalëkyçe:

trajnim, program, specializim, avancim, arsimim policor, oficerë policie.

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit»

1. Hyrje

Sistem i trajnimit në Policinë e Shtetit përputhet me strategjitë, planet aktuale për ndryshimet organizative si dhe me reformat që po kryhen në Policinë e Shtetit, duke synuar njëkohësisht për të qenë i ndryshueshëm, me qëllim për t'iu përshtatur nevojave, kërkesave, zhvillimit dhe risive.

Policia e Shtetit, për të përmbushur me sukses misionin dhe përgjegjësitë e veta institucionale, duhet të përmirësojë në vazhdimësi standardet dhe performancën e sistemit të trajnimit, duke synuar në: zhvillimin e një sistemi trajnimi të bazuar në standardet e vendeve euroatlantike; zhvillimin e një sistemi trajnimi të bazuar në parimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës; zhvillimin e një sistemi trajnimi për t'u dhënë shanse të barabarta të gjithë punonjësve të policisë; zhvillimin e ecurisë në karrierë, nëpërmjet shkollimit dhe trajnimit dhe, zhvillimin e trajnimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve të policisë në detyrë. Në këtë punim do të përqendrohemi në zhvillimin e trajnimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve të policisë në detyrë, çfarë programe duhet të hartohen, si duhet bërë menaxhimi i këtij trajnimi dhe punonjësit e policisë që do të përfshihen në këto trajnime. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional do të thotë që punonjësit të jenë të aftë të demonstrojnë se ata po ruajnë dhe përmirësojnë aftësitë e tyre, veçanërisht në fusha të rëndësishme dhe të veçanta.³

Disa programe formimi p.sh., Programi i Shkollës Bazë të Policisë etj., kanë për qëllim të mësojnë dhe edukojnë në mënyrë të organizuar punonjësit e rinj të policisë me njohuritë bazë policore, por në Policinë e Shtetit ka shumë punë e detyra të cilat kërkojnë

¹ Ligji Nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", neni 37.

² Rregullore e Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr750, datë 16.9.205, neni 156,157,158,159,160.

³ Koxhaj, Andri. *Aftësitë menaxheriale* (bot. i parë). Tiranë, 2006, f. 378-379.

njohuri specifike. Me qëllim që punonjësit e policisë të zhvillohen nga ana profesionale dhe të kenë mundësi të punojnë në ato vende pune ku kërkohen njohuri specifike, të cilat nuk i përfitojnë në programet e formimit, është e nevojshme që Policia e Shtetit të zhvillojë shumë programe trajnimi ku punonjësit e policisë do t'i përfitonin këto njohuri. Disa prej programeve po i rendit si më poshtë.

2. Programi për trajnimin e specializuar/avancuar

Ky program ka për qëllim që të trajnojë punonjës policie të aftë për drejtime specifike të punës policore, në të cilat kërkohen aftësi apo njohuri të caktuara, si dhe konsolidimin dhe fitimin e shkathtësive dhe njohurive të reja, më të thelluara në fushën për të cilën këta punonjës policie janë specializuar. Ky program nuk u ofrohet domosdoshmërisht të gjithë punonjësve të policisë, por vetëm atyre që janë në pozicione të tilla, të cilat kërkojnë trajnim të specializuar dhe të avancuar. Trajnimet e specializuara/avancuara janë të lidhura me ndarjet dhe nënndarjet e punës në Policinë e Shtetit. Programi i specializuar/avancuar ka në përbërje disa programe, por jo vetëm këto:

a) *Programi i specializuar/avancuar për hetimin e krimeve kundër personit dhe pronës.* Ky program ka për qëllim të trajnojë punonjës policie për hetimin e veprave penale kundër personit dhe pasurisë. Programi u ofrohet të gjithë atyre punonjësve të policisë, të cilët do të punojnë në strukturat e hetimit të krimit që kanë për objekt veprat penale kundër personit dhe pasurisë. Programi do të përmbajë tema që kanë lidhje me, por jo vetëm këto: njohuri të plota për veprat penale kundër personit dhe pasurisë; veçoritë e përdorimit të mjeteve për kërkimin e provës gjatë hetimit të këtyre veprave penale; veçoritë e metodikave të hetimit të këtyre veprave penale; veçoritë e përdorimit të informacionit dhe të veprimtarisë informativë për hetimin e këtyre veprave penale; hetimi i çështjeve të vjetra në këto vepra penale; zhvillimi i aftësive praktike për hetimin e këtyre veprave penale.

b) *Për hetimin e trafikut të paligjshëm lëndëve narkotike.* Ky program ka për qëllim të trajnojë punonjës policie për hetimin e veprave penale kundër lëndëve narkotike. Programi u ofrohet të gjithë atyre punonjësve të policisë, të cilët do të punojnë në strukturat e hetimit të krimit që kanë për objekt veprat penale në fushën trafikimit të lëndëve narkotike. Programi do të përmbajë tema që kanë lidhje me, por jo vetëm këto: njohuri të plota për veprat penale në fushën e narkotikëve; kuptimi për bashkëpunimin; veçoritë e përdorimit të informacionit dhe të veprimtarisë informativë për hetimin e këtyre veprave penale; veçoritë e përdorimit të mjeteve për kërkimin e provës gjatë hetimit të këtyre veprave penale; veçoritë e veprimeve me iniciativë në hetimin e këtyre veprave penale; veçoritë e metodikave të hetimit të këtyre veprave penale dhe zhvillimi i aftësive praktike për hetimin e këtyre veprave penale.

c) *Për hetimin e trafikeve të paligjshme.* Ky program ka për qëllim të trajnojë punonjës policie për hetimin e veprave penale kundër trafikeve të paligjshëm. Programi u ofrohet të gjithë atyre punonjësve të policisë, të cilët do të punojnë në strukturat e hetimit të krimit që kanë për objekt veprat penale në fushën e trafikeve të paligjshme. Programi do të përmbajë tema që kanë lidhje me, por jo vetëm këto: njohuri të plota për veprat penale në fushën e trafikeve të paligjshme; kuptimi për bashkëpunimin; veçoritë e përdorimit të informacionit dhe të veprimtarisë informativë për hetimin e këtyre veprave penale; veçoritë e përdorimit të mjeteve për kërkimin e provës gjatë hetimit të këtyre veprave penale; veçoritë e veprimeve me iniciativë në hetimin e

këtyre veprave penale; veçoritë e metodikave të hetimit të këtyre veprave penale; zhvillimi i aftësive praktike për hetimin e këtyre veprave penale.

d) *Për hetimin e akteve terroriste.* Ky program ka për qëllim të trajtojë punonjës policie për hetimin e veprave penale kundër akteve terroriste. Programi u ofrohet të gjithë atyre punonjësve të policisë, të cilët do të punojnë në strukturat e hetimit të krimit që kanë për objekt veprat penale në fushën e akteve terroriste. Programi do të përmbajë tema që kanë lidhje me, por jo vetëm këto: njohuri të plota për veprat penale në fushën e akteve terroriste; kuptimi për bashkëpunimin; veçoritë e përdorimit të informacionit dhe të veprimtarisë informativë për hetimin e këtyre veprave penale; veçoritë e përdorimit të mjeteve për kërkimin e provës gjatë hetimit të këtyre veprave penale; veçoritë e veprimeve me iniciativë në hetimin e këtyre veprave penale; veçoritë e metodikave të hetimit të këtyre veprave penale; zhvillimi i aftësive praktike për hetimin e këtyre veprave penale.

e) *Për hetimin e veprave penale në sferën ekonomike dhe korrupsionin.* Ky program ka për qëllim të trajtojë punonjës policie për hetimin e veprave penale në sferën ekonomike. Programi u ofrohet të gjithë atyre punonjësve të policisë, të cilët do të punojnë në strukturat e hetimit të krimit që kanë për objekt veprat penale në fushën e lëndëve narkotike. Programi do të përmbajë tema që kanë lidhje me, por jo vetëm këto: njohuri të plota për veprat penale në sferën ekonomike; kuptimi për bashkëpunimin; veçoritë e përdorimit të informacionit dhe të veprimtarisë informativë për hetimin e këtyre veprave penale; veçoritë e përdorimit të mjeteve për kërkimin e provës gjatë hetimit të këtyre veprave penale; veçoritë e veprimeve me iniciativë në hetimin e këtyre veprave penale; veçoritë e metodikave të hetimit të këtyre veprave penale; zhvillimi i aftësive praktike për hetimin e këtyre veprave penale.

f) *Për përpunimin analitik të informacionit.* Programi ka për qëllim të japë njohuri të plota për analizën e informacionit kriminal. Programi u ofrohet punonjësve të policisë, të cilët do të punojnë në strukturat e analizës së informacionit kriminal. Programi do të përmbajë module që kanë lidhje me, por jo vetëm këto: analiza operationale (pjesa teorike); "Analyst's Notebook"; trajnim bazë për Memex; "Microsoft Excel" për analistët; "Microsoft Access" për analistët; baza ligjore për analistët.

g) *Për përgatitjen e laborantëve kriminalistë.* Programi ka për qëllim të japë njohuri më të domosdoshme që kanë të bëjnë me marrjen, paketimin e trajtimin e provave, për të mos humbur vlerat e tyre identifikuese gjatë transportimit, apo krijimit të kushteve në laborator. Programi u ofrohet punonjësve të policisë, të cilët do të përgatiten për ndihmës specialistë laborantë në strukturat e Policisë Shkencore. Programi do të përmbajë module që kanë lidhje me, por jo vetëm këto: formim i përgjithshëm dhe formim profesional.

h) *Për përgatitjen e ekspertëve kriminalistë.* Programi ka për qëllim të japi njohuri të plota për këqyrjen e vendit të ngjarjes, kërkimin, gjetjen, fiksimin, marrjen e administrimin e provave materiale. Programi u ofrohet punonjësve të policisë, të cilët do të përgatiten për specialistë të këqyrjes së vendit të ngjarjes në strukturat e Policisë Shkencore. Programi do të përmbajë module që kanë lidhje me, por jo vetëm këto: formim i përgjithshëm; formim profesional; taktika kriminalistike; mjekësia e biologjia ligjore.

i) *Për përgatitjen e instruktorëve dhe të qenve të policisë.* Programi ka për qëllim të japë njohuri të plota dhe aftësi për përgatitjen e instruktorëve dhe të qenve të policisë, sipas specialiteteve zbulim lëndësh narkotike, zbulim lëndësh eksplozive, ndjekje

gjurme, patrullim, kundër terrorit dhe zbulim kufomash. Programi u ofrohet punonjësve të policisë të përzgjedhur për instruktor të qenve të policisë si dhe për qentë e policisë sipas specialiteteve përkatëse. Programet do të përmbajë module që kanë lidhje me, por jo vetëm këto: teori stërvitje, bindje e përgjithshme, zoohigjienë dhe pjesa praktike (specialiteti).

j) *Për policinë rrugore.* Programi ka për qëllim të jap njohuri dhe të zhvillojë aftësitë e punonjësve të policisë për zbatimin e legjislacionit në fushën e qarkullimit rrugor. Ky program u ofrohet punonjësve të policisë, të cilët do të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre në strukturat e policisë rrugore. Programet do të përmbajë module që kanë lidhje me, por jo vetëm këto: njohuritë mbi legjislacionin e qarkullimit rrugor; njohuri për përdorimin e mjeteve dhe aparaturave në përdorim; njohuri për hetimin e kundërvajtjeve administrative dhe veprave penale në fushën e qarkullimit rrugor.

k) *Për forcat speciale dhe forcat e ndërhyrjes së shpejtë.* Programi ka për qëllim të jap njohuri dhe të zhvillojë aftësitë e punonjësve të policisë për kryerjen e detyrave për rivendosjen e rendit si dhe për kryerjen e operacioneve policore me vështirësi të lartë. Ky program u ofrohet punonjësve të policisë, të cilët me përfundimin e suksesshëm të tij do të emërohen në strukturat e forcave të ndërhyrjes së shpejtë dhe të forcave speciale.

l) *Për policinë kufitare dhe migracionit.* Programi për policinë kufitare dhe migracionin ka për qëllim të pajisë punonjësit e policisë me shkathtësitë dhe aftësitë të cilat janë të nevojshme për t'i kryer detyrat e tyre, duke u bazuar në modelin e menaxhimit të kufijve të Bashkimit Evropian dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar. Ky program gjithashtu siguron njohuri për Konventën/Rregulloren e Dublinit dhe bankën e të dhënave të EURODAC. Programi u ofrohet punonjësve të policisë, të cilët do të shërbejnë në strukturat e policisë kufitare dhe migracionit. Programet do të përmbajë module që kanë lidhje me, por jo vetëm këto: termat e menaxhimit të kufirit; kontrollat kufitare; vëzhgimet kufitare; kufijtë tokësor, kufijtë ajror dhe kufijtë detar; kufijtë e brendshëm dhe kufijtë e jashtëm; shenjat kufitare dhe vija e kufirit; organizimi dhe funksionimi i policisë kufitare dhe migracionit, etj.; Organet institucionale dhe organet e larta jo institucionale të Bashkimit Evropian dhe karakteristikat e tyre kryesore; përparësitë e instrumenteve ndërkombëtare dhe efekti i drejtpërdrejt i ligjit të BE.

m) *Programin për trajnimin e detyruar në shërbim.* Ky program do të trajtojë të gjithë punonjësit e policisë në detyrë me njohuritë e nevojshme që kanë lidhje me zhvillimet, ndryshimet brenda organizatës, azhurnimin me legjislacionin, të ruajë disa njohuri dhe shkathtësi specifike në lidhje me funksionin që ata kanë dhe konkretisht mbi: armët e zjarrit; dhënien e ndihmës së shpejtë dhe vetëmbrojtjen; drejtimin e automjeteve; azhurnimin me legjislacionin dhe procedurat standarde të policisë. Ky program u ofrohet të gjithë punonjësve të policisë që kanë kompetenca operacionale. Programi do të zhvillohet për jo më pak se 24 orë mësimore në vit.

n) *Programin për formim mesimdhënës.* Ky program ka për qëllim të njohë dhe aftësojë pjesëmarrësit me njohuritë me të domosdoshme të metodave të mësuarit tek të rriturit. Ky program u ofrohet punonjësve të policisë, të cilët do të ushtrojnë përgjegjësitë e mesimdhënësve që do të zhvillojnë programet e trajnimit në Policinë e Shtetit. Programi do të përmbajë modulet që kanë lidhje me, por jo vetëm këto: moduli i parë "Udhëzuesi i mësimin në distancë; moduli i dytë "Metodat kryesore të mesimdhënies"; moduli i tretë "Prezantim".

3. Programi për formimin e oficerëve të trajnimit në terren (OTT)

Ky program ka për qëllim të përgatitë oficerë të trajnimit në terren për punonjësit e patrullës së përgjithshme, të cilët vazhdojnë procesin e trajnimit në terren. Ky program u ofrohet punonjësve të policisë, të cilët nëpërmjet një procesi testues përzgjidhen për të ushtruar përgjegjësitë e oficerit të trajnimit në terren për patrullën e përgjithshme. Programi do të përmbajë tema që kanë lidhje, por jo vetëm, me këto: komunikimi; etika; menaxhimi i konfliktit; drejtimi dhe këshillimi; plani i veprimit; dosja e zhvillimit në terren.

3. Zhvillimi i seminareve dhe “workshop”-eve

Ky proces ka për qëllim të ruajë nivelin e dijeve, të japë njohuri dhe dijë të reja në fushën e legjislacionit, të teknologjisë, të njohë punonjësit e policisë me ndryshimet brenda organizatës, të plotësojë mangësitë e njohurive dhe dijeve që reflektohen gjatë dinamikës së punës, etj. Këto programe hartohen mbi bazën e nevojave për trajnim që kanë strukturat dhe punonjësit e policisë dhe planifikohen çdo vit. Programet u ofrohen të gjithë punonjësve të policisë, sipas përkatësisë strukturore dhe përgjegjësi që ushtrojnë.

3.1 Menaxhimi i trajnimit të vazhdueshëm profesional në Policinë e Shtetit

Planifikimi dhe realizimi i trajnimeve në Policinë e Shtetit bëhet sipas një planifikimi dhe organizimi të orientuar dhe standarde, dhe nuk i lihet spontanitetit.⁴ Menaxhimi i trajnimit të vazhdueshëm profesional përfshin disa etapa, si përcaktimi⁵ i nevojave për trajnim, zhvillimi i programeve të trajnimit, planifikimi i aktiviteteve të trajnimit, zhvillimi i trajnimit, vlerësimi i trajnimit, të cilat mund të dallohen si më poshtë.

3.2 Identifikimi dhe mbledhja e nevojave për trajnim

Identifikimi dhe mbledhja e nevojave për trajnim përbën elementin përcaktues në hartimin e një plani konkret të trajnimeve për organizatën. Ky proces identifikon fushat e njohurive dhe aftësive profesionale që duhen të plotësohen, duke mbështetur objektivat strategjike të organizatës, kërkesat për rritjen në vazhdim të njohurive profesionale për sektorët dhe shërbimet, si dhe kërkesat individuale të çdo punonjësi, që do të përfshihet në trajnim. Ky është një proces i rëndësishëm që lidhet me përcaktimin e nevojave që kanë për trajnime strukturat e punonjësit e organizatës. Nëpërmjet këtij procesi organizohet puna për grumbullimin e informacioneve dhe propozimeve për trajnime. Procesi për identifikimin e nevojave për trajnim mund të realizohet në disa mënyra të cilat janë:

a) Zhvillimi i anketimeve. Anketimi është një test ose pyetësor me anë të cilit, identifikohen nevojat për trajnim të një grupi punonjësish.

b) Intervistimi. Me anën e intervistave merren mendimet dhe propozimet e drejtpërdrejta të nevojave që kanë për trajnim punonjës të niveleve të ndryshme dhe

⁴ Procedura standarde e punës, “Planifikimi trajnimeve në Policinë e Shtetit”, miratuar me urdhër të Drejtorit të Policisë, nr. 210, dt. 07.03.2016.

⁵ Koli, Zan dhe Shyqyri Llaci. *Menaxhimi i burimeve njerëzore*. (botimi i II). Tiranë: 2005, f. 199.

sektorëve të ndryshëm

c) Plotësimi të formularëve standard, të cilët ju dërgohen strukturave të organizatës. Njëpërmjet këtij formulari, strukturat identifikojnë nevojat për trajnim.

4. Vlerësimi dhe përzgjedhja e trajnimeve si dhe vlerësimi i kapaciteteve trajnuese që ka organizata

Ky proces përzgjedh trajnimet më të domosdoshme për të cilat ka nevojë organizata, si dhe bën një analizë të kapaciteteve që disponohen për të kryer këto trajnime: analizohet informacioni i mbledhur nga pyetësorët, anketimet dhe intervistimet përpunohet dhe krahasohet me trajnimet e kryera më parë me qëllim për të përzgjedhur trajnimet më të domosdoshme; listohen trajnimet sipas prioriteteve, duke filluar nga trajnimet për punonjësit e rinj, trajnimi në periudhën e provës, trajnimet aktualizuese e përditësuese, trajnimet e specializuara, trajnimet për zhvillimin e karrierës dhe formimin e menaxherëve; vlerësohen kapacitetet trajnuese që ka organizata; vlerësohen kapacitetet akomoduese (ushqim, fjetje); vlerësohen kapacitetet mësimdhënëse (klasat, salla leksionesh, mjetet mësimore dhe didaktike); vlerësohen kapacitetet e mësimdhënëse.

Organizata duhet të krijojë një rrjet trajnerësh të kualifikuar për dhënien e mësimit.

4.1 Zhvillimi i programeve të trajnimit

Nga analiza e nevojave për trajnim përcaktohen temat e trajnimeve më të domosdoshme, për të cilat organizata ka nevojë. Për çdo trajnim hartohen programet e trajnimit, të cilat kanë të bëjnë me përcaktimin e objektivave dhe përmbajtjes së trajnimit.

4.1.1. Përgatitja e planit të trajnimeve

Plani i trajnimeve përfshin tërësinë e trajnimeve që do të kryhen për një periudhë kohe të caktuar (zakonisht trajnimet planifikohen për një periudhë një vjeçare). Në plan përcaktohet numri i punonjësve që do të marrin pjesë në trajnim, kriteret e pjesëmarrësve në trajnim, koha e vendi i zhvillimit të trajnimit.

4.1.2. Shpërndarja dhe publikimi i planit të trajnimeve

a) Plani i trajnimeve dërgohet në formë të shkruar dhe elektronike, strukturave përfituese të trajnimit.

b) Strukturat përfituese të trajnimit duhet të garantojnë që plani i trajnimeve të njihet nga punonjësit e organizatës.

c) Plani i Trajnimeve publikohet edhe në faqen e internetit të organizatës.

4.2 Ndryshimet dhe shtesat në planin e trajnimeve

a) Plani i Trajnimeve duhet të jetë flexible. Ai duhet të marrë në konsideratë edhe propozimet që bëhen gjatë vitit për ndryshimin apo zhvillimin e trajnimeve shtesë, trajnime të cilat i dikton dinamika e veprimtarisë së strukturave dhe shërbimeve.

b) Strukturat e organizatës mund të paraqesin kërkesa për ndryshime në planin e trajnimeve dhe propozime për shtesa të trajnimeve.

4.3 Zhvillimi i trajnimeve

Zhvillimi i trajnimeve të planifikuara bëhet në pune, jashtë punës, ose pranë saj.

a) Formimi në punë, në këtë rast trajnimi realizohet në ambientet e punës. Pjesëmarrësit në trajnim mësojnë duke vrotuar punën e punonjësve me eksperiencë, si dhe duke punuar në mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të një punonjësi me eksperiencë.

b) Formimi pranë punës, në këtë rast trajnimi kryhet nëpërmjet instruksioneve të programuara, regjistrimit në kaseta video etj.

c) Formimi jashtë punës, në këtë rast trajnimet zhvillohen nga mësimdhënësit në klasa.

4.4 Vlerësimi i trajnimit

Vlerësimi i trajnimit është një përmbledhje objektive dhe analizë e të dhënave të mbledhura rreth efikasitetit të një programi trajnimi. Vlerësimi i trajnimit ndihmon për të gjykuar mbi cilësinë e programit të trajnimit, metodave e mjeteve të përdorura për mësimdhënie, plotësimin e nevojave të pjesëmarrësve, shkallën e përvetësimit të përmbajtjes së trajnimit nga pjesëmarrësit dhe si ka ndikuar trajnimi në ushtrimin e detyrës. Vlerësimi i trajnimit kryhet:

- *Menjëherë, pas përfundimit të trajnimit.* Vlerësimi i trajnimit pas përfundimit të tij, ndihmon për të gjykuar se sa i ka plotësuar trajnimi nevojat e pjesëmarrësve, shkallën e përvetësimit të përmbajtjes së trajnimit nga pjesëmarrësit, si dhe efikasitetin e metodave dhe mjeteve të trajnimit. Vlerësimi i trajnimit pas përfundimit të tij kryhet struktura që zhvilloi trajnimin duke plotësuar formularin e vlerësimit.

- *Gjatë ushtrimit të detyrës, pas përfundimit të trajnimit.* Vlerësimi i trajnimit gjatë ushtrimit të detyrës, pas përfundimit të tij, kryhet nga struktura që zhvilloi trajnimin, ose struktura e që përfitoi trajnimin. Vlerësimi i trajnimit gjatë ushtrimit të detyrës bëhet me anën e intervistave dhe sondazheve të cilat iu përgjigjen pyetjeve se; çfarë kanë mësuar më tepër pjesëmarrësit, përshtypjet e pjesëmarrësve, kolegëve dhe eprorëve mbi ushtrimin e detyrës, rezultatet në punë dhe si ka ndikuar trajnimi në rritjen e imazhit dhe rezultateve të organizatës. Pas mbledhjes së formularëve të vlerësimit, intervistave dhe sondazheve, bëhet analiza e informacionit të mbledhur dhe hartohet raporti i vlerësimit të trajnimit. Ky raport, në mënyrë të përmbledhur prezanton:

a) cilësinë e trajnimit,

b) mendimet dhe sugjerimet e pjesëmarrësve mbi trajnimin,

c) kalueshmërinë e pjesëmarrësve në trajnim,

d) konkluzione dhe rekomandime për ecurinë e mëtejshme të trajnimit.

Kur nga raporti i vlerësimit të trajnimit dilet në konkluzionin se trajnimi i zhvilluar është cilësor, atëherë në trajnim përfshihen dhe punonjës të tjerë të organizatës. Kur raporti arrin në konkluzionin se trajnimi nuk ja arriti qëllimit, atëherë duhen bërë ndryshime në kurrikulën e trajnimit, me qëllim ndryshimin e objektivave të trajnimit dhe përmbajtjes së tij.

5. Përfundime

- Është i nevojshëm hartimi i një strategjie dhe i një plani afatgjatë, për trajnimet e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të Policisë së Shtetit.

- Është i nevojshëm hartimi i sistemit të trajnimeve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në Policinë e Shtetit, ku të përcaktohen programet që do të zhvillohen si dhe institucionet arsimore që do të zhvillojnë këto programe.

- Krijimi i një rrjeti mësimdhënës, me pedagogë të trajnuar, të cilët punojnë në terren që do të zhvillojnë programet e trajnimit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional.
- Ndërtimi i kabineteve dhe laboratorëve të nevojshëm, ku pjesëmarrësit në trajnim, të fitojnë aftësi në përfundim të trajnimeve të vazhdueshëm profesionalë.
- Kreditet e përfituara nga programi i vazhdueshëm profesional duhet të jenë kusht për ecurinë në karrierë dhe përfitimin e një grade më të lartë për punonjësit e policisë.⁶

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

⁶ Rregullore e Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.9.2005, neni 125, pika ç.

Bibliografi

1. Ligji "Për Policinë e Shtetit".
2. *Rregullore e Policisë së Shtetit*, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.9.2005.
3. Koxhaj, Andri. *Aftësitë menaxheriale*. Tiranë: 2006.
4. Koli, Zan dhe Shyqyri Llaci. *Menaxhimi i burimeve njerëzore*. Tiranë: 2005.
5. Procedura standarde e punës "Planifikimi trajnimeve në Policinë e Shtetit", miratuar me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit, nr. 210, dt. 07.03.2016.

Ethical and social justice issues - the case of correctional institutions

PhD. (candidate) Ferid Azemi¹

Kosovo Academy for Public Safety

Ferid.azemi@rks-gov.net

Abstract

This study will examine the role of administrator in implementing code of ethics and reducing misconduct in correctional centers and other public safety agencies. Ethics and social justice are the main emphasized factors in this study, where various abuses may constitute in human rights violation, violation of code of ethics, corruption inside prisons and also other forms of misbehaviors. The purposes of this study was to bridge gaps in knowledge about administrator's decision-making process, political influences, external and internal controls, and conflict of interests. Research questions focused on reasons organizational culture and outside factors that may have impact on decision-making process of administrators. The theoretical frame works for this study were McNeal's organizational culture and Cooper's the principles of responsible administrator, to include O'Leary's guerrilla government theory. The qualitative phenomenological study design was employed using case study of Wakulla Correctional Institution, in the U.S. Data from various censuses were included and categorized for thematic analysis and comparisons. Results indicated the lack appropriate implementation of ethical principles in practice not only in a piece of paper. This study shed light on challenges that public administrators face such as financial burdens and issues that derive from inequality, all forms of abuses, and also bureaucratic laws. The implication for social change include better financial support for trainings and education of officers in the field, implementation of ethics at all levels in the public safety agencies, and also reduce disparities between men and women. In order to implement recommendations that bring positive changes, the administrators face with very difficult challenges. Some of challenges are the financial issues and burden, deep reforms in justice system especially deep reforms in correctional centers and also the promotion of diversity and reduction of gender disparities.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

Key words:

ethics, values, decision-making, administration, misconduct.

1. Introduction

The last group of questions was dedicated to the students' view about Police officers and their job. More than 80% of the students agree that Police officers conduct according to deontological and ethical standards. These answers are in relation with the students' views about their own behavior and how they will react in situation when someone breaks the etiological rules. On the other hand, "only" 65% give an answer that they believe Police officers refrain from corruptive activities and do not tolerate such behavior among colleagues. Huge number of 27% of students thinks that Police officers do not act according to ethical standards and are not very immune on corruptive activities. Almost 80% of the students think that Police officers know how to act in case someone offers bribes or other corruptive activity. These answers are very important for another reason. This shows that students are familiar with corruption, its manifestation and means or models of influence in the society. However, 93% of the students have confidence in the Police work. Only 5% answered negatively, and 2% were unable to say whether they confide in the Police. This shows that even with many challenges, Police officers do their job in appropriate way. Confidence among citizens is of a crucial importance for their success. Students are very important; they are the driving force of the progress in every society. Thus, it is important to hear their attitudes and to follow their values about the Police and how Police officers conduct their work.

Finally, training and education are never enough. 64% of students agree that the Police officers are not sufficiently educated in ethics and they need further training. This could be a good challenge for Police managers, teacher, and trainers to plan additional courses in Police ethics, to prepare new, contemporary program of ethical issues, and to deliver training for Police officers. Such a program should discuss corruption, human rights and freedoms, ethics in communication, the rule of the law, mutual respect, public relation, community policing, etc.

5. Conclusion

Ethics is a topic for research among scientists, professors, teachers and it is a question of discussion in every society, every organization, even in the family. Scientists recognize ethics as a number of distinct duties, such as those proscribing the killing of innocent people (murder) and prohibitions on lying and promise breaking (Manning, 1977). Four types of ethical theory have been the most heatedly debated among the analytic philosophers since the appearance in 1903 of G. E. Moore's Principia Ethica. Each type has certain consequences for jurisprudence (Nakhnikian, 1957). Contemporary ethics is in turn divided into ethical theory and normative ethics. Ethical theory concerns with such questions as: What is the semiotical status (roughly, the "meaning") of ethical words such as 'good,' 'right,' 'duty,' 'obligation'? Can any one of such terms be an adequate primitive for defining the rest? Can ethical term be defined in nonethical terms? Can ethical sentences judgments be true or false? Are they, like the statements in the field of the natural sciences, confirmed or "disconfirmed" by the evidence obtained from experimentation and observation? These and similar questions which may be posed in ethical theory are questions about the typical meanings or standard functions of, and logical connections among, certain words and sentences. They are not questions about what we ought to do or what we ought to value (Nakhnikian, 1957). Questions about what we ought to do and value are normative questions.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

Traditionally, such questions have been regarded as belonging to the normative ethics or moral philosophy. Normative ethics is that branch of philosophy which seeks to discover, justify, and communicate normative principles (rules of conduct, rules joining certain kinds of disposition, etc.) which are objective (Julius, 1950). Any conclusion reached regarding the objectivity of normative utterances has certain consequences for the status and procedures of ethical jurisprudence. This paper describes the essential features of the student views and points out to some of the readily discernible consequences. Police ethics is an essential question in the everyday police work and it is very important to introduce students into ethics even wider than only into Police ethics.

The answers collected with this research, were detailed analyzed and authors bring very interesting information about student's attitudes. It is very important to emphasize that students at the Faculty of Security are aware of the importance of ethics in everyday living, not only during the students' days, but also in personal and professional life. However, education and training on ethics is essential for personal and professional development. Because of this, professors and trainers should prepare enough topics and materials for long life learning of ethics. This survey and also future surveys will give important data on how to develop Police ethics as a science as well as how to perform ethics in an appropriate way in the everyday working and living.

Bibliography

1. Bittner, E. (1971). *The functions of police in modern society*. Washington, DC: National Institute of Mental Health. Retrieved 06 17, 2015, from <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/Digitization/147822NCJRS.pdf>
2. Black, D. &. (1967). *Patterns in behavior in police and citizen transactions*. (1967). DC: Washington: US Government Printing Office.
3. Dragana, D. (2007). *Ethics and Politics in Humanitarian Aid*. Belgrade: Faculty of Security and Official Gazette.
4. Greene, J. R. (2010). Pioneers in Police Research: William A. Westley. *Police practice and research*, 545-468.
5. Julius, S. (1950). *The Province and Function of Law*. Harvard: Harvard University Press.
6. Kelly Cheeseman, Claudia San Miguel, Durant Frantzen, Lisa Nored;. (2016). *Everyday Ethics for the Criminal Justice Professional*. Carolina Academic Press.
7. Manning, P. K. (1977). *Police Work: The Social Organization of Policing*. Cambridge, Massachusetts: M.I.T. Press.
8. Nakhnikian, G. (1957). *Contemporary Ethical Theories and Jurisprudence*. *Natural Law Forum*.
9. Reiss, A. J. (1971). *The police and the public*. New Haven: Yale University Press.
10. Stojanovski, Trpe. 2007. *Policiskaetika I deontologija*. Stip: 2ri Avgust;
11. Westley, W. (1953). Violence and the police. *American Journal of Sociology*, 59(1).
12. White, M. G. (1949). Value and Obligation in Lewis and Dewey. *Philosophical Review*, 321-329.

Nevoja për programe deradikalizimi në Shqipëri

■ Msc Tonin VOCAJ

Akademia e Sigurisë
tonin.vocaj@asp.gov.al

Abstrakt

Mungesa e programeve që synojnë deradikalizimin në Shqipëri, krijon mundësi për lindjen dhe zhvillimin e ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmin e individëve dhe krijimin e kushteve për përfshirjen e këtyre individëve në konfliktet e huaja, por edhe për kryerjen e akteve të rënda të dhunës apo edhe vepra terroriste në vend. Me një kontekst, paraqiten mjaft interesante dhe të favorshëm për të "ushqyer" rrezikun e ekstremizmit faktorët si: shoqëri në tranzicion, sisteme qeverisëse gjithmonë në konsolidim, papunësia, niveli i lartë i varfërisë dhe një fluks i vazhdueshëm dhe i pakontrolluar i rrymave kulturore, media, etj. Këta faktorë vinë në kundërshtim me kulturën tradicionale të rrymës konservatore të Islamit, si pasojë Shqipëria është një terren ushqyes për radikalizëm. Të rinjtë janë të ndjeshëm ndaj një mjedisi që shkakton dhe ushqen radikalizmin, dhe me presionin e faktorëve të jashtëm të konflikteve, ky radikalizim mund t'i dërgojë këta individë deri në kryerjen e veprave terroriste. Organizata e sotme terroriste si Al-Qaeda, etj., kanë mundur të rekrutojnë dhe të radikalizojnë me mjaft lehtësi individët duke përdorur fenë si justifikim për dhunën e tyre. Deradikalizimi në Shqipëri nuk është një temë e hulumtuar dhe shpesh ka mbetur pa vëmendje specifike. Megjithëse në 2015 është miratuar një strategji kombëtare dhe një plan veprimi, masat konkrete për parandalimin e fenomenit, dhe zbatimin e programeve është lënë në dorën e aktorëve ndërkombëtarë dhe organizatave lokale. Më shumë duhet të bëhet për t'u angazhuar në një punë konkrete parandaluese tek ato subjekte që kanë tendencë radikalizimi dhe vëmendja duhet përqendruar në zonat me rrezik të lartë për të parandaluar fenomenin dhe për deradikalizimin e individëve tashmë të radikalizuar e në mënyrë të veçantë të kthyerit nga konflikti në Siri dhe Irak. Ky prezantim do të analizojë faktorët socialë që shndërrojnë Shqipërinë në një terren ushqyes për radikalizimin e individëve, si dhe faktin se si feja është përdorur si një justifikim nga grupet ekstremiste për individët për të kryer akte të dhunshme, dhe domosdoshmërinë për një program kombëtar deradikalizimi.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

Fjalëkyçe:

deradikalizimi, terrorizmi, strategji kombëtare, programe deradikalizimi

1. Pasiguria rajonale dhe globale

Terrorizmi, si një mjet, metodë, proces, dhe projekcion i dhunës psikologjike dhe fizike në kundërshtim me ligjin nuk është diçka e re. Edhe pse taktikat dhe strategjitë e terrorizmit nisen dhe nxiten në emër të parimeve teologjike, apo parimeve “të larta” nacionaliste dhe ideologjike për të arritur objektivat politike, sociale apo ekonomike dhe datojnë që nga kohëra të lashta, sërisht në shekullin XX dhe madje edhe në fillim të shekullit XXI, ato rishfaqen unike si rrjedhojë e shkallës së jashtëzakonshme të globalizimit dhe brutalizimit të kësaj mënyrë të re të luftës me mjete të tjera. Më konkretisht, asnjë komunitet, vend, apo rajon nuk është i imunizuar nga kërcënime të pazakonta dhe konvencionale të terrorizmit. Lindja e Mesme është rajoni më aktiv terrorist dhe kjo paraqet pasoja serioze dhe afatgjata për sigurinë ndërkombëtare. Radikalizmi terrorist është një proces dinamik, sipas të cilit individit nis ta pranojë dhunën terroriste si një rrugë të mundshme, madje edhe legjitime të veprimit. Nuk ka asnjë profil të vetëm i cili do të përfshinte të gjithë terroristët, sikundërse nuk ekziston asnjë rrugë “e prerë me thikë”, e cila i çon individët në rrugën drejt terrorizmit. Shtysat e mundshme të radikalizmit terrorist, janë të ndryshme dhe komplekse, duke u ndërthurur në mënyrë unike për çdo rast specifik. Profilet që ndërtohen mbi bazën e supozimeve të stereotipizuara, mbi bazën e përkatësisë fetare, racore, etnike, gjinore, statusit shoqëror dhe ekonomik etj., jo vetëm që janë diskriminuese, por po ashtu janë edhe të paefektshme. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së hedhin poshtë me vendosmëri identifikimin e terrorizmit me kombësinë, përkatësinë fetare apo etnike.¹

Radikalizimi islamik nuk përbën një fenomen indigjen shqiptar. Ajo ka një dimen-

¹ OSBE. *Parandalimi i Terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që favorizojnë terrorizmin: qasja e policimit në komunitet*. Vjenë, Austri: OSBE, 2014. <http://www.osce.org/atu>

sion global edhe para zhvillimit të tij në Shqipëri. Shqiptarët nuk janë qytetarët e parë që janë përfshirë në Irak dhe Siri, brenda organizatave të terroristëve. Fakti se shumë prej luftëtarëve të huaj vijnë nga vendet evropiane, mund të shërbejë si një faktor stimulues edhe në Shqipëri. Konflikti në Siri, fillimisht është shfaqur në vazhden e “Pranverës Arabe” dhe ka filluar me protesta spontane kundër qeverisë së Bashar al Asadit e më pas këto protesta, kanë evoluuar në konflikt të armatosur, mes opozitës dhe grupeve të ndryshme kryengritëse dhe forcave të armatosura të regjimit shtetëror. Me vazhdimin e konfliktit, kryengritësve u janë bashkuar edhe grupe dhe organizata të ndryshme ekstremiste islamike, në mesin e të cilave edhe organizata “Jahbat Al Nusra”, udhëheqësi i së cilës Abu Muhammad Al Javlani, është zotuar se do të jetë besnik ndaj Al-Kaidës dhe udhëheqësit të saj Ayman Al Zauahiri. Organizata tjetër, e cila është ndarë si fraksion nga “AL NUSRA”, është organizata “ISIS”, “ISIL” apo “DAISH”, (Islamic State of Iraq and Sham/Islamic State of Iraq and Levent/Daule Islamiya Fil Iraku ue Sham). Karakteristikë e kësaj organizate, është ideologjia skajshmërisht ekstreme selefiste dhe axhenda e tyre, është e bazuar në Kalifatin Islam edhe jashtë këtyre dy vendeve në konflikt (Irak dhe Siri). Në konfliktin në Siri janë përfshirë edhe shumë lëvizje dhe organizata të tjera islamike të cilat janë duke luftuar regjimin e Asadit, megjithatë këto lëvizje dhe organizata nuk e ndajnë qëllimin e njëjtë me opozitën siriane, të cilët luftojnë për një Siri të lirë dhe demokratike, por qëllimi i tyre është krijimi i shtetit islamik të Sirisë i cili do të udhëhiqej sipas islamit politik dhe ligjit të Sheriatit. Gjatë gjithë kohës janë raportuar krime të tmerrshme nga regjimi i Asadit kundër popullsisë civile në Siri, megjithatë nuk kanë munguar edhe raportimet për krime makabre të këtyre grupeve islamiste, si ndaj forcave të Asadit po ashtu edhe ndaj qytetarëve të besimeve dhe bindjeve të tjera. Forcave kryengritëse në Siri u janë bashkuar edhe vullnetarë nga shume vende të botës, përfshirë vendet e BE-së, Ballkanit (Bosnja, Kosova, Maqedonia, Serbia, Shqipëria), vullnetarë të cilët kryesisht janë persona që i përkasin ideologjive ekstremiste islamike. Debatet për fenë në Shqipëri kanë mbetur në përgjithësi brenda kufijve të traditës fetaro-myslimane, e cila është e moderuar. Megjithatë, islami radikal ka arritur të depërtojë në mjedisin shqiptar për shkak të faktorëve të caktuar, të cilat janë kulturorë, arsimorë, socialë dhe ekonomikë. Në fakt, në interpretim të këtyre fakteve, rajoni i Ballkanit Perëndimorë (përfshi Shqipërinë) mbeten shqetësim për shkak të së dhënave për prezencën dhe demagogjinë që ofrohet nga “terroristët”, të cilët përdorin këto metoda teologjike dhe nacionaliste për rekrutimin e individëve. Një nga shkaqet për forcimin e radikalizimit ka qenë depërtimi në komunitetin mysliman të rrymave fetare ekstremiste duke indoktrinuar një numër në rritje të individëve.

2. Mjedisi mundësues

Potenciali për radikalizimin e të rinjve në Shqipëri është i lartë: 58% e popullsisë së Shqipërisë janë të moshës 25-45 vjeç, shpesh banues në zona rurale ku mungesa e sigurisë, varfëria, varësia e drogës, mungesës së mundësive arsimore dhe papunësia, lehtësojnë rekrutimin. Radikalizimi gjithashtu ndodh në një moshë shumë të re, me fëmijë të detyruar të bashkohen pranë grupeve ekstremiste, në krah të së rriturit që radikalizohet². Procesi i radikalizimit modern në Shqipëri nuk shfaqet papritur, por

² Horgan, John G. (2015) “Terrorist Deradicalization”. *LA Times*.

Parë për herë të fundit më dt. 10. 8. 2016:

<http://www.latimes.com/opinion/op-ed/la-oe-0215-horgan-terrorist-deradicalization-20150215-story.html>

edhe si thyerje e besimeve tradicionale islame dhe zakoneve kulturore të trashëguara. “Për fat të keq, jeta e ka humbur kuptimin e saj: luftëtarët janë mësuar të besojnë se kjo jetë është e përkohshme dhe duhet të investojnë në jetën pas vdekjes dhe xhihadi është mënyra më e shpejtë për të udhëhequr një jetë të përjetshme në parajsë”³.

Kjo do të thotë se ata kanë qasje të drejtpërdrejtë në grupe të mëdha e mendjet e ndjeshme të të rinjve që mund të ndikohen lehtë nga retorika ekstremiste, apo me të rekrutuar të vërtetë në radhët e terroristëve. Mjedisi ekzistues mundëson radikalizmin dhe u jep atyre dorë të lirë për të perceptuar si kauzë padrejtësitë e tyre. Që prej sulmeve të 11 shtatorit, në Shtetet e Bashkuara, islamofobët dhe manipulorët politikë kanë promovuar idenë e rrjeteve të gjera dhe të koordinuara të islamikëve radikalë në Ballkan, për arsye të ndryshme si justifikimi i planeve për ndarjen e Bosnjës, anulimin e pavarësisë së Kosovës dhe goditje ndaj besimtarëve myslimanë. Teoritë janë se, hartat e kalifatit ISIS përfshijnë Bosnje-Hercegovinën, Sanxhakun, Kosovën, Shqipërinë dhe Maqedoninë dhe se numri i rekrutëve islamikë për ISIS, nga rajoni, është rritur në mënyrë dramatike. Realiteti është më pak i bujshëm. Harta e Kalifatit përfshin edhe Gadishullin Iberik dhe territore të tjera evropiane dhe burimet e inteligjencës, vlerësojnë se ISIS ka tërhequr shumë më tepër vullnetarë nga Evropa Perëndimore sesa nga Ballkani - me Francën, Gjermaninë, Belgjikën dhe Britaninë e Madhe, si kontribuuesit më të mëdhenj. Që nga fillimi i konfliktit në Siri, ashtu si edhe nga vendet e BE-së dhe vendet tjera të rajonit është shfaqur fenomeni i predikimit dhe indoktrinimit për të marrë pjesë dhe më pas është zhvilluar duke marrë pjesë aktive të shtetasve shqiptarë në konfliktin në Siri. Sipas burimeve të ndryshme, numri i vullnetarëve shqiptarë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe vendet tjera evropiane besohet se varion mes 400-500 personave dhe se një numër i konsiderueshëm i tyre, janë shtetas të Republikës së Shqipërisë. Sipas informacioneve të deritanishme, rezulton se drejt Sirisë e më pas në Irak, kanë shkuar për Xhihad, si luftëtarë aktivë, rreth 83 shtetas shqiptarë ku nga këta:

- 30 shtetas Shqiptarë vazhdojnë të jenë pjesë e konfliktit në Siri dhe Irak.
- 13 shtetas Shqiptarë dyshohet se janë vrarë gjatë konfliktit.
- 7 shtetas Shqiptarë janë plagosur.
- 40 shtetas Shqiptarë janë kthyer nga konflikti Sirian.
- 31 shtetas janë familjare (gra e fëmijë) të cilat janë bashkuar me familjarët e tyre në Siri/Irak.⁴

Duhet theksuar se zhvillim i konfliktit në terren, gjatë vitit 2015-2016, është shoqëruar me një tkurrje të madhe të territoreve të zotëruara nga ISIS dhe për pasojë me largimin e shumë luftëtarëve të huaj nga këto territore dhe kthimin e tyre në vendet e origjinës. Komente sensacionale, përpiqen të shkrijnë identitetin mysliman me radikalizmin politik dhe konservatorizmin islam me terrorizmin, duke injoruar faktin se shtetet me shumicë myslimane, njëlloj si shtetet e tjera me shumicë popullsie të krishterë, janë laike dhe pro-perëndimore. Argumente të përsëritura pretendojnë se ekziston një projekt islamist “Shqipëria e Madhe”, i cili ka në qendër Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë. Disa politikëbërës duken të shqetësuar se xhihadizmi ndër shqiptarë është në rritje dhe se ai, paraqet një rrezik afatgjatë për sigurinë e Ballkanit. Ia vlen të kujtohet, megjithatë, se shqiptarët kanë një traditë të fortë të tolerancës fetare. Islami, Ortodoksia dhe Katolicizmi kanë bashkëjetuar në shoqëritë shqiptare me breza me radhë dhe nuk kanë qenë shtyllat

³ Ahmadi, (2015). “Deradicalization in Pakistan”. *Chicago Journal* [online]

Parë për herë të fundit më dt. 10. 8. 2016: <http://chicagojournalfip.com/?p=49>

⁴ Të dhëna të vitit 2015.

e identitetit kombëtar.

Duke pasur parasysh historinë e tyre, shqiptarët duhej të ishin të fundit në Evropë për të përkrahur xhihadin anti-Perëndimor dhe për të marrë pjesë në konfliktin në Siri dhe Irak. Megjithatë, të dhënat e paraqitura me lart flasin për shumë luftëtarë shqiptarë nga Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria që i janë bashkuar grupeve të lidhura me ISIS dhe ky fakt është shoqëruar me arrestime të disa rekrutuesve dhe militantë të njohur në Shqipëri, Kosovë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Ekstremizmi i dhunshëm, radikalizmi dhe prania e trajnimit i luftëtarëve të huaj edhe nga Shqipëria, e shndërron potencialisht vendin në një territor të ekstremizmit fetar, duke e vendosur atë në një objektiv të mundshëm të aktiviteteve terroriste. Ekstremizmi i dhunshëm dhe islami radikal kërcënojnë imazhin e vendit dhe rrezikon krijimin e një perceptimi të gabuar për Shqipërinë, si anëtare e NATO-s, si një vend kandidat për në BE, dhe një kontribuues i vazhdueshëm në luftën kundër terrorizmit që nga fillimi i vitit 1990.

3. Diversifikimi i faktorëve radikalizues

Pavarësisht mjedisit të përshtatshëm të krijuar me anë të kushteve socio-ekonomike, dhuna brenda një komuniteti në vetvete nuk është e mjaftueshme për të radikalizuar një individ. Problemi i radikalizmit i atribuohet shumë faktorëve të ndërlikuar shkakësor, një faktor i vetëm nuk mund të radikalizojë një individ⁵. Shpesh varfëria dhe papunësia, janë mbajtur si faktorët kryesorë që kontribuojnë radikalizimin e një të riu; bashkimin me një grup të dhunshëm radikal vetëm për të shpëtuar nga privimi social, ofrimi i një page dhe mbështetje për familjet e tyre. Megjithatë, një sërë faktorësh mund të luajnë një rol në atë që sot njihet si një proces me faza të radikalizmit, praktika ka treguar se në radhët e radikalëve ekstremistë ka pasur edhe individë me një nivel më të lartë arsimor. Pa asnjë dallim nga rastet në shumë vende të botës si, në Danimarkë, Belgjikë, SHBA, ata ndikojnë pranë familjeve të shëndosha socio-ekonomike, për të krijuar imazhin e mbështetjes. Skepticizmi shpesh shtohet edhe për shkak të mospranimit të kushteve gjeopolitike në vend. Zonat më pak të kontrolluara nga agjencitë ligjzbatuese, formimi i familjeve shqiptare në zonat rurale, - ende me ngjyra të forta patriarkale, - shpesh lehtësojnë shpërndarjen e ideologjisë, sidomos, ruajtjen e saj si gjë të shenjtë. “Kjo gjë rrit mundësitë për të çuar përpara një identitet islamik, të bazuar në lëvizjen shoqërore dhe në mënyrë efektive krijon një rini të radikalizuar për shkaqe potencialisht militante”.⁶

Nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm nuk kufizohen tek faktorë të veçantë, por përfshijnë procese shoqërore, lidhje personale dhe dinamika grupi që lehtësojnë përfshirjen në veprimtari të ekstremizmit të dhunshëm. Radikalizimi fetar (si proces) dhe ekstremizmi i dhunshëm (si rezultat) mundësohen, nxiten dhe/ose formësohen nga një sërë faktorësh dhe nxitësish që operojnë në një kontekst të caktuar të vendit në nivel makro (shoqëror) dhe mikro (individ/grup).⁷

Në literaturën tradicionale të radikalizmit, është theksuar se varfëria dhe papunësia janë drejtuesit e ekstremizmit të dhunshëm, se anëtarësimet e një grupi ekstremist në thelb janë punë për t’i dhënë fund varfërisë për veten dhe familjen e tyre. Megjithatë,

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

⁵ Khan, K. et al. “Causes and Impact of Radicalization on Young People Inside and Outside Pakistan”. *The Rand Corporation* [online], Parë për herë të fundit më dt. 10. 8. 2016: <http://www.ejbss.com/Data/Sites/1/mydata/ejbss-12-1124-causesandimpactofradicalization>

⁶ Haque, R. (2014) “Youth Radicalization in Pakistan”. USIP, 2014 [online].

Parë për herë të fundit më dt. 10. 8. 2016: <http://www.usip.org/publications/youth-radicalisation-in-pakistan>.

⁷ Radikalizimi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri. IDM, Tiranë 2015.

ky arsyetim është vënë në pikëpyetje nga studime të ndryshme që pretendojnë se padrejtësia është arsyeja kryesore prapa radikalizmit. Një studim i Mercy Corps mbi rininë dhe vullnetarizmin, kryer në shumë vende botës, shprehet se, “shpesh supozohet se grupet ekstremiste përbëhen vetëm nga të rinjtë”; në fakt ky është thjesht një faktor kontribuues. “Drejtuësit kryesorë të dhunës politike nuk i gjejnë rrënjët në varfëri, por në përvojat e padrejtësisë: diskriminimit, korrupsionit dhe abuzimit nga ana e agjentëve dhe forcave të sigurisë”⁸. Të dhënat empirike tregojnë se ky lloj drejtimi në radikalizimin e tyre në fakt është ndjenja e padrejtësisë ndaj individëve dhe grupeve, zemërim mbi varfërinë. “Fakti është empirik sepse nuk ka mundur të interpretojë një lidhje të drejtpërdrejtë mes varfërisë kolektive ose individuale dhe terrorizmit. Me fjalë të tjera, një fakt i tillë mbetet mit apo më saktë një gjysmë e vërtetë”.⁹

3.1. Traditat lokale

Shumë nga personat pjesëmarrës në grupet e radikalizuara, në zonat rurale, duhet të respektojnë kodin e sjelljes të komunitetit të tyre, që shpesh ndryshon në varësi të statusit familjar, fisnor, dhe pozicionit gjeografik. Siç u përmend në faktorët socialë, elementë si padrejtësitë, pandëshkueshmëria dhe korrupsioni njihen si mjetet kryesore të rekrutimit. Mungesa e infrastrukturës dhe mbështetja e komunitetit nxisin përfshirjen e të rinjve për të marrë armët për të luftuar kundër këtyre frustrimeve, për të rifituar nderin për veten e tyre, familjen e tyre dhe kulturën e tyre.

4. Arsimimi

Në vlerësim të përgjithshëm të situatës së ekstremizmit dhe radikalizmit në vend, evidentohet fakti se ka individë të cilët që çdo ditë e më shumë, përbëjnë rrezik radikalizimi dhe përfshirjeje në veprime të dhunshme. Pavarësisht punës së përditshme të strukturave antiterror në Policinë e Shtetit dhe agjencive të tjera ligjzbatuese, për mbajtjen nën kontroll të këtyre individëve dhe nxitësve, strukturat investiguese duhet të koordinojnë punën e tyre në adresimin e problematikave të identifikuara në një qasje holistike, duke përfshirë sistemin arsimor (përfshirë atë teologjik) e komunitetin. Në interpretim të këtij indikator, shpesh kontingjenti i individëve të radikalizuar, ka përfaqësuar ata studentë që pas studimeve, janë rikthyer në komunitetet e tyre konservative shpesh me pikëpamje ekstremiste. Sistemi arsimor kontribuon në një formë në hartëzimin e tendencave ekstremiste. Si një sistem i mbipopulluar, shpesh neglizhohet për shkak të mungesës së kapacitetit të mësuesve për të punuar me një numër të lartë nxënësish. Klasat janë të mëdha dhe studentët pa mbikëqyrje. Medresetë shpesh janë konsideruar qendra radikalizimi për të rinjtë (sidomos në vendet e njohura për radikalizim si Afganistani dhe Pakistani). Si formë parandalimi, mund të konsiderohet iniciativa e re e Qeverisë Shqiptare për prezantimin e edukimit fetar në sistemin arsimor, si një mundësi parandalimi ndaj çdo forme të mundshme të rekrutimit të së rinjve. Nëpërmjet adresimit të edukimit fetar nëpërmjet një sistemi të centralizuar, mund të minimizohet mundësia e “kuriozitetit” të së rinjve ndaj ideologjive radikale dhe të dhunshme.¹⁰

⁸ Mercy Corps Annual report, 2015. https://www.mercycorps.org/sites/default/files/Mercy_Corps_2015_Annual_Report.pdf

⁹ Schmid, A. P. (2013) *Radicalisation, De-Radicalisation, Counter-Radicalisation: A Conceptual Discussion and Literature Review*. International Centre for Counter-Terrorism.

¹⁰ Ahmad, M. (2015) “Deradicalization in Pakistan”. *Chicago Journal*,

Parë për herë të fundit më dt. 10. 8. 2016: <http://chicagojournalifp.com/?p=49>

Projekti “Shkolla si qendër komunitare” mund të shndërrohet në një instrument politik afatgjatë të fuqishëm, që i kundërpërgjigjet kërcënimit të ekstremizmit të dhunshëm, duke ofruar shërbime këshillimi e duke vepruar si hallkë qendrore në konceptimin e programeve parandaluese. Mësuesit janë punonjës të rëndësishëm të vijës së parë, të cilët shërbejnë si ndërlidhës brenda komuniteteve. Për rrjedhojë, aftësia e tyre për të shquar dhe për t’u kundërpërgjigjur radikalizimit e përfundimisht, për ta parandaluar atë, duhet forcuar.¹¹

Sipas “Strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar” (2014–2020), Ministria e Arsimit dhe Sportit ka në plan që, gjatë viteve pasardhëse të zgjerojë rrjetin “Shkolla si qendër komunitare”.

Kjo masë do të përmbajë veprimet në vijim:

a) Zgjerimin e rrjetit “Shkolla si qendër komunitare” për t’u shtrirë në zonat problematike.

b) Fuqizimin dhe trajnimin e mësuesve për të dalluar e për të reaguar ndaj shenjave të radikalizimit.

c) Rritjen e mbështetjes për përpjekjet shkollore e jashtëshkollore në shkollat e synuara, për të parandaluar radikalizmin, përfshi edukimin civil e fetar, nismat artistike dhe sportive, klubet e debatit dhe veprimtari të ngjashme që rritin qëndresën.¹²

5. Feja si mjet

Grupet ekstremiste radikale ndryshojnë në bindje, strategji dhe qëllim përfundimtar. Pavarësisht se disa prej tyre me bindje kundër-dhunës, të gjithë kanë ndjenjë antidemokratike, janë kundër strukturave shtetërore¹³. Të gjitha këto grupe kanë të përbashkët interpretimin e tyre konservator tradicional të Kuranit dhe një dëshirë për sundimin e ligjit të Sheriatit. Pavarësisht analizës së mësipërme të shumë faktorëve socio-ekonomikë dhe emancipues, feja mbetet narrativi që i jep kuptim gjithçkaje, ajo është korniza justifikuese e luftës.

“*Si rezultat, retorika fetare është thelbësisht e rëndësishme për procesin e radikalizimit*”¹⁴. Ajo është në qendër të mesazheve të rekrutimit; rekrutuesit përdorin fenë si një mjet me të cilin individët mund të përqendrohen në zemërimin e tyre ndaj pushtetit. Kjo justifikon vrasjet dhe lejon rekrutët për të kanalizuar frustrimet e tyre të lartpërmendura në një objektiv, njëkohësisht për sigurinë e familjeve të tyre dhe rivënien e nderit. Siç u përmend më lart, feja nuk shihet si shkak kryesor i radikalizimit, por ajo duhet të shihet si një tipar përcaktues në aktivizimin e individëve të radikalizuar¹⁵. Pavarësisht nëse feja është moderator

¹¹ *Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm*. Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr 203, viti 2015.

¹² *Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm*. Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr 203, viti 2015.

¹³ Osman, 2015 Taspinar, O. (2009) *Fighting Radicalism, not ‘Terrorism’: Root Causes of an International Actor Redefined*. The Brookings Institute.

[online], Parë për herë të fundit më dt. 10. 8. 2016: http://www.brookings.edu /~/media/research/files/articles/2009/9/summerfallradicalismtaspinar/summer_fall_radi calism_taspinar.pdf

¹⁴ Porges, M. L. (2010) *The Saudi Deradicalization Experiment*. Council on Foreign Relations [online] Parë për herë të fundit më dt. 10. 8. 2016: <http://www.cfr.org/radicalization-and-extremism/saudi-deradicalization-experiment/p21292>.

¹⁵ Aggarwal, N. (2015) “Knowledge and Practice in War on Terror Deradicalization Programs”. *Mental Health in the War on Terror: Culture, Science, and Statecraft*. Columbia: Columbia University Press: pp. 133-156.

apo thjesht një tjetër faktor kontribuues, udhëheqësit fetarë dhe institucionet fetare janë një element thelbësor për luftën ndaj radikalizmit.

Pjesa kërkimore, raportet dhe të dhënat nga strukturat policore, media dhe intervista me ekspertë dhe anëtarë të komunitetit mysliman apo me drejtorët e institucioneve të rëndësishme, tregojnë se ajo që bashkon ekstremistët, është izolimi dhe margjinalizimi i tyre nga pjesa tjetër e shoqërisë. Këta dy faktorë ndikojnë tek xhihadistët duke i bërë ata të përpiqen për të gjetur një kuptim në jetë. Rikthimi i luftëtarëve të huaj në vendet e origjinës, paraqet për ta të njëjtën situatë të papunësisë, të pamundësisë ekonomike për veten dhe familjen e tyre. Programet për nxitjen e punësimit, hapja e vendeve të reja të punës, përfshirja e tyre në jetën shoqërore dhe angazhimin komunitar ndikon drejtpërsëdrejti në shkëputjen e këtij kontingjenti ndaj rinxites së procesit që rezulton në kryerjen e akteve të dhunshme ekstremiste.

Në vendin tonë janë evidentuar grupe dhe individë që përhapin dhe përkrahin ide të Islamit më radikal. Këto grupe dhe individë shpeshherë ndikohen nga elemente fetarë të importuar nga Lindja e Mesme përmes përhapjes së ideve dhe përkrahjes së ideologjive radikale Islamike të luftës së shenjtë apo "xhihadit" kundër Perëndimit dhe SHBA-së. Këta individë të rrymës/sektit selafi/tekfiristë dhe grupe kryesisht aktivitetin e tyre fetar e zhvillojnë jashtë ombrellës së Komunitetit Mysliman Shqiptar. Tekfirizmi përfaqëson një sekt/rrymë radikale të doktrinës vahabiste-salafiste, që bazohet jo vetëm në propagandë e indoktrinim, por edhe në dhunë, që e përdor ndaj çdo kërcënimi që i kanoset islamit të pastër (interpretimit direkt të Kuranit) dhe kërkon zbatimin e formës më të rreptë të Sheriatit (ligjit islamik). Tekfiristët përdorin një varg instrumentesh dhe mjetesh për t'i radikalizuar dhe rekrutuar njerëzit në ideologjinë e tyre, që është njëri nga hapat e parë të nevojshëm për t'u ndërmarrë para se t'i bindin që të shkojnë në Siri. Ndër instrumentet ose mjetet e përdorura, janë xhamitë dhe vetë imamët; megjithatë, ekziston një aspekt i qëllimshëm dhe një i paqëllimshëm i këtyre instrumenteve ose mjeteve që kontribuojnë në tekfirizim. Aspekti i qëllimshëm përfshin rastin kur disa xhami përdoren qëllimisht nga imamët tekfirë për ta përhapur ideologjinë.¹⁶

Nisur nga monitorimi disavjeçar i veprimtarisë radikale religjioze, vërtetohet se, nga persona të caktuar zhvillohet propagandë ekstremiste, në drejtim të:

- promovimit të xhihadit nëpërmjet ushtrimit të dhunës, duke e justifikuar përdorimin e saj me interpretim të Kuranit;
- nxitjes së urrejtjes dhe ushtrimit të dhunës ndaj besimtarëve të feve të tjera, si dhe kundër harmonisë dhe bashkekzistencës fetare;
- mosnjohjes së autoritetit të institucioneve shtetërore, apo në tërësi të funksionimit të shtetit laik, si dhe kundërshtimit/mospranimit të çdo rendi social që nuk bazohet mbi Islamit;
- nxitjes së urrejtjes kundër vendeve Perëndimore, stilit të jetesës dhe vlerave demokratike;
- diskriminimit racial dhe fetar, veçanërisht kundër hebrenjve dhe të krishterëve.

¹⁶ KSCS. *Raport për shkaqet dhe pasojat e përfshirjes së qytetarëve të Kosovës si luftëtarë të huaj në Siri dhe Irak*, KSCS/Kosovar Center for Security Studies. Prishtinë: KSCS 2015.

Këta persona, shprehin haptas bindjet e tyre kundër rendit demokratik dhe përkrahin idenë e Shtetit Islamik, ku sundon kalifi dhe sheriatit dhe tërë sistemi dhe mënyra e jetesës të jetë e organizuar në bazë të fesë islame. Me gjithë angazhimin e vendit tonë kundër ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit, kjo e shprehur në përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare, por edhe nëpërmjet ndjekjes së masave të parashikuara në strategjitë kombëtare apo rajonale, mendoj se është i nevojshëm intensifikimi i punës së të gjitha agjencive ligjzbatuese për zbatimin praktik të strategjive ekzistuese dhe për planifikimin e masave konkrete për parandalimin e fenomenit.

6. Masat kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe angazhimi i Shqipërisë

Shqipëria konsiderohet tradicionalisht një vend tolerant, me dialog konstruktiv ndërftuar dhe një radikalizëm të kufizuar. Por, radikalizimi është një kërcënim global dhe në vitet e fundit Shqipëria është prekur gjithashtu nga fenomeni luftëtarëve të huaj, së bashku me disa shtete anëtare të BE-së dhe vende të Ballkanit Perëndimor. Në nivel global, BE-ja ka ndërmarrë në vazhdimësi veprimet në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm: “Iniciativa kundër terrorizmit për Ballkanin Perëndimor”, drejtuar nga Sllovenia dhe Austria, me mbështetjen e plotë të së gjitha shteteve anëtare të BE-së dhe institucionet e BE-së, ka për qëllim të koordinojë dhe të planifikojë masat kundër terrorizmit dhe luftën kundër aktiviteteve të ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor. Projekti global për forcimin e regjimit ligjor kundër luftëtarëve të huaj terroristë (FTF, ang.) në Lindjen e Mesme, Afrikën Veriore (MENA) dhe vendet e Ballkanit, synon të forcojë kapacitetet në këto vende për të parandaluar dhe për të luftuar terrorizmin, veçanërisht duke shqyrtuar rrjedhën e rekrutëve ndërkombëtarë të organizatave terroriste, duke përfshirë FTF. Raporti vjetor i Komisionit Evropian (2015) njih përparimet e Shqipërisë për të trajtuar radikalizmin dhe terrorizmin dhe bën thirrje për “një politikë efektive për të parandaluar radikalizmin, duke përfshirë masat për zbatimin e ligjit dhe veprimeve socio-ekonomike që kanë për qëllim forcimin e përfshirjes sociale, veçanërisht së të rinjve si dhe shtimin e përparimeve për të identifikuar, parandaluar dhe ndërprerë lidhjet e luftëtarëve terroristë të huaj që udhëtojnë në zonat e konfliktit si Irak dhe Siri”¹⁷.

Në maj 2015, u mbajt Samiti rajonal për Ballkanin në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm me pjesëmarrjen e të gjitha vendeve të rajonit dhe organizatave ndërkombëtare aktive në këtë fushë. Konkluzionet kryesore adresojnë disa çështje:

- nevoja për trajtimin e këtyre sfidave të mëdha nëpërmjet një strategjie gjithëpërfshirëse që identifikon dhe zhvillon një gamë të gjerë të respektimit të së drejtave themelore dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm;
- kundërvënien dhe parandalimin e përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm, nëpërmjet përparimeve të lokalizuara, të specializuara, duke zgjeruar fuqizimin e aktorëve lokalë-pushtetin vendor, të rinjtë, familjet, anëtarët e komunitetit të

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:
“Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit”

¹⁷ Raporti Vjetor, Komisioni Evropian, 2015.

margjinalizuara fetare, kulturore dhe drejtuesit e arsimit për të miratuar qasje të përshtatura ndaj kulturave lokale dhe besimeve fetare në adresimin e këtij fenomeni;

- njohjen e rolit të rëndësishëm që luan gruaja në parandalimin dhe rëndësinë e integritit të grave në përpjekjet kundër ekstremizmit;

- nevojën e vlerësimit të natyrës së kërcënimeve të dhunshme ekstremiste në nivel lokal dhe rajonal, duke përfshirë dhe nxitur analizat kërkimore për të gjitha segmentet e shoqërisë dhe informacionin mbi grupet e marginalizuara;

- nevojën për të intensifikuar përpjekjet për identifikimin e figurave të nderuara lokale dhe angazhimin e tyre në adresimin e mesazheve kundër ekstremistëve të dhunshëm me rrëfime pozitive alternative, dhe de legjitim të ideologjive ekstremiste të dhunshme;

- rëndësinë e ndërtimit të komuniteteve fleksibël në përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe nevojën për zgjerimin e shërbimeve sociale, arsimore dhe ekonomike, veçanërisht për anëtarët e popullsisë të marginalizuara dhe të rinjve për t'iu përgjigjur nevojave të qytetarëve më të rrezikuara;

- nevojën për të zgjeruar programet që fuqizojnë rininë për sipërmarrje dhe mundësi ekonomike dhe rritjen e edukimit qytetar dhe kulturës së paqes dhe tolerancës;

- zhvillimin e strategjive gjithëpërfshirëse kombëtare dhe planeve të veprimit për adresimin e ekstremizmit të dhunshëm, që përfshijnë një shumëllojshmëri të autoriteteve qeveritare dhe shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e kornizave kundër terrorizmit ekstrem.

Në nëntor 2015, qeveria miratoi “Strategjinë për luftën kundër ekstremizmi të dhunshëm”. Strategjia ka për qëllim parandalimin e ekstremizmit me mbështetjen e arsimit të tolerancës dhe qasje të zhvillimit të gjerë profesional me angazhimin e institucioneve qendrore, lokale si dhe komuniteteve fetare dhe shoqërisë civile. Për këtë qëllim, ajo parashikon një rol kryesor për ministritë e arsimit dhe mirëqenies sociale, rinisë dhe punësimit. Programe të tilla si trajnimi i organeve të zbatimit të ligjit mbështesin identifikimin e shenjave të hershme të radikalizimit, si dhe promovojnë fushatat e koordinuara publike në mediet sociale dhe tradicionale; ato janë gjithashtu pjesë e planit programatik të strategjisë.

7. Deradikalizimi në Shqipëri

Për identifikimin e potencialeve dhe programeve është ndërmarrë një analizë krahasimore e programeve të ngjashme në vende të ndryshme. Praktika të konsoliduara ofrohen nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, nëpërmjet programeve të paqes dhe riintegritit, të zbatuara në disa vende si, Egjipti, Jordania, Afganistani. Ky program ka synuar riintegrimin e luftëtarëve në shoqëri duke “kombinuar dimensionet politike, të sigurisë dhe zhvillimit të ndërtimit të paqes” (UNDP, 2013); ky projekt ka synuar edhe riintegrimin e individëve, duke siguruar vende pune dhe të ardhura. Kjo është një version i programeve të deradikalizimit, të zbatuar edhe në vende të tjera, që në thelb lufton varfërinë si nxitës kryesor në radikalizim. Ky program nuk ka adresuar në fakt, faktorë të tjerë socialë dhe kulturorë si dhe injoron rolin e fesë si moderatore - përkundrazi – ai e ka konsideruar atë si nxitëse dhe si justifikim për dhunën (Derksen, 2011). Me

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

konvergimin e faktorëve të përmendur më lart, është me rëndësi që qeveria, aktorët ndërkombëtarë dhe organizatat lokale të punojnë së bashku për të trajtuar pasojat e pashmangshme dhe çështjet e radikalizimit dhe procesin e tij. Prioritet duhet të vendosen në frenimin e këtyre furnizuesve të radikalizimit; luftën kundër ndikimit që kanë ata mbi popullatën. Përpyekjet aktuale dhe të kaluara në vende të tjera që kërkojnë të deradikalizojnë individët gjithashtu fokusohen në stimuj të tillë si, formimi profesional, kreditë me interes të ulët të biznesit të vogël dhe disa lloj trajnimesh profesionale. Megjithatë, këto programe, përveç fuqizimit ekonomik, duhet të koordinojë edhe përpyekjet për rehabilitimin, mbështetjen psikologjike dhe shkëputjen e individëve nga shkollat dhe besimet ekstremiste. Në Indonezi dhe Arabinë Saudite, vende me shumë luftëtarë që kthehen nga Afganistani, programet e deradikalizimit kanë qasje të neutralizimit të kondicionuar të aspekteve ideologjike¹⁸. Kjo është arritur në kombinim me mbështetjen financiare, me shpresën se me këtë qasje, radikalët do i shohin autoritetet si më të besueshme dhe të gatshme për t'i ndihmuar. Kjo pasohet nga programe të përkujdesjes së vazhdueshme që kërkojnë sigurinë për mos përsëritje¹⁹.

Ka shembuj të ndryshëm të programeve të deradikalizimit në mbarë botën, të cilat kanë pasur shkallë të ndryshme suksesi dhe kërkesa të bëra nga qeveritë e caktuara. Analiza e këtyre praktikave mund të jetë pikënisje e përshtatjes së praktikave të mira për Shqipërinë. Një implikim i kësaj analize krahasimore, është se programet e deradikalizimit nuk mund të transplantohen thjesht nga një vend në tjetrin, madje edhe brenda të njëjtit rajon. Ata duhet të zhvillohen organikisht në një vend dhe kulturë të veçantë²⁰.

Prandaj çdo program duhet t'i përmbahet situatës dhe kontekstit gjeografik, vendor dhe fetar, duke zbatuar një qasje graduale. Praktika botërore tregon se programet e deradikalizimit mund të kenë rezultate pozitive vetëm nëse adresohen në mënyrë rigorozë tek rrënjët dhe zanafilla e problemeve në vend. Në të vërtetë shumë luftëtarë më shumë gjasa do të bëhen më të radikalizuar dhe të trajnuar për të kryer veprimtari terroriste kur të kthehen në rajon apo në vendin tonë. Duke mos kuptuar asgjë tjetër veç dhunës, ata mund të përpiqen të kthehen në shtëpi, ndaj nevoja e programeve rehabilituese mund të shndërrohet në emergjencë për këta persona. Për më tepër, kjo qasje do të konsolidonte rezultate në kuadër të strategjisë ndërkombëtare të antiterrorizmit dhe do të sillte angazhim të komunitetit për punën ndaj të rikthyerve. *Në të vërtetë, programet e deradikalizimit marrin kohë, ato nuk mund të zbatohen me formulë dhe fakti që ato ose janë në fazë fillestare ose mungojnë krejtësisht, sjell probleme që mund të shndërrohen në kërcënim për vendet.*²¹

Pakistani është angazhuar në programe të ndryshme deradikalizimi, me të rinjtë dhe të burgosurit që kanë potencial për radikalizim dhe ata që kanë kryer

¹⁸ Porges, M. L. (2010) *The Saudi Deradicalization Experiment*. Council on Foreign Relations [online]. Parë për herë të fundit më dt. 10. 8. 2016: <http://www.cfr.org/radicalization-and-extremism/saudi-deradicalization-experiment/p21292>

¹⁹ Schulze, K. (2008) *Indonesia's Approach to Jihadist Deradicalization*. Combating Terrorism Center [online]. Parë për herë të fundit më dt. 10. 8. 2016.

²⁰ Rabasa et al, 2010 Rabasa, A., Pettyjohn, S., Ghez, J., Boueck, C. (2010) *Deradicalizing Islamist Extremists*. The Rand Corporation [online]. Parë për herë të fundit më: dt. 10. 8. 2016: http://www.rand.org/content/dam/rand/pubs/monographs/2010/RAND_MG1053.pdf

²¹ Horgan, John G. (2015) *Terrorist Deradicalization*. LA Times <http://www.latimes.com/opinion/op-ed/la-oe-0215-horgan-terrorist-deradicalization-20150215-story.html>

tashmë akte ekstremiste të dhunshme. *Pakistani ka ndërmarrë një qasje holistike që përfshin aparatit e sigurisë, sistemet politike, shoqërore dhe edukative*²². Në këto programe ofrohet këshillim psikologjik për të burgosurit me trauma të luftës, arsim të ofruar nga imamë për t'iu kundërvënë besimeve ekstremiste, dhe formim profesional për t'i bërë ata ekonomikisht të pavarur. *Gjatë programeve, ofrohet dialog alternativ dhe diversitet, ndërveprim fetar*²³.

Praktikat më të mira nga këto shembuj ofrojnë një qasje shumëplanëshe që konsideron një sërë ndërhyrjesh, duke përfshirë udhëzimin fetar, trajnim profesional, mbështetje psikologjike dhe masat mbrojtëse për individët dhe të afërmit. Qasjet duhet të trajtojnë burimet e dhunës, jo simptomat. Akademikët, qeveritë përkrahin e përdorimin organizata joqeveritare në nivel komuniteti dhe organizatat e shoqërisë civile për të sjellë së bashku aktorët si: viktimat e dhunës, të afërmit e luftëtarëve të huaj të kthyer, ekstremistë të reformuar, imamët e xhamive, etj. Këta aktorë pastaj mund të punojnë me organizatat për të ndihmuar individët në deradikalizim, duke u fokusuar në vlerat e përbashkëta historike dhe kulturore dhe në anët pozitive të paqes e bashkëjetesës. Përveç kësaj ndryshimi i një individi ish-anëtar i një organizate ekstremiste dhe deradikalizimi deri në kthimin në e bashkëjetesës normale me komunitetin, do të krijojë praktika pozitive për informim për luftëtarët e tjerë të kthyer dhe për vazhdimin e programeve konkrete rehabilituese edhe për këta individë. *Është e rëndësishme për të identifikuar grupet parësore të këtyre përpjekjeve, veçanërisht të rinjtë, ish-luftëtarë, refugjatë, dhe të burgosur të cilët janë më të rrezikuar për rekrutim dhe radikalizëm*.²⁴

Kuptimi i gjendjes së pasigurt të zonave të veçanta ndihmon sqarimin se si radikalizimi ndodh në kontekstin shqiptar, duke theksuar mundësitë pragmatike për përpjekjet për deradikalizim. Megjithatë, është e vështirë puna për studimin e situatës për personat e identifikuar më në rrezik (masa parandaluese) dhe për të zhvilluar me ta masa për rehabilitimi (deradikalizimin). Për këtë të fundit, edhe pse është një proces jo shumë i komplikuar, përsëri ka nevojë për ndërtimin e besimit, për punë të vazhdueshme dhe, siguri për mospërsëritje të situatës së radikalizimit. Synimet e vendosura nga qeveria në strategjinë kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe planit të veprimit duhen konkretizuar nga strukturat e ngarkuara në strategjinë e miratuar. Nevoja e menjëhershme në Shqipëri mbetet për të trajtuar mekanizmat për radikalizimin dhe grupet më të rrezikuara në radikalizëm. Programet që ofrojnë një gamë të ndërhyrjeve të tilla si, formimi profesional, mbështetje psikosociale dhe masat individuale dhe familjare të mbrojtjes mund të ndihmojnë në rehabilitimin e të rinjve. Programet duhet të trajtojnë në mënyrë të qartë dhe në mënyrë sistematike drejtuesit e dhunës.

8. Përfundime

Mungesa e çdo strategjie koherente për të arritur deradikalizimin duhet të

²² Khan, 201, Op. cit Khan, A. (2015) Deradicalization Programming in Pakistan. *USIP* [online]. Parë për herë të fundit më dt. 10. 8. 2016:: <http://www.usip.org/publications/2015/09/14/deradicalization-programming-in-Pakistan>.

²³ Khan, 2015, Op. cit.

²⁴ Haque, R. (2014) "Youth Radicalization in Pakistan". *USIP* [online]. Parë për herë të fundit më dt. 10. 8. 2016: <http://www.usip.org/publications/youth-radicalisation-in-pakistan>.

jetë shqetësim për shoqërinë shqiptare dhe për agjencitë e zbatimit të ligjit që merren me antiterrorizmin. Konteksti

i rekrutëve të mundshëm për t'u bashkuar me grupe ekstremiste është përhapur për shkak të mjedisit të dhunshëm të vendit tonë, me përqindje të lartë të varfërisë, papunësisë dhe nivele të ulëta të arsimimit. Nëse ky kontekst i pakontrolluar do të zgjerohet, kjo do të shkaktojë paqëndrueshmëri në vend dhe në rajon. Feja është përdorur si një justifikim nga grupet ekstremiste ndaj individëve për të kryer akte të dhunshme në një vend me balancë të ndryshme fetare dhe me qasje konservative. Ekzistenca edhe në vitin 2016 të mjaft xhamive jashtë autoritetit të komunitetit mysliman shqiptar si dhe organizimi i faljeve dhe dëgjësive në xhami të improvizuara, mbetet një shqetësim i vazhdueshëm për prirjen e të rinjve drejt rrymave ekstremiste të islamit dhe për një radikalizim të tyre. Cenimet e rendit dhe të sigurisë publike dhe moskuptimi i reformave të ndërmarra, përkeqëson problemin dhe lejon më shumë persona drejt radikalizimit. Me gjithë investimet dhe bashkëpunimin në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, vendi ynë nuk ka zhvilluar ende programe specifike deradikalizimi, duke shtuar urgjencën e ndërhyrjeve të centralizuara, angazhimin e aktorëve lokalë dhe të shoqërisë civile e komunitetit. Përfshirja e donatorëve ndërkombëtarë dhe marrja e analizimit i përpjekjeve pozitive në vendet e tjera me synim krijimin e programeve kombëtare të deradikalizimit, mbetet një hap në drejtimin e duhur, që t'iu mundësojë luftëtarëve të riintegrohen në shoqëri dhe të shkëputen përfundimisht nga dhuna. Deradikalizimi nuk është kurë, apo dozë ndërhyrjesh përkundrazi, zbatohet në kontekst kombëtar, mbi mësimet e nxjerra dhe praktikën botërore të konsoliduar. Përfshirja në këto programe deradikalizimi, e komuniteteve fetare, e shoqërisë civile, e strukturave të pushtetit vendore, e agjencive të zbatimit të ligjit, e individëve të ndryshëm me peshë të madhe në komunitet, mbeten domosdoshmëri dhe garanci për suksesin e këtyre programeve.

Referenca

1. OSBE. *Parandalimi i Terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që favorizojnë terrorizmin: qasja e policimit në komunitet*. Austri: Botim i OSBE, Vjenë 2014.
2. Instituti IDM. *Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri*. Tiranë: IDM, 2015.
3. KSCS. *Raport për shkaqet dhe pasojat e përfshirjes së qytetareve të Kosovës si luftëtarë të huaj në Siri dhe Irak*. Prishtinë: KSCS/Kosovar Center for Security Studies, 2015.
4. Aggarwal, N. "Knowledge and Practice in War on Terror Deradicalization Programs". In *Mental Health in the War on Terror: Culture, Science, and Statecraft*. Columbia: Columbia University Press, 2015, 133-156.
5. *Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm*. Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr 203, viti 2015.
6. Ahmad, M. (2015) "Deradicalization in Pakistan". *Chicago Journal* [online], gjendet: <http://chicagjournalfcp.com/?p=49>.
7. Ahmadi, B. (2015) "Afghan Youth and Extremists". *USIP* [online], gjendet: <http://www.usip.org/sites/default/files/PB188-Afghan-Youth-and-Extremists.pdf>
8. Ali, O. (2015) "The 2015 Insurgency in the North case studies from Kunduz and Sar-e-Pul Provinces". *Afghan Analysts Network* [online], gjendet: <https://www.Afgan-analysts.org/the-2015-insurgency-in-the-north-case-studies-from-kunduz-and-sar-e-pul-provinces>.
9. Burke, J. (2013) "Fighting terrorism: Do 'deradicalisation' camps really work?" *The Guardian* [online], gjendet: <http://www.theguardian.com/world/2013/jun/09/terrorism-do-deradikalizimi-camps-work>.
10. Haque, R. (2014) "Youth Radicalization in Pakistan". *USIP* [online], available: <http://www.usip.org/publications/youth-radicalisation-in-pakistan>.
11. Horgan, John G. (2015) "Terrorist Deradicalization". *LA Times* <http://www.latimes.com/opinion/op-ed/la-oe-0215-horgan-terrorist-deradicalization-20150215-story.html>
12. Khan, A. (2015) Deradicalization Programming in Pakistan. *USIP* [online], gjendet: <http://www.usip.org/publications/2015/09/14/deradicalization-programming-in-pakistan>.
13. Khan, R. K., & Khan, S., & Aziz, R., & Rehmat, U. S. (2012) *Causes and Impact of Radicalization on Young People Inside and Outside Pakistan*. The Rand Corporation [online], gjendet: <http://www.ejbs.com/Data/Sites/1/mydata/ejbss-12-1124-causesandimpactofradicalization>
14. Porges, M, Stern, J. (2010) *Getting Deradicalization Right*. Foreign Affairs [online], gjendet: <https://www.foreignaffairs.com/articles/persian-gulf/2010-05-01/getting-deradicalization-right>.
15. Porges, M. L. (2010) *The Saudi Deradicalization Experiment*. Council on Foreign Relations [online], gjendet: <http://www.cfr.org/radicalization-and-extremism/saudi-deradicalization-experiment/p21292>.
16. Rabasa, A., Pettyjohn, S., Ghez, J., Boueck, C. (2010) *Deradicalizing Islamist Extremists*. The Rand Corporation [online], gjendet: http://www.rand.org/content/dam/rand/pubs/monographs/2010/RAND_MG1053.pdf
17. Schmid, A. P. (2013) *Radicalisation, De-Radicalisation, Counter-Radicalisation: A Conceptual Discussion and Literature Review*. International Centre for Counter-Terrorism.
18. Schulze, K. (2008) *Indonesia's Approach to Jihadist Deradicalization*. Combating Terrorism Center [online], gjendet: <https://www.ctc.usma.edu/posts/indonesia%E2%80%99s-approach-to-jihadist-deradicalization>
19. Taspinar, O. (2009) *Fighting Radicalism, not 'Terrorism': Root Causes of an International Actor Redefined*. The Brookings Institute [online], available: http://www.brookings.edu/~media/research/files/articles/2009/9/summerfallradicalismtaspinar/summer_fall_radicalism_taspinar.pdf

Policimi dhe shoqëria, një marrëdhënie interaktive afatgjatë bazuar në edukim dhe përgjegjshmëri

Msc. Ardi VELIU

Drejtoria e Policisë Rrugore

ardi.veliu@asp.gov.al

Abstrakt

Të jesh punonjës policie, nuk është thjesht një detyrë, por shumë më tepër se kaq. Nëse dëshiron të jesh i vlefshëm për shoqërinë, komunitetin ku bën pjesë, atëherë karriera në këtë organizatë është një mundësi, por jo për këdo. Ajo paraqet mbi të gjitha rrezikshmëri në përballjen me krimin, me njerëz të cilët me sjelljen e tyre deformojnë vlerat sociale dhe vënë në pikëpyetje vet ekzistencën e shoqërisë. Është një nga detyrat më të vështira për t'u realizuar. Kjo kërkon përgjegjshmëri në kryerjen e detyrave rutinë, punës në grup, fitimit të respektit në shoqëri, etj. Realizimi i këtyre, do të thotë të heqësh dorë nga vetvetja e nga familja, në funksion të një qëllimi më të madh. Një domosdoshmëri në suksesin e këtij qëllimi është edukimi policor, i cili duhet të kalojë në disa faza, për t'u konkretizuar me formim oficerësh policie të aftë për të zgjidhur situata të komplikuar dhe për të zbatuar ligjshmërinë me përpikmëri. Organizata jonë policore, është e përfshirë në një ristrukturim të plotë të saj, duke ridizajnuar rolet, gradat dhe edukimin policor, me synim dhënien e kredibilitetit që duhet të gëzojë në shoqëri, - nga ajo dhe për atë. Ristrukturimi i saj, nis me kriterin edukim, duke u riorganizuar në hierarki dhe kurrikula në Akademinë e Sigurisë dhe Kolegjin e Policisë, për t'i dhënë asaj një dimension tjetër. Për këtë qëllim, është realizuar një pyetësor, i shpërndarë te kursantët që mbaruan Shkollën Bazë të Policisë (Kolegjin e Policisë), për të rivlerësuar performancën e shkollës, si në nivelin didaktik ashtu dhe atë logjistik. Analizmi i tij, synon të evidentojë fushat ku instancat përkatëse duhet të fokusohen më synim përmirësimin e tyre në të ardhmen. Natyrisht që ky përmirësim duhet të përkojë me performancën e organizatës policore në tërësi, për të përgatitur policinë e gjeneratës së re.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit»

Fjalëkyçe:

policimi dhe shoqëria, edukimi, performanca policore, përgjegjshmëria policore.

1. Hyrje

Duke pasur parasysh rëndësinë e rolit të policisë në shoqëri, misionit, përgjegjësive të saj në fushën e sigurisë publike, marrëdhëniet që ajo krijon me qytetarët dhe institucionet e tjera, punonjësi i policisë duhet të jetë domosdoshmërisht një person me edukim të lartë. Njohuritë me të cilat duhen të pajiset, janë njohuri që e fokusojnë policimin si një shërbim të një organizate komplekse, që mund të trajtojë dhe të zgjidhë problematika të ndërlikuara dhe të shumëfishta në fushës e sigurisë. Rrjedhimisht, punonjësi i policisë, pavarësisht funksionit dhe pozicionit që gëzon në strukturën e kësaj organizate, duhet të jetë minimalisht i pajisur me njohuritë e nevojshme profesionale policore.

Përvojat praktike, në një mënyrë apo tjetrën, kanë treguar se vlerat intelektuale janë aspekt i rëndësishëm në formimin e konceptit modern të shërbimit policor dhe në veprimtarinë e saj konkrete. Kështu, mund të themi se, një kriter parakusht për formimin modern të organizatës policore është që, çdo punonjës policie duhet të zhvillojë aftësitë e tij intelektuale në përputhje me interesin e shoqërisë ku ai bën pjesë. Krijimi i vetëbesimit, bazuar në karakteristikat jo vetëm individuale, por edhe si rrjedhojë e standardeve të larta që kërkon organizata, është domosdoshmëri e ditëve të sotme, për të krijuar një polici bashkëkohore. Çdo punonjës policie duhet të zhvillojë aftësitë e reagimit inteligjent, duke u përshtatur me ndryshimet e mjedisit dhe shoqërisë, duke shprehur aftësi dhe vetëbesim, si edhe të ndiejë përgjegjësinë për detyrën që kryen. Krijimi i ndjesisë së përgjegjësive në çdo veprim të punës së tij, e mundësuar kjo edhe gjatë formimit të tij policor, hedh themelet për një shtet demokratik, për të cilin ligji është i padiskutueshëm, nga të gjithë dhe për këdo.

Për arsyet e mësipërme, profesionalizmi i punonjësit të policisë, themi se është një ndër kushtet kryesore për të qenë i suksesshëm. Punonjësi i policisë profesionist, me

aftësitë e veta krijuese dhe intelektuale, në mjedisin ku shërben, duhet të tejçojë besimin se në kushtet aktuale, në botën demokratike, veprimet policore nuk bazohen ekskluzivisht në masa ekspresive. Në këtë kuadër, ai duhet të udhëhiqet nga parimi i mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, zbatimi i ligjshmërisë; të ketë aftësi për të marrë vendimet e duhura në situata të vështira duke kultivuar kulturën e sjelljes të një punonjësi në shërbim të qytetarit dhe për qytetarin, mbi të gjitha duke reflektuar humanizëm. Është me rëndësi të veçantë që njohuritë e përftuara të mos ngelin në suazën e intelektualizmit. Ato duhet të vendosen në funksion të organizatës policore, duke bërë të mundur realizimin e detyrave dhe objektivave në shënjestër. Në organizatën policore nuk mund të flasim për punonjës policie të fuqishëm dhe autoritarë, pa njohjen e mirë të rregullave institucionale dhe juridike, të profesionit, të parimeve udhëheqëse, të qëndrimit korrekt dhe të veprimeve ndaj bashkëpunëtorëve, të respektimit të dinjitetit dhe të së drejtave të tyre, të nderimit dhe të pranimit të figurës së tij, të gadishmërisë për të marrë përgjegjësi dhe të përkushtimit për realizimin e qëllimeve të organizatës. Punonjësi i policisë duhet të ketë komunikim të mirë dhe duhet të jetë i përgjegjshëm për të mësuar bashkëpunëtorin kur konstaton mangësi në veprimtarinë e tij. Me njohuritë profesionale dhe eksperiencën, respektin e ndërsjellë, qëndrueshmërinë dhe besimin, duhet që të kontribuojë në mënyrë maksimale në formimin dhe kulturën e sjelljes të kolegëve dhe veprimtarinë e tyre humane. Koncepti i policisë moderne kërkon nga çdo punonjës që me shembullin e tij të jetë aktiv për të ndikuar pozitivisht në sjelljen dhe kulturën e organizatës ku ai bën pjesë. Paralelisht me komunikimin, ai duhet të ketë aftësi tekniko-profesionale operuese. Vetëm me metoda didaktike, efikase dhe të sofistikuar, - nëpërmjet trajnimeve, kualifikimeve si edhe me përdorimin e mjeteve më të mira, - duhet që të gjendet koha dhe mënyra për kualifikimin dhe trajnimin e çdo punonjësi policie, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me profile dhe shkallë të ndryshme profesionalizmi.

Shkollimi i punonjësit të policisë nënkupton që çdo njëri prej tyre duhet të mbartë në vetvete kualifikime, trajnime e specializime, duke u udhëhequr nga humanizmi dhe respektimi i marrëdhënieve brenda organizatës, si parakusht për konfirmimin individual. Kjo është një ndër kriteret më të rëndësishme drejt përmirësimit dhe ecjes përpara të organizatës policore, sidomos në marrëdhëniet me shoqërinë. Sipas studimeve menaxheriale, është vërejtur se ka lidhje pozitive mes përmasave të karakteristikave të punës dhe qëndrimeve pozitive të sjelljes së punonjësve¹.

Formula e cila i përmbledh këto karakteristika, e quajtur si korja potenciale e motivimit - MPS është si vijon:

$$MPS = \frac{\text{Varietet aftësish} + \text{Identifikim detyre} + \text{Domethënie detyre}}{3 * \text{Autonomi} * \text{"Feedback"}}$$

Formula ka ndikim të madh në dizajnimin e punës. Vihet re se punët me nivele të ulëta të varietetit të aftësive, identifikimit të detyrës dhe domethënies së saj, mund të jenë motivuese nëse pjesa tjetër e formulës, autonomia dhe "feedback" janë në nivele të larta. Është e rëndësishme që puna të jetë e motivuar dhe duhet që ajo të ketë patjetër autonomi dhe "feedback". Në këtë rrugë të reformave dhe modernizimit të forcave policore, organizata e policisë formon dhe bën aktive përpjekjet e saj, me synim realizimin e objektivave. Edukimi, është një shtyllë mbështetëse e rëndësishme, por jo vendimtare

¹ Hackman, J. R dhe Oldham, G. R. *Job Characteristic Theory*. 1976, f. 24-26.

në performancën e punonjësit të policisë. Është e nevojshme që ai të ketë edhe aftësi praktike. Rrjedhimisht, për të ditur se sa mirë gërshetohen këto dimensione, janë grumbulluar të dhëna dhe konkluzione nga dy burime kryesore:

- burimi primar: të dhëna nga pyetësi i shpërndarë ndërmjet kursantëve;²
- burim sekondar: shqyrtimi i arritjeve nga kazuse të ndryshëm në këtë fushë, në rajone të ndryshme.

Nëpërmjet metodës SËOT, do të fokusohemi në analizimin e të dhënave të grumbulluara për të parë se cilat janë fushat edukative që kanë nevojë për përmirësim dhe sidomos marrëdhëniet në komunitetin përkatës të Kolegjit të Policisë, raportet didaktike instruktor-kursant, etj., me synim rritjen dhe përmirësimin e rezultateve. Përdorimi i programit statistikor do të mundësojë nxjerrjen e rezultateve të duhura në funksion të synimit. Një kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet punës në lidhje me kuadrin e ri, sepse për çdo punonjës policie fillimi është i vështirë dhe ndeshet me eksperiencën të panjohura më parë. Prandaj, mënyra sesi do t'i trajtojë organizata policore punonjësit e rinj, në ditët e tyre të para të punës, do të varet edhe suksesi i tyre fillestar, efikasiteti, zhvillimi, përkushtimi si dhe vazhdimësia e tyre në të ardhmen. Vetëm duke respektuar vlerat e gjithsecilit, organizata ofron mundësi për zhvillimin krijues të aftësive policore duke u larguar nga praktikat e ngurta tradicionale.

2. Planifikimi dhe përgatitja e punonjësve për drejtues në polici

Kur e vendos dikë në ndonjë post, ki kujdes që njeriu të cilin je duke vendosur, të jetë i aftë për atë post, e jo të ketë mungesa në aftësi (*Kai Kaus, 1982*). Çdo detyrë nuk mund t'i besohet gjithkujt, prandaj punën besoja atij që di ta bëjë më mirë, në këtë mënyrë evitohen edhe problemet. Nëse nuk bëhet planifikimi afatshkurtër dhe afatgjatë për kuadrin policor, mbi bazën e të cilit do të mund të bëhet dhe projekcioni i kuadrin policor në të ardhmen, kjo mund të çojë në krijimin e një vakuumi apo gjendje patologjike të qetë të sistemit policor. Në këtë kontekst, patologjia nënkupton atë pjesë të strukturës menaxheriale ose drejtuese, e cila nuk pajtohet lehtë me formimin modern dhe rolin e policisë në shoqërinë moderne dhe demokratike, shpesh herë edhe duke iu kundërvënë. Për këtë arsye, planifikimi i kuadrin është një ndër faktorët e rëndësishëm për realizimin e doktrinës së veprimit policor. Për shkak të specifikës organizative dhe shumëllojshmërisë së detyrave, kërkesat për një model të ri policor, kushtëzohen edhe nga politika e ndjekur për të, sidomos edhe nga strategjia për shkollim, trajnim, kualifikim dhe specializim në fusha të veçanta dhe në mënyrë të vazhdueshme, të punonjësve të policisë. Policia ka institucionin e saj arsimor përgjegjës për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit³, i ndarë ky, në nivel operues, administrativ dhe menaxherial.

Akademia e Sigurisë është i vetmi institucion arsimor në fushën e sigurisë, përgjegjës për:

- formimin e punonjësve të policisë dhe të specialistëve të policisë (shkollimi bazë policor, shkollimi për ngritjen në gradën “nënkomisar” dhe “drejtues”);
- trajnimin për ngritjen në gradën “komisar”, “kryekomisar” dhe “drejtues i parë”;

² Kursi IX i Shkollës Bazë të Policisë, Akademia e Sigurisë, 25-30 qershor 2015.

³ Bazuar në nenin 37 ligji nr 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

- trajnimin e specializuar dhe të avancuar të së gjitha shërbimeve të policisë;
- kualifikimin e punonjësve të policisë;
- trajnimin e vazhduar ricertifikues të shërbimeve të policisë;
- trajnimin e personelit të agjencive të tjera të zbatimit të ligjit.

Sikundërse, çdo gjë ndjek ciklin e vet natyror, edhe akademja policore ka pësuar transformime, duke nxjerrë në pah rolin e tre niveleve menaxheriale, për t'u arritur rezultatet e pritshme.



Figurë 1 : Rolet menaxheriale në organizatën policore

Është e nevojshme dhe e domosdoshme që, tre nivelet menaxheriale të konvergojnë në treguesit e punëve të tyre, me synim realizimin e kores së vlerave të organizatës⁴. Kjo e fundit, rezultante e punës së tre niveleve (të parë, të mesëm dhe të lartë), bën të mundur identitetin e figurës policore në shoqëri, transmeton fuqinë dhe sigurinë e shtetit dhe hedh premisat për një karrierë në organizatë të bazuar në meritokraci dhe aftësi individuale.

Hulumtimi i funksionalitetit dhe efikasitetit të sistemit policor dhe studimi i programeve të saj arsimore, në përgjithësi mund të thotë formim, zhvillim gradual i proceseve drejtuese operative –strategjike dhe që varen nga si funksion, nga kriteri edukim. Edukimi nuk presupozon vetëm zhvillimin socio-intelektual të individit, por mundëson edhe transferimin tekniko-shkencor të njohurive. Për më tepër, kjo, në fushën e sigurisë, është kriter i padiskutueshëm i marrëdhënieve interaktive me institucione simotra bashkëkohore, për të zgjidhur dhe ezauruar çështje të ndryshme. Gjatë këtij procesi të vazhdueshëm, bazuar edhe në natyrën njerëzore, çdo anëtar i organizatës policore ka mundësi të performojë më mirë, të zhvillohet dhe të mund të nxjerrë vlerat më të mira të tij, pra të vetëaktualizohet. Sistemi i edukimit, në përgjithësi, duhet të jetë i tillë që përmbajtja e tij të jetë burim i mendimeve kreative dhe i reformave, duke marrë parasysh dinamikën gjithnjë e më të madhe të proceseve shoqërore, ekonomike, teknologjike dhe ato sociale. Gjatë fazës së transferimit të njohurive, është e nevojshme që ato të përshtaten me strukturën dhe në mënyrë konstante të testohen nëpërmjet aktiviteteve konkrete. Në realizimin e këtyre funksioneve rol të posaçëm kanë punonjësit udhëheqës. Në mënyrë që ky proces të zhvillohet suksesshëm, baza potenciale e njohurive dhe ekspertizës duhet të jetë e gjerë , për të mundësuar sistemin

⁴ Memaj, Bilbil. *Lidershipi në policinë e shtetit : rasti i Shqipërisë*. Tiranë: Kristalina-KH, 2016, f. 69.

e vlerave të nevojshme për realizimit të detyrave të planifikuara.

Duke u fokusuar në strukturën policore aktuale, bazuar edhe në hapat reformuese të ndërmarra, kërkesa për edukimin e policisë dhe kuadrit udhëheqës, nuk ka qenë kurrë më parë, kaq imperative. Kjo në fakt, ka rrjedhur edhe nga tërësia e faktorëve dinamikë politiko-ekonomik, social-kulturorë, e nga ndikimi i marrëdhënieve korrelative ndërmjet tyre, të zhvilluara gjatë dimensioneve kohore të vendit. Rrjedhimisht, policia nuk kishte sesi të mos prekej nga këto ndikime, duke i mëshuar rritjes së rolit të sistemit modern policor, në përputhje edhe me kërkesat moderne të shoqërisë, për t'u kthyer në një nga profesionet më të rëndësishme, edhe nga pikëpamja sociale. Arsimi në polici, në të gjitha nivelet e tij, duhet të ketë matricën e përdorimit të gjithanshëm në veprimin konkret të forcave policore, në mënyrë që njohuritë dhe aftësitë të jenë instrumente në segmente të ndryshme të zbatimit të detyrave të sigurisë. Për këto arsye, duhet të ketë karakter të sistematizuar dhe të vazhdueshëm, me përthithje dhe edukim konstant të anëtarëve, sidomos të drejtuesve në nivele të larta, pasi ata janë përgjegjës për funksionimin efikas të strukturës policore. Ndaj, ekzistojnë kërkesa të arsyeshme që në ndryshimin e policisë, pikënisja duhet të jetë e mbështetur te strategjitë inovative edukuese e sidomos te roli i tyre shoqëror. Ndryshimet, shpeshherë në fazat fillestare të tyre, shoqërohen me përpjekje penguese edhe nga struktura të brendshme policore, në varësi të perceptimeve të tyre të impaktit të këtyre ndryshimeve në jetën e përditshme⁵. Sistemi policor duhet të tregojë aftësi, të tërheqë njerëz të shkolluar dhe të përmirësorë kushtet të cilat garantojnë në vend të parë, autonominë e tyre dhe vetërespektimin, duke braktisur filozofinë e nënshtrimit të ashpër ndaj eprorit. Nëse ndodh kjo e fundit dhe në masë të gjerë në strukturat policore, atëherë cenohet vetë MPS – thelbi i motivimit të punonjësve, duke cenuar madje në afat të gjatë, edhe vetë misionin e policisë. Sa më lart të ngjitemi në nivelin hierarkik të organizatës, aq më i nevojshëm është stili i leadershipit jo autoritar, duke mundësuar përthithjen e informacioneve të nevojshme me synim hartimin e strategjive afatmesme dhe afatgjata efikase.

Meqenëse asgjë nuk është më e tmerrshme se mosdija aktive, është i nevojshëm ndryshimi i nocionit të praktikave kur kemi të bëjmë me arsimimin, që do të thotë planifikimin e përparimit në polici. Meqenëse ajo që vlen për strukturën policore, vlen po njëjllë edhe për shoqërinë në tërësi, duhet të realizohet patjetër ky ndryshim, në mënyrë që çdo institucion të jetë i aftë të ezaurojë edhe problemet më të ndërlikuara. Nëse nuk është në gjendje të sigurojë një gjë të tillë, vetë organizata policore, shumë shpejt do të rezultojë në një formë hierarkike tradicionale të mbyllur pa rezultate konkrete. Faktori kyç për një sjellje të tillë është mungesa e kuadrit të arsimuar, të gatshëm për udhëheqje inovative. Krijimi i një klime bashkëpunuese ndërmjet hallkave, ku punonjësit të motivohen dhe mos t'a perceptojnë vendin e punës si afatshkurtër, sidomos nga ndikimet e mjedisit politiko-ekonomik, është kriter bazë në mënyrë që ata të shprehin profesionalizmin e tyre dhe të përballen me sfidat e reja në çdo aspekt të jetës⁶. Këto të fundit kërkojnë që performanca në rritje e tyre të realizohet nëpërmjet një procesi edukativo-profesional të vazhdueshëm dhe dhënien e detyrave më të përgjegjshme në strukturën hierarkike. Nëse në funksionin arsimor do të infiltrohet teknizimi i pastër dhe do të injorohet dimensionin human dhe vlerat inovative teknike

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

⁵ Memaj, Bilbil. "Roli i negociatave në zgjidhjen e konflikteve". *Marrëdhënie Ndërkombëtare - MN*, nr. 13. Tiranë: Qendra Hapësirë, 2015.

⁶ Wills, Mike. *Managing the training process - Putting the basics into practice*. London: McGraw-Hill, 1993, f. 40-56.

në procesin e zhvillimit të saj, atëherë do të mbizotëroj tendenca e cila çon në një teknikizëm pragmatik.

Mësimi është si lundrimi kundër rrymës dhe, nëse pushon së lundruari kthehesh mbrapa. Prandaj, nëse dëshirohet afirmimi i veprimit policor, përqendrimi i strukturave përkatëse mbi edukimin modern të saj, duhet të paraqesin një ndër investimet më të vlefshme për policinë e ardhshme. Në shumicën e vendeve, është filluar shumë më herët edukimi sistematik dhe inovativ i kuadrit, me plan-programet e përmirësuara në përputhje me kërkesat e paraqitura në mjediset përkatëse. Mirëpo, organizimi i edukimit për përparimin e kuadrit, nënkupton edhe përzgjedhjen paraprake në të gjitha nivelet, në vartësi nga aftësitë me të cilat do të ndalet riprojektimi i kuadrit gjysmë të arsimuar. Planifikimi strategjik për promovimin dhe ngritjen në karrierë duhet të kalojë në faza të tjera, pjesë e një procesi të vazhdueshëm edukimi, për t'iu përgjigjur në mënyrë inteligjente ndryshimeve shoqërore⁷.

Policia duhet të jetë në koherencë me ndryshimet shoqërore pozitive. Në këtë pikëpamje, idetë policore marrin një kuptim dhe rëndësi tjetër, të drejtuar nga kushtet moderne për punë policore. Vetëm në këtë mënyrë krijohet organizata policore, transparente, demokratike dhe komunikative⁸. Me parashtrimin e qëllimeve dhe përcaktimit të detyrave strategjike, hapet procesi i dëshiruar i modernizimit. Ky projekt, i testuar teorikisht dhe shkencërisht nëpërmjet operacionalizimit praktik, duhet të sigurojë për shoqërinë rolin demokratik të policisë me kërkesa reciproke dhe interes të përbashkët në zgjidhjen e problemeve të sigurisë. Siguria nuk është vetëm problem i policisë, por i të gjithë qytetarëve. Në këto marrëdhënie interaktive, policia mund t'i sigurojë vetes vendin e respektuar në shoqëri, ku gjatë veprimtarisë së saj të mundë të shprehë arritjet shkencore dhe profesionale. Kështu, gradualisht eliminohet pragmatizmi i ashpër tekniko-policor dhe pranohen idetë e reja kreative, me realizimin e të cilave vërtetohet aftësia e organizatës policore dhe kuadrit të saj udhëheqës, për ndryshimin shkencor të organizatës dhe funksionimit të saj.

Veçanërisht, duhet të insistohet në format aktive të mësimin në vend të formës pasive, e cila është e orientuar kryesisht drejt pranimit të diturisë pa shembuj jetësor. Gjatë reflektimit të metodave të përdorura në situata të veçanta, teknikave dhe taktikave udhëheqëse, arrihet sigurimi i diturive të nevojshme për të menaxhuar edhe situata të vështira⁹. Kjo mënyrë edukimi, ky rol primar dhe interaktiv luan edhe udhëheqësi i cili në mënyrë didaktike vepron në vet procesin e detyrave policore, kontribuon në krijimin e një organizate me baza solide dhe profesionale. Rrjedhimisht, policia shndërrohet në një institucion fleksibël dhe kreativ, e cila kanalizon opinionin publik në drejtimin e duhur të logjikës dhe vlerave shoqërore, duke u bazuar në një marrëdhënie socio-politike me shoqërinë civile, afatgjatë dhe të drejtë¹⁰. Me pranimin e konceptit modern të edukimit policor, krijohet një parakusht i rëndësishëm që policia të mos mbetet prapa ndryshimeve shoqërore, por madje të jetë një përcjellës aktiv i tyre.

⁷ Davis, R. *Madison Police Department - Quality Leadership Workbook*. Wisconsin: Madison Police Department, 1992, f. 26-34.

⁸ OSCE (2002), *Public Perception of the Police in Serbia, Survey conducted on behalf of the OSCE Mission to the FRY and the Serbian Ministry of Internal Affairs*, Belgrade.

⁹ Phillips, Jack dhe Ron Stone. *How to Measure Training Results-A Practical Guide to Tracking the Six Key Indicators*. New York: McGraw Hill, 2002, f. 21-28.

¹⁰ Harris, Frank. *The Role of Capacity-Building in Police Reform, OSCE, Mission in Kosovo, Department of Police Education and Development*. Prishtinë: 2005.

3. Kolegji i Policisë, si pjesë integrale e rëndësishme e Akademisë së Sigurisë

Shkolla Bazë (Kolegji i Policisë) është një nga njësitë kryesore të Akademisë së Sigurisë. Sipas ligjit “Për Policinë e Shtetit”:

- Shkolla Bazë e Policisë është përgjegjëse për përgatitjen e punonjësve të Policisë së Shtetit të rolit bazë. Pra ka si mision bazë formimin, shkollimin, trajnimin, kualifikimin e gjithë punonjësve të policisë të rolit zbatues.

- Kursantët shkollohen për një periudhë 11 (njëmbëdhjetë) mujore, nga këto 8 (tetë) muaj në ambientet e Akademisë dhe 3 (tre) muaj praktikë mësimore në strukturat e policisë.

- Pas përfundimit të trajnimit në terren kursantët certifikohen dhe emërohen në pozicione sipas nevojës.

- Shkolla Bazë e Policisë është përgjegjëse edhe për trajnimet bazë të specializuara sipas shërbimeve, për punonjësit e policisë së rolit bazë të Policisë së Shtetit .

Objektivi për të përgatitur punonjës policie të aftë profesionalisht, me kulturë qytetare dhe njohuri bashkëkohore, me standarde të larta etike, njohës të mirë të ligjit dhe mbrojtës të lirisë dhe të drejtave të njeriut, të përgatitur për të përballuar e menaxhuar situatë të prishjes së rendit e përballur me elementë të ndryshëm kriminal, përbëjnë sfidat kryesore për stafin e instruktorëve të Shkollës Bazë.

Në procesin reformues që po kalon organizata e policisë në tërësi, nuk mund të anashkalohej edhe reformimi i institucioneve arsimore të policisë. Rrjedhimisht, lindi si nevojë e domosdoshme rihapja e Akademisë së Sigurisë, fakulteteve dhe Shkollës Bazë së saj, fokusuar në ridimensionimin dhe kurrikulat e saj.

Shkolla Bazë ose Kolegji i Policisë sipas strukturës së re, si një nga njësitë kryesore të Akademisë së Sigurisë, përgjegjëse për formimin, shkollimin e kualifikimin e punonjësve të policisë që shërbejnë në vijën e parë “Patrullë e Përgjithshme” domosdoshmërisht duhet të përgatis dhe aftësojë punonjës policie me një nivel të lartë edukimi teorik dhe praktik për t’i shërbyer me devotshmëri, përkushtim dhe kulturë të lartë qytetare shoqërisë ku ajo bën pjesë. Përmirësimi i programeve dhe metodave të mësimdhënies do të mundësonte kulturën e sjelljes së veprimeve policore në raste të ndërlikuara dhe të vështira, duke nxitur sjelljet dhe veprimet humane kur është e nevojshme, e njëkohësisht zbatimin me korrektësi të ligjit. Gjatë fazës paraprake të përzgjedhjes së punonjësve të rinj dhe integritit të tyre në organizatë, përkushtimi ndaj tyre dhe krijimi i fasiliteve është një proces i domosdoshëm, pasi mungesa e eksperiencës, njohja me kriteret e reja që ndikojnë jo vetëm në formimin e tyre por edhe në cilësinë e jetës, ngelet një nga fazat më vendimtare për krijimin e një brezi policor të aftë dhe të përgjegjshëm.

Pikërisht, me tagrin e përmirësimit të vazhdueshëm, me synim realizimin e një analize SËOT, është ndërmarr krijimi dhe analizimi i pyetësorit në 490 kursantë (numri i shpërndarjes së pyetësorëve është statistiki i pranueshëm me synim marrjen e informacionit të nevojshëm). Studimi është kryer me kursantët e kursit IX-të të Shkollës Bazë, datë 25 deri më 30 qershor 2015. Fokusimi te ata, është parë si domosdoshmëri për rritjen e motivimit, në mënyrë që të merret “feedback”-u i duhur dhe përmirësimi i shërbimit qytetar. Kjo pasi, pavarësisht se ata akoma nuk janë pjesë integrale afatgjatë e organizatës policore, për shkak edhe të funksionimit organizativ dhe kurrikular të Shkollës, ata rikthehen në terren duke dhënë ndikimin e parë te shoqëria për figurën

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

policore.

Pyetësi, i fokusuar mbi performancën e deritanishme të aktiviteteve mësimore-logjistike në Shkollën Bazë, është organizuar në disa seksione. Gjatë kthimit të përgjigjeve është përdorur shkalla e Likertit, me synim analizimin e tij sa më mirë. Gjatë shqyrtimit të seksionit të parë, më përgjigjet e dhëna nga 490 kursantët, të cilët u certifikuan në kursin e IX-të, 42.2% e tyre janë femra dhe 56.9% janë meshkuj. Vetëm 0.9% e tyre nuk u janë përgjigjur pyetjes. Rritja e peshës specifike të femrave në organizatë është parë si risi, duke ditur dhe projektimin e kaluar të përbërjes së punonjësve të policisë. Përfshirja e tyre do të mundësojë mbi të gjitha rritjen e edukatës qytetare dhe krijimin e një klime reciprociteti dhe besimi ndërmjet organizatës dhe shoqërisë ku ajo bën pjesë. Për sa i përket kategorisë së moshës, dominojnë moshat e reja me 61.4% grupimi 18-25 vjeç, 35.7% grupimi 26-35 vjeç dhe vetëm 2.9% grupimi 36-45 vjeç. Pra vihet re një tendencë për pëlqimin e detyrës së punonjësit të policisë dhe karrierës që ofron, duke cituar prej tyre më së shumti me 64.3% e tyre se nuk kanë përgjegjësi të tjera përveç shkollës. Vetëm 41.3% e tyre deklarojnë se formimi i tyre i mëparshëm ka qenë shkollë e mesme e përgjithshme publike dhe 48.8% e tyre arsimi i lartë, një indikator ky që reflekton baza paraprake të formimit të tyre. Ndër gjithë të anketuarit, 81.3% e tyre deklarojnë se e kanë për herë të parë konkurrimin në organizatë dhe përbërja e tyre sipas rajonit të vendbanimit varion me një dominim prej 55.5% nga Shqipëria e Mesme. Gjatë shqyrtimit të seksionit të dytë, i cili bazohet në performancën në mësimdhënie dhe proceset edukuese, (ju lutem, shikoni figurën 2 të mëposhtme):




Figura 2: Lëndët e marra gjatë edukimit policor, të shpërndara sipas peshës specifike

vihet re se moduli i policimit të përgjithshëm kategorizohet si lënda e cila mbart informacionet më të rëndësishme për fushën përkatëse, rrjedhimisht fokusimi në të, në proceset interaktive didaktike me synim rritjen e sinerjisë informative instruktor-kursant, pa anashkaluar modulet e tjera, do të ishte e një rëndësie të veçantë në performancën didaktike të së gjithë shkollës.

Duke e nisur nga këndvështrimi i raportit teori-praktikë (figura 3 jep informacioni e mëposhtëm), 80.6% e të anketuarve pohojnë se këto raporte janë në nivele të duhura. Me synim përmirësimin e vazhdueshëm, figura 4 jep detaje të rëndësishme (ju lutem

shihni më poshtë). Praktikiteti i njohurive, shumë më tepër se çdo fushë tjetër studimi, duhet të shihet si një kriter i pa anashkalueshëm, i cili mundëson zhdërvjellësimin e oficerëve të ardhshëm, të aftë për të përballuar situata të vështira dhe komplekse.




Figura 3: Evidenca e raportit teori-praktikë në modulet e marra

Mendimi i mësipërm mbi praktikitetin e nevojshëm përforcohet akoma dhe më shumë ku 47.0% e tyre pohojnë se, sidomos në modulën policimi i përgjithshëm, pasuar nga moduli aftësim policor operacional me 23.3% duhet të rishikohet mënyra e strukturimit për sa i përket këtij raporti dhe dhënies së prioritetit me literaturën më të avancuar bashkëkohore.




Figura 4: Domosdoshmëria për aktivitete dhe literaturë ekstra në lëndët mësimore

Gjatë shqyrtimit të pyetësorit evidentohet akoma dhe më shumë ky fakt, ku 30.2% e tyre pohojnë se për t'u përmirësuar mësimdhënia duhet një fokusim i madh në bazën materiale dhe logjistike, kjo në funksion të madh të anës praktike të mësimdhënies, pasuar me 29.1% të krijimit të situatave të vështira për kontrollin e tyre. (ju lutem shihni figurën 5 të mëposhtme)




Figura 5: Fokusi në aspektet specifike të mësimdhënies me synim përmirësimin e saj

Bazuar në këtë këndvështrim, në shkollë janë ndërmarrë një sërë aktivitete për të përmirësuar logjistikën ambientale dhe didaktike, krijimi i ambienteve më bashkëkohore dhe inskenimi i situatave të vështira, për të qenë më afër objektivit primar. Si çdo organizatë e mirëstrukturuar, e cila performon për të rritur vlerën e saj të deritanishme dhe sidomos të ardhshme, kjo në funksion edhe të krijimit të një shoqërie civile humane dhe të përgjegjshme, e cila bazohet në rregulla dhe ligje, është i nevojshëm dhe i domosdoshëm marketingu i shërbimeve dhe vlerave që ajo mbart. Mbi të gjitha duhet të gërshetohet me rritjen e motivimit të stafit në të gjitha nivelet menaxheriale, në çdo strukturë përbërëse të organizatës, duke u fokusuar në koren e vlerave të saj dhe elementeve përkatës.

Në këtë aspekt, nga kursantët (kanalizuar në drejtimet përkatëse) është parë si mundësi marketingu i shkollës dhe pikërisht duke u fokusuar në krijimin e situatave ndihmë me 39.7% e të anketuarve. Ideja e situatave ndihmë konsiston në edukimin që në bankat e shkollës së fëmijëve mbi disa rregulla specifike të lidhura me aktivitetet e shërbimit policor si përkujdesja rrugore, ndihma e shpejtë, aksidentet nga zjarri etj. Marketingu është parë i nevojshëm edhe në orët e hapura mësimore me 21.0% pasuar nga ndihmesa në komunitet për shembull për grup-mosha të caktuara si të moshuarit, me 19.6%. Kursantët pohojnë se shkolla ka ndikuar në cilësinë e jetës së tyre duke përmirësuar komunikimin dhe rritur kohezionin social me 48.5% e tyre si dhe të qenit i pavarur në jetë, të aftë për të përballuar situata të vështira me 27.1% prej tyre. Por ata, për sa i përket një dimensionit social, siç është ushqimi, pretendojnë që ai të përmirësohet me 60.7% e tyre, pasuar kjo me 14.4% me ndryshim të raportit kohë e lirë/mësimdhënie, në favor kjo të kohës së lirë, shoqëruar kjo nga dimensionet e tjera si oraret disiplinore me 6.1% etj. Pavarësisht nga këto referenca sociale, kursantët pohojnë hapa reformues në njohuritë e marra në Shkollën Bazë të Policisë dhe përmirësim të ndjeshëm të tyre, si në aspektin individual dhe atë shoqëror.

4. Konkluzione

Reformimi i çdo institucioni është një proces vendimtar në vazhdimësinë e tij dhe sidomos, për performancën e tij. Ai kalon nëpërmjet hallkave të ndryshme, por në organizatën policore ai nuk është një parakusht për t'i shërbyer sa më mirë komunitetit dhe për t'u arritur vlera e thënies nga shoqëria dhe për shoqërinë. Reformimi është domosdoshmëri, sidomos kur vendi kalon në periudha specifike në fusha të ndryshme jetësore. Mbi të gjitha, reformimi nis që në zinxhirin e parë të vlerës, aty ku formohen dhe përmirësohen oficerët policorë të së ardhmes. Edukimi i tyre, përputhja e vlerave individuale me ato të institucionit apo organizatës policore në përgjithësi, mundëson hedhjen e një baze të fortë shërbimi policor që komunitetin apo shoqërinë civile e ka në qendër të vëmendjes. Përmes edukimit, sidomos në Shkollën Bazë të Policisë, ata do të mundësojnë përthithjen e vlerave të tilla si respekti ndaj qytetarit, të gjenerojnë transparencë, të shpërndajnë rezultatet dhe informacionin në kohën e duhur dhe vendin e duhur, të japin më të mirën e tyre, mbi të gjitha besim. Praktikiteti dhe mësimdhënia, gërshtuar së bashku do të mund të krijojnë zinxhirin e duhur të vlerave policore për të krijuar te shoqëria idenë e policisë moderne dhe bashkëkohore. Në këto dy aspekte, Shkolla Bazë e Policisë ka hedhur hapa të rëndësishëm, në koherencë edhe me objektivat kryesore të reformës së përgjithshme policore të aplikuar në vend, reformë, e cila e jep një dimension tjetër rolit dhe figurës së oficerit, duke u parë nga shumë të rinj e të reja si një mundësi për të dhënë kontributin e tyre në komunitet, por edhe jetesës së tyre.

Referenca

1. Adam, R and Villiers, P. *Police Leadership in Twenty-First Century, Philosophy Doctrine and Development*. London: Waterside Press, 2003.
2. Memaj, Bilbil. *Lidershipi në policinë e shtetit: rasti i Shqipërisë*. Tiranë: Kristalina-KH, 2016.
3. Memaj, Bilbil. "Roli i negociatave në zgjidhjen e konflikteve". *Marrëdhënie Ndërkombëtare - MN*, nr.13. Tiranë: Qendra Hapësirë, 2015.
4. Davis, R. *Madison Police Department - Quality Leadership Workbook*. Wisconsin: Madison Police Department, 1992.
5. Policia e Shtetit. *Manuali i Procedurave Standarde për Rendin dhe Sigurinë Publike*, 2014.
6. OSCE (2002), *Public Perception of the Police in Serbia, Survey conducted on behalf of the OSCE Mission to the FRY and the Serbian Ministry of Internal Affairs*, Belgrade.
7. Neni 37 ligji nr 108/2014 "Për Policinë e Shtetit".
8. Phillips, Jack dhe Ron Stone. *How to Measure Training Results-A Practical Guide to Tracking the Six Key Indicators*. New York: McGraw Hill, 2002.
9. Senge, P. *The Fifth Discipline : The Art and Practice of the Learning Organization*, New York, Doubleday
10. Harris, Frank. *The Role of Capacity-Building in Police Reform, OSCE, Mission in Kosovo, Department of Police Education and Development*. Prishtinë: 2005.
11. Hackman, J. R dhe Oldham. G. R. *Job Characteristic Theory*. 1976.
12. Hackman, J.R dhe Lawler, E. E. "Employee Reaction to Job Characteristics". *Journal of Applied Psychology*, 55(3).
13. Wills, M. *Managing the training process - Putting the basics into practice*. London: McGraw-Hill, 1993.
14. Anketim i zhvilluar me Kursin IX i Shkollës Bazë të Policisë, Akademia e Sigurisë, 25-30 qershor 2015.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

Programet e arsimimit policor, konform kërkesave të ligjit për arsimin e lartë në RSH

Prof. Asc. Dr. Qetsor ORHAN
Akademia e Sigurisë
qetsor.orhan@asp.gov.al

Msc. Qetsor GURRA
Akademia e Sigurisë
qetsor.gurra@asp.gov.al

Abstrakt

Arsimimi policor ka hyrë tashmë në një proces rrënjësor ndryshimesh, reformimi e modernizimi, për t'u përshtatur si me ligjin për Arsimin e Lartë në RSH ashtu edhe me programet e vendeve partnere me të cilat ne vazhdojmë të operojmë. Në këtë fazë të zgjerimit të spektrit të arsimimit, është e domosdoshme që sistemi i arsimimit policor jo vetëm të përfshijë të tre ciklet e studimit¹, por njëkohësisht të bëhet sa më atraktiv dhe konkurrues me të tjerët, për të arritur këtë kërkohet një filozofi e re e arsimimit policor e cila tu rezistojë kohës dhe kërkesave gjithnjë në rritje të arsimit të lartë i cili është gjithmonë në transformim të vazhdueshëm. Reformimi i programeve të arsimimit kërkon njëkohësisht, integrimin brenda tij, të së gjithë trajnimeve për karrierë, që zhvillohen në Akademinë e Sigurisë. Ky integrim do të çojë krahas reformimit edhe në rritjen e cilësisë së trajnimeve të ndryshme që zhvillohen gjatë gjithë karrierës së punonjësve të policisë. Rritja e cilësisë së arsimimit është e lidhur gjithashtu me krijimin e strukturave të qëndrueshme të arsimimit, duke filluar nga departamenti si njësi bazë e deri tek hallkat e tjera të arsimimit, një pjesë e të cilave nuk janë krijuar ende, nëpërmjet të cilave sistemi ynë arsimor policor do të funksionojë si një i vetëm, duke ndjekur me përparësi të gjitha evoluimet që pëson ky arsimim, si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Përmirësimi i programeve të arsimimit policor do të çojë në krijimin e një trupe drejtuesish të aftë për të menduar e vepruar në mënyrë kritike, të cilët të kenë vlerat e duhura, fleksibilitet në vendimmarrje dhe aftësi drejtuese për të kryer siç duhet detyrat e tyre.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit»

Fjalëkyçe:

kurrikulat e arsimimit policor, arsimimi i vazhdimësisë, autonomi financiare, arsimimi i inspektorëve.

1. Hyrje

Një program efektiv dhe i plotësuar sipas standardeve të arsimimit të lartë, i përgatit drejtuesit e ardhshëm të policisë për përgjegjësitë e shtruar dhe i aftëson ata për të arritur rezultate të suksesshme në hierarkinë e tyre të drejtimit. Këta drejtues duhet të dinë si të operojnë në bashkëpunim me aleatët dhe partnerët tanë, për më tepër, duhet të tregojnë besnikëri, integritet dhe përgjegjësi, ndërsa veprojnë në një mjedis sigurie shumë kompleks, me paqartësi dhe shumë shpejt të ndryshueshëm. Njëherësh, këta drejtues duhet të ndërtojnë ekipe efektive, plotësisht të afta për të mbështetur operacionet e përbashkëta dhe shumëkombëshe, në mjedisin e një ndryshimi teknologjik dhe organizativ të shpejtë dhe të vazhdueshëm. Programet e arsimimit dhe trajnimit në Akademinë e Sigurisë (AS), kanë nevojë për të reflektuar kërkesat e përdorimit të Policisë së Shtetit në mjedisin e ardhshëm të sigurisë. Kjo kërkesë e rëndësishme reflektohet qartë në nenin 35, paragrafi 9 të ligjit “Për Arsimin e Lartë” në RSH ku theksohet se: “Institucioni i arsimit të lartë për programe studimi të akredituara mund të bëjë ndryshime profilizuese deri në masën 20 përqind dhe t’i reflektojë ato në diplomën e lëshuar prej tij. Miratimi i ndryshimeve bëhet nga Senati Akademik dhe për to njoftohet ministria përgjegjëse për arsimin e lartë jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të vitit akademik”².

Është pra, shumë e rëndësishme që AS-ja, të arsimojë dhe trajnojë një trupë drejtuesish dhe inspektorësh me kulturë të balancuar, që të jetë e aftë, e ndërveprueshme dhe e mirëpërgatitur për të përmbushur misionin gjatë gjithë spektrit të saj. Këto ndryshime të programeve duhet të rishikohen në përputhje me çështjet e mëposhtme.

² VKM nr. 185, datë 25.02.2015, paragrafi 9, pika b, “Për organizimin e Akademisë së Sigurisë”.

2. Përmirësime në sistemin arsimimit të Policisë së Shtetit

Pavarësisht se kjo konferencë shkencore fokusohet në aspektin e sigurisë publike nëpërmjet arsimimit, çështja e reformimit të vazhdueshëm të programeve të arsimimit që zhvillohen në AS, është një nga pikat më të rëndësishme pasi, pa një sistem arsimor të konsoliduar, nuk mund të pretendohet për një siguri publike të qëndrueshme. Aktualisht prej disa vitesh, AS bashkëpunon me një sërë vendesh partnere, të cilat kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në reformimin e sistemit tonë arsimor për ta bërë atë sa më të integrueshëm me arsimimin e vendeve të tyre. Po ashtu, sistemi ynë arsimor duhet të jetë plotësisht i integruar në sistemin e arsimimit të lartë kombëtar, për të cilin janë hedhur tashmë hapa të rëndësishëm. Aktualisht, AS ka realizuar deri tani ciklin e parë të studimeve dhe është në proces për hapjen e ciklit të dytë, ndërsa për hapjen e ciklit të tretë na duhet një kohë më e gjatë, por kjo nuk do të thotë që duhet të presim, pasi në bazë të ligjit “Për Arsimin e Lartë” në RSH, Akademia e Sigurisë, mund të bashkëpunojë me institucione të tjera të akredituara, gjë e cila shprehet qartë në ligjin për arsimin e lartë: *“Kur studimet e doktoratës zhvillohen në bashkëpunim midis institucioneve të arsimimit të lartë, pjesë të procesit kërkimor, mund të zhvillohen pranë institucioneve bashkëpunuese”*³.

Po kështu në nenin 80 paragrafi 1 theksohet se: *“Programet e përbashkëta të studimit realizohen nga një institucion i arsimimit të lartë ose njësi kryesore të tij, në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimimit të lartë, publike ose jopublike, brenda ose jashtë vendit”*⁴.

Aktualisht Akademia e Sigurisë ka marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione të arsimimit të lartë sidomos, me Universitetin e Tiranës, nëpërmjet të cilit personeli ynë akademik mund të bashkëpunojë për të realizuar arsimimin për ciklin e tretë. Për shkak të natyrës së PSH, por dhe vlerat që përfaqëson, mendoj se sistemi ynë arsimor ka nevojë të jetë i plotë dhe integral, kështu p.sh. rekrutimi 100% i kandidatëve nga sistemi ynë i arsimimit policor mendojmë se në njëfarë mënyre e ul cilësinë për të thithur kontingjente më të reja dhe më të spikatura nga shkollat e mesme, pasi siç dihet nga historia e arsimimit policor, Akademia e Policisë thithte kontingjentet më të zgjedhura të shkollave të mesme, gjë e cila është vërejtur edhe nga testimet e kryera kohët e fundit, nga të cilat rezultoi se një përqindje shumë e vogël e kandidatëve arriti të kapte përqindjen e pikëve të përcaktuara. Në bazë të udhëzimit të MAS-it, i cili bie ndesh me mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve nga ana jonë, theksohet se: *“Institucionet e arsimimit të lartë të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuara nga ana e tyre. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë, përzgjedhin fituesit dhe publikojnë listat e rankuara të kandidatëve sipas të dhënave të përcjella nga AKP-ja dhe mënyrën/formulën e përzgjedhjes së kandidatëve”*⁵.

Natyrisht që zgjidhjet janë të shumta, një prej të cilave mund të jetë edhe rekrutimi i kombinuar i kandidatëve nga sistemi kombëtar dhe ai policor. Me kthimin e Shkollës

² Neni 35, paragrafi 9, “Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

³ Neni 79, paragrafi 3, “Ligji për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.

⁴ Neni 80, paragrafi 1, “Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

⁵ Udhëzim i MAS-it për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me karakter profesional.

Bazë të Policisë në Kolegj Profesional, duke e kthyer atë si pjesë e programeve universitare, mendojmë se përzgjedhja duhet të bëhet në të njëjtën kohë me universitetet e tjera të vendit, ndoshta edhe më parë, pasi kështu Akademia e Sigurisë do të vazhdojë të përzgjedhë vetëm kandidatët që nuk kanë mundur të regjistrohen në asnjë shkollë të lartë. Padyshim që ky është një problem kompleks i cili kërkon një studim të veçantë pasi, duhet të shoqërohet edhe me përmirësime të tjera në sistemin e rekrutimit dhe programeve të arsimit policor, për të edukuar profesionistë, të devotshëm dhe të disiplinuar. Rritja e rolit të sistemit tonë arsimor dhe bashkëpunimi gjithnjë e më i gjerë me atë rajonal, kërkon që, ky sistem të jetë në përmirësim të vazhdueshëm dhe konkurrues. Vitet e fundit AS ka shtrirë bashkëpunimin e saj me institucionet homologe të rajonit e me gjerë. Kapacitetet e AS-së lejojnë një rol më aktiv në bashkëpunimin rajonal dhe rritjen e rolit të sistemit tonë arsimor policor në këtë bashkëpunim. Rritja e këtij roli gjithmonë ka nevojë të vlerësohet në përputhje me strategjinë e sigurisë kombëtare.

3. Konsolidimi i mëtejshëm i sistemit arsimor policor

Një nga drejtimet e punës sonë gjatë ripunimit të programeve këtë vit akademik, ka të bëjë me realizimin e të gjitha kërkesave që shtrou ligji, nr. 80/2015, datë 17.9.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Shfrytëzimi i mundësive për transferim kreditesh duhet të jetë një tjetër drejtim i përmirësimit të programeve, pasi ky do të ndikonte dukshëm në transferimin e krediteve që qindra punonjës policie kanë marrë në akademitë apo universitetet e vendit e më gjerë, duke reflektuar ndaj procedurave të përbashkëta për ndërveprim. “Institucionet e arsimit të lartë mund të njohin kredite të përfituara në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit “Master i shkencave”⁶.

Përmirësimi i kurrikulave të programeve të arsimit policor është një detyrë e përhershme, duke zgjeruar spektrin me elemente të rinj të luftës kundër terrorizmit, trafikimit të qenieve njerëzore, kundër prodhimit dhe transferimit të lëndëve narkotike, etj., si dhe të sfidave me të cilat përballen sot vendet e rajonit e më gjerë. Arritja e këtij standardi kërkon krijimin e strukturave të reja të arsimit të cilat kanë të bëjnë me rritjen e cilësisë së brendshme të arsimit policor, për një koordinim më të mirë të Akademisë së Sigurisë me MAS-in dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe për një rol të ri cilësor të qendrës së arsimit të Akademisë së Sigurisë. Zhvillimet teknologjike dhe natyra e re e krimit kërkojnë ndryshimin e kundërveprimit dhe kjo gjë kërkon që programet e arsimit dhe trajnimit në Akademinë e Sigurisë, të reformohen vazhdimisht, duke përfshirë në modulet përkatëse karakteristikat e këtyre ndryshimeve. Ngritja e sistemeve të reja të vëzhgimit të kompletimit me pajisje dhe armatim të ri, përmirësimet e ndjeshme në sistemet operacionale, ngritja e qendrave të simulimit, etj., kërkojnë njohuri bashkëkohore për përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Programet e arsimit dhe të trajnimit në Akademinë e Sigurisë, duhet të përfshijnë arsimimin dhe trajnimin e personelit policor me njohuritë e nevojshme profesionale, - jo vetëm të teknologjisë në përdorim, - për t’i paraprirë zhvillimeve teknologjike të së ardhmes. Kërcënimet dhe rreziqet natyrore e njerëzore janë një kërcënim real ndaj

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

⁶ Neni 76, paragrafi 5, “Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

sigurisë kombëtare dhe globale. Policia e Shtetit gjithmonë e më shumë po përfshihet në operacione ndaj emergjencave civile në mbështetje të autoriteteve civile. Përfshirja e ndryshimeve dhe trajtimi i temave të karaktereve të tilla në programet arsimore dhe trajnuese të policisë, është domosdoshmëri dhe si e tillë kërkon rishikim dhe përmirësim të vazhdueshëm të programeve të arsimit.

4. Për një rol të ri të inspektorëve

Arsimimi dhe trajnimi i inspektorëve, ka si qëllim përgatitjen e mëtijshme dhe konsolidimin e vazhdueshëm të rritjes së tyre profesionale dhe, krijimin e piramidës paralele të hierarkisë, si një kontingjent i rëndësishëm që në mënyrë të dukshme, ndikon në rritjen e nivelit profesional. Ngritja e arsimit të inspektorëve në kornizat e arsimit të lartë, duke e kthyer Shkollën Bazë të Policisë në Kolegj të Lartë Profesional, pa dyshim që do të çojë shumë shpejt në rritjen e cilësisë së arsimit të inspektorëve të policisë, njëkohësisht lidhja dhe integrimi i këtij arsimit me ciklin e parë të studimeve, do të ndikonte dukshëm si në rritjen e kërkesave të kandidatëve ashtu edhe në aspektin ekonomik. Mendojmë se lidhur me programin e arsimit të inspektorëve, ka nevojë për ndryshime të mëtijshme, duke u fokusuar në përmirësimin e programeve të arsimit, duke i kthyer ato në programe të njehsueshme me ato të arsimit të lartë apo me programet e arsimit të nënkomisarëve. Në këtë kontekst, sistemi arsimor në Policinë e Shtetit duhet të konsiderohet si një dhe i pandarë. Kjo kërkon që programet të jenë pjesë integrale e këtij sistemi, si tullat e një muri, të lidhura dhe pa hapësira boshe në të. Pavarësisht pavarësisë akademike të arritur në sistemin tonë të arsimit policor, rishikimi i të gjitha programeve, nga ky këndvështrim, është ndoshta i nevojshëm. *“Institucionet e arsimit të lartë mund të ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë të gjithë jetës. Këto programe shërbejnë për plotësim, thellim e konsolidim të njohurive...”*⁷ theksohet në ligjin për arsimin e lartë. Këto kredite, të zhvilluara në kurse të ndryshme, mund të bëhen pjesë e programeve universitare. Në neni 90 të ligjit për arsimin e lartë theksohet se: *“Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të njësisë bazë të institucionit që pranon studentin, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e saj”*⁸.

Kjo vijueshmëri duhet të ndërthurë si arsimimin bazë ashtu dhe atë të vazhdimësisë e ndoshta një rishikim të plotë të programeve, me qëllim shmangien e mbivendosjeve dhe garantimin e vijueshmërisë, gjë që do të mundësonte një identifikim më të mirë të mangësive në programet aktuale dhe përmirësimin e tyre, duke hapur një linjë të re për degën e arsimit të AS-së, e cila do të kryente rolin e koordinimit, njehsimit dhe standardizimit të mëtijshëm të programeve të arsimit policor.

5. Personeli akademik dhe autonomia financiare e Akademisë së Sigurisë

Aktualisht, Akademia e Sigurisë duhet të hartojë një plan të veçantë për kualifikimin e personelit akademik pasi mendoj se është një nga pikat më të dobëta, që nuk i përgjigjet

⁷ Neni 81, paragrafi 1 i Ligjit për AL në RSH.

⁸ Neni 90 i Ligjit për AL në RSH.

perspektivës sidomos për gradat dhe titujt shkencorë, për të cilat në nenin 126, të ligjit për arsimin e lartë theksohet se: *“Personeli akademik, i punësuar në institucionet e arsimit të lartë, si personel me kohë të plotë, brenda pesë viteve, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, duhet të përfundojë studimet e doktoratës. Kur, brenda këtij afati, personeli akademik nuk përfundon studimet e doktoratës, rektori kryen procedurat për zgjidhjen e kontratës së punës”*⁹.

Mendoj se ka ardhur koha që personeli akademik i Akademisë së Sigurisë duhet të trajtohet sipas kërkesave të ligjit “Për Arsimin e Lartë në RSH” dhe udhëzimeve të vazhdueshme që nxjerr MAS-i, pasi ka disa pika ku ky ligj bie ndesh edhe me ligjin për Policinë e Shtetit. Aktualisht MAS-i po përgatit VKM-në “për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, gjë e cila do të ndihmonte personelin akademik të AS-së, që të ndjekë dhe të plotësojë të gjitha kërkesat që kërkon MAS-i. Kështu p.sh., personeli akademik me grada policore, por që ka edhe grada e tituj shkencorë, ashtu sikurse edhe personeli akademik civil, mund të përzgjidhnin trajtimin financiar më të përshtatshëm për aq kohë sa do të shërbenin në Akademinë e Sigurisë. Në praktikën e përditshme ndeshemi vazhdimisht me mangësi ligjore për trajtimin financiar të personelit akademik, të brendshëm e të jashtëm, të cilat duhet të ndiqen nga specialistët dhe të hartohet legjislacioni që aktualisht sot mungon. Përvoja që praktikojnë sot institucionet publike të arsimit të lartë, padyshim që është e vlefshme edhe për AS-në, por ajo kërkon hartimin e dokumentacionit përkatës që të bëhet e vlefshme edhe për ne. Autonomia financiare e institucioneve të arsimit të lartë, është pikërisht ajo që i mungon Akademisë së Sigurisë ose, nuk zbatohet sipas kërkesës së nenit 108, pika 2, të ligjit “Për Arsimin e Lartë në RSH”, ku theksohet se: “Institucioni i arsimit të lartë harton një plan buxhetor afatmesëm, i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Ky plan përditësohet çdo vit”¹⁰.

Në bazë të këtij neni shumë të rëndësishëm për funksionimin e institucioneve të arsimit të lartë, AS-ja ka mangësi, pasi asnjë njësi kryesore e saj, në kushtet aktuale, nuk mund të hartojë një plan buxhetor financiar. Kjo është e lidhur me mungesën e personelit administrativ, si në njësitë kryesore ashtu dhe në qendër: kështu p.sh., të ardhurat që akademia siguron nga të tretët, nuk mund t’i përdorë sikundër thuhet në ligjin “Për Arsimin e Lartë në RSH”, i cili thekson: “Të gjitha të ardhurat e krijuara nga institucionet publike të arsimit të lartë përdoren prej tyre dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës”¹¹.

Kjo ka çuar në mospagimin e personelit të jashtëm dhe po ashtu edhe në mospagimin e mbingarkesës së personelit të brendshëm akademik. Këto, e të tjera mangësi në këtë aspekt, kërkojnë rishikimin dhe hartimin e urdhrave, udhëzimeve apo edhe hartimin e ndonjë VKM-je shtesë, të cilat do të ndihmonin për zhblokimin e këtij procesi.

6. Përfundime

Bazuar në këtë analizë të shkurtër që kryem më sipër dhe në argumentet që paraqitëm, po pasqyrojmë në mënyrë të shkurtër e të përmbledhur disa përfundime:

1. Është e domosdoshme ngritja e një grupi kërkimor për hartimin e një strategjie

⁹ Neni 126, i Ligjit për AL në RSH.

¹⁰ Neni 108, pika 2, “Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

¹¹ Neni 108, pika 3, “Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

afatgjatë në lidhje me filozofinë afatgjatë të arsimit të personelit policor, duke filluar nga rekrutimi e deri në përfundimin e karrierës policore.

2. Hartimi i një udhëzimi të veçantë, për të rregulluar dhe për të përshtatur mospërputhjet me ligjin e arsimit të lartë, do të ndihmonte strukturat dhe personelin akademik për të funksionuar në bazë të këtij ligji.

3. Kompletimi i programeve të arsimit policor për të tre ciklet e studimit, do të përbënte bazën e sistemit tonë arsimor, mbi bazën e të cilit do të ngrihej e funksiononte e gjithë piramida e arsimit dhe e kualifikimit në Policinë e Shtetit.

4. Rifomatimi dhe konsolidimi i strukturave bazë të arsimit në Akademinë e Sigurisë nëpërmjet të cilave do të organizohej diskutimi dhe rishikimi i programeve të arsimit policor.

5. Nevojitet përshtatja e programeve të arsimit të Kolegjit Profesional të Policisë me standardet dhe kërkesat e MAS-it si dhe integrimi i tij me programet e ciklit të parë.

6. Përshtatja e linjës së administrimit me standardet e institucioneve të arsimit të lartë konform ligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Literatura

1. Ligji nr. 80/2015, datë 17. 9. 2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
2. Ligj nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit".
3. VKM nr. 185 datë, 25. 02. 2015 "Për organizimin e Akademisë së Sigurisë".
4. Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016 – 2017".
5. VKM "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik".

Reformimi i sistemit arsimor policor, domosdoshmëri për përballimin e sfidave bashkëkohore të sigurisë

Dr. Xhavit SHALA

Akademia e Sigurisë

xhavit.shala@asp.gov.al

Abstrakt

Objekti i studimit dhe i hulumtimit në këtë punim, është trajtimi, analiza dhe vlerësimi i procesit të ecurisë në karrierë të punonjësve të policisë që kanë kryer shkollimin bazë policor, menaxhimin e këtij procesi si dhe rolin e sistemit arsimor të përzgjedhur në plotësimin e nevojave të Policisë së Shtetit me specialistë nënkomisarë, të aftë për përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësive të organizatës në përballimin e sfidave bashkëkohore të sigurisë, si dhe adresimi i problemeve me qëllim për të mbështetur vendim marrjen në rishikimin dhe formësimin e politikave të nevojshme për reformimin e sistemit arsimor policor në përballje me sfidat bashkëkohore të sigurisë. Gjatë këtij punimi janë aplikuar metodat dhe instrumentet bazë kërkimore shkencore, sasiore dhe cilësore, si metoda e analizës dhe sintezës, analizës krahasuese, ajo historike, juridike, e krahasimit dhe konfrontimit si dhe e studimit të rastit. Në përfundim të punimit konkludohet se shkollimi bazë policor ka luajtur një rol të rëndësishëm për përgatitjen e një shërbimi policor shqiptar drejt standardeve euroatlantike, ndërsa sistemi arsimor i përzgjedhur për ecurinë në karrierë të punonjësve të policisë që kanë përfunduar shkollimin bazë policor, nga niveli bazë për në nivelin e parë të drejtimit, keqmenaxhimi i këtij procesi si dhe mbyllja e Akademisë së Policisë, kanë penguar plotësimin e nevojave sasiore dhe cilësore të Policisë së Shtetit me specialistë nënkomisarë, që të zotërojnë aftësitë parësore të kërkuara për të përmbushur përgjegjësitë e vendit të punës e përballur me sfidat e kohës, pasoja të cilat janë ndjerë në përgjithësi në të gjithë strukturat e Policisë së Shtetit e, në veçanti, në strukturat e hetimit të krimeve.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

Fjalëkyçe:

shkollimi bazë policor, menaxhim, ecuria në karrierë, burlimet njerëzore, politikat e zhvillimit të karrierës, arsimi i lartë policor, trajnimi policor, nënkomisar.

1. Hyrje

Nëse do t'i bëjmë një analizë në planin historik, ecurisë së sistemit arsimor policor në Shqipëri, do të gjejmë se arsimimi policor në Shqipëri, deri në vitin 2006, ka qenë i ndarë në dy nivele: në nivelin e trupës policore dhe në nivelin e specialistëve të policisë. Nga viti 1945¹ deri në vitin 1960 si dhe në vitet 1968-1971, arsimimi i specialistëve të policisë ka qenë i organizuar në nivelin e kurseve me kohëzgjatje nga disa muaj deri në dy vjet, ndërsa për vitet 1961-1967 ka qenë i organizuar në nivelin e një teknikumi të mesëm profesional trevjeçar². Arsimimi i trupës së policisë (punonjësve të policisë të nivelit bazë), nga viti 1945 e deri në vitin 1985, është realizuar me kurse trajnimi nga disa ditore³ deri në disa mujore, në qendra të veçanta instruksioni, ndërsa nga viti 1986 deri në vitin 2006 është organizuar në shkollë të veçantë me kohëzgjatje 1-2 vjet (e quajtur fillimisht Shkolla e Ulët e më pas Instituti i Policisë)⁴. Në gusht të vitit 2005, me mbështetje të Programit ICITAP dhe Pameca, filloi procesi i rishikimit të sistemit të edukim trajnimit policor shqiptar dhe, në shtator 2006, fillon programi i parë për trajnimin bazë policor me kohëzgjatje 20 javore⁵. Arsimi i Lartë Policor në Shqipëri

¹ Shkresë e Drejtorisë së Policisë së Ministrisë Punëve të Brendshme Nr. 416/1, datë 16 tetor 1947, drejtuar Drejtorisë Punëve të Brendshme Korçë, Seksionit të Policisë. Në të jepen udhëzime për pjesëmarrjen e oficerëve të Policisë Popullore në kurset e Shkollës Unike e të Mesme për Oficerët e Ushtrisë Kombëtare. Arkivi i Sistemit të Ministrisë Punëve të Brendshme. Dosje 11/1947.

² Akademia e Policisë Shqipëri-Guidë. Tiranë 2002. Faqe 13.

³ Shkresë e Drejtorisë së Policisë së Ministrisë Punëve të Brendshme Nr. 961/1, datë 4 tetor 1945 "Mbi kursin e Policisë"; Qarkore e Drejtorisë së Policisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme Nr. 961/3, datë 3.10.1945, drejtuar Komitetit Ekzekutiv të Prefekturës Shkodër për organizimin e një kursi polici 20 ditor. Arkivi i Sistemit të Ministrisë Punëve të Brendshme. Dosje 2/48. faqe 1-7; Qarkore e Drejtorisë së Policisë Nr. 1248 datë 10.04.1946. Arkivi i Sistemit të Ministrisë Punëve të Brendshme. Dosje 5/48. faqe 1-3.

⁴ Akademia e Policisë Shqipëri-Guidë. Tiranë 2002. Faqe 15. Burim i cituar.

⁵ Kursi i parë i shkollimit bazë policor ka filluar me 4 shtator 2006 deri me 2 shkurt 2007.

filloi në vitin 1972⁶, rishikohet në vitin 1984⁷, ristrukturohet në vitin 1991⁸, ndërpritet në vitin 2009⁹ dhe rikthehet përsëri në vitin 2015 me krijimin e Akademisë së Sigurisë¹⁰. Pra, arsimi i lartë ka qenë dhe mbetet pjesë e rëndësishme e zhvillimit të karrierës në polici dhe ka ndikuar në përgatitjen e specialistëve të aftë për të përmbushur përgjegjësitë e vendit të punës në 37, nga 70 vitet e Shtetit Shqiptar të pas Luftës së II Botërore dhe, në 18, nga 24 vitet e Shtetit Shqiptar të pas Luftës së Ftohtë.

Objektin e studimit dhe të hulumtimit në këtë punim, mendojmë ta arrijmë nëpërmjet një analize të integruar dhe sintetike të sistemit arsimor të trashëguar, duke filluar me përcaktimin, sipas strukturave policore, të punonjësve të policisë që kanë përfunduar shkollimin bazë policor gjatë periudhës analizuese (2006-2015), vlerësimin e ecuresisë së tyre në karrierë dhe ndikimit të saj në plotësimin e nevojave të Policisë së Shtetit me nënkomisarë të aftë për përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësive të vendit të punës; identifikimin e problematikave, të faktorëve ndikues dhe të domosdoshmërisë së reformimit e krijimit të një sistemi arsimor policor bashkëkohor, në mbështetje të zhvillimit të karrierës dhe përballimit të sfidave bashkëkohore të sigurisë.

Gjetjet kryesore të punimit evidentojnë dhe pasqyrojnë fakte interesante dhe sfida me të cilat duhet të përballen strukturat e Policisë së Shtetit në të ardhmen. Këto gjetje të shumta dhe përfundimet na ndihmojnë në përcaktimin e një prognozë të përafërt për të ardhmen si dhe mundësinë, për dhënien e rekomandimeve përkatëse, për politika që përmirësojnë punën për ecurinë në karrierë të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe, reformimin e sistemit arsimor policor.

2. Shkollimi bazë policor, rol kryesor në transformimin e shërbimit policor, drejt standardeve euroatlantike

Në gusht të vitit 2005 filloi procesi i rishikimit të sistemit të edukimit trajnimit policor shqiptar dhe, në shtator 2006, fillon programi i parë për trajnimin bazë policor me kohëzgjatje 20 javore¹¹. Deri në fund të vitit 2013 shkollimin bazë policor e kanë përfunduar të gjithë punonjësit e nivelit bazë të policisë (7720), të cilët zënë 74.88% e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Policisë së Shtetit. Nga këta 5905 ose 76.5% e tyre kanë përfunduar shkollimin bazë policor 11 javor, dhe 1815 punonjës policie ose 23.5% e tyre kanë kryer shkollimin bazë policor 22 javor¹².

⁶ VKM nr. 184 datë 20.12.1971 "Mbi organizimin e Shkollës së Lartë të Ministrisë Punëve të Brendshme. Arkivi i Sistemit të Ministrisë Punëve të Brendshme. Dosje 12. Viti 1972, faqe 22-23.

⁷ Në vitin 1984 kohëzgjatja e trajnimit në Shkollën e Lartë dhe në shkollën e policisë u shtua me nga një vit. Kështu shkolla për oficerë u bë 4 vjet, ndërsa shkolla për policë u bë dy vjet. Joseph Hauer, *Studim mbi Shpërndarjen e Personelit*, faqe 16. Projekti i ICITAP-it mbi Menaxhimin e Burimeve Njerëzore & Përgjegjshmërisë Policore, Shtator 2006.

⁸ *Me Vendim Nr. 339 datë 2.9.1991*, Këshilli i Ministrave vendosi ristrukturimin e Shkollës së Lartë të Ministrisë Punëve të Brendshme dhe krijimin e Institutit të Lartë të Rendit me kohëzgjatje 4 vjeçare. Këtij instituti i përcaktohet detyra për të përgatitur specialistë të lartë të profilin të përgjithshëm për organet e Policisë, Shërbimit Informativ, Policisë Financiare dhe të llojeve të tjera të policive që krijoheshin brenda vendit. Arkivi i Ministrisë së Brendshme, Fondi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Nr. 145, Dosje Nr. 40, Viti 1991, faqe 3-5.

⁹ VKM nr. 135, datë 11.2.2009 "Për mbylljen e Akademisë së Policisë "Arben Zylyftari"


¹⁰ Në ligjin për Policinë e Shtetit Nr. 108/2014, në nenin 37, parashikohet që Policia të ketë institucionin e saj arsimor përgjegjës për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit të nivelit operues, administrativ dhe menaxherial. Kjo konkretizohet më pas me VKM Nr.185 datë 25.2.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë"

¹¹ Kursi i parë i shkollimit bazë policor ka filluar më 4 shtator 2006 deri më 2 shkurt 2007.

¹² Shifrat janë vënë në dispozicion të studimit më datën 23.9.2015, nga Znj. Albana Vrapit, Shefe e Sektorit të Databazës, në Drejtorinë e Teknologji Informacionit.


Pra, nga fillimi i aplikimit të shkollimit bazë policor në vitin 2006, për një periudhë thujtse 10 vjeçare, 74.88% e punonjësve të Policisë së Shtetit janë të pajisura me njohuritë bashkëkohore për një policim demokratik.

Sipas shtrirjes strukturore, 72.93% e punonjësve të policisë që kanë përfunduar shkollimin bazë policor i përkasin strukturës së Sigurisë Publike dhe Parandalimit të Krimit, 5.8% i përkasin strukturës së Krimeve të Rënda dhe Krimit të Organizuar dhe 16.1% i përkasin strukturës së Kufirit dhe Migracionit.



	Grada	Krimet e Rënda & KO	Siguria Publike	Kufiri	Mbështetëse	Gjithsej
	Inspektor	405	5074	1114	364	6957
GJITHSEJ	% me totalin	5.8%	72.93%	16.01%	5.2%	100%

Ndërsa duke analiza e raporti që zënë punonjësit që kanë përfunduar shkollimin bazë policor, sipas strukturave policore të cilave iu përkasin, me numrin total të punonjësve të policisë të vetë strukturës gjejmë se në strukturën e Sigurisë Publike dhe Parandalimit të Krimit e kishin përfunduar shkollimin bazë policor 81.4% e kësaj strukturë, pastaj të Kufirit dhe Migracionit me 76.88% dhe më pak në atë të Krimeve të Rënda dhe Krimit të Organizuar 35.8%.



	Grada	Krimet	Siguria			Gjithsej
			Publike	Kufiri	Mbështetëse	
	Inspektor	405	5074	1114	364	6957
GJITHSEJ	STRUKTURA	1131	6226	1449	485	9295
% e gradës	%	35.8%	81.4%	76.88%	75.05%	74.85%

Analiza e gjetjeve të mësipërme na mundëson të konkludojmë se impakti pozitiv i shkollimit bazë policor është ndërë më shumë në strukturën e Sigurisë Publike dhe Parandalimit të Krimit (72.93% dhe 81.4%), të Kufirit dhe Migracionit (16.01% dhe 76.88%) si dhe më pak në atë të Krimeve të Rënda dhe Krimit të Organizuar (5.8% dhe 35.8%).

Sa më sipër arrijmë në përfundimin se shkollimi bazë policor ka luajtur një rol të rëndësishëm për përgatitjen e një shërbimi policor shqiptar drejt standardeve euroatlantike. Kjo është një arritje e madhe për organizatën tonë policore dhe kjo me ndihmën dhe mbështetjen e partnerëve tanë euroatlantik e, në mënyrë të veçantë, monitorimit të këtij shkollimi nga misioni amerikan ICITAP. Ky impakt pozitiv më shumë është ndërë në strukturën e Sigurisë Publike dhe Parandalimit të Krimit dhe më pak në strukturën e Krimeve të Rënda dhe Krimit të Organizuar

3. Arsimimi policor dhe nevojat e policisë për specialistë, që do të përballen me kërcënimet bashkëkohore të sigurisë

Për të bërë një vlerësim të ndikimit të sistemit arsimor të përzgjedhur për ecurinë në karrierë të punonjësve të policisë që kanë përfunduar Shkollën Bazë të Policisë, në plotësimin e nevojave cilësore të Policisë së Shtetit me specialistë nënkomisarë të aftë, është e nevojshme të analizohet nëse ky sistem arsimor i përzgjedhur plotëson:

- nevojat sasiore të Policisë së Shtetit me punonjës policie të gradës nënkomisar;
- nevojat e Policisë së Shtetit për nënkomisar të aftë për të përmbushur përgjegjësitë

e vendit të punës për t'u përballur me sfidat bashkëkohore të sigurisë (nevojat cilësore).

a. Një vlerësim të përafërt të nevojave të Policisë së Shtetit me specialistë policie të gradës nënkomisar mund ta realizojmë nëpërmjet formulës $NN^{13} = NP^{14} + NK^{15} + NL^{16} - NR^{17}$

E kthyer në vlerë numerike nevojat për nënkomisar (NN) llogariten të jenë:

$$NN = NP(33.52) + NK(29.2) + NL(44.8) - NR(46.3) = 61.22^{18}.$$

¹³ NN- Nevojat për nënkomisar.

¹⁴ NP-Nënkomisar në pension - Për zëvendësimin e punonjësve të policisë të gradës nënkomisar të cilët dalin në pension përlllogarit të që çdo vit të kemi mesatarisht 33.52 nënkomisarë të rinj. Dhe, në qoftë se ne synojmë të ulim moshën mesatare të nënkomisarëve, do të duhet një numër akoma më i madh nënkomisarësh të rinj

¹⁵ NK-Nënkomisar në komisar - Për zëvendësimin e numrit të punonjësve të policisë që kanë ecuar nga grada e nënkomisarit në atë të komisarit, përlllogarit mesatarisht një shtesë me 29.2 nënkomisarë të rinj në vit.

¹⁶ NL-Nënkomisarë të liruar - Për zëvendësimin e numrit të punonjësve të policisë të gradës nënkomisar, të cilët janë larguar para kohe nga organizata e policisë (me kërkesë të tyre apo përjashtim etj.) përlllogarit mesatarisht një shtesë me 44.8 nënkomisarë të rinj në vit.

¹⁷ NR- Nënkomisarë të rikthyer - Në vitet e fundit janë rikthyer në strukturat e Policisë së Shtetit mesatarisht 46.3 punonjës policie në vit me gradën nënkomisar. Kjo shifër e zbut kërkesën për nënkomisarë të rinj prandaj dhe zbritet në vlerë nga shumata e tre të mësipërmeve.

¹⁸ Të dhënat për moshën mesatare të punonjësve të policisë sipas gradave janë nxjerrë nga Sistemi RMIS i Policisë së Shtetit. Shifrat janë vënë në dispozicion të studimit më datën 23.9.2015, nga Znj. Albana Vrapit, Shefe e Sektorit të Databazës, në Drejtorinë e Teknologji Informacionit. Të dhënat për punonjësit e policisë të larguar dhe të rikthyer nga Policia e Shtetit, sipas viteve dhe motiveve, për periudhën 2007-2015, janë marrë nga sistemi RMIS i Policisë së Shtetit.

Pra, nga përlogaritjet e mësipërme mund të themi se nevojat mesatare të Policisë së Shtetit janë për 61.22 punonjës policie të gradës nënkomisar në vit.

Nga përlogaritjet ka rezultuar se mesatarja vjetore e nënkomisarëve të certifikuar për periudhën analizuese, nga punonjësit e policisë që kanë kryer shkollimin bazë policor është afërsisht 16 nënkomisarë në vit¹⁹. Nevojat mesatare vjetore të organizatës policore janë për 61 punonjës policie të gradës nënkomisar. Pra, gjatë periudhës analizuese 2006-2015 janë certifikuar nënkomisar 4 herë më pak se nevojat mesatare të organizatës.

Në përfundim konkludojmë se sistemi arsimor i përzgjedhur i ecurisë në karrierë për gradën e nënkomisarit, të punonjësve të policisë që kanë përfunduar shkollimin bazë policor nuk ka ndihmuar në plotësimin sasior të nevojave të Policisë së Shtetit me specialistë të kësaj grade. Sistemi i përzgjedhur ka mundur plotësimin vetëm të 25% të nevojave të Policisë së Shtetit me specialistë të gradës nënkomisar.

b. Për të parë nëse sistemi arsimor i përzgjedhur arrinte të siguronte përgatitjen e nënkomisarëve të aftë për të përmbushur përgjegjësitë e vendit të punës për t'u përballur me sfidat bashkëkohore të sigurisë (nevojat cilësore) është e nevojshme të analizojmë dhe vlerësojmë nëse ky sistem arsimor i përzgjedhur arrinte të siguronte:

1. nënkomisarë të rinj me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme si oficerë të policisë gjyqësore.

2. nënkomisarë të rinj me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të punuar me rrjetin sekret informativ dhe në përgjithësi me veprimtarinë informativo-gjurmuese.

Në të vërtetë, në draftin e “Politikave bazë orientuese për zhvillimin e sistemit të përzgjedhur të trajnimit në Policinë e Shtetit”²⁰, në projekt-draftin “Për zhvillimin e afërt dhe perspektiv të sistemit arsimor për Policinë e Shtetit Shqiptar”²¹ si dhe në Strategjinë e miratuar “Për trajnimet në Policinë e Shtetit për vitet 2011-2016”, ishte përcaktuar qartë se kalimi nga niveli në nivel për ecurinë në karrierë do të bëhej nëpërmjet shkollimit.

Grada e nënkomisarit ishte grada e parë e nivelit të parë të drejtimit dhe, për ta marrë atë, duhej kaluar në një proces shkollimi. Kohëzgjatja e procesit të shkollimit të nënkomisarëve u caktua vetëm 6 javë (238 orë mësimore duke përfshirë dhe ceremoninë e mbylljes së kursit). Kursi 6 javor për nënkomisarët nuk përmbushte asnjë nga parametrat e shkollimit të përcaktuara në ligjin “Për arsimin e lartë”²². Kalimi nga një nivel më i ulët në atë më të lartë është realizuar në kundërshtim me ligjin me kurse trajnimi e jo shkollim të detyrueshëm²³.

Jo rrallë, është fajësuar tërësisht sistemi i arsimit policor që u zgjodh për sa i përket dobësive në përgatitjen e nënkomisarëve të policisë. Në të vërtetë, përveçse pasojë e sistemit arsimor që u përzgjedh, “kriza e nënkomisarëve” u thellua nga keqmenaxhimi

¹⁹ Xhavit Shala, *Mbi menaxhimin e karrierës dhe sistemin arsimor policor. Fokusi në Nivelin Bazë dhe Nivelin e Parë të Drejtimit në Policinë e Shtetit*. Tiranë, nëntor 2015. Faqe 57.

²⁰ Drafti i Politikave Bazë Orientuese për Zhvillimin e Sistemit të Trajnimit në Policinë e Shtetit është hartuar nga grupi i punës i përbërë nga Drejtues Ilo Kecka-përgjegjës dhe kryekomisarët Lorenc Panganika e Artur Zoto, anëtarë.

²¹ Projekt-draft “Për zhvillimin e afërt dhe perspektiv të sistemit arsimor për Policinë e Shtetit Shqiptar”, përgatitur nga Zoti Jashar Vreka, Drejtor i Akademisë së Policisë, Zoti Tomas Moïelle nga Misioni ICITAP dhe Zoti Antony Finnerty nga Misioni PAMEKA, dërguar me shkresën Nr. 330 datë 6.7.2007 Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Zotit Ahmet Prençi, Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për Shërbimet Mbështetëse, Zoti Arben Doçi si dhe Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për Trajnimin Policor, Zotit Ahmet Haxhij. Burim i cituar.

²² Ligji nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjet nr. 9832, datë 12.11.2007 dhe nr. 10 307, datë 22.7.2010.

²³ Studimi “Mbi vlerësimin e gjendjes së brendshme të Policisë së Shtetit” faqe 55. Tiranë, nëntor 2013.

i implementimit të programit për shkollimin në nivelin e parë drejtues.

Sistemi i arsimit policor i përzgjedhur si dhe keqmenaxhimi i implementimit të këtij sistemi solli pasoja të rënda në dy drejtime kryesore:

- në përgatitjen e nënkomisarëve të rinj me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme si oficerë të policisë gjyqësore;
- në përgatitjen e nënkomisarëve të rinj me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të punuar me rrjetin sekret informativ dhe në përgjithësi me veprimtarinë informativo-gjurmuese.

3.1 Përgatitja e nënkomisarëve të rinj me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme si oficerë të policisë gjyqësore

Nënkomisarët që do të merren me hetimin e krimeve duhen pajisur me njohuritë e nevojshme si oficerë të policisë gjyqësore pasi duhet që të zotërojnë aftësitë për të kryer veprime ligjore e procedurale në zbatim të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale të RSH. Por, nëse do të shohim programin e shkollimit të nënkomisarëve dhe, konkretisht, Modulin 2 për “Çështjet ligjore”, do të vëmë re se i gjithë moduli ka pasur gjithsej 16 orë mësimore dhe njohuritë mbi legjislacionin penal dhe procedural penal zënë vetëm 8 orë mësimore. Por, a mund të bëhesh oficer i policisë gjyqësore me 8 orë mësimore njohuri mbi legjislacionin penal dhe procedural penal? A mund ta zbatosh drejt ligjin në këtë rast dhe a mund t’i respektosh siç duhet liritë dhe të drejtat e njeriut?

Moduli 2	Çështjet ligjore²⁴	Orë
Mësimi 23	Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë	2
Mësimi 24/A	Njohuri mbi legjislacionin penal	4
Mësimi 24/B	Njohuri mbi legjislacionin procedural penal	4
Mësimi 25	Ligji Nr. 9749, datë 4.6.2007 “Mbi Policinë e Shtetit” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.	6
Gjithsej orë moduli		16

Në fakt, 8 orët e planifikuara në programin e shkollimit të nënkomisarëve për legjislacionin penal dhe procedural penal, ndoshta do të ishin të mjaftueshme për një rifreskim njohurish nëse kandidatët për nënkomisar do të kishin kryer të paktën një master profesional në të drejtën penale, pas përfundimit të arsimit të lartë juridik. Ndërkohë, në analizë krahasuese rezultoi se në fillimet e arsimit të lartë policor, në vitin 1972, nga 868 orë mësimore që zinte programi për “Çështjet ligjore” në tërësi, programet mësimore për lëndët “E Drejtë Penale” dhe “Procedurë Penale”, përfshinin gjithsej 259 orë mësimore, kur vetë programi i Fakultetit Juridik në Universitetin e Tiranës për këto lëndë ishte gjithsej 302 orë mësimore²⁵.

²⁴ Moduli 2: “Çështjet ligjore”. Program shkollimi për “Nivelin e Parë Drejtues” për gradën nënkomisar. Miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 1137 datë 9.12.2008. Burim i cituar.

²⁵ Arkivi i Sistemit të Ministrisë Punëve të Brendshme. Kolegjiumi i MPB për Shkollën e Lartë të Ministrisë Punëve të Brendshme. “Pasqyrë Krahasuese e Planeve Mësimore” ku krahasohen programet e Shkollës së Lartë të Ministrisë Punëve të Brendshme me Universitetin e Tiranës dhe Shkollën e Bashkuar të Oficerëve. Dosja Nr. 665, Viti 1976, faqe 67-68. Burim i cituar.

3.2. Përgatitja e nënkomisarëve të rinj me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të punuar me rrjetin sekret informativ dhe në përgjithësi me veprimtarinë informativo-gjurmuese

Nëse i referohemi përsëri programit për nivelin e shkollimit Nënkomisar do të shohim se për aftësimin e nënkomisarëve të rinj në punën me informacionin dhe rrjetin sekret informativ nuk ka asnjë modul të veçantë. Këto njohuri ishin planifikuar të merreshin me dy tema mësimore, me gjithsej 16 orë mësimore, në përbërje të Modullit 6, “Njohuri për menaxhimin e hetimit të krimit”.

Por, a mund të zhvillosh një policim proaktiv dhe të mbështetur në inteligjencë me 16 orë mësimore përgatitje në këtë fushë? Ndërkohë, në analizë krahasuese rezultoi se në fillimet e arsimit të lartë policor, në vitin 1972 njohuritë në këtë fushë zinin 594 orë në programin mësimor²⁶ dhe zhvilloheshin në lëndë të veçanta dhe me shtrirje vjetore.²⁷

Moduli 6	Njohuri për menaxhimin e hetimit të krimit ²⁸	Orë
Mësimi 36	Njohuri mbi menaxhimin e burimeve të informacionit policor.	8
Mësimi 37	Njohuri mbi menaxhimin dhe analizën e informacionit kriminal	8
Gjithsej		16

Mangësitë në formimin e specialistëve mbi rolin e posaçëm që luajnë informatorët dhe rrjeti sekret informativ në veprimtarinë informativo-gjurmuese të strukturave të hetimit dhe parandalimit të krimit në luftën për zbulimin, parandalimin dhe goditjen me efikasitet të veprimtarisë kriminale ka bërë që nga viti në vit të vijë në ulje vëllimi i informacioneve të përfituara nga rrjeti i fshehtë informativ dhe gradualisht, pavarësisht akteve normative të miratuara, të krijohet dhe legalizohet mendimi i gabuar se të pasurit informatorë dhe puna me ta është tashmë një çështje dëshire. Me këtë nivel programi profesional për përgatitjen e nënkomisarëve të policisë është e vështirë ta besosh se po përgatit oficerë të policisë gjyqësore të aftë që të zhvillojnë hetime të thelluara e zbatojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, si dhe të zhvillojnë një policim proaktiv e të mbështetur në inteligjencë.

Pra, nga gjetjet e mësipërme konkludojmë se sistemi arsimor i përzgjedhur për ecurinë në karrierë dhe programi i shkollimit të punonjësve të policisë për gradën e nënkomisarit nuk siguronin përgatitjen e nënkomisarëve të rinj me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme si oficerë të policisë gjyqësore si dhe me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për veprimtarinë informative gjurmuese dhe për të punuar dhe me rrjetin sekret informativ.

Por, cilat nga strukturat e policisë janë prekur më shumë nga “kriza e nënkomisarëve”? Këtë përgjigje mund ta gjejmë duke analizuar raportin që zë grada e nënkomisarit me totalin e gradave të tjera, sipas strukturave kryesore policore. Pra, duke përcaktuar se cila strukturë policore ka pasur më shumë nevojë për punonjës policie të gradës nënkomisar? Raporti që zë grada e nënkomisarit me totalin e gradave të tjera, sipas strukturave kryesore policore paraqitet në tabelën dhe grafikun në vijim.


²⁶ Po aty.

²⁷ Xhavit Shala, *Mbi vlerësimin e performancës strategjike të punës së strukturave të hetimit dhe parandalimit të krimeve me informatorët dhe rrjetin sekret informativ*, faqe 73. Tiranë: korrik 2014.

²⁸ Moduli 6: “Njohuri për menaxhimin e hetimit të krimit”. Program shkollimi për “Nivelin e Parë Drejtues” për gradën Nënkomisar. Miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 1137 datë 9.12.2008. Burim i cituar.

Paraqitja tabelore dhe grafike:

	Grada	Krimet	Siguria Publike	Kufiri	Mbështetëse	Gjithsej
	<u>Nënkomisar</u>	367	752	224	33	1376
GJITHSEJ	STRUKTURA	1131	6229	1449	485	9295
% e gradës	<u>Nënkomisar në</u> %	32.4 %	12.07 %	15.4 %	6.8%	14.8%



Nga analiza e të dhënave statistikore (tabelore dhe grafike) rezulton se grada e nënkomisarit zë përqindjen më të lartë në strukturën e Krimeve të Rënda dhe krimet të organizuar, pothuajse sa 2-5 herë më shumë se në strukturat e tjera.

Nga kjo analizë mund të konkludojmë se pasojat e mangësive në ecurinë në karrierë për gradën e nënkomisarit janë ndjerë më shumë në strukturat e hetimit të krimeve.

Prandaj, që pas përmbylljes së procesit të parë të shkollimeve për nivel dhe trajnimeve për ngritjen në gradë në Korrik të vitit 2009 ishte konkluduar se “për zhvillimin e karrierës është e nevojshme të shihet mundësia e një ndërthurje mes shkollimit policor, arsimimit të përgjithshëm dhe ecurisë në karrierë. Kjo të paktën në nivelin e parë të drejtimit”²⁹, gjë që nuk mor në konsideratë për shumë vite.

Në përfundim të çështjes, pasi studiuam, analizuam dhe vlerësuam gjetjet lidhur me ndikimin e sistemit arsimor të përzgjedhur në plotësimin e nevojave sasiore e cilësore të Policisë së Shtetit me specialistë nënkomisarë që të zotërojnë aftësitë për t’u përballur me kërcënimet bashkëkohore të sigurisë arrijmë në përfundimin se sistemi arsimor i përzgjedhur për ecurinë në karrierë të punonjësve të policisë që kanë përfunduar shkollimin bazë policor, nga niveli bazë për në nivelin e parë të drejtimit, si dhe keqmenaxhimi i këtij procesi, kanë penguar plotësimin e nevojave sasiore dhe cilësore të Policisë së Shtetit me specialistë nënkomisar, që të zotërojnë aftësitë parësore të kërkuara për të qenë të aftë për të përbushur përgjegjësitë e vendit të punës, procesi i cili ka cenuar më shumë strukturat e hetimit të krimeve.

4. Konsolidimi i një sistemi arsimor policor bashkëkohor, për zhvillimin profesional dhe të karrierës

Siç e provuam gjatën këtij punimi, shkollimi bazë policor, si pjesë e këtij procesi reformimi, ka luajtur një rol të rëndësishëm për përgatitjen e një shërbimi policor drejt

²⁹ Analiza e zhvillimit dhe përmbylljes së procesit të shkollimeve për nivel dhe trajnimeve për ngritjen në gradë. Drejtuar z. Ahmet Haxhia, Zëvendësdirjtor i Përgjithshëm i Policisë Shtetit për Departamentin e Trajnimit Policor. Pika 3 “Nxjerrja e konkluzioneve dhe përcaktimi i detyrave për të ardhmen”, Tiranë 14 korrik 2009.

standardeve euroatlantike. Kjo është një arritje e madhe për organizatën tonë policore. Gjatë këtij punimi ne provuam gjithashtu se sistemi i përzgjedhur për ecurinë në karrierë për gradën e nënkomisarit, të punonjësve të policisë që kanë përfunduar shkollimin bazë policor, ka penguar plotësimin e nevojave sasiore e cilësore të Policisë së Shtetit me specialistë që të zotërojnë aftësitë parësore të kërkuara dhe të aftë për të përbushur përgjegjësitë e vendit të punës. Këtu kanë ndikuar disa faktorë ku ndër më mund të përmendim si në vijim.

4.1 Keqmenaxhimi i implementimit të Programit për Shkollimin në Nivelin e Parë Drejtues, i sistemit arsimor të zgjedhur

Siç e theksuam kursi 6 javor për nënkomisarët nuk përmbushte asnjë nga parametrat e shkollimit të përcaktuara në ligjin “Për arsimin e lartë”³⁰. Kalimi nga një nivel më i ulët në atë më të lartë është realizuar në kundërshtim me ligjin me kurse trajnimi e jo shkollim të detyrueshëm³¹. Këtu qëndron dhe keqmenaxhimi i implementimit të sistemit arsimor të përzgjedhur. I ashtuquajtur shkollim synonte marrjen e gradës dhe jo të profesionit. Edhe nga vetë pjesëmarrësit në kurset e shkollim-trajnitimit për gradë, kohëzgjatja e kurseve përgjithësisht është vlerësuar e pamjaftueshme.³² Në të vërtetë dhe në vitet e para kur Shqipëria sapo kishte dalë nga lufta, kurset për përgatitjen e oficerëve zgjasnin shumë më tepër³³.

4.2 Mangësitë në planifikimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore gjatë implementimit të reformës në sistemin arsimor policor të përzgjedhur

Nuk ishte planifikuar që në fillim një zgjidhje për vakuumin që do të krijohet, të paktën për gradën e nënkomisarit, pra për nivelin e specialistit të policisë, fillimi i implementimit të reformës së planifikuar në sistemin arsimor policor. Në bazë të Ligji Nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policin e Shtetit”³⁴, punonjësit të policisë i cili kryente shkollimin bazë policor i lind e drejta të aplikojë për të konkurruar për nënkomisar pas 7 vjetësh në fund të vitit 2013³⁵. Pra, në Policinë e Shtetit, që në fillim të implementimit të reformës në sistemin arsimor policor nuk ishte marrë parasysh dhe nuk ishte bërë planifikimi se, për 7 vjet strukturat e Policisë së Shtetit nuk do të “furnizoheshin” me punonjës policie të gradës nënkomisar, nga punonjësit e policisë që mbaronin shkollimin bazë policor.

³⁰ Ligji nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjet nr. 9832, datë 12.11.2007 dhe nr. 10 307, datë 22.7.2010.

³¹ Studimi “Mbi vlerësimin e gjendjes së brendshme të Policisë së Shtetit” faqe 55. Tiranë, nëntor 2013.

³² Konkluzione të Workshopit të zhvilluan ne QFP më datë 14 korrik 2009 në përmblyllje të procesit të parë të shkollimeve për nivel dhe trajnimeve për ngritjen në gradë.

³³ Pas çlirimit të vendit, në Shtator 1946 u hap Shkolla e Policisë në Tiranë me një sistem kursesh me kohëzgjatje deri në 6 muaj për oficerë. Në Janar 1948 shkolla merr formë më të plotë me hapjen e kurseve 4 mujore për oficerë, nënoficerë dhe policë. Në vitin 1951 u hap Kursi i Parë 1 vjeçar i Policisë për oficerë dhe nënoficerë. Këto kurse vazhduan deri në vitin 1953. Akademia e Policisë Shqipëri-Guidë. Tiranë 2002. Faqe 13-14.

³⁴ Ligji Nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit”, Neni 41, pika 5

³⁵ për të konkurruar në procesin e përzgjedhjes për ecuri në karrierë (ngritje në gradë), pas plotësimit të kohës së qëndrimit në gradë, e cila ishte nga “nëninspektor” në “inspektor” 2 vjet; nga “Inspektor” në “Kryeinspektor” 2 vjet dhe nga “Kryeinspektor” në “Nënkomisar” 2 vjet. Nëse kësaj i shtojmë dhe 1 vit shkollimin bazë policor (kursi teorik dhe trajnimi në terren) i bie që kursantët e parë të shkollimit bazë policor që startoi në fund të vitit 2006 u lind e drejta të konkurrojnë për nënkomisar pas 7 vjetësh në fund të vitit 2013

4.3 Keqmenaxhimi dhe mbyllja e Akademisë së Policisë si institucion i arsimit të lartë policor

Efektet e vakuimit në përgatitjen e nënkomisarëve nuk do të ishin ndjerë nëse, paralelisht me shkollimin bazë policor të vazhdonte normalisht dhe Akademia e Policisë³⁶, si shkollë e lartë që përgatiste punonjës policie të gradës nënkomisar, punonjës të cilët mund të vinin nga shkollimi bazë policor. Vazhdimi i Akademisë së Policisë do ta zbuste si nga ana sasiore, ashtu dhe nga ana cilësore “krizën” e nënkomisarëve në Policinë e Shtetit. Sistemi i Trajnimit në Policinë e Shtetit si dhe kurrikulat për zhvillimin e tij janë huazuar si model nga Kosova e janë përshtatur për Shqipërinë. Në projekt- strategjinë “Për zhvillimin e afërt dhe perspektiv të sistemit arsimor për Policinë e Shtetit Shqiptar” të përgatitur në vitin 2007 bashkërisht nga Akademia e Policisë dhe përfaqësuesit e misioneve ICITAP dhe PAMECA, dokument i propozuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, parashikohej vazhdimi i Akademisë së Policisë me misionin që “... të menaxhojë zhvillimin dhe zbatimin e trajnimit bazë, trajnimit të specializuar/avancuar dhe të Programeve Trajnuese për Rritje në Gradë dhe Përgjegjësi”³⁷.

Pavarësisht projekt strategjisë së mësipërme, propozim i përbashkët i Akademisë së Policisë dhe misioneve ICITAP dhe PAMECA, Akademia e Policisë u suprimua edhe formalisht³⁸ me një vendim qeverie në vitin 2009³⁹ dhe u zëvendësua me një strukturë administrative në qendër, të quajtur Departamenti për Trajnimit të cilit, në kundërshtim dhe me ligjin “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”⁴⁰, iu dhanë edhe kompetenca të një institucioni arsimor. Në vitin 2011, ndonëse urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit ishte për hartimin e Strategjisë Afatgjatë të Sistemit Arsimor në Policinë e Shtetit⁴¹, u hartua Strategjia “Për trajnimin në Policinë e Shtetit për vitet 2011-2016”, në të cilën nuk përmendet në asnjë rast modeli i sistemit arsimor që do të ndiqej. Edhe në dokumentin “Për sistemin e arsimit në Policinë e Shtetit”, si pjesë e paketës që shoqëron strategjinë e mësipërme⁴², përveçse në titullin e dokumentit, nuk përmendet në asnjë rast dhe nuk shkruhet asgjë për sistemin arsimor policor dhe programet për arsimimin, por vetëm për trajnimet. Por arsimimi⁴³ dhe trajnimi⁴⁴, janë

³⁶ Akademia e Policisë u mbyll me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 135 datë 11.2.2009

³⁷ Projekt-draft “Për zhvillimin e afërt dhe perspektiv të sistemit arsimor për Policinë e Shtetit Shqiptar”, faqe 4. Burim i cituar.

³⁸ Pranimet e reja në Akademinë e Policisë, në sistemin me shkëputje nga puna, realisht ishin pezulluar që në vitin 2005, me një urdhër verbal të ministrit të brendshëm të asaj kohe, Iglit Toska.

³⁹ Akademia e Policisë u mbyll me VKM nr. 135, datë 11.2.2009 “Për mbylljen e Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari” dhe riorganizimin e arsimit policor si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”

⁴⁰ Ligji nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjet nr. 9832, datë 12.11.2007 dhe nr. 10 307, datë 22.7.2010.

⁴¹ Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 05.01.2011 “Për përgatitjen e strategjisë afatgjatë të sistemit arsimor në Policinë e Shtetit” dhe Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 83, datë 24. 01. 2011 “Për ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Punës për përgatitjen e strategjisë afatgjatë të sistemit arsimor në Policinë e Shtetit”. Burim i cituar.

⁴² Memo e përgatitur për Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nga Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm, Ahmet Haxhia më datë 7.3.2011.

⁴³ Gabriele Bammer, *The role of higher education*, “Dealing with Uncertainties in Policing Serious Crime” p.156, ANU (The Australian National University): Three underlying tenets, as defined in the Oxford English Dictionary (2000) are: critical thinking—analytical evaluations, being diagnostic and discriminating, fastidious, perceptive and precise. Making judgments using intelligent thought, assessment, opinion and rational reasoning analysis—to investigate or interpret research—systematic investigation to establish facts or collect information on a subject, to analyse and examine. Burim i cituar

⁴⁴ MarriamWebster - An Encyclopedia Britanica Company, Training: Action of teaching a person or animal a partikular skill or type of behaviour; a process by which someone is taught the skills that are needed for an art profession or job. Burim i cituar

dy procese që nuk zëvendësojnë, por plotësojnë⁴⁵ njëri tjetrin.

Është interesant fakti se, ndërsa në Shqipëri, Policia e Shtetit në vitin 2011, modelin e trajnimeve të huazuar nga Kosova, e përfshin në strategjinë e saj afatgjatë, duke hequr përfundimisht dorë nga sistemi i arsimit të lartë policor, Kosova, e cila e kishte implementuar me sukses këtë sistem trajnimi në Shërbimin e saj Policor, po në vitin 2011, me asistencën dhe të misioneve ICITAP dhe OSBE, e sheh të domosdoshme dhe themelon Akademinë e Kosovës “Për Siguri Publike”⁴⁶, si institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike. Kjo hedh poshtë çdo pretendim të papërgjegjshëm se mbyllja e Akademisë së Policisë dhe heqja dorë nga sistemi i arsimit të lartë policor u bë nën trysinë e misioneve partnere që asistonin Policinë e Shtetit. Misionet partnere, lidhur me sistemin arsimor policor, nuk mund të kishin një standard për Kosovën e një tjetër për Shqipërinë.

Për arsye të mos ngritjes së sistemit të shkollimit për nivelin e parë të drejtimit, ka ndodhur bllokimi i procesit të promovimit të kryeinspektorëve për nënkomisarë, gjë që ka krijuar vakum të theksuar të specialistëve në strukturat operacionale të punonjësve me këtë gradë në strukturat e hetimit e parandalimit të krimit dhe sigurisë publike⁴⁷.

“Krizë” për nënkomisar nuk do të ishte ndjerë nëse paralelisht me shkollimin bazë policor të vazhdonte normalisht dhe Akademia e Policisë, e ristrukturuar si shkollë e lartë që përgatiste punonjës policie të gradës nënkomisar, punonjës të cilët vinin nga shkollimi bazë policor si dhe të merrej edhe me shkollim-trajnimin dhe të niveleve të tjera. Në këtë rast, në këtë Akademi, nuk do të kishte ndërprerje, si më parë mes nivelit të policit dhe oficerit të policisë, por vazhdimësi në ecurinë në karrierë dhe përgatitjen e punonjësve të policisë nga niveli bazë në nivelin e parë dhe nivelet e tjera të drejtimit. Kjo gjithashtu do të ishte në përputhje me Ligjin e Policisë së Shtetit Nr. 9749, date 04.06. 2007, i cili kishte sanksionuar vazhdimësinë në karrierë nga roli bazë deri tek roli drejtues.

Menaxhimi i Akademisë së ristrukturuar të Policisë do të plotësonte dhe misionin për zhvillimin e drejtuesve të ardhshëm të organizatës policore si dhe trajnimin e punonjësve të policisë sipas gradave dhe niveleve. Vazhdimi i funksionimit të Akademisë së Policisë të ristrukturuar, do të ishte gjithashtu dhe një vazhdim i traditës më të mirë të arsimit të lartë policor në Shqipëri, i cili filloi në vitin 1971 si pjesë e rëndësishme e zhvillimit të karrierës në polici në 37 nga 70 vitet e Shtetit Shqiptar të pas Luftës së II Botërore dhe në 18 nga 24 vitet e Shtetit Shqiptar të pas Luftës së Ftohtë. Në të dy draft dokumentet bazë të hartuara për t’i paraprirë në atë kohë reformimit të sistemit arsimor dhe konkretisht në “Politikat Bazë Orientuese për Zhvillimin e Sistemit të Trajnimit në Policinë e Shtetit” dhe projekt-draft “Për zhvillimin e afërt dhe perspektiv të sistemit arsimor për Policinë e Shtetit Shqiptar”, ishte parashikuar akreditimi i trajnimeve dhe mundësia për ta pajisur personelin e policisë me një diplomë të nivelit universitar.

⁴⁵ Tracey Green and Greg Linsdell “Higher Education in Policing”: The contemporary investigation of serious crime needs a collaborative approach to both training and education with practitioners and researchers providing new approaches and innovative solutions to what are very difficult and complex problems, namely the investigation of serious crime in uncertain times. Edited by Gabriele Bammer The role of higher education, “Dealing with Uncertainties in Policing Serious Crime” ANU (The Australian National University, ANU Press Library). Burim i cituar.

⁴⁶ Akademia e Kosovës Për Siguri Publike, themelohet me Ligjin Nr. 04/L-053, datë 21 tetor 2011. Shpallur me dekreten Nr. DL-045-2011, datë 15.11.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga

⁴⁷ Studimi “Mbi vlerësimin e gjendjes së brendshme të Policisë së Shtetit” faqe 55. Tiranë, Nëntor 2013. Burim i cituar.

Por, pavarësisht parashikimit në dy dokumentet e mësipërm, në të dy dokumentet e miratuara si udhërrëfyes për arsimin policor në të ardhmen, në Strategjinë “Për trajnimet në Policinë e Shtetit për vitet 2011-2016” dhe dokumentin “Për sistemin e arsimit në Policinë e Shtetit”, si pjesë e paketës që shoqëron këtë strategji, nuk parashikohej fare akreditimi i trajnimeve, duke e lënë kështu sistemin arsimor policor jashtë standardeve dhe kornizave ligjore të kohës. Themelimi i Akademisë së Sigurisë në vitin 2015 dhe konceptimi i saj strukturor, infrastrukturor e në kurrkula si institucion i arsimit të lartë publik, me programe ku ndërthuren arsimimi bazë policor, arsimimi i lartë në të tre ciklet sipas Kartës së Bolonjës si dhe trajnimet e kualifikimet profesionale, shënojnë një moment të rëndësishëm kthese për Policinë e Shtetit, për fillimin e eliminimit të pasojave në fushën e arsimit, sidomos të nënkomisarëve të policisë, edukimit profesional policor e ecurisë në karrierë, të shkaktuara nga mbyllja e Akademisë së Policisë si dhe për përgatitjen e tyre për përballimin e sfidave bashkëkohore të sigurisë.

5. Përfundime

Pasi studiuam dhe analizuam, për një periudhë thuajse 10 vjeçare (2006-2015), procesin e ecurisë në karrierë të punonjësve të policisë që kanë kryer shkollimin bazë policor, menaxhimin e këtij procesi si dhe rolin e sistemit arsimor të përzgjedhur në plotësimin e nevojave të Policisë së Shtetit me specialistë nënkomisarë të aftë për përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësive të organizatës në përballimin e sfidave bashkëkohore të sigurisë, mbështetur në hulumtime, analiza e sintheza, arrijmë në përfundimin se:

- Shkollimi bazë policor ka luajtur një rol të rëndësishëm për përgatitjen e një shërbimi policor shqiptar drejt standardeve euroatlantike. Kjo është një arritje e madhe për organizatën tonë policore dhe kjo falë dhe mbështetjes nga partnerët tanë euroatlantik e, në mënyrë të veçantë, monitorimit të këtij shkollimi nga misioni amerikan ICITAP. Ky impakt pozitiv më shumë është ndjerë në strukturën e Sigurisë Publike dhe Parandalimit të Krimit dhe më pak në strukturën e Krimeve të Rënda dhe Krimit të Organizuar.

- Sistemit arsimor i përzgjedhur për ecurinë në karrierë të punonjësve të policisë që kanë përfunduar shkollimin bazë policor, nga niveli bazë për në nivelin e parë të drejtimit, si dhe keqmenaxhimi i këtij procesi, kanë penguar plotësimin e nevojave sasiore dhe cilësore të Policisë së Shtetit me specialistë nënkomisar, që të zotërojnë aftësitë parësore të kërkuara për të qenë të aftë për të përmbushur përgjegjësitë e vendit të punës, proces i cili ka cenuar më shumë strukturat e hetimit të krimeve.

- Fillimi i reformimit të plotë të sistemit arsimor policor dhe themelimi i Akademisë së Sigurisë, konceptimi i saj si institucion i arsimit të lartë publik, me programe ku ndërthuren arsimimi bazë policor, arsimimi i lartë në të tre ciklet sipas Kartës së Bolonjës si dhe trajnimet e kualifikimet profesionale, shënojnë një moment të rëndësishëm kthese për Policinë e Shtetit, për fillimin e eliminimit të pasojave në fushën e arsimit, sidomos të nënkomisarëve të policisë, edukimit profesional policor e ecurinë e tyre në karrierë, për t'i bërë ata më të aftë për t'u përballur me sfidat bashkëkohore të sigurisë.

6. Rekomandimet dhe politikat

Sa më sipër do të ishte e rekomandueshme:

- Hartimi i një strategjie “Për zhvillimin dhe konsolidimin e sistemit arsimor policor dhe menaxhimin procesit të zhvillimit të karrierës në Policinë e Shtetit për vitet 2016-2020” si dhe e Planit Veprimit në zbatim të saj.

- Hartimi i strategjisë “Për zhvillimin dhe konsolidimin e Akademisë së Sigurisë për vitet 2016-2020” si dhe e Planit të Veprimit në zbatim të saj, si një dokument që synon të mbështesë rrugëtimin e Akademisë së Sigurisë drejt një akademie moderne dhe të zhvilluar për të trajnuar dhe arsimuar punonjësit e Policisë së Shtetit dhe jo vetëm ata.

- Konsolidimi i kapaciteteve ekzistuese dhe zhvillimi i kapaciteteve të reja në Kolegjin Policor, për të mësuar dhe edukuar në mënyrë të organizuar punonjësit e rinj të policisë me njohuritë bazë policore.

- Ndërprerja e çdo lloj mundësie për të marrë gradën e nënkomisarit në rrugë të tjera përveçse duke përfunduar ciklin e plotë të studimeve bachelor në Akademinë e Sigurisë.

- Menaxhimin e punës për eliminimin sa më parë të pasojave të ardhura nga mbyllja e Akademisë së Policisë dhe vlerësimi i mundësisë për kalimin në një proces të plotë shkollimi në Akademinë e Sigurisë, pa shpëputje nga puna, të punonjësve të Policisë së Shtetit të cilët gjatë kësaj periudhe janë certifikuar nënkomisar.

Referencat

Ligje dhe VKM

1. Ligji nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjet nr. 9832, datë 12.11.2007 dhe nr. 10 307, datë 22.7.2010.
2. Ligji Nr. 9749, datë 4.6.2007, "Për Policin e Shtetit".
3. Ligji Nr. 108/2014, datë 31.7.2014 "Për Policinë e Shtetit",
4. Ligjin Nr. 04/L-053, datë 21 tetor 2011 "Për krijimin e Akademisë së Kosovës "Për Siguri Publike".
5. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 281, datë 2.6.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Policisë".
6. VKM nr. 135, datë 11.2.2009 "Për mbylljen e Akademisë së Policisë "Arben Zylyftari" dhe riorganizimin e arsimit policor si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit".
7. VKM Nr.185 datë 25.2.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë".
Dokumente arkivore
8. Arkivi i Sistemit të Ministrisë Punëve të Brendshme. "Kolegjiumi i MPB për Shkollën e Lartë të Ministrisë Punëve të Brendshme. Pasqyrë Krahasuese e Planeve Mësimore", Dosja Nr. 665,Viti 1976, faqe 67-68.
9. Arkivi i Sistemit të Ministrisë Punëve të Brendshme. Shkresë e Drejtorisë së Policisë së Ministrisë Punëve të Brendshme Nr. 416/1, datë 16 tetor 1947, drejtuar Drejtorisë Punëve të Brendshme Korçë, Seksionit të Policisë. Dosje 11/1947.
10. Arkivi i Sistemit të Ministrisë Punëve të Brendshme. Shkresë e Drejtorisë së Policisë së Ministrisë Punëve të Brendshme Nr. 961/1, datë 4 tetor 1945 "Mbi Kursin e Policisë". Dosje 2/48. faqe 1-7;
11. Arkivi i Sistemit të Ministrisë Punëve të Brendshme. Qarkore e Drejtorisë së Policisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme Nr. 961/3, datë 3.10.1945, drejtuar Komitetit Ekzekutiv të Prefekturës Shkodër "Për organizimin e një kursi policie 20 ditor". Dosje 2/48. faqe 1-7;
12. Arkivi i Sistemit të Ministrisë Punëve të Brendshme. Qarkore e Drejtorisë së Policisë Nr. 1248 datë 10.04.1946. Dosje 5/48. faqe 1-3.
13. Arkivi i Sistemit të Ministrisë Punëve të Brendshme. VKM nr. 184 datë 20.12.1971 "Mbi organizimin e Shkollës së Lartë të Ministrisë Punëve të Brendshme. Dosje 12,Viti 1972, faqe 22-23.
14. Arkivi i Ministrisë së Brendshme. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 339 datë 2.9.1991, "Mbi rstrukturimin e Shkollës së Lartë të Ministrisë Punëve të Brendshme dhe krijimin e Institutit të Lartë të Rendit" Fondi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Nr. 145, Dosje Nr. 40, Viti 1991,faqe 3-5.
15. Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 05.01.2011 "Për përgatitjen e strategjisë afatgjatë të sistemit arsimor në Policinë e Shtetit",
16. Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 83, datë 24. 01. 2011 " Për ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Punës për përgatitjen e strategjisë afatgjatë të sistemit arsimor në Policinë e Shtetit".
17. Memo e përgatitur për Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nga Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm Ahmet Haxhia me datë 7.3.2011 "Për rishikimin e dokumentacionit të hartuar në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 1720/1 datë 05.01.2011 "Për përgatitjen e strategjisë afatgjatë të sistemit arsimor në Policinë e Shtetit".
18. Rregullore për Trajnimet në Policinë e Shtetit, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 1136, date 9.12. 2008.
19. Drafti i Politikave Bazë Orientuese për Zhvillimin e Sistemit të Trajnimit në Policinë e Shtetit, hartuar nga grupi i punës i përbërë nga drejtues Ilo Kecka-përgjegjës dhe kryekomisarët Lorenc Panganika e Artur Zoto, anëtarë.

Dokumente nga Arkivi në Veprim i Akademisë së Sigurisë

20. Projekt Strategji "Për zhvillimin e afërd dhe perspektiv të sistemit arsimor për Policinë e Shtetit Shqiptar", përgatitur nga Zoti Jashar Vreka, Drejtor i Akademisë së Policisë, Zoti Tomas Moisselle nga Misioni ICITAP dhe Zoti Antony Finnerty nga Misioni PAMEKA, dërguar me shkresën Nr. 330 datë 6.7.2007 Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Zotit Ahmet Prençi. Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për Shërbimet Mbështetëse Zoti Arben Doçi si dhe Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për Trajnimin Policor, Zotit Ahmet Haxhia.
21. Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 1/211, datë 09/03/2009 për ngritjen në gradën kryeinspektor.
22. Program shkollimi për "Nivelin e Parë Drejtues" për gradën Nënkomisar. Miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.1137 datë 9.12.2008.
23. Analiza e zhvillimit dhe përmbylljes së procesit të shkollimeve për nivel dhe trajnimeve për ngritjen në gradë. Drejtuar Zotit Ahmet Haxhia, Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Policisë Shtetit për Departamentin e Trajnimit Policor. Pika 3 "Nxjerrja e konkluzioneve dhe përcaktimi i detyrave për të ardhmen", Tiranë 14 korrik 2009.
24. Strategji "Për Trajnimet në Policinë e Shtetit 2011-2016. Paraqitur për miratim Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit me memon shoqëruese të datës 7.3.2011, të Zotit Ahmet Haxhia. Studime, raporte, analiza, relacione, etj.

25. Joseph Hauer: "Studim mbi Shpërndarjen e Personelit". Projekti i ICITAP "Mbi Menaxhimin e Burimeve Njerëzore & Përgjegjshmërisë Policore", Shtator 2006.
26. Raport Studimor "Për vlerësimin e personelit në Policinë e Shtetit". Punuar nga Arben Gjergji, Luan Dervishi dhe Genc Mërepeza. 20 Nëntor 2013
27. Akademia e Policisë, Shqipëri-Guidë. Tiranë 2002.
28. Studimi "Mbi vlerësimin e gjendjes së brendshme të Policisë së Shtetit" Tiranë, Nëntor 2013, Grup autorësh.
29. Dr. Xhavit Shala: Studim "Mbi vlerësimin e performancës strategjike të punës së strukturave të hetimit dhe parandalimit të krimeve me informatorët dhe rrjetin sekret informativ", Tiranë Korrik 2014.
30. "Raport për mbylljen e punësimit të punonjësve të Policisë së Shtetit 2006-2015", nxjerrë nga sistemi RMIS, përgatitur për studimin nga kryekomisar Arben Gjergji, datë 15.9.2015
31. "Raport për pranimet e punonjësve të Policisë së shtetit 2016-2015 nxjerrë nga sistemi RMIS, përgatitur për studimin nga kryekomisar Arben Gjergji, datë 18.9.2015
32. Lista e punonjësve të rolit të mesëm dhe të lartë, të larguar në Korrik 2007, përgatitur për studimin nga kryekomisar Arben Gjergji, 16.9.2015., Monografi
33. Gabriele Bammer, The role of higher education, "Dealing with Uncertainties in Policing Serious Crime" p.156, ANU (The Australian National University).
34. Marriam Webster - An Encyclopedia Britanica Company, Training.
35. Tracey Green and Greg Linsdell "Higher Education in Policing" Edited by Gabriele Bammer The role of higher education, "Dealing with Uncertainties in Policing Serious Crime" ANU (The Australian National University, ANU Press Library.
36. Henri Fayol: "Administration, Industrielle et Générale - Prévoyance, Organisation, Commandement, Coordination, Contrôle". 1916. Whatis Management? (Generaland Industrial Management by HenriFayol. (Constance Storrs, Trans.). London: Pitmanand Sons, Ltd., 1949).

Liria e besimit, në Kushtetutën e Shqipërisë së vitit 1950 dhe, në Kushtetutën e vitit 1976

Aspektet historiko-juridike

Dr. Irvin FANIKO

Akademia e Sigurisë

irvin.faniko@asp.gov.al

Abstrakt

Për të kuptuar më mirë dhe në mënyrë gjithë përfshirëse sistemin kompleks juridik institucional të vendit tonë, Shqipërisë, në fillim është e nevojshme për të analizuar të gjithë rrugën ligjore të evolucionit të saj historik, veçanërisht në dritën e rëndësisë juridiko-institucionale që e ka mbuluar në strukturën aktuale kushtetuese. Fillimisht mund të përqendrohemi tek të gjitha statutet e miratuara në vend pas pavarësisë.¹ Në Monarkinë e I-rë, statuti u aprovua më datë 10 prill të vitit 1914 nga Komisioni Ndërkombëtar Mbikëqyrës², si përfaqësues i Fuqive të Mëdha.³ Rëndësia e tij ishte themeltare sepse ishte fryt i drejtë për drejtë i dëshirës së tyre e në të njëjtën kohë hidhte bazamentet demokratik për këtë shtet të ri.⁴ Gjithmonë në Monarkinë e I-rë u aprovua i dyti, "Statuti i Lushnjës" (21 janar i vitit 1920), këtë herë vetëm si punim i Asamblesë kombëtare.⁵ Në vitin 1922 kjo ishte në fakt objekt i ndryshimit nga ana e Këshillit Kombëtar që i ri-dha emrin e ri të "Statuti i Zgjeruar i Lushnjës".⁶ Tre vite më pas, në vitin 1925, Republika e Zogut (Republika e I-rë) favorizonte përpilimin e Statutit themeltar, më pas, më datën 1 shtator 1928 nga President i Republikës, Zogu vendosi që të ndryshonte formën qeverisëse të shtetit duke e kthyer në një Monarki (Monarkia e II-të), tek e cila u vetëquajt sovrani. Statuti i Mbretërisë së Shqipërisë ishte i përbërë nga një hyrje e dhjetë tituj. Nga titulli i II-të "sovrانيتeti i shtetit" dukej qartë sesi mbretit i jepeshin të gjitha fuqitë e forta, nga e drejta e vetos në krahasim të ushtronte ndërmjet ministrave. Ndër të tjera, sovrani ishte i papërgjegjshëm e i paprekshëm për çfarë do lloj fakti të kryer. Kuptohet që, bëhej fjalë për një statut që ishte i ndërmarrë nga modelet e monarkive kushtetuese evropiane.⁷ Në dhjetëvjeçarën e mëpasshëm,⁸ më datën 16 prill të vitit 1939, falë ndihmës së Benito Mussolinit, ndodh bashkimi personal midis koronës së mbretit të Italisë, Vittorio Emanuele III (Monarkia e III-të).

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

Fjalëkyçe:

Kushtetutë, shtet, besim fetar, ligj, krahasim.

1. Zhvillimet historiko-juridike në prag të ardhjes së diktaturës

Pas kësaj hyrjeje sintetike, mund të arsyetojmë, sesi ndodhi në këtë periudhë kaq të shkurtër historike (1912-'39) me gjithë emancipimin e përse statuteve dhe modifikimet e vetë formës së shtetit, nuk kishte një demokraci e stabilizim juridik të vendit. Por, cilët ishin motivet? Ka shumë mundësi që me ardhjen e diktaturës ka qenë një përgjigje e një zgjidhjeje të munguar të këtyre problemeve.⁹ Në veçanti, në këtë moment historik, mund të marrim në shqyrtim dy Kartat kushtetuese: e para, e promulguar në vitin 1950¹⁰ gjatë Republikës Popullore të Shqipërisë¹¹ dhe, e dyta, të Kartës Kushtetuese të vitit 1976 të promulguar në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Në këtë periudhë është e qartë që: “*Vendi ishte i mbytur nga diktatura totalitare e Enver Hoxhës*”.¹² Gjithsesi, përveç kësaj, megjithëse të dy Kushtetutat ishin të ngjashme përsa i përket sovranitetit shtetëror¹³, me Kuvendin popullor¹⁴ të vendosur si Organ Suprem i Shtetit, është e vërtetë që ekzistonin edhe diferencime.

Kushtetuta e dytë, ishte e drejtuar drejt një integrimi më të madh drejt ideologjisë komuniste që diferencojë nga një anë, nga cenimi i të drejtave të lirisë dhe, nga tjetra, ndërmyjet fuqizimit të sovranitetit të Kuvendit popullor e të Kryetarit të shtetit gjithashtu.

Kjo sepse me Kushtetutën e I-rë ishte vetëm vendosur një sistem qeverisës, më tepër tranzitor e me qëllim që të çlironte Shqipërinë nga çdo pushtim i jashtëm. Por, një herë që Shqipëria u bë e lirë e e pavarur, kombi u gjet gati i detyruar të krijonte një sistem të ngurtë të organizimit shtetëror.

Ndër të tjera Kushtetuta e vitit 1976¹⁵ specifikonte qartësisht e në më shumë pjesë

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

të ndryshme të saj rolin e drejtuesit të partisë dhe mbi të gjitha kushtetizonte marksizëm-leninizim si ideologji të shtetit shqiptar.

Me miratimin e Kushtetutës së II-të vendi ishte izoluar akoma edhe më shumë e po rigjendej përpara një rendi juridik kushtetues shumë të ngurtë.¹⁶

Sipas mendimit tim, me Kushtetutën e I-rë Shqipëria kishte vënë në dispozicion vetëm një sistem qeverisës të përkohshëm, për ta finalizuar përfundimisht më pas me Kushtetutën e II-të¹⁷ me formën e qeverisjes tipike të regjimeve totalitare.¹⁸

2. Aspekte krahasuese midis dy kushtetutave socialiste

Diferenca më e madhe midis Kushtetutës së parë dhe të dytë¹⁹ është e dukshme tek liria fetare. Në fakt Shqipëria është i vetmi shtet ku ishte deklaruar ateizmi i shtetit me ligj. Që nga viti 1967 Enver Hoxha kishte deklaruar ateizmin e shtetit duke futur në fuqi një ligj që ndalonte krijimin e shoqërive fetare, praninë e vendeve të kulteve, shitjen ose publikimin e materialeve fetare dhe mësimin fetar, por gjithmonë duke mbajtur e ruajtur mundësinë e praktikimit fetar privat. Kushtetuta e mëparshme më thjeshtësisht nuk e deklaronte fenë e shtetit, duke pranuar gjithsesi ekzistencën e më shumë besimeve në shtet²⁰. Vetëm me Kushtetutën e dytë e cila u shty pak më tepër duke deklaruar mbi të gjitha që nuk njihje asnjë besim fetar²¹ dhe mbi të gjitha ndalonte çdo shoqëri ose propagandë fetare²².

Midis Kushtetutës së parë dhe të dytë diferenca është shumë e dukshme: nëse më parë ateizmi do të ishte vetëm një realizim i politikës qeveritare, në të dytën ideologjia u bë ligj. E ky ishte i vetmi shtet nga të gjithë anëtarët e zinxhirit të sistemit komunist ku kjo u realizua²³.

Pra nëse në Kushtetutën e parë liria personale e shprehur në ndjenjën fetare nuk ndalohej, në të dytën vinte plotësisht e ndaluar dhe mbi të gjitha dënohej penalisht. Në fakt neni 55 i Kodit Penal të vitit 1977 detyronte se si dënimi me burg nga tre deri në dhjetë vjet për shkeljen e nenit 55 të Kushtetutës. Hoxha u mahnit pjesërisht në këtë kontekst nga revolucioni kulturor kinez dhe në shinat e gabuara të tij dha urdhër që të konfiskoheshin; xhamitë, kishat, manastiret të cilat i shkatërroi ose i transformoi në ofiçina, magazina, stalla, etj. Kushtetuta e dytë gjithsesi nuk arriti të ndalonte praktikimin privat të kultit, por vetëm publikimin e tij dhe për këtë ndalonte jo vetëm shpërndarjen e shkrimeve mbi këtë temë por edhe emërtimin fetar dhe në këtë sens nuk mund t'u vendosnin fëmijëve të sapo-lindur emra fetar. Në këtë moment është e rëndësishme të sjellim ndër mend nenin 55 të Kushtetutës së dytë ku thuhet: *“Është e ndaluar krijimi i çfarë do lloj organizate me karakter fashist, antidemokratik, fetar ose antisocialist. Është i ndaluar aktiviteti dhe propaganda fashiste, antidemokratike, fetare antisocialiste, luftë-formuese ashtu si dhe urrejtja kombëtare ose etnike”*.

Ky nen është emblematik dhe sjell idenë sesi ideologjia komuniste mund të integrohet plotësisht në Kushtetutën e dytë sesa në Kushtetutën e parë. Siç mund të shikohet nuk është vetëm besimi që ishte i ndaluar por dhe çdo gjë që nuk është ideologjikisht bashkë-kohore me socializmin. Se në fakt si në Kushtetutën e parë dhe në të dytën u ndalua fashizmi dhe kjo sjellje është qartësisht e shpjeguar tek vullneti i lirisë së popullit shqiptar ndaj pushtuesve ose më mirë ndaj shtypësve (që në atë epokë ishte Benito Mussolini), vetëm në të dytën ndalohej propaganda e çdo ideje

“antisocialiste”. Pra në Kushtetutën e dytë në krahasim me të parën është “e mbyllur” dhe antidemokratike. Edhe pse në fakt shumë shpesh në Kushtetutën e dytë përdoret termi demokratik ajo nuk është aspak e tillë dhe tregon tamam aty ku jep ekuacionin demokracia është e përbërë me socializmin kur nuk respektohet vullneti i popullit nëse është ndryshe nga ideologjia socialiste. Edhe atëherë kur maxhoranca e popullatës do të ishte dakord me një ideologji antisocialiste, ajo do të konsiderohej e paligjshme dhe do të dënohej me burgim. Kjo nuk është demokraci.

Duke rishikuar Kushtetutën e parë e cila propozonte një shtet edhe pse të mbyllur por të paktën të lirë në disa manifestime personale, e dyta e mbyll plotësisht unazën e shtetit i detyron qytetarët e tij kundrejt një kontrolli të rreptë, duke realizuar në praktikë një regjim të vërtetë. Në fakt, siç është parë dhe më përpara, Asambleja popullore është tamam si një lloj *Big Brother*-i për të përdorur një neologji bashkëkohore e cila mund të garantoj funksionimin korrekt të së gjithë sistemit. Tek ajo fillonte gjithçka sepse vetëm kështu mund të ishte efikase dhe efiçente. Çdo gjë pra kontrollohet imtësisht, si p.sh: shkrimet, publikimet por edhe korrespondenca, komunikimet e kështu me radhë. Në fund edhe pronësia shpërbëhet sepse kapitalizmi është kundër ideologjisë. Në fakt teoria marksiste-leniniste e ndërton socializmin jo në bazën e pronësisë kapitaliste shtetërore, por vetëm mbi bazën e pronësisë sociale socialiste të mjeteve të prodhimit.

3. Konkluzione

Ky sistem qeverisjeje, nëse mund të duket i rrezikshëm në pikë-pamjen e mendimit të përbashkët bashkëkohor, kishte një kuptim të tijin historik shumë preciz. Në Kushtetutën e parë shqiptare ishte propozuar vetëm një sistem qeverisjeje, mbi të gjitha transitor dhe i kryer për të liruar Shqipërinë nga çdo presion i jashtëm. Njëherë që u bë e lirë dhe e pavarur Shqipëria u gjet gati e detyruar për të krijuar një sistem të rreptë të organizimit Shtetëror.²⁴

Dëshmitarë të këtij sistemi janë bunkerët e pafundmë të mbrojtjes dhe të kontrollit që ndërtoheshin gjatë viteve. Duke qenë një Shtet në pozicion qendror Shqipëria historikisht ka qenë e detyruar të mbrohej nga pushtimet. Ka shumë mundësi dhe ky është edhe motivi për të cilën me gjithë politikën mbytëse dhe jo-demokratike të kësaj Kushtetute, e cila bëri që kjo të durohej dhe të zgjaste kaq gjatë.

Referenca dhe shënime

¹ E gjitha kjo për rrjedhojë e traktatit të paqes tek i cili sulltani ia beson tek Fuqitë e Mëdha (Gjermanisë, Austrisë, Francës, Anglisë, Italisë dhe Rusisë) të ardhmen e Shqipërisë e njohur si një Shtet i pavarur por tek i cili duhen ri-parë kufijtë hapësinorë.

² Përbëhej nga shtatë anëtarë nga të cilët vetëm njëri duhet të ishte shqiptar, i ngarkuar për pesë vjet dhe me mundësi ri-zgjedhjeje, dhe nga një përfaqësues i gjashtë fuqive garante. Komisioni kishte si detyrë: Të formulonte statutin e Shqipërisë; Të eliminonte pushtetin e autoriteteve lokale; Të krijonte një qeveri të qëndrueshme; Të kontrollonte trupat e pranishme në territor që kishin si detyrë ruajtjen e rendit.

³ Amedeo Giannini, diplomat e studiues italian, në volumnin e tij: *La questione albanese* (Roma 1925), nënvijëzon sesi teksti i traktatit të Londrës nuk parashikonte, në realitet, pavarësinë e Shqipërisë; me nenin 3 Turqia i jep territorin evropian "me përjashtim të Shqipërisë". Çështja nuk u vendos në këtë kontekst dhe Konferenca e Ambasadorëve fillon të hartojë një Statut për shtetin e ri.

⁴ Gjithashtu Komisionit Ndërkombëtar iu besua kontrolli i administratës civile dhe të financës. Komisioni u ngarkua edhe me formulimin e një projekti për organizimin e administratës publike si dhe me kontrollin, në pritje të emërimit të princit, e sjelljes së autoriteteve kombëtare, ndërsa xhandarmëria iu besua komandës së ushtarakëve suedeze.

⁵ U zgjodh një Këshilli i Lartë Regjence – i cili përbëhej nga katër anëtarë – një ekzekutiv me gjashtë anëtarë, ndër të cilët Sulejman Bej Delvina si Kryeministër, Mehmet Bej Konica ministër i jashtëm dhe Ahmet Bej Mati Zogu ministër i brendshëm (nga marsi në muajin nëntor të vitit 1920) dhe në fund, themeloi Këshillin Kombëtar (Senatin). Në fund të afatit të saj, Asambleja Kombëtare nxori një dokument që kërkonte për Shqipërinë "një pavarësi të plotë në kufijtë e saj etnike dhe natyrorë" – ekzistenca e të cilëve ishte njohur nga Konferenca e Ambasadorëve në formën e monarkisë – dhe refuzonte "çdo mandat apo protektorat të huaj". Kështu u shpall lirshëm vullneti për të luftuar dhe për të ruajtur integritetin dhe pavarësinë kombëtare. Këshilli i Lartë i Regjencës përbëhej nga katër anëtarë që përfaqësonin Kryetarin e Shtetit Shqiptar, derisa ky i fundit dhe forma e qeverisjes të vendoseshin përfundimisht. Ky megjithatë, përsa i përket miratimit të ligjeve, nuk kishte të drejtë votoje për të ndaluar zbatimin e një ligji, pra shpallte të gjithë ligjet e miratuara nga Këshilli Kombëtar.

⁶ I cili nuk ishte gjë tjetër veç vendosja e regjimit parlamentar dhe shpallja për herë të parë në historinë e vendit të së drejtave themelore të qytetarëve.

⁷ Organizimi i Shtetit, përsa i përket institucioneve, në Republikën e Shqipërisë në vitet 1925-28 përbëhej nga: Parlamenti, që përbëhej nga Dhoma e Deputetëve (57 anëtarë) dhe Senati (18 anëtarë). Për më tepër parlamenti mblidhej bashkërisht, i emëruar nga Asambleja legjislativë, për të zgjedhur Kryetarin e Shtetit. Presidenti i Republikës, i cili: ishte Komandant i Forcave të Armatosura; Deklaronte luftë, pasi të merret miratimin e dhomave; Ratifikonte traktatet (me një kontroll nga ana e dhomave) dhe akreditonte përfaqësuesit diplomatikë; Mund të shpërbënte Dhomën e Deputeteve; Publikonte ligjet, por kishte edhe të drejtë votoje; Emëronte dhe tërhiqte ministrat; Emëronte dhe tërhiqte prokurorët. Neni 8 i Statutit Themelor të Republikës së Shqipërisë vendosi që pushteti ekzekutiv i përkiste vetëm Kryetarit të Republikës, i cili e ushtronte nëpërmjet ministrave. Pra pushteti ekzekutiv ishte fokusuar në duart e Zogut, i cili ishte njëkohësisht edhe kryeministër. Ministrat – dhjetë ditë pas emërimit – duhet të prezantoheshin përpara Dhomës për të marrë besimin. Ata kishin të drejtën të dëgjoreshin, në çdo mbledhje të Dhomës dhe Senatit, sa herë që kërkonin fjalën, por mund të votonin vetëm ata që ishin deputetë ose senatorë. Gjatë presidencës së Zogut, në Shqipëri u eliminua gradualisht shërbimi dhe filloi të shfaqej më shumë si komb sesa si agregat feudal i beve lokalë, për herë të parë që pas vdekjes së Skënderbeut.

⁸ Mbretërimi i Zogut shumë shpejt u lidh shumë me Italinë e Mussolini-t, deri kur më datën 7 Prill të vitit 1939 Duce pushtoi ushtarakisht Shqipërinë dhe e detyroi Zogun të arratisej.

⁹ Në fakt, në mënyrë paradoksale, edhe pse numri i të punësuarve në shtet ishte trefishuar me ndihmën e fashizmit, varfëria e përgjithshme ishte rritur, edhe sepse qeveria italiane vazhonte të privilegjonte feudalët e njohur të përhershëm, bejëjt dhe bajraktarët. Fitoret e vazhdueshme në luftën e përbashkët kundër fashizmit sollën në një kohë të shkurtër në Konferencën e Pezës më datë 16 shtator të vitit 1942, në të cilën morën pjesë përfaqësues të rrymave të ndryshme politike të vendit, si Partia Komuniste e Enver Hoxhës: në konferencë organizimi i popullit mori emrin Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar, me një ushtri me 70000 ushtarë, në të cilën më vonë morën pjesë edhe italianë. Konferenca zgjodhi edhe organin drejtues të frontit, të quajtur Këshilli i Përbashkët Kombëtar, i përbërë nga disa anëtarë të zgjedhur të PKSH-së. Akti i parë "zyrtar" i Frontit ishte çlirimi i qytetit të Skraparit. Konferenca e parë kombëtare e PKSH-së daton në muajin Mars të vitit 1943: ajo zgjodhi zyrtarisht Enver Hoxhën si Sekretar të Përgjithshëm të Partisë, post që e ruajti deri në vdekje, më vitin 1985.

Falë fitoreve të Ushtrisë Çlirimtare Shqiptare, Enver Hoxha filloi një fazë të re luftimi për ta futur Shqipërinë në rrugën e socializmit. Në fakt, në Mars të vitit 1946 Asambleja Kushtetuese shpalli Shqipërinë Republikë

Popullore, dhe emëroi Enver Hoxhën Kryeministër. Në vazhdim të shpalljes së Republikës Popullore të Shqipërisë, të gjitha pronat e italianëve dhe gjermanëve u konfiskuan, si edhe të atyre që kishin tradhtuar vendin e vet.

¹⁰ Kushtetuta e Republikës Popullore, u formulua në vitin 1946, dhe u miratua më datën 4 Korrik të vitit 1950 në Tiranë. Kushtetuta ishte e nën-ndarë në tre pjesë, si: Pjesa I Principet themelore, ku bënin pjesë Kapitulli I *Republika Popullore e Shqipërisë* (nenet 1-6); Kapitulli II *Rendi social dhe ekonomik* (nenet 7-13) dhe Kapitulli III *Të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve* (nenet 14-40); Pjesa II Organizimi i Shtetit, ku bënin pjesë Kapitulli I *Organet supreme të Shtetit* (nenet 41-60); Kapitulli II *Organet e Administratës Shtetërore* (nenet 61-70); Kapitulli III *Organet e sovranitetit Shtetëror të bashkësive administrative lokale* (nenet 71-78); Kapitulli IV *Gjykatat dhe Prokura* (nenet 79-90); Kapitulli V *Raportet e organeve të sovranitetit shtetëror dhe të administratës shtetërore* (nenet 91-93) dhe Kapitulli VI *Ushtria Popullore* (nenet 94-95); Pjesa III Stema, Flamuri, Kryeqyteti (nenet 96-98).

¹¹ Shqipëria e E. Hoxhës me këtë Kushtetutë ndjek hapat e vendosura më përpara nga Rusia në 1917 dhe spostohet bashkërisht me revolucionin qeveritar të vitit 1948 në Çekoslovakia. Pra Rusia, Shqipëria dhe Çekoslovakia e transformojnë Frontin e Lirisë Kombëtare në Këshill Popullor e që këtu lind Qeveria e re.

¹² Neni 2 i Kushtetutës specifikonte që Shqipëria, si Republikë Popullore është "Shteti i punëtorëve dhe i fshatarëve punëtorë".

Sfondi social-komunist është i dukshëm dhe manifestohet nga përcaktimet që në nenet e para, në veçanti në nenin e tretë dhe të katërt, që deklarohen kundër fashistëve dhe i japin sovranitet punëtorëve.

Në Shqipëri, diktatura e proletariatit shtjellohet me Këshillin popullor (neni 3), të formuar nga "punëtorë të qytetit dhe fshatit". Në fakt, organizmat popullorë si Këshillat popullorë lindën që më parë si organizma të masës dhe të luftës, në këtë rast, kundër fashizmit, për t'u transformuar më pas në celula organizative të sovranitetit proletar dhe, vetëm më vonë, me përfundimin e revolucionit, në organizma shtetërorë. Këshillat popullorë pra janë struktura pushteti të Shtetit proletar. Detyra dhe vendosja e tyre janë përshkruar nga Lenini në shumë prej shkrimeve të tij, në të cilët përcaktohet qartë detyra e tyre e shpejtë, të fusin masat punëtore brenda aparatit administrativ përmes shkrirjes së pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv. Në këtë mënyrë, Këshillat popullorë janë një risi në sistemin e përfaqësisë politike dhe forma më e pastër e diktaturës së proletariatit. Dhe kjo shprehet qartë në nenin 5 paragrafi i I-rë të Kushtetutës, i cili pohon se: "Të gjithë organet që përfaqësojnë pushtetin e shtetit zgjidhen nga qytetarët me votim të lirë....".

¹³ Po të shihet me vëmendje, një pjesë e mirë e Kushtetutave komuniste të impostuara pas Luftës së Dytë Botërore kanë të njëjtin përcaktim: të ngrenë një qeveri demokratike dhe antiimperialiste në periudhën fillestare dhe pastaj të realizojnë një diktaturë të vërtetë të proletariatit. Përsa i përket argumentit krahasoni Gambino L. (a cur.), *Brani di classici del pensiero politico*, Giappichelli G. Editore, Torino 2002, faqet 466-468.

¹⁴ Asambleja popullore në formën e saj qeverisëse lind nga zgjedhja e Këshillit Antifashist të Çlirimt Kombëtar (1944). Më pas do të bëhej, në harkun e një viti, Asambleja konstituente dhe me pas Asambleja popullore (2 dhjetor 1945). Neni 43 Kusht. "Sovraniteti legjislativ ushtrohet vetëm nga Asambleja popullore.

¹⁵ Kushtetuta e aprovuar nga Asambleja popullore më datë 28 nëntor 1976, ishte e përbërë nga 112 nene. Ajo fillonte me një Preambulë të gjatë, me kontekst historik, dhe ishte kështu e ndarë: Pjesa I: Kapitulli I *Rendi social* (nenet 1-37), Kapitulli II *Të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve* (nenet 38-65); Pjesa II: Kapitulli I *Organet superiore të sovranitetit Shtetëror* (nenet 66-79), Kapitulli II *Organet supreme të administratës shtetërore* (nenet 80-86), Kapitulli III *Mbrojtja e vendit dhe forcat e armatosura* (nenet 87-91), Kapitulli IV *Organet lokal të sovranitetit dhe të administratës Shtetërore* (nenet 92-100), Kapitulli V *Gjykatat Popullore* (nenet 101-103), Kapitulli VI *Prokura* (nenet 104-106); Pjesa III: Kapitulli I *Stema, Flamuri, Kryeqyteti* (nenet 107-109), Kapitulli II *Dispozitat Përfundimtare* (nenet 110-112).

¹⁶ Çështja kryesore e kësaj situate të vështirë ekonomike, që po binte dita-ditës, përshkruhet nga neni 31 i Kusht. të vitit 1976, ku sipas të cilit vendosej se qytetarët nuk paguajnë taksa. Një pohim tipik dhe themelitar i rangut kushtetues të shteteve totalitare, që në fakt nuk linte rrugë shpëtimi, pra një perspektive për zhvillimin ekonomik, mbi të gjitha e më pas, social dhe kulturor të vendit.

¹⁷ Kushtetuta e vitit 1976 specifikon qartësisht dhe në më shumë pjesë rolin drejtues të Partisë, kurse marksizëm-leninizmi kushtetizohet si ideologjia e shtetit. E gjitha kjo konfirmon vizionin e përbashkët të sovranitetit të shtetit të diktaturës së Proletariatit: tamam kjo në fakt është përkufizimi i shtetit shqiptar që pohohet në nenin 2 të Kushtetutës.

Ri-njohja e Partisë si i vetmi instrument i sovranitetit, në fakt, kalon si një filtër i jetës sociale edhe ekonomike siç është treguar nga hyrja e saj në strukturën institucionale të vendit.

¹⁸ Friedrich C. J. e Brzezinski Z., zbulojnë ekzistencën e një ideologjie zyrtare që është "një bashkim idesh arsyetishtë bashkëkohore që kanë të bëjnë me mjetet praktike për të ndryshuar rrënjësisht dhe për të ri-ndërtuar një shoqëri me forcën ose me dhunim, të bazuar mbi një kritikë botërore ose totale të asaj që është e gabuar në shoqërinë ekzistente ose të mëparshme". Veçoritë e regjimeve totalitare: a) prezenca e një partie të vetme; b) një polici sekrete shumë të zhvilluar; c) monopolin shtetëror të mjeteve të komunikimit; ç) kontrollin e centralizuar të së gjitha organizatave politike, sociale, kulturore, deri në krijimin e një sistemi planifikimi ekonomik;

d) nën-vendosja e përgjithshme e forcave të armatosura tek pushteti politik. Kjo karakteristikë është precizuar më së miri në shprehjen maosite: "Sovraniteti del nga gryka e pushkës, por është Partia ajo që kontrollon pushkën" in Pasquino G., f. 226.

¹⁹ Për kritikën shihni edhe Anastasi A., *Historia e institucioneve*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2002 faqet 49-53.

²⁰ Krahasoni nënin 18 Kusht. Paragrafi i I-rë që pohonte: "Të gjithë qytetarëve i është garantuar liria e ndërgjegjës dhe e besimit.

Kisha është e ndarë nga Shteti.

Komunitetet fetare janë të lira në çështjet e tyre të besimit dhe në ushtrimin e praktikës së tyre të jashtme. Është e ndaluar që Kisha dhe besimi fetar të përdoren për çështje politiko-fetare.

Ndër të tjera janë të ndaluara organizatat politike me baza fetare.

Shteti nuk mund t'i ndihmojë ekonomikisht komunitetet fetare".

²¹ Krahasoni nënin 37 Kusht. paragrafi i II-të, ku, sipas të cilit: "Shteti nuk njeht asnjë besim fetar...".

²² Krahasoni nënin 55 Kusht. paragrafi i II-të, e cila pohon: "është e ndaluar krijimi i çfarëdo lloj organizate me karakter fashist, antidemokratik, fetar dhe antisocialist;

është e ndaluar aktiviteti dhe propaganda fashiste, antidemokratike, fetare ...".

²³ Disa nga Shtetet e tjera ku ka mbretëruar një diktaturë e vërtetë, me të njëjtat principe, por pa i cilësuar në Kushtetutë, kanë qënë: në Azi: Birmania 1962-1988 (Ne Win), Kamboxhia 1975-1979 (Pol Pot), Kina 1926-1949 1949-1976 (Mao Zedong) akoma ka diktaturë, Korea e Veriut 1948- akoma ka diktaturë, Indonezia 1965-1998 (Su Harto), Iran 1953-1979 (Mohammad Reza Pahlavi) 1979-1989 (Ruhollah Khomeini) akoma ka diktaturë, Irak 1973-2003 (Saddam Hussein), Laos 1975- akoma ka diktaturë, Mongoli 1924-1991, Taiwan 1949-1975 (Chiang Kai-Shek), BRSS 1917-1922 (Lenin) 1924-1953 (Stalin), Vietnam 1975- akoma ka diktaturë, Vietnam i Veriut 1945-1975, Vietnam i Jugut 1955-1975; në Evropë: Shqipëri 1946-1989 (Enver Hoxha dei në 1985), Austri 1933-1934 (Engbert Dolfuss), Bullgari 1945-1989, Çekoslovakia 1948-1989, Gjermani 1934-1945 (Adolf Hitler), Itali 1922-1945 (Benito Mussolini), Jugosllavi 1941-1945 (Ante Paveliç) 1944-1980 (Josip Broz, Tito), Poloni 1948-1989, Rumania 1944-1989, Spanjë 1939-1975 (Francisco Franco), Hungari 1946-1989; nëpër Amerikë: Guatemala 1966-1974 (Peralta Azuria e Julio Cèsar Menguez Montenegro), Nikaragua 1967-1979 (Anastasio Somoza), Haiti 1957-1971 (Francois Duvalier), Kuba 1952-1958 (Fulgencio Batista) 1959-2008 (Fidel Castro) 2011-sot (Raul Castro), Argjentina 1976-1983 (Këshilli Ushtarak), Kilei 1973-1990 (Augusto Pinochet), Paraguaj 1954-1989 (Alfredo Stroessner); në Afrikë: Etiopi 1974-1991 (Mengistu Haile Mariam), Guinea Ekuatoriale 1968-1979 (Francisco Macias Nguema), etj.

Literatura

1. Abdiu F., *P, r Kushtetut, n, ligjin dhe drejt, sin, ,* Sht, pia Botuese Arbri, Tiran, 2002.
2. Anastasi A., *E drejta kushtetuese*, Shtëpia Botuese Pegi, Tiranë 2003.
3. Anastasi A., *Historia e institucioneve*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë 2002.
4. Amedeo G., *La questione albanese*, Roma, 1925.
5. Astrit A., *Në ditët e Shtetit pa pushtet*, Tiranë, Dardania, 1998.
6. Gambino L. (a cur.), *Branì di classici del pensiero politico*, Giappichelli G. Editore, Torino, 2002.
7. Folco Biagini A., *Storia dell'Albania contemporanea*, IV^a ed., Tascabili Bompiani, Milano 2005.
8. Lepri L. (a cur.), *Albania questa sconosciuta*, Editori Riuniti, Roma 2002.
9. Lippi A. e Morisi M., *Scienza dell'amministrazione*, Il Mulino, Bologna 2005.
10. Loidice A. e Shehu N., *La costituzione albanese*, Cacucci Editore, Bari 1999.
11. Margjinaj Z., *Piccolo compendio della grande storia dell'Albania*, redatto in collaborazione con Sabattini G., Krinon, Caltanissetta 1990.
12. Marx K. e Engels F., *Manifesto del partito comunista*, (la traduzione si basa sul testo della versione originale apparso per la prima volta a Londra nel 1848).
13. Motta G. (a cur. di), *I turchi, il Mediterraneo e l'Europa*, F. Agnelli, Milano 1998.
14. Motta G., *Nell'Europa dell'età moderna: memoria collettiva e ricerca storica*, Passigli Editore, Bagno a Ripoli 2013.
15. Motta G., *Studi sull'Europa orientale: un bilancio storiografico. Una nuova generazione di storici (1970-2010)*, Passigli Editore, Bagno a Ripoli 2012.
16. Omari L. e Luarasi A., *Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri*, Shtëpia Botuese Luarasi, Tiranë 2001.
17. Omari L., *Parime dhe institucione të së drejtës publike*, botimi VI, Shtëpia Botuese Elena Gjika, Tiranë 2004.
18. Omari L., *Sistemi parlamentar*, botimi III, Shtëpia Botuese Elena Gjika, Tiranë 2004.
19. Zaganjori Xh., *Democrazia dhe Shteti i së drejtës*, Tiranë 2002.

Rëndësia e arsimimit dhe pedagogjisë në dimensionin policor dhe të sigurisë publike

Msc Anisa AGASTRA

Akademia e Sigurisë

anisa.agastra@asp.gov.al

Abstrakt

Në mbarë botën, ashtu edhe në Shqipëri, është parë e nevojshme rritja e nivelit më të lartë të kërkimit, hulumtimit shkencor dhe arsimimit në fushën e sigurisë dhe të policisë. Kjo do të ndikojë në rritjen e besueshmërisë dhe të prestigjit të shkencës së policisë në botën akademike dhe në mënyrën e ofrimit të shërbimeve. Në këtë artikull paraqitet parimisht roli thelbësor që luan edukimi, pedagogjia, arsimimi dhe procesi i mësimdhënies, si dhe domosdoshmëria e efikasiteti i tyre në institucionet akademike policore. Në Shqipëri, Akademia e Sigurisë si institucion publik i arsimit të lartë policor në kuadër të përbushjes së misionit të saj, është e interesuar në transmetimin e dijeve nëpërmjet mësimdhënies e kërkimit shkencor, në fushën e rendit dhe të sigurisë për përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera ligjzbatuese. Zhvillimi i kërkimit shkencor dhe i arsimimit në fushën e policisë, është një problematikë që shumë shtete e rajone e kanë kapërcyer në mënyra të ndryshme. Përvoja ka treguar se nuk është e thjeshtë të implementosh bazat arsimore, akademike e kërkimore në praktikën policore. Njohja me rolin e edukimit dhe arsimimit në këtë fushë, me rëndësinë e lëndëve sociale në fushën akademike policore dhe me paradigmat kryesore të policimit, ndikojnë në rritjen e nivelit të edukimit apo mënyrës së komunikimit të punonjësve të policisë, në rritjen e përmirësimin e aftësive të tyre profesionale, në rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve në vendet e punës apo në komunitet duke kontribuar në uljen e nivelit të kriminalitetit. Këto do të ndikojnë pozitivisht në funksionimin dhe efektivitetin e organizatës policore dhe të Strategjisë së Policimit në Komunitet.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit»

Fjalëkyçe:

edukim, policim, siguri, mësimdhënie, institucion akademik policor.

1. Hyrje

“Gjithcka që shoqëria ka arritur për vete, vihet në dispozicion të anëtarëve të saj të ardhshëm nëpërmjet agjencisë së shkollës”¹

Edukimi zhvillohet nga pjesëmarrja e individit në vetëdijen shoqërore të njerëzimit, që në lindje e deri në vazhdim të formimit të forcave të individit. Procesi fillon me ngarkimin e vetëdijes të individit, formimin e shprehive të tij, trajnimin e ideve dhe në nxitjen e ndjenjave dhe emocioneve. Nëpërmjet edukimit të pvetëdijshëm, individit gradualisht arrijn të marrë pjesë në burimet intelektuale dhe morale duke u bërë një trashëgimtar i fundit potencial i qytetërimit². Në fushën e sigurisë dhe policimit është e nevojshme një reformim radikal i rolit të shkencës në polici, nëse policia është e predispozuar të bëhet një arenë e politikave të bazuara në dëshmi. Avancimi i shkencës në polici është thelbësor, në qoftë se policia do të mbajë mbështetjen legjitime të publikut, përballjen me reduktimet e buxhetit apo vetë industrisë së policisë për të lehtësuar problemet që kanë të bëjnë me një pjesë të detyrës së policimit³. Edukimi është i një rëndësie parësore në kontekstin e pabarazive sociale dhe mobilitetit social si kualifikim formal (ose mungesë e tyre) dhe është bërë çështje e rëndësishme e pozicionit individual në strukturën e punësimit. Në përgjithësi, në shoqëritë e zhvilluara, sa më i lartë niveli i

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

¹ John Dewey, *Shkolla dhe shoqëria* (Tiranë: Plejad, 2003), 30.

² John Dewey, *Shkolla dhe shoqëria* (Tiranë: Plejad, 2003), 11.

³ David Weisburd dhe Peter Neyroud, *Police Science: Toward a New Paradigm* (Washington DC: National Institute of Justice, Harvard Kennedy School, 2011), 1.

Marrë nga: <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/228922.pdf>

kualifikimit të një personi, aq më i lartë niveli i të ardhurave të tij. Për realizimin e këtij artikulli janë përdorur metoda cilësore, hulumtim në literaturë vendase dhe të huaj, si dhe analizë historike-logjike e dialektike me qëllim analizimin dhe argumentimin e nevojës së arsimimit, edukimit dhe kërkimit në fushën e sigurisë dhe në fushën policore. Në Shqipëri, Akademia e Sigurisë është institucion publik i Arsimit të Lartë me liri akademike, respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në Ligjin për Policinë e Shtetit dhe atë të Arsimit të Lartë, si dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore që dalin prej tyre. Misioni kryesor i Akademisë së Sigurisë është zhvillimi dhe transmetimi i dijeve me anën e mësimdhënies e kërkimit shkencor, në fushën e rendit dhe të sigurisë për përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera ligjzbatuese⁴.

Sipas shpjegimeve të hershme sociologjike, marrëdhëniet mes performancës në edukim dhe sfondit socioekonomik, janë fokusuar jo vetëm në shkollë, por në faktorët e gjerë të shoqërisë, veçanërisht te klasa punonjëse e familjes⁵. Ndërsa ajo që kritikohet në sistemin arsimor në tërësi është shterpësia në arsim që vjen nga izolimi i pjesëve të ndryshme të sistemit shkollor, si mungesa e unitetit në qëllimet e edukimit, mungesa e koherencës në studime dhe metodat e këtij sistemi. Në përgjithësi, sipas Dewey, sistemi shkollor është i zhvilluar nga lart poshtë⁶.

Procesi edukativ ka dy anë: një psikologjike dhe një sociologjike. Ajo psikologjike është themelore. Instinktet dhe forcat e vetë fëmijës sigurojnë materialin dhe pikën e nisjen për gjithë edukimin, ku edukimi bëhet i nënshtruar prej një trysnie nga jashtë. Pa depërtimin në strukturën psikologjike dhe aktivitetin e individit, procesi edukativ do të jetë i rastit dhe arbitrar. Ndërsa përcaktimi shoqëror (sociologjik) i edukimit, si përgatitje ndaj qytetërimit, krijon prej tij një proces të diktuar dhe të sipërfaqshëm dhe përfundon me nënshtrimin e lirisë së individit në një status politik dhe shoqëror të formuar më parë. Anët psikologjike dhe shoqërore janë të lidhura organikisht dhe edukimi nuk mund të shihet si një kompromis ndërmjet të dyjave apo një mbivendosje e njërit mbi tjetrin⁷.

2. Procesi i mësimdhënies dhe roli i pedagogjisë

“Të shkolluarit duhet të konceptohet si një nga elementët e sistemeve të komunikimit masiv që u shfaqën me industrializimin”⁸

Sipas konceptit dhe skematikes së Dewey, të gjitha institucionet e edukimit luajnë rol specifik në formimin e individit. Kështu, niveli informues në kopsht lidhet me çështjet e moralitetit, në fillore me çështjet teknike të së mësuarit, në shkollën e mesme me çështjet e kulturës dhe disiplinës dhe në shkollën e lartë në çështje më të zgjeruara të kulturës dhe disiplinës⁹. Përveç rëndësisë së gjithanshme të edukimit, procesi

⁴ Akademia e Sigurisë, *Album Akademia e Sigurisë* (Tiranë: Qendra Kërkimore Shkencore, 2015), 8.

⁵ Për më tepër shih Sarah Vesecky, Sara Woodward, Amy Levine, "Foster care education fact sheets," *California Foster Youth Education Task-Force* (2005).

Marrë nga <http://www.fosteryouthhelp.ca.gov/pdfs/CAFYETFFactsheets.pdf>

⁶ Për më tepër shih Dewey, *Shkolla dhe shoqëria* (Tiranë: Plejad, 2003), 71-100.

⁷ John Dewey, *Shkolla dhe shoqëria* (Tiranë: Plejad, 2003), 13.

⁸ Anthony Giddens, *Sociologjia* (Tiranë: Cabej, 2007), 428.

⁹ John Dewey, *Shkolla dhe shoqëria*, (Tiranë: Plejad, 2003), 89.

mësimdhënës dhe pedagogjia kanë rëndësi thelbësore në formimin e shoqërisë. Mësimdhënia, përkufizohet si akti i të dhënit mësim, në një institucion arsimor dhe është veprimtaria dhe drejtimi i procesit mësimor nga mësuesi¹⁰. Mësimdhënia gjithnjë është një proces i qëllimshëm, ku duhet të realizohen objektivat e caktuar¹¹. Si çdo veprimtari e qëllimshme, mësimdhënia është një proces i planifikuar, që kushtëzon realizimin e efektshëm të këtij procesi. Ndërsa sipas Banks-it mësimdhënia është një proces aktiv, në të cilin një person e ndan informacionin me të tjerët për t'i pajisur ata me njohuri, të cilat çojnë në ndryshime të sjelljes¹².

Përsa i përket pedagogjisë, një ndër fushat e pedagogjisë është ajo kritike e cila është projekt politik, që ndriçon lidhjet midis dijes, autoritetit dhe fuqisë. Në këtë pikë tërhiqet vëmendja që të ngrihet për diskutim çështja lidhur me kushtet për prodhimin e dijes, vlerave, dhe aftësive duke ndriçuar njohurinë, identitetet dhe autoritetet që janë ndërtuar në grupe të veçanta të marrëdhënieve shoqërore¹³. Në mënyrë të ngjashme, ajo tërheq vëmendjen për faktin se pedagogjia është një përpjekje e qëllimshme për të ndikuar, se “si” dhe “çfarë” njohurish dhe subjektivitetesh janë prodhuar në grupe të veçanta të marrëdhënieve shoqërore. Ndërsa mësimdhënia është një proces ose një veprimtari ndërpersonale, ku mësuesi bashkëvepron me një ose me shumë nxënës dhe ndikon tek ata, por që nënkupton edhe ndikimin e nxënësve të mësuesi. Në kuptimin e gjerë mësimdhënia është drejtimi nga mësuesi i situatës mësimore dhe të nxënësve që përfshin¹⁴.

a) Procesin paraveprues të marrjes së vendimeve për planifikimin, skicimin dhe përgatitjen e materialeve për të mësuarit dhe të nxënësve, për diagnostikimin e nevojave të nxënësve, për krijimin e mjedisit mësimor, për shfrytëzimin e kohës mësimore;

b) Procesin bashkëveprues, bashkëpunimin e drejtpërdrejtë mësues-nxënës, përdorimin e metodave të mësimdhënies;

c) Fazën pasvepruese, që përmbledh: vlerësimin, vetëvlerësimin, ridrejtimin, riskicimin; caktimin e procedurave për të vlerësuar të nxënësve, për të vënë nota, për të vlerësuar programin mësimor, për të vlerësuar materialet mësimore

Ndër parimet kryesore të shkollës, do të renditen më poshtë ato të Frobelit, të cilat janë:

1. puna kryesore e shkollës është të edukojë;
2. rrënja kryesore e punës edukative gjendet në qëndrimet instiktive e impulsive dhe veprimtaria e reagimi, jo të shfaqja apo përdorimi i materialit të jashtëm;
3. mbajtja gjallë e frymës së bashkëpunimit.

Këto parime janë krijuar duke u bazuar në konceptet kryesore të shkollës tëvëjçare të shkollës së Çikagos¹⁵.

¹⁰ Shefqet Shyti, *Fjalor i Edukimit Qytetar* (Tiranë: Redona, 2006), 65.

¹¹ Anastasia Liasidou, “Bilingual and special educational needs in inclusive classrooms: some critical and pedagogical considerations,” *British Journal of Learning Support*, Volumi 28, Numri 1 (2013).

Marrë nga:

<http://www.crosscultured.com/documents/Teaching%20CLDE/Inclusion%20liasidou.pdf>

¹² Michael Vavrus, “Race, culture and education: The selected works of James A. Banks,” *The Journal of Negro Education* (2006).

Marrë nga: <https://www.questia.com/library/journal/1P3-1423101281/race-culture-and-education-the-selected-works-of>

¹³ Henry Giroux, “Beyond Pedagogies of Repression,” *Testing and social studies in Capitalist Schools*, Volumi 67, Numër 9 (2016).

Marrë nga: <http://monthlyreview.org/2016/03/01/beyond-pedagogies-of-repression>

¹⁴ Henry Giroux, “Beyond Pedagogies of Repression,” *Testing and social studies in Capitalist Schools*, Volumi 67, Numër 9 (2016).

Marrë nga: <http://monthlyreview.org/2016/03/01/beyond-pedagogies-of-repression>.

¹⁵ Për më tepër, shih John Dewey, *Shkolla dhe shoqëria*, (Plejad, Tirane, 2003), 122-134.

Bazuar në një shkrim analitik, dyzet e dy përqind e numrit të përgjithshëm botëror të fëmijëve që kanë mbushur moshën për shkollën fillore, nuk janë regjistruar në shkollë dhe jetojnë kryesisht në vendet e prekura nga konflikti (35 vende nga viti 1999 deri në vitin 2008, 15 prej tyre në Afrikën Sub-Sahariane). E gjithë kjo përforcon rrethin vicioz të luftës. Fëmijët që nuk kanë një arsim përballen me një të ardhme të prishur nga varfëria, e cila është një rreshter shumë bindës rekrutimi për grupet e armatosura. Niveli i ulët arsimor është një ndër faktorët e rëndësishëm statistikorë përcaktues të dhunës¹⁶.

Kjo përbën një krizë të së drejtave të njeriut që konsiderohet si fatkeqësi afatgjatë për shoqërinë njerëzore. Në fushën e sigurisë, është shumë e nevojshme që të ndërtohen institucione të forta për zhvillimin e edukimit dhe arsimimit cilësor. Përgatitja e punonjësve të fushës së sigurisë, policisë, hetimit, etj., përbën një sfidë të rëndësishme, pasi përgjegjësia për të prodhuar kapacitet eficient në këto fusha do punë, përvojë, njohuri. Sipas këtij raporti në Pakistan janë regjistruar 7.3 milion banorë në vitin 2008 dhe shpenzimet e investimet më të mëdha kanë shkuar më shumë për armë sesa për shkollë¹⁷. Nga ana tjetër sistemet arsimore janë përdorur për të nxitur urrejtjen duke kontribuar në nxitjen e konflikteve, nga Ruanda në Sri Lanka, por edhe në Guatemalë dhe Sudan. Nga ana tjetër, pedagogjia kritike, nga pikëpamja etike thekson rëndësinë e të kuptuarit se çfarë në të vërtetë ndodh në klasa dhe mjedis të tjera arsimore duke ngritur pyetje në lidhje me çfarë janë më të vlefshme njohuritë, në çfarë drejtimi duhet një dëshirë dhe çfarë do të thotë të dini diçka. Më e rëndësishmja, ajo trajton në mënyrë serioze se çfarë do të thotë të kuptosh marrëdhëniet mes “si ne mësojmë” dhe “se si kemi vepruar” si agjentë individuale dhe sociale, çka do të thotë se ajo ka të bëjë me të mësuarit e individit jo vetëm për të menduar por, edhe për të krijuar një sens të përgjegjësisë individuale dhe shoqërore në mënyrë që ata të jenë përgjegjës për veprimet, si pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për të qenë një qytetar i angazhuar në jetën publike demokratike¹⁸.

Modeli i mësimdhënies që duhet përgëzuar është ai në të cilin mësuesit janë ndërtuar si nëpunësit dhe teknikët të cilët kanë nevojë për një vizion publik, në të cilin të imagjinohet roli demokratik dhe përgjegjësia sociale që shkollat, mësuesit apo pedagogjia mund të marrin përsipër t’u ofrojnë të rinjve kudo në botë në të ardhmen e tyre. Shkolla, sipas J. Dewey, është një institucion shoqëror, që nën ndikimin e edukimit që përbën një proces shoqëror, çojnë individin drejt zhvillimit në të gjitha aspektet¹⁹. Në këtë pikë arsimimi dhe edukimi duhet të jenë gjithëpërfshirës dhe jo të shkëputen nga jeta e përditshme e individit. Dështimi i një sistemi arsimor dhe edukativ vjen nga konceptimi i shkollës si një institucion ku mund të marrësh informacion, por jo duke u bërë pjesë integrale e përvojës së individit. Kështu veçse humbet roli edukativ që ndikon rrjedhimisht në procesin e të nxënit. Në parim, mirëorganizmi i sistemeve arsimore në fushën e sigurisë, të policimit, të hetimit dhe investigimit, etj., rritja e cilësisë së programeve

¹⁶ Irina Bokova, “Education and security,” në Dawn of Pakistan, ‘Next’, Nigeria; La Croix, France; El Tiempo, Colombia; and on Lebanon’s Assafir Newspaper, (2011).

Marrë nga: http://www.unesco.org/new/en/unesco/about-us/who-we-are/director-general/singleviewdgd/news/education_and_security_dawn_pakistan_why_education_matters_for_global_security_234nextcom_nigeria/#.V-GNy_krLIU.

¹⁷ po aty.

dhe të mësimdhënies, pasurimi i programeve me lëndë, kurrikula, module të pasura e të shumëllojshme bazuar në modele të mëparshme të huaja, rritja e cilësisë së stafit pedagogjik, moslejimi i keqpërdorimit të arsimit dhe edukimit në sajë të interesave të ndryshëm, etj., janë çështje të rëndësishme për prodhimin e një niveli arsimor të kualifikuar në këto fusha dhe prodhimin e produkteve eficientë në punën e tyre. Investimi në arsim është një pjesë thelbësore e zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Krijimi i mundësive për arsimim dhe vlerësimi i domosdoshmërisë së tij ndikon në reduktimin e nivelit të konfliktit, të luftërave dhe në rritjen e civilizimit të një shoqërie. Një shoqëri e mirëedukuar dhe e mirëarsimuar është më pak e predispozuar për të gjeneruar kaos, luftë, shpërthime, krime, probleme emocionale e psikologjike, etj. Arsimimi duhet të ndikojë në ngritjen e nivelit të paqes, dhe jo në nxitjen e konflikteve. Në këtë pikë duhet pasur kujdes me mënyrën se si përdoret për të nxjerrë produktet e dëshiruara.

Faktorë të tillë si urbanizmi, kalimi në ekonominë e tregut, mjetet e lira të komunikimit dhe zhvillimi i teknologjisë dhe internetit, individualizimi i shoqërisë kanë ndikuar në ndryshim të procesit të edukimit dhe arsimimit²⁰. Nga ana tjetër niveli i ulët arsimor ndikon në rritjen e nivelit të kriminalitetit dhe devijancës në shoqëri. Mjafton të analizosh të gjithë grupet shoqërore që kryejnë akte devijante apo kriminale për ta vërtetuar këtë. Në botë dhe në vendin tonë ata që vjedhin, që kryejnë vrasje, vetëvrasje e që sillen jashtë normave, rregullave e ligjeve shoqërore janë individët me nivel të ulët arsimor, kryesisht me arsim tetëvjeçar ose të mesëm apo të paarsimuar. Niveli arsimor lidhet direkt me nivelin e kriminalitetit të një vendi dhe kjo ndikon më tej në punën e punonjësve të policisë dhe të sigurisë. Duke ndjekur këtë linjë stafi i institucioneve të policisë apo të sigurisë duhet të ketë nivel të lartë e të zhvilluar të edukimit dhe arsimimit. Në vazhdim stafi i punonjësve në këto institucione duhet të nxitet për kualifikime të vazhdueshme në mënyrë që gjithë sistemi të funksionojë mbi parime e vlera.

3. Teoritë e shkollimit

Këto teori në përgjithësi shpjegojnë rolin dhe ndikimin e shkollës, të arsimimit dhe edukimit në shoqërinë njerëzore. Ndër shkollat kryesore të shkollimit përmenden:

1. *Programi shkollor i fshehtë nga Ivan Illich*, i cili argumenton se nocioni i shkollimit të detyrueshëm, tashmë i pranuar kudo në botë, mund të vihet në dyshim. Shkollat, përveç detyrave kryesore si, realizimi i kujdesit për ruajtjen, shpërndarjen e njerëzve në veprimtaritë profesionale, mësimin e vlerave mbizotëruese dhe përvetësimin e njohurive, që shërbejnë si organizatë ruajtje, mësojnë edhe për shumë gjëra që nuk kanë të bëjnë me përmbajtjen zyrtare të mësimave. Sipas Illich shkollat priren të ngulitin konsumin pasiv – një pranim jokritik të rendit social ekzistues, ku individit mësohet të qëndrojnë në vendin e tyre, në mënyrë të qetë²¹.

2. *Arsimi dhe riplodhimi kulturor nga Bourdieu dhe Passeron*, argumenton se riplodhimi kulturor ka të bëjë me mënyrat me të cilat shkollat së bashku me institucionet

¹⁸ Henry Giroux, "Beyond Pedagogies of Repression," *Testing and social studies in Capitalist Schools*, Volumi 67, Numër 9 (2016).

Marrë nga: <http://monthlyreview.org/2016/03/01/beyond-pedagogies-of-repression>

Për më tepër shih edhe Henry Giroux, "Pedagogy of the Precariat," *Counter Punch magazine* (2015). Marrë nga: <http://www.counterpunch.org/2015/06/12/pedagogy-of-the-precariat>.

¹⁹ Për më tepër, shih John Dewey, *Shkolla dhe shoqëria* (Tiranë: Plejad, 2003), 15-18.

²⁰ Pwr më tepër shih John Dewey, *Shkolla dhe shoqëria* (Tiranë: Plejad, 2003), 30-49.

²¹ Anthony Giddens, *Sociologjia* (Tiranë: Cabej, 2007), 412-413.

e tjera sociale ndihmojnë për të përjetësuar pabarazitë sociale dhe ekonomike brez pas brezi. Ky koncept tërheq vëmendjen tek mjetet nëpërmjet të cilave, përmes programeve mësimore të fshehura, shkollat ndikojnë në përvetësimin e vlerave, të qëndrimeve dhe të zakoneve²². Ndërsa Paulo Freire thekson konceptet e pedagogjisë së shtypur, konceptit “bankar” të arsimit si një instrument i shtypjes së saj, edukimi si një proces i përbashkët në rang global, etj.²³

4. Rëndësia e arsimit dhe e lëndëve sociale në fushën e sigurisë dhe policimit

Arsimimi në formën e tij moderne filloi të zhvillohej me përhapjen e materialeve të shtypura e të shkrim këndimit. Në shekullin XX zgjerimi i arsimit ka qenë i lidhur ngushtë me kërkesat për një fuqi punëtore të arsimuar dhe të disiplinuar. Reformuesit e kanë parë arsimimin si një mjet për zvogëlimin e pabarazive por nga ana tjetër ka qenë gjithmonë rreziku i nxjerrjes në pah të pabarazive ekzistuese nën ndikimin e arsimit²⁴. Marrëdhëniet mes edukimit, klasës dhe mobilitetit social kanë qenë gjithmonë në interesin e sociologëve të edukimit. Mobiliteti social i referohet lëvizjes së njerëzve ndërmjet kategorive të klasave sociale dhe normat e mobilitetit social janë konsideruar shpesh si “indikatore” ose “matës” së shkallës së fluiditetit dhe hapjes së një shoqërie²⁵. Sociologët i shohin arritjet arsimore si një variabël ndërhyrës. Ky variabël ndërhyrës mes vendosjes së familjes në strukturën sociale (statusi i atribuar) dhe vendit që ju mundësisht zini si rezultat i vetë përpjekjeve tuaja (statusi juaj i arritur). Funkcionalistët e shohin edukimin formal si rrugën kryesore për të ngjitur shkallët e mobilitetit në shoqëritë moderne dhe për rrjedhojë si një barazues (balancues) mes pabarazive sociale të atribuara, veçanërisht për anëtarët e shtresës së ulët²⁶.

Përsa i përket arsimit në fushën e policimit dhe të sigurisë, institucioni arsimor përgjegjës është Akademia e Sigurisë. Arsimi i lartë policor në Shqipëri ka filluar që në vitin 1972, ku me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 184, datë 20.12.1971, u vendos krijimi i shkollës së Lartë trevjeçare të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe fillimi i programeve të rregullta mësimore u bënë në shtator 1972. Kjo shkollë u përfshi në sistemin e lartë arsimor policor (fillimisht jo universitar), me kohëzgjatje 2 vjet me shkëputje nga puna dhe 1 vit stazh në organet e policisë vendore. Pas përfundimit të stazhit dhe diplomimit studenti titullohej “Oficer policie”.²⁷

Që nga ai vit sistemi arsimor dhe shkolla e policisë (Akademia e Policisë) ka pësuar ndryshime të vazhdueshme deri në ditët e sotme. Në ligjin për Policinë e Shtetit, nr. 108/2014, në nenin 37, parashikohet që Policia të ketë institucionin e saj arsimor përgjegjës për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit të nivelit operues, administrativ dhe menaxherial. Në zbatim të këtij neni, me VKM nr. 185, datë 25.02.2015, u krijua Akademia e Sigurisë²⁸. Hulumtimi

²² Anthony Giddens, *Sociologjia* (Tiranë: Cabej, 2007), 413-414.

²³ Mark Patrick Hederman, Paulo Freire “*Pedagogy of the Oppressed*” (Latin America: The Crane Bag, 1982), 58-63.

Marrë nga: http://www.jstor.org/stable/30023905?seq=1#page_scan_tab_contents.

²⁴ Anthony Giddens, *Sociologjia* (Tiranë: Çabej, 2007), 427.

²⁵ Për më tepër, shih Anthony Giddens, *Sociologjia* (Tiranë: Çabej, 2007), 211-240.

²⁶ *po aty*.

²⁷ Akademia e Sigurisë, *Album Akademia e Sigurisë* (Tiranë: Qendra Kërkimore Shkencore, 2015), 4.

²⁸ Akademia e Sigurisë, *Album Akademia e Sigurisë* (Tiranë: Qendra Kërkimore Shkencore, 2015), 5.

akademik është në përgjithësi i divorcuar nga dinamika e policisë. Dinamika e policisë është që të veprojë në një realitet në të cilin vendimet duhet të bëhen shpejt dhe çështjet e financave dhe efikasitetit mund të jenë aq e rëndësishme sa dhe efektiviteti. Por edhe kërkimet e policisë akademike në përgjithësi injorojnë këto aspekte të botës së policisë duke dhënë shpesh rezultate të zgjatura në kohë, për ngjarje që kanë shumë kohë që kanë ndodhur apo duke u fokusuar në çështjet që drejtuesit e policisë kanë pak interes²⁹. Sipas Morgan dhe Neyroud ka një lidhje e fortë mes të dobësive të aplikuara në metodën shkencore në mjekësinë ligjore dhe mungesës e pranimi të shkencave sociale në polici³⁰.

5. Niveli arsimor i punonjësve të policisë që ndërveprojnë më shkollat

Paradigma e fundit që predikohet është që të ketë një nivel gjithnjë e më të lartë të kërkimit, hulumtimit shkencor dhe arsimimit të policisë dhe që universitetet policore të bëhen praktikë e fushës policore. Kjo do të ndikojë në rritjen e besueshmërisë dhe të prestigjit të shkencës së policisë në botën universitare apo akademike dhe në sigurimin e mbijetesës së saj në botën konkurruese të ofrimit të shërbimeve³¹. Në vendin tonë, në Akademinë e Sigurisë, studimet universitare organizohen në formën e studimeve me kohë të plotë, kualifikimeve për zhvillim në karrierë, specializimeve afatshkurtra dhe trajnimeve për fusha specifike. Shkollimi i punonjësve të policisë i përfshin të tre ciklet e studimit dhe lidhen me hierarkinë e gradave dhe me kohëzgjatjen në punë të çdo punonjësi. Pra nivelet e shkollimit të punonjësve të policisë lidhen drejtpërdrejt me rritjen e tyre në gradë. Për shembull, punonjësit e policisë me gradë paraprake ‘inspektor’, me eksperiencë pune deri në tre vite, kanë mundësi në bazë të procesit të konkurrimit të regjistruhen dhe të hyjnë në ciklin e studimeve “Bachelor”, që zgjat tre vite. Ata në fund të periudhës tre-vjeçare, përfundojnë ciklin “Bachelor” dhe marrin gradën nënkomisar. E njëjta linjë, por me specifika të ndryshme ndiqet edhe për gradat e tjera³².

Arsimimi i punonjësve të policisë është i rëndësishëm pasi rrit nivelin e “background”-it të tyre, rrit aftësitë e tyre komunikuese, zgjeron vazhdimisht aftësitë e tyre profesionale, ndihmon në brendësimin e vlerave të ndryshme që ndihmojnë punonjësin e policisë në bashkëpunimin me qytetarin dhe komunitetin, etj. Dr. Piro Lazi, në një shkrim të disa viteve më parë, është shprehur se të realizosh një “policim të mirë”, është i nevojshëm edukimi dhe arsimimi i punonjësve të policisë. Por, veçoritë e së kaluarës sonë të largët dhe të afërt, na bëjnë të supozojmë se do vazhdojë të ndihet për një kohë të gjatë mentaliteti sipas të cilit, shumë nga shqetësimet morale të punës policore nuk kanë pse bëhen objekt analizash etike. Por nga ana tjetër, sipas tij është bërë e qartë se nuk mund të realizohet një policim i suksesshëm dhe njëkohësisht i qartë për publikun, në qoftë se

²⁹ David Weisburd dhe Peter Neyroud, *Police Science: Toward a New Paradigm* (Washington DC: National Institute of Justice, Harvard Kennedy School, 2011), 5-6.

Marrë nga: <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/228922.pdf>

³⁰ David Weisburd dhe Peter Neyroud, *Police Science: Toward a New Paradigm* (Washington DC: National Institute of Justice, Harvard Kennedy School, 2011), 4.

Marrë nga: <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/228922.pdf>

³¹ David Weisburd dhe Peter Neyroud, *Police Science: Toward a New Paradigm* (Washington DC: National Institute of Justice, Harvard Kennedy School, 2011), 2.

Marrë nga: <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/228922.pdf>

³² Për më tepër, shih Akademia e Sigurisë, *Album Akademia e Sigurisë* (Tiranë: Qendra Kërkimore Shkencore, 2015), 12-62.

tentohet thjesht e vetëm nëpërmjet rrugës intuitive³³.

6. Paradigmat e policimit

Në mjaft vende jashtë vendit i kushtohet shumë rëndësi kualifikimit të posaçëm të punonjësve të policisë të cilët janë në ndërveprim me shkollat tetë ose nëntëvjeçare, të mesme apo të larta. Në një studim theksohet se punonjësit e policisë në shkolla përfaqësojnë një lloj të ri të “shërbëtorit publik”, duke luajtur rolin e korrektuesit, zbatuesit të ligjit dhe modeluesit ndërsa njëkohësisht mbikëqyrin grupe pjesërisht të institucionalizuar dhe të padisiplinuar, me më pak të drejta se sa popullata e përgjithshme që kanë nevojë për mbrojtje ligjore më të madhe sesa të rriturit. Prandaj është e domosdoshme që studiuesit të zhvillojnë një kuptim adekuat të rolit të shkollave të policisë dhe impaktin e oficerëve në shkolla, komunitete dhe në shoqëri në tërësi³⁴. Sipas një analize të thellë të raportit të sistemit policor me atë akademik, kërkimor e shkencor, u përpunuan dy paradigma për policimin.

6.1 Paradigmat e vjetra të policimit³⁵

Edukim dhe trajnim – Është e bazuar në njohuritë e marra dhe puna në bazë të njohurive.

Lidership – Liderat e shohin shkencën të dobishme vetëm kur kjo mbështet iniciativën dhe nuk e mbështet kur nuk shihet si e leverdisshme.

Raporti akademik i policisë – struktura të ndara dhe të dallueshme institucionale dhe profesionale.

Zhvillimi i praktikës – Praktika zhvillohet nga iniciativa individuale dhe mandatet politike.

Investimi në kërkime – Një angazhim i kufizuar kombëtar dhe lokal ose individual, për vlerësimin e iniciativave specifike.

6.2 Paradigma e re – Policimi i bazuar në zhvillimin e shkencës³⁶

Edukim dhe trajnim – E themeluar në shkencë, që lidh njohuritë shkencore me praktikën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional.

Lidership – Udhëheqësit vlerësojnë edhe vlerën e shkencës duke e parë atë si një pjesë e rëndësishme të tyre, edhe vlerën e stafit dhe të agjencive të tyre në kuadër të zhvillimit të efikasitetit, efektivitetit dhe legjitimitetit me publikun.

Raporti akademik i policisë – Shkolla universitare e policisë (Akademia e Policisë) ka të kombinuarra mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, me lidhje të forta institucionale dhe shkëmbim personeli me agjencitë policore lokale.

Zhvillimi i praktikës – Praktikantët dhe agjencitë janë të angazhuar për kërkimin

³³ Akademia e Policisë “Arben Zylyftari, “Kriminaliteti, rendi dhe policimi,” në *Etika e policimit profesional dhe sfidat e së ardhmes*, aut. Piro Lazi. (Tiranë: Qendra e studimeve&kualifikimeve, 2001), 86.

³⁴ Ben Brown, “Understanding and assessing school police officers: a conceptual and methodological comment,” *Journal of criminal justice* (2006).

Marrë nga: <http://youthjusticenc.org/download/education-justice/school-policing-security...%20Comment.pdf>

³⁵ David Weisburd dhe Peter Neyroud, *Police Science: Toward a New Paradigm* (Washington DC: National Institute of Justice, Harvard Kennedy School, 2011), 16.

Marrë nga: <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/228922.pdf>

³⁶ David Weisburd dhe Peter Neyroud, *Police Science: Toward a New Paradigm* (Washington DC: National Institute of Justice, Harvard Kennedy School, 2011), 16.

Marrë nga: <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/228922.pdf>

dhe vlerësimin e praktikave të vazhdueshme dhe sistematike.

Investimi në kërkime - Një përqindje e përkushtuar e shpenzimeve të policisë përkushtuar për hulumtimin, vlerësimin dhe zhvillimin e shkencës dhe të kërkimit bazë e cila është e përshtatur në kuadër të një strategjie kombëtare (dhe ndoshta ndërkombëtare) për të ndërtuar bazën e njohurive mbi afatmesme dhe afatgjatë. Studiuesit duhet të argumentojnë dhe të përdorin metodologjitë e përshtatshme ku të përfshihen një shumëllojshmëri strategjish dhe një numër të konsiderueshëm të efekteve potencialisht pozitive dhe negative të punonjësit të policisë në shkolla, në komunitete dhe në shoqëri. Me anë të hulumtimit të cilësisë, dijetarët e ardhshëm do të jenë në gjendje për të konceptuar më mirë dhe të vlerësuar nivelin arsimor të policisë nëpërmjet dialogimeve dhe bashkëpunimeve me kërkuesit, arsimtarët, oficerët e policisë, zyrtarët e lartë dhe politikëbërësit. Vetëm në këtë mënyrë, do të identifikoheshin detyrat që duhet të kryente një punonjës policie në shkolla, mënyrën e duhur e të sjellit e të komunikuarit, arsimimin dhe trajnimet e përshtatshme, etj., të cilat do ta ndihmonin në kryerjen e detyrave të tij rutinë³⁷.

Thelbi i edukimit dhe arsimimit cilësor është integrimi i njohurive të marra nga shkencat ekzakte apo shoqërore me veprimtarinë dhe marrëdhëniet njerëzore. Kjo është e domosdoshme në të gjitha stadet dhe llojet e arsimit, duke përfshirë dhe atë në fushën e policimit dhe sigurisë. Edukimi luan rol të rëndësishëm në promovimin e sigurisë kombëtare, që tregon një korrelacion pozitiv ndërmjet arsimit dhe sigurisë kombëtare. Arsimimi është konceptuar të jetë një proces i të mësuarit gjatë gjithë jetës që fillon me lindjen dhe vdekjen e një personi. Investimet e mëdha në arsim në të mirë të popullatës janë të vlefshme sepse ndihmojnë në stabilizimin e kombit duke promovuar sigurinë kombëtare³⁸. Arsimi promovon sigurinë kombëtare me anë të ngulitjes së tipareve të dëshirueshme të njeriut si ndershmëria, sinqeriteti, vështirësia e punës, saktësia, produktiviteti, risia, patriotizmi, vetëmohimi, vëllazëria, miqësia, etj. Ato që kanë rëndësi për t'u promovuar janë siguria, çështja e pasigurisë dhe strategjitë për promovimin e sigurisë kombëtare përmes edukimit. Siguria kombëtare mbulon çështje socio-ekonomike, politike, ushtarake, kulturore, familjare, industriale, diplomatike, artistike, etj.

7. Praktika e Strategjisë së policimit në komunitet në Shqipëri

Me ringritjen dhe riorganizimin e strukturave të policisë pas vitit 1997, u krijuan kushtet për fillimin e një procesi të ri reformash organizative nëpërmjet hartimit për herë të parë të një dokumenti strategjik për policinë (2000-2003). Përveç krijimit të infrastrukturës strukturore, ligjore dhe përmirësimit të efikasitetit të strukturave, arritja kryesore e reformës ishte shndërrimi i policisë, nga një strukturë ushtarake, në një

³⁷ Ben Brown, "Understanding and assessing school police officers: a conceptual and methodological comment," *Journal of criminal justice* (2006).

Marrë nga: <http://youthjusticenc.org/download/education-justice/school-policing-security/....Methodological%20Comment.pdf>

³⁸ Sadiq Isah Radda, "The role of education in promoting national security by professor," *Departamenti i Sociologjisë, Universiteti Bayerno*.

Marrë nga:

http://www.academia.edu/7554217/THE_ROLE_OF_EDUCATION_IN_PROMOTING_NATIONAL_SECURITY_BY_PROFESSOR.

institucion të administratës shtetërore në shërbim të komunitetit. Krijimi i strukturave të policimit në komunitet në të dy nivelet shënoi përafrim me policimin perëndimor, që filloi të ndikojë në parandalimin e krimit në komunitet. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit në vitin 2006, Policia e Shtetit si pjesë e detyrimeve të kësaj marrëveshjeje, iu nënshtrua procesit të ndryshimeve të thella organizative, strukturore, ligjore dhe teknologjike nëpërmjet implementimit të Strategjisë së Policisë së Shtetit për vitet 2007-2013. Një nga prioritet kryesorë të kësaj strategjie ishte përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe ndërtimi i besimit në publik, nëpërmjet zbatimit të filozofisë e stileve të menaxhimit të Policimit në Komunitet. Kjo kërkon fokusimin e policisë tek qytetarët, promovon zgjidhjen e problemeve në mënyre proaktive, ofrimin e ndihmës në rastet emergjente, trajtimin e viktimave të krimit sipas standardeve ligjore dhe forcimin e partneritetit të ndërsjellë me komunitetin³⁹.

Baza e strategjisë së policimit në komunitet është ndërveprimi i punonjësve të policisë me komunitetin dhe krijimi i një linje besimi mes palëve. Një ndër faktorët ndikues dhe më të rëndësishëm është niveli i edukimit dhe arsimimit të punonjësve të policisë. Të qenit interaktiv me qytetarët do të thotë të paturit një komunikim sa më efektiv me ta. Për të qenë të komunikueshëm, të kuptueshëm, të aftë profesionalisht etj., është e nevojshme për punonjësit e policisë që të kenë shkollim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të pasur me module e kurrikula të fushave të ndryshme si ato juridike, sociale, ekonomike, etj. Puna e një punonjësi të policisë lidhet me të gjitha fushat e dimensionet, sepse lidhet ngushtë me qytetarin dhe zgjidhjen e problemeve të tij. Për këtë arsye formimi i tij në shkollë duhet të jetë i gjithanshëm. Vetëm në këtë mënyrë mund të përgatiten punonjës policie të aftë për t'u përballur me qytetarin. Për këtë arsye arsimimi në fushën e policimit është shumë i rëndësishëm. Mirëarsimimi i punonjësve në polici e në fushën e sigurisë sikundër dhe mirëarsimimi i gjithë shoqërisë, do të prodhonte produkte shoqërore më të civilizuar, duke mposhtur kaosin dhe duke ndikuar në uljen e nivelit të devijancave e kriminalitetit.

8. Përfundime

Niveli i lartë akademik e kërkimor në fushën e sigurisë dhe të policimit është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për efektivitetin në punë, në shërbime dhe në rritjen e besueshmërisë dhe të prestigjit të shkencës së policisë në botën akademike. Këto do të ndikojnë në përmirësimin e nivelit të profesionalizmit, edukimit, qytetarisë, komunikimit, civilizimit të punonjësit të policisë në raport me kolegët, eprorët, komunitetin e më gjerë. Kjo do të do ndikonte në rritjen e kapacitetit akademik policor, në uljen e nivelit të kriminalitetit, në rritjen e civilizimit në radhët e policisë dhe të shoqërisë dhe në funksionimin sa më të mirë të organizatës policore dhe strategjisë së policimit në komunitet në vendin tonë.

³⁹ SACP, Mbështetja suedeze për MB/PSH për policimin në komunitet dhe Instituti për Ndryshim dhe Lidhshmëri në Shqipëri, *Policia, rendi, siguria dhe marrëdhëniet me komunitetin* (Tiranë: prill 2014), 9.

Referenca

1. Dewey, John. *Shkolla dhe shoqëria*. Plejad: Tiranë, 2003.
2. Giddens, Anthony. *Sociologjia*. Tiranë: Çabej, 2007.
3. Shyti, Shefqet. *Fjalor i Edukimit Qytetar*. Tiranë: Redona, 2006.
4. Weisburd, David dhe Peter Neyroud. *Police Science: Toward a New Paradigm*. Washington DC: National Institute of Justice, Harvard Kennedy School, 2011. <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/228922.pdf>
5. Akademia e Sigurisë. *Album Akademia e Sigurisë*. Tiranë: Qendra Kërkimore Shkencore, 2015.
6. Akademia e Policisë "Arben Zylyftari". "Kriminaliteti, rendi dhe policimi." Në *Etika e policimit profesional dhe sfidat e së ardhmes*, aut. Piro Lazi. Tiranë: Qendra e studimeve&kualifikimeve, 2001.
7. SACP, Mbështetja suedeze për MB/PSH për policimin në komunitet dhe Instituti për Ndryshim dhe Lidhshëm në Shqipëri. *Policia, rendi, siguria dhe marrëdhëniet me komunitetin*. Tiranë: prill 2014.
8. Vesecky, Sarah, Sara Woodward dhe Amy Levine. "Foster care education fact sheets," *California Foster Youth Education Task-Force* (2005). <http://www.fosteryouthhelp.ca.gov/pdfs/CAFYETFactsheets.pdf>
9. Liasidou, Anastasia. "Bilingual and special educational needs in inclusive classrooms: some critical and pedagogical considerations." *British Journal of Learning Support, Volumi 28, Numri 1* (2013). <http://www.crosscultured.com/documents/Teaching%20CLDE/Inclusion%20Liasidou.pdf>
10. Vavrus, Michael. "Race, culture and education: The selected works of James A. Banks." *The Journal of Negro Education* (2006). <https://www.questia.com/library/journal/1P3-1423101281/race-culture-and-education-the-selected-works-of>
11. Giroux, Henry. "Beyond Pedagogies of Repression." *Testing and social studies in Capitalist Schools, Volumi 67, Numër 9* (2016). <http://monthlyreview.org/2016/03/01/beyond-pedagogies-of-repression>.
12. Bokova, Irina. "Education and security." Në Dawn of Pakistan, 'Next', Nigeria; La Croix, France; El Tiempo, Colombia; and on Lebanon's Assafir Newspaper, (2011). http://www.unesco.org/new/en/unesco/about-us/who-we-are/director...ecurity_234nextcom_nigeria/#.V-GNy_krLIU
13. Giroux, Henry. "Pedagogy of the Precariat." *Counter Punch magazine* (2015). <http://www.counterpunch.org/2015/06/12/pedagogy-of-the-precariat>
14. Hederman, Patrick Mark. *Paolo Freire "Pedagogy of the Oppressed"*. Latin America: The Crane Bag (1982). http://www.jstor.org/stable/30023905?seq=1#page_scan_tab_contents
15. Brown, Ben. "Understanding and assessing school police officers: a conceptual and methodological comment." *Journal of criminal justice* (2006). <http://youthjusticenc.org/download/education-justice/school-policing-security/....pdf>
17. Radda, Isah Sadiq. "The role of education in promoting national security by professor." *Departamenti i Sociologjisë, Universiteti Bayerno*. http://www.academia.edu/7554217/THE_ROLE_OF_EDUCATION_IN_PROMOTING_NATIONAL_SECURITY_BY_PROFESSOR

Analizimi i veprës penale së “përndjekjes”

Sanksionimi dhe evoluimi i ligjeve

të kësaj vepre penale, me zhvillimin e shoqërisë

Msc Elerta SHANAJ

Ministria e Punëve të Brendshme
elertashanaj1@gmail.com

Abstrakt

Ky punim synon të trajtojë një vepër penale, që sidomos kohëve të fundit po merr përmasa të konsiderueshme e po bëhet gjithnjë e më shqetësuese. Përndjekja është akti i ndjekjes me dashje dhe të vazhdueshme ose ngacmimi i një personi tjetër në rrethana të tilla që mund t'i shkaktojë personit frikë ose kërcënime të vazhdueshme për dëmtimin e shëndetit ose jetës së viktimës. Përndjekja si vepër penale cenon të drejtën për jetë një private dhe shpesh shkel mbi parimet themelore të së drejtave të njeriut, siç janë dinjiteti, integriteti. Qëllimi i studimit është evidentimi i mekanizmave ligjor dhe institucional ekzistues për veprën penale të “përndjekjes” dhe analizimi i tyre në kuadrin lokal e në aspektin ndërkombëtar. Përmes metodave efikase dhe cilësore si metodat analizuese, krahasuese, përshkruese synohet të arrihet në një analizë të thelluar të trajtimit të kësaj vepre penale dhe sanksionimit të bërë në Kodin Penal Shqiptar, gjithashtu krahasuar edhe me interpretimin e “Përndjekjes” sipas legjislacioneve dhe kodeve penale europiane. Nëpërmjet analizës së përndjekësit dhe sjelljes së viktimave kuptojmë se ka disa lloje marrëdhëniesh përndjekës-viktimë. Por viktimat kryesore, që janë pre e kësaj vepre penale janë kryesisht femrat. Tema është trajtuar si në kuadrin ligjor ashtu edhe në atë institucional, me qëllim mundësinë e përafrimit të legjislacionit të brendshëm më të drejtën ndërkombëtare. Ky është një hap i rëndësishëm për të ndihmuar në parandalimin e viktimave të përndjekjes dhe procesin e riintegritit të tyre në shoqëri, rikthimit të privatësisë, dinjitetit. Në fund të punimit tim, arrij në konkluzione konkrete mbi motivet që shtyjnë në konsumimin e veprës penale të përndjekjes, mbrojtjen e viktimave dhe sanksionimin e saj, si një nga reformat që vijnë në ndihmë të shoqërisë.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit»

Fjalëkyçe:

përndjekja, mekanizmi ligjor, Kodi Penal, marrëdhënia përndjekës-viktimë

1. Hyrje

Përndjekja ka qenë dhe vazhdon të jetë një fenomen që e ka shoqëruar njerëzimin për një kohë të gjatë. Me zhvillimin e shoqërisë dhe format e përndjekjes janë zhvilluar dhe përsosur. Me zhvillimin e teknologjisë përndjekja ka marrë një përhapje më të madhe me përndjekjen kibernetike. Përndjekja në kuptimin e saj juridik është ngacmimi i vazhdueshëm dhe i përsëritur ndaj një personi me qëllim që të shkaktojë gjendje ankthi dhe frike. Në këtë temë është trajtuar sanksionimi dhe evoluimi i ligjeve mbi veprën penale të përndjekjes. Zhvillimet e saj me zhvillimin e shoqërisë. Lidhja e ngushtë e kësaj vepre penale me parimet themelore të njeriut si dinjiteti dhe drejta për një jetë private. Synimi i punimit të kësaj teme ishte analiza juridiko-penale e veprës penale të përndjekjes e sipas sanksionimit të bërë në legjislacionin e vendit tonë. Gjithashtu dhe një vështrim krahasues juridiko-penal me kodet penale të disa vendeve evropiane për të vënë në dukje mangësitë e legjislacionit tonë dhe plotësimin e tyre për ta bërë sa më efektiv zbatimin e kësaj vepre penale. Një psikolog amerikan J. Reid Meloy e përkufizon përndjekjen sipas përndjekësit: “Nëse mund ta shoh atë në privatësi, mbase unë mund ta njoh atë më shumë, mund të jem me të në fantazinë e saj, dhe mbase mund të jem më shumë si ajo. Ajo mund të më njohë mua.”

1. Përkufizim i konceptit të përndjekjes dhe rëndësia e mbrojtjes juridiko-penale e të drejtës për jetën private

1.1 Përkufizime të përndjekjes dhe vështrim i përgjithshëm mbi zhvillimin e saj
Përndjekja është të ndjekësh ose të ngacmosh dikë me mënyrë të tepruar dhe të

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit »

padëshiruar nga viktimat.¹ Përndjekja konsiderohet si krim i fuqisë dhe pushtetit të një personi ndaj një personi tjetër. Për herë të parë kjo vepër penale pati përhapjen në një koncert kur aktorja e famshme Rebeca Shafer e cila jetonte në Kaliforni u qëllua për vdekje nga një fans i fiksuar pas saj, I cili e përndiqte atë prej dy vjetësh². Ky rast tërhoqi vëmendjen e gjerë të medieeve dhe zbuloi se sa e përhapur ishte përndjekja si për njerëzit e famshëm ashtu edhe për njerëzit jo të famshëm. Në këtë kohë u hodhën themelet për hartimin e ligjit të parë kundër përndjekjes në Kaliforni në 1990. Ky ligj i sapokrijuar kishte shumë mangësi. Policia kishte një pushtet të kufizuar për të arrestuar dikë që sillej në mënyrë kërcënuese. As në rastet kur i dyshuari dërgonte mesazhe me urrejtje ose kërcënues ose kryente sjellje në mënyrë kërcënuese, policia nuk ishte e legjitimuar për ti dënuar ato. Ligji parashikonte se nuk mund të ndërmerreshin veprime derisa i dyshuari të vepronte me kërcënimet e tij duke sulmuar ose dëmtuar viktimën. Pas hartimit të këtij ligji u miratuan në shumë shtete të tjera të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e më pas me kalimin e viteve, në Evropë më shumë pas viteve 2000.

Përndjekja në kohët e sotme është përkufizuar si “ sjellje e drejtuar ndaj një personi të caktuar, që përfshin një afrim fizik ose mendor të vazhdueshëm, pra një komunikim jokonsensual, verbal, kërcënime të shkruara ose të nënkuptuara, që mund të shkaktojnë një gjendje ankthi dhe frike të arsyeshme “. Përndjekja është akti i ndjekjes me dashje dhe të vazhdueshme ose ngacmimi i një personi tjetër në rrethana të tilla, që mund ti shkaktojë personit frikë ose kërcënime të vazhdueshme për dëmtimin e shëndetit ose jetës së viktimës. Ajo është konsideruar zakonisht e rënduar kur rrethanat përfshijnë gjithashtu shkeljen e urdhrin frenues për mbrojtjen e viktimës.³

Në fjalorin Merriam Webster përcaktohet si përndjekës edhe një person që ndjek një person tjetër “në mënyrë fiksuese dhe me qëllim ngacmimi”. Me fjalë të tjera është një etiketim që i është dhënë një individi që ka një fiksion joreal ndaj një personi tjetër. Kjo përndjekje ka një qëllim negativ për të ngacmuar personin tjetër psikologjikisht ose fizikisht.

1.2 Llojet e përndjekjes dhe të përndjekësve

Përndjekësit e realizojnë këtë vepër penale nga ana objektive nëpërmjet veprimeve të ndryshme. Sipas këtyre veprimeve përndjekjen mund ta klasifikojmë në disa lloje. Përndjekja reale është njëra prej tyre, e cila i bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme viktimës për ta frikësuar atë duke pasur kontakte fizike me të si:

- ndjekja e vazhdueshme e personit kudo që ai shkon;
- shfaqja e papritur në ambientet e punës ose në ambiente ku viktimat ka vendbanimin ose vendqëndrimin;
- kryerja e veprimeve kërcënuese si: telefonata kërcënuese, mesazhe, letra, dërgimi i buqetave me lule të zeza, fotografi të subjektit ose imazhe të tjera kërcënuese;
- kërcënimet i jetës së personit ose personave të afërt të tij me të cilët viktimat ka lidhje familjare, shoqërore;

Për ta ilustruar këtë lloj përndjekjeje mund të japim një rast nga praktika:⁴

Një djalë i quajtur Fran, përndiqte për një kohë të gjatë Dr. Oriona. Fillimisht ajo

¹ Fjalori Oxford, 2002.

² Legal dictionary, “The free dictionary”, <http://www.legal-dictionary.thefreedictionary.com>

³ Për më shumë informacion shikoni: Fjalorin e ligjeve Merriam-Webster ©2001

Merriam-Webster themeluar e publikuar nën licencën e Merriam-Webster, e themeluar, <http://www.m-w.com>.

⁴ Orion, Doreen. *Unë e di që ti më do më të vërtetë: analiza psikiatrike e përndjekjes dhe e dashurisë së fiksuar* (eng.), New York: Dell, 1997.

nuk e kishte vënë re sjelljen e tij, por pas shqetësimeve të vazhdueshme nga ana e Franit ajo nuk dinte më si të sille ndaj tij. Ai merrte çdo gjë si një shenjë për t'iu qëndruar pranë. Oriona nuk i përgjigjej veprimeve të tij me shpresën për të dekurajuar atë dhe për ta larguar. Frani i dërgoi një buqetë të madhe me lule për Shën Valentin. Pas një viti përndjekje, mesazhet filluan të bëheshin edhe më kërcënuese. Njëherë i dërgoi një pikturë të një gruaje të keqtrajtuar me fytyrën e saj. Pas këtyre veprimeve të vazhdueshme ngacmimi dhe kërcënimi, Oriona e denoncoi Franin, i cili u dënua për veprën penale të përndjekjes. Këta janë personat që besojnë se viktimat e tyre kanë gabuar me ta në disa mënyra. Ato e shohin veten si viktimat ndaj personave që ndjekin. Ata ushqejnë zemërim dhe armiqësi dhe ndjehen të përlulur dhe të trajtuar padrejtësisht prej tyre. Ky tip i përndjekësëve ka një nevojë për tu ndjerë i fuqishëm dhe për të pasur një kontroll ndaj viktimave të tyre. Një klasifikim i bërë nga autorja Linden Gross e cila përfshinte disa lloje përndjekësish. Këtë klasifikim e bëri në bazë të kriterit të raportit të përndjekësit me viktimën.⁵

1.2.1 Përndjekësi i panjohur

Në rastet kur viktimat ndiqet nga një person i njohur gjendja e frikës e shoqëron vazhdimisht, por kur është një person i panjohur frika që shkaktohet është më e madhe sepse viktimat nuk ka dijeni se ndaj cilit person duhet të ketë kujdes. Ky rast i përndjekjes sipas ekspertëve cilësohet si rasti më i rrezikshmi. Në pjesën më të madhe të rasteve përndjekësit e panjohur vuajnë nga erotomania⁶; një çrregullim mendor që bën përndjekësin të besojë se personi tjetër është i dashuruar me të. Viktimat e kësaj përndjekjeje bëhen më pak të shoqërueshëm dhe mbyllen në vetvete.

1.2.2 Përndjekësi iluzionar

Këto lloje përndjekësish mund të vuajnë nga sëmundje të tilla si skizofrenia, erotomania ose mund të jenë maniak. Në rastin e erotomanisë, përndjekësi iluzionar mendon se viktimat e dashuron atë si për shembull rasti i Madonës kur përndiqej nga një fans⁷. Përndjekësit iluzionar vijnë nga një e shkuar pa emocione dhe ndjenja, apo nga abuzime të rënda. Ato rriten me idenë se kanë një personalitet shumë të varfër. Ato preferojnë personat të cilët janë të shoqërueshëm ose që kanë një status të lartë në shoqëri.

1.2.3 Përndjekësi serial

Përndjekësit serial nuk kanë pasur një lidhje intime me viktimën para fillimit të përndjekjes, ato mund të përndjekin më shumë se një person të së njëjtës familje në të njëjtën kohë. Ato ndjekin një sjellje të njëjtë që e kryejnë prej vitesh.

1.2.4 Përndjekësi virtual

Lloji tjetër i përndjekjes është virtuale ose e njohur ndryshe, “cyberstalking” (përndjekja kibernetike). Përndjekja kibernetike është përdorimi i kompjuterëve ose i mjeteve të tjera teknologjike, që ndihmojnë në kryerjen e përndjekjes. Përndjekësi kibernetik nuk ka kontakte fizike me viktimën. Kjo përndjekje mund të kryhet në

⁵ “End Stalking In America / Forms of Stalking”. Gjetet online në: <http://www.esia.net>.

⁶ Meloy, J. Reid, *Sulmet e dhunshme*, 1992.

⁷ Rhonda J.D., Saunders, “The Madonna Stalking Case”, publikuar në 20 gusht 2005. Gjetet online në: <http://www.stalkingalert.com/articlesofinterest.htm>.

mënyrë elektronike nëpërmjet telefonit, GPS, kamerave, përgjimit të kompjuterëve, ose internetit. Kjo formë e përndjekjes në ditët e sotme më zhvillimin që ka marrë teknologjia dhe interneti është përhapur në përmasa të mëdha. Një rast nga praktika për këtë lloj përndjekje është marrë nga një përndjekje kibernetike që ka ndodhur në New Hampshire⁸. Në vitin 1999 një çështje në New Hampshire, pas marrjes së të dhënave personale të viktimës nga një ndërmjetës informacioni, përndjekësi hapi një faqe në internet ku publikoi se do ta përndiqte dhe do ta vriste viktimën e tij, të cilën ai e qëllloi për vdekje disa muaj më vonë. Gjykata vendosi se për shkak të rrezikut të përndjekjes dhe vjedhjes së identitetit, agjentët e informacionit do të mbajnë përgjegjësi për dhënien një informacioni të tillë personal. Përndjekësit mund të klasifikohen në lloje nga më të ndryshmet për nga mënyra se si sillen me viktimën, por ato kanë një pikë të përbashkët qëllimin për ta ngacmuar dhe për ti shkaktuar gjendje ankthi dhe frike viktimës. Gjithashtu një pikë tjetër lidhëse midis përndjekësve të ndryshëm sipas studimeve të fundit është se përndjekësi gjatë kryerjes së veprimeve të tij kalon në tre faza⁹:

a. Faza e tensionit

Në këtë fazë përndjekësi bën telefonata të shumta, dërgon letra, shfaqet në çdo vend që viktimë është, e ndjek viktimën kudo që shkon, shfaqet në çdo vend që është viktimë dhe bën survejimin e saj. Në këtë fazë kur nuk plotësohen synimet e viktimës, tensioni rritet dhe përndjekësi fillon të bëjë kërcënime, veprime vandale, dhe këmbëngul më shumë për të arritur qëllimet e tij me viktimën.

b. Faza e përdorimit të dhunës

Kur përndjekësit i dështojnë përpjekjet e bëra në fazën e parë, ai përdor forcën jo vetëm ndaj viktimës por edhe ndaj të afërmeve, familjarëve dhe miqve. Kjo përfshin kontaktet fizike midis viktimës dhe përndjekësit, fyerjet, rrëmbimin në raste ekstreme mund të shkojë deri në vrasje.

c. Faza e dashurisë

Në këtë fazë përndjekësi pakëson përdorimin e dhunës dhe shpesh kërkon falje viktimës për përdorimin e dhunës dhe për përndjekjen e vazhdueshme. Kjo periudhë zgjat për një kohë mjaft të shkurtër. Kjo fazë është faza më e rrezikshme pasi viktimë mendon se përndjekja ka marrë fund dhe si pasojë e le mënjanë mbrojtjen. Ato mund të gjenden të papërgatitur përballë përsëritjes së përndjekjes, e cila në pjesën më të madhe të rasteve është e dhunshme. Një element mjaft i rëndësishëm që viktimë duhet të ketë parasysh është fakti se këto faza nuk janë absolute përndjekësi mund të ndryshojnë duke shfaqur sjellje të dhunshme e më pas shfaq dashurinë brenda pak sekondash.

1.3 Sjelljet e viktimave

Sipas studimeve të bëra rezulton se mbi dyqind mijë raste të përndjekjes ndodhin çdo vit. Pjesa më e madhe e viktimave rezulton se janë vajza. Një në nëntë, prej numrit të përgjithshëm të viktimave, janë vajza dhe një në njëzet rezultojnë djem, kjo për arsye se djemtë janë më të prirë për të qenë autorë sesa viktimë. Ashtu si dhe përndjekësit edhe viktimat kanë një cikël të caktuar sjelljesh të cilën studiuesit e kane ndarë në shtatë faza nëpër të cilat viktimë kalon:¹⁰

⁸ Gjykata administrative Remsburg. "Çështja Amy kundër Docusearch Nr.17", 2003. Citron, Danielle Keats (2009). "Law's Expressive Value in Combating Cyber Gender Harassment". *Michigan Law Review* 108: 373. Mullen, Paul. "Tipet e përndjekësve", *Gazeta amerikane e psikiatrisë*, 1999.

⁹ "End Stalking In America/Forms of stalking". Gjendet online në: <http://www.esia.net>.

¹⁰ Gross, Linden. *Për të pasur ose për të dëmtuar*, 1994.

- Faza e parë është mohimi. Në këtë fazë viktimja mendon se kjo është diçka kalimtare dhe do të mbarojë shumë shpejt. Nuk e pranon ose nuk e beson që dikush po e përndjek dhe fillon të dyshojë në realitetin dhe në veten e saj/tij.
- Faza e dytë është faza e bisedimeve. Viktimja mendon se duke biseduar me përndjeksin ai mund ta kuptojë ose të mërzitet dhe do të heqë dorë. Por në realitet kërkesat e përndjekësit rriten dhe ai mendon se viktimja do të përgjigjet në të njëjtën mënyrë.
- Faza e tretë është faza kur viktimja fillon ta besojë dhe fillon të shqetësohet. Kjo fazë është faza e ankthit. Përndjekësi shfaqet kudo në çdo vend në mënyrë të papritur viktimja nuk mund ta kontrollojë më atë dhe gjendja e ankthit shtohet gjithnjë e më shumë.
- Faza e katërt është faza kur viktimja është lodhur nga përndjekja, pra i kane shtuar të gjithë burimet. Kjo fazë karakterizohet nga gjendja e depresionit, nga ankthet që shoqërojnë vazhdimisht viktimën, nga çrregullimet në fjetje, në ushqim, dhe mendimi se në çdo moment përndjekësi mund të shfaqet.
- Faza e pestë është vetëfajësimi. Viktimja mendon se e ka shkaktuar vetë përndjekjen nëpërmjet një sjelljeje, një pune të re, personit që është martuar ose personit që ka një lidhje shpirtërore. Pra mendon se nëpërmjet veprimeve të saj/tij e ka çuar veten drejt përndjekjes
- Faza e gjashtë është zemërimi kur viktimja e kupton se nuk është faji tij/ saj. Në këtë fazë ankthi, lodhja mendore nga përndjekja kanë ndikuar në rritjen e zemërimit dhe viktimja është i aftë të bëjë çdo gjë që t'i jap fund përndjekjes.
- Faza e shtatë dhe e fundit është kur viktimja e pranon përndjekjen dhe mësohet me këtë mënyrë jetese sepse nuk mund ta shmangë dot.

2. Analiza juridiko-penale e veprës penale të “Përndjekjes”

2.1 Neni 121/a Përndjekja

Kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t'i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet. Kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, dënimi rritet me një të tretat e dënimit të dhënë. Kur kjo vepër kryhet ndaj të miturit, gruas shtatzënë ose një personi të pazotë për t'u mbrojtur, si dhe kur kryhet nga një person i maskuar ose shoqërohet me mbajtjen ose me përdorimin e armëve, dënimi rritet deri në një të dytën e dënimit të dhënë¹¹

Vepra penale e përndjekjes është një vepër penale e cila është parashikuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë në seksionin e krimeve kundër moralit dhe dinjtetit.

2.2 Ana objektive

Krimi i përndjekjes kryhet nëpërmjet veprimeve aktive të kundërligjshme në forma

¹¹ “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, 2011, neni 113

Ligj nr. 23/2012 “Për dënimin dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, neni 15.

Elezi, Ismet. *E drejta penale - pjesa e posaçme*, 2011, f. 154.

dhe mënyra të ndryshme. Format në të cilat shfaqet kjo vepër penale janë:

- Kërcënimi i vazhdueshëm ndaj viktimës ose personave të lidhur shpirtërisht me të nëpërmjet veprimeve të përsëritura.
- Ngacmimi i vazhdueshëm i personave me qëllim që të shkaktojë gjendje ankthi dhe frike ndaj personit.
- Kjo vepër penale në rrethana të cilësuar mund të kryhet duke kërcënuar ose ngacmuar nëpërmjet përdorimit të armës ose nga një person i maskuar.

2.3 Ana subjektive

Kjo vepër penale kryhet me dashje të drejtpërdrejt. Në veprën penale të përndjekjes merr rëndësi qëllimi për cilësimin juridik, ky krim duhet të kryhet me qëllimin për t'i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës. Motivet marrin rëndësi në paragrafin e dytë të nenit 121/a kur është kryer nga personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin .

3. Vështrim krahasues juridiko-penal me kodet penale të disa vendeve evropiane

Në një vështrim krahasues të veprës penale me disa kode të vendeve evropiane do të shohim që dallimet do të jenë të vogla. Kjo pasi vepra penale e përndjekjes është studiuar nga shkencat sociale evropiane si një fenomen i përbashkët pas vitit 1990. Pas studimeve të këtij fenomeni është bërë mbrojtja juridike e përndjekjes. Vendi i pare i Bashkimit Europian që ka miratuar ligjin kundër përndjekjes ka qenë Mbretëria e Bashkuar. Kushtetuta e Danimarkës e ka parashikuar edhe më parë në mënyre të tërthortë, në Kodin e saj Penal të vitit 1993, i cili përmbante një kusht lidhur me përndjekjen. Shtetet e tjera e kanë parashikuar në legjislacionin e tyre ligjin kundër përndjekjes shtete si: Belgjika, Holanda, Gjermania Malta, Irlanda, Austria dhe e fundit që e ka parashikuar është Italia.

3.1 Vështrim krahasues me Kodin Penal Italian¹²

Neni 612 "përndjekja": "Ndëshkohet 6 muaj deri në 4 vjet kushdo që me veprime të përsëritura, kërcënon ose ngacmon dikë në mënyre që t'i shkaktojë për një kohë të gjatë një gjendje të rëndë ankthi dhe frike domethënë që ngjall frikë për sigurinë vetjake të tij, ose të një personi të afërt, ose të një personi që ka lidhje shpirtërore, duke e detyruar për të ndryshuar mënyrën e jetesës. Dënimi është rritur, nëse krimi është kryer nga ish-bashkëshorti ose një person që ka pasur lidhje shpirtërore me viktimën. Dënimi rritet me një të dytën e dënimit, nëse krimi është kryer ndaj një të mituri, ndaj një gruaje shtatzënë, ose ndaj personave të pafate siç janë parashikuar në nenin 3 të ligjit numër 104 të Kodit Penal, ose kur kryet me armë ose nga persona të maskuar. Ndryshimet ndërmjet parashikimit të kësaj vepre penale në legjislacionin tonë dhe atë italian do të vërehen në rrezikshmërinë shoqërore që ka kjo vepër penale në secilin vend. Në kodin penal Italian nuk parashikohet se sa rritet dënimi kur përndjekja është kryer nga bashkëshorti ose personi që ka lidhje shpirtërore me të, por lihet në diskrecion të gjyqtarit ndërkohe që në legjislacionin shqiptar parashikohet se dënimi rritet me një

¹² Kodi Penal Italian, neni 612, dt. 23.2.2009, nr. 11.

të tretën e dënimit kryesor. Ashtu siç parashikohet në Kodin Penal Italian që vepra penale është e dënueshme vetëm me ankesën e viktimës edhe pse kjo nuk është e parashikuar në legjislacionin tonë ajo del në mënyrë të tërthortë pasi kjo vepër përfshihet në seksionin e veprave penale që procedohen vetëm me ankesën e viktimës.

4. Përfundime dhe rekomandime

Përndjekja është një fenomen i cili e ka shoqëruar njerëzimin gjatë gjithë zhvillimit të tij edhe pse ai është sanksionuar pas viteve 1990 në fillim në Shtetet e Bashkuara e më pas në vendet Evropiane. Fillimisht rëndësi kishin rastet e përndjekjes së personave të famshëm e cila shoqërohej me pasoja të rënda për shëndetin. Pas sanksionimit të parë në Kaliforni dhe përhapjes së përndjekjes jo vetëm ndaj personave të famshëm, por edhe njerëzve të thjeshtë, vepra penale e përndjekjes do të dënonte çdo përndjekje dhe ngacmim të vazhdueshëm që kishte si qëllim shkaktimin e ankthit dhe të frikës tek viktima. Përndjekja në ditët e sotme është mjaft e përhapur. Dalim në këto përfundime, duke iu referuar të dhënave të marra nga qendra të njohura zhvillimi të studimeve mbi intimitetin dhe anketës së dhunës seksuale. Një në gjashtë femra dhe një në nëntë meshkuj janë përndjekur gjatë gjithë jetës së tyre. Si për femrat ashtu dhe për meshkujt, përndjekja në pjesën më të madhe të rasteve, është bërë nga njeri i njohur për ta. Dy e treta e femrave (66.2%) që janë viktima të përndjekjes, e kanë raportuar se përndjekja është kryer nga një person që kanë pasur lidhje shpirtërore dhe një e katërta (24%) kanë raportuar se përndjekja është bërë nga një person i njohur. Një në tetë femra (13.2 %) janë viktima të përndjekjes nga një i panjohur¹³.

Arsyet që ndikojnë në përhapjen e kësaj vepre penale lidhen me natyrën e përndjekësit me motivet që e çojnë atë drejt përndjekjes. Nga analiza e bërë më sipër e llojeve të përndjekjes dhe e tipave të përndjekësve mund të arrijmë në konkluzionin se motivet që i shtyjnë këto persona për kryerjen e veprës penale janë: vetmia, papjekuria, paaftësia për të mbajtur një lidhje të afërt; ka një histori me të cilën ka qenë/është shumë i afërt; kërkon t'i afrohet objektivave të paarritshme; i arrin këto objekte nëpërmjet fantazisë dhe mendon se mund t'i arrijë edhe në realitet; ndjenja e fajit në vetvete për ndjenjat e të tjerëve; iluzioni që mund të zgjasë për vite; motive për të kuptuar se cila është arsyeja që viktima e refuzon atë; mund të jetë lakmitar përse dikush e ka arritur objektivin e tij dhe ai jo; kërkon të ketë një njohje qoftë edhe negative vetëm për të qenë i lidhur me viktimën; për shkak të iluzioneve të krijuara pasi ka humbur një lidhje që për të ka qenë shumë e rëndësishme; për arsye se ai e ka këtë një sjellje të përhershme; për shkak se vuan nga skizofrenia; ose fiksimit që mund të ketë për të arritur këtë objekt. Motivet që ndikojnë tek përndjekësi për realizimin e kësaj vepre penale mund të jenë nga më të ndryshmet të cilat ndikojnë dhe në përcaktimin e llojit të këtij përndjekësi.

Për të ulur numrin e lartë të përndjekjes përveç dënimit të përndjekësve një mënyrë e efikase, mendoj se, mund të jetë edhe trajtimi i tyre nëpërmjet terapive të ndryshme psikiatrike. Kjo mund të ndihmojë në largimin e fiksimeve, iluzioneve, në bindjen e personave se një lidhje ka marrë fund, ose për trajtimin e fiksimeve hakmarrëse.

Në vendin tonë përndjekja është një fenomen sa i vjetër që ka ekzistuar prej kohësh,

¹³ Mund të shikoni: "Instituti Kombëtar i Dhunës Seksuale: Raport përmbljedhës". Atlanta: Qendra për Kontrollin e të plagosurve, 2010.

aq edhe i ri sepse është i sapa sanksionuar. Sanksionimi i përndjekjes do të ndihmojë në uljen e përhapjes së kësaj vepre penale dhe gjithashtu në sigurinë e viktimave. Edhe pse mund të jetë pak herët për ndryshimet dhe plotësimet e kësaj vepre penale e cila akoma nuk është vënë në zbatim në vendin tonë, mund themi se në të ardhmen kjo vepër duhet të përmirësohet në disa drejtime. Duke iu referuar vështrimit krahasues të bërë midis legjislacionit shqiptar dhe atij të vendeve të huaja mund të konstatojmë këto ndryshime për përmirësimin e sanksionimit të veprës penale të “përndjekjes”:

1. Duhet të parashikohet dënimi në rastet kur përndjekja shoqërohet me dëmtimin e shëndetit ose vdekjen e viktimës.

2. Duhet të parashikohen mënyrat e realizimit të kësaj vepre penale ashtu si dhe në Kodin Penal gjerman dhe jo të shikohen rast pas rasti nga gjykata.

3. Duhet të parashikohet edhe një dëmshpërblim për viktimën ashtu siç është parashikuar dhe në legjislacionin francez.

4. Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë duhet të parashikohet dhe përndjekja kibernetike. Sot internet ka një numër të madh përdoruesish në të gjithë botën dhe në vendin tonë gjithashtu, si pasojë përhapja e përndjekjes në internet është mjaft e përhapur sepse është më e lehtë të mblidhen informacionet dhe më e vështirë për tu identifikuar përndjekësi. Për rolin që luan internet në shoqërinë shqiptare sanksionimi i “përndjekjes kibernetike” si një krim kibernetik duhet të legjitimohet sa më shpejt. Pavarësisht mangësive që mund të vihen re në veprën penale të përndjekjes sanksionimi i saj është një nga reformat që vijnë në ndihmë të shoqërisë. Rastet e përndjekjes rriten çdo ditë prandaj kjo mbrojtje e viktimave sidomos atyre femra i vjen shumë në ndihmë atyre për tu ndjerë më të sigurta dhe për ti dhënë fund gjendjes së ankthit dhe frikës.

Bibliografia

1. Elezi, Ismet. *E drejta Penale, Pjesa e Posaçme*. Tiranë: 2009.
2. Gross, Linden. *Për të pasur ose për të dëmtuar*. 1994.
3. Meloy, J. Reid. *Sulmet e dhunshme*. 1992
4. Orion, Doreen. *I Know You Really Love Me: A Psychiatrist's Account of Stalking and Obsessive Love*. New York: Dell, 1997.
5. *Fjalor i Oxford-it*, 2002.
6. *Kushtetuta Republika e Shqipërisë*, Tiranë 2011.
7. *Kodi Penal Republika e Shqipërisë*, Tiranë 2011.
8. *Kodi Penal Italian*, 2009.
9. Ligji nr. 23/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar".
Artikuj
10. Mullen, Paul, "Tipet e përndjekësve", *Gazeta amerikane e psikiatrisë*, 1999.
11. Gjykata administrative Remsburg, "Çështja Amy kundër Docusearch, nr.17", 2003.
12. Citron, Danielle Keats (2009). "Law's Expressive Value in Combating Cyber Gender Harassment". *Michigan Law Review* 108: 373.
Raporte
13. "Instituti kombëtar i dhunës seksuale", *Raport përmbledhës*, Atlanta: Qendra për Kontrollin e të Plagosurve, 2010.
14. Ueb
15. <http://legal-dictionary.thefreedictionary.com>.
16. http://www.ncvc.org/src/main.aspx?dbID=DB_Utah125.
17. <http://www.esia.net>.
18. <http://www.stalkingalert.com/articlesofinterest.htm>, publikuar në 20 gusht 2005

Ngritja e kapaciteteve trajnuese të Policisë së Kosovës dhe ndikimi i tyre, në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar

— Msc Agron RUKIQI

Policia e Kosovës

agron.rukiqi@kosovopolic.com

Abstrakt

Policia paraqet njërin nga institucionet më të rëndësishme të shtetit në të gjitha periudhat e tij të zhvillimit. Në periudhat bashkëkohore asaj i kushtohet një rëndësi e veçantë, si në shtetet me demokraci të zhvilluar ashtu edhe në ato të tranzicionit. Krijimi dhe ndërtimi i një policie në bazë të parimeve demokratike, paraqet një detyrë dhe obligim, por edhe një sfidë të madhe për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar. Krimi i organizuar konsiderohet si kërcënim ndaj sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky kërcënim, mund të manifestohet në forma të ndryshme, në varësi me zhvillimin e jetës ekonomike dhe shoqërore, sidomos në kushtet e globalizimit. Pozita gjeostrategjike e Republikës së Kosovës në Ballkan, si dhe kushtet e krijuara pas luftës, u mundësojnë grupeve të ndryshme kriminale, për të zhvilluar aktivitete të krimit të organizuar. Shkalla e lartë e papunësisë dhe varfëria, kontribuojnë gjithashtu në krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar në veçanti. Problemit të krimit të organizuar në shoqërinë kosovare, i duhet kushtuar kujdes të veçantë, sidomos nga mekanizmat shtetëror, institucional dhe shoqëror duke u angazhuar aktivisht në parandalimin dhe zbulimin e të gjitha formave të krimit të organizuar. Republika e Kosovës duhet të bëjë akoma më shumë përpjekje për të implementuar një politikë të besueshme dhe reale, duke përmirësuar situatën aktuale në fushën e sundimit të ligjit dhe të merret në mënyrë efikase, me luftimin e krimit të organizuar, me qëllim progresin drejt rrugës së integritetit euroatlantik. Roli i Policisë së Kosovës, është rol vendimtar në parandalimin dhe luftimin e krimit në përgjithësi dhe kjo bëhet në bashkëpunim edhe me aktorët e tjerë. Për t'u arritur ndërtimi dhe zhvillimi i një force policore të qëndrueshme, demokratike dhe bashkëkohore, e cila të përballet me sukses me parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, është e nevojshme që ajo të ketë një personel të zgjedhur, të kualifikuar, të trajnuar mirë, të motivuar, të mbikëqyrur dhe të udhëhequr në mënyrë të drejtë.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

Fjalëkyçe:

trajnimi, ngritja e kapaciteteve, parandalimi i krimit dhe luftimi i krimit.

1. Hyrje

Në çdo shoqëri demokratike, parandalimi i jepet përparësi në raport me represionin, gjatë zbulimit dhe luftimit të kriminalitetit. Parandalimi është me i mirë se ndëshkimi.¹ Policia është një institucion tradicional i njohur për mbrojtjen e rendit shoqëror në të gjitha formacionet historike shoqërore dhe në të gjitha vendet e botës.² Me qëllim që veprimtaria parandaluese e policisë të jetë sa më e efektshme, është e nevojshme që programet dhe udhëzimet e përgjithshme të politikës kriminale, të formulohen në nivelin më të lartë kombëtar.³ Kërkimet më të reja të aktivitetit policor, si sektor i posaçëm i kontrollit shoqëror, tregojnë se aktiviteti i policisë po transformohet gjithnjë e më shumë në kuptimin e preventiv, e kështu si insistohet, duhet t'i kuptojmë edhe vetë pjesëtarët e policisë se ata janë njëkohësisht edhe zyrtarët e prevencionit dhe se prevencioni i krimit, marrë në kuptimin më të gjerë është funksion i shërbimit të policisë.⁴

Funksioni kryesor i policisë është parandalimi dhe luftimi i krimit e për tu realizuar me sukses kjo, është shumë e rëndësishme që policia të funksionojë dhe punojë si një trup i vetëm. Ngritja e kapaciteteve në shtyllën e hetimit të krimit, nuk është e mjaftueshme për të pasur sukses, por është e rëndësishme që edhe funksionet tjera të zhvillohen paralelisht për të mbështetur këtë fushë. Policia ndërmerr aktivitetet të përcaktuara që më parë, me qëllim të parandalimit të kriminalitetit – prevencioni

¹ Alfred Stumpper, 'Vorbengung-Steitkinder polizeilichen Arbeit', *Izbor clanaka iz stranih casopisa*, (Zagreb 1987), nr 1-2, fq. 21.

² Vesel Latifi, *Taktika kriminalistike*. (Prishtinë: 2013), fq. 26.

³ Raymond Screvens, 'Police et prevention de la criminalite', *Izbor clanaka iz stranih casopisa*, (Zagreb 1979), nr. 3, fq. 212.

⁴ Vesel Latifi, *Taktika kriminalistike*, (Prishtinë, 2001), fq. 28

policor mund të shfaqet në forma të ndryshme të aktivitetit dhe pasivitetit, siç është mbikëqyrja dhe patrullimi i terrenit, kryerja e shërbimit të mbikëqyrës që trajtohet provencion policor, kryerja e kontrollit në rrugë, të cilin e praktikojnë policitë e shumë vendeve, dhënia e këshillave qytetarëve me qëllim të mbrojtjes nga kriminaliteti, etj. Ndër këto aktivitete parandaluese, është veçanërisht e rëndësishme nevoja për punën paraprake operative, si formë e preventivës së thjeshtë policore, e cila praktikohet në vendet e rrezikuara nga kriminaliteti. Kjo punë parandaluese është e domosdoshme për parandalimin e organizimit, për luftimin dhe trajtimin e të gjitha llojeve të kriminalitetit.⁵

Nëpër debat publike, opinioneve të ekspertëve, analistëve të cilat pasqyrohen në mediet e shkruara dhe elektronike në Kosovë, ku përgjegjës për sigurinë e paraqesin vetëm Policinë e Kosovës. Përgjegjësinë për sigurinë e kanë të gjithë, duke filluar nga individ, familja, rrethi shoqëror e deri te institucionet si: Presidenca, Kuvendi, Qeveria, Ministrinë përkatëse dhe agjencitë e tjera, sidomos ato të sigurisë si, Policia, Agjensioni Kosovar për Inteligjencë, etj., etj. Nëse secila hallkë e shoqërisë e kryen detyrën, duke dhënë një kontribut sado modest dhe nëse këto detyra kryhen si duhet, atëherë edhe niveli i sigurisë do të rritet dhe më këtë rast do të kemi uljen e nivelit të krimit, me theks të veçantë të krimit të organizuar dhe gjithashtu kjo do të ndikonte edhe në parandalimin e krimeve.

2. Historik i shkurtër i Policisë së Kosovës

Policia e Kosovës (PK) u formua me 6 shtator 1999, nën mandatin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1244). Me krijimin e sajë PK-ja, pas luftës trashëgoi një situatë të rënduar në aspektin e sigurisë. Ky ishte fillimi i ndërtimit të kapaciteteve, në shërbim të sigurisë për të gjithë qytetarët e Kosovës. PK-ja filloi me gjeneratën e parë, e cila numëronte njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë (176) zyrtarë policorë duke përfshirë tridhjeteshtatë femra. Trajnimi për zyrtar policor, në Shkollën Policore në Vushtrri, fillimisht kishte një kohëzgjatje gjashtë javore, duke u zgjatur gradualisht në 26 javë, siç është edhe aktualisht. Me krijimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, përmes miratimit të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2005/54 në vitin 2005, Policisë së Kosovës iu shtua mbështetja institucionale, për një funksionim me një ngritje të vazhdueshme kualitative dhe profesionale. PK-ja, gjerë më tani në mënyrë relativisht të mirë kontribuoi, në ngritjen e kapaciteteve profesionale si dhe në përmbushjen e misionit përmes rolit të saj, në parandalim, hetim të krimit, luftimin e kriminalitetit, mbrojtjen dhe sigurinë publike konform rrethanave dhe situatës së përgjithshme të sigurisë. Tranzicioni i PK-së ka filluar në vitin 2002 dhe ka vazhduar deri në pavarësimin e plotë të këtij institucioni, me nxjerrjen e Ligjit për Policinë në vitin 2008. Në këtë kohë ku shumë nga funksionet për sundimin e ligjit kanë kaluar në kompetencë të PK-së me këtë rast shtrohen edhe shumë detyra dhe sfida para saj.

Policia e Kosovës, ka kaluar një fazë shumë të rëndësishme të zhvillimit dhe të ngritjes profesionale të saj, duke u bazuar në vizionin, misionin, objektivat dhe vlerat e saja. Vizioni i Policisë së Kosovës është: “Polici profesionale, e trajnuar, e pajisur mirë, efikase në ofrim të sigurisë, në zbatim të ligjit, parandalimit dhe luftimit të krimit, duke qenë shembull në rajon, gjithnjë në mbështetje dhe besnike ndaj komunitetit”. Misioni i PK-së, është: “Të ofrojë siguri dhe shërbime për të gjithë personat në Kosovë, bazuar

⁵ Po aty.

në ligj, praktikat më të mira dhe standardet e policimit demokratik”. Policia e Kosovës do të përbushë misionin, duke ofruar siguri publike (sigurinë e jetës dhe pronës), duke mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut, duke bashkëpunuar me komunitetin dhe institucionet, duke kontrolluar dhe mbikëqyrur kufirin, duke përmirësuar performancën e organizatës, duke parandaluar dhe luftuar krimin e organizuar, korrupsionin dhe format tjera të aktiviteteve kriminale. Vlerat e PK-së janë: orientimi ndaj shërbimit, - secili zyrtar kontribuon në kualitetin e jetës ndaj komunitetit që i shërben; integriteti - ne do të punojmë me drejtësi, ndershmëri dhe sinqeritet, gjithnjë bazuar në standardet më të larta etike dhe morale; dedikimi - vigjilent dhe proaktiv në organizatë dhe komunitet, i vetëmotivuar dhe kreativ; puna në ekip - puna në ekip është esenciale për arritjen e suksesit. Në ekip duhet të kyçen edhe zyrtarët nga brenda, po ashtu edhe komuniteti, për arritjen dhe përbushjen e objektivave strategjike.⁶

3. Korniza ligjore

Bazë për funksionimin e Policisë së Kosovës janë, Kushtetuta e Kosovës, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale dhe ligjet e tjera, ligji i Policisë së Kosovës, strategjitë nacionale dhe sektoriale, udhëzimet administrative, rregulloret dhe procedurat standarde të operimit. Për ngritjen e kapaciteteve të rekrutimit dhe trajnimit në kuadër të policisë së Kosovës, është përgjegjës Departamenti i Burimeve Njerëzore (DBNJ) i cili është një nga pesë departamentet e Policisë së Kosovës. DBNJ është përgjegjës për sigurimin e implementimin e politikave që kanë të bëjnë me personelin dhe trajnimin; ai ofron efikasitet dhe efektivitet në menaxhimin e burimeve njerëzore në kuadër të Policisë së Kosovës; siguron që rekrutimi i personelit në Policinë e Kosovës të jetë i bazuar në kualifikimet profesionale, në kompetencat dhe meritat dhe për ta zhvilluar atë në konkurrencë të drejtë dhe transparente si dhe ofron një sistem efikas për menaxhimin dhe zhvillimin e karrierës në gjithë personelin policor.⁷

Me ligjin nr. 04/L-076 për Policinë, kreu V, rregullohet marrëdhënia e punës, neni 44, paragrafi 1: Policia e Republikës së Kosovës punëson tri kategori të personelit policor, nënparagrafët: 1.1 zyrtarë policorë që bëjnë betimin dhe kanë autoritet t’i ushtrojnë dhe t’i kryejnë autorizimet dhe detyrat policore; 1.2. staf civil që punësohet për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative, por që nuk ka autoritet të ushtroj autorizime policore; 1.3. kadet policor. 2. Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor.⁸

Ligji nr. 04/L-076 për Policinë ka paraparë me nenin 55 nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatim të këtij ligji e me këtë rast nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë janë nxjerrë aktet nënligjore për marrëdhënien e punës dhe procedurën e gradimit që të dy këto akte nënligjore ndikojnë në ngritjen e kapaciteteve në funksion të parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar. Lidhur me ngritjen e kapaciteteve trajnuese, ligji nr. 04/L-076, për Policinë, në nenin 33, Drejtorja e Përgjithshme e Policisë, paragrafi 2, nënparagrafi 2.6 ka paraparë, citoj: “koordinon funksionet administrative të policisë, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në mirëmbajtjen e të dhënave të policisë dhe sistemin e telekomunikimit, rekrutimit, trajnimit dhe të edukimit të personelit policor, menaxhimin e buxhetit dhe të çështjeve financiare, prokurimin dhe në menaxhimin e

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

“ Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit ”

⁶ Policia e Kosovës, *Plani Strategjik i Policisë së Kosovës, 2016-2020*, (Prishtinë, 2015), fq. 13

⁷ *Ueb i Policisë së Kosovës*. Marrë nga <http://www.kosovopolic.com>.

⁸ Ligji nr. 04/L-076 Për Policinë, (Prishtinë, 2012), fq. 24.

rasteve dhe objekteve policore”.⁹

Policia e Kosovës i ka kushtuar kujdes ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore që janë në funksion të parandalimit dhe luftimit të krimit me theks të veçantë, krimit të organizuar ku ka paraparë edhe objektiva strategjike me planet strategjike të PK-së. Plani i parë strategjik në PK është hartuar për periudhën kohore 2008-2010, për të vazhduar pastaj me “Planin Zhvillimor Strategjik” 2011-2015, dhe aktualisht “Plani Zhvillimor Strategjik” 2016-2020. Policia e Kosovës në objektivin strategjik nr. 4 të “Planit Zhvillimor Strategjik”, 2016-2020 në objektivin strategjik nr. 4, ka paraparë avancimin e menaxhimit të burimeve njerëzore. Policia e Kosovës do t’i kushtojë rëndësi të madhe ngritjes dhe avancimit të performancës, duke aplikuar standarde më të mira për personelin policor përmes aplikimit të sistemit të menaxhimit të personelit, trajnimeve në vazhdimësi dhe kujdesit ndaj shëndetit. Rëndësi të veçantë do t’i kushtohet edhe ngritjes së cilësisë së programeve të trajnimeve, duke filluar nga trajnimet themelore deri tek ato të specializuara, në funksion të plotësimit të nevojave të së gjithë të punësuarve.¹⁰

4. Personeli

Në kuadër të departamentit për burime njerëzore, funksionon divizioni për personel dhe administratë i cili është përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e strukturës organizative në tërë PK-në, implementimin e ligjeve, udhëzimeve administrative, rregulloreve, parimeve dhe PSO-ve, në lëmin e administratës, për të mundësuar shërbim profesional, identifikim dhe plotësim të nevojave me personel e staf të graduar, organizimin e procesit të rekrutimit dhe seleksionimit në PK, monitorimin e realizimit të programeve të trajnimit për policë të rinj dhe zyrtarë policorë të graduar, identifikimin e nevojave për rekrutim të personelit policor (zyrtar policor dhe stafit civil), identifikimin e nevojave të promovimit në gradë, krijimin e politikave për mbështetje të së punësuarve të PK-së, në aspektin shëndetësor dhe psikologjik, mbikëqyrjen dhe kontrollimin e bazës së të dhënave në kuadër të divizionit, përkujdeset për mirëqenien e të gjithë të punësuarve në kuadër të PK-së.¹¹ Referuar të dhënave nga Departamenti për Burime Njerëzore, Policia e Kosovës në përbërjen e saj ka 8931 punonjës; nga ta 7843 zyrtarë policorë dhe 1088 staf civil, për pozita mbështetëse dhe administrative. Prej tyre 83.83% janë shqiptarë, 16.17% të numrit të përgjithshëm të personelit e përbëjnë pakicat (serbë, boshnjakë, turq, goranë, romë, ashkali, egjiptianë, etj.) dhe përfshirja gjinore me 88.89% meshkuj dhe me 13.81% femra.¹²

5. Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimit

Policia e Kosovës është rritur shumë për këto vite me këshilla ndërkombëtare dhe mbështetje financiare, që nga viti 2008. Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, është instaluar misioni EULEX në emër të Bashkimit Evropian ku roli i tij është monitorimi, mentorimi dhe këshillimi. Një numër i agjencive tjera e ka ndihmuar zhvillimin e policisë

⁹ Po aty.

¹⁰ Policia e Kosovës, *Plani Strategjik i Policisë së Kosovës, 2016-2020*, (Prishtinë, 2015), fq. 13.

¹¹ *Uebi i Policisë së Kosovës*. Marrë nga <http://www.kosovopolice.com>.

¹² Policia e Kosovës. *Raport i personelit, nga Drejtoria e Personelit*, (Prishtinë, 2016).

si: OSBE, ICITAP, etj. dhe mbështetja bilaterale nga shumë partnerë ndërkombëtarë kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në polici dhe zhvillimin përkatës institucional.¹³ Për t'u arritur ndërtimi dhe zhvillimi i një force policore të qëndrueshme, demokratike dhe bashkëkohore, e cila do të përballlet me sukses me parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, është e nevojshme që ajo të ketë një personel të zgjedhur, të kualifikuar, trajnuar mirë, të motivuar, mbikëqyrur dhe udhëhequr në mënyrë të drejtë. Policia e Kosovës, si shërbim i ri, ka përqafuar trajnimin e vazhdueshëm për punonjësit e saj; trajnimi fillimisht është konceptuar dhe zhvilluar nga misioni i OSBE-së në Kosovë dhe më pas është zhvilluar dhe avancuar nga ne. Së fundi, ne kemi një koncept të integruar të trajnimit përmes themelimit të Akademisë Kosovare për Siguri Publike (AKSP) në kuadrin e MPB-së, në të cilën i kryejnë trajnimet personeli që punojnë në fushën e sigurisë publike si: Policisë, Inspektorati Policor i Kosovës, Doganave, Shërbimit Korrektues, Shërbimit Sprovues dhe Shërbimit Emergjent. Normalisht që pjesa më e madhe është e dedikuar për trajnimin e policisë. Përveç trajnimeve që organizohen në AKSP, trajnimet mbahen edhe në objektet e Policisë së Kosovës, si në nivelin lokal, nivelin qendror, në hapësirat tjera që koordinohen me partnerët si dhe trajnimet të cilat organizohen jashtë vendit.

Paketa e trajnimit e cila zbatohet për personelin policor është e përbërë nga disa lloje trajnimesh si: trajnimi bazë (themelor), trajnimet e specializuara dhe të avancuara, trajnimet e menaxhimit (lidërshipt), etj. Trajnimi bazë apo themelor, është i konceptuar prej 26 javësh trajnim teorik në AKSP dhe 52 javë trajnim në terren. Gjatë këtij trajnimi, zyrtari policor përgatitet për detyrat e përgjithshme policore. Trajnimi ngërthen në vete, trajnimet për: veprimtarinë e përgjithshme policore, hetime, trafik, veprime në komunitet, të drejta të njeriut etj.

Trajnimet e specializuara: organizohen shumë trajnime të specializuara të cilat mbahen nga instruktorë vendorë, por edhe ndërkombëtarë si dhe instruktorë të jashtëm, kryesisht profesorë universiteti, jurist gjykatës dhe prokurorë. Këto trajnime kryesisht kanë të bëjnë me fushat e operacioneve, hetimit të krimit, policinë kufitare, etj. Trajnimet për lidërshipt i organizojmë në tri nivele: niveli i parë i mbikëqyrjes (grada e rreshterit), trajnimet për nivel të mesëm të menaxhimit (toger, kapiten) dhe trajnimet për nivelin e lartë menaxhues (major, nënkolonel dhe kolonel).

Për ngritjen e kapaciteteve të rekrutimit dhe trajnimit, në kuadër të policisë së Kosovës është përgjegjës Departamenti i Burimeve Njerëzore (DBNJ) i cili është një nga pesë departamentet e Policisë së Kosovës. DBNJ është përgjegjës për sigurimin dhe implementimin e politikave që kanë të bëjnë me personelin dhe trajnimin; ofron efikasitet dhe efektivitet në menaxhimin e burimeve njerëzore, në kuadër të Policisë së Kosovës, siguron që rekrutimi i personelit në Policinë e Kosovës të jetë i bazuar në kualifikimet profesionale, në kompetencat dhe meritat dhe për ta zhvilluar atë në konkurrencë të drejtë dhe transparente si dhe ofron një sistem efikas për menaxhimin dhe zhvillimin e karrierës në gjithë personelin policor.¹⁴ Në kuadër të Departamentit për Burime Njerëzore të PK-së, vepron Divizioni i Trajnimeve i cili është përgjegjës për krijimin e kadrove përmes programeve trajnuese kualitative të dedikuara për personelin policor, përmirësimi i vazhdueshëm i kurrikulave për programet e trajnimit sipas nevojave operacionale dhe trajnuese, ngritjen e cilësisë duke përdorur metoda bashkëkohore për

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

¹³ FRIDOM, *Rishikimi Funkcional i Policisë së Kosovës*, (Shtator 2009), fq. 3.

¹⁴ *Ueb i Policisë së Kosovës*. Marrë nga <http://www.kosovopolic.com>

mësim dhe zhvillim, sigurimin e cilësisë së punës për një performancës më të mirë dhe përmirësim të vazhdueshëm.¹⁵

Filozofia e trajnimeve, bazohet në parimet se të gjitha përgatitjet që janë të nevojshme për kryerje të detyrave policore, mund të arrihen përmes trajnimit të vazhdueshëm gjatë gjithë karrierës, përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies, mësimnxënies si dhe forcimit të bashkëpunimit, me institucionet vendore dhe ndërkombëtare që kanë për qëllim ngritjen profesionale të personelit policor. Kjo qasje është në pajtim me modelin demokratik të kryerjes së punëve policore, bazuar në praktikat më të mira të BE-së në fushën e trajnimeve. Të gjitha trajnimet që ofrohen, duke filluar nga ato bazike, të avancuara, të specializuara dhe të lidhshpimit mbështeten në filozofinë e njëjtë të aftësisë profesionale. Prioriteti i trajnimeve është ngritja dhe profesionalizimi i kapaciteteve trajnuese, krijimi dhe plotësimi i programeve mësimore, përdorimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies, mësimnxënies, si dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet homologe dhe organizatat tjera.¹⁶

Në baza vjetore, Divizioni i Trajnimeve i ka të përgatitura rreth 90 lloje të programeve të trajnimit, të cilat i realizon në bazë të nevojave të PK-së. Përveç trajnimit të pjesëtarëve të Policisë, Divizioni i Trajnimeve ka ndihmuar dhe ndihmon në mënyrë aktive në aftësimin dhe trajnimin e pjesëtarëve të agjencive të ndryshme që ofrojnë siguri publike në Kosovë.¹⁷

Policia e Kosovës një rëndësi të veçantë i kushton trajnimeve duke filluar nga ato bazike, të specializuara dhe të lidhshpimit për ngritjen e kapaciteteve me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar. Për të pasur një pasqyrë sa më të qartë lidhur me ngritjen e kapaciteteve nëpër vite në funksion të parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar, në vijim paraqesim: trajnimet e organizuara brenda Policisë së Kosovës, trajnimet e organizuara brenda vendit në bashkëpunim me partnerët mbështetës vendorë dhe ndërkombëtarë si dhe trajnimet e organizuara jashtë vendit me mbështetjen e partnerëve. Në vitin 2007, trajnimet e realizuara që lidhen me krimin e organizuar brenda vendit në koordinim Divizioni i Trajnimeve të PK-së është 10 trajnime me 553 pjesëmarrës.

Ndërsa Divizioni i Trajnimeve në koordinim me agjencitë e tjera partnere brenda vendit ka realizuar 24 trajnime me 512 pjesëmarrës. Këto trajnime janë mbështetur nga aktorë si Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER), TADOC, Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Europol, OSBE, ICITAP, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Guardia di Finanza, etj. Janë mbajtur trajnime jashtë vendit, në mbështetje nga: ambasada amerikane, TADOC, FIC, OCTN, etj., me 13 e 96 pjesëmarrës. Nga Divizioni i Trajnimeve PK, në vitin 2008 janë mbajtur 21 trajnime me 397, pjesëmarrës.

Në koordinim me partnerë (AER, ambasada amerikane, ICITAP, OSBE, Turqi) brenda vendit janë mbajtur 34 trajnime me 435 pjesëmarrës. Ndërsa jashtë vendit janë mbajtur 38 trajnime, konferenca, vizita jashtë vendit me 124 pjesëmarrës. Në vitin 2009, nga Divizioni i Trajnimeve janë mbajtur 43 trajnime me 773 pjesëmarrës, në koordinim me agjencitë partnere (ICITAP, OSBE, MSU, IGJK, ADA) brenda vendit janë mbajtur 29 trajnime me 124 pjesëmarrës, ndërsa jashtë vendit me përkrahjen e partnerëve janë mbajtur 8 trajnime me 24 pjesëmarrës. Në vitin 2010 nga Divizioni i

¹⁵ Uebi i Policisë së Kosovës. Marrë nga <http://www.kosovopolic.com>.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Po aty.

Trajnimeve janë mbajtur 26 trajnime me 494 pjesëmarrës, në koordinim me agjencitë partnere (ICITAP, OSBE, KE, BE, ambasadën gjermane, ambasadën amerikane, turke, etj.); brenda vendit janë mbajtur 47 trajnime me 812 pjesëmarrës, ndërsa jashtë vendit me përkrahjen e partnerëve (OSBE, ambasadë amerikane, ambasadë gjermane, turke, etj.) janë mbajtur 10 trajnime me 55 pjesëmarrës. Në vitin 2011 nga Divizioni i Trajnimeve janë mbajtur 22 trajnime me 371 pjesëmarrës, në koordinim me agjencitë partnere (ambasadë amerikane, ambasadë gjermane, OSBE, IGJK, KE, ILECU, Turqi) brenda vendit janë mbajtur 38 trajnime me 667 pjesëmarrës, ndërsa jashtë vendit me përkrahjen e partnerëve (OSBE, ICITAP, ambasadë amerikane, turke, etj.) janë mbajtur 17 trajnime me 87 pjesëmarrës.

Në vitin 2012, nga Divizioni i Trajnimeve janë mbajtur 25 trajnime me 437 pjesëmarrës, në koordinim me agjencitë partnere (ambasada amerikane, OSBE, Slloveni, TAIEK, BE, NICO, Turqi, etj.) brenda vendit janë mbajtur 71 trajnime me 979 pjesëmarrës, ndërsa jashtë vendit me përkrahjen e partnerëve (OSBE, ambasadë amerikane, ambasadë gjermane, Turqi, etj.) janë mbajtur 15 trajnime me 55 pjesëmarrës.

Në vitin 2013 nga Divizioni i Trajnimeve janë mbajtur 41 trajnime me 601 pjesëmarrës, në koordinim me agjencitë partnere (ambasada amerikane, OSBE, Agjencia kundër korrupsionit, IGJK, ICITAP, KE, Francë, Turqi etj.) brenda vendit janë mbajtur 49 trajnime me 605 pjesëmarrës, ndërsa jashtë vendit me përkrahjen e partnerëve (OSBE, ambasadë amerikane, ambasadë gjermane, ambasada franceze, ICITAP, Këshilli Evropian, UNDP, Instituti Evropian, Turqi, etj.), janë mbajtur 26 trajnime me 93 pjesëmarrës.

Në vitin 2014 nga Divizioni i Trajnimeve janë mbajtur 36 trajnime me 554 pjesëmarrës, në koordinim me agjencitë partnere (ambasada amerikane, OSBE, Agjencia kundër korrupsionit, IGJK, ICITAP, KE, Francë, Turqi etj.) brenda vendit janë mbajtur 42 trajnime me 481 pjesëmarrës, ndërsa jashtë vendit me përkrahjen e partnerëve (OSBE, UNDP, ambasadë amerikane, Policia Franceze, IGJK, etj.) janë mbajtur 40 trajnime me 170 pjesëmarrës.

Në vitin 2015 nga Divizioni i Trajnimeve janë mbajtur 16 trajnime me 292 pjesëmarrës, në koordinim me agjencitë partnere (BE, ICITAP, OSBE, UNDP etj.) brenda vendit janë mbajtur 42 trajnime me 615 pjesëmarrës, ndërsa jashtë vendit me përkrahjen e partnerëve (OSBE, ambasadë amerikane, Policia turke, ambasadë Franceze, Policinë Hungareze, FRONTEx, ambasadë Italiane, etj.) janë mbajtur 39 trajnime me 210 pjesëmarrës. Në vitin 2016 janar-gusht nga Divizioni i Trajnimeve janë mbajtur 5 trajnime me 98 pjesëmarrës, në koordinim me agjencitë partnere (BE, ambasadë amerikane, ICITAP, IGJK, Policia turke, etj.) brenda vendit janë mbajtur 16 trajnime me 215 pjesëmarrës, ndërsa jashtë vendit me përkrahjen e partnerëve (Itali, ambasadë amerikane, Policia turke, MPB Austri, MPB Slloveni, ILEA, KE TAIEK, etj.) janë mbajtur 24 trajnime me 89 pjesëmarrës.¹⁸

Gjatë kryerjes së punës PK-ja aplikon metodat, metodologjinë, teknikat, teknologjinë, trajnimin (trajnimin e stafit PK-ja e ka bërë në mbi 20 vende të botës me standarde evropiane, trajnime që njej bota Perëndimore), përfaqësuese me grupe etnike dhe përfaqësim gjinor në kuadër të saj, kjo bën që PK-ja të radhitet si policia më e mirë e rajonit dhe me gjerë.

¹⁸ Policia e Kosovës. Raport, Divizioni i trajnimeve, (Prishtinë, 2016).

6. Organizimi strukturor

Nga viti 1999 deri në vitin 2010, Policia e Kosovës është duke operuar sipas strukturës organizative të dizajnuar nga stafi ndërkombëtar dhe lokal. Aktivitetet koordinohen në dy nivele të organizimit: niveli qendror dhe niveli lokal (përfshi nivelin rajonal). Nuk ka strukturë ndërkombëtare të policisë në të cilën do të bazohej edhe modeli i Policisë së Kosovës. Në mungesë të një “Modeli Evropian të Policisë”, Policia e Kosovës është zhvilluar si i produkt i 50 modeleve të ndryshme kombëtare, fillimisht të udhëhequra nga UNMIK-u. Struktura aktuale e Policisë së Kosovës është zhvilluar përgjatë një periudhe prej 10 vitesh nën Komisionarët e Policisë të emëruar nga UNMIK-u, Komisionerët: Vittrup, Wilson, Curtis dhe Monk. Disa prej tyre gjatë mandatit të tyre krijuan një organigram, një numër i strukturave të ndryshme u krijuan në periudhën 2005/2008. Janë prezantuar organigramat të shumta, disa janë nënshkruar, disa mbetën si “drafte”. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë është niveli qendror përgjegjës për tërë Republikën e Kosovës. Niveli lokal përfshin drejtoritë rajonale të policisë, përgjegjëse për rajonet e përbëra me komunat e caktuara, stacionet policore që janë përgjegjëse për policinë lokale në secilën komunë dhe nënstacionet policore - përgjegjëse për policinë lokale brenda zonave të caktuara të një komune.¹⁹

Policia e Kosovës, momentalisht funksionon sipas strukturës organizative e cila është e dizajnuar konform nevojës, organizimit dhe funksionimit të saj. Gjatë implementimit, struktura disa herë ka pësuar ndryshime dhe është bërë ristrukturimi i saj, sipas ndryshimeve dhe nevojave organizative të paraqitura në praktikë. Policia e Kosovës i ka dhënë prioritet parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar, duke filluar nga niveli lokal dhe rajonal si dhe përgjegjësinë me të madhe për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar e kanë njësitet e formuara në nivelin qendror. Pra, në nivel qendror kemi departamentin e hetimeve - në kuadër të tij ka dy departamente si: divizioni për hetimin e krimeve dhe divizioni kundër krimit të organizuar. Këto divizione në kuadër të tyre kanë drejtoritë, sektorët dhe njësitë përkatëse. Drejtoria kundër krimit të organizuar ka përgjegjësinë kryesore për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar. Kjo drejtori është e vendosur në nivelin qendror, me shtrirje të njëjve nëpër drejtoritë rajonale.

Funksionin më të mirë të hetimit të krimit e posaçërisht, në parandalim dhe luftimin e krimit të organizuar ndikojnë shumë faktorë ndër më kryesorit është struktura organizative e përcaktuar qartë, sistemi i ndërtuar i analizës së informacionit kriminal i veçantë, ndërlidhja e punëve midis të gjitha njësive që merren në luftimin e krimit, ndërlidhja e funksioneve në aspektin horizontal dhe vertikal, koordinimi dhe ndërlidhja e funksioneve me prokurorinë dhe gjyqësinë, etj. Analizat e informacionit kriminal, kryesisht mbështeten në informacionet që merren nga zyrtarët policor të inteligjencës, numri i të cilëve është mjaft i kufizuar. Për të qenë një polici efikase dhe funksionale, është e rëndësishme që të ketë sa më shumë informim, si nga zyrtarët policorë ashtu edhe nga publiku i gjerë. Për Drejtorinë për Inteligjencë dhe Analiza në kuadër të PK-së është e rëndësishme që të marrë informacione nga të gjithë zyrtarët policorë në radhë të parë si dhe nga publiku. Kjo realizohet përmes krijimit të një sistemi të qëndrueshëm, i cili e ka bazën te teknologjia e informacionit si dhe te aktet normative

¹ FRIDOM, *Rishikimi Funksional i Policisë së Kosovës*, (Shtator, 2009), fq. 3.

që përcaktojnë qartë këtë fushë.

7. Përfundimet

Funksioni kryesor i policisë është parandalimi dhe luftimi i krimit, për tu realizuar me sukses kjo është shumë e rëndësishme që policia të funksionojë dhe punojë si një trup i vetëm. Ngritja e kapaciteteve në departamentin e hetimit të krimit nuk është e mjaftueshme për të pasur sukses, por është e rëndësishme që edhe funksionet tjera të zhvillohen paralelisht për të mbështetur këtë fushë. Policia nuk mund të jetë përgjegjëse e vetme për sigurinë e komunitetit pa përfshirjen e partnerëve, grupeve të interesit, dhe individëve në këtë proces. Policia e Kosovës i ka kushtuar kujdes ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore, që janë në funksion të parandalimit dhe luftimit të krimit me theks të veçantë krimit të organizuar duke paraparë edhe objektiva me planet strategjike. Për tu arritur ndërtimi dhe zhvillimi i një force policore të qëndrueshme, demokratike dhe bashkëkohore e cila me sukses do të përballet me parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar është e nevojshme që ajo të ketë një personel të zgjedhur, të kualifikuar, trajnuar mirë, të motivuar, mbikëqyrur dhe udhëhequr në mënyrë të drejtë. Filozofia e trajnimeve bazohet në parimet se të gjitha përgatitjet që janë të nevojshme për kryerje të detyrave policore mund të arrihen përmes trajnimit të vazhdueshëm gjatë gjithë karrierës, përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies, mësimnxënies si dhe forcimit të bashkëpunimit, me institucionet vendore dhe ndërkombëtare që kanë për qëllim ngritjen profesionale të personelit policor.

Referenca

1. Latifi, Vesel. *Taktika kriminalistike*. Prishtinë: 2013.
2. Latifi, Vesel. *Taktika kriminalistike*. Prishtinë: 2001.
3. Stumpper, Alfred. "Vorbengung-Steitkindder polizeilichen Arbeit". *Izbor clanaka iz stranih casopisa, nr 1-2*. Zagreb: 1987.
4. Screvens, Raymond. "Police et prevention de la criminalite". *Izbor clanaka iz stranih casopisa, nr. 3*. Zagreb: 1979.
5. FRIDOM. *Rishikimi Funksional i Policisë së Kosovës*. Prishtinë: 2009.
6. Uebi i Policisë së Kosovës. <http://www.kosovopolic.com>.
7. Ligji nr. 04/L-076 Për Policinë. Prishtinë: 2012.
8. Policia e Kosovës. *Plani Strategjik i Policisë së Kosovës, 2016-2020*. Prishtinë: 2015.
9. Policia e Kosovës. *Raporti i personelit, nga Drejtoria e Personelit*. Prishtinë: 2016.
10. Policia e Kosovës. *Raport, nga Divizioni i trajnimeve*. Prishtinë: 2016.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

Formimi i ekspertëve kriminalistë përballë sfidave të kohës

Msc. Ajdin MBORJA
Akademia e Sigurisë
ajdin.mborja@asp.gov.al

Dr. (proces) Artili MANDRO
Fakulteti i Drejtësisë
artilimandro@yahoo.com

Abstrakt

Sot, policia shkencore ka marrë një rol më të rëndësishëm se kurrë për sa i përket zbulimit të autorëve të veprave penale dhe dokumentimit ligjor të fajësisë së tyre. Pas viteve '90 policia shkencore shqiptare ka përfjetuar reformat në Policinë e Shtetit me të mirat dhe të këqijat e saj; e rëndësishme është që ajo vazhdimisht është performuar. Gjatë kësaj periudhe, ngarkesa e punës ka pësuar një rritje të konsiderueshme, shoqëruar kjo dhe me një rritje të ngarkesës psikologjike e sociale të punonjësve të saj. Organi procedural si dhe ai gjyqësor i kanë rritur mjaft kërkesat si në drejtim të numrit të ekzaminimeve të kryera, ashtu dhe në drejtim të specifikave në këto ekzaminime. Ata presin nga eksperti kriminalist që të japë një përgjigje më të plotë dhe më të detajuar lidhur me identifikimet, mekanizmin e ngjarjes, të zgjidhjes së versioneve të mundshme me anë të eksperimenteve hetimore, të cilat po praktikohen sa vjen e më tepër. Përkundrazi, mënyra e formimit të ekspertëve kriminalistë ka ndryshuar shumë pak. Përballë këtij realiteti, eksperti kriminalist, gjithnjë e më tepër ndjen nevojën e një standardizimi të veprimtarisë së tij, të një profilizimi ku ai është më i specializuar, për një ekuilibër optimal mes vartësisë së tij administrative, metodike e procedurale dhe pavarësisë e bindjes së tij personale në dhënien e konkluzioneve. Mbi këtë bazë, mendoj se duhet të ndërmerren disa ndryshime për sa i përket mënyrës së formimit të ekspertëve kriminalistë në mënyrë që ata të jenë në gjendje t'i përgjigjen në kohë dhe me cilësi sfidave që koha shtron përpara tyre.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

Fjalëkyçe:

policia shkencore, formimi i ekspertëve kriminalistë, standardizim, profilizim, pavarësi në dhënien e konkluzioneve.

1. Hyrje

Ekspertët kriminalistë janë punonjës të Policisë së Shtetit. Si të tillë, kriteret e përzgjedhjes së tyre janë konform ligjit “Për Policinë Shtetit”, të “Rregullores së Policisë së Shtetit” dhe të “Rregullores së Policisë Shkencore”. Me ligjin aktual të Policisë¹ dhe Rregulloren², punonjësit e policisë shkencore mund të përzgjidhen si me arsim policor ashtu dhe nga disa fusha të tjera të përcaktuara (për funksione të veçanta). Por, në këtë punim do të trajtojmë vetëm formimin klasik kriminalistik, pra jashtë funksioneve të veçanta të fushave ngushtësisht të specializuara e konkretisht për fushën e këqyrjes së vendngjarjes dhe fiksimit të provave, fotografisë, daktiloskopisë, traseologjisë, balistikës dhe ekzaminimit të dokumenteve e ekzaminimeve grafike. Sot policia shkencore shqiptare është e organizuar në tre nivele: ai qendror, që është Instituti i Policisë Shkencore; ai rajonal, që përfshin laboratorët rajonalë në drejtoritë e policive në qarqe dhe niveli i tretë, shërbimi në disa komisariate të policisë që kanë dinamikë të konsiderueshme apo largësi nga drejtoria e policisë së qarkut përkatës. Policia shkencore numëron rreth 160 punonjës, nga të cilët 36% (rreth 58 punonjës) shërbejnë në Institutin e Policisë Shkencore dhe pjesa tjetër në dy nivelet e tjera. Nga personeli i përgjithshëm, 69% janë specialistë dhe 31% rrolli bazë ndihmëspecialistë. Në këto shifra futen edhe punonjësit e ekzaminimeve në fusha të veçanta. Të tre nivelet janë operative, pra ato realizojnë direkt veprime procedurale hetimore (këqyrje vendngjarje, eksperimente hetimore, etj.) dhe ekzaminime kriminalistike e hartojnë akte ekspertimi. Ky punim synon të bëjë një analizë të thjeshtë të aktivitetit të policisë shkencore duke synuar të përcaktojë se sa i përgjigjet mënyra e formimit të ekspertit kriminalist, aktivitetit dhe kërkesave ndaj tij në kohën e sotme. Mbi këtë bazë, jepen edhe disa rekomandime se si mund të përmirësohet e përshtatet mënyra e formimit të këtyre ekspertëve. Për sa më lart, jemi bazuar në analizat vjetore të Policisë Shkencore shqiptare në shkallë vendi, të

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

dhënat e drejtorisë së burimeve njerëzore dhe në programet e kurrikulat për formimin e ekspertëve kriminalistë që disponohen në Institutin e Policisë Shkencore dhe në Akademinë e Sigurisë.

2. Formimi aktual i ekspertëve kriminalistë

Konkretisht, një ekspert kriminalist me arsim policor, përgatitet në fushën e këqyrjes së vendngjarjes, të fotografisë, të ekzaminimeve balistike, ekzaminimeve traseologjike, ekzaminimeve grafike e të dokumenteve si dhe në atë të ekzaminimeve daktiloskopike. Formimi fillestar i ekspertit kriminalist, konsiston në kryerjen e kursit për ekspert kriminalist dhe të praktikës në terren. Programi i këtij kursi synon që të përgatisë një ekspert, i cili të jetë i aftë që të operojë në të gjitha fushat e përmendura në paragrafin e mësipërm, duke e kompletuar njëkohësisht atë me njohuri dhe mbi bazën ligjore, funksionimin e institucioneve të tjera që lidhen me procesin, etj. Fillimisht, formimi fillestar i mësipërm, shtrihet në një periudhë kohore prej nëntë muajsh, ku diçka më pak se gjysma, trajtonte aspektin procedural dhe juridik në përgjithësi e më tej të lidhur me ekzaminimin kriminalistik në veçanti.

Në vitin 2000 u pa e arsyeshme që ky formim të shtrihet në një periudhë kohore tre-katër mujore, duke marrë të mirëqenë që pjesa juridike ishte trajtuar gjatë formimit shkollor të kandidatëve, pra trajnimi do të shtrihet vetëm në fushën e ekzaminimeve kriminalistike. Duhet të theksojmë se programi i zhvilluar në këto kurse ishte po ai kurseve nëntë mujore (duke hequr pjesën juridike) pra, ai i një formimi të gjithanshëm. Në fund, jepej një dëshmi që kishte vlerë vetëm për vendin e ngjarjes.

Nga viti 2007 e në vazhdim, u zhvillua po i njëjti kurs, me të njëjtin program e shtrirje kohore, por dëshmia jepej për gjithë fushat e ekzaminimeve pasi programi ishte i tillë. Teorikisht, pas kursit të formimit parashikohej një vit praktikë në terren, por pa pasur të drejtë firme në akte ekspertimi, etj. Kjo është praktika e ndjekur deri më sot. Pra, nëse kursi përfundon me sukses, atëherë specialisti pajiset me dëshminë e ekspertit kriminalist sipas të cilës ai ka të drejtë të kryejë ekspertime kriminalistike, pa cituar këtu fushat konkrete pasi presupozohet se ai është tashmë i aftë në të gjitha fushat (në bazë të programit të zhvilluar). Kjo është një metodë mjaft klasike e formimit të ekspertit kriminalist dhe ka mëse 25 vjet që zbatohet tek ne pa asnjë ndryshim, me përjashtim të atyre kurseve që u përmendën më lart. Kjo metodë formimi është bazuar në disa arsye:

- tradita e formimit dhe e përgatitjes së ekspertëve kriminalistë të trashëguar nga metodat ruse të aplikuara më parë, ku në të gjitha fushat synohej në një formim të përgjithshëm të kuadrove në përgjithësi;

- numri i kufizuar i ekspertëve kriminalistë në qendër e sidomos në bazë;

- ekspertët kriminalistë në bazë, deri rreth vitit 2000 dispononin kartotekat e rretheve të veta dhe kryenin vetë pothuaj të gjitha llojet e ekzaminimeve, sado të pakta në numër krahasuar me ditët e sotme;

- mungesa e infrastrukturës teknike sillte kufizimin e punës së ekspertit vetëm brenda rrethit ku ai punonte, pa pasur mundësi konsultimi me kartotekat e rretheve të tjera (kërkohej vetëm me emra apo ngjarje konkrete në bazë të informacioneve që disponoheshin);

¹ Ligji nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", neni 40.

² "Rregullore e Policisë së Shtetit", miratuar me VKM nr. 750, dt. 16. 09. 2015, nenet 153-155.

- kërkesat ndaj punës së ekspertit kriminalist nuk ishin aq rigorozë si në ditët e sotme, shtuar këtu kërkesat gjithnjë e në rritje nga organi i prokurorisë e gjykatës, në drejtim të mënyrës së administrimit të provës.

Pas vitit 2000, me aplikimin e programit “Për modernizimin e policisë shkencore shqiptare”³, ndryshuan pothuaj tërësisht metodat e zbulimit, marrjes dhe administrimit të gjurmëve daktiloskopike, si në vendngjarje ashtu dhe në kushte laboratorike, përpunimi kimiko-fizik i tyre, etj. Kjo u shoqërua edhe me aplikimin e sistemeve automatike të krahasimit të gjurmëve të duarve (gishtave e pëllëmbëve) dhe të atyre balistike, ku këto të fundit, krahas aspektit teknik të krahasimit, luajnë një rol mjaft të madh për sa i përket dhe mënyrës e sigurisë së administrimit të këtyre gjurmëve e rrjedhimisht provave që burojnë prej tyre.

3. Analiza e praktikës aktuale të punës së ekspertit kriminalist

Në ditët e sotme, vihet re mjaft qartë që përballë kërkesave të kohës, asnjë ekspert kriminalist nuk mund të jetë i aftë në të gjitha fushat. Konsiderimi i kundërt ndikon ndjeshëm në cilësinë e punës e gjithashtu në efektivitetin e saj. Po ashtu, nga organet e prokurorisë e gjykatës të cilët kanë të drejtë të caktojnë nominalisht ekspertin për kryerjen e një ekzaminimi, mund të abuzohet mjaft lehtë me këtë fakt pasi nga pikëpamja ligjore ata janë konform ligjit. Po të studiojmë praktikën e aktivitetit konkret të ekspertëve kriminalistë në laboratorët rajonalë kriminalistikë dhe në IPSH⁴, rezultojnë se në dhjetë ekspertë kriminalistë në shkallë vendi, katër ekspertë gjithë kohën kryejnë vetëm veprime në vendin e ngjarjes; katër të tjerë kryejnë veprime në vendngjarje dhe ekzaminime ndërsa dy ekspertë kryejnë vetëm ekzaminime. Po të bëjmë një ndarje, në aktivitetin e përgjithshëm të policisë shkencore, 60% janë veprime në vendngjarje (rreth 18.000) dhe 40% janë ekzaminime kriminalistike (rreth 15.000)⁵. Nga këto të fundit, duke përjashtuar ekzaminimet kimike, biologjike dhe ato kompjuterike të cilat lidhen me formim të veçantë, rezultojnë se:

- 62% janë ekzaminime vlerësim gjurmësh daktiloskopike (30%) dhe krahasime (32%),
- 21% balistike e traseologjike,
- 12% grafike e dokumentesh,
- 5% të tjera (kryesisht ekspertime të numrave të shasive të mjeteve).

Pra nga sa më lart vihet re se në veprimtarinë e ekspertëve kriminalistë, pjesën më të madhe e dominojnë veprimet në vendin e ngjarjes. Nga rreth 2000 akte ekspertimi që kryhen në vit nga ekspertët e laboratorëve rajonalë kriminalistikë pranë drejtorive të policisë së Qarkut, rreth 1900 prej tyre janë përcaktim i gjendjes teknike armë zjarri, ekspertim armë e ftohtë dhe ekspertim numri shasie mjete, që në përgjithësi janë ekzaminime të thjeshta dhe vetëm 100 (apo 5%) janë ekspertime të llojeve të tjera, më të vështira, si daktiloskopike, grafike të thjeshtë, identifikim me anë të fotografisë, etj. Në IPSH, çdo eksperti kriminalist, duke marrë si masë vlerësimi aktet e ekspertimit, i takojnë mesatarisht rreth 360-400 akte ekspertimi në vit. Aktet e ekspertimit janë të së

³ Ky program startoi në vitin 1999 dhe përfundoi në vitin 2009. Ai u zbatua nga policia e Essex, Britani e Madhe dhe u financua nga BE nëpërmjet Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, Tiranë.

⁴ Analizat vjetore 2007-2013, të policisë shkencore.

⁵ Analizat vjetore 2007-2013 të policisë shkencore.

gjitha llojeve, pra balistike, traseologjike, vlerësuese daktiloskopike, daktiloskopike, grafike e dokumentesh. Këtu nuk llogariten punimet e tjera teknike apo procedurale, si ato për zbulimin e gjurmëve në objekte, këqyrje e vendngjarjeve të rënda, kryerja e eksperimenteve hetimore, regjistrimet në kartoteka të kartelave daktiloskopike, balistike, etj. Në IPSH, kryerja e ekzaminimeve kryhet sipas sektorëve përkatës. Pra, shtrohet pyetja: “A është me të vërtetë efektive të shpenzohet një periudhë kohore katërmujore duke nënkuptuar këtu lektorët, materialin e përgatitur, ambientet, etj., të cilat secila kanë koston e tyre, për të përgatitur një ekspert kriminalist të përgjithshëm, ndërkohë që në praktikë atij do t’i duhet të verë në përdorim vetëm një të katërtën e atyre njohurive të thelluara që ka marrë gjatë formimit në kurs?”. Mendoj që përgjigja, automatikisht, është: “Jo!”.

Siç e kemi përmendur më parë, gjatë viteve të fundit, në policinë shkencore ka ndryshuar pothuaj tërësisht mënyra e të punuarit. Kështu janë përqendruar në IPSH kartotekat daktiloskopike e balistike, janë përqendruar ekzaminimet kriminalistike, janë futur në përdorim sisteme automatike e aparatura të cilat i japin një dimension të ri mënyrës së ekzaminimeve, po ashtu është ndryshuar tërësisht metodika e zbulimit dhe marrjes së gjurmëve në vendngjarje dhe administrimi i tyre, fotografimi, et; janë shtuar lloje të reja e mjaft të specializuara ekzaminimesh si ato kimike lidhur me lëndët narkotike dhe biologjike duke realizuar ekzaminimet me anë të ADN, ekzaminimet kompjuterike, etj.

4. Kërkesat që shtrohen sot ndaj ekspertit kriminalist në fokusin e zhvillimeve aktuale të kriminalitetit

Aktualisht, shoqëria botërore po përballlet me forma të reja kriminaliteti të cilat po cenojnë seriozisht sigurinë kombëtare e më gjerë, atë rajonale. Krimi i organizuar po shfaqet në formën më të egër e më të sofistikuar të tij, duke u ndërthurur, bashkëpunuar e në mjaft raste duke shërbyer si bazë financimi edhe për terrorizmin. Bashkëpunimi mes organizatave kriminale e terroriste ka kaluar me kohë kufijtë shtetërorë e rajonalë, por sot ato po shfaqen mjaft të rrezikshme si pasojë e shfrytëzimit të ndërsjellë të aktiviteteve të njëra-tjetrës. Vetëm dy vitet e fundit vërehet një rritje galopante e terrorizmit, shoqëruar me trafik të qenieve njerëzore, trafik të lëndëve narkotike, kontrabandë, emigracione masive, etj. Përballë këtij realiteti, policia shqiptare është munduar të përshtatet, pavarësisht se aspekti terrorist, të paktën në dukje, nuk është shqetësues në vendin tonë. Në vorbullën e këtyre zhvillimeve, përpara policisë shkencore shqiptare shtrohen kërkesa të cilat synojnë si anën cilësore të ekzaminimeve edhe gamën e tyre, por dhe shpejtësinë dhe arrijten në konkluzione në kohë reale. Kjo kërkon një përgatitje specifike mjaft të thelluar të ekspertit kriminalist dhe kjo, është e pamundur që të arrihet për të gjithë ekspertët, në të gjitha fushat. Aq më tepër që, me metodikat, teknologjinë dhe aparatat e sotme, eksperti klasik (i balistikës, daktiloskopisë apo grafikës e dokumenteve) duhet të ketë njohuri që i tejkalojnë ato fillestare edhe në fushën e kimisë, fizikës, atë kompjuterike, etj., të cilat nuk mund të arrihen bazuar vetëm në formimin e përgjithshëm⁶.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

⁶ Ekzaminimet e mbetjeve të faktorëve plotësues të çitjes me anë të mikroskopit elektronik, përpunimet kimike dhe fiziko-luminishente për zbulimin e gjurmëve të duarve, ekzaminimet fiziko-luminishentë të dokumenteve e grafikë, etj.; përdorimi i sistemeve automatike të identifikimit të gjurmëve të duarve AFIS dhe atyre balistike ARSENAL, etj.

Bashkëpunimi policor ndërkombëtar ka dhe aspektin e tij për sa i përket policisë shkencore. E ardhmja është drejt unifikimit të metodave e praktikave, aksesëve të ndërsjella në sistemet automatike tip “data-base”, të identifikimit, etj. Në këtë funksion është dhe procesi i akreditimit⁷ të laboratorëve të policisë shkencore ku synohet standardizimi i metodikave, përshtatja sipas standardeve dhe kontrolli i aparaturave e pajisjeve, standardizimi i niveleve të besueshmërisë, rrjedhimisht standardizimi e besueshmëria e konkluzioneve dhe njohja e pranimi i tyre si të mirëqena nga organet procedurale e gjyqësore të vendeve të tjera. Të gjitha sa më lart janë pasqyruar në standardet ndërkombëtare ISO 9001, ISO 17020 dhe ISO 17025 të detyrueshme për zbatim për vendet e BE-së dhe aspiruese për në BE⁸.

Theksojmë, se tashmë janë hedhur hapat e para drejt akreditimit. Pra, mbështetur në gjithë analizën e shtjelluar më lart, mendoj se duhet të ndryshojë mënyra e formimit të eksperteve kriminalistë.

5. Ndryshimet në mënyrën e formimit të ekspertëve kriminalistë

Para ekspertit kriminalist, sot paraqitet një realitet shumë i ndryshëm nga ai i disa viteve më parë. Ndryshimi i teknikës që ai ka në dispozicion, metodat e reja të realizimit të veprimtarisë së tij, etj., shoqërohen edhe me një kërkesë gjithnjë e në rritje nga organi prokurorisë e gjykatës për administrimin ligjor të provës. Po ashtu para ekspertit kriminalist shtrohen pyetje mjaft specifike lidhur me konkluzionet e ekzaminimeve dhe në ditët e sotme, eksperti duhet të paraqitet në një numër mjaft të konsiderueshëm rastesh edhe para organit të gjykatës për të shpjeguar aktin e ekspertimit dhe për të mbrojtur konkluzionet e arritura. Të gjitha sa më lart, brenda një fushe të caktuar, nuk mund të realizohen pa pasur njohuri mjaft më të thelluara se më parë. Në këtë kuadër, mënyra e formimit të ekspertëve kriminalistë duhet të ndryshojë. Ajo duhet të synojë në përgatitjen e një eksperti kriminalist, i cili duhet të marrë njohuri për sa i përket bazës ligjore e nënligjore që normon veprimtarinë e tij, njohuri të përgjithshme mbi legjislacionin penal e procedural, si dhe ta përgatisë atë në anën teknike duke u fokusuar ndjeshëm në një fushë specifike.

5.1. Formimi fillestar

Formimi fillestar i tij duhet të konsistojë në marrjen e njohurive të përgjithshme për bazat teoriko-teknike të ekspertimit, llojet e ekzaminimeve që kryhen si dhe ato të jenë të tilla që eksperti të jetë në gjende të kryeje disa ekzaminime të thjeshta teknike dhe të synojë më tepër në *aftësimin e tij për kryerjen e veprimeve në vendin e ngjarjes* siç janë këqyrja e vendngjarjes⁹, aplikimi i teknikave për zbulimin e provave dhe gjurmëve në vendngjarje, fiksimin e tyre dhe në fund marrjen dhe administrimin. Këtu përfshihet dhe përgatitja e ekspertit në fushën e fotografisë. Mendoj se është me vend që të kujtoj se veprimet e kryera në vendngjarje janë nga veprimet procedurale më të rëndësishme që kryhen gjatë hetimit të një krimi. Një provë apo një gjurmë (p.sh. një gjurmë gishti) e zbuluar, e fiksuar dhe e marrë konform metodikave kriminalistike, e administruar

⁷ Dearing, Paul dhe Jacqueline Grace. *Raporti strategjik për Policinë Shkencore shqiptare*. Tiranë: 2012, f. 42.

⁸ ISO është Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin.

⁹ *Kodi Procedurës Penale*, nenet 198-201.

konform procedurave ligjore, në shumë raste është një element kyç i hetimit për identifikimin e autorëve dhe provimin e fajësisë së tyre. Ekspertët e vendit të ngjarjes duhet të jenë të ndërgjegjshëm që në atë prove apo gjurme të gjetur e fiksuar prej tij, mbështetet e gjithë puna e ekspertëve të tjerë kriminalistë që kryejnë ekzaminime kriminalistike të mëpasshme.

5.2. Kohëzgjatja dhe programi i kursit të formimit fillestar

Duke analizuar programet e kurseve 3-4 mujore të zhvilluara pothuaj çdo vit nga ana e IPSH, duke kryer mjaft ndryshime e përmirësime që konsistojnë në trajtimin e metodave e teknikave të reja, duke përmbledhur në njohuri të përgjithshme për ekzaminimet në fusha të përcaktuara, por duke trajtuar mjaft hollësisht veprimet në vendngjarje, rezulton që formimi fillestar i ekspertit kriminalist, të kryhet në një kurs me kohëzgjatje rreth dy muaj (afërsisht 150 orë).

Kursi duhet të jetë teoriko-praktik. Programi i këtij kursi, në vija të përgjithshme duhet të konsistojë në objektin e punës së ekspertit kriminalist dhe njohuri të përgjithshme mbi fushat ku shtrihet ky aktivitet; në bazën ligjore të aktivitetit të ekspertit kriminalist dhe aktet nënligjore që e normojnë atë; gjurmët dhe llojet e tyre, njohuri mbi mekanizmin e formimit të gjurmëve (e detajuar); këqyrja e vendngjarjes (e detajuar); zbulimi, fiksimi dhe marrja e gjurmëve të së gjitha llojeve e provave në vendngjarje, ambalazhimi dhe administrimi i tyre (të detajuara); teknikat e fotografimit në vendngjarje (e detajuar); njohuri mbi armët e zjarrit, municionet dhe përcaktimi i gjendjes teknike të tyre; njohuri mbi armët e ftohta dhe përcaktimet mbi to; njohuri të përgjithshme mbi llojet e ekzaminimeve kriminalistike, etj. Të gjitha duhet të shoqërohen me veprime konkrete praktike¹⁰.

Për këto të fundit (aspektin praktik), vetë IPSH e ka atë dinamikë pune për sa i përket ekzaminimeve që lidhen me anën praktike të kursit. Po ashtu, lidhur me veprimet në vendngjarje, Laboratori Rajonal Kriminalistik i Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë kryen mesatarisht tetë deri në dhjetë vendngjarje të shumëllojshme në ditë, pra është mundësia që të praktikohen veprime edhe në vendngjarje konkrete. Programi konkret duhet të hartohet në bashkëpunim me IPSH dhe Akademinë e Sigurisë, në mënyrë që ai të jetë sa më i kompletuar si nga ana teknike, ashtu dhe nga ana pedagogjike e administrative.

Në përfundim të formimit fillestar, eksperti duhet të kalojë në një provim për gjithë njohuritë e marra gjatë kursit. Provimi konsiston në kontroll si të njohurive teknike teorike, po ashtu dhe në praktikë, shoqëruar me raste konkrete praktike. Nëse provimi kalon me sukses, atëherë kandidati (tashmë specialist) duhet të pajiset me një certifikatë apo dëshmi, ku të cilësohet që është i aftësuar për veprimet në vendngjarje dhe për ekzaminime të thjeshta kriminalistike. Kjo duhet të normohet me akte nënligjore ku të jenë të përcaktuara saktë llojet dhe nivelet e ekzaminimeve që mund të kryhen prej tij. Pas formimit fillestar të përshkruar më lart, mendoj se çdo ekspert kriminalist duhet të punojë për një periudhë jo më pak se tre vjet në laboratorët rajonalë kriminalistikë pranë drejtorive të policisë së Qarkut, pra të kryejë në praktikë veprimet në vendin e ngjarjes dhe disa ekzaminime të thjeshta. Dy muajt e parë të kësaj periudhe të jenë pa të drejtë firme pra një periudhe e mirëfilltë praktike në terren. Vetëm pas kësaj periudhe, eksperti kriminalist mund të kalojë në fazën tjetër të formimit të cilin po e quajmë

¹⁰ Colin, Evans. *Crime Scene investigation*. New York: 2009, f. 15.

formim të specializuar.

- Formimi i specializuar konsiston në formimin e ekspertit kriminalist në një apo disa fusha të caktuara që lidhen me njëra-tjetrën. Pra, eksperti kriminalist mund të specializohet në fushën e ekzaminimeve vetëm balistike apo balistiko-traseologjike, të vlerësimit të gjurmëve daktiloskopike dhe krahasimit të tyre, të ekzaminimeve grafike dhe ato teknike të dokumenteve, etj. Gjatë këtij formimi eksperti duhet të marrë njohuri të hollësishme, të plota dhe specifike në fushën përkatëse, duke mësuar të gjitha metodat dhe teknikat e ekzaminimit, të mësojë kapacitetet dhe funksionimin e pajisjeve dhe sistemeve që posedohen dhe të aftësohet t'i përdorë ato. Gjithashtu ai duhet të krijojë një "modus operandi"¹¹ të saktë lidhur me ekzaminimin në të gjitha fazat e tij, duke filluar nga ato përgatitore e deri në arritjen e konkluzioneve e përpilimin e aktit të ekspertimit, p.sh., në një ekspertim balistik: kontrolli i armës, zgjedhja dhe kontrolli i fishekëve, përgatitja për qitje, kryerja e qitjes për marrjen e gëzhgojave apo predhave, pastrimi tyre, këqyrja e provave balistike - objekt ekspertimi e model krahasimi, - përcaktimi i karakteristikave të përbashkëta e të veçanta të gjurmëve të lëna në to nga mekanizmat e qitjes, krahasimi ndërmjet tyre, konkludimi, përpilimi i aktit bashkë me tabelën fotografike, plotësimi i kartelës të provave balistike, etj.¹²

I gjithë procesi i mësipërm duhet të shtrihet në dy aspekte: atë teorik dhe atë praktik, por duhet theksuar se nëse aspekti teorik mund të ezaurohet tërësisht nga lektorët dhe të përvetësohet mjaft mirë nga kursantët, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për aspektin praktik, pasi sot është provuar që një ekspert të arrijë të kryejë praktikisht ekzaminime e të arrijë në mënyrë të pavarur në konkluzione, duhet të kalojë një stazh praktik pune të paktën gjashtëmuor në fushën përkatëse.

5.3 Kohëzgjatja dhe programi i kursit të formimit të specializuar

Kjo përcaktohet duke u mbështetur në pjesët e programeve të kurseve 3-4 mujore, që kanë të bëjnë me përgatitjen në fusha të veçanta të kriminalistikës (kjo varet shumë dhe nga fusha konkrete), po ashtu dhe në njohuritë e reja që duhet të implementohen në këto programe. Kështu p.sh., programi teorik i përgatitjes në fushën e ekzaminimeve balistike është relativisht më i përmblendhur sesa ai i fushës së ekzaminimeve grafike dhe teknike të dokumenteve, ndërkohë që aspekti praktik paraqitet diçka më ndryshe.

Në këtë logjikë, nga studimi sa më lart dhe analizat e zhvilluara, rezulton se kohëzgjatja e programeve të përgatitjes teorike (përfshirë këtu edhe ilustrime praktike) varion 4-6 javë (afërsisht 70-90 orë) dhe kjo varet nga fusha konkrete. Ky program teorik duhet të shoqërohet patjetër me një stazh praktik në sektorin përkatës, i cili duhet të zgjasë jo më pak se dy muaj (afërsisht 150 orë) në mënyrë që eksperti të aftësohet në drejtim të njohurive konkrete praktike, të arrijë të kryejë vetë të gjitha fazat e ekzaminimeve direkt nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e specialistëve të fushës - kuptohet pa të drejtë firme. Pas kryerjes së stazhit praktik, kandidati duhet të kalojë në provimin për njohuritë teorike dhe praktike të trajtuara gjatë kursit teorik dhe stazhit praktik. Provimi duhet të shoqërohet dhe me ushtrime konkrete praktike.

Nëse provimi kalon me sukses, atëherë specialisti duhet të pajiset me një certifikatë apo dëshmi ku të cilësohet, që është i aftësuar për kryerjen e ekzaminimeve në fushën e cituar. Kjo duhet të normohet me akte nënligjore ku të jenë të përcaktuara saktë llojet

¹¹ Lat. *mënyrë veprimi.*

¹² Matheus, Howard. *Firearms Identification*, vol. I (bot. i dytë). Illinois: 1973, f. 7.

dhe nivelet e ekzaminimeve që mund të kryhen prej tij. Edhe pas përfundimit të formimit të specializuar, mendoj se për një periudhë gjashtëmujore, specialisti mund të fillojë të kryejë ekzaminime me nivel vështirësie deri tek ai i mesëm edhe të hartojë akte ekspertimi ku të firmosë vetëm i dubluar nga një specialist tjetër me përvojë dhe stazh pune. Duhet të theksojmë se sa më lart, kuptojmë fillësen e formimin të ekspertit kriminalist në këtë fushë. Më pas, në kuadrin e formimit të vazhduar, ai mund dhe duhet të specializohet më tej me anë të kurseve specifike për problematika të ndryshme¹³.

Theksojmë se në praktikën europiane, formimi i plotë i një eksperti kriminalist në një fushë të caktuar zgjat tre deri në pesë vjet. Edhe njëherë sjellim në vëmendje që programet konkrete duhet të hartohen në bashkëpunim të IPSH me Akademinë e Sigurisë, e cila duhet të ketë dhe akreditimin përkatës.

6. Përfundime

Policia shkencore duhet të ndjekë zhvillimin e modernizimin e policisë në mënyrë që t'i përgjigjet në lartësinë e duhur kërkesave që shtrohen para saj në luftën kundër kriminalitetit i cili sa vjen e përsos metodat e organizimin e tij. Mënyra e formimit të ekspertëve kriminalistë duhet t'i përshtatet këtij zhvillimi duke gjetur ato forma e mënyra që sjellin një thellim specifik të njohurive. Kjo nuk mund të arrihet me formimin klasik të tyre që është ndjekur deri më sot pasi është e pamundur që një ekspert kriminalist të jetë i specializuar në të gjitha fushat ku shtrihet aktiviteti i ekspertizës kriminalistike. Duke pasur parasysh edhe përvojën e vendeve të tjera, mendojmë që ky formim duhet të jetë i tillë që të iniciohet me një formim të përgjithshëm deri në nivelin mesatar shoqëruar detyrimisht me njohuri të thelluara në këqyrjen e vendit të ngjarjes. Më pas, duke kaluar paraprakisht dhe një stazh pune të paktën tre vjet, në varësi të sektorit përkatës, eksperti kriminalist duhet të formohet në mënyrë specifike e të thelluar në një fushë të caktuar apo disa fusha por që lidhen me njëra-tjetrën, në të cilën të vazhdojë gjatë karrierës së tij dhe formimin e vazhduar.

Për sa më lart, mendoj që formimi fillestar të pajisë ekspertin me njohuri të përgjithshme për bazat teoriko-teknike të ekspertimit, për llojet e ekzaminimeve që kryhen (dhe ato të jenë të tilla, që eksperti të jetë në gjende të kryejë disa ekzaminime të thjeshta teknike), për këqyrjen e vendngjarjes (aplikimin i teknikave për zbulimin e provave dhe gjurmëve në vendngjarje, fiksimin e tyre dhe në fund marrjen dhe administrimin). Këtu përfshihet dhe përgatitja e ekspertit në fushën e fotografisë. Formimi fillestar të jetë teoriko-praktik dhe me kohëzgjatje rreth dy muaj (afërsisht 150 orë). Formimi i specializuar duhet të pajisë ekspertin kriminalist me njohuri të hollësishme, të plota dhe specifike në fushën përkatëse, duke mësuar të gjitha metodat dhe teknikat e ekzaminimit, të mësoje kapacitetet dhe funksionimin e pajisjeve dhe sistemeve që posedohen dhe të aftësohet t'i përdorë ato. Ky formim të ketë një kohëzgjatje nga 4-6 javë (afërsisht 70-90 orë) dhe kjo varet nga fusha konkrete, i ndjekur nga një kurs tërësisht praktik në IPSH me kohëzgjatje rreth 150 orë.

¹³ Dearing, Paul dhe Jacqueline Grace. "Rekomandimet" në, *Raporti strategjik për Policinë Shkencore shqiptare*. Tiranë: 2012, f. 43, 46-51.

Literatura

1. Dearing, Paul dhe Jacqueline Grace. *Raporti strategjik për Policinë Shkencore shqiptare*. Tiranë: 2012.
2. Houck, Max M. *Forensic sciences; Modern methods of solving crime*. USA 2007.
3. White, Peter (red.). *Crime Scene to Court; The Essentials of Forensic Science*. Lincoln, UK: University of Lincoln, 2004.
4. Matheus, Howard. *Firearms Identification, vol. I* (bot. i dytë). Illinois: 1973
5. Colin, Evans. *Crime Scene investigation*. New York: 2009.
6. Analizat vjetore te Policise Shkencore 2007-2013.
7. "Kodi i Procedurës Penale të Shqipërisë", i ndryshuar.
8. Ligji nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit".
9. "Rregullore e Policisë së Shtetit", miratuar me VKM nr. 750, dt. 16.09.2015.

Zhvillimi i procedurës penale ndaj të miturve

MRLI Nebi HALILI

*Shërbimi Korrektues i Kosovës
nebih.halili@ks-gov.net*

Abstrakt

Të analizosh sistemin e drejtësisë penale për të miturit në Kosovë, është një detyrë shumë komplekse. Kjo, sepse në këtë janë të përfshira çështje që kanë të bëjnë me ligjin dhe standardet e tij, me institucionet përgjegjëse, strukturat, nivelin e kompetencës dhe të përgjegjshmërisë së tyre, burimet njerëzore kualifikimin dhe pamjaftueshmërinë e tyre, politikat dhe mënyrën e adresimit të tyre dhe padyshim edhe mënyrën e zbatimit të ligjeve si edhe qëndrimeve subjektive ndaj politikave të caktuara, etj. Të bësh një analizë objektive të administrimit të sistemit të drejtësisë për të mitur kërkohet që të merresh me shumë komponentë, që kanë të bëjnë jo vetëm me të lexuarit e ligjit, por edhe të një sërë vendimesh në bazë dhe për zbatim të tij. Kërkohet që të gjitha analizat dhe deduksionet t'i përgjigjen pyetjes: sa është mbajtur parasysh interesi më i lartë i fëmijës? A është i mirë apo i keq administruar sistemi i drejtësisë për të mitur? Sa është qasja me standardet ndërkombëtare, etj?

AKADEMIA
E SIGURISË

Fjalëkyçe:

procedurë penale ndaj të miturit, shqyrtim gjyqësor, sistemi i drejtësisë për të mitur, ndalimi policor, paraburgimi i të miturve.

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

1. Hyrje

Një i ri, shpeshherë gjykon dhe i përjeton veprimet dhe mendimet e veta, ndryshe nga të rriturit dhe, për këtë arsye, edhe në procedurën penale duhet të ketë qasje ndryshe veprimi. Kriminaliteti i të miturve është një fenomen për të cilin kanë shkruar shumë autorë të cilët kanë dhënë edhe definicione të ndryshme. Në këtë aspekt, ata kanë marrë në konsideratë veçoritë biologjike, psikologjike dhe sociologjike të cilat karakterizojnë të miturit. Së këndejmi, ata e kanë trajtuar kriminalitetin e të miturve në aspektin kriminologjik, kriminalistik, etj. Në këtë aspekt, duhet të përmendim edhe veçoritë dalluese të kësaj kategorie së të miturve në kryerjen e veprave penale, në mënyrën e organizimit të tyre nëpër grupe problematike dhe kryerjen e veprave të dëmshme kriminale për shoqërinë, deri te format më të rënda të kriminalitetit. Me kriminalitetin e të miturve nënkuptojmë tërësinë e të gjitha krimeve të kryera në një kohë, hapësirë dhe periudhë të caktuar nga të miturit. Kriminaliteti është dukuri masive e që përmbledh në vete të gjitha format e krimeve të cilat kryhen në një vend.¹

2. Vështrim i përgjithshëm për procedurën penale ndaj të miturve

Në Kosovë, procedura ndaj të miturve të cilët kanë kryer vepra penale, rregullohet me Kodin i Drejtësisë për të Mitur, i vitit 2010 Kodi nr 03/L-193² dhe në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës si dhe ligjin “Për ekzekutimin e sanksioneve

¹ Halili R. *Kriminologjia*,..., Prishtinë: 2007, fq. 21.

² Kodi i Drejtësisë për të Mitur, i vitit 2010, Kodi nr 03/L-193.

penale”. Me këtë kod (Kodin e Drejtësisë për të Mitur), janë paraparë dispozitat materiale dhe procedurale-juridike si dhe dispozitat tjera, të cilat kanë të bëjnë me kryerësit e mitur të veprave penale e të cilat, janë të ndryshme nga ato që kanë të bëjnë me kryerësit madhorë të veprave penale. Këto norma ligjore e përcaktojnë pozitën e të miturve në procedurën penale dhe në të drejtën penale, duke iu dhënë përparësi masave alternative dhe të integritimit social të së miturve. Ato venë gjithashtu në pah, ndarjen e të miturve nga të rriturit e moshës madhore, duke penguar ndikimet negative të delinkuentëve të moshës madhore. Krahas të cekurave, ky kod përmban edhe dispozitat mbi veprat penale të cilat kryhen në dëm të fëmijëve. Dispozitat specifike të së drejtës materiale dhe përmbauese për të miturit, lidhen për moshën e të miturve, madje si për kohën e kryerjes, ashtu edhe për kohën e gjykimit së të miturit, gjegjësisht ekzekutimit të sanksionit penal.

Në këtë kuptim, për të miturit, të cilët kryejnë vepra penale, ekzistojnë rregulla të përpunuara dhe të përshtatura të procedurës specifike penale. Ky grup i posaçëm i rregullave procedurale, do të duhej të siguronte procedurë të tillë, në të cilën do të mbroheshin të drejtat e të miturve si pjesëmarrës në procedurë. E rëndësishme është se procedura specifike ndaj të miturve, zbaton edhe standardet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me pozitën e kryesit të mitur të veprave penale, me ç’rast shprehen përpjekjet për mbrojtjen e garancive procedurale dhe të drejtave të njeriut. Qëllimi i dënimit së të miturit, nuk paraqet kërkimin e përgjigjes ekskluzive për çështjet e caktuara, por gjykimi i të miturit mbështetet para së gjithash në kërkimin e masave më të përshtatshme për integrimin e tij pozitiv në shoqëri.³

3. Karakteristikat themelore të procedurës ndaj të miturve

Duke u bazuar në dispozitat penale me të cilat rregullohen heshtjet penale që kanë të bëjnë me të miturit, mund të konkludohet se, si veçori të procedurës penale, e cila zhvillohet ndaj kësaj kategorie të kryerësve të veprave penale janë:

- Procedura penale ndaj të miturit zbatohet ndaj personave që kanë kryer vepër penale, si, të mitur 14-18 vjeç dhe të cilët, në kohën e fillimit të procedurës apo të gjykimit, kanë mbushur 21 vjeç. Në këtë rrjedhë duhet sqaruar se disa nga dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur, aplikohen edhe në procedurën ndaj madhorit, i cili në kohën e gjykimit nuk ka mbushur moshën 21 vjeçare. Po ashtu, në qoftë se gjatë zhvillimit të procedurës penale personi i caktuar nuk i ka pasur 14 vjet, procedura penale pushohet me aktvendim, pasi persona të tillë nuk konsiderohen penalisht përgjegjës.⁴

- I mituri nuk mund të gjykohej në mungesë. Nëse i mituri i thirrur me rregull, nuk paraqitet në shqyrtim dhe mungesën e tij nuk e arsyeton, gjyqtari për të mitur lëshon urdhërarrestin ose e shtyn shqyrtimin dhe urdhëron që i mituri të shoqërohet në gjykatë, në seancën e radhës.

- Në procedurën penale kundër të miturit, karakteristikë është paraqitja e prindit ose e organit të kujdestarisë. Kështu, sipas zgjedhjeve të dhëna në Kodin e Drejtësisë për

³ Sahiti, Ejup dhe Murati, Rexhep. *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë: 2013, fq. 426.

⁴ *Kodi Penal i Kosovës*.

të Mitur, prindi, prindi adoptues dhe kujdestari i të miturit, kanë të drejtë ta shoqërojnë të miturin në tërë procedurat gjyqësore. Ata mund të detyrohen të marrin pjesë në procedurën penale nëse kjo çmohet si në interes të së miturit. Sa i përket organit kujdestarisë, ligdhënësi e ka paraparë që prokurori i shtetit ta njoftojë atë kurdoherë që fillon procedurën penale ndaj të miturit, kurse gjyqtari për të mitur varësisht nga situata konkrete mund të lejojë pjesëmarrjen e përfaqësuesit të autorizuar të organit të kujdestarisë, që të marrë pjesë në procedurë me qëllim që të njoftohet me rrjedhën e procedurës, por ai ka të drejtë të bëjë edhe propozime dhe të paraqesë fakte e prova të rëndësishme për marrjen e vendimit të gjyqtarit.

- Mbrojtja në procedurën penale për të mitur është e obligueshme. Ky obligim shtrihet që nga fillimi e deri në përfundim të procedurës penale. Së këndejmi, në rastet kur i mituri përfaqësuesi ligjor ose anëtari i familjes së tij nuk angazhojnë mbrojtës, gjyqtari për të mitur ose organi kompetent që e zbaton procedurën penale, emëron një mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike. Po ashtu edhe nëse i mituri mbetet pa mbrojtës gjatë rrjedhës së procedurës penale dhe ai nëse nuk mund të sigurojë tjetër mbrojtës, gjyqtari për të mitur ose organi kompetent, që e zbaton procedurën emëron tjetër mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike. Rrjedhimisht, i mituri duhet të njoftohet për të drejtën në mbrojtës me shpenzime publike, që me rastin e marrjes në pyetje për herë të parë. Më në fund, duhet theksuar fakti se të miturin mund ta përfaqësojë vetëm mbrojtësi i regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës.

- Në procedurën penale për të mitur, askush nuk mund të lirohet nga detyra për të dëshmuar mbi rrethanat që vlerësohen të nevojshme për konstatimin e zhvillimit psikologjik të së miturit, për njohjen e personalitetit të tij dhe kushteve në të cilat ai jeton.

- Në procedurën penale për të mitur nuk ka publicitet.⁵ Në dallim nga procedura penale për të rritur, procedura penale për të mitur, zhvillohet pa të ashtuquajturin publicitet të përgjithshëm. Mirëpo, publiciteti i kufizuar është i mundshëm. Së këndejmi, trupi gjykues për të mitur mund të lejojë që në shqyrtimin gjyqësor të asistojnë ekspertët dhe personat e tjerë që merren me mirëqenien dhe edukimin e të miturve. Megjithatë, në raste të jashtëzakonshme, trupi gjykues për të mitur mund të urdhërojë prindin, prindin adoptues, ose kujdestarin që të largohen nga seanca e shqyrtimit gjyqësor, por kjo mund të bëhet vetëm në rastet kur ka arsye të besohet se ndërmarrja e kësaj mase është në interes të së miturit.

- Procedura penale për të mitur zhvillohet më urgjencë. Sipas këtij Kodi të Drejtësisë për të Mitur, autoritetet ose institucionet që marrin pjesë në procedurën gjyqësore që kanë të bëjnë me të miturit, si dhe personat dhe institucionet e tjera nga të cilët kërkohen njoftime, raportime e mendime janë të obliguara që të veprojnë shpejtë dhe pa vonesa të paarsyeshme, (paragrafi 1 i nenit 40 i KDM). Në këtë aspekt, gjyqtari për të mitur e njofton kryetarin e gjykatës për çdo shterje ose ndërprerje të shqyrtimit gjyqësor, kurse ky i fundit detyrohet t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, që në kohën më të shkurtër të mundshme, të eliminohen shkaqet të cilat kanë sjellë deri të shtyrja ose ndërprerja e procedurës.

3.1. Rrjedha e procedurës ndaj të miturve

Procedura penale për të mitur kalon nëpër disa faza. Në kuadër të fazës të

⁵ KDM Neni 71.

procedurës paraprahe dallojmë procedurën përgatitore, pas së cilës prokurori i shtetit paraqet propozimin për ndjekje. Pason shqyrtimin gjyqësor dhe procedura me mjete juridike. Në procedurë ndaj të miturve, gjithashtu mund të zbatohet procedura e ndërmjetësimit. Edhe pse këto faza të procedurës për të mitur janë të ngjashme me fazat e procedurës ndaj personave madhorë megjithatë, këto nuk duhet të identifikohen ndër vete.

4. Procedura për ndërmjetësim

Edhe në procedurë ndaj të miturve ekziston instituti i ndërmjetësimit. Ndërmjetësimi është procedurë jashtëgjyqësore, e cila zhvillohet nga ndërmjetësuesi në pajtim me KDM dhe Ligjin për ndërmjetësim⁶. Ndërmjetësimi vjen në shprehje dhe ai mund t'u propozohet palëve, vetëm nëse ato kanë vullnet dhe shprehin pëlqimin për ndërmjetësim (neni 14 i KDM). Për dallim nga neni 232 i KPP, i cili mundësinë e aplikimit të procedurës për ndërmjetësim për persona madhorë e kufizon për vepra penale të ndëshkueshme me gjobë ose me burgim deri në tri vjet, kodi për të mitur, nuk përcakton as llojin e veprës penale e as lartësi konkrete të sanksionit si element për të propozuar ndërmjetësimin.

Këtë ia lë për vlerësim prokurorit të shtetit apo trupit gjykues për të mitur. Aty renditen: natyra e veprës penale; rrethanat në të cilat është kryer vepra penale; e kaluara e të miturit; mundësia e kthimit të raporteve normale në mes të miturit dhe palës së dëmtuar; mundësia e zvogëlimit të dëmit të palës së dëmtuar; mundësia e rehabilitimit të së miturit dhe riintegrimi i tij në shoqëri. Pëlqimi i palëve (të pandehurit dhe të dëmtuarit) për ndërmjetësim shënohet në procesverbal. Procedura e ndërmjetësimit nuk mund të zgjasë më shumë se 90 ditë nga dita kur prokurori apo gjyqtari ka nxjerrë aktvendimin për emërimin e ndërmjetësit.

Procedura e ndërmjetësimit përfundohet kur – ndërmjetësimi është kryer me sukses; – ka kaluar afati 90 ditësh; – konsiderohet se ndërmjetësimi nuk është i mundur ose është i paarsyeshëm; dhe – i mituri ose i dëmtuari deklarojnë se dëshirojnë ta ndërpresin procedurën e ndërmjetësimit. Për rezultatin e ndërmjetësimit, njoftohet zyrtarisht prokurori i shtetit apo gjyqtari për të mitur. Kur ndërmjetësimi ka sukses, pushohet procedura penale me aktvendim dhe për këtë njoftohen palët. Marrëveshja e arritur në procedurë të ndërmjetësimit dhe e miratuar nga prokurori i shtetit apo gjyqtari përbën titull ekzekutiv që ekzekutohet në pajtim me ligjin në fuqi.

Kur ndërmjetësimi nuk përfundon me sukses, prokurori ose gjyqtari i cili e ka propozuar ndërmjetësimin vazhdon procedurën penale të pezulluar. Procedura e ndërmjetësimit për të mitur është pa pagesë për palët. Shpenzimet e ndërmjetësimit, varësisht nga ajo se kush e ka urdhëruar ndërmjetësimin e paguan Këshilli Gjyqësor i Kosovës apo Këshilli Prokurorial i Kosovës (nenet 81 dhe 82 të KDM).

5. Fillimi dhe zbatimi i procedurës përgatitore

Në procedurën për të mitur, ndjekja ushtrohet ekskluzivisht sipas parimit të oficalitetit, sepse për të gjitha veprat penale, procedura fillon vetëm në bazë të kërkesës

⁶ Ligji "Për ndërmjetësim" Nr. 03/L-057

së prokurorit të shtetit. Prokurori i shtetit e fillon procedurën përgatitore në bazë të informacionit të fituar nga kallëzimi penal (i policisë ose i personave tjerë) ose nga burime të tjera nëse ekziston dyshim i bazuar se i mituri ka kryer veprë penale. Për veprat penale të cilat ndiqen sipas propozimit të së dëmtuarit, procedurën mund ta fillojë prokurori i shtetit kompetent, vetëm nëse atij ia ka paraqitur propozimin për fillimin e procedurës i dëmtuari. Parimi i legalitetit, sipas rregullit, zbatohet edhe në procedurë për të mitur. Mirëpo, duke u udhëhequr me qëllimin e procedurës për të mitur, ligjvënësi, në disa raste, lejon edhe zbatimin e parimit të oportunitetit (parimit të arsyeshmërisë). Në të vërtetë për veprat penale për të cilat është paraparë dënimi deri në tri vjet burgim ose gjoja, prokurori i shtetit mund të vendosë të mos fillojë procedurën përgatitore megjithëse ekziston dyshim i bazuar se i mituri ka kryer veprë penale, kur konsideron se, nuk do të ishte e përshtatshme të zbatohet procedura ndaj të miturit për shkak të natyrës së veprës penale, të rrethanave në të cilat është kryer ajo, mungesës së dëmit të rëndë ose të pasojave për viktimën si dhe të së kaluarës së të miturit dhe të karakteristikave të tij personale.

Procedura përgatitore duhet të përfundojë brenda 6 muajsh. Nëse nuk përfundon brenda këtij afati, prokurorimi shtetit i dorëzon gjyqtarit për të mitur kërkesë të arsyetuar me shkrim për vazhdimin e procedurës përgatitore, e cila vazhdohet në pajtim me dispozitat e KPP. Gjatë zhvillimit të procedurës përgatitore, i mituri duhet të ketë mbrojtës – avokat dhe duhet të njoftohet për rrjedhat gjatë grumbullimit të provave. Përveç prokurorit publik, gjatë procedurës përgatitore mund të paraqiten propozime për prova të reja edhe nga subjektet të tjerë.

Prokurori i shtetit e drejton rrjedhën e zhvillimit të procedurës përgatitore, vlerëson provat e grumbulluara dhe pas përfundimit të procedurës përgatitore vendos për paraqitjen e propozimit për shqiptimin e masës ose dënimit. Sipas KPP-së, procedura përgatitore për të mitur, është filluar me kërkesën e prokurorit publik për zhvillimin e procedurës përgatitore, ndërsa aktvendimin për fillimin e procedurës përgatitore e ka nxjerrë gjyqtari për të mitur. Me KDM, prokurori shtetit, është obliguar që të jetë aktiv në procedurë dhe të nxjerrë të gjitha provat me të cilat mbështetë propozimin për shqiptimin e masës edukative ose dënimit. Hapa më të avancuar në KDM, konsiderohen - masat e diversitetit, të cilat janë të parapara me këtë kod⁷; masa të cilat, janë të karakterit më favorizues për pozitën e të miturit me qëllim të riintegritit sa më të shpejtë në rrjedhat e përgjithshme shoqërore.

Gjithashtu, ndaj të miturve mund të shqiptohen edhe dënimet siç janë dënimi me gjobë, urdhri për punë në dobi të përgjithshme dhe burgimi për të mitur. Përndryshe, prokurori publik është prezentë gjatë tërë procedurës penale deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në paraqitjen e mjeteve të rregullta juridike - ankesës, si dhe mjeteve të jashtëzakonshme juridike, siç janë kërkesa për rishikimin e procedurës penale dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

6. Arrestimi i përkohshëm, ndalimi policor dhe paraburgimi për të miturit

Arrestimi i përkohshëm, ndalimi në polici dhe paraburgimi si masë për sigurimin e pranisë së të miturit në procedurë, urdhërohet vetëm si masë e fundit, për një kohë sa

⁷ KDM kapitulli IV faqe 8.

më të shkurtër të mundshëm. Policia mund të arrestojë dhe të ndalojë të miturin në pajtim me dispozitat e KPP lidhur me arrestin e përkohshëm dhe ndalimin, mirëpo, arresti dhe ndalimi i të miturit nuk mund të kalojnë periudhën 24 orë (nenet 64, 65 të KDM)⁸.

Gjyqtari për të mitur, e urdhëron paraburgimin ndaj të miturit përjashtimisht, nëse ekzistojnë kushtet për paraburgim nga neni 187 të KPP dhe nëse alternativat e paraburgimit nuk do të ishin të mjaftueshme për të siguruar praninë e të miturit, për të parandaluar kryerjen e serishme të veprës dhe për të siguruar zbatimin e suksesshëm të procedurës. Gjyqtari për të mitur shqyrton nëse masat tjera nga KPP për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë apo masat e parapara në nenin 6 të KDM (që kanë të bëjnë me vendosjen e fëmijës në strehimore, ose në institucion edukativ apo të ngjashëm, me vendosjen e fëmijës nën mbikëqyrjen e organit të kujdestarisë ose transferimin e fëmijës në familje tjetër, kur është e nevojshme ndarja e fëmijës nga ambienti ku ka jetuar ose për t' i afruar ndihmë, mbrojtje, strehim) mund të urdhërohet si alternativë për paraburgim.

Aktvendimi mbi paraburgimin e të miturit duhet të përfshijë një shpjegim të arsyetuar për pamjaftueshmërinë e alternativave kundruall paraburgimit. I mituri mund të qëndrojë në paraburgim, sipas aktvendimit të gjyqtarit për të mitur, më së shumti tridhjetë ditë, ndërsa kolegji për të mitur i gjykatës kompetente, për arsye të justifikueshme mund ta vazhdojë edhe për gjashtëdhjetë ditë. Mirëpo, trupi gjykues, duhet ta rishqyrtojë aktvendimin mbi vazhdimin e paraburgimit brenda një muaji nga marrja e aktvendimit dhe atë, në prani të të miturit, mbrojtësit të tij dhe të prokurorit të shtetit (neni 66 i KDM).

Kur personi i arrestuar nuk e ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjet, policia menjëherë pas arrestimit e lajmëron përfaqësuesin ligjor të personit të arrestuar për arrestimin dhe vendin e ndalimit dhe, për çdo ndryshim të mëvonshëm të vendit, të ndalimit, menjëherë pas ndryshimit të vendit të ndalimit. Kur lajmërimi i tillë është i pamundur ose do të ishte i dëmshëm për interesat e personit të arrestuar, apo shprehimisht refuzohet nga personi i arrestuar, policia e lajmëron qendrën për punë sociale (Neni 215 (2) KPPK).

Lajmërimi i anëtarëve të familjes dhe i personave të tjerë përkatës në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni mund të vonohet deri në 24 orë kur prokurori publik, çmon se kjo kushtëzohet me nevoja të jashtëzakonshme për hetimin e rastit. Vonesë të tillë nuk ka, kur personi i arrestuar është nën moshën tetëmbëdhjetë vjet ose tregon shenja të çrregullimit a të paaftësisë mendore (Neni 215 (4) KPPK). Privimi i lirisë do të shqiptohet vetëm si mjete i fundit dhe do të kufizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm. Gjatë privimit të lirisë së shqiptuar si dënim, kryerësit të mitur i ofrohet edukim, ndihmë psikologjike, e sipas nevojës edhe ndihmë mjekësore për të lehtësuar rehabilitimin e tij (Neni 3 KDM). Fëmijës që merr pjesë në procedurë penale i ofrohet mundësia që të shprehet lirisht (Neni 3 KDM).

7. Roli i prokurorit publik në procedurën për të mitur

Procedura përgatitore ndaj të miturve zhvillohet me kujdes të theksuar, në mbështetje të dispozitave të KPPK-së, si dhe instrumenteve dhe akteve të tjera

⁸ Nenet 64, 65 KDM.

ndërkombëtare⁹ që rregullojnë materien e të miturve.

Prokurori i shtetit në procedurën përgatitore për të mitur, nxjerrë aktvendimin për fillimin e procedurës përgatitore dhe prej atij momenti, i qaset nxjerrjes dhe grumbullimit të provave të nevojshme. Pasi të paraqitet kallëzimi penal, kur prokurori publik vlerëson se ka bazë për shqiptimin e masës së diversitetit, atëherë ai përcaktohet për llojin e masës përkatëse. Po që se e sheh të nevojshme, duhen ndër të tjera: rregullat Standarde Minimale të Kombeve Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit), të miratuara nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, 40/33 të dt 29 nëntor 1985, Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Delikuencës së të miturve (Udhëzimet e RIADIT), të miratuara dhe të shpallura me Rezolutën 45/112 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara me 14 dhjetor 1990, sesioni 68, plenar, Rregullat Standarde Minimale për Masat jo-Ndëshkimore (Rregullat e Tokios) të miratuara me Rezolutën 45/110 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të dt 14 dhjetor 1990.

Para se të nxirret aktvendimi për fillimin e procedurës përgatitore, prokurori publik duhet të shikojë shkresat e lëndës e me theks të posaçëm të përcjellë qëndrimin e të miturit në polici. Qëndrimi i të miturit në ndalim policor, llogaritet prej kohës së privimit prej lirisë, duke u shënuar data e saktë, koha, që nënkupton orën dhe minutat, të cilët do të llogariten në veprimet e mëtutjeshme të kërkuara privimit prej lirie nuk guxon të jetë më gjatë se 24 orë.

8. Shqyrtimi gjyqësor

Shqyrtimi gjyqësor përfaqëson një fazë të veçantë të procedurës penale për të mitur, në të cilën gjykata, pas shqyrtimit të gjithanshëm të provave, duhet të vendosë për arsyeshmërinë e propozimit të arsyetuar të prokurorit të shtetit. Së këndejmi, sipas paragrafit 1 të nenit 69 të KDM, gjyqtari për të mitur, pas pranimit të propozimit të arsyetuar, mund të merr aktvendim për hedhjen e propozimit të parashtruar apo për transferimin e çështjes në një gjykatë tjetër.¹⁰ Një aktvendim të tillë gjyqtari për të mitur, mund ta marrë atëherë kur çmon se vepra me të cilën është i ngarkuar i mituri, nuk paraqet vepër penale, kur ekzistojnë rrethanat të cilat përjashtojnë përgjegjësinë penale, kur ka kaluar afati i parashkrimit apo kur është përfshirë me amnisti ose falje apo ekzistojnë rrethana që e pengojnë ndjekjen, kur nuk ka prova që mbështesin dyshimin e bazuar se i mituri ka kryer veprën penale që i është ngarkuar, kur propozimi nuk është ngritur nga prokurori i shtetit kompetent dhe, kur çmon se gjykimi i veprës penale, është kompetencë e gjykatës tjetër. Nëse gjyqtari për të mitur nuk merr aktvendim për hedhjen poshtë të propozimit ose transferimin e çështjes në gjykatë tjetër, ai do të caktojë shqyrtimin gjyqësor brenda 8 ditëve nga dita e pranimit të propozimit.¹¹

Rrjedhimisht, trupi gjykues për të mitur, mund të pushojë procedurën e shqyrtimit gjyqësor dhe të shqiptojë masën e diversitetit, nëse i mituri pranon përgjegjësinë penale për veprën e kryer dhe kur shpreh gatishmërinë që të pajtohet me palën e dëmtuar. Para se të marrë një masë të tillë, trupi gjykues për të mitur dëgjon të miturin, prindin e tij, prindin adpotues, kujdestarin dhe mbrojtësin. Para se të caktojë ditën e mbajtjes së

⁹ Konventa për të drejtat e fëmijës.

¹⁰ Neni 16 i KPDM.

¹¹ Hajdari, Azem. *E drejta e procedurës penale pjesa e posaçme*. Prishtinë: 2013, fq. 140.

shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari për të mitur duhet t'i bëjë përgatitjet e nevojshme. Të japë urdhrin me të cilin cakton datën, vendin dhe orën ku do të mbahet seanca për shqyrtimin gjyqësor. Sipas paragrafit 1 të nenit 71 të KDM, kur gjykohet i mituri, publiku përjashtohet nga shqyrtimi gjyqësor. Pavarësisht kësaj, trupit gjykues për të mitur, megjithatë i ofrohet mundësia që të lejojë që në shqyrtim gjyqësor të marrin pjesë ekspertë dhe persona të tjerë të cilët profesionalisht trajtojnë mirëqenien dhe edukimin e të miturve ose, luftimin e sjelljeve kriminale të miturve, (paragrafi 2 i nenit 71 të KDM). Gjatë seancës gjyqësore, trupi gjykues për të mitur mund të urdhërojë që të gjithë personat ose personat e caktuar të largohen nga seanca me përjashtim të së miturit, prokurorit, mbrojtësit, përfaqësuesit të organit të kujdestarisë dhe përfaqësuesit të Shërbimit Sprovues.

Në fakt, trupi gjykues për të mitur mund të urdhërojë që prindi, prindi adoptues ose kujdestari të largohen nga shqyrtimi gjyqësor vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, nëse ka arsye për të besuar se kjo është në interesin më të mirë të së miturit. Gjyqtari për të mitur me propozimin e palëve, por vetëm në situata shumë specifike, mund të vendosë që shqyrtimi gjyqësor të shtyhet për një ditë. Për çdo shtyrje apo ndërprerje të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari për të mitur duhet të njoftojë kryetarin e gjykatës duke ia paraqitur arsyet për këtë, (neni 72 i KDM).

Më tutje, nëse prokurori i shtetit tërhiqet nga ndjekja para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari për të mitur njofton personat e thirrur në shqyrtim gjyqësor për ndërmarrjen e veprimit të tillë nga ana e prokurorit. Palët dhe i dëmtuari në thirrje për shqyrtim gjyqësor njofton për pranimin e fajësisë së të miturit, nëse ka ardhur deri te një situatë e tillë, ndonëse në procedurën penale për të mitur fakti i pranimit të veprës penale, duhet të merret me shumë kujdes dhe rezervë. Si parakusht për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor në procedurën penale për të mitur, paraqitet prania e subjekteve themelore të procedurës penale dhe e mbrojtësit.

Në këtë rrjedhë nëse në shqyrtim gjyqësor nuk vjen prokurori i shtetit, shqyrtimi gjyqësor shtyhet. Nëse i mituri, i cili është i thirrur nuk paraqitet në shqyrtim dhe mungesën nuk e arsyeton, siç është theksuar më lart gjyqtari për të mitur lëshon urdhërarrestin ose e shtyn shqyrtimin dhe urdhëron, që i mituri të shoqërohet në gjykatë në seancën e ardhshme. Ndaj të miturit të padisiplinuar, mund të caktohet paraburgimi, por kjo duhet të bëhet brenda suazave të ligjit dhe vetëm në rastet e shkeljeve të rënda të rregullave që kanë të bëjnë me disiplinën në shqyrtim gjyqësorë.

Nëse mbrojtësi i thirrur me rregull nuk vjen ose pa leje të gjyqararit braktis seancën, shqyrtimi ose do të shtyhet ose do të sigurohet mbrojtës tjetër kur kjo është e mundur. Në këtë rast, mbrojtësi mund të ngarkohet me shpenzimet e procedurës penale që i ka shkaktuar. Gjykata, në varësi të situatës, mund të vendosë që dëshmitarët dhe ekspertët që mungojnë pa arsye, të shoqërohen menjëherë ose shqyrtimi gjyqësor të fillojë pa praninë e tyre. Në këto raste, gjatë shqyrtimit gjyqësor, vendoset se për shkak të mungesës së dëshmitarit ose ekspertit, nëse duhet të ndërpritet apo të shtyhet shqyrtimi gjyqësor. Edhe dëshmitari, edhe eksperti, për mospërgjigje në ftesë, mund të ngarkohen me shpenzimet që kanë shkaktuar dhe mund të dënohen edhe me të holla. Është e rëndësishme të theksohet se trupi gjykues për të mitur, nuk është i lidhur me propozimin e prokurorit të shtetit me rastin e marrjes së vendimit të tij, lidhur me llojin e masës ose dënimit që do të shqiptohet (paragrafi 1 i nenit 73 të KDM).

Në procedurë për të mitur, po ashtu aplikohet ndryshimi dhe zgjerimi i akuzës. Megjithatë, trupi gjykues për të mitur është i autorizuar të marrë vendim, madje edhe

nëse prokurori i shtetit nuk ka ndryshuar propozimin e tij ose nuk ka përgatitur propozim të ri, në bazë të gjendjes faktike e cila ka ndryshuar në shqyrtim gjyqësor (paragrafi 3 i nenit 70 i KDM). Në rast se i mituri përgjigjet për vepra penale në bashkim, pa marrë parasysh se kur konstatohet se janë kryer ato, para ose pas shqiptimit të masës edukative apo dënimit me burgim për të mitur, gjykata i shqipton të miturit vetëm një masë edukative ose, vetëm dënimin me burgim për të mitur.

9. Aktet në procedurë penale ndaj të miturit

Vendimet në procedurë penale për të mitur, jepen në formë të aktvendimit dhe aktgjykimit. Me aktvendimin në procedurë penale për të mitur, zgjidhen si çështja procedurale, ashtu edhe çështja kryesore. Në këtë rrjedhë, me aktvendim vendoset kur:

- pushohet procedura penale, (par. 2 neni 73 i KDM) dhe,
- kur trupi gjykues shqipton masën edukative ose edukuese korrektuese, masën e trajtimit të detyrueshëm ose dënimin plotësues.

Në dispozitën e aktvendimit shënohet vetëm masa që shqiptohet, por i mituri nuk shpallet fajtor për veprën penale të përshkruar në propozimin e prokurorit të shtetit. Gjykata vendos me aktgjykim, kur të miturit i shqipton dënimin (paragrafi 4 i nenit 73 i KDM). Aktgjykimi merret konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, të cilat i përmban aktgjykimi dënues me procedurën penale të rregullt ku përfshihet edhe urdhri për shqiptimin e trajtimit të detyrueshëm, për rehabilitimin e kryerësve të mitur, të varur nga droga ose alkooli, kur janë në pyetje persona me këto varësi si dhe dënimi alternativ, kur gjykata ka shqiptuar dënimin e tillë.

10. Përfundime

Drejtesia penale për të mitur në Kosovë është e rregulluar me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, i cili përmban dispozita të natyrës penale materiale, procedurale dhe të ekzekutimit të sanksioneve penale. Ky kod ka pranuar zgjidhjet më bashkëkohore të drejtësisë penale për të miturit, të cilat në sistemin juridik të vendit tonë paraqiten për herë të parë. Në këtë kontekst duhet paraparë procedura e ndërmjetësimit, si procedurë jashtëgjyqësore, e cila shprehet vetëm atëherë kur ekziston vullneti i lirë dhe pjesëmarrja e kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, me qëllim të kthimit të raporteve normale në mes të miturit dhe palës së dëmtuar. Ndërsa dënimet ndaj të miturve shqiptohen për veprat penale që janë paraparë me dënimin mbi pesë vite burgim.

Gjatë studimit të kësaj problematike, kemi vërejtur se në praktikën gjyqësore masat edukative “Dërgimi i të miturit në qendër disiplinore”, “Dërgimi i të miturit në institucionin edukativ” dhe “Dërgimi i kryerësit të mitur në institucionin për kujdes të posaçëm”, nuk janë dhënë asnjëherë, për shkak se nuk ekzistojnë institucione për ekzekutimin e tyre. Organet kompetente nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për themelimin e këtyre institucioneve. Në mungesë të institucioneve adekuate, kemi edhe pamundësi të zbatimit në tërësi të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Konsideroj se, në këtë aspekt, duhet që të bëhet sa më parë themelimi i këtyre institucioneve, për të mundësuar zbatimin në tërësi të Kodit të Drejtësisë për të mitur. Personat e mitur i nënshtrohen ligjit me të gjitha karakteristikat e tyre specifike. Për shkak të këtyre specifikave, sistemi i drejtësisë duhet të shqyrtojë përgjegjësinë penale të

së miturve, si çështje të veçantë në kuadër të elementeve të veprës penale.

11. Rekomandime

Për gjyqësorin dhe autoritet e tjera relevante:

- T'i përmbahen parimit "të interesave më të mira për fëmijët", në procedurat penale ku përfshihen të miturit.

- Të sigurojnë që paraburgimi i dhënë kundër të miturve, të mos e tejkalojë afatin e paraparë me ligj (është propozuar shkurtimi në 6 muaj).

Për gjyqtarët:

- T'i përmbahen në mënyrë rigorozë rregullave procedurale, përkitazi me rolin e gjykatësit për të mitur dhe përbërjes së trupit gjykues në procedurë ndaj të miturve.

- Të veprojnë në mënyrë ekspeditive dhe t'u shmangen çfarëdo vonesave të panevojshme në procedurat penale ku përfshihen të miturit dhe,

- sapo që trupi gjykues për të mitur, ta pranojë propozimin nga prokurori publik për dhënien e ndonjë mase edukative apo dënimi, në fund të procedurës përgatitore, veç nëse ekziston një vendim për hedhjen poshtë të propozimit apo për transferimin e çështjes te ndonjë gjykatë tjetër, gjykatësi për të mitur duhet menjëherë, dhe jo më vonë se tetë ditë, të caktojë shqyrtimin kryesor.

Për Odën e Avokatëve të Kosovës:

- Të organizojë trajnime për avokatët mbrojtës mbi standardet ndërkombëtare të së drejtave të njeriut, që kanë të bëjnë me drejtësinë për të mitur.

Literatura

1. *Kodi Penal i Kosovës*, Prishtinë: 2013.
2. *Kodi i Procedurës Penale i Kosovës*, Prishtinë: 2013.
3. *Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Kosovës*, Prishtinë: 2010.
4. *Ligji "Për ekzekutimin e sanksioneve penale"* i Kosovës, Prishtinë: 2013.
5. Sahiti, Ejup dhe Rexhep Murati. *E drejta e procedurës penale*. Prishtinë: 2013.
6. Hajdari, Azem. *Procedura Penale, Komentar*. Prishtinë: 2010.
7. Hajdari, Azem. *Sistemi i drejtësisë për të mitur, Komentar*. Prishtinë: 2010.
8. Çollaku, Hashim. "Punim në Buletinin e Odës së Avokatëve të Kosovës. Karakteristikat kryesore të procedurës për të mitur sipas kodit penal të drejtësisë për të mitur në Kosovë". *Avokatura, viti V, nr. 8/2009*.
9. Henry, W. McGowen. *Të drejtat e njeriut dhe sundimit i të drejtës*. OSBE, Misioni në Kosovë.

Burime të tjera
10. *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut*, shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me 10 dhjetor të vitit 1948.
11. *Konventa Europiane për "Parandalimin e torturës ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese"*.
12. *Deklarata Mbi të Drejtat e Fëmijëve*, shpallur nga Asambleja e Përgjithshme në Rezolutën 1386 (XIV të 20 nëntorit 1959).
13. *Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve*, miratuar dhe e hapur për nënshkrim, ratifikim dhe pranim nga AP me -Rezolutën 44 /25 të 20 nëntorit 1989 që ka hy në fuqi më 2 shtator 1990.
14. Udhëzimet e KB për parandalimin e delikuentës së të miturve (Udhëzimet e Riadit), e miratuar dhe e shpallur më *Rezolutën 45 / 112 të AP*, më 14. dhjetor 1990, sesioni i 68-të plenar.
15. Rregullat e KB për mbrojtjen e të miturve që janë privuar nga liria e miratuar me *Rezolutën 45 / 113 të AP* më 14 dhjetor 1990.
16. Standardi i rregullave minimale të KB, për administrimin e të drejtave për të mitur "Rregullat e Pekinit", të adaptuar nga *Marrëveshja e Asamblesë së Përgjithshme nr. 40 / 33 të 29 nëntorit 1985*.
17. Rregullat Standarde minimale për masat jondëshkimore (*Rregullat e Tokios*) të miratuara me *Rezolutën 45 /110 të AP* të 14 dhjetorit 1990.

Reformimi i arsimit bazë policor për përballimin e sfidave të së ardhmes

Dr. Myzafer ELEZI

elezi_myzafer@yahoo.com

Abstrakt

Objekt i punimit është reformimi i arsimit bazë të policisë, programit dhe kurrikulave të tij, në përputhje me ligjin aktual për arsimin e lartë, me qëllim përballimin e sfidave të së ardhmes me të cilat do të ndeshet punonjësi i policisë së rolit zbatues. Sipas ligjit për Policinë e Shtetit kriteri kryesor për tu bërë pjesë e organizatës së Policisë së Shtetit është përfundimi i arsimit policor. Ky arsim starton në Shkollën Bazë të Policisë. Në këtë shkollë procesi mësimor zhvillohet me një program mësimor të miratuar, por që nuk është akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Ky program synon formimin e punonjësve të policisë të rolit bazë me njohuritë e nevojshme për kryerjen e detyrave të patrullës së përgjithshme. Me qëllim pasurimin e programit mësimor me ndryshimet që pësojnë aktet ligjore dhe nënligjore, në të cilat mbështetet puna e policisë, si dhe adoptimin e metodave bashkëkohore të procesit të mësimdhënies, specialistët e kurrikulës dhe kontrollit të cilësisë në Akademinë e Sigurisë, rishikojnë periodikisht programin dhe kurrikulat mësimore, bazuar në një procedurë standarde të miratuar. Duke qenë se Shkolla Bazë e Policisë synon të shndërrohet në Kolegj Profesional, lind i nevojshëm rishikimi i programit dhe i kurrikulave dhe hartimi i tyre në përputhje me kriteret ligjore të parashikuara në ligjin e ri për arsimin e lartë. Në këtë kontekst, nevojitet që programit të hartohet në mënyrë të tillë që të plotësojnë 60 kredite (ECTS) dhe çdo modul të ketë të përcaktuar kreditin përkatës. Ky është kriteri fillestar për të aplikuar pranë Ministrisë së Arsimit për akreditimin e këtij programi studimi. Kriter tjetër është cilësia e kurrikulave, niveli shkencor i stafit akademik, teknikat dhe metodat e mësimdhënies, etj. Në punimin do të paraqesim disa opsione lidhur me reformimin e këtij arsimit, hartimin e një programi mësimor cilësor në përputhje me ligjit për arsimin e lartë, që të formoj punonjës policie të pajisur me njohuritë e domosdoshme teorike dhe me aftësitë e kompetencat e nevojshme për aplikimin e tyre në praktikë.

Fjalëkyçe:

kursantë, shkolla bazë, kurrikula, program mësimor, punonjës policie, ligj.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

1. Hyrje

Shkollimi policor është një ndër kriteret bazë më të domosdoshme të organizatës së policisë për të formuar dhe trajnuar strukturat policore të nivelit operues e më tej, për të patur sukses në misionin e saj. Në Policinë e Shtetit trajnimi bazë për Patrullë e Përgjithshme ka marrë formë të plotë shkollimi në vitin 2006, falë suportit të misioneve ICITAP dhe PAMECA, të cilët asistojnë arsimin policor në vendin tonë. Fillimisht i janë nënshtruar një trajnimi 11 javor të gjithë punonjësit e policisë së rolit bazë, e mandej është vijuar me trajnimin e rekrutëve të rinj të përzgjedhur për tu bërë pjesë e organizatës së policisë duke ndjekur studimet e programit 20 deri në 22 javor për Patrullë e Përgjithshme. Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për Policinë e Shtetit¹ u krijua Akademia e Sigurisë² si institucion i arsimit të lartë policor në Shqipëri, përgjegjës për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit të nivelit operues, administrativ dhe menaxherial.³ Ndërsa me miratimin e ligjit për arsimin e lartë, kompetencat për organizimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor i kaluan ministrisë përgjegjëse për arsimin. Ndër të tjera në nenin 7 të këtij ligji përcaktohet se: *“Ministria përgjegjëse për arsimin është institucioni që realizon programin qeverisës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”*.⁴ Në këtë kuadër, ministri përgjegjës për arsimin ka ndërmarrë veprime për reformimin dhe riorganizimin e Akademisë së Sigurisë. Me Urdhrin nr. 180, datë 15.04.2016 të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit »

¹ Ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”.

² VKM nr. 185, datë 25.02.2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”.

³ Neni 37, pika 1, e Ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”.

⁴ Neni 7, pika 1, e Ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

riorganizimin institucional të Akademisë së Sigurisë”, Akademia e Sigurisë përbëhet nga dy njësi kryesore, përkatësisht nga Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, si dhe Kolegji profesional i lartë “Kolegji i Policisë”. Pra, shkollimi bazë policor bëhet njësi kryesore e Akademisë dhe rritet në nivelin e arsimit të lartë.

Nëpërmjet këtij punimi do të bëjmë një rezymë të situatës aktuale procesit të mësimdhënies, programit mësimor, të moduleve dhe kurrikulave që zhvillohen aktualisht në Shkollën Bazë, duke ofruar opsionin tonë për përmirësime të mundshme, të bërë këto në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore të nxjerrë nga ministri përgjegjës për arsimin, në funksion të zhvillimit dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor. I rëndësishëm është fakti që kurrikulat e programit mësimor duhet të jenë në koherencë me sfidat më serioze të përballjes së shoqërive demokratike në ditët e sotme, kryesisht me kërcënimet dhe rreziqet ndaj sigurisë publike, të cilat aktualisht kanë përhapje të gjerë në shumë vende të botës. Nëpërmjet këtyre kurrikulave të synohet që kursantit ti ofrohen njohuri bazë dhe trajnime të vazhduara për fenomenin e terrorizmit dhe krimin të organizuar, taktikat dhe teknikat që aplikohen sot në Europë e më gjerë për parandalimin dhe goditjen e këtij kërcënimi serioz.

2. Objektivat kryesore që duhet të arrijë programi mësimor i Kolegjit të Policisë

Aktualisht mësimdhënia në shkollën bazë të policisë përfshin zhvillim të leksioneve, seminareve, ushtrimeve, laboratorëve, praktikave mësimore e profesionale, si dhe veprimtari për përgatitjen dhe mbështetjen e procesit të mësimdhënies: përgatitje individuale, zhvillim të kurrikulave, provime, kontrole të pjesshme të dijeve, konsultime të programuara me studentët, etj. Një gjë e tillë parashikohet edhe në ligjin për arsimin e lartë, që do të thotë se ky nivel shkollimi ka plotësuar disa nga standardet më kryesore të procesit të mësimdhënies, në raport me kërkesat aktuale dhe metodat më të mira të cilat implementohen në institucionet e arsimit të lartë me eksperiencë disa vjeçare.⁵ Gjithashtu, në Ligjin nr. 80/2015 përcaktohet se Kolegji Profesional i Lartë është institucion i arsimit të lartë me orientim profesional, që përgatit profesionistë me aftësi praktike. Ai ofron veprimtari mësimore dhe trajnuese, që zgjasin një ose dy vite akademike me ngarkesë përkatësisht 60 ose 120 kredite (ECTS) dhe që finalizohen me lëshimin përkatësisht të një certifikate ose diplome profesionale.⁶ Një strukturë në përshtatje me këtë ligj duhet të jetë Kolegji profesional i lartë “Kolegji i Policisë”, i cili është miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.⁷

Kolegji i Policisë do të përbëjë ciklin i parë të studimit profesional, kohëzgjatja e

⁵ Udhëzim nr. 20, datë 09.05.2008, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”, në pikën 4 të tij përcakton elementet që përfshin zhvillimi i procesit të mësimdhënies.

⁶ Neni 21 Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se: “Mësimdhënia në institucionet e arsimit të lartë përfshin zhvillim të leksioneve, seminareve, ushtrimeve, laboratorëve, praktikave mësimore apo profesionale, si dhe veprimtari për përgatitjen dhe mbështetjen e procesit të mësimdhënies: përgatitje individuale, zhvillim të kurrikulave, përtëritje të materialeve didaktike dhe hartim të materialeve të reja, modernizim të metodave dhe të procedurave të transmetimit e të kontrollit të dijeve, përgatitje të materialeve didaktike nëpërmjet teknologjive të informacionit e komunikimit dhe përdorimi i këtyre teknologjive në veprimtari të mësimdhënies, provime, kontrole të pjesshme të dijeve, konsultime të programuara me studentët, etj”.

⁷ Urdhri nr. 180, datë 15.04.2016, i ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për riorganizimin institucional të Akademisë së Sigurisë”.

studimeve të të cilit duhet të jetë një vit akademik dhe forma e studimeve të jetë me kohë të plotë. Ky program studimi duhet të përmbajë 60 kredite (ECTS) dhe raporti i orëve mësimore në auditor me atë jashtë auditorit/studim i pa varur etj, të jetë në përputhje me kriteret akademike të përcaktuara nga ministria përgjegjëse e arsimit. Ne sugjerojmë 750 orë në auditor në vit, nga të cilat të parashikohet 20 - 25 orë në auditor në javë. Ngarkesa totale brenda dhe jashtë auditorit e cila të përfshijë numrin e orëve leksioni në auditor, numrin e orëve për aktivitete të tjera mësimore, si dhe numrin e orëve për studim individual dhe në total të përfshijë 1500 orë mësimore. Format e mësimdhënies të përfshijnë leksione, seminare, punë laboratorike, ushtrime dhe praktikë mësimore/profesionale në terren duke i'u përshtatur Udhëzimit nr. 20, datë 09.05.2008, të ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë".

Ndërsa programi i studimit në Kolegjin e Policisë, duhet të synojë që pjesëmarrësit/kursantët të jenë në gjendje që ditën që do të marrin detyrën e oficerit të patrullës së përgjithshme të policisë të kenë marrë njohuri të plota lidhur me:

- liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe përgjegjësitë e tij për të mbrojtur ato;
- detyrën funksionale si person që mbart autoritetin e punonjësit të zbatimit të ligjit, i cili do të jetë në kontakte të përditshme me qytetarët, për të krijuar një perceptim pozitiv tek publiku;

- legjislacionin shqiptar dhe procedurat e përgjithshme që ai duhet të zbatoj në praktikë për sigurinë publike, sigurinë rrugore, sigurinë në kufi, etj;

- veprimet e para në vendin e ngjarjes, sigurimin e informacionit për ngjarjen dhe autorët e mundshëm, mbledhjen dhe ruajtjen e provave materiale, arrestimin e autorëve të dyshuar, etj;

- menaxhimin e incidenteve me të cilat mund të ndeshet gjatë dinamikës së punës, përdorimin e pajisjeve, komunikimin, vetë-menaxhimin, si dhe veprimet për ndërhyrjen e parë në çdo situatë në përshtatje me mjedisin dhe rrethanat;

- kryerjen e kontrollit të ambienteve, kërkimin e provave dhe të personave;

- veprimet për dhënien e ndihmës së parë të personave të lënduar, viktimat të një aksidenti automobilistik, të një ngjarje e rëndë kriminale, akti terrorist, raste të dhunës në familje, dhunim i të miturve, viktimat të trafikimit dhe dhunimit seksual, etj;

- gjykimin dhe vendimmarrjen e shëndoshë të mbështetur në etikën dhe vlerat e kërkuara;

- aftësitë praktike profesionale për të përballuar dhe t'u japë zgjidhje e përgjigje situatave kritike krijuara nga kërcënimet dhe rreziqet ndaj sigurisë publike, me teknika të sprovuara, për të mbrojtur qytetarët dhe për t'u shërbyer atyre⁸.

3. Kurikulat e arsimit bazë policor në raport me kërcënimet dhe rreziqet ndaj sigurisë publike

Problemet kryesore të cilat kërcënojnë sot sigurinë publike janë terrorizmi dhe krimi i organizuar. Aktualisht në programin bazë për "Patrullë e Përgjithshme" janë parashikuar 479 orë mësimore për pjesën teorike të modulit "Policim i Përgjithshëm". Në këtë modul nuk ka asnjë temë për aktet terroriste, ndërsa ka shumë pak tema

⁸ Objektivat të ngjashme janë të parashikuara edhe në programin aktual të Shkollës Bazë të Policisë.

kundër krimit të organizuar. Krimi i organizuar trajtohet përciptazi vetëm me tre tema. Konkretisht në program janë parashikuar njëzetë orë mësimore, nga të cilat gjashtë orë për trajtimin e trafikimit të qenieve njerëzore, gjashtë për falsifikimin e dokumenteve dhe tetë orë për lëndët narkotike. Këto tema zënë 4.17 % të pjesës teorike të modulit “Policim i Përgjithshëm”. Tema e falsifikimit të dokumenteve Edhe pse në program është parashikuar që për temën e trafikimit të qenieve njerëzore të ofrohet një person me eksperiencë të tillë, ose një ekspert/hetues për të dhënë leksion, në përgjithësi një gjë e tillë nuk është realizuar, duke mjaftuar me literaturën e programit dhe eksperiencës e instruktorit mësimdhënës për trajtimin e temës.

Ndërsa, programi plotësues të Shkollimit Bazë Policor për “Patrullë e Përgjithshme”, me personelin e certifikuar Forca Komando, të përzgjedhur për trupë operacionale në forcat lëvizëse operacionale i vitit 2014, pjesa teorike të cilit zhvillohej me 147 orë mësimore, ka qenë e planifikuar një temë për aktet terroriste e cila zhvillohej për tre orë mësimore. Kjo temë zinte 3 orë mësimore ose 2.04 % të pjesës teorike të programit. Tema mësimore ka patur synim që të zhvillojë njohuritë e pjesëmarrësve mbi kërcënimet terroriste ndaj botës së sotme, karakteristikat dhe ideologjitë e terroristëve, tendencave në rritje, shqetësimet për të ardhmen si dhe planifikimet dhe metodat e sulmit nga ana e terroristëve. Ky program është zhvilluar në vitin 2014 dhe 2015 për katër javë mësimore dhe ka patur katër objektiva mësimore, të cilat po i citojmë më poshtë:

1. Shpjegojnë kuptimin e aktit terrorist;
2. Përkufizojë objektivat e aktit terrorist, format dhe metodat që përdorin;
3. Identifikojnë qartë karakteristikat e financimit të terrorizmit;
4. Shpjegojnë masat për parandalimin e akteve terroriste.⁹

Por, a është e nevojshme përfshirja e temave kundër akteve terroriste në programet e Kolegjit të Policisë? Unë mendoj se, po. Dhe, kjo përgjigje, lidhet me faktin se sot në botë, aktet terroriste kanë prekur pothuajse shumë shtete të zhvilluara, përfshi SHBA, Gjermaninë, Francën në disa raste, Britaninë e Madhe, Belgjikën, Turqinë, etj.

Për tu bërë ballë akteve me natyrë terroriste, të cilat mund të jenë prezentë edhe në vendin tonë, është e nevojshme marrja e njohurive dhe trajnimi i të gjithë trupës policore, duke filluar që nga shkollimi bazë e deri tek nivelet më të larta të drejtimit, me konceptet e terrorizmit, mesazhin që përcjell akti terrorist për publikun dhe qeverinë e vendit, qëllimet që duhet të arrijnë terroristët, masat parandaluese dhe veprimet që duhet të kryej punonjësi i policisë nëse ndodhet para, gjatë ose pas një akti terrorist.

Mendoj që kjo temë, të trajtohet për auditorin nga ekspertë të fushës, të cilët të paraqesin skenarë, foto, video, etj., nga situata të tilla, si dhe të rendisin veprimet e para që duhet të kryhen nga punonjësi i Patrullës së Përgjithshme, por edhe nga hetuesit e çështjes, për dhënien e ndihmës së parë viktimave të prekura, sigurimin e perimetrit/rrethimin e vendit të ngjarjes, sigurimin e provave, dokumentimin dhe kryerjen e veprimeve hetimore, etj. Rregullimi mund të bëhet edhe pa orë mësimore shtesë në programin aktual, por duke menaxhuar orët e miratuara nëpërmjet rialokimit të orëve që janë, p.sh. : mund të shkurtohen orë nga tema të ndryshme për të cilat gjykohej se janë më tepër sesa nevojiten, ose edhe opsioni tjetër, ai i shtimit në programin aktual të disa orëve mësimore për temën e terrorizmit.

⁹ Programi Mësimor për Shkollimin Bazë Policor për “Patrullë e Përgjithshme”, për personelin e certifikuar Forca Komando, përzgjedhur për trupa operacionale në FLO, Miratur me Urdhër nr. 1367/1, datë 30.09.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, PP-43.

4. Hartimi i një programi mësimor të akredituar në përputhje me ligjin për arsimin e lartë

Shpërndarja e krediteve (ECTS) të lëndëve sipas veprimtarive formuese të përcaktuara në Udhëzimin nr. 15, datë 04.04.2008, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të Arsimit të Lartë”. Ky udhëzim, në pikën II të tij, përcakton se: “Një krediti të formimeve universitare, i korrespondojnë 25 orë mësimore punë të studentit. Sasia mesatare e punës së kryer, gjatë një viti studimesh universitare, nga një student me kohë të plotë është 60 kredit apo 1500 orë mësimore punë të studentit, që përfshijnë orë në auditor dhe orë për punë të pavarur të tij.”¹⁰

Mbi bazën e këtij kriteri akademik mendojmë të bëjmë përcaktimin e krediteve për çdo modul të programit, duke përcaktuar raportin në % të çdo moduli me programin teorik të shkollimit bazë. Nga përlllogaritjet e bëra rezulton kjo shpërndarje e krediteve:

EMËRTIMI I MODULIT	KREDITE	% që zë çdo modul në Programin Mësimor
A- Moduli i Policimit të Përgjithshëm	25 ECTS	41.67 %
B- Moduli i Aftësimit Policor Operacional	11 ECTS	18.33 %
C- Moduli i Ndihmës së Parë Mjekësore	2 ECTS	3.33 %
D- Moduli i Përgatitjes për Armët e Zjarrit	6 ECTS	10 %
E- Moduli i Gjuhës së Huaj	3 ECTS	5 %
F- Moduli i Sistemit Informatikë	3 ECTS	5 %
G- Moduli i Praktikës Profesionale	10 ECTS	16.67 %
Total	60 ECTS	100 %

Sikurse aplikohet në çdo institucion të arsimit të lartë, çdo modul përbëhet nga një ose disa lëndë, të ndara në kredite. Më poshtë po paraqesim opsionin tonë lidhur me lëndët që do të përfshihen në çdo modul.

Shpërndarja e lëndëve sipas moduleve			
Nr.	MODULI	Nr.	LËNDËT
1.	“Policim i Përgjithshëm”	1.	Formimi i përgjithshëm
		2.	Rendi dhe siguria publike
		3.	E drejtë penale dhe procedurale
		4.	Kufiri dhe migracioni
		5.	Shkencaat ligjore
2.	“Aftësim Policor Operacional”	6.	Teknika të ndërhyrjes dhe vetëmbrojtje
		7.	Përgatitje fizike
		8.	Disiplina policore
3.	“Ndihma e Parë”	9.	Ndihmë e parë
4.	“Përgatitje për Armët e Zjarrit”	10.	Njohuri mbi armët e zjarrit
		11.	Veprimtari praktike me armët
5.	“Gjuhë e Huaj”	12.	Gjuhë e huaj (angleze)
6.	“Sistemet Informatike në Polici”	13.	Informatikë
7.	“Praktikë Profesionale”		Trajnim në terren

Studime më të avancuara të lëndëve të përshkruara më lartë janë parashikuara në programet aktuale të sistemit “bachelor” në Akademinë së Sigurisë. Studentët të cilët do

¹⁰ Udhëzim nr. 15 datë 04.04.2008, i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të Arsimit të Lartë”.

të hyjnë në fakultetin e Sigurisë dhe Hetmit, të Akademisë së Sigurisë, do të mbartin 60 kredite (ECTS) nga programi i prezantuar më sipër dhe, në bazë të ligjit për arsimin e lartë, kanë mundësinë e transferimit të këtyre krediteve e për rrjedhojë, shkurtohet me një vit periudha e qëndrimit në fakultet me statusin e studentit. Ky sugjerim ka efekt pozitiv të dyfishtë, si për studentët edhe për institucionin. Nga njëra anë, ndihmon studentët, duke i shkurtuar kohën me deri në një vit akademik dhe, nga ana tjetër, lehtëson buxhetin e Policisë së Shtetit, pasi siç dihet, aktualisht studentët gjatë gjithë periudhës së studimeve të larta marrin pagë të plotë.

Nr.	Moduli / Lëndët	Orët faktike						
		Kredite	Leksione	Seminare	Veprimtari praktike	Punë laborator	Vetëstudim	Gjithsej
A.	POLICIM I PËRGJITHSHËM	25	190	85	30	5	315	625
A.1.	Formimi i përgjithshëm	5	40	20	-	-	65	125
A.2.	Rendi dhe siguria publike	9	70	25	15	-	115	225
A.3.	E drejtë penale dhe procedurale	7	50	20	15	-	90	175
A.4.	Kufiri dhe migracioni	2	15	10	-	-	25	50
A.5.	Shkencat ligjore	2	15	10	-	5	20	50
B.	AFTËSIMI POLICOR OPERACIONAL	11	44	16	167	-	48	275
B.1.	Teknikat e ndërhyrjes & vetëmbrojtje	7	40	16	76	-	43	175
B.2.	Përgatitje fizike	3	-	-	75	-	-	75
B.3.	Disiplinë policore	1	4	-	16	-	5	25
C.	NDIHMA E PARË	2	15	-	10	-	25	50
C.1.	Ndihma e parë	2	15	-	10	-	25	50
D.	PËRGATITJE PËR ARMËT E ZJARRIT	6	40	15	35	-	60	150
D.1.	Njohuri mbi armët e zjarrit	4	30	10	-	-	60	100
D.2.	Veprimtari praktike me armët	2	10	5	35	-	-	50
E.	GJUHË E HUAJ	3	25	10			40	75
E.1	Gjuhë e huaj	3	25	10			40	75
F.	SISTEMET INFORMATIKE	3	20	-	10	15	30	75
F.1.	Informatikë	3	20	-	10	15	30	75
G.	PRAKTIKË PROFESIONALE	10	-	-	250	-	-	250
G.1.	Trajnim në terren	10	-	-	250	-	-	250
	Shuma	60	334	126	502	20	518	1500

6. Konkluzione

Procesi i reformimit të sistemit të edukim trajnimit policor shqiptar duhet të bëhet në raport me sfidat e përbaljes së strukturave të sigurisë, e në veçanti të Policisë së Shtetit, me kërcënimet dhe rreziqet ndaj sigurisë publike që paraqiten në ditët e sotme. Ai duhet të synoj realizimin e trajnimit së të gjitha niveleve hierarkike në polici, pavarësisht kostove financiare që nevojitet. Rishikimi i programeve mësimore duhet të bëhet mbi baza ligjore dhe argumente të vlefshme, duke tentuar të implementohen në to eksperiencat më të mira të policive të vendeve partnere, duke u konsultuar vazhdimisht edhe me këshilltarët e misioneve ICITAP dhe PAMECA që asistojnë Policinë e Shtetit.

Edhe pse shkollimi bazë policor është gjykuar si i konsoliduar, jap disa sugjerime të

cilat lidhen me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Organizimi i kurrikulës duhet ribërë në lidhjen integrale që kanë planet mësimore me njëri tjetrin. Rishikimi i kurrikulës duhet bërë sipas procedurave standarde të miratuara¹¹. Shpeshherë ka mungesë lidhjeje, mes një plani mësimor dhe një tjetri dhe kjo, sjell çorientim tek pjesëmarrësit/kursantët. Shqetësimi lidhet me faktin se një student që sapo hyn në strukturat policore nuk ka hapësirën e nevojshme për një adaptim normal, në një organizatë të tillë siç është Policia. Shkollimi duhet të parashikojë një fazë të parë të instruksionit, ku studenti të njihet me organizatën, misionin dhe historikun, vlerat, etj.

Krijimi i një bordi vlerësues mbi përmbajtjen kurrikulare është më shumë se i nevojshëm. Objekt pune i këtij bordi duhet të jetë cilësia e këtyre kurrikulave, nëse ato janë të standardizuara me ato të sistemeve arsimore homologe, janë këto kurrikula produkt i një kaste njerëzish me eksperiencë operationale policore, apo krijime të individëve pa status shkencor, e përktihme të shëmtuara, të aplikuarra kuturu, në mungesë të një bordi vlerësimi, që gëzon ekspertizë bashkëkohore. Pikërisht këtu është edhe sfida më e madhe që paraqitet përpara çdo kursanti dhe instruktori mësimdhënës. Gjykoj se modulet e shkollimit bazë, duhet të jenë organizuar në këtë format shkencor. Ekspertiza e këshilltarit të misionit ICITAP, që asiston sistemin arsimor policor në Shqipëri, ka dhënë efekte tepër të vyera në lidhje me formatin shkencor të kurrikulave dhe përmbajtjen e tyre, pasurimin e tyre me konceptet bashkëkohore, duke i përafuar ato me kurrikulat që zhvillohen në arsimin bazë amerikan dhe të disa vendeve të Bashkimit Europian. Bashkëpunimi me këtë mision, por dhe me misionet e tjera ndërkombëtare duhet të vazhdoj të thellohet më tej edhe në të ardhmen.

Duhet theksuar se, arsimit bazë policor në dhjetë vitet e fundit është reformuar tërësisht. Falë angazhimit të stafit mësimdhënës dhe sportit nga misionet ndërkombëtare ICITAP e PAMEC, por dhe bashkëpunimit me shkollat policore të vendeve partnerëve është arritur të krijohet një shkollë me programe dhe kurrikula të plota, e cila formon punonjës policie të rolit zbatues me njohuritë e nevojshme dhe aftësitë e duhura për përballimin dhe kryerjen e detyrave të patrullës së përgjithshme në Policinë e Shtetit. Megjithatë, mbetet ende për të bërë në lidhje me pasurimin në vijimësi të këtyre kurrikulave me përvojat më të mira të policisë shqiptare dhe të rajonit, por edhe me përmirësimin e teknikave e metodave të mësimdhënies, me qëllim rritjen e nivelit të përvetësimit të njohurive, fokusimin tek çështjet që kërcënojnë sigurinë publike, kryesisht terrorizmi dhe krimi i organizuar, si dhe masat e domosdoshme për përballimin e sfidave të përballjes me to.

7. Rekomandime

Rishikimi i kurrikulës të arsimit bazë policor të bëhet periodikisht nga specialistët më të mirë të Akademisë së Sigurisë dhe me eksperiencë, por të angazhojë edhe ekspertë të Policisë së Shtetit sipas fushave përkatëse edhe me qëllim vlerësimin e kurrikulës duke u mbështetur në parimet dhe procedurat standarde të punës së Policisë së Shtetit, njohuritë, kompetencat dhe aftësitë që kërkohet të ketë një punonjës policie i Patrullës së Përgjithshme, si dhe detyrat që kërkohet të zgjidhen prej tij në praktikën e përditshme të punës, përvojat më të mira në vite të Policisë së Shtetit, vendeve të rajonit dhe më

¹¹ Procedura Standarde për "Hartimin, rishikimin, kontrollin e cilësisë dhe administrimin e kurrikulave", miratuar me Urdhër nr. 213, datë 07.03.2016 të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

gjerë. Gjithashtu mendoj që, specialistët e kurrikulës në Akademinë e Sigurisë, të kenë bashkëpunimin me struktura të arsimit të lartë, për njohjen dhe implementimin në programin mësimor të Kolegjit të Policisë, të metodave më të mira të mësimdhënies e vlerësimit dhe kontrollit të njohurive.

Rekomandojmë, përfshirjen në program të temave që lidhen me kërcënimet ndaj sigurisë publike, si p.sh. : terrorizmi, duke synuar që kursanti të marrë njohuri të mjaftueshme për përkufizimin e aktit terrorist, qëllimi dhe objektivat e aktit terrorist, format dhe metodat që përdorin, të identifikojnë qartë karakteristikat e financimit të terrorizmit si dhe masat për parandalimin e akteve terroriste. Gjithashtu, kursanti duhet të mësojë për veprat e rënda penale që lidhen me aktet terroriste dhe karakteristikat e tyre, pasojat, organizatat kriminale, rekrutimi i personave për tu përfshirë në organizata terroriste, si dhe veprimet e policisë në një situatë të tillë, para, gjatë dhe pas kryerjes së një akti terrorist, kërcënimet terroriste ndaj botës së sotme, karakteristikat dhe ideologjitë e terroristëve, tendencave në rritje, shqetësimet për të ardhmen si dhe planifikimet dhe metodat e sulmit nga ana e terroristëve, etj. Temat që lidhen me terrorizmin duhet të parashikohet të zhvillohet në jo më pak se 20 orë mësimore dhe, për trajtimin e të cilave të sigurohen video me pamje filmike në situata të tilla kriminale. Gjithashtu, për trajtimin e kësaj teme, të angazhohen në procesin e mësimdhënies ekspertë/specialistë të Drejtorisë kundër Akteve Terroriste në Policinë e Shtetit ose prokurorë me eksperiencë në hetimin e veprave me natyrë terroriste.

Gjithashtu rekomandojmë:

- Rishikimin dhe hartimin e një infrastrukture të re organizative në sistemin bazë policor, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi,

- Përcaktimin e statusit të arsimit bazë/Kolegjit të Policisë në sistemin arsimor të Republikës së Shqipërisë. Hartimin e rregullores së brendshme të këtij cikli studimesh në përputhje me ligjin për Policinë e Shtetit dhe ligjin për Arsimin e Lartë, si dhe përfshirjen e tij në statutin e Akademisë së Sigurisë, si njësi kryesore të saj, kriter ky i detyrueshëm për akreditimin e programeve të studimit.

- Pikët e kursantëve në testet/quiz-et, të marra nëpërmjet kontrollit elektronik të njohurive me shantron, të konvertohen në nota, bazuar në sistemin e pikëve që aplikohet sot në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Për rrjedhojë, kursantët/studentët e Kolegjit të Policisë krahas diplomës apo certifikatës të pajisen edhe me listën e notave përkatëse. Mesatarja e notës, e përcaktuar me vendim Senati, të shërbej edhe si kriter për vazhdimin e studimeve të mëtejshme në ciklin e studimeve pasardhëse.

- Adaptimin dhe zhvillimin e programeve trajnuese mësimore sipas standardeve të kurrikulës së CEPOL (Akademitë e Policisë së vendeve anëtarë të Bashkimit Europian).

- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me ICITAP, PAMECA, OSCE dhe me policitë e vendeve partnere, me qëllim zhvillimin e trajnimeve profesionale me tema që lidhen me çështjet e kërcënimit të sigurisë sot në botë, kryesisht me terrorizmin ndërkombëtar dhe krimin e organizuar, veprimet parandaluese nga institucionet ligjzbatuese, veprimet e para që duhet të kryej punonjësi i patrullës së përgjithshme pas marrjes së njoftimit për një akt të tillë kriminal, teknikat e hetimit, bashkëpunimit ndër-institucional e ndërkombëtar, si dhe masat që ndërmerren për tu ardhur në ndihmë viktimave të këtyre sulmeve, etj.

- Rishikimi i procedurave të përzgjedhjes të stafit mësimdhënies sipas parashikimeve të përcaktuara në Ligji nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Duhet që stafi mësimdhënës

të jetë i trajnuar më parë për teknikat e mësimdhënies, dhe të synohet që çdonjëri prej tyre të ketë planifikim për kërkimin shkencor në fushën e drejtësisë dhe sigurisë.

- Ngritja e Drejtorisë së Sigurimit të Cilësisë dhe Trajnimeve pranë rektoratit, me qëllim që të hartoj raportin e cilësisë së brendshme të institucionit, kontrollin dhe sigurimin e cilësisë akademike të programeve dhe kurrikulave që zhvillohen, zhvillimin e trajnimeve profesionale, si dhe ndjekjen e procedurave për akreditimin e këtij niveli studimi, duke shërbyer si pikë kontakti me ministrinë përgjegjëse për arsimin.

Referencat

1. Ligji nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit".
2. Ligji nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
3. VKM nr. 185, datë 25.02.2015, "Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë".
4. Statuti i Akademisë së Sigurisë, miratuar me Urdhër nr. 490, datë 21.09.2015 të ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Arsimit dhe Sporteve.
5. Rregullore e Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015.
6. Urdhër nr. 180, datë 15.04.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për riorganizimin institucional të Akademisë së Sigurisë".
7. Procedura Standarde për "Hartimin, rishikimin, kontrollin e cilësisë dhe administrimin e kurrikulave", miratuar me Urdhër nr. 213, datë 07.03.2016 të Drejtorit të Policisë së Shtetit.
8. Udhëzim nr. 15 datë 04.04.2008, i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për organizimin e studimeve në institucionet publike të Arsimit të Lartë".
9. Udhëzim nr. 20, datë 09.05.2008, i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë".
10. Programi Mësimor për Shkollimin Bazë Policor për "Patrullë e Përgjithshme", për personelin e certifikuar Forca Komando, përzgjedhur për trupa operacionale në FLO, miratuar me Urdhër nr. 1367/1, datë 30.09.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
11. Programi Mësimor për "Patrullë e Përgjithshme", miratuar me Urdhër nr. 533, datë 17.05.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm të Akademisë së Sigurisë.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimit»

370

P Ë R F U N D I M E

të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare “Kontributi në Sigurinë Publike nëpërmjet arsimimit”

Me 1 nëntor 2016, në Tiranë, u zhvilluan punimet e Konferencës së I-rë Shkencore Ndërkombëtare: “Kontributi në Sigurinë Publike nëpërmjet arsimimit”. Konferenca u organizua nga Akademia e Sigurisë në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Akademinë e Forcave të Armatosura dhe Universitetin e Romës “Tor Vergata”.

Konferencën e nderuan me pjesëmarrjen e tyre akademike, studiues, analistë dhe të ftuar nga institucionet e arsimit të lartë të rendit publik, sigurisë, mbrojtjes, pjesëtarë të misionëve të huaja që asistojnë policinë dhe struktura të tjera ligjzbatuese, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Në fokus të Konferencës ishte natyra shumëdimensionale e kërcënimeve dhe rreziqeve në fushën e sigurisë, të cilat imponojnë trajtimin e çështjes së arsimimit jo vetëm si prioritet, por si një ndër mjetet e rëndësishëm për forcimin dhe zhvillimin më tej të saj. Përvoja e vendeve të përparuara ka vërtetuar se, *arsimimi dhe trajnimet profesionale të ndërthurura me kërkimin shkencor realizojnë synimet për një policim më dinamik dhe të adoptueshëm me ambientin e ndryshueshëm të sigurisë*; vërehen nivele më të larta të sigurisë publike me rritjen e investimeve në kualifikimin e burimeve njerëzore dhe mbështetje më e madhe nga komuniteti, kur personeli i mirëarsimuar i shërben sigurisë së tyre; sikurse adoptim më i lartë me ambientin dinamik të kërcënimit dhe përmirësim i kapaciteteve menaxheriale të organizatës, të materializuara këto, në zona e rajone me rend e siguri normale dhe kriminalitet më të ulët.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Kontributi
në sigurinë
publike
nëpërmjet
arsimimit »

Objekti kryesor i konferencës ishte trajtimi gjithanshmërisht i rolit dhe impaktit të arsimit në tërësi, në zbutjen e kërcënimeve ndaj sigurisë dhe i arsimit të trajnimit profesional në veçanti, në raport me sfidat e sotme dhe të ardhshme të sigurisë publike. Sikurse, diskutimi i qasjeve dhe rekomandimeve për përmirësimin e programeve akademike për të përgatitur ekspertë të lartë sigurie për policinë dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit.

Nëpërmjet referateve, kumtesave dhe diskutimeve të fokusuara në kontributin e arsimit për problemet e sigurisë publike, në të tre sesione plenare, lidhur me rritjen e impaktit të proceseve të formimit, kualifikimit dhe trajnimit profesional për sigurinë, u arrit në disa përfundime, prej të cilave veçojmë:

- Shumica e referuesve dhe diskutuesve, vunë theksin në domosdoshmërinë e ndërgjegjësimit të së gjithë aktorëve dhe faktorëve relevante (politike, sociale, ekonomike, religjioze, etj.) dhe përfshirjes së tyre, së bashku me strukturat e sigurisë dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, në përballjen me sfidat bashkëkohore të sigurisë, si dhe rolin e veçantë të institucioneve akademike për formimin dhe forcimin e kapaciteteve të ekspertizës të punonjësve të policisë dhe zyrtarëve të tjerë të zbatimit të ligjit në përballimin e këtyre sfidave, nëpërmjet arsimit dhe trajnimit të burimeve njerëzore.

- Shkollimi bazë policor ka luajtur një rol të rëndësishëm për përgatitjen e një shërbimi policor shqiptar drejt standardeve euroatlantike, ndërsa sistemi arsimor i përzgjedhur për ecurinë në karrierë, sidomos nga niveli bazë për në nivelin e parë të drejtimit, të punonjësve të policisë që kanë përfunduar këtë shkollim, keqmenaxhimi i këtij procesi si dhe mbyllja e Akademisë së Policisë, kanë penguar plotësimin e nevojave sasiore dhe cilësore të Policisë së Shtetit me specialistë nënkomisarë, që të zotërojnë aftësitë parësore të kërkuara për të përmbushur përgjegjësitë e vendit të punës e përballur me sfidat e kohës, pasoja të cilat janë ndjerë në përgjithësi në të gjithë strukturat e Policisë së Shtetit e, në veçanti, në strukturat e hetimit të krimeve.

- Fillimi i reformimit të plotë të sistemit arsimor policor dhe themelimi i Akademisë së Sigurisë, konceptimi i saj si institucion i arsimit të lartë publik, me programe ku ndërthuren arsimiti bazë policor në Kolegjin e Policisë, arsimimi i lartë në të tre ciklet sipas Kartës së Bolonjës si dhe trajnimet e kualifikimet profesionale, shënojnë një moment të rëndësishëm kthese për Policinë e Shtetit, në përgatitjen e një shërbimi policor profesional e të aftë për t'u përballur me sfidat bashkëkohore të sigurisë.

- Policia e Shtetit është ndër institucionet kryesore me mision, rol dhe pritshmëri të veçanta në përballje me krimin dhe kërcënimet e tjera reale për sigurinë. Ndaj dhe mbetet gjithnjë në rritje kërkesa për punë e shërbime gjithnjë e më profesionale në përmbushje të misionit të saj.

- Vlerësohet dhe mbështetet "Formimi vazhdues", si mënyrë e të studiuarit gjatë gjithë karrierës dhe sistem programesh me objektiva të gjera, të thella, specifike dhe të integruara me nivele të tjera të arsimit. E ndërthurur me forma të reja të mësimdhënies, ai e konsideron nivelin e arritur nga programet e mëparshme, i ripërtërin ato dhe ndihmon në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive për zbatimin në kohë të ligjeve e akteve të fushës së kontrollit të krimit dhe sigurisë publike. Këto do ta nxjerrin procesin e sotëm nga formalizmi duke e kthyer në mundësi reale që çdo punonjës të bëhet më i aftë profesionalisht, më i disiplinuar dhe më i informuar mbi përgjegjësitë që ushtron.

